

SHKOLLA E MESME TURGUT OZAL

YEARBOOK 2024



MATURA YEARBOOK

2024





KOLEGJI TURGUT OZAL TIRANË

**MATURA
2024**

Drejtori
Mustafa Gezen

Menaxhere përmbajtjeje
Sonila Shehu
Flora Çollaku
Roza Pali

Fotografe-Designer
Ola Xhaferaj

Falenderime të veçanta shkojnë për:

Olanda Muça
Adelajda Mujo
Donika Çekrezi
Greljon Zaimi
Rajmonda Haxhiaj

Brikela Salihaj
Erisa Muhja
Jonida Stafaj
Danjela Çuka
Flora Çollaku

Qëllimi i realizimit të këtij libri kujtimesh erdhi së bashku me dëshirën për të memorizuar në kujtesën e shkollës vitet e gjimnazit të Maturës 2024. Në këtë rrugëtim trevjeçar, nxënësit, që sot janë të diplomuar e mbajnë emrin Maurantë, kanë mbledhur vlerat, dijen dhe kulturën në një pergamenë, e cila do të jetë pasaporta që do të hapë dyert e tyre të jetës së suksesit.



drejtoria@turgutozal.edu.al



+355 69 31 83 041



Turgut Ozal High School Tirana



Turgut Ozal High School Tirana



Turgut Ozal High School Tirana

PËRMBAJTJE

4	Himni i Flamurit
5	Presidenti i Republikës së Shqipërisë
6	Drejtori i Shkollës “Turgut Ozal”
7	Drejtori Didaktik
8	Administrata
15	Kujtime të Maturës 2024
18	Foto të klasave të 12-ta
40	Kujtime nga Klasa 12-A
68	Kujtime nga klasa 12-B
96	Kujtime nga klasa 12-C
122	Kujtime nga klasa 12-D
152	Kujtime nga klasa 12-E
182	Kujtime nga klasa 12-F
210	Kujtime nga klasa 12-G
238	Kujtime nga klasa 12-H
266	Kujtime nga klasa 12-I
284	Kujtime nga klasa 12-J
310	Redaktorët
311	Kujtime nga Ceremonia e Maturës 2024

HIMNI I FLAMURIT

Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshir` e një qëllim,
Të gjith` atij duk` ju betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ai largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk friksohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!



Në dorë armët do t`i mbajmë
Të mbrojmë atdhenë më çdo kënd,
Të drejtat tona ne s`i ndajmë;
Këtu armiqtë s`kanë vend.
Se Zoti vetë e tha me gojë
Që kombet shuhen përmbi dhe,
Po Shqipëria do të rrojë;
Për të, për të luftojmë ne!

O flamur, flamur, shenj` e shenjtë,
Te ty betohemi këtu,
Për Shqipërin` atdhen` e shtrenjtë,
Për nder` edhe lavdimn` e tu.
Trim, burrë quhet dhe nderohet
Atdheut kush iu bë theror;
Për jet` ai do të kujtohet
Mbi dhe, nën dhe si një shenjtor!

Asdreni



Shkëlqesia e Tij z. BAJRAM BEGAJ
President i Republikës së Shqipërisë



Dear Class of 2024;

I am filled with gratitude for the moments we've shared and the progress you've made as I address you in these pages. The pages of this yearbook remind us of all the experiences, achievements, and memories that have shaped us into who we are.

As you step towards new adventures, remember that you carry with you the values and knowledge gained here. You are now joining our big alumni family. You are becoming part of a group that has been through our school and gone on to do great things. As you move forward, you will always be connected to us, and we can't wait to see your achievements unfold.

I would also like to extend my gratitude to our dedicated teachers and staff. Your guidance is appreciated more than words can express. You've played a vital role in our students' growth.

As we turn these pages and move ahead, let's remember the friendships, laughter, and lessons. Cherish the memories made and carry our school's spirit with you.

Congratulations, Class of 2024. The future is waiting, and we believe in each of you.

With pride,

Mustafa Gezen



Matura 2024,

Sa shpejt kaluan 9 muaj. Ishte një periudhë kohore që më shërbeu e më dha mundësinë, t'ju njoh më mirë e t'ju dua më shumë. Bashkë kaluam ditë të bukura, ditë kur ju shpalosët individualitetin tuaj: herë këmbëngulës e herë të paduruar, herë të qetë e herë si vullkanë :):); përditë sollët diçka të re, duke e bërë shkollën një mjedis të këndshëm e motivues.

Ju përgëzoj për çiltërsinë, të qenurit të hapur e të natyrshëm me njerëzit që ju rrethojnë. Këtë e kam parë përditë te ju dhe e kam çmuar pa masë.

Uroj që të jeni gjithmonë të suksesshëm në çdo hap tuajin. Të jeni të sigurt se në çdo sfidë e fitore, ne do të jemi me ju.

Për ta mbyllur, ashtu sikurse thotë edhe Chris Grosser: "Opportunities don't happen. You create them."

Bëhuni më të mirët!

Me dashuri,
Sonila Shehu

Omur Uyrca
Koordinator i
Alumnit



Bujar Muzhaqi
Nëndrejtor

Nuray Donmez
Këshilluese për
Arsimin e Lartë





Kastriot Capa
Këshilltar Shkollor

Eglantina Mulleti
Shefe e Udhëzimit
dhe Këshillimit



Brenardo Nuredini
Nëndrejtör

Greta Asllani
Shefe e Zyrës



Aida Kamberi
Psikologe



Valentina Yzeiri
Receptioniste





Ola Xhaferaj
Designer



Mirjana Uzun
Ekonomiste



Suela Tasha
Psikologe

Armela Likollari
Sekretare



Albulena Luli
Burimet Njerëzore

Mustafa Balci
Shef Transporti





Eduart Boja
IT Suport

Artiola Rama
Punonjëse
Biblioteke



Drilon Gelaj
Përgjegjës i
mirëmbajtjes

Enejda Damzi
Këshilluese për
Arsimin e Lartë






Tamerlan Shergazy
Këshillues për
Arsimin e Lartë

Kujtimet Matura 2024



Kujtimet Matura 2024











1995

ARANË

12A





12B





12C





1995

IRANĚ

12D







12E





95

ANË

12F





12G





95
ANË

12H





12I






12J







Olanda Muca

Të dashur nxënës të klasës 12 A,

Tre vitet e fundit kanë qenë një udhëtim i paharrueshëm për të gjithë ne. Kemi kaluar momente të bukura së bashku, kemi mësuar shumë gjëra të reja dhe kemi përballuar sfida të ndryshme. Secili prej jush ka sjellë diçka të veçantë në klasën 12 A.

Jam e lumtur që kam pasur mundësinë të jem pjesë e udhëtimit tuaj të mësimit dhe rritjes. Kam parë se si secili prej jush është rritur dhe është zhvilluar, duke përballuar sfida dhe duke arritur sukseset e tij.

Pavarësisht nga rruga që do të zgjidhni të ndiqni, unë jam shumë krenare për secilin prej jush dhe besoj fort se e ardhmja juaj është plot suksese dhe mundësi të pafundme.

Mbani mend gjithmonë vlerat dhe mësimet që kemi ndarë së bashku.

Gjithmonë puna e palodhur dhe këmbëngulja do t'ju çojnë drejt ëndrrave tuaja.

Me dashuri dhe respekt,

Mësuesja juaj kujdestare



Adelajda Shahini

-Sabjan Haska-

O pëllumbi i folesë, të uroj suksese dhe të daltë çdo gjë siç e parashikon. Je një shoqe shumë e mirë dhe e devotshme. Vazhdo kështu me ambicien dhe guximin tënd dhe ke për t'ia dalë mbanë më së miri. Të përqafohem HASKA

-Sara Halilaj-

Adelaa, një shoqe tepër e përzemërt e imja. Shoqëria jonë nisi me fillimin e gjimnazit ku kemi kaluar disa nga momentet më të gëzuara. Shkak i afrimit tonë u bë një pëlqim i përbashkët për një serial televiziv dhe që atëherë shoqëria jonë sa ka ardhur dhe është forcuar. Kemi kaluar shumë momente të këndshme, shpesh dhe të mërzitshme ku i kemi qëndruar pranë njëra-tjetrës. Personaliteti yt unik është gjëja që pëlqej më shumë te ty. Nuk e di a do njoh ndonjëherë një të dytë si ty. Shpresoj shumë që shoqëria jonë të zgjasë gjatë! Të uroj vetëm suksese në çdo hap tëndin! Mbështetjen time do e kesh gjithmonë.

-Debora Qendra-

Adela, ti ke qenë një nga shoqet e mia të para në gjimnaz. Për mua ti ke qenë vajza më interesante në Mehmet Akif. Fati donte që të na bashkonte përsëri në vitin e tretë dhe unë jam shumë e lumtur për këtë gjë. Jam shumë mirënjohëse që pata mundësinë të kaloj shumë momente të bukura me ty! Në bisedat me ty nuk mungojnë asnjëherë të qeshurat. Të falenderoj për kohën që kemi kaluar së bashku dhe të uroj suksese kudo në jetë!

-Erisa Noga

Jam e lumtur që kam një person të vetëm në të gjithë paralelin vitprodhim të 2004, pra moshataren time me pak fjalë. Ndihem ndonjëherë sikur je i vetmi person

që më kupton me të gjithë atë "tufën me fëmijë". Më pëlqen pa masë karakteri yt i çilter dhe disi lozonjar por në të njëjtën kohë shumë e fortë dhe stoike karshi gjërave që do. Adela, ishte kënaqësi për mua të shpenzoja këto vite gjimnazi me ty. Të uroj nga thellësia e zemrës sa më shumë suksese dhe lumturi në jetë! Të dua shumë!

-Greta Berisha-

Adelaaa, vajza më pozitive që unë kam njohur në jetën time. Në çdo moment të ditës ti je e gatshme ti ndihmohesh të gjithë. Je shumë e ëmbël dhe shumë zemërgjerë. Jam e lumtur që kam arritur të takoj një person si ti në jetën time. Suksese Adela!

-Hilda Marinaj-

Adela ti erdhe këtë vit në shkollën tonë dhe ke sjellë shumë pozitivitet. Je një vajzë shumë e çilter dhe e qeshur. Do më marr malli për komplimentet çdo mëngjes. Të uroj shumë suksese!

-Noel Sharka-

Edhe pse sapo u njohëm këtë vit miqësia jote e ka bërë këtë vit të veçantë. Faleminderit që je një shoqe fantastike dhe mezi pres të shoh se çfarë do të bësh në të ardhmen!

-Ines Balliu-

Adela, edhe pse nuk kemi shumë kohë që njihemi por prej kaq pak kohë bashkë kam kuptuar që je një vajzë shumë e qetë dhe e dashur. Jam shumë e lumtur për momentet që ne qeshnim në fiskulturë me historitë e Endit. Gjithashtu kam kuptuar se je një vajzë punëtore dhe përpiqesh të arrish çdo gjë që kërkon me forcat e tua. Nuk heziton kurrë të jesh aty për miqtë e tu dhe shpresoj të kesh sa më shumë suksese në jetë dhe të të plotësohen të gjitha dëshirat

-Dea Xhemalaj-

Pavarësisht se jemi njohur këtë vit më duket sikur kemi shumë vite që njihemi së bashku. Për këtë kohë që kam kaluar me ty kam kuptuar se je shumë e dashur dhe e sjellshme dhe në të njëjtën kohë je shoqe që të gjendet gjithmonë pranë atëherë kur ke nevojë. Je shumë punëtore dhe përpiqesh gjithmonë që të bësh më të mirën nga vetja jote. Të falenderoj për këtë kohë që kemi kaluar edhe pse e shkurtër dhe të uroj të kesh sa më shumë sukses në jetë.



Alban Himallari

-Albin Hoxha-

Kemi qenë shoke qe te vegjel edhe vazhdojme të jemi. Je një nga personat më gazmor që kam takuar dhe shpresoj që kjo gjë të mbetet me ty tërë jetën. Të uroj shumë suksese.

-Kristi Lipivani-

Bashkë jemi njohur që në klasë të parë dhe që atehere i kemi mirëmbajtur raportet shoqërore. Të uroj fat e sukses në aventurën për tu bërë mekaniku më i mirë në Shtetet e Bashkuara të Paskuqanit, respekte.

-Uejsi Caca-

Për Albanin mund të themi se është një djalë me një zemër të madhe, me një ego të forte dhe me pak shpirt aventurieri. Është i gatshëm gjithmonë të të gjendet pranë për çdo gjë. Ai është person i cili pëlqen humorin dhe me modestin e tij, na bën për të qeshur të gjithëve. Këtij djali, sigurisht, i uroj vetëm të mira në jetë.

-Hilda Marinaj-

Je një djalë shumë i mirë dhe i sjellshëm. Je djali që më bën për të qeshur sa here që ti mungon klasa është shumë qetësi. Të uroj shumë suksese !

-Albana Bami-

Mund të them që Albani është një person me shumë energji. Ai gjallëron të gjithë klasën dhe mendoj se batutat e tij do të mbahen mend nga të gjithë. Të uroj që të plotësohet çdo dëshirë që ke!

-Xhoi Beja-

Gjate këtyre viteve që kemi kaluar në klasë bashkë ke treguar që je një person me shumë humor, i qeshur dhe mund të them se je atmosfera e klasës. Kemi kaluar shumë kohë të bukura. Shpresoj të arrish çdo

gjë që do në jetë!

-Brusen Tupi-

Albani gjithmone ka pasur aftesinë për të të ngritur humorin dhe në ditë jo të mira dhe e falenderoj për respektin që kemi shkëmbyer me njëri-tjetrin. Shpresoj të kesh një jetë të mbarë.

-Noel Sharka-

Edhe pse bisedat tona kanë qenë të kufizuara, angazhimi yt me mësimin më tregon që ti je i përkushtuar. Mos u dorëzo dhe padyshim që do t'i arrish qëllimet e tua. Paç fat në të ardhmen!

-Idlir Mergjyli-

Me një zemër të madhe dhe një karakter të fortë, dallohesh nga të tjerët. Je një shembull i vërtetë i miqësisë dhe besnikërisë. Duke inkurajuar dhe duke mbështetur në çdo sfidë që takon shpresoj që kështu të bësh me këdo dhe të arrish majat.

-Ines Balliu-

Alban, je një djalë shumë energjik dhe pozitiv, I cili gjithmonë mundohet t'i bëjë të tjerët për të qeshur në çdo moment. Gjithmonë je përpjekur të tregosh anën tënde më të mirë dhe shpresoj që të arrish çdo gjë që ke ëndërruar dhe të uroj sa më shumë suksese në të ardhmen.

-Greta Berisha-

Një nga personat që i jep gjallëri klasës sonë je ti. Humori dhe pozitiviteti që të karakterizon ty mund ti rregulloj ditën çdo personi. Shpresoj të kesh sa më shumë suksese në jetë sepse e meriton!

-Hilda Marinaj-

Je një djalë shumë pozitiv dhe i sjellshëm. Personi i cili na bën të gjithë të qeshim. Ke një dëshirë shumë të madhe për të mësuar dhe kjo gjë me pëlqen shumë tek ti. Të uroj suksese kudo që të shkosh!

-Dea Xhemalaj-

Je një djalë pozitiv dhe gjithmonë krijon situata gazmore në klasë. Përpiqesh gjithmonë të tregosh anën tënde më të mirë duke krijuar një ambient pozitiv në klasë. Të uroj shumë suksese në jetë dhe të arrish gjithcka që dëshiron!



Albana Bami

-Albin Hoxha-

Albana është një vajzë shumë e sjellshme dhe e zgjuar. Ajo është e qetë dhe ka një zemër shumë të madhe. Albana di të respektojë e të falë dashuri dhe mbi të gjitha të gjendet pranë kur ti ke nevojë për të. Besoj se karakteri dhe zgjuarsia e saj do ta çojnë atë përpara. Të uroj fat, mbarësi dhe sukses në çdo hap që do të hedhësh!

-Xhoi Beja-

Të flas për shoqen time të ngushtë nuk është aq e lehtë. Albana është më shumë se një shoqe për mua. Ajo është një nga personat e vetëm që më kupton dhe që nuk do më gjykoj kurrë për asnjë vendim timin. Kujtimet që kemi bashkë mendoj se do ngelen gjithmonë të paharrueshme dhe do të ketë dhe shumë të tjera. Për mua ajo është më e mira në çdo aspekt të mundshëm dhe nuk ka dy si Albana. Jam me fat që je pjesë e jetës time dhe nuk mendoj se do të kishte një person që do mund të të zëvendësonte. Je një nga personat e mi të preferuar dhe ashtu do të mbetet gjithmonë. Dua të shoh të arrish majat dhe të kesh sa më shumë sukses në çdo moment të jetës! Love you!

-Hilda Marinaj-

Je një vajzë shumë inteligjente dhe e edukuar. Të uroj shumë suksese në karrierën tënde!

-Gjeorgjos Koci-

Një vajzë e sjellshme dhe shumë inteligjente. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat në jetë!

-Brusen Tupi-

Albana është një njeri i thjeshtë dhe me një frymë lidërshipi të madhe. Ajo ka një personalitet unik dhe

përcjell pozitivitet në cdo moment. Shpresoj të ketë mbarësi në jetë!

-Noel Sharka-

Dëshira dhe këmbëngulja jote për të mësuar gjatë këtyre më ka treguar se ti je një studente e talentuar, inteligjente dhe punëtore. Shpresoj që edhe në të ardhmen këto cilësi të ndihmojnë për çdo sfidë. Suksese!

-Emili Leka-


Thonë që shoqëritë më të mira nisin me konflikte, prandaj kemi kaq shumë vite shoqe. Të më thoje atëherë se do isha kaq afër me ty nuk do e besoja. Ndihem me fat që kam patur mundësi të kaloj këto vite të shkollës me ty. Nëse do më pyesnin për personin më funny do thoja se je ti. Nuk kalon një moment kur jemi bashkë, që nuk jemi duke qeshur. Jam e bindur se shoqëria jonë do të vazhdojë dhe pse ndonjëherë shakatë e mia duken si e kundërta, dhe padyshim që do jesh nga personat e parë që do telefonoj për cdo histori. Shpresoj që të vazhdosh me çiltërsinë tënde gjithmonë pasi ajo të karakterizon. Çdo person e thotë per ty se sa vajzë e drejtë dhe e mirë je kështu që nuk po i ripërmend. Love you!

-Sara Pajtoni-

Albana, kemi kaq vite shoqëri dhe je kthyer në një nga njerëzit më të afërt për mua. Nuk do i harroj kurrë momentet e bukura që kemi kaluar gjatë këtyre viteve. Je një nga vajzat më pozitive dhe të dashura që kam njohur ndonjëherë. Qëndro kaq e çiltër sa je tani gjithmonë. Ndihem me fat që kam një shoqe të ngushtë si ti në jetën time. Ke qenë gjithmonë aty për mua dhe faleminderit për çdo të qeshur dhe kujtim të bukur që kemi ndarë bashkë në këto vite. Fundi i shkollës erdhi por ne na presin vite akoma më të bukura së bashku. Të uroj më të mirat e botës në vazhdim sepse ti i meriton.

-Ines Balliu-

Albana, kemi 3 vite që njihemi, por kam kuptuar që ti ke qenë ajo vajza e lumtur dhe e sjellshme. Gjithmonë do të kujtoj këto momente kaq të bukura që kemi kaluar. Jam shumë e lumtur që të kam quajtur shoqe dhe tek ti vlerësoj shumë pozitivitetin dhe buzëqeshjen që mban gjithmonë në fytyrë. Shpresoj që të vazhdosh kështu. Të uroj shumë suksese!



Albin Hoxha

-Gjeorgjos Koci-

Djalë I qetë dhe I komunikueshëm.Nuk shqetësonte asnjë në klasë.Të uroj suksese.

-Idlir Mergjyli-

për një periudhë kaq të shkurtër kam kuptuar se je një njeri inteligjent por dhe serioz aty ku duhet. Të uroj suksesin e merituar dhe sa më shumë aventura të paharrurshme në jetë!

-Uejsi Caca-

Albini është një djalë introvert dhe i matur në gjërat që thotë me këdo. Ai është i gatshëm të të ndihmojë sa herë mundet ,pra le të themi se është pak altruist në natyrën e tij.Gjithmonë,përpiqet të respektojë këdo dhe nga vetja jep më të mirën e tij.Këtë mirësi që ai shfaq te të tjerët,ia uroj që ti kthehet mbrapsht,në çdo formë të mundshme.

-Hilda Marinaj-

Shoku im i ngushtë këto vite gjimnazi .Faleminderit për që smë lije asnjher pa muhabet .Je nje cun shumë i sjellshëm edhe pse ne pamje te pare nuk te jep ate pershtypje .Te uroj shume suksese!

-Adelajda Shahini-

Albini është një djalë i cili di të respektojë dhe di ku ti bëj shakatë. Unë e njoh si një djalë introvert i cili kur flet, flet me vend. Është shume i matur me ato që thotë dhe një njeri i qetë. I uroj suksese dhe më të mirat.

-Dea Xhemalaj-

Je një djalë serioz ,por dhe humorist në të njëjtën kohë. Po ashtu, je mjaft punëtor dhe tregon gjithmonë anën tënde më të mirë.Të uroj sa më shumë sukses në të ardhmen si në profesionin që ke zgjedhur dhe në jetë.

-Matteo Mavriqi-

Albin je Një djalë shumë i urtë dhe i mbajtur.Përpiqesh të arrish më të mirën.Të uroj suksese në studimet e tua!

-Endi Corja-

Të respektoj për seriozitetin dhe qendrimin që ke mbajtur gjatë këtyre viteve. Je djalë shumë I përmbledhur. Të uroj suksese në jetë.

-Greta Berisha-

Albin,je një djalë i mire dhe mjaft serioz.Të kam njohur keto 2 vitet e fundit dhe gjithmonë më je gjendur pranë në çdo gjë që të kam kërkuar.Te uroj shumë suksese në jet!

-Ines Balliu-

Albin, kemi që në vit të parë që jemi njohur dhe je një djalë punëtor dhe serioz. Gjithmonë je përpjekur të tregosh anën tënde më të mirë dhe shpresoj që të arrish çdo gjë që ke ëndërruar dhe të uroj sa më shumë suksese në të ardhmen.

-Idlir Mergjyli-

për një periudhë kaq të shkurtër kam kuptuar se je një njeri inteligjent por dhe serioz aty ku duhet. Të uroj suksesin e merituar dhe sa më shumë aventura të paharrurshme në jetë!

-Gledis Bajrami-

Një djalë i respektueshem,i komunikueshmëm dhe shumë i sjellshëm,ia kemi kalur shumë mirë kto vite që te kam patur ne klasë, të uroj te realizosh cdo dëshire tënden dhe të uroj shumë suksese në jetë!

-Noel Sharka-

Albin--Gjatë këtyre viteve e kam parë sa i zgjuar je, edhe pse ne nuk flasim me njëri-tjetrin në klasë. Shpresoj që e ardhmja jote të jetë plot me sukses! Paç fat në jetë!

-Megan Mara-

Albin kemi që në vit të parë që jemi në të njëjtën klasë dhe më je dukur një djalë i qetë dhe pozitiv. Të uroj fat dhe mbarësi në jetë

Albini përcjell vetëm mirësi dhe pozitivitet. Mendoj se karakteri i tij dhe qetësia që ai shfaq në situata të caktuara e bëjnë atë një person me këmbë ne tokë. Uroj që të arrish aty ku do!



Ardian Marinaj

Albin Hoxha- Kur kam parë listat e klasave asnjeherë nuk e mendoja që do të ishe një nga shokët e mi më të mirë. Kemi 3 vite që njihemi por që duken si 30 sepse kemi qenë jo vetëm në shkollë por edhe jashtë në shoqëri të njëri-tjetrit. Të uroj shumë suksese!

Idlir Mergjyli- Ardiani, me respekt dhe krenari për aftësitë dhe përkushtimin tënd në shkollë. Shembull i frymëzuar për të tjerët me dëshirën tënde për të mësuar dhe përparuar. Suksese të mëdha në rrugën tënde arsimore!

Uejsi Caca- Ardiani është një djalë shumë i mirë edhe me këmbë në tokë. Ai është i hapur ndaj gjithçkaje dhe nuk e vret mendjen për asgjë që atij i duket e parëndësishme. Ardiani është një person që dua ta shikoj gjithmonë sa më lart, dhe i uroj lumturi në çdo moment të jetës së tij.

Sofia Burimi- Ardian: Ardian je një djalë shumë pozitiv dhe plot energji, na ke bërë gjithmonë për të qeshur, të uroj suksese në jetë.

Albana Bami- Gjate këtyre viteve që kemi kaluar bashkë ke treguar që je një person me shumë humor, i qeshur dhe mund të them se je atmosfera e klasës. Kemi kaluar shumë kohë të bukura. Shpresoj të arrish çdo gjë që do në jetë!

Xhoi Beja- Mund të them që Ardiani është një person me shumë energji. Ai gjallëron të gjithë klasën dhe mendoj se batutat e tij do të mbahen mend nga të gjithë. Të uroj që të plotësohet çdo dëshirë që ke!

Megan Mara- Ardian je një djalë i cili ka gjithmonë energji dhe je pozitiv. Ti gjithmonë ke arritur të bësh

shaka në klasë. Të uroj suksese në jetë.

Uejsi Caca- Ardiani është një djalë shumë i mirë edhe me këmbë në tokë. Ai është i hapur ndaj gjithçkaje dhe nuk e vret mendjen për asgjë që atij i duket e parëndësishme. Ardiani është një person që dua ta shikoj gjithmonë sa më lart, dhe i uroj lumturi në çdo moment të jetës së tij.

Brusen Tupi- Ardiani është një djalë me seder dhe shpirt të mirë i cili është gjithmonë i gjendur në momente të vështira për të të ndihmuar. I uroj suksese në jetën e tij.

Ines Balliu- Ardian, kemi që në klasë të tetë që jemi në të njëjtën klasë dhe kam kuptuar që je një person i qeshur. Nuk do t'i harroj momentet kur ke menduar për të tjerët dhe je munduar të jesh tolerant kundrejt tyre. Të uroj gjithë të mirat dhe sa më shumë suksese në vazhdim!

Greta Berisha- Ardian, humoristi i klasës. Ke qenë një shok shumë i mirë për mua këto vite të fundit dhe gjithmonë më je gjendur pranë në çdo moment. Ata persona që të njohin mirë e dinë se çfarë personi i dashur dhe pozitiv je. Të uroj sa më shumë suksese në jetë!

Hilda Marinaj- Kushuriri dhe shoku më i mirë, je një djalë shumë i sjellshëm dhe i edukuar hahahah. Me mua do jesh gjithmonë dhe në universitet. Të uroj suksese! Të puth kushurira jote e preferuar!

Endi Corja- Vërtet ke qenë pjesë e klasës. Nëse ke objektiva në jetë, uroj që të të plotësohen. Suksese

Matteo Mavriqi- Je një djalë energjik dhe i shkathët. Kemi 3 vite në klasë bashkë. Skemi ndenjor shumë bashkë por me je dukur si një djalë i mirë. Suksese!

Dea Xhemalaj- Ardian je një djalë shumë energjik dhe i çilter. Cdo moment e kalon duke bërë shaka të ndryshme dhe duke na bërë për të qeshur. Uroj të kesh sa më shumë sukses si në jetë dhe në shkollë!

Adelajda Shahini- Ardiani është një djalë i cili i jep zë dhe në një farë menyrë gjallëri klases me shakatë që e karakterizojnë gjithë kohën. Është një djalë i logjikshëm dhe i shkathët. I uroj më të mirat dhe sukses kudo.



Arsia Sefaj

Albana Bami- Arsia është një vajzë e cila e shfaq pozitivitetin që ka brenda saj vetëm duke e parë. Ajo gjithashtu është përpjekur të më ndihmojë kur kam pasur ndonjë paqartësi. Do i ruaj gjithmonë kartolinat e tua. Të uroj vetëm të mira dhe suksese sëeetie!

Xhoi Beja- Mund ta përshkruaja me një fjalë si artistja e klasës por nuk mund ta lej me kaq sepse është shumë më shumë. Arsia është një vajzë pozitive, e zgjuar dhe shumë e talentuar. Gjithashtu ka qenë gjithmonë një person me shumë vullnet dhe i arrin gjërat që do. Të uroj vetëm të mira dhe suksese sëeetie!

Ueysi Caca- Arsia je një vajzë shumë pozitive dhe e talentuar. Gjithmonë të kam parë vetëm të buzëqeshur dhe kështu shpresoj të jesh përherë. Të uroj gjithë suksesin e kësaj bote dhe shpresoj që të të plotësohen të gjitha dëshirat që ti ke.

Brusen Tupi- Është një vajzë shumë e sjellshme dhe e gjendur gjithmonë për çdo problem të klasës. Shpresoj të ketë suksese të mëtëjshme!

Noel Sharka- Ti nuk je thjesht një shoqe e mire, aftësitë e tua në art i bënë ditët e shkollës më të gjalla dhe argëtuese. Talenti yt ka qenë një frymëzim i vazhdueshëm dhe krijimtaria jote është e mahnitshme! Urime në jetë dhe shpresoj të vazhdosh të bësh gjëra interesante!

Idlir Mergjyli- Për shoqen time të dashur Arsia. Me një zemër të ndritur dhe një shpirt të mirë. Faleminderit që je gjithmonë aty për ne me miqësinë tënde. Për të gjitha këto arsye dhe shumë të tjera, të dedikoj këtë fragment të vogël të mirënjohjes për ty. Shpresoj të arrish atë çfarë dëshiron.

Ines Balliu- Arsia, je një vajzë shumë e sjellshme dhe e lumtur. Gjithmonë do të kujtoj talentin që ti ke pasur për të bërë gjithçka dhe durimin për ta përfunduar atë. Jam shumë e sigurt që ti do t'ia dalësh në jetë me gjithë talentet që ke. Të uroj suksese në të ardhmen dhe jam e lumtur që të kam quajtur shoqe.

Greta Berisha- Një ndër vajzat më pozitive që unë njoh. Je gjithmonë e gatshme t'i ndihmosh të gjithë dhe kjo gjë më pëlqen shumë tek ti. Shpresoj që zgjuarsia jote të të ndihmojë të arrish sa më shumë në jetë. Sukseseeee!


Hilda Marinaj- Arisa ose senatorja më e bukur e shkollës. Kemi që në vit të parë që njihemi dhe kemi kaluar mjaft momente të bukura. Je një vajzë e zgjuar dhe e sjellshme me të gjithë. Shpresoj shumë që ëndrrat e tua të realizohen!

Matteo Mavriqi- Arsia je një vajzë shumë e zgjuar dhe e sjellshme. Me kreativitetin tënd gjithmonë ke qenë e gatshme të zbukuroje klasën me projektet e tua të bukura. Të uroj suksese!

Dea Xhemalaj- Arsia je një vajzë shumë e talentuar dhe e dashur me të gjithë. Gjithmonë të kam parë vetëm të buzëqeshur dhe kështu shpresoj të jesh përherë. Kemi krijuar një shoqëri mjaft të mirë me njera-tjetrën të cilën shpresoj ta vazhdojmë dhe pasi të mbarojë gjimnazi. Uroj që t'ia dalësh mbanë në jetë dhe të arrish majat për çdo gjë. Jam e sigurt që do të kesh përherë sukses sepse je shumë punëtore dhe gjithmonë përpiqesh të japësh më të mirën nga vetja jote. Suksese

Megan Mara- Arsia, ka qenë një kënaqësi që kemi që në klasë të 9 bashkë. Dhe pse gjimnazi ka qenë i vështirë përsëri ja kemi kaluar mirë në klasë. Je një vajzë e zgjuar, e sjellshme dhe e dashur. Vlerësoj çdo moment dhe shaka që ne kemi kaluar së bashku. Të uroj shumë suksese në jetë dhe shpresoj të arrish atë që ti dëshiron!

Adelajda Shahini- Arsia një vajzë me aftësi kreative ku ecën përpara me një shtysë dhe motivim të madh dhe me ambicie të forta. Vajzë e shoqërueshme me të gjithë dhe mbi të gjitha e dashur. Arsia karakterizohet nga një buzëqeshje e ëmbël e cila fsheh aftësi të mëdha dhe një dashuri të pafundme, gjë e cila e bën një njeri kreativ dhe në mendje dhe me një shpirt të hapur, ku i uroj që dhe sukseset e saj të jenë të pafundme, ashtu siç do ajo!



Brusen Tupi

Gjeorgjos Koci- Mbaj mend në vit të parë që të kam parë në orën një të natës duke lexuar biologjinë dhe thash me vete sa mësonka ky. Me ty kam shumë kujtime të bukura dhe nuk harrohesh ti për gjërat që ke bërë.

Albin Hoxha- Eshte viti I parë të njoha edhe që tani je bërë një shok shumë I mirë për mua. Shkatë me ty nuk kanë të mbaruar edhe kur kemi ditë të këqija. Të uroj shumë suksese.

Idlir Mergjyli- Më i miri i klasës! Asnjëherë nuk dështon të bëj të tjerët për të qeshur. Shpresoj që mbas këtyre tre viteve që jemi njohur të të plotësohen ëndërrat prej biznesmeni. Mos më harro pasi të jesh bërë Princi i Fierit.

Kristi Lipivani- Një djalë me vizion të gjerë për jetën, të uroj fat në rrugëtimin tënd për t'u bërë deputet i qarkut Fier.

Greta Berisha- Brusi ,një princ i vërtet !Viti parë që të njoh por karakteri yt më bën të mendoj sikur kam kaluar një shoqëri shumë të gjatë me ty.Je i zoti vetes dhe gjithmonë gjen një zgjidhje për çdo problem. Humori yt mos ndryshoftë asnjëherë ishalla.Të uroj suksese!

Hilda Marinaj- O brus o princi i klasës .Do të të mbaj mend si një djalë shumë të dashur dhe gazmor .Shpresoj të të realizohen të gjitha ëndërrat që ti ke.

Sofia Burimi- Brus je nje djal I shkathët dhe I dashur,ke shume energji positive,të uroj suksese në jete.

Albana Bami-Ky është viti im i parë që të njoh por mund të them që je një djalë shumë i sjellshëm dhe me

humor të mirë. Të uroj vetëm suksese në jetë!

Xhoi Beja- Ky është viti im i parë që të njoh por mund të them që je një djal i qeshur dhe humorist. Të uroj vetëm suksese në jetë!

Adelajda Shahini- Është një djalë shakaxhi dhe na mban duke qeshur gjithë kohën. I pëlqen të krijojë situata qesharake por gjithashtu i dhe ti vëj të tjerët në lojë. I uroj suksese dhe më të mirat.

Arsia Sefaj- Mund të them që Brusën është një person me shumë energji. Ai gjallëron të gjithë klasën dhe mendoj se batutat e tij do të mbahen mend nga të gjithë. Të uroj që të plotësohet çdo dëshirë që ke!



Dea Xhemalaj

Uejsi Caca- Dea është një vajzë shumë e zgjuar dhe e durueshme ,e cila punon shumë për gjërat e saj me një punë të merituar. Ajo ka potencial dhe është shumë e artikulluar,kjo shihet në mësimet , por edhe në bashkëbisedime me shoqërinë.Dea uroj që të gjitha ëndërrat e tua të realizohen duke i bërë të gjithë krenar!

Idlir Mergjyli- Me një mendje të shkëlqyer dhe një zemër të butë, ti je një burim i pafund i inspirimit për të gjithë ne rreth teje. Me përkushtimin tënd për dije dhe me talentin tënd të jashtëzakonshëm, je një shembull i vërtetë i forcës dhe vullnetit njerëzor. Mbetesh gjithmonë e kujdesshme dhe e këmbëngulur në ndihmën për të tjerët. Gjithmonë shpresoj të fitosh sa më shumë dije!

Ines Balliu- Dea, kaluan kohët dhe iku një jetë e tërë me ty. Asnjëherë nuk do e imagjinoja që do të isha kaq falenderuese për kohën që do të kalonim bashkë. Faleminderit që më ke qëndruar gjithmonë afër edhe në momentet e mia jo aq të mira. Me çdo kujtim të bukur që kemi kaluar, ti më je gjendur gjithmonë pranë. Nuk ka fjalë për të shprehur se sa mirënjohëse jam për ato ditë kur kemi qeshur deri në lot, kemi ndarë, dhe kemi kaluar sfidat bashkë. Shpresoj që në të ardhmen, të plotësosh të gjitha ëndërrat që ke, edhe ato të cilat mendoje se kishim shumë potencial. Të uroj sa më shumë suksese në të ardhmen dhe të lutem, mos më përfshi më në punë të tjera, se më mjaftojnë këto që kam.

Noel Sharka- Bisedat tona kanë qenë një moment i paharrueshëm i miqësisë sonë. Fjalët e tua do t'i mbaj mend edhe mbas këtyre viteve shkollore, dhe unë gjithmonë do t'i vlerësoj momentet kur mbështesim

njëri-tjetrin. Paç fat kudo që do të shkosh!

Megan Mara – Dea ne kemi plot 3 vite që njihemi. E mbaj mend si sot, kur erdhe në vit të parë në klasë. Ti ishe ulur në bankë të parë dhe unë isha mbrapa teje , por nuk e shikoja mire tabelën dhe mora leje të ulesha me ty. Unë pashë tek kuleta jote grupin tim muzikor të preferuar,dhe pse kisha pak turp, vendosa të të pyesja për to. Nuk pendohej kurrë që të pyeta, se pas asaj ne filluam dhe u bëmë shumë shoqe. Dea je një vajzë shumë e dashur, e sjellshme, e zgjuar dhe gjithmonë më bën për të qeshur. Shpresoj që edhe pasi të mbaroj gjimnazin ne të vazhdojmë të jemi shoqe, dhe të kemi mundësi ti rikujtojmë gjithë kujtimet që kemi kaluar së bashku. Të uroj shumë suksese në të ardhmen tënde, dhe shpresoj që ëndrra jote e të hapuri të një biznesi të realizohet.

Etien Dhima– Dea (ose Idea, sipas emrave qesharake që i jap njerëzve) ka qenë pjesë e shoqërisë sime për rreth 5 vjet tashmë, por në dy vitet e fundit të gjimnazit është bërë një mikeshë më e afërt, kryesisht për shkak të lidhjes së ngushtë që krijuam si grup shoqëror, që na bëhet si një familje gazmore brenda shkollës. Është një vajzë shumë inteligjente dhe e dashur. I uroj një të ardhme sa më të lumtur dhe me sukses!

Endi Corja- Je një vajzë shumë e mirë, e zgjuar, e qeshur dhe çfarë do ishte grupi jonë pa ty. Shoh një të ardhme premtuese përpara teje. Mos ndrysho kurrë.

Matteo Mavriqi- Dea je një vajzë shumë e mirë , të kam njohur për vetëm 3 vite , por ja kemi kaluar mirë bashkë me shakatë dhe batutat tona..Je një vajzë shumë e zgjuar dhe gjithmonë më ke ndihmuar për mësimet në lëndë të ndryshme.Suksese!

Adelajda Shahini- Vajza më e urtë dhe punëtore , e cila me shakatë e saj të lezetshme, gjithmonë më bën për të qeshur. Dea është një vajzë e dashur dhe e qetë , e cila asnjëherë nuk nguron të më ndihmojë sa herë që i kërkoj ndihmë. Ajo është e gatshme dhe e përgatitur gjithmonë për mësimet. Nga një punë e palodhur, vjen gjithmonë një shpërblim dhe Deas i uroj këtë sukses gjatë gjithë jetës së saj.

Albana Bami- Dean e njoh që në klasë të nëntë dhe mund të them se është një vajzë shumë e rezervuar. Aftesitë e saj në mësimet shfaqin vullnetin që ajo ka. Jam shumë mirënjohëse që e njoh. Shpresoj të kesh sa më shumë sukses në të ardhmen!



Endi Çorja

Adelajda Shahini- Djali me fantazinë më të çmendur dhe kreative, i cili është i ndjeshëm dhe i kushton rëndësi gjërave të vogla, ku respekti për të tjerët është primare për të. Ky kreativitet i çmendur dhe i veçantë, e bën atë një njeri vërtet me mendje të hapur me anë të së cilës, i uroj të përmbush qëllimet që i ka vënë vetes.

Noel Sharka- Unë jam me fat që ne jemi bërë shokë gjatë këtyre viteve. Ti je një person i talentuar, artistik dhe inteligjent. Aftësitë e tua për art nuk do i harroj kurrë dhe gjithmonë do mbaj mend se si ti gjallëroje klasën. Gjithë të mirat në jetë!

Ines Balliu- Endi, kam 3 vite që të njoh dhe që në ditën e parë kam menduar se sa i talentuar je. Ti me fiksimin e filmave horror ke treguar një Endi i cili nuk ka frikë të bëjë asgjë dhe gjithashtu je një artist i vërtetë, i cili është gati të bëjë gjithçka të pamundur në të mundur. Gjithmonë do t'i kujtojë shakatë e tua dhe lajmet interesante që më tregojë që në pikë të mëngjesit. Shpresoj të kesh sa më shumë suksese në jetë dhe të të plotësohen të gjitha dëshirat sepse e meriton!

Matteo Mavriqi- Endi-Endi kam shumë vite që të njoh. Kemi qenë në të njëjtën klasë që prej klasës së parë. Kemi kaluar shumë momente të lumtura bashkë që nuk do ti harroj kurrë. Do të ngelesh shoku im më i ngushtë për shumë kohë të gjata. Suksese ne studimet e tua!

Dea Xhemalaj- Endi kam tre vite që të njoh dhe duhet thënë që je djali më pozitiv që kisha takuar ndonjëherë. Kurrë nuk të kam parë të mërzhitur dhe gjithmonë ke parë më shumë anën pozitive sesa

negative të gjërave. Në të njëjtën kohë je dhe shumë i talentuar. Je përpjekur të më mësosh të vizatoj dhe pse kurrë nuk do ta kuptoj se si e ben aq mire. Kemi kaluar shumë momente të bukura nga më të ndryshmet dhe çdo herë jemi argëtuar. Shpresoj që të të plotësohen të gjitha dëshirat që ke dhe të gësh sukses kudo që të shkosh sepse e meriton.

Megan Mara- Endi, në vit të fundit të gjimnazit ne jemi ulur bashkë por ne ishim shokë që në vit të parë, gjithmonë të shikoj duke vizatuar dhe habitem se si ke aq shumë imagjinatë dhe arrin ta kthesh në një art. Ty nuk të harroj se sa shumë pasion ke për festën e Halloëeen-it dhe për filmat. Çuditësha kur merrja vesh që gati gati ke parë çdo film të mundshëm. Nuk kemi të njëjtat pëlqime në përgjithësi por arrim ti kuptojmë ato. Shpresoj pas gjimnazit të mbetemi akoma shokë. Të uroj shumë suksese në jetë dhe ëndrra e të qënurit një kërcimtar dhe aktor i talentuar të realizohet.

Etien Dhima- Ende vazhdon më çudit se si edhe pas 13 vjetësh vazhdoj të të kem mik po aq të afërt sa në fillim, nëse jo edhe më të afërt. Nuk di të shpjegoj se si në mes të çdo drame të kotë që ka prekur shoqërinë, nuk te ka prekur kurrë me gisht ty. Ke treguar që je një nga shokët më të besuar dhe më argëtues që kam pasur, dhe dua të të kem pranë edhe në të ardhmen. Vlerësoj që jemi të dy artistë me respekt reciprok, edhe pse të kundërt në stil e parime në atë që bëjmë. Nuk ka më mirë se një individ që refuzon të jetë i cekët në atë që bën, por zhytet thellë përtej sipërfaqes. Jam i lumtur që ke qenë miku im gjatë këtyre viteve, dhe jam i sigurt që të pret një e ardhme e suksesshme dhe e merituar me talentin që zotëron.

Brendis Kasharaj- O Endi a të kujtohet dita kur u takuam? Të them të drejtën as mua. Kemi 6 vite që jemi shokë. Në këto 6 vite marrëdhënia jonë u forcua duke parë filma horror bashkë. Kjo eksperiencë javore ka qenë një nga pjesët më të bukura të fundjavës time. Ti duke u tallur me zgjedhjet më të paaferta të regjizorëve dhe unë duke bërë sikur nuk friksohesha. Të uroj shumë suksese!



Gjeorgjos Koci

Adelajda Shahini- Jorgo është djali introvert,djali më fjalë pak por dëgjuesi më i mirë që kam njohur. Është djalë i aftë të bëjë atë çfarë do dhe do të punojë derisa ta arrijë atë. Person i shoqërueshëm të cilit i uroj një sukses të madh në çfarëdo që ai do.

Idlir Mergjyli- Ja hodhëm edhe këtyre tre viteve dhe tani të uroj më të mirat në jetë. Shpresoj të arrish çfarë ke dëshiruar gjithmonë. Akoma stë kam gjetur një emër më të shkurtër se më lodhe me atë emër grek.

Kristi Lipivani- Bashkë jemi njohur sivjet por prap se prapë kemi arritur të ndërtojmë një raport të fortë shoqëror të cilin besoj se do ta mirëmbajmë. Të uroj suksese mik.

Brusen Tupi- Jorgo shfaq një dëshirë të vërtetë dhe te madhe për të bërë ndryshime pozitive duke u angazhuar ne politikë.Ambicia e tij per tu bërë deputet shprehet në perkushtiin e tij ndaj çështjeve sociale dhe drejtesisë sociale.Të uroj suksese në rrugëtimin tënd.

Megan Mara- Gjeorgjos je një djalë i sinqertë dhe i zgjuar. Ti ke ardhur këtë vit në klasën time dhe uroj të jesh kënaqur. Të uroj fat në jetë.

Ueysi Caca- Jorgo është shumë i talentuar dhe ka një inteligjencë të jashtzakonshme . Ai arrin të kuptojë gjithçka dhe mundohet të më ndihmojë kur unë kam nevojë. Këtij djali , sigurisht , i uroj vetëm lumturi dhe mirësi në jetë.

Noel Sharka- Edhe pse nuk kemi folur shumë këtë vit, e kam parë sa punëtor je. Jam i sigurt se nëse vazhdon të punosh me të njëjtin pasion që ke patur deri më tani, ti ke për t'i arritur qëllimet e tua në jetë. Suksese!

Gledis Bajrami- Një djalë shumë i respektueshëm dhe i qetë,të uroj më të mirat dhe shumë suksese në jetë!

Arsia Sefaj- Një djalë i qetë dhe i sjellshëm. Të uroj gjithë të mirat.

Ines Balliu- Gjeorgjos, në këtë vit që të kam njohur, kam kuptuar se, je një djalë I qeshur dhe I zgjuar. Gjithmonë je përpjekur të tregosh anën tënde më të mirë dhe shpresoj që të arrish çdo gjë që ke ëndërruar dhe të uroj sa më shumë suksesenë të ardhmen.

Greta Berisha- Je një person shumë i thjeshtë dhe i qetë,por në të njëjtën kohë shumë I zgjuar.Kam kuptuar që je gjithmon i gatshëm të ndihmosh të tjerët.Të uroj sa më shumë suksese!

Endi Corja- Je një person pasionant që nuk të mungon aftësia. Të uroj suksese te vitet në vazhdim.

Matteo Mavriqi- Gjeorgjos-Edhe pse kam 1 vit që të njoh kam kuptuar që je një djalë goxha punëtor dhe i sjellshëm.Të uroj suksese drejt studimeve të tua.

Dea Xhemalaj- Je një djalë I zgjuar dhe I qetë. Gjithmonë përpiqesh të nxjerrësh anën tënde më të mirë në çdo aspekt.Uroj që të arrish majat në shkollë dhe të kesh profesionin që ti dëshiron në jetë.Të uroj shumë suksese kudo!

Albana Bami- Gjeorgjos është një djal i sjellshem. Edhe pse është viti i parë që e njoh kam vënë re se ka një intelekt të lartë dhe i kushton shumë vëmendje mësimëve. Suksese në vazhdimësi!

Sofia Burimi- Gjeorgjos është një djalë i sjellshem. Edhe pse është viti i parë që e njoh kam vënë re se ka një intelekt të lartë dhe i kushton shumë vëmendje mësimëve. Suksese në vazhdimësi!



Gledis Bajrami

Albin Hoxha- Je një vajzë fjalë pak dhe shumë pozitive. Dua të të them faleminderit për të gjithë detyrat që më ke dhënë gjatë këtyre viteve. Të uroj shumë suksese.

Ueysi Caca- Me Gledisin kam më shumë se pesë vite në klasë dhe gjatë kësaj kohe kam arritur të njoh se kush është ajo . Gledisi është një vajzë e buzëqeshur dhe shumë dashamirëse. Vajzë e shoqërueshme që sa here i kërkon ndihmë është gjithmonë aty. Person i pandrojtur me një sinqeritet të madh. Gledisit i uroj që të shohë vetëm arritje dhe suksese të mëdha në jetën e saj.

Matteo Mavriqi- Gledis je Një vajzë shumë e mirë dhe e sjellshme. Tani po bëhet viti i dytë që ulemi bashkë në bankë dhe gjithmonë ja kemi kaluar mirë bashkë.

Endi Corja- Nga fillimi i këtyre 3 viteve që njihemi nuk flisnim shumë por tani je dhe do jesh një nga shoqet e mia më të ngushta. Ti i jep personlitet dhe karakter klasës duke mos u munduar fare sepse ti vetë rrezaton karakter. Të uroj suksese.

Xhoi Beja- Gledisi është një vajzë e qetë dhe e fokusuar në qëllimet e saj. Ajo gjithashtu është realiste dhe me këmbë në tokë gjë e cila do ti sjelli shumë sukses në të ardhmen. Të uroj fat dhe mbaresi!

Noel Sharka- Shkolla e mesme nuk do të kishte qenë e njëjtë pa ty si shoqe. Ti je një nxënëse e mirë dhe bisedat tona kanë qenë një burim inspirimi. Paç fat me gjithçka që do të bësh duke ecur përpara!

Ildir Mergjyli- Shpresoj që çdo vit të jetë akoma më i ndritur për ty. Çdo ditë e më tepër duket dashamirësia jote jo vetëm si nxënëse por dhe si person në çdo

veprim dhe çdo hap që hedh drejt suksesit. Ky vit mbaroi por jeta vazhdon me plot të papritura. Shpresoj te jesh gjithmonë vetvetja

Ines Balliu- Gledis, edhe pse kam vetëm 3 vite që të njoh, gjithmonë më ke dhënë përshtypjen se je një vajzë shumë pozitive dhe miqësore. Gjithmonë do të kujtojë me buzëqeshje se sa shumë shaka kemi bërë në fiskulturë. Shpresoj të arrish çdo gjë në jetë dhe të uroj sa më shumë suksese!

Greta Berisha- Një vajzë e çiltër, e qeshur, me shumë vullnet dhe e vendosur për çdo gjë që bën. Më pëlqen tek ti aftësia jote ku ti përshtatesh me çdo njeri. Të uroj sa më shumë suksese në jetë.

Hilda Marinaj- Kaçurrelsja e klases sonë. Gledis ti je një vajzë fjalpak por kur mblidhemi të gjithë mund të ambientohesh mjaft mirë me situatën. Të uroj suksese


Endi Corja- Ti i jep personlitet dhe karakter klasës sepse je një vajzë me një personalitet të madh. Të uroj suksese dhe të të plotësohet çdo ëndërr.

Matteo Mavriqi- Gledis- Gledis je Një vajzë shumë e mirë dhe e sjellshme. Tani po bëhet viti i dytë që ulemi bashkë në bankë dhe gjithmonë ja kemi kaluar mirë gjatë orëve të mësimi. Te uroj suksese në studimet e tua të mëtejshme.

Dea Xhemalaj- Je vajza më e ëmbël dhe më e qeshur që kam njohur këto tre vite. Gjithmonë ke qenë e shoqërueshme me të gjithë. Sa here kemi kaluar kohë bashkë ke qenë shumë suportive ndaj meje dhe për këtë të falenderoj. Uroj që të kemi krijuar një shoqëri shumë të bukur me njera tjetrën dhe ta ruajmë edhe pasi ky vit I fundit të mbarojë. Shpresoj të jesh gjithmonë e lumtur dhe kaq e qeshur sa je dhe tani. Të uroj shumë suksese dhe të arrish majat.

Adelajda Shahini- Gledis është një vajzë shumë e ëmbël dhe e matur. Është suportuese dhe e gatshme të jetë aty për të të ndihmuar dhe mbi të gjitha miqësore. Është ajo vajza e cila di ku dhe kur të flas. Shpresoj që gjithçka që ajo dëshiron të plotësohet dhe të jetë gjithmonë me atë buzëqeshjen e ëmbël në fytyrë.

Megan Mara- Gledis ne kemi që në vit të parë bashkë dhe gjithmonë më je dukur një vajzë pozitive dhe e dashur. Kemi kaluar shumë bukur bashkë dhe pse gjimnazi ishte pak i vështirë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen dhe të të realizohen ëndrrat.



Greta Berisha

-Hilda Marinaj-

Bestieeee,shkrimin tënd e lash për në fund sepse kam shumë për të shkruar...Shoqëria jonë nisi si diçka fare e kotë por u kthye në diçka mjaft unike .Ky vit gjimnazi u bë edhe më i bukur pasi ishim në klasë bashkë .Je një nga vajzat më ambicioze , më të mrekullueshme dhe më me stil që njoh . Ti je dhe do jesh e vetmja kosovare në jetën time .Jam shumë e lumtur që je pjesë e jetës sime në momente të vështira por mbi të gjitha tek ato më të bukurat. Do të mbaj mend gjithmonë buzqeshjen tënde pasi gjithmonë qeshje kot hahah. Sdo ti harroj momentet e shkollës kur linim orët ,kur hanim me zor ushqimet e berqetit ,kur kopjonim me njëra tjetrën ne provimeTë falenderoj për çdo kujtim që kemi bashkë o loqkkk dhe shpresoj që shoqëria jonë të zgjasë për shumë kohë. Faleminderit që ke qenë gjithmonë aty për mua .Faleminderit dhe për ato përqaftimet që si pëlqeja . Jam e sigurt se e ardhmja ka rezervuar vendin më special për një njeri kaq special sa ty .Po e mbyll këtu sepse dhash shumë dashuri .Te puth Bello

-Ines Balliu-

Greta, edhe pse u njohëm këtë vit shkollor, kam kuptuar se je një vajzë e dashur dhe e qeshur. Ti je gjithmonë aty për shoqet e tua dhe asnjëherë nuk bën askënd të ndihet keq afër teje. Të uroj gjithë të mirat dhe sa më shumë suksese në vazhdim!

-Idlir Mergjyli-

Me një shpirt të këndshëm dhe një zemër të madhe. Me mirësinë tënde të pafundme dhe me gatishmërinë tënde për të ndihmuar të tjerët, je një frymëzim për të gjithë rreth teje. Faleminderit që je gjithmonë aty për klasën në momente të ndryshme, duke qenë një mbështetje e vërtetë. Suksese më tej.

-Arsia Sefaj-

Greta, je një vajzë e sjellshme, e dashur dhe e qeshur. Edhe pse më e vogla, i ke vërtetuar të gjithëve që je shumë e zgjuar dhe e matur. Uroj shumë që jeta të të dhurojë më të mirat!

-Gledis Bajrami-

Greta një vajzë shumë e mirë, e sjellshme dhe e qetë. Ia kemi kalur shumë mirë kështu vit shkollor. Të uroj shumë suksese të mëtejshme!

-Noel Sharka-

Ndonëse bisedat tona kanë qenë të pakta, njohuritë dhe intelijenca jote përpara klasës kanë lënë mbresa te unë. Nuk kam dyshim se do të vazhdosh të shkëlqesh në të ardhmen. Suksese!

-Brusen Tupi-

Greta-Për ty që po lexon këtë shkrim ky është një dedikim për vajzën më të mirë të shkollës dhe vajzën më të vecantë që kam njohur gjatë jetës time, vërtet përshtypja e parë ishte jo e mirë por ajo me veprimet e saj tregoi te kundertën. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë dhe pas gjimnazit.

-Xhoi Beja-

Për Gretën mund të them se është një vajzë shumë e matur. Më pëlqen mënyra e komunikimit të saj dhe energjia pozitive që ajo percjell. Të uroj shumë suksese!

-Albana Bami-


Për Gretën mund të them se është një vajzë e matur dhe e rezervuar. Më pëlqen energjia që ajo percjell. Të uroj suksese në vazhdimësi dhe të arrish atë që do!

-Sofia Burimi-

Greta:Je nje vajzë positive dhe plot energji,ne njihemi që më përpara por asnjëherë skemi qenë kaq të afërta sa këtë vit.Jam shumë e lumtur që kemi rënë në klasë bashkë e na u dha mundësia të njiheshim më shumë,më ke afruar që në fillim dhe aty ka nisur shoqëria jonë.Të kam shum xhan

-Megan Mara-

Greta, mbaj mend që kemi qenë bashkë në klasë të 9 për një kohë të shkurtër, dhe tani në vit të fundit të gjimnazit jemi përsëri bashkë. Shpresoj që në gjimnaz të kesh kaluar një kohë shumë të bukur dhe ti rikujtosh momentet e bukura që ke kaluar. Të uroj shumë suksese ne jetë e kudo.



Hilda Marinaj

Adelajda Shahini- Vajza e dashur,e shoqërueshme dhe një nga vajzat më të bukura të klasës.Person i cili do që ti ndihmojë të tjerët dhe të kënaqet me shoqërinë e saj.Vajzë e cila fal dashuri dhe përpiqet për atë që ajo do,të mbështet në çfarëdolloj situatë dhe shumë zemërgjerë,dhe nga kjo zemërgjersi uroj që çdo sukses i saj të jet i madh dhe i bukur,ashtu si ajo.

Albin Hoxha- Je një nga shoqet më të mira qe kam pasur. Bisedat që kemi bërë bashkë dhe te qeshurat në bankë do I kujtoj gjithmonë. Shpresoj qe çdo ëndërr që ke të bëhet realitet. Të uroj shumë suksese!

Uejsi Caca- Hilda është një vajzë shumë e mirë dhe e edukuar. Ajo mundohet të të qëndrojë pranë dhe të të mirëkuptojë në çdo situatë.Zemërgjersia dhe pozitiviteti që ajo mbart e bëjnë atë një person të dashur nga të gjithë. Shpresoj që Hildës ti realizohen të gjitha ëndrrat që ajo ka!

Brusen Tupi- Hilda një vajzë shumë e zgjuar dhe me personalitet ndryshe nga të tjerat të cilën e kam njohur gjithashtu këtë vit .Shpresoj që pozitiviteti yt të percjelli ty në të gjitha hapat e jetës.

Ines Balliu- Hilda,je një vajzë shumë e qeshur dhe e dashur. Këto 5 vite që kemi qenë në të njëjtën klasë do t'i kujtoj gjithmonë duke qeshur , sepse jemi argëtuar shumë. Sidomos ato bisedat e veçanta që bënim bashkë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Greta Berisha- Hilda,me imee,loqkaa imeee...Goca më e bukur n'bottt.Nga t'ja nis sdi ca t'them.Cdo gjë ka ndryshuar shumë që në momentin që un të kam njohur ty.Sigurisht që ka ndryshuar për mirë.Nuk e di se si dhe pse jemi besties sot por që shyqyr që

ka ndodhur.Kemi kaluar shumë gjëra bashkë ndaj të falenderoj shumë që ke qenë gjithmonë pranë meje në çdo moment.Nuk do të harrohen kurrë paragjykimet e tepërta që kemi për njerëzit edhe pse ato duhet të ndalojn.Shoferja jonë profesioniste.Je një nga personat më pozitiv që unë njoh(me njerëzit që do vetë sigurisht).Je më sociale seç duhet kështu që të lutem mos i fol më gjithë njerëzve që shef në rrugë. Një person si ti shpresoj ta kem gjithmonë pranë në jetën time.Qofsh vajza më e lumtur në univers sepse e meriton të jesh.Nuk e quaj këtë dedikim të plot pa përmendur bebushat tonë. Love you,lil Bello!

Dea Xhemalaj- Hilda kemi që në klasë të tetë që njihemi së bashku dhe kemi kaluar shumë kohë të bukura gjatë këtyre viteve.Nuk do ti harroj bisedat që kemi bërë së bashku dhe madje do të më mungojnë kur të mbaroj gjimnazi.Për mua je shumë vajzë pozitive dhe gjithmonë e kam vlerësuar këtë tek ti sepse dhe mua më ke dhënë një komoditet sa herë që kam qenë me ty.Të uroj gjithë suksesin e kësaj bote dhe shpresoj që të të plotësohen të gjitha dëshirat që ti ke.

Sindi nikolli -Te dua! Jam shumë e sigurt që e di sa shumë të dua edhe nëse nuk ta them shpesh. Të dua për shumë arsye por më e rëndësishmja është që gjithmonë kemi qëndruar afër njëra- tjetrës dhe kemi krijuar disa nga momentet me te bukura të jetës tonë! Ti je dashuri dhe shpresoj që të të kem gjithmonë ty dhe dashurinë tënde afër meje! Faleminderit që mi ke bërë ditët më të bukura , je shoqe e mrekullueshme. Never leaving your side <3

Sara collaku-Hilda është një ndër personat që kam njohur më gjatë gjatë këtyre viteve në kolegji. Na lidhte më shumë miqësija e kushërinjve tanë që në fëmijëri por fatkeqësisht nuk kishim kurrë nje shoqëri të përbashkët.Kjo ndryshoj në gjimnaz,ku unë e njoha Hildën në të vërtetë se kush është.Ajo është një vajzë shumë e mirë ,gjithmonë e qeshur dhe gati për muhabet.Është një shoqe që të gjendet pranë dhe të lumturoj vetem duke qenë në praninë e saj.Do t'i kujtoj gjithmonë momentet e bukura që kemi ndarë bashkë ,dhe të uroj shumë suksese në të ardhmen. Puçç<3

Sofia Burimi-

E mira Hilda,ne njihemi që prej 8 vitesh dhe kemi qenë shoqe shumë të mira,kemi shkuar gjithmonë shumë mirë bashkë kuptohemi për çdo gjë,jam shumë e lumtur që jemi në klasë e jemi afruar më shumë se kurrë.Të kam shumë xhan“ kordoni im“!



Ildir Mergjyli

Gjeorgjos Koci- Je djalë shumë shumë pozitiv , gjithmonë mund të qeshësh me ty .Që nga viti I parë e deri tani kam vënë re se çdo kush por dhe unë ia kalon shumë mirë me ty.Të uroj suksese dhe mi mbaj mirë emigrantët kur të vijnë në Lezhë.

Kristi Lipivani- Senatori më i mirë sot për sot, që ka një zemër të mirë. Të uroj suksese vëlla.

Xhoi Beja-Ildiri është një djalë i sjellshëm. Edhe pse është viti i parë që e njoh kam vënë re se ka një intelekt të lartë dhe i kushton shumë vëmendje mësimëve. Suksese në vazhdimësi!

Hilda Marinaj- Je një cun mjaft i edukuar dhe i sjellshëm .Shpresoj ëndrrat për tu bërë një mjek të të realizohen.

Megan Mara- Ildir ti ke ardhur këtë vit në klasën time dhe më je dukur një djalë i mirë dhe i zgjuar. Shpresoj të arrish aty ku dëshiron në jetën tënde.

Uejsi Caca- Ildiri është një djalë shumë i mirë dhe me shumë potencial . Ai di të menaxhojë situata të vështira dhe ti bëj ballë problemeve . Unë mendoj se ai do të arrijë majat dhe kte gjë ja uroj me gjithë zemër .

Brusen Tupi- Ildiri është një djalë me një karakter të vecantë ku në sy bien vlerat e tij ne lidërsipin e detyrave të ndryshme që i ngarkohen. I uroj suksese në jetën e tij.

Noel Sharka- Ne nuk kemi shumë kohë që njihemi por përkushtimi yt ndaj projekteve dhe detyrave më ka bërë të kuptoj që je një nxënës i zgjuar dhe punëtor. Kontributet e tua kanë qenë të domosdoshme për

suksesin tonë. Paç fat në të ardhmen!

Gledis Bajrami- Një djalë shumë i sjellshëm dhe i respektueshëm,shpresoj të realizosh çdo dëshirë tënden dhe të uroj shumë suksese!

Arsia Sefaj- Erdhe këtë vit në klasë dhe i dhe shumë alegri. Je djalë i sjellshëm dhe i zgjuar. Të uroj shumë suksese në degën që ke zgjedhur dhe mëtej!

Ines Balliu- Ildir, në këtë vit që të kam njohur, kam kuptuar se, je një djalë i qeshur dhe i zgjuar. Gjithmonë je përpjekur të tregosh anën tënde më të mirë dhe shpresoj që të arrish çdo gjë që ke ëndërruar dhe të uroj sa më shumë suksese në të ardhmen.

Greta Berisha- Je një person shumë i qetë,por gjithashtu dhe shumë puntor e inteligjent.Je gjithmonë i gatshëm ti ndihmosh të tjerët. Të uroj sa më shumë suksese në jetë!

Endi Corja- Ke provuar që je një djalë shumë punëtor dhe i zgjuar. Ke qenë i sjellshëm dhe të respektoj. Suksese!

Matteo Mavriqi- Je një djalë shumë punëtor dhe i qetë por dhe i zgjuar.Këtë vit jemi njohur dhe ja kemi kaluar mirë.Suksese në studimet e mëtejshme.

Dea Xhemalaj- Jemi njohur këtë vit dhe dua të them se je një djalë shumë i zgjuar dhe punëtor.Në të njëjtën kohë përpiqesh gjithmonë të japësh më të mirën nga vetja jote dhe për këtë të vlerësoj.Shpresoj që të gjitha ëndërrat e tua të plotësohen dhe të uroj suksese kudo.

Adelajda Shahini- Ildiri është një djalë që nuk e njoh shumë por di që është një djalë që ka synime të qarta dhe i arrin ato në çdo mënyrë që ai mundet. I uroj suksese dhe shpresoj që të arrijë çdo gjë që ai dëshiron.

Albana Bami- Ildiri është një djalë i edukuar dhe i matur. Me ka ndihmuar sa herë më është dashur ndihmë dhe e vlerësoj këtë. Të uroj sukses dhe mbarësi në vazhdimësi!



Ines Balliu

Adelajda Shahini- Vajza e cila bën shaka dhe humor kurdo, e qeshur dhe me një zemër të madhe. Vajzë e shoqërueshme, që sa herë i kërkon ndihmë, është gjithmonë aty. Person që i thotë gjërat dhe i shpreh dëshirat pa ndrojtje, me një sinqeritet të madh. Uroj që të shikosh vetëm arritje dhe suksese të mëdha në jetë!

Xhoi Beja- Inesin e njoh që në klasë të tetë dhe mund të them se është një vajzë shumë e rezervuar. Aftesitë e saj në mësim shfaqin vullnetin që ajo ka. Jam shumë mirënjohëse që e njoh. Shpresoj të kesh sa më shumë sukses në të ardhmen!

Matteo Mavriqi- Ines kam vetëm tre vite që të njoh dhe gjithmonë ke qenë një shoqe e mirë, kemi bërë shumë gallata dhe jemi kënaqur gjithnjë. Je një person shumë pozitiv dhe i urtë. Të uroj shumë suksese!

Greta Berisha- Ines, kam shumë vite që të njoh ty. Kemi qenë bashkë në klasë të katërt dhe di të them që ti je po i njëjti person që atëherë. Ke një zemër shumë të madhe, që gjithmonë mundohet t'i ndihmojë njerëzit. Je shumë inteligjente ndaj të uroj sa më shumë suksese dhe fat në jetë!

Endi Corja- Nga t'ia filloj. Këto vite kanë qenë një eksperiencë. Këto tre vite janë ndjerë si nëntë vite sepse kur bën aq shumë qejf, ti do që ajo kohë të zgjasë përgjithmonë. Të uroj suksese në punën tënde (ose punët) nëse e di, e di. Le të shpresojmë që brenda këtyre pesë viteve që vijnë të takohemi.

Arsia Sefaj- Të kaloje gjimnazin me ty në klasë do thoja që ishte kohë cilësore. Një vajzë me karakter dhe padyshim shumë e sjellshme. Shpresoj që shoqëria jonë të mos shuhet dhe të uroj shumë suksese!

Ueysi Caca- Inesi është një vajzë e qetë dhe ambicioze. Gjatë këtyre viteve ajo mundohet të më ndihmonte shumë në mësim. Inesi ma bënte shkollën shumë më të lehtë seç ishte. Mund të themi se ajo ishte një shtysë e madhe për mua dhe kishte shumë ndikim në rezultatet dhe performancën time në shkollë. Me zemërgjersinë dhe punën e saj, besoj se ajo do arrijë majat në të ardhmen. Inesit i uroj shumë sukses dhe lumturi në jetë!

Dea Xhemalaj- Shoqja ime e ngushtë prej 12 vitesh. Kemi kaq shumë vite dhe kaq shumë kohë që njihemi me njëra-tjetrën, sa që nuk di nga t'ia nis. Nuk e harroj kurrë herën e parë kur u takuam bashkë në klasë të parë kur ti ishe duke qarë dhe une tu afrova për të të qetësuar. Që atëherë e kuptuam se do të ishim gjithmonë aty për njëra-tjetrën dhe do të rriteshim çdo ditë duke kaluar momente të bukura së bashku. Je shoqja më e mirë që mund të kërkoja në këtë botë dhe shpresoj që kjo shoqëri të vazhdojë dhe pas gjimnazit. Të falenderoj shumë që gjatë gjithë kësaj kohe nuk më ke lënë kurrë vetëm dhe më ke mbështetur për çdo gjë që kam bërë. Je personi që më jep më shumë pozitivitet dhe gjithmonë e gjen dicka për të më bërë për të qeshur. Shpresoj që çdo ëndërr e jotja të realizohet dhe të arrish majat atje ku ti dëshiron!

Albana Bami- Është një vajzë shumë e sjellshme dhe zemërmirë. Mund të them me shumë siguri që sa herë dikush ka patur një paqartësi, i janë drejtuar gjithmonë Inesit sepse përveç dëshirës dhe mirësisë së saj për të ndihmuar dikë, ajo është gjithashtu shumë e zgjuar. Jam shumë mirënjohëse që të njoh. Dëshiroj shumë që të shkosh sa më lart dhe të uroj sukses!

Megan Mara- Ines, të them të vertetën unë nuk e mbaj mend fare se si ne jemi bërë shumë shoqe, por di të them që jam shumë e lumtur që ne jemi bërë shoqe. Sa herë jam me ty unë vetëm qesh dhe shumicat e shakave nuk i harroj. Në vit të dytë ne jemi ulur në bankë bashkë, edhe pse të bezdisja pak, ti gjithmonë me bëje për të qeshur. Më pëlqen që ne biem dakort në shumë gjëra, edhe pse disa herë jo, dhe kemi të njëjtin humor. Shpresoj shumë që pasi të mbaroj gjimnazin të vazhdojmë të jemi shoqe dhe të qeshim së bashku. Një gjë që më pëlqen tek ty është pasioni që ti ke për fizikën, mënyra se si ti i zgjidh të gjitha ushtrimet saktë më mahnit. Je një vajzë shumë e zgjuar, e sjellshme dhe e dashur, edhe pse nuk e tregon. Të uroj shumë suksese në jetë dhe shpresoj që ëndrra që të bëhesh një DJ dhe bariste e artë të realizohet.



Kristi Lipivani

Gjeorgjos Koci- Djalë me humor dhe me mendime të padëguara si të Brusenit sidomos kur ishit bashkë. Të uroj suksese.

Adelajda Shahini- Kristi është djalë i cili të vlerëson në çdo ndihmë që i jep, person i cili të respekton dhe kërkon falje sinqerisht. Është djalë të cilit nuk i mungojnë shakatë dhe ka një sedër të madhe duke e treguar me sjelljen e tij. Djalë i shoqërueshëm dhe mirëkuptues, djalë i cili nëse e do vërtet diçka, e arrin dhe këtë arritje të madhe ja uroj kudo dhe kurdo që ai dëshiron.

Albin Hoxha- Ishte viti I parë që të kisha në klasë edhe dukej sikur kisha më shumë. Shakatë dhe të qeshurat që kemi kaluar bashkë nuk kam për ti harruar asnjëherë. Të uroj suksese.

Idlir Mergjyli- Je një djalë mjaft inteligjent dhe ruan seriozitetin në momente kritike kur nuk duhet të qeshim në orën e mësimi. Shpresoj që e ardhmja të ketë rezervuar diçka speciale për ty dhe të arrish suksesin!

Uejsi Caca- Kristi është një djalë i cili di të vlerësojë . Ai është një djalë gazmor dhe shumë besnik. Kristi ka ambicje të larta dhe nëse ai e do vërtet diçka e arrin atë. Bashkë kemi shumë vite që njihemi dhe shpresoj që kjo shoqëri të vazhdojë gjithmonë.

Xhoi Beja- Krishti përcjell vetëm mirësi dhe pozitivitet. Mendoj se karakteri i tij dhe qetësia që ai shfaq në situata të caktuara e bëjnë atë një person me këmbë në tokë. Uroj që të arrish aty ku do!

Hilda Marinaj- Je shumë djalë i mirë dhe i dashur

.Ishte shumë kënaqesi të të kisha ty në klasë dhe të të njihja . Të uroj shumë suksese.

Sofia Burimi- Kristi je një djalë i urtë dhe i mirë. Suksese.

Albana Bami- Mund të them që Kristi është një person me shumë energji. Ai gjallëron të gjithë klasën dhe mendoj se batutat e tij do të mbahen mend nga të gjithë. Të uroj që të plotësohet çdo dëshirë që ke!

Megan Mara- Kristi je një djalë i cili ka arritur ta bëjë klasën për të qeshur gjatë orëve të mësimi. Të uroj fat dhe mbarësi në jetën tënde.

Brusen Tupi- Kristi është një person shumë pozitiv dhe i afrueshëm, pozitivitetin e të cilit e kam ndjerë që në ditët e para të shkollës. Ai ka një sens humorit të mirë. Shpresoj të ketë vetëm suksese !

Noel Sharka- Kam vënë re punën dhe përkushtimin tënd në klasë. Vazhdo të punosh me të njëjtin pasion si tani dhe jam i bindur se do t'i arrish qëllimet e tua në rrugëtimin akademik. Suksese!

Gledis Bajrami- Një djalë i sjellshëm dhe i komunikueshëm, gjithmonë i gatshëm për të thënë fjalë të mira. Ia kemi kaluar mirë këtë vit të uroj shumë suksese!

Ines Balliu- Kristi, në këtë vit që të kam njohur, kam kuptuar se, je një djalë energjik dhe I qeshur. Gjithmonë je përpjekur të tregosh anën tënde më të mirë dhe shpresoj që të arrish çdo gjë që ke ëndërruar dhe të uroj sa më shumë suksese në të ardhmen.

Greta Berisha- Ke qenë një shok shumë i mir për mua gjatë gjithë këtyre viteve gjimnazi. Edhe pse je një person i qetë prezenca jote gjithmonë ndihet në klasë. Te uroj sa më shumë sukseseeee!

Matteo Mavriqi- Kristi je një djalë i urtë dhe zgjuar. Gjithmonë me dëshirën për të ditur më shumë. Kemi vetëm 1 vitë në klase por ja kemi kaluar mirë. Suksese!

Dea Xhemalaj- Kemi pak kohë që njihemi së bashku, por kam kuptuar se je një djalë shumë I shoqërueshëm dhe I sjellshëm. Mundohesh gjithmonë të krijosh një ambient pozitiv në klasë dhe shikon anën më të mirë të gjërave. Të uroj sa më shumë sukses në jetë!



Matteo Mavriqi

Adelajda Shahini- Mateo, djali që sipas meje, e shikon gjithçka me një këndvështrim tjetër nga ai i imi, gjë që e bën të veçantë në karakterin e tij duke iu bashkangjitur kështu dhe shakatë me ironi. Gjithmonë ka diçka për të treguar dhe mendime vërtet të veçanta. Është i përpiktë në atë që do dhe i uroj që kjo vendosmëri, ta shoqëroj në rrugën e tij drejt arritjes që ai do.

Idlir Mergjyli- Për Mateon, shokun e klasës dhe gjithmonë aty kur të nevojitet. Faleminderit që ke sjellë kënaqësi dhe humor në ditët e shkollës. Mendoj për aventurat e tjera që do ndajmë bashkë

Xhoi Beja- Mateo është një djalë i cili sheh punën e tij dhe nuk nguron të ndihmojë dikë që është në nevojë. Rrespekti që tregon ndaj të tjerëve tregon shumë për karakterin e tij. Uroj që të arrish majat dhe të kesh sukses në të ardhmen!

Endi Corja- Shoku im më i vjetër prej 12 vitesh. Aventurat që kemi kaluar gjatë këtyre viteve të arta (disa) por ka qënë qejf gjatë gjith kohës. E pamundur të mendosh që gjatë këtyre viteve nuk jemi zënë asnjëherë as nuk jemi mërzuar kurrë, dhe kështu do vazhdoj deri në pafundësi. Je shoku im më i ngushtë dhe suksese në jetë.

Dea Xhemalaj- Je një djalë shumë i mirë dhe i edukuar por në të njëjtën kohë dhe shumë gazmor. Këto tre vite kemi kaluar shumë mirë me njëri-tjetrin dhe kemi krijuar një shoqëri të cilën do ta ruajmë dhe vite të tjera. Do ta mbaj mend gjithmonë se si kemi kaluar orën e kimisë duke pritur thjesht të bjeri zilja e të mbarojë ora. Unë shpresoj që t'ia dalësh mbanë në jetë dhe të kesh suksesin gjithmonë me vete. Të falenderoj për të gjitha momentet e bukura që kemi kaluar!

Hilda Marinaj- Te ti kam vën re që je shumë optimist, mendjehapur dhe i sjellshëm me të gjithë. Të uroj suksese!

Ines Balliu- Matteo, je një djalë i cili ka shumë energji dhe në të njëjtën kohë edhe s'ka fuqi për asgjë. Gjithmonë je aty për të më bërë për të qeshur dhe për të thënë fjalë që as nuk kanë lidhje me muhabetin që ne po flasim. Gjithsesi ti je gjithmone ai personi që të bën të lumtur në çdo moment. Shpresoj të jesh gjithmonë kështu dhe mos të ndryshosh!

Brusen Tupi- Eshte nje djale i qete i cili shikon punen e tij dhe nuk perfshihet ne aktivitete intensive por vazhdon ne qetesine e tij. Shpresoj te kete mbaresi

Ueysi Caca- Për Mateon mund të themi se është një djalë i matur dhe i dashur. Mateon e kam njohur që në klasë të parë dhe është po i njëjti si atëherë. Edhe pse kanë kaluar shumë vite ai mbetet po ai djali i çiltër dhe i sjellshëm që kam njohur në fillim. Po ashtu Mateo është dhe shumë punëtor dhe gjithmonë arrinë atë që do. Shpresoj shumë që ai të bëhet një dentist i suksesshem ashtu si dhe ai ëndërron.

Albana Bami- Mateo përcjell vetëm mirësi dhe pozitivitet. Mendoj se karakteri i tij dhe qetësia që ai shfaq në situata të caktuara e bëjnë atë një person me këmbë në tokë. Uroj që të arrish aty ku do!

Sofia Burimi- Mateo je nje djal I urte dhe I qeshur, te uroj suksese ne jete.

Megan Mara- Matteo, në vit të parë ne nuk kemi qënë aq shokë të afërt se sa jemi tani dhe as nuk e mbaj mend se si ne filluam të bëheshim shokë. Ti gjithmonë di se si ti bësh njerzit për të qeshur. Mbaj mend shumë kujtime që ne kemi kaluar bashkë, që kur në fillim të vitit të dytë ne uleshim bashkë dhe ne filozofi të bërtiste zysha kur bëja unë zhurmë dhe e merje ti fain, dhe kënaqem shumë kur ne dalim dhe nxjerrim Rion me Smaxhin bashkë. Je një djal shumë i sjellshëm dhe më pëlqen personaliteti jot. Shpresoj të vazhdojmë të jemi shokë pas gjimnazit. Të uroj shumë suksese në jetë dhe shpresoj që gjithë ëndrrat e tua të realizohen.

Brendis Kasharaj- Matteo je një nga shokët e mi më të mirë. Je gjithmonë një person që mund t'i kthehem për problemet e mia pa fund dhe gjithmonë e gjen një mënyrë për të më bërë të qesh. Hajde ndonjëherë me mua në Kanada. Suksese në të ardhmen!



Megan Mara

Dea Xhemalaj- Je një nga vajzat më të dashura dhe më energjike që kam njohur ndonjëherë. Më pëlqen që gjithmonë e gjen momentin për të na bërë për të qeshur. Kemi tre vite që njihemi bashkë pavarësisht se më duket sikur kemi më shumë. Besoj se që kur jemi njohur për herë të parë e kam ditur që me ty do të kem një shoqëri shumë të mirë që do të zgjasi dhe pas gjimnazit. Gjithmonë ke qenë afër meje dhe kur kam qenë e mërëzitur je përpjekur të më gëzosh duke përdorur mënyra të ndryshme sidomos kur fillon të këndosh. Uroj që pas gjimnazit të arrish majat dhe të kesh sukses për çdo gjë që do të bësh. Të falenderoj për të gjitha momentet e bukura që kemi kaluar keto vite.

Ines Balliu- Megan, një vajzë gjithmonë e qeshur dhe plot me energji, e cila më ka bërë për të qeshur edhe në momentet kur nuk duhet të qeshja. Nuk ke ndryshuar që në momentin e parë që të kam njohur. Këto 3 vite që kemi qenë shoqe kanë qenë sa për një jetë. Shpresoj të kesh sa më shumë suksese në jetë dhe të të plotësohen të gjitha dëshirat. Gjithashtu shpresoj të të plotësohet dëshira për tu bërë një Beyonce shqiptare.

Matteo Mavriqi- Megan je një vajzë e sjellshme dhe gazmore. Ja kemi kaluar shumë mirë bashkë. Gjithmonë kemi bërë shaka në klasë dhe jemi kënaqur. Ke qenë një shoqe shumë e mirë.

Endi Corja- Shoqja ime e bankës. Potencialisht sa kujtime kemi krijuar këtë vit, që janë të mira. Je një person me një personalitet të veçantë. Shumë suksese në jetë.

Greis Koka- Megi-meg dashuria ime, nuk e di se sa vite u bëmë bashkë, por s'ka rëndësi se shumë të tjera na presin. Tashmë je pjesë e familjes time dhe doja

të të falenderoja për gjithçka që kemi kaluar. E kam menduar shumë herë dedikimin tënd, por do e mbaj thjesht. Je një nga personat më të rëndësishëm në jetën time dhe të dua jashtëzakonisht shumë, të vlersoj pafund dhe uroj që gjithmonë ta kem energjinë tënde kudo të jem. Mezi po pres për vitet që do të vijmë dhe të gjitha planet na u realizofshin! Gjithmon fansja jote më e madhe dhe dikush që mund të mbështetetsh kurdo. Sa më shumë dexha vy!

Arsia Sefaj- Je shoqja që qëndroi me mua kur isha e re në këtë shkollë dhe e vlerësoj shumë. Më ke zbuluar shumë ditë me humorin dhe pozitivitetin tënd. Të uroj shumë suksese për të ardhmen!

Idlir Mergjyli- Me një shpirt të ngrohtë dhe një pranverë të paçmueshme në zemër. Me gatishmërinë tënde për të ndarë gëzimin, je një shkëlqim i pashuar. Faleminderit që je gjithmonë aty çdo moment, duke na ndihmuar dhe duke na këshilluar. Shpresoj të arrish shumë

Noel Sharka- Imagjinata jote gjithmonë më ka mahitur dhe i ka bërë edhe më të veçanta këto vite. Unë jam mirënjohës për idetë dhe bisedat që ndamë të cilat krijuan miqësinë tonë. Uroj të kesh një të ardhme të mbushur me frymëzim të pafund!

Brusen Tupi- Megani është një vajzë gjithashtu fjalë pak dhe me rezultate të larta mësimore. I uroj suksese.


Sofia Burimi- Je një vajzë shumë e mirë dhe faleminderit për ngjyrat.

Albana Bami- Megan është një nga vajzat më energjike dhe të sjellshme që njoh. Ajo ka një personalitet unik dhe përcjell pozitivitet në çdo moment. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat

Xhoi Beja- Është kënaqësi të kesh një mikeshë të sjellshme e pozitive si ty Megan. Pas kaq shumë vitesh që kemi ndarë bashkë, gjithmonë ti identifikohesh me mirësinë që fal dhe sinqeritetin. Te uroj më të mirat dhe vetëm suksese në çdo hap!

-Greta Berisha-

Megan, është viti parë që unë ndaj të njëjtën klasë me ty. Edhe pse kemi kaluar kaq pak kohë bashkë, unë kam arritur të kuptoj çfarë vajze e mirë dhe me vlera ti je. Ti di të jesh mjaft sociale me njerëzit dhe kjo gjë më pëlqen shumë tek ti. Të uroj sa më shumë suksese!



Noel Sharka

Gjeorgjos Koci- Djalë i papërshkrueshëm. Data ishte diku te dhjetë ose pesëmbëdhjetë nëntor dhe vizatoje pemën e Vitit të Ri dhe shkruaje “Merry Christmas”. I paparë je.

Adelajda Shahini- Djalë i urtë dhe i sjellshëm me këdo. Djalë me ambicie të larta, i zgjuar me arritje vërtet të merituar. Person me një zemër të madhe dhe i gatshëm të të ndihmojë me përpikmëri. Këto karakteristika vijnë si merita te ai, merita të cilat uroj dhe jam e sigurt, që do ta çojnë atë lart e më lart drejt suksesit dhe arritjeve me benefite.

Idlir Mergjyli- Noel, me dashuri dhe admirim për personin e shkëlqyeshëm që je. Faleminderit për momentet e gëzuara dhe mbështetjen tënde të vazhdueshme. Shpresoj që rrugëtimi yt të jetë i mbushur me suksese dhe lumturi.

Xhoi Beja- Noeli është një person i cili më ka habitur gjithmonë me zgjuarsinë dhe aftësinë e tij në mësim. Qetësia dhe vullneti i tij e karakterizojnë dhe e bëjnë atë një person të veçantë. Shpresoj të ecësh vetëm para!

Matteo Mavriqi- Noel, ti je një djalë shumë i urtë, por dhe shumë i sjellshëm dhe i zgjuar. Nuk kam shumë që të njoh po dhe me kaq e kam vënë re që je një person i duhur për t'u mbajtur shokë.

Greta Berisha- Noel, shoku im i bankës. Je një djalosh shumë i qetë. Ti je i mbushur plot me gjëra interesante brenda teje edhe pse nuk i tregon gjithmonë ato. Je shumë sistematik me çdo gjë tënden dhe kjo gjë më pëlqen tej mase shumë. Të uroj sa më shumë suksese!

Hilda Marinaj- Je një djalë i urtë dhe i zgjuar. Shpresoj të të shkojë jeta ashtu si ke dhe notat.

Albana Bami- Noeli është një mik shumë i zgjuar! Ai ka një mendje të shkëlqyer dhe është gjithmonë gati të mësojë gjëra të reja. Ai është një burim frymëzimi për mua dhe gjithmonë më bën të ndihem e motivuar. Uroj të arrish atë që meriton!

Ueysi Caca- Noeli është një djalë shumë i zgjuar dhe me rezultate shumë të mira në mësim. Sinqeriteti dhe qetësia është ajo që e karakterizojnë atë. Me zgjuarsinë dhe vullnetin e tij jam i bindur se do i arrijë të gjitha ëndrrat që ka.

Brusen Tupi- Noeli është një djalë shumë i qetë dhe me një vëmendje të plotë në orët mësimore ku nuk lejon ta shpërqendrojë asgjë. Shpresoj të ketë suksese.

Ines Balliu- Noel, edhe pse kemi 3 vite që jemi njohur, ti ke qenë gjithmonë ai djali pozitiv dhe i urtë. Je një djalë shumë inteligjent dhe gjithmonë i sjellshëm. Edhe pse kemi kaluar ca momente jo shumë të bukura në këto 3 vite, prapë do i kujtojë duke qeshur. Shpresoj që të arrish gjithçka që do dhe suksese në vazhdim!

Dea Xhemalaj- Je një djalë shumë punëtor dhe i qetë. E kam vlerësuar gjithmonë opinionin tënd për tema të ndryshme që kemi folur dhe besoj se kemi krijuar një shoqëri shumë të mirë me njëri- tjetrin. Uroj që t'ia dalësh gjithmonë mbanë dhe të kesh sa më shumë sukses në universitet e në çdo hap tjetër të jetës. Të falenderoj për të gjitha momentet e bukura që kemi kaluar këto vite të gjimnazit.

Megan Mara- Noel, unë të kam njohur që në vit të parë dhe madje mbaj mend që na vuri zysha të uleshim bashkë në vit të parë. Je një djalë shumë i zgjuar dhe i sjellshëm. Ke patur shumë arritje në shkollë dhe të uroj suksese në të ardhmen.

Etien Dhima- Noeli, në pamjen e parë, transmeton imazhin e një personi të qetë, të matur dhe të përkushtuar në mësim. Megjithatë, fsheh një thesar të vërtetë brenda tij, me shumë fakte interesante për t'u ndarë dhe diskutuar, gjë që mund të zgjasi me orë të tëra. Rëndësi ka të jesh ti i gatshëm t'i nisësh. Përtej imazhit të nxënësit inteligjent, ai mbart një notë të fortë të humorit, gati për t'u zbuluar. Në të vërtetë, një mik i veçantë!



Sofia Burimi

-Gledis Bajrami- Një vajzë shumë energjike, e qeshur dhe me shumë humor, ia kemi kalur mirë këtë vit dhe të uroj shumë suksese!

Arsia Sefaj- Erdhe këtë vit në klasë dhe i dhe asaj shumë ngjyra. Më pëlqen pafund guximi që ke dhe dashamirësia që shpreh ndaj njerëzve të cilët I ndjen të afërt. Uroj më të mirën për ty në çdo hap!

Idlir Mergjyli- Ti je një dhuratë e veçantë në shkollë. Me praninë tënde të përzemërt dhe me mbështetjen tënde të pafundme, je një shkëlqim i pashuar. Shpresoj të arrish atë çka dëshiron më shumë në jetë

Ines Balliu- Sofia, edhe pse kemi që në klasë të parë që jemi njohur, kemi kaluar një kohë shumë të bukur. Gjithmonë më ke bërë për të qeshur me shakatë e tua. Shpresoj të arrish gjithçka që ke ëndërruar dhe të uroj të gjithë të mirat dhe sa më shumë suksese në vazhdim!

Greta Berisha- Viktoriaaaa...Asnjëherë se kam menduar që do isha shoqe me ty sepse asnjëherë nuk të kam njohur mjaftueshëm. Je një ndër personat e mi të preferuar. Je një person që të rregullon ditën dhe humorin edhe sikur të thuash vetëm një fjalë te vetme. Vetëm ata persona që te njohin e din se sa pozitive je dhe çfarë shpirti të mirë që ke. Kujdesesh shumë për njerëzit e tu të zemrës dhe mundohesh ti bësh të gjithë të lumtur. Shpresoj që të kesh sa më shumë fat në jetë sepse sinqerisht një person që i meriton të gjitha. Love you loqka jeme!

Endi Corja- Je një vajzë shumë gazmore që ka një të ardhme të mirë përpara saj. Të uroj suksese për ta përmbushur atë.

-Matteo Mavriqi- Sofia je një vajzë energjike dhe gazmore. Kemi vetëm 1 vitë në klasë dhe ke arritur ti bësh për të gëzuar. Momentet me shakatë e tua ngelen të pa harrueshme. Të uroj suksese në studimet e mëtejshme.

-Dea Xhemalaj- Je një nga vajzat më gazmore dhe më të çiltra që kam njohur ndonjëherë. Gjithmonë më ke bërë për të qeshur me humorin tënd. Po ashtu je shumë e talentuar, sidomos në pikturë dhe më kanë pëlqyer të gjitha vizatimet që ke realizuar në klasë. Të uroj të arrish majat kudo që të shkosh sepse je një talent!

Adelajda Shahini- Sofia te unë në pamje të parë me ka ardhur si një vajzë trazovaçe dhe moskokëçarëse por kuptova në vazhdim që ajo është vajza më e dashur e cila kur të sheh të mërëzitur thjesht vjen dhe të përqafton. Është një vajzë e cila është e gatshme të kënaqet kudo dhe kurdo. I uroj nga zemra më të mirat dhe ta shoh atje ku ajo dëshiron.

Xhoi Beja- Sofia është një vajzë sociale dhe me karakter të fortë. Me anë të humorit të saj ajo mund të vërë një buzëqeshje në fytyrën e cdokujt. Të uroj vetëm të mira në jetë!

Hilda Marinaj- Bianka? Bashkim? Hahaha . Sofia kam gjithë këto vite që të njoh më në fund ramë në klasë bashkë. Ti ma ke bërë këtë vit më të bukur se sa e mendoja . Jam shumë e lumtur që kam një shoqe si ty . One of my favorite people në shkollë . Nuk do ti harroj asnjëherë momentet me ty nga ato më seriozet deri tek ato gazmoret . Je një vajzë me një karakter mjaft të fortë dhe mos ndrysho. Të uroj shumë suksese!

Albana Bami- Sofia është një shoqe e shkëlqyer! Ajo është një humoriste e mrekullueshme që gjithmonë më bën të qesh. Me shakatë e saj të freskëta dhe stilin e saj unik, Sofia është gjithmonë në gjendje të sjellë gëzim dhe kënaqësi në çdo moment. Është një kënaqësi të jem në shoqërinë e saj!

Megan Mara- Sofia je një vajzë shumë e mirë dhe gjithmonë ke ditur si ta bësh ditën në shkollë gazmore. Uroj që të kesh fat dhe mbarsi në jetën tënde. -

Uejsi Caca- Sofia është shumë gazmore dhe e pa ndrojtur . Ajo është një vajzë që të bën të ndihesh mirë dhe gjithmonë mundohet të të rrespektojë . Shpresoj shumë që Sofia të arrijë çdo gjë që e bën atë të lumtur



Steisi Laraku

Xhoi Beja- Steisi është një nga vajzat më energjike dhe të sjellshme që njoh. Ajo ka një personalitet unik dhe përcjell pozitivitet në çdo moment. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat !

Albana Bami- Është kënaqësi të kesh një mikeshë të sjellshme e pozitive si ty Steisi. Pas kaq shumë vitesh që kemi ndarë bashkë, gjithmonë ti identifikohesh me mirësinë që fal dhe sinqeritetin. Te uroj më të mirat dhe vetëm suksese në çdo hap!

Ueysi Caca- Steisi është një vajzë me karakter të fortë. Ajo di të mbrojë mendimin e saj dhe ka forcë argumenti . Me guximshmërinë që ajo mbart besoj se do ti arrijë të gjithë qëllimet e saj .

Brusen Tupi- Një vajzë me një sens humori të zhvilluar dhe një sjellje të mirë me të gjithë nxënësit e klasës. Uroj që të ketë suksese!

Noel Sharka- Prania jote në klasë ka qenë e paharrueshme dhe unë e kam admiruar angazhimin që ke treguar gjatë këtij viti. Suksese në jetë!

Arsia Sefaj- Steisi, një vajzë impulsive, e fortë dhe që e mbron mendimin tënd në të gjitha situatat. Tipare të cilat i vlerësoj shumë dhe tipare të cilat shpresoj të të ndihmojnë në rrugëtimin tënd!

Idlir Mergjyli- Me një shpirt të butë dhe një buzëqeshje të shkëlqyer, ti je një nga personat më të veçantë. Me miqësinë tënde të pashoqe dhe me gatishmërinë tënde për të ndihmuar të tjerët gjithmonë, je një kujtesë e mrekullueshme për kujtimet tona. Çdo ditë shpresoj të jetë një ditë me diell dhe e lumtur për ty.

Ines Balliu- Nuk kemi shumë kohë në të njëjtën klasë

apo që njihemi , por për kaq pak kohë që kemi kaluar bashkë kam kuptuar që je një vajzë shumë e qeshur dhe e dashur. Nuk heziton kurrë të jesh aty për miqtë e tu dhe shpresoj të kesh sa më shumë suksese në jetë dhe të të plotësohen të gjitha dëshirat sepse e meriton.

Greta Berisha- Stexhiii.Një vajz që nuk do tja di për njerëzit dhe opinionet e tyre por do vazhdoj të ndjek zemrën dhe idetë e saj.Nuk kam njohur asnjëherë një person si ti dhe jam e sigurt që nuk ka dy Stexhaa hahaha.Je shumë e zgjuar dhe fjala jote ka shumë peshë e vler.Të uroj sa më shumë suksese në jetë!

Hilda Marinaj- Stexhiii moj, muhabetet me ty janë gjithmonë interesante sidomos ato në fiskulturë hahaha. Je një vajzë me një karakter mjaft të fortë. Më pëlqen që i qëndron mendimit tënd deri në fund .Sdo ti harroj ndonjëherë shakatë me njëra tjetrën që veç ne i kuptojmë .Të uroj të gjitha të mirat në jetë!

Endi Corja- Je një vajzë shumë gazmore që ka një të ardhme të mirë përpara saj. Të uroj suksese për ta përmbushur atë.


Matteo Mavriqi- Steisi je një vajzë e zgjuar dhe energjike.Edhe pse kemi vetëm 1 vit në klasë ja kemi kaluar mirë.Të uroj suksese në studimet e mëtejshme.

Dea Xhemalaj- Pavarësisht se kemi një vit që njihemi ,kam arritur të të njoh shumë mirë.Je një vajzë shumë e dashur dhe mirëkuptuese dhe gjithmonë të shoh të buzëqeshur.Të uroj shumë suksese si në shkollë dhe në jetë dhe të arrish gjithcka që dëshiron!

Adelajda Shahini- Steisi është një vajzë që ne pamje të parë duket sikur nuk e çan kokën për asgjë por nëse e njeh mirë do kuptosh që është një vajzë e mbarë, e ndjeshme dhe e dashur. Shpretësoj që çdo gjë që ajo dëshiron ta ketë dhe çdo qëllim që ajo ka ta arrijë.

Sofia Burimi- Steisi:Shqiptareskaaa hahaha,kemi plot tre vite në klasë bashkë dhe kan qenë kohët më të bukura me ty,jemi zënë kemi qeshur e kemi qëndruar afër njëra tjetes,je një shoqe shumë e mirë dhe më bëhet qejfi që miqësia jonë ka vazhduar deri më tani. Të kam xhan brazilianjaa.

Albana Bami- Është kënaqësi të kesh një mikeshë të sjellshme e pozitive si ty Steisi. Pas kaq shumë vitesh që kemi ndarë bashkë, gjithmonë ti identifikohesh me mirësinë që fal dhe sinqeritetin. Të uroj më të mirat dhe vetëm suksese në çdo hap!



Ueji Caca

Adelajda Shahini- Djali më pozitiv dhe suportues i klasës. Person që di të fal mbështetje dhe buzëqeshje dhe të ta kthej atë pa hezitim. Ai është i hapur ndaj gjërave dhe i thotë ato ashtu si ai i mendon, karakteristika këto të veçanta që e bëjnë një njeri akoma më të mirë, si mbrenda ashtu edhe jashtë. Uroj që ky pozitivitet, humor i mirë dhe buzëqeshje të të shoqërojë gjatë gjithë jetës duke parë suksese!

Albin Hoxha- Bashkë njihemi që kur kemi qenë në një moshë të vogël edhe prap jemi shokë shumë të mirë. Në këto 3 vite shakatë që kemi bërë bashkë nuk mund ti numërojmë. Suksese kudo që të jesh!

Kristi Lipivani- Sëbashku jemi njohur në klasë të tetë dhe që atëherë jemi bërë shokë të ngushtë. Të uroj fat e suksese!

Xhoi Beja- Ueji është një djalë i veçantë dhe me ide nga më të ndryshmet. Ai ka ambicie të larta në jetë, të cilat ai ka kapacitetin që ti arrijë. Gjatë këtyre viteve ai ka qenë një nga shokët e mi më të mirë që kam patur. Do i mbaj gjithmonë mend historitë e tua dhe kohën që kemi kaluar bashkë me të qeshurat tona që nuk ndalonin. Shpresoj që ti arrish të gjitha ato bizneset e tua dhe të ecësh sa më shumë në jetë!

Endi Corja- Kemi tri vite që jemi në klasë bashkë dhe kam patur mjaftueshëm kohë që të kuptoj që je person gazmor! Suksese! Plus që je një nga shokët më të vjetër që kam.

Albana Bami- Ueji është një mik i shkëlqyer! Ai është i vendosur të arrijë qëllimet e tij. Ueji është një person vizionar dhe i përkushtuar në punën e tij. Me inteligjencën e tij, nuk ka dyshim se do të arrijë shumë

suksese në jetë. Jam e lumtur që kam një mik kaq ambicioz.

Gjeorgjos Koci- Ueji e bën klasën më të gjallë me fjalët dhe humoret e tij. Gjithashtu është një djalë tepër inteligjent në aspekte të ndryshme. Të uroj më të mirat!

Brusen Tupi- Ai ka një logjikë të fortë dhe është shumë i dashur. Shoqëria me të bën të ndihesh mirë. Shpresoj që të ketë një karrierë dhe jetë të suksesshme.

Noel Sharka- Ti je një shok dhe student i mirë edhe pse nuk flisim shumë gjatë shkollës. Mua më pëlqente kur punoja me ty në projekte dhe përkushtimi yt në grup e bënte punën të këndshme. Suksese në jetë!

Arsia Sefaj- Një shok klase i sjellshëm, gjithmonë i respektueshëm dhe plot me histori. Mënyrat që krijon për të dalë nga sitata janë me të vërtetë për tu vlerësuar. Të uroj më të mirën!

Idlir Mergjyli- Me një humor të shkëlqyer dhe një zemër të madhe, ti je një nga personat më të veçantë. Me ndihmën tënde të paçmueshme dhe me gatishmërinë tënde, je një burim i lumturisë për të gjithë. Faleminderit që je gjithmonë aty në çdo moment dhe për të gjitha aventurat e paharrueshme. Për të gjitha këto arsye dhe shumë të tjera, të uroj fat më tej!

Ines Balliu- Ueji, edhe pse kaq pak vite që jemi njohur, nuk do e harroj asnjëherë kohën që kemi kaluar bashkë. SIDOMOS, ato ditët kur luaje me maskerinat dhe unë asnjëherë nuk acarohesha. Shpresoj të të plotësohen të gjitha ëndërrat dhe sa më shumë suksese në vazhdim!

Greta Berisha- Shoku im i bankës. Përveç faktit që je një çun shumë pozitiv dhe i sjellshëm, ti je dhe një humorist shumë i mirë. Je një person me të cilin mund të flasësh çdo gjë dhe kjo gjë më pëlqen shumë tek ti. Shpresoj që planet e tua të pafundme që ke për të ardhmen të të plotësohen të gjitha. Suksese!

Hilda Marinaj- Je i qeshur gjithmonë gjë që të cilën e përcjell tek të gjithë. Ti je një djalë shumë i shkathët dhe i drejtpërdrejtë. Mund të shoqërohesh mjaft mirë me të gjithë brenda dhe jashtë rrethit tënd shoqëror. Të uroj shumë suksese!



Xhoi Beja

Gjeorgjos Koci- Edhe pse në fillim kur të shih të bie në sy pamja jote e bukur kur bisedon me ty vë re që je një vajzë e dashur dhe zemërmirë. Do më kujtohet gjithmone kur më pyete sa bejnë tre minus zero dhe u bëre gati të përdorje makinën llogaritëse. Suksese!

Adelajda Shahini - Xhoi është vajza e cila nuk ka turp të të flasë, e qeshur dhe e bukur. Person i cili të vlerëson shumë dhe të përgjigjet me sinqeritet. Xhoi është vajzë me ambicie, motive dhe qëllime të larta duke i marrë qetë dhe pa vështirësi, duke arritur atë që ajo do dhe këtë ja uroj me gjithë zemër, një sukses të madh për një zemër të madhe.

Uejsi Caca- Xhoi, ti je një vajzë shumë e sjellshme dhe e bukur . Ëmbëlsia dhe dashuria që ti përcjellë te njerëzit të bëjnë ty shumë të veçantë. Edhe pse kemi shumë vite që njihemi , gjimnazi është ai i cili bëri të mundur të të njoh më mirë. Uroj që pas gjimnazit të arrish majat dhe të kesh sukses për çdo gjë që do të bësh.

Dea Xhemalaj- Kemi së bashku pesë vite që njihemi dhe dua të them se jam shumë e lumtur që kam njohur dhe kam një shoqe si ti. Gjithmonë më ka pëlqyer humori jot dhe kohët që kemi kaluar së bashku tërë këto vite. Të falenderoj për të gjitha momentet e bukura dhe të vecanta që kemi përjetuar dhe uroj që sukcesi të të ndjeki gjatë gjithë jetës tënde. Shpresoj të arrish çdo gjë që dëshiron në këtë jetë.

Alban Hima -Xhoi, shoqja ime me humor, është një person që mban gjithmonë një buzëqeshje në fytyrë. Ajo ka një talent për të bërë njerëzit të qeshin me shakat e saj. Çdo herë që jam me të, koha kalon shpejt dhe plot humor. Te uroj vec sukses nga bunny!

Ardian Marinaj- Xhoi Beja, për ty skam fjalë. Shumë vite kanë kaluar dhe ti prap je e njejtë, je prap ajo Xhoi e cila mëson me orë të vona, je ajo e cila bën shpesh pauza nga realiteti, je prap ajo e cila mundohesh të besh si e sinqert nderkohë gënjen më shumë se pinoku. Gjithsesi themi se je një gocë e mirë, e sinqert, e embël, gallat dhe kemi kaluar një kohë shumë të bukur. Plotësosh ëndrrat e tua nga Ardian bisha!


Albana Bami- Xhoi, shoqja ime e ngushte, është një person me një talent të jashtëzakonshëm për të bërë njerëzit të qeshin. Kur jemi së bashku, aventurat tona janë të panumërta dhe çastet që kalojmë nuk harrohen lehtë. Nuk ka moment të mërzitshëm kur jam me të. Ne kemi kaluar shumë kohë bashkë dhe ajo më është gjendur pranë gjithmonë. Edhe pse ka një diferencë të madhe në gjatësi midis nesh, ajo ka aftësinë e veçantë të më bëjë të ndihem sa më afër saj në çdo kohë. Shoqëria jonë padyshim që do të vazhdojë edhe pse shkolla po mbaron. Jam shumë e lumtur dhe e privilegjuar që kam një shoqe si Xhoi në jetën time! Nuk ka fjalë për ta përshkruar se sa e rëndësishme është ajo për mua. Nuk më mbetet gjë tjetër veçse të uroj më të mirat dhe vetëm sukses në çdo hap! Love you!

Emili Leka- Best model dhe funniest. E di që je e preferuara. Edhe pse tallemi se thua që je superiore ke të drejtë. Je shumë e mirë, e zgjuar dhe e talentuar. Je personi me i vecantë që njoh. Ke një karakter si askush tjetër dhe asnjëherë nuk ka momente të qeta kur jemi me ty. Kemi kaluar shumë momente të bukura bashkë dhe jam e sigurt se do të vazhdojë. Kemi shumë plane për të ardhmen të cilat duhet ti realizojme. Ly!

Sara Pajtoni- Xhoi, sa vite u bëmë që njihemi dhe duke kaluar koha aq më shumë jemi afruar. Nuk e kisha menduar më parë se do ishim kaq të afërta sa në keto tre vite gjimnazi. Dikur ishim vetëm shoqe shkolle e tani je kthyer në një nga njerëzit më të rëndësishëm të rrethit tim. Ke qen gjithmonë aty për të dëgjuar sa her kam pasur dicka dhe i kemi qendruar përherë pranë njëra tjetrës . Mos e humb kurrë mirësinë që ke brenda teje dhe sidomos sensin e humorit që të karakterizon. Nuk do e harroj kurrë çdo kohë të bukur që kemi kaluar në këto vite dhe mezi pres për kohët në vazhdim. Gjimnazi mbaroj dhe po kalon ne një etap tjetër të jetës, gjëra më të bukura të presin dhe duke të njohur jam e sigurt që do shkëlqesh në çdo fushë të jetës.











Adelajda Mujo

Të dashur maturantë!

Sot, ju po mbyllni një kapitull shumë të rëndësishëm të jetës suaj, atë të gjimnazit. Ky është një moment i veçantë dhe i paharrueshëm për ju, por gjithashtu është edhe fillimi i një kapitulli të ri, plot me sfida dhe mundësi të reja.

Klasa 12 B, ju do të kujtoheni gjithmonë për bashkëpunimin dhe unitetin që treguat me njëri-tjetrin. Ju ishit një klasë që respektonit çdo mësues që ju dha mësim dhe çdo pjesëtar të klasës që iu bashkua gjatë tri viteve të gjimnazit. Bashkëpunimi dhe përkushtimi juaj ndaj njëri-tjetrit ishte shembull për të gjithë.

Jam shumë e lumtur që kam qenë zysha juaj kujdestare për dy vite. Kemi kaluar shumë momente të mira dhe jo të mira së bashku dhe kemi arritur të kuptohemi shumë mirë, thjesht edhe me një shikim.

Ju do të kujtoheni gjithashtu për vendosmërinë tuaj kur vendosnit diçka dhe e realizonit të gjithë së bashku. Qoftë edhe kur vendosnit të mungonit një ditë mësimore, e realizonit të gjithë me një mendje.

Ju uroj të gjithëve suksese dhe fat në çdo hap të jetës që do të ndërmerrni!

Gëzoni pafund, qeshni pafund, pa pasur frikë nëse dukeni keq apo mirë.

Shijoni dhe jetoni me emocion çdo minutë, vlerësoni gjërat e vogla e përpiquni ti bëni të tjerët të ndihen si ju.

Me dashuri dhe respekt,
Adelajda Mujo



Keisi Çuçaj

Adora Kika: Keisi është një vajzë e dashur me njerëzit e afërt, por di të bëhet edhe rebele për të kërkuar të drejtën e saj, gjë e cila më pëlqen shumë në karakterin e saj. Ajo ka një ego për të qënë gjithmonë e para dhe është shumë kërkuese ndaj vetes. Me këto karakteristika, si dhe vullnetin e saj për të marrë përsipër gjithçka dhe për ta çuar deri në fund, jam shumë e sigurt që do ia dalë më së miri në jetë dhe do të realizojë të gjitha dëshirat e saj. Suksese!

Ajsel Mlika: Ndër vajzat më të mira që unë kam njohur dhe këtë e them me plot gojë. Ndër vajzat më të sjellshme, më të disiplinuar dhe më unike që unë kam pasur nderin të ndaj të njëjtin ambient për tre vjet në jetën time. Se di a e mban mend, por kujtimet e mia të para me ty janë tek ai provimi i fizikës në semestër të parë të vitit të parë. Pastaj në ekskursionin e Shkodrës u njohëm dhe më shumë, si vendi i parë jashtëshkollor ku kaluam kohë. E sa gjëra të bukura kemi kaluar bashkë. Unë ti dhe Kevi formonim atë treshen studioze, ku para çdo provimi semestri mësonim njeri-tjetrin. Keis Çuçaj ta thashë dhe po ta them përsëri se je ndër vajzat më të sjellshme ndonjëherë dhe se do të të mbaj gjithmonë në memorien time.

Amina Haxhialushi-Keisii! Në këto dy vite, ti ke qënë një nga shoqet e mia më të afërta. Ti je një vajzë shumë e mirë, e zgjuar dhe e sinqertë. Çdo ditë kemi folur për gjëra nga më të ndryshmet dhe jemi argëtuar shumë. Gjithmonë më ke dëgjuar e më ke ndihmuar kur kam patur nevojë. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë. Suksese!

Alden Malaj: Keisi, ti je një nga vajzat që mëson më shumë dhe nga më të urtat në klasë, prandaj edhe unë të bezdis dhe të ngacmoj që të zgjohesh nga gjumi, por

mos e merr gjithçka shumë seriozisht, disa gjëra duhet t'i kalosh me sportivitet. Më ke ndihmuar shumë herë në situata të vështira dhe për këtë të jam mirënjohës. Suksese!

Amarda Heta- Nuk do ta mendoja kurrë që do të ishe kaq e rëndësishme për mua. Kur të kam takuar, ishe akoma me telat e tua dhe më jepe një përshtypje sikur nuk dëshiroje të rrije me askënd, por vetëm të mësoje. Ishe krejtësisht e kundërta ime dhe akoma je, por në një farë mënyre përshtatemi më së miri. Ndoshta kjo është të kesh një shoqëri të vërtetë. Je gjithmonë aty duke më këshilluar kur gaboj ose jo, dhe shpresoj të ndihesh dhe ti njësoj për mua. Pa u zgjatur më shumë, do të jesh gjithmonë me mua, edhe nëse nuk je prezente. Shpresoj që të realizosh ëndrrën tënde dhe të bëhesh arkitektja më e njohur në botë. Të përqafoj fort!

Joel Merkaj- Vajza më punëtore e klasës. Gjithmonë e gatshme të marr rolin e liderit në projekte, si dhe të organizojë aktivitete jashtëshkollore për klasën. Suksese!

Kevin Kotarja-Keisi redaktorja e klasës sonë. Gjithmonë ke qënë e palodhur, sado punë të vështira ke marr përsipër. Për çdo gjë nuk ke ngurruar asnjëherë për të më pyetur dhe më pëlqen besimi që ke te unë. Jemi mekur këto vite me bankat tona afër. Më mbetet në mendje sa herë I toleron njerëzit dhe përpiqem të të ngjajë shumë nga kjo anë. Je një vajzë e qeshur dhe zemërmirë. Suksese!

Ledio Zaimi -Një mike shumë e mirë. Do ta kujtoj gjithmonë për karakterin e saj dhe për faktin se ajo konkurren me çdo student të mundshëm. Do ta kujtoj për faktin që ajo është personi që qan më lehtë se të gjithë njerëzit që njoh. Suksese!

Rei Skura- Kjo s'fal kurrë. I ngrita zërin në orën e fizikës para 2-3 javësh dhe akoma s'e ka harruar. Prapëseprapë, e kam shoqe. Është shumë vajzë e mbarë. Suksese!

Uendi Baço - Je një nga vajzat më të mira që kam njohur. Je e çiltër, plot pozitivitet dhe me zemër të madhe, mundohesh të ndihmosh të gjithë. Të uroj fat në jetë!



Amarda Heta

Adora Kika- Amarda është një vajzë e dashur ,që e kam shumë përzemër. Në pamje të parë ajo mund të duket shumë e urtë ,por në momentin që fillon rri me të edhe e njeh është shumë e hapur dhe e qeshur. Është një person që mund të kalosh relativisht një kohë të mirë dhe mund të flasësh për gjëra të ndryshme ,se e di që ka zhvillimin e duhur për të kuptuar dhe dëgjuar. I uroj shumë suksese në degën e bukur që ka zgjedhur! Jam shumë e sigurt ,që si vajzë inteligjente që është ,do t'ja dali në dëshirat që ajo ka.

Ajsel Mlika: Sa orë kemi kaluar bashkë, duke qeshur për më të voglat budalliqe gjatë orës së mësimit apo jashtë saj. Andej nga viti i dytë, kur kishim dy orët e fundit fiskulturë, zinin atë stolin aty përjashta e ja shtronim muhabetit për dy orë rresht me kë të na dilte para. Kemi bërë shokë e jemi zënë me shoqe gjatë gjimnazit ,por asnjëherë nuk kemi debatuar bashkë si dy njerëz të kulturuar që jemi. Ato ditët e Asefit kanë qënë interesante ,kur vinim plot me materiale për të prezantuar projektin edhe na përcillnin te dera, se medaljet i merrnin ata që kishin bërë rrugë të gjatë të vinin deri te Turku. Prapë se prapë kjo nuk na ndaloi ne të kalonim çaste të bukura me grupin nëpër korridoret e nëntë-vjeçares. Po fundja se mos u futëm të fitonim gjë ne, mjafton të na merrnin zyshat me sy të mirë se s'po na duhej fort ajo medalja jo. Dhe pse harxhonim një ditë të plotë nga fundjava jonë në shkollë, prapë gjenim dritën në fund të tunelit. Të uroj suksese në karrieren tënde se e di që nuk është aspak e lehtë!

Albi Çela-Je një vajzë shumë e zgjuar dhe e sjellshme. Shpresoj të realizosh dëshirat e tua në jetë!

Arbi BraÇi-Vajzë e mençur, pozitive dhe llafazane. Të

uroj gjithë të mirat!

Ekaltra SulÇe- “Nuçe”. Dëshirë kam të flas për ty ,por e kemi paksa të kufizuar hapësirën për të shkruajtur. Të uroj suksese dhe shihemi së shpejti sa në Western sa në Epokë!


Joel Merkaj- Vajzë shumë e mirë dhe e zgjuar. Kemi kaluar plot momente të bukura gjatë këtyre tre viteve. Të uroj suksese!

Keisi ÇuÇaj-Të jesh shoqe me ty është një aventurë e fuqishme. Nuk kalon një ditë pa ndonjë tragedi të vogël që në pikë të mëngjesit (si derdhjet e përhershme të makiatos që btw s'është faji im që I lë tek brryli im hahaha). Dihet se nëse mungoj unë, do mungosh edhe ti , nëse jam unë në një konkurs ,je dhe ti. Se jemi të pandashme (dmth të tjerët s'kanë nevojë ta dinë që të tërheq gjithmonë unë ,pasi ti s'do të marrësh pjesë në asgjë PASIVJA IME).Të gjithë na pyesin se si e kuptojmë njëra-tjetrën me shikime ,në fakt as ne vetë nuk e kuptojmë sesi ,por një gjë është e sigurt që na hyn shumë në punë kur është sezon provimesh. Më pëlqejnë shumë orët e turqishtes ,ku marrim nga një kapucino dhe ca stika dhe ia fusim një dorë muhabeti. Më pëlqen që nuk ke frikë të më thuash të vërtetën në sy dhe pse zgjedh fjalët më të gabuara dhe më vrastare për t'i thënë. Gjimnazi është vetëm një kapitull nga libri i aventurave tona Am. Shpresoj që shoqeria jonë të mos ketë një epilogue, pasi kjo do të nënkuptonte fundin e shoqerise që do apo nuk do ti nuk do të vij kurrë, por të jetë një libër që s'ka fund. Nuk të ndahem moj uaaa. Dashuri të puth fort!

Kevin Kotarja- Si shoqja e ngushtë e Keisit, Ami është një pol komplet I kundërt me të. Është një vajzë shumë e mirë dhe e qeshur. Herë e shohim plot energji, e herë të fikur fare. Ka një sens të thjeshtë humorit dhe I pranon shakatë mirë. Nuk stepet kur vjen puna të debatojë me të tjerët. I uroj suksese të mëtejshme!

Ledio Zaimi - Një mike vërtetë e mirë dhe e vlefshme. Do ta kujtoj gjithmonë për pozitivitetin e saj dhe për faktin se është gjithmonë e lodhur. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj që shoqëria jonë të mos përfundojë kurrë!

Rei Skura- Ke zemrën më të ngrohtë. Je shumë e sinqertë dhe e urtë. Je shumë vajzë e mirë, po s'ke humor fare dhe s'më vjen keq që po ta them. Gjithsesi të kam shoqe dhe do të të kem.Suksese!



Joel Merkaj

Ajsel Mlika: Bashkë Merkaj u njohëm nga një shok i përbashkët, para se të bashkoheshim në të njëjtën klasë brenda pak javësh. Ke qënë ndër shokët më të mirë që kam pasur ndonjëherë brenda mureve të shkollës, se kemi pasur një lidhje shumë të pastër e të hapur bashkë. Për çdo kënaqësi, apo pakënaqësi me njëri-tjetrin ne ja themi lirisht njëri-tjetrit pa ndonjë ndrojtje a mërzitje, se në këtë mënyrë e kemi krijuar dhe mbajtur vetë lidhjen. Për çdo herë që kemi rënë bashkë nëpër projekte ja kemi hedhur kollaj, se aftësitë tona të komunikimit si ka njeri aty brenda klasës. Ne të dy e hapnim shkollën edhe klasën se vinim çdo ditë më përpara se të vinte ndonjë tjetër, shpesh për të bërë ndonjë detyrë, apo për t'i dhënë një refresh atyre që kishim mësuar një natë më përpara, se kishim provim që në orën 9. Vetëm tre vjet kemi kaluar bashkë si miq që na bashkoi gjimnazi pa gerricje e zënka. Ke qënë ndër miqtë e mi më të mirë dhe do të mbaj mend për shumë gjatë. Suksese në universitet dhe jetë e do shihemi shpejt!

Albi Çela-Kaluam shumë mirë dhe kuptova që je një djalë plot humor dhe pozitiv. Të uroj suksese në jetë!

Alden Malaj: Boksieri ynë shihet gjatë gjithë kohës duke gjuajtur dikë, ose duke u ushtruar. Një nga humoristët e klasës, por një mik i vërtetë. Ai i di kufijtë e shakasë, prandaj më pëlqen shumë ky fakt. Nëse keni një problem, ai do të gjej një zgjidhje për problemin. I thonë tamam më mirë një mik se një thesar.

Amarda Heta- Je një djalë shumë i sjellshëm dhe i zgjuar. Një ndër miqtë që më ke qëndruar pranë më së shumti, kur kam pasur nevojë. Ke qënë aty në të mirë e në të keq duke u munduar gjithmonë që të qeshim sa më shumë. Je më funny se unë, okay po e

pranoj. Jam shumë e lumtur që të kam njohur dhe që je bërë një ndër personat, që e kanë bërë këtë gjimnaz të paharrueshëm. Të uroj sa më shumë sukses në vazhdimsinë tënde!:)

Arbi Braci-Një shok i mirë, një djalë i zgjuar dhe i shkathët. Të uroj suksese!

Ekaltra SulÇe- Je një djalë tepër i sjellshëm me Çdokënd që njeh dhe i respekton. Dhe pse nuk kemi shkëmbyer shumë diskutime bashkë, më ke lënë përshtypje si një djalë i respektueshëm. Suksese në të ardhmen!

Keisi ÇuÇaj - Takimi ynë I parë ka qënë në vitin e parë, ku unë dhe Ami u ulëm në bankën tënde dhe veÇ kur ti vjen tërë seriozitet dhe thua 'Çohu, se s'kam nerva t'ju duroj' dhe ne si fillim u shtangëm dhe pastaj bërtite e the- 'DO ÇOHENI!' e ne u ngritëm e ndërnuam bankë mekem kur e kujtoj. Nejse atëherë dukesh sikur s'të fliste dot njeri, po thjesht ishte një fasadë se në fund dole një tip shakaxhi dhe aspak serioz. Edhe pse gjithmonë më tall dhe të pëlqen të më bësh për të qarë, sa herë që kam pasur nevojë më ke dhënë këshilla shumë të vlefshme. Suksese në Gjermani se të duhet!

Endi Hysi-Një shok i mirë, një djalë i zgjuar dhe i shkathët. Ti je një person i sjellshëm, që e vlerëson shoqërinë. Ti ke llojin tënd të humorit, i cili nuk është kurrë zhgënjyes. Të uroj suksese!

Kevin Kotarja- Shoku im më I mirë prej vitesh. Arrijmë të kuptohemi me njëri-tjetrin vetëm me një shikim. Nuk mbahen mend sa e sa herë kemi qeshur bashkë për budallallikun më të vogël e I kemi hapur punë njëri-tjetrit Çdo orë mësimi. Kujtimet e situatat që kemi kaluar bashkë s'kanë të mbaruar, që nga më të mirat deri te më të këqijat. Është një person, që të mbështet në vendimet e tua dhe të gjendet gjithmonë pranë. I drejtë dhe I gatshëm për të të thënë të vërtetën në sy. I uroj suksese të mëtejshme!

Ledio Zaimi- Një shok i vlefshëm që e njoha në vitin e dytë të gjimnazit. Shumë i afrueshëm, i sjellshëm dhe i zgjuar. E vlerësoj për të gjitha ato momente që krijoj me mua. Të uroj shumë suksese!

Rei Skura- Kur të pashë për herë të parë, thashë me vete:-' Me këtë do zihem.' Tani as që më shkon ndërmend. Je shumë I zgjuar dhe shok shumë I mirë. Të uroj suksese të mëtejshme!



Ajsel Mlika

Adora Kika: Tashmë u bë pesë vite që unë me Ajselin jemi në të njëjtën klasë dhe të pesta këto vite nuk di njëherë që ai të më ketë lënë një përshtypje negative. E di që do më mungojë humori i tij ,si dhe energjia e mirë që të fal që në mëngjes edhe kur ,ti nuk je në gjendjen tënde më të mirë. Suksese Ajsel!

Alden Malaj: Kur më vjen rasti të flas për miqësinë tonë, nuk di çfarë të them më parë dhe kam të drejtë, sepse nuk besoj se ka njeri në këtë botë ,që e ka këtë miqësi. Kemi kaluar momente të bukura dhe të këqija, kemi qeshur e qarë së bashku, me pak fjalë jemi rritur së bashku. Kur pas dhjetë apo njëzet vitesh të kthehesh pas në kohë dhe t'i lexosh dedikimin tim fëmijëve të tu, e të fillosh ti tregosh për aventurat tona dhe çfarë do të thotë të kesh një shok për jetën, nuk dua të qash, dua vetëm të qeshësh. Suksese Ajsel!

Amarda Heta: Je djali më i mirë që kam njohur ndonjëherë dhe gjithmonë je ti ai që e mban klasën në harmoni. A do të vish ti tek shkolla ime ,apo unë tek e jotja, do ta zgjidhim më vonë hahaha ,por gjithsesi rëndësi ka që do të takohemi. Të uroj më të mirat dhe sa më shumë të qeshura!

Ekaltra Sulçe: Besti im.. Jam shumë me fat që je pjesë e jetës time. Shpresoj mos të më zëvendësosh për askënd se i shkreti ti. Më vjen keq që të kam nxirë jetën me detyrat e shtëpisë, pasi unë e kam mendjen të merrem me gjëra më të mëdha se detyrat që na jepnin. Nuk të uroj më të mirat ,pasi më e mira për ty jam unë. Suksese në të ardhmen!

Endi Hysi: Personi më pozitiv në klasë. Ai është një djalë shumë i drejtë dhe më lë të kopjoj gjithmonë detyrat e tij. Shakatë e tij më binin gjithmonë në sy

dhe ai gjithmonë gjente një mënyrë për të më bërë për të qeshur. Të uroj suksese!

Joel Metaj: Ajseli një nga djemtë më të mirë të klasës. Të them të drejtën pa ty o Ajsel, nuk do t'ja kishim arritur kurrë ta kalonim gjimnazin dhe jo vetëm unë ,por e gjithë klasa. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë më tej shkollës. Të uroj gjithë të mirat!

Keisi Çuçaj: Doni apo nuk doni ju Ajseli ka qënë dhe do të mbetet shoku im më i mirë. Detaji i parë që na ka lidhur, ishte se ne ishim dy më të përgjegjshmit e klasës. Gjatë vitit të dytë e të tretë shkëmbenim shumë shaka me njëri-tjetrin. Kur ndonjë zysh bëhej me nerva dhe thoshte- “MBYLLNI LIBRAT, QUIZ!!!” i jepnim njëri-tjetrit një side-eye dhe mekeshim. Ai quiz-i i fundit në gjeografi na propozoi fare hahahahah. Hajde tani me një bursë tek Epoka ,s'po kërkojmë shumë të shkretët një 75%. Suksese Ajsel!

Kevin Kotarja: Çuni më i përgatitur i klasës. Gjithmonë spektakolar, gjithmonë me Gridën, gjithmonë Ajseli që kam njohur që në kopësht. Si dy më të mëdhenjtë e “Cicërimave” mu bë shumë qejfi kur e pashë emrin tënd në klasën time të gjimnazit. Edhe pse do jemi larg, jam i sigurt që do mbetemi shokë shumë të mirë. Të uroj suksese!

Ledio Zaimi: Djali më pozitiv në klasën tonë je ti. Do të të kujtoj gjithmonë për faktin ,se më ndihmoje me detyrat e shtëpisë përherë dhe se asnjëherë nuk mërziteshe me asnjërin prej nesh. Të uroj suksese!

Rei Skura: E mban mirë me të gjithë në klasë. Je një djalë shumë i qetë dhe për këtë të kam zili. Është e pamundur të krijosh një konflikt me ty. Suksese në jetë!

Tania Shoraj- O Ajsel, o zemra ime. Kemi kaq shumë kohë që njihemi edhe çdo ditë që kalon mendoj ,sesi do ja dal unë në universitet pa të patur ty aty mbrapa bankës, për të komentuar çdo gjë gjatë mësimit vetëm me një shikim. Çdo fundjavë do vish në Romë ,se do pimë kafën e fundjavës(që ta dish dmth). Të uroj shumë suksese dashuri!

Uendi Baço: Një nga djemtë më të mirë dhe më pozitiv që kam njohur. Gjithmonë di ta nxjerrësh veten nga situata dhe di se çfarë dhe kur të thuash diçka. Të uroj suksese në jetë!



Ledio Zaimi

Adora Kika- Ledion e kam një shokë të mirë të cilin e vlerësoj. Ai është i dashur, pozitiv dhe ka një zemër të madhe. I uroj suksese dhe si djalë inteligjent që është jam shumë e sigurt ,që do ia dali shumë mirë në degën që ka zgjedhur.

Ajsel Mlika: Kushoja e prof Greljonit e ke emrin e do mbetesh. Ti më jep një ndjenjë shumë pozitive ,kur të kam afër vetes. Na ecën muhabeti vaj fare, se të dy jemi tipa që i marrim goxha lehtshëm gjërat ,sado të vështira të jenë dhe s'na intereson fort mendimi i të tjerëve për ne. Çfarë s'do harroj nga ti është një ditë ,kur bëmë bashkë mundje dore, se ku ma kape keq krahun më le me një dorë për 1 javë. Je njëfarë nerdi dhe ti po se jep veten. Dhe pse supozohet të jetë një dedikim apo letër lamtumire, të dy e dimë se do shifemi shumë shpejt nëpër shkallët dhe oborret e Epokës, duke lënë orët se s'do kemi nerva as të hyjmë në mësim. Të puth fort e see you soon!

Alden Malaj: Mirë që erdhe ti ,që njohëm se ku i binte Gramshi. Shpresoj që të vazhdosh të sillesh si tani, me atë buzëqeshjen tënde që të karakterizon. Më pëlqen që i trajton mirë të gjithë dhe nuk përpiqesh kurrë t'i poshtërosh të tjerët. Edhe pse kemi vetëm 2 vite në të njëjtën klasë, më duket se kemi kaluar 12. Të uroj më të mirat!

Amarda Heta-Hi bestie!Je shoku më i mirë që kam dhe jam mjaft e lumtur që të kam.Kemi kaluar momente të paharrueshme gjatë shoqërisë tonë.Je gjithmonë aty për të më ngritur humorin me shakatë e tua ,por në fund të ditës të kam xhan haha!Do të kënaqemi në universitet sëbashku dhe me këtë të uroj gjithashtu sa më shumë suksese!

Arbi BraÇi- Një nga shokët e mi më të mirë. Gjithnjë i qeshur dhe pozitiv. Suksese!

Ekaltra SulÇe-Më pëlqen të flas me ty në kohën e lirë. Je djalë i sinqertë dhe tepër i dashur. Nuk e kuptoj pse gjithmonë sillesh mirë dhe me njerëzit që nuk ta duan të mirën, ne jse zgjedhja jote. Interesante është që në shoqëri nuk bën diferencime ,gjë që të bën për vete. Të uroj më të mirat!

Keisi ÇuÇaj- Erdhe vitin e dytë ishe I urtë në fillim dhe flisje vetëm me Arbin e Rein po pasi unë dhe Ami të afruam, s'kishte njeri të ta qepte atë gojë. Ne na ecën mirë muhabeti, se ndajmë të njëjtat ndjenja për ca njerëz të parëndësishëm. Gjithmonë kur unë kam qarë më ke ndenjuri pranë për të më ngritur humorin. Të falenderojë për cdo gjë. Suksese në jetë!

Kevin Kotarja- Super çun. Një ndër djemtë më të mirë që kam takuar ndonjëherë dhe njëkohësisht një ndër shoket e mi më të mirë. Është një mik I cili edhe pse kemi 2 vite që njihemi ,mund ti drejtohem si të kem nje jetë që e njoh. Gjithmonë është I qeshur dhe I gatshëm për të na larguar nga monotonia e ditëve të shkollës. Është shumë I aftë në bisedat që bën dhe argumentat që shtron. Suksese të mëtejshme!

Rei Skura- Jemi njohur në vitin e parë dhe as që jam bërë pishman. Je nga personat me të cilin ja kaloj më mirë. Je shumë pozitiv dhe i zgjuar. Kemi kaluar shumë momente të bukura bashkë dhe do të vazhdojmë kështu. Suksese në jetë!

Tania Shoraj- O Ledio i vogël. Je djali më zemërbardhë edhe më pak i djallëzuar që njoh. Më pëlqen shumë qetësia dhe thjeshtësia jote.Një djalë që është gjithmonë i qeshur dhe nxjerr në pah anën time pozitive më mirë se çdo person tjetër. Do më mungojnë shumë 5 minutshat gjatë orëve të mësimit ,që merrnim makiato edhe lojërat murlan në telefon. Mungesa jote do ndihet shumë dhe shpresoj t'i mbajmë kontaktet. Të uroj shumë suksese!



Rei Skura

Ajsel Mlika: Kasetofoni i klasës që e nis çdo ditë me këngë e valle. Ke qënë ndër çunat më flori që kam njohur në jetë dhe shpirti yt frymëzues është tepër i rrallë për tu gjetur te gjenerata jonë. Marrëdhëniet tona kanë pasur vetëm ngjitje ,ku në asnjë moment nuk janë krijuar hapsira për hatërmbetje. Do të mbetet sekret botëror se si ja del të çohesh në matematikë, të japin ushtrimin më të vështirë dhe ti ta zgjidhësh si të ishte lojë e gjitha kjo ,pasi ke qënë në gjumë gjatë gjithë orës. Na lidh njëfarë kimie e pashpjegueshme neve të dyve dhe mendoj se dhe ti e ke vënë re. S'kemi lënë këngë e valle pa kënduar e vallëzuar. Të uroj më të mirat në çdo rrugë që vendos të ndjekësh.

Albi çela-Je një djalë shumë pozitiv dhe me humor. Kaluam mirë në klasë edhe pse u takuam këtë vit. Të uroj suksese në jetë!

Alden Malaj: O gango... kështu nis biseda mes nesh, e çuditshme por e veçantë. Mirësia dhe intelijenca jote të kanë bërë të dallohesh në klasën tonë. Ti je një djalë me shumë virtyte dhe gjithmonë përpiqesh të mos mërzhitësh askënd. Të vlerësoj shumë për këto vite që kemi kaluar bashkë dhe shpresoj që të kalojmë edhe shumë të tjera.

Amarda Heta-Shpirti i festës kudo që shkel me aftësitë e tua për të ditur çdo këngë përmëndësh.Nuk e mendoja që do bëheshe një ndër shokët e mi më të mirë dhe kur e mendoj tani këtë fakt nuk e di se si do të kishin kaluar këto dy vite pa ty në shoqëri.Shumë mirënjohëse për çdo gjë që ke bërë për mua.Shpresoj që kjo shoqëri të vazhdoj gjithmonë.Të uroj suksese të mëtejshme dhe këndofsh gjithë jetën hahaha!

Arbi Braçi-Shokë shumë I mirë. Kemi kaluar momente

shumë të bukura bashkë dhe shpresoj të vazhdojmë kështu dhe në të ardhmen. Suksese!

Endi Hysi-Djalë i zgjuar dhe këngëtari i klasës. Të uroj më të mirat ,pasi je djalë pozitiv dhe në terezinë tënde!

Joel Merkaj- Djalë shumë inteligjent dhe gazmor. Përherë gjen batutat më të bukura dhe ngre humorin e klasës. Një nga shokët e mi më të mirë.

Joel Metaj- Rei je një djalë shumë gazmor dhe i sjellshëm. Gjithmonë gati të sjellësh harmoni në klasë sidomos nëpër pushime me këngët e tua. Shpresoj të ngelemi miq të mire! Të uroj gjithë të mirat!

Keisi Çuçaj- Je një nga djemtë më të zgjuar të klasës. Gjithmonë je I gatshëm të këndosh dhe të kërcesh në pushimin e madh. Je një karakter I kundërt nga unë,por kjo s'më ndalon të të kem një shokë shumë të mirë. Je një person që gjithmonë sheh punën e tij dhe asnjëherë nuk i fut hundët tek punët e të tjerëve. Suksese në jetë!

Kevin Kotarja- Ahengu I klasës sonë. Kudo mbizotëron dashuria e tij për muzikën e cila tashmë është bërë dhe pjesë e jona. Batutat që gjen nuk krahasohen me asnjë tjetër. Gjithmonë arrin ta gjejë një menyrë për të na bërë për të qeshur. Është ndër shokët e mi më të mirë dhe I uroj suksese të metejshme! Suksese!

Ledio Zaimi- Një nga miqtë e mi më të rinj dhe më të mirë. Unë u njoha me Rein në vitin e parë në shkollën e mesme. Që në fillim ndjeva se do të ishim miq shumë të mirë. Do ta kujtoj gjithmonë për inteligjencën, humorin dhe shijen e tij në muzikë. Të uroj suksese!

Tania Shoraj- O Rei G, o vibe-i pozitiv i klasës sonë. Në fillim kur të pash nuk e prisja që do ishim ndonjëherë kaq shokë sa jemi tani ,por energjia jonë kishte plane të tjera për ne. Shpresoj të ngelemi shokë edhe në vazhdim. Të uroj shumë suksese dhe sa më shumë fat!

Uendi Baço - Je një nga djemtë më të zgjuar të klasës. Gjithmonë më habit me faktin se në orë të mësimit je duke fjetur gjumë dhe nuk e dëgjon fare mësimin, por sa të ngre mësuesja në tabelë je çdo herë i aftë ta zgjidhësh ushtrimin ose të thuash mësimin. Je një person që gjithmonë sheh punën e tij dhe asnjëherë nuk i fut hundët tek punët e të tjerëve. Paç fat!



Megi Jata

Adelajda Shahini-Megi është një vajzë e mirë dhe bën çdo gjë për të arritur atë që ajo do. Ti më ke qëndruar gjithmonë afër ,kur unë kam pasur nevojë të flas me dikë dhe më ke mbështetur në shumë gjëra. Dhe pse njihemi pak dhe kemi qëndruar pak me njera-tjetrën kemi krijuar ato kujtime tona të lezetshme bashkë ,siç janë ditët kur mësonim për provime. Të falenderoj për sinqeritetin dhe mbështetjen që më ke dhuruar dhe të uroj më të mirat dhe shumë suksese!

Adora Kika- Megi është një vajzë e qetë ,por goxha e qeshur me njerëzit e afërt. Një shoqe e mirë të cilës po ti kërkosh ndihmë, do të të gjendet pranë. Nuk ja ka frika të jetë rebele dhe ti bëj zot të drejtave të veta. I uroj shumë suksese për të ardhmen që e pret!


Ajsel Mlika- Një vajzë tepër e veçantë ,të cilën nuk e kisha hasur ndonjëherë në jetën time. Duke njohur tipa të ndryshëm na mëson ne, si të sillemi në mënyra të caktuara me njerëz të caktuar. Ke qënë ndër të vetmit persona, që lidhjen tonë shoqërore nuk e ke bazuar mbi interesa ,por mbi shoqëri. Unë jam tepër i bindur se egoja jote nuk do të lërë në baltë dhe se ke për të arritur majat.

Ekaltra Sulçe- Shoqja ime më e mirë. Që kur të njoha ty e dija që do ishim një kombinim fantastik. Ti e di shumë mirë çfarë dashurie kam për ty, që nuk ta shpreh me fjalë. Dëshirë kam të flas për ty, por fjalitë duhen të jenë të reduktuara. 3 vite gjimnaz dhe disa vite gjatë 9-vjeçares nuk harrohen kurrë nga unë ,pasi je e gdhendur në zemrën time. E di që nuk do të pëlqej dedikimi im për ty, po unë jam vajzë e veprave jo e fjalëve të tepërta. Nuk mund të harroj ditët që kam kaluar me ty, ato të lumturat dhe ato më pak të lumturat. Lënia e orëve të mësimi ka qënë pjesë kyçe

që ka luajtur rol interesant në shoqërinë tonë ,por dhe ndihma gjatë orëve të mësimi ,apo gjatë testeve të shumta. Jeta është e bukur ,kur rrethohesh nga njerëz të bekuar dhe me vlera, kështu që ti je një ndër to. Nuk dua të zgjatem më se ti e kupton mesazhin që dua të përcjellë ,pasi je vajzë tepër inteligjente. Faleminderit për këto vite të mrekullueshme dhe shpresoj të vazhdojë po kështu siç jemi!

Jona Belba-Shoqe e dashur, me emocione dhe kujtime të bukura ,e dedikoj këtë moment të veçantë për ty! Një udhëtim i gjatë fillon me një hap të vogël dhe në ditën e parë të shkollës, një mikpritje e ngrohtë dhe e sinqertë na lidhi përjetësisht, kemi ndarë ditët e vështira dhe momentet e bukura. Më pas shëtitjet tona të shpeshta kontribuan në këtë lidhje të veçantë që kemi. Rrallë herë mund të them se mund të rastisin persona si ti, me zemër të çiltër dhe me dëshirën për të të parë sa më lartë. Ti je e veçantë dhe kështu do të mbetesh gjithmonë. Kujtimet tona do jenë si perla që ndriçojnë rrugën tonë të ardhshme. Faleminderit që je pjesë e jetës sime! Jeta na sjell sfida dhe aventura, por bashkimi ynë do të jetë gjithmonë burimi i fuqisë dhe lumturisë. Me ty, çdo ditë është një rrugë e re për të eksploruar, për të mësuar, dhe për të krijuar kujtime që do na shoqërojnë gjatë gjithë jetës. Një shoqëri e mrekullueshme si e jona meriton festime të paharrueshme dhe respekt të pakufishëm. Të dua dhe të vlerësoj shumë! Bashkimi ynë është si një kopsht i gjelbëruar që rritet me kujdes dhe dashuri. Fjala “shoqe” për mua do të thotë “partnerë në krim”, partnerja në krijimin e kujtimeve të paharrueshme dhe në mbajtjen e një lidhjeje të fortë dhe të mrekullueshme. Do të jemi gjithmonë një forcë e pandashme, e gatshme për të sfiduar botën bashkë!

Tania Shoraj- Je një vajzë ndoshta ndryshe nga gocat bazike që shohim ditët e sotme ,por kjo gjë më pëlqen tek ty. Ai stili unik i yti edhe fryma e re që sjell është diçka që rrallë herë e shohim. Nuk do t'i harroj bisedat vajzërore që kemi bërë bashkë edhe udhëtimin tonë në Prizren. Gjëja që ka qënë më për të qeshur, ishte momenti që tregove historinë se nga çfarë i preve baluket. Je një shoqe shumë fisnike edhe pozitive. Të uroj suksese edhe shumë fat!



Tania Shoraj

Ajsel Mlika-Nga t'ia nis me ty moj çupë? E mbaj mend fytyrën tënde rrumbullake (dhe timen gjithashtu) tek ato bankat e ftohta të klasës së parë. Nuk e di a jemi ulur bashkë në bankë ,por ajo që di është se ai ishte vetëm fillimi i një shoqërie të gjatë pa zënka për budalliqe. Nuk mund të të quaj një shoqe ,por do të të quaj motra që se pata asnjëherë. O nuk kemi lënë njeri pa marr nëpër gojë e nuk ka ngel njëri pa e zënë lemza nga fjalët tona. Më shumë se një shoqe ke qënë për mua dhe dua të mbash mend që do të dua fort përherë. Suksese Tania!

Alden Malaj- Ajo është një nga gocat më të qeta në klasë, por nuk mund të them të njëjtën gjë kur ajo nuk është në klasë. Një vajzë zemërbutë kur vjen puna për të ndarë gjërat. Edhe pse ndonjëherë mërzhitet për asgjë, është një vajzë që nuk i mban mëri askujt. Një vajzë që është shumë e sjellshme me miqtë e saj, por tregon një anë tjetër për të tjerët. Ajo është një mikeshë e vërtetë dhe gjithmonë aty për t'u gjendur pranë në momentet më të vështira. Suksese në jetë Tania!

Amarda Heta-Shoqëria jonë ka pasur uljet dhe ngritjet e veta,por gjithmonë jemi rikthyer sikur nuk ka ndodhur asgjë.Je një vajzë që mendon shumë për të tjerët dhe i ndihmon pa e menduar dy herë dhe do doja shumë që njerëzit të ishin sado pak si ti.Kuptohemi mjaft mirë me njëra-tjetrën dhe përshtatemi shumë(jo vetëm në horoskop haha).Në fillim mendoja se nuk do të afrohem kaq shumë sa ç'jemi afruar dhe për këtë jam shumë falenderuese.Të kam shumë xhan dhe do të jem gjithmonë aty kur të kesh nevojë.Shkurtimisht uroj të të shoh sa më lart sepse një person si ty e meriton .

Ekaltra Sulçe-O, klein. Kemi gjithë këto vite që njihemi

dhe prapë nuk ta bën zemra të largohesh nga unë. Më vdiqe duke më thërritur gjithmonë me nickname të ndryshëm, unë se kam as emrin e vështirë ,por të veçantë ashtu siç jam dhe vet. Kemi plane për verën shpresoj mos t'i harrosh siç bën zakonisht. Si vlonjate që je këngëtalet e tua të preferuara janë Maja dhe Poni ,por tekstet e këngëve nuk ja di fare. Je vajzë shumë e mirë dhe të uroj suksese sidomos tek paraqitja në mësim se vetëm pushime bën gjatë gjithë vitit shkollor!

Endi Hysi- Vajza inteligjente.Të uroj gjithë të mirat!

Joel Metaj- Shokë gjithë këto vite, që në klasë të gjashtë bashkë. Gjithmonë sa herë të kam kërkuar ndihmë më ke ndihmuar dhe pse ca herë ke bërë si e vështirë ,po të gjithë e dimë që kot e ke se në fund të fundit mi bën përherë projektet. Shpresoj të jemi shokë përherë. Të uroj gjithë të mirat!

Keisi çuçaj- Tania nuk kam nga t'ia nis me ty..... Shoqëria jonë ka qënë një rollercoaster I vërtet. Takimi ynë I parë ka qënë në vitin e parë në orën e gjuhës ,kur në heshtje po konkurronim se kush përgjigjej më shumë. Më pas ecim tek dreka jonë e parë jashtë shkollës ku unë,ti,ami hëngrëm sushi ,në këtë moment të gjitha mendimet që kisha krijuar për ty ndryshuan për mirë siç dhe ti e di nga video-ja që bëm në Brezovic hahahahahah. Patëm uljet-ngritjet tona , një vit sa për syrin e keq nuk folëm ,mblodhëm mirë e mirë gjithë ato muhabete ,që në vitin e tretë të kishim boll me fol. Viti I tretë ka qënë viti ku unë kam kuptuar se nëse s'do të kisha pasur rastin të të takoja do të kisha humbur shumë, duket cliché , por e them me plot gojën se je kthyer në një motër për mua. Ndihem si një fëmijë që s'kam nevojë të shqetesohem për asgjë ,pasi ti je aty për të më mbrojtur. Sa për djeni po qaj ,por që është e zakonshme kur flas për shoqërinë tonë. Të puth tantan!

Ledio Zaimi- Vajza më qesharake e klasës sonë. Edhe pse ndonjëherë mërzhitet, ajo përsëri përpiqet të qëndroj e buzëqeshur gjatë gjithë kohës. Suksese!

Rei Skura- Shoqe shumë e mirë. Je shumë inteligjente për vajzën që je. Energjitë tona përshtaten në mënyrë perfekte, gjë që e shoh te shakatë që ne bëjmë tërë ditën. Suksese të mëtejshme!



Arbi Braçi

Adora Kika: Arbi është një djalë i turpshëm në njohje të parë ,por s'mund të them të njëjtën gjë, pasi e njeh. Ai është i qeshur e pozitiv si dhe një djalë shumë I talentuar në vizatim. I uroj suksese në vazhdim!

Ajsel Mlika- Vitin e dytë na erdhën nja tre gango te klasa ,ku të njohëm edhe ty Braç. More ato nofkat "neck" apo "goja" ,që me konfidencialitet t'i thoja dhe unë ndonjëherë, por përherë i kaloje me të qeshura si tip gazmor që je. Kur kapesh me fjalë me atë Alb Çelën ,na bën me mbajt barkun me dorë se vetëm perla nxirrni kur debatoni me njëri-tjetrin. Gjithmonë të ka ndjekur ajo pyetja "Ça e ke Kozak Braçin?" ,po gjithmonë thua që se ke gjë dhe ëndrrat tona thyhen në gjysëm. Je shumë çun danoç e do të shifemi shumë shpejt.Suksese Arb!

Albi Çela - Ne u njohëm këtë vit dhe ti ishe shoku im në bankë. Ti je një djalë shumë pozitiv dhe me humor. Të uroj suksese në jetë!

Alden Malaj- Arbi, një nga djemtë më të mirë. Shakaxhi i klasës. Ai që çdo gjë e kthen në humor edhe pse je pak i inatosur, je djalë i talentuar, por nuk i përkushtohesh shumë talentit që ke. Nuk dua të shkruaj për mësimet, por le të kujtojmë batutat që ke bërë, shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë dhe të uroj sa më shumë suksese në jetë!

Amarda Heta-Më i urti i shoqërisë ,ama pa ty nuk do të ishte njësoj.Nuk je shumë i urtë kur vjen puna për të bërë shaka bashkë me Ledion ,por ka rëndësi që kënaqemi.Vizatimet e tua janë prezente në çdo libër që hap dhe janë shumë të veçanta prandaj duhet ta vazhdosh këtë pasion.Shpresoj të kesh sa më shumë sukses kudo!

Ekaltra SulÇe- Më pelqejnë shumë vizatimet e tua. Je djalë shumë i qeshur dhe rrezaton pozitivitet. Të uroj më të mirat dhe mos hiq dorë nga vizatimi. Konsideroje veten me fat kur gëzon një dhunti të tillë ,që jo çdokujt i jepet dhe shtrëngoje fort fatin tënd. Shkëlqe kudo!

Joel Merkaj- Një nga shokët më të mirë që kam ,megjithse u njohëm në vitin e dytë. Ja kuptojmë shakat njëri-tjetrit dhe bëjmë shumë gallat në klasë. Të uroj suksese!

Keisi ÇuÇaj- Arbi, një nga djemtë më të talentuar. Shakaxhi i klasës në orën e matematikës. Ai që çdo gjë e kthen në humor edhe pse je pak i inatosur kur të thërras 'neck'.Batutat që ke bërë me Albin janë nga më të bukurat, shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë dhe të uroj sa më shumë suksese në jetë!

Kevin Kotarja- Një ndër çunat më të mirë dhe pozitiv që kam njohur ndonjëherë dhe njëkohësisht një ndër shokët e mi më të ngushtë. Është gjithmonë pozitiv dhe I qeshur. Kontrollon situatat shumë mirë dhe është një djalë që I pranon dhe kupton shakatë. I uroj shumë suksese!

Ledio Zaimi - Një mik i imi i vjetër. Shoqëria jonë nuk fillon në shkollën e mesme, por më herët që në fëmijëri.Do të kujtoj gjithmonë për humorin dhe talentin tënd në pikturë. Uroj që shoqëria jonë të vazhdojë edhe më tej

Rei Skura-Jemi njohur që në vitin e parë. Je shumë i dashur dhe nevrrik në të njëjtën kohë. Nuk kemi lënë njeri pa ngacmuar bashkë, madje edhe në rrugë dhe do të vazhdojë kështu për një kohë të gjatë. Suksese koz'!

Tania Shoraj- Je djali i vetëm që njoh që është i fiksuar pas detajeve. Ke një talent aq të madh drejt vizatimit edhe akoma se kam kuptuar pse nuk e shfrytëzon, pasi do më pëlqente me të vërtet shumë të shikoja nesër ,pasnesër disa nga punimet e tua. Më pëlqen që i mbyll gjërat deri në fund kur angazhohesh. Akoma mendoj që mund të ishe nxënës shumë i mirë ,nese do i merrje mësimet seriozisht ,por je akoma në kohë edhe unë do jem gjithmonë aty për ty që të të nxis dhe motivoj. Të uroj shumë suksese edhe fat!



Albi Çela

Adora Kika- Albi edhe pse i ri këtë vit në klasën tonë u ambjentua mjaft shpejtë. Ai është një djalë i qeshur të cilit i uroj suksese në jetë!

Ajsel Mlika- Kam pas një mendim krejt tjetër për ty ,derisa erdhe te klasa ime. Je shumë çun i zgjuar ,po nuk do vetë ti se ta njoh tipin. Të kam njohur që në klasë të shtatë apo të tetë kur rrije me Gledin e Alfredin dhe bënit një lloj treshe të fuqishme bashkë. Të uroj më të mirat!

Arbi Braçi-Je një djalë shumë pozitiv dhe me humor. Kaluam mirë në klasë edhe pse u takuam këtë vit. Të uroj suksese në jetë!

Alden Malaj: Ku do ishte Fushkruja pa ty Albo? Miqësia jonë nuk filloi vitet e fundit, por që në klasën e gjashtë kur ai ishte vetëm fëmijë. Gjithmonë ke treguar një karakter të fortë edhe nëse ndonjëherë je shumë kokëfortë. E kuptoj që e ke marrë patentën para nesh, sepse është bërë si alarm. Shpresoj të mos ndryshosh dhe të uroj më të mirat në këtë botë!

Ekaltra Sulçe - Nuk e mbaj mend mirë në çfarë klase jemi njohur ,por e vetmja gjë që mbaj mend janë shakatë tona në çdo orë mësimi. Je djalë shumë i mirë ,por pak çapkën. Të uroj më të mirat!

Joel Merkaj- Megjithëse vitin e fundit erdhi në klasën tonë, Albin e njihja që nga 9-vjecarja kur luanim futboll. Djalë i mirë dhe humorist. Suksese!

Joel Metaj- Me Albin shokë këtu e në klasë të gjashtë, kur filloi gjimnazi na ndanë nga klasat ,por ja që erdhi viti i tretë prapë bashkë përfunduar. Kujtime pafund me ty dhe me budalliqet që kemi bërë. Shpresoj të

jemi shokë përherë. Të uroj gjithë të mirat!

Keisi ÇuÇaj- Alb je një djalë shumë I mirë. Na ke kënaq me humorin tënd në orë të ndryshme të mësimit dhe je një lojtar shumë I mirë në vollejboll. Pa ty nuk do ta kishim fituar kurrë kupën. Suksese!

Kevin Kotarja- Një djalë shumë I mirë dhe I qeshur. I uroj suksese të mëtejshme!

Luis Zenelaj-Na erdhe në vitin tonë të fundit të gjimnazit si një qershi mbi tortë.Je djalë shumë i mirë dhe të uroj shumë fat në jetë!

Rei Skura- Një shokë i mirë dhe I besueshëm. Me ty ora e mësimit shkon vaj e nuk e ndien fare. Je shumë i zgjuar dhe I dashur po ashtu. Të uroj sa më shumë suksese!

Tania Shoraj- Je një djalë shumë gazmor edhe humorist. Nuk ta them dot emrin pa thënë edhe mbiemrin hahaha. Tek mua do mbahesh mend si nxënësi që nuk erdhi kurrë herët në shkollë ,edhe që kishte mjaftueshëm zotësi që të ishte ekselent ,por ndoshta po i ruan këto zotësi për t'i përdorur në një kapitull tjetër të jetës së tij. Të uroj shumë suksese edhe fat!

Uendi Baço - Edhe pse nuk kam shumë që të njohë gjithmonë më je dukur një djalë shumë i mirë dhe i qetë, por nuk je ashtu, literalisht nuk pushon në asnjë moment së foluri, por ndonjëherë kjo është një gjë e mirë. Të uroj fat!



Brand Beshku

Adora Kika- Brandi edhe pse i ri në klasën tonë diti të ambjentohet shpejt. Ai është një djalë I qeshur të cilit i uroj suksese në jetë!

Ajsel Mlika-Vitin e fundit erdhe në klasën tonë ,por shpesh dukej sikur kishe një jetë te klasa jonë në mënyrën se sa shpejt u ambientove. Shpejt zure vend dhe te grupi im se të vlerësuam si çun gangster e me karakter. S'do ta marr vesh ndonjëherë si je me shkollën ,se herë del nga provimi pa gabime e herë-herë je tu ngel. Ke qënë ndër cunat më gango dhe je një shokë shumë i respektueshëm. Të uroj më të mirat!

Albi Çela-Ne u takuam këtë vit. Ti je një djalë plot humor dhe ne kemi kaluar shumë mirë. Të uroj suksese në jetë!

Alden Malaj-Edhe pse nxënës i ri u përshtat shumë mirë me klasën dhe solli shumë humor. Brandi ka sjell shumë karakter në klasën tonë. Shpresoj që miqësia jonë të mos mbarojë këtu. Ai komunikon lirshëm me të gjithë dhe nuk ka turp të flas me të huajt. Ai është një person i respektueshëm dhe u hap rrugë të tjerëve. Ai është një djalë që qëndron për atë që është e tij.

Amarda Heta- Shoku im nga Burreli, më ke kënaq me shakatë e tua nga veriu që vetëm unë I kuptoj hahahaha. Të uroj suksese në jetë!

Arbi Braçi-Djalë me synime të qarta dhe inteligjent. Të uroj më të mirat në jetë!

Joel Metaj- Dhe pse këtë vit u njohëm se erdhe në klasën tonë dhe në fillim si të gjithë nuk ishim shumë afër, se e di ti si është kur të vjen një I ri në klasë. Arritëm të bëhemi shokë të mirë dhe ta ndajmë Çdo

ditë të vitit të tretë së bashku. Shpresoj të jemi shokë përherë. Të uroj gjithë të mirat!

Luis Zenelaj-A mër “kokmadh” edhe pse një vit kemi që njihemi ne jemi afruar shumë me njëri-tjetrin dhe kemi kaluar shumë momente të bukura .Unë të uroj shumë suksese në jetë!

Rei Skura- Je djalë danoç. Dukesh serioz në pamje të parë, por s'ka të bëj fare me personalitetin tënd. Prej kësaj je një shok shumë i mirë. Suksese në jetë!

Tania Shoraj- Je një djalë shumë pozitiv edhe gazmor. Ishalla e pranon që vlonjatët në politikë kanë bërë më shumë sesa burrelsit hahahah. Të uroj shumë suksese edhe fat në jetë!

Uendi Baço - Je një djalë shumë i mirë dhe pozitiv ,edhe pse të kam njohur këtë vit kam vetëm mendime të mira për ty. Je një djalë plot humor dhe gëzim. Të uroj fat në jetë!



Melich Boz

Ajsel Mlika- Melich je një djalë shumë i sinqertë. Më kujtohet kur shkua në Shkodër një ditë në klasën e 10-të. Nuk kishe asnjë nga shokët e tu turq me vete atë ditë. Ne kaluam shumë mirë së bashku. Ke qenë një mik shumë i mirë edhe pse ne nuk flasim shumë. Të uroj më të mirat!

Albi Çela-Ne u takuam këtë vit dhe kuptova që je një djalë qesharak dhe me sens të mirë humori. Të uroj suksese në jetë!

Alden Malaj- Edhe pse ne nuk ishim shumë të afërt me njëri-tjetrin, por ti ke qenë gjithmonë njeriu më i sjellshëm në klasë. Kur të vjen Zaferi, atëherë je në formë. Të uroj suksese në jetë!

Ekaltra SulÇe-Pavarsisht se dy tipa të ndryshëm, por që ngjajmë për shkak të sjelljes dhe të kulturave që na përafrohen, vlerësimi im për ty është maksimal. Ndodh në jetë që sjellja e individit t'i shuaj kufijtë dhe ti bëj njësh. Të uroj suksese dhe të arrish atje ku deshiron!

Joel Merkaj- Djalë i mirë dhe i urtë. Megjithëse nuk flasim të njëjtat gjuhë jemi marrë vesh goxha mirë me njëri-tjetrin dhe kemi kaluar mjaft bukur. Suksese!

Kevin Kotarja Një Çun shumë i mirë dhe i qetë. Është një djalë me humor i cili i kupton batutat tona dhe kur ne mezi i përshtatim në anglisht. Suksese të mëtejshme!

Ledio Zaimi - Një nga nxënësit me origjinë turke në klasën tonë. Edhe pse komunikimi ynë ishte pak i vështirë, sepse ai nuk di të flasë shqip dhe unë nuk di të flas turqisht, ia doli të përcjellë pozitivitetin e tij. Të

uroj më të mirat!

Rei Skura- Nuk e kupton nëse ai është në klasë ose jo. Në fillim më është dukur shumë misterioz ,por e kuptova se Çfarë djali ishte ,kur fillova të flisja me të dhe është djalë flori. Suksese të mëtejshme!

Tania Shoraj-Je një djalë shumë pozitiv edhe shumë aventurier. Më ka ngelur në mendje një histori e jotja me biçikletë gjatë aventurave të verës edhe aty e kuptova që të pëlqen të rrezikosh. Të uroj shumë suksese edhe fat në jetë!

Uendi BaÇo- Je një djalë i urtë dhe dashamirës. Edhe pse ne të tjerëve nuk na flet shumë, dallohet që je një nga djemtë më të mirë që ka kjo klasë. Të uroj fat!



Zafer Eren Basıbüyük

Ajsel Mlika- Një nga miqtë e parë të huaj që kisha njohur ndonjëherë në jetën time. Ti ishe shumë i turpshëm në fillim ,kur ti dhe dy shokët e tu turq u ulët në një cep të klasës, por më pas ne shkuam shumë mirë gjatë dy viteve të ardhshme. Ne ndamë të njëjtin pasion për futbollin dhe ti ishe një lojtar i madh në fushën e futbollit pas shkollës. Do të shihemi së shpejti edhe pasi të përfundojë shkolla.

Alden Malaj- Ti je një futbollist mjaft i mirë, vetëm vrapon. Në klasë nuk je shumë i zellshëm, por kur vjen koha për gara, je i pari. Të uroj fat!

Kevin Kotarja- Një çun shumë i mirë dhe I qeshur. Edhe pse flasim gjuhë të ndryshme, i kupton shumë mirë mimikat dhe shakatë tona. I uroj suksese!

Uendi Baço- Po ashtu si Melihu as ti nuk përzihesh shumë me klasen, por kam vënë re që je një djalë shumë i sjellshëm dhe me një zemër të bardhë. Paç fat!

Joel Merkaj-Djalë dhe futbollist shumë i mirë sidomos në mbrojtje. Suksese!

Rei Skura- Ky djalë është i vecantë. Është i pari që bashkohet për të bërë shaka dhe nuk ta prish qejfin. Të uroj suksese sa më të mira!

Ledio Zaimi - Djali tjetër me origjinë turke në klasën tonë. Komunikimi ka qenë pak i vështirë, por ka treguar gjithmonë anën e tij pozitive. Suksese!

Ekaltra Sulçe- Djalë i urtë. Djalë shumë pozitiv. Përpiqesh të komunikosh në gjuhën shqipe ,por nuk është e thjeshtë, kjo të lartëson ty dhe vlerat që ke ti si njeri duke u përpjekur të bëhesh njësh me ne. Suksese

në jetë!

Albi Çela-Ne u takuam këtë vit, por kuptova që je një djalë i zgjuar dhe pozitiv. Të uroj suksese në jetë!

Tania Shoraj- Je një nga djemtë më të qetë të klasës sonë. Më pëlqen që nuk e vret mendjen për gjërat e vogla edhe nuk i shkakton vetes stres. Të uroj shumë suksese edhe fat në jetë!



Luis Zenelaj

Ajsel Mlika- O fratello gjallë je mor? Energjinë tënde në orën 7 të mëngjesit e kam pas zili mos me të rrejt ,se veç ti zgjohesh aq pozitiv që me mëngjes. Kemi kaluar tre vite të bukura bashkë ,po jo vetëm aq. Stres e lodhje i kemi kaluar bashkë si grup dhe nuk e kemi ndjerë fort sprovën e gjimnazit. I ke ca të forta ti që të kënaq mes orëve të mësimi. Je shumë gango e të respektoj pa masë. Suksese në karrierën tënde!

Alden Malaj: Eh, mo Luis edhe këtu më dole? Sa shumë gjëra kemi kaluar së bashku dhe sa shumë do të vazhdojmë të kalojmë së bashku. Historitë tona do të mbeten gjatë në mendjen dhe zemrën time. Mos u bëj doktor me puthje... Ti je flori, nuk rrin dot pa koment ,si ato plakate e lagjjes, por je një shok që kam dashur gjithmonë të kem pranë. Miqësia jonë nuk mbaron këtu dhe jam shumë i sigurt se nuk do të përfundojë kurrë, ndaj të jeni të bindur. Të dua shumë dhe suksese në jetë!

Amarda Heta-Luis je një shokë shumë i mirë dhe gjithmonë i gjendesh pranë njerëzve kur ata kanë nevojë për ty.Je shumë i zgjuar dhe batutat nuk të mungojnë asnjëherë.Suksese!

Ekaltra SulÇe- Vitet e gjimnazit janë drejt fundit dhe historitë e tua nuk mbarojnë kurrë. Je djalë fantastik, i dashur dhe tepër aventurier. Të uroj sa më shumë eksperiencë të reja në hapat ku do të hedhësh!

Joel Merkaç-Një nga shokët e mi më të mirë. Kemi kaluar shumë mirë bashkë si brenda dhe jashtë shkollës. Të uroj suksese!

Joel Metaj- Luisi humoristi jonë ,që do të na bëhet doktor të na marri në qafë të gjithëve. Bën pak si i keq,

po të gjithë e dimë që je i mirë. Që nga viti i parë deri më tani bashkë në klasë me pafund momente që kemi kaluar njëra më e bukur se tjetra. Shpresoj të jemi shokë përherë. Të uroj gjithë të mirat!

Jona Belba- Për ty mund të them se je ndër djemtë më pozitiv, energjik dhe mirëkuptues në klasë. Gjithmonë ofrohesh të japësh ndihmën tënde në quize ,apo ushtrime të ndryshme. Shpresoj të të realizohet çdo dëshirë që ke!

Rei Skura- Gazmor dhe serioz në momentet e duhura. Më ngre humorin që në pikë të mëngjesit. Nga djemtë më të mirë që kam njohur ndonjëherë. Suksese!

Ledio Zaimi- Shoku më energjik i klasës sonë. Do ta kujtoj gjithmonë për batutat e tij, që na mbushte gjithmonë me energji dhe pozitivitet. Suksese!

Tania Shoraj- Je një djalë shumë i zgjuar, por edhe humorist, gjë që jo të gjithë e kanë. Do më mungojnë shakatë në furgon edhe gallatat që bëje me Durimin. Të uroj shumë suksese edhe inshallah bëhesh një mjek i zoti në të ardhmen!

Uendi BaÇo - Je një djalë plot humor dhe asnjëherë nuk të shohë pa një buzëqeshje. Mendoresh të shkosh mirë me të gjithë dhe t'i bësh të gjithë për të qeshur me shakatë e tua. Paç fat!



Adora Kika

Ajsel Mlika- Për Adorën nuk mjaftojnë fjalët për ta përshkruar atë vajzë me zemër floriri. Karakteri i saj i fortë më bën të ndihem njëkohësisht dhe unë i fortë ,kur jam pranë saj. Aftësia numër një e jotja është muhabeti në çdo moment të mundshëm, qoftë ai i përshtatshëm apo jo. Ndër të paktët njerëz që kam njohur që kurrë nuk heziton të thuash mendimin tënd qoftë ai, komplimentues apo këshillues. Jam tepër i bindur që dhe pasi rrugët tona të vijnë në drejtime të ndryshme, në momentin që ne do të bashkohemi një ditë, nuk do ta ndiejmë mungesën dhe në moment do të rifilloj çdo gjë aty ku e kemi lënë.

Albi Çela-Je një vajzë shumë e zgjuar dhe e sjellshme. Shpresoj t'i realizosh dëshirat e tua në jetë! Sukses!

Alden Malaj-Adora ose volejbollistja e klasës, edhe pse nuk luajti në finale se vrau këmbën, o zot. Adora gjithmonë ka treguar karakter të fortë dhe pavarsi nga të tjeret. Në qoftë se ajo i futet një pune me kokë , e zgjidh dhe nuk dorëzohet kurrë. Ajo nuk kërkon ndihmë askujt kur është e vendosur në atë që do të bëjë dhe ky virtyt më pëlqen shumë.Adora nuk ka asnjëherë ftohtë më çudit!

Amarda Heta-Energjia jote është një ndër gjërat që më pëlqen më shumë tek ti ,kjo sepse ndikon dhe tek unë haha.Ke përcjell gjithmonë pozitivitet dhe këtë nuk duhet ta ndryshosh për asnjëlloj arsye.Më je gjendur pranë kur jam mërziur dhe sidomos kur jam vlarë, pasi është specialiteti yt.Faleminderit që ke qënë aty kur kam pasur nevojë për mbështetje.Te uroj suksese në rrugëtimin dhe pasionin tënd gjithashtu për arkitekturën.Të puth!

Ekaltra SulÇe- Volejbolliste profesionale. Je ndër

vajzat më shpirtbardhë që kam takuar ndonjëherë në jetë. Je vajzë me shumë vlera e virtyte. Sukses në jetë!

Geld Pepa-E dashur Adora Kika, shoqëria me ty ka qënë eksperiencia më e bukur e këtij viti. Nuk do ti harroj kurrë momentet e të qeshurave dhe të qarave. Pavaresisht se më bezdis ndonjëherë, të kam shumë xhan. Të uroj shumë suksese në jetë dhe t'u realizofshin të gjitha dëshirat se i meriton!

Jona Belba- Je një vajzë vërtet shumë pozitive dhe ke një energji karakterizuese, të cilat mund të them se janë pika kyçe të karakterit tënd. Je vërtet shumë e zgjuar, prandaj jam e bindur se do ia arrish të gjitha ato që do në jetë.

Keisi ÇuÇaj- Bashkë jemi njohur në vitin e parë ,por viti i tretë ishte ai vit ku shoqëria jonë u bë akoma më e madhe. Unë dhe Adora kemi një shoqëri të vecantë që më shumë zihemi ,sesa duhemi hahahaha po kjo gjë më pëlqen më shumë pasi e bën jetën time më interesante. Gjithmonë më ke qëndruar pranë dhe për këtë të jam mirënjohëse. Arkitektja ime e ardhshme shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat!

Kevin Kotarja- Vajzë shumë e mirë dhe e sjellshme. E aftë për të kuptuar shakatë dhe gjithmonë e qeshur. Gjithashtu një dëgjuese e mirë. Sukses!

Ledio Zaimi- Volejbollistja e klasës sonë. Gjithmonë energjike dhe e qeshur. Sukses!

Rei Skura- Energjinë që ke ti do donte ta kishte çdo njeri. Nuk pushove njëherë së qeshuri. Je një vajzë shumë e mbarë dhe e shoqërueshme. Sukses!

Shefrin Shtylla-Një nga dedikimet më të vështira për t'u bërë ka qënë pikerisht i joti. Jo se nuk kam çfarë shkruaj, përkundrazi ngaqë kam shumë, por ama dua të të them që pavarësisht çdo gjëje, ke për të ngelur një nga njerëzit më të afërt për mua dhe përherë do e kesh një vend në zemrën time. Gjithmonë kur kam pasur nevojë për një përqafim, mjaftonte të vija tek ti. Je kaq pozitive dhe e sjellshme, dhe një nga njerëzit më zemërgjerë dhe me shpirtin më të pastër që njoh dhe do më mungosh masivisht shumë(më shumë Bloza), do më mungojnë muhabetet e gjata te shkallët e pallatit dhe krepat që kemi fiksuar ti marim sa herë dalim.Të uroj gjithë të mirat dhe të kesh sukses në çdo hap të jetës tënde! T'du shumë o kusho!



Kevin Kotarja

Ajsel Mlika -Ne kur s'na ndau kopshti Cicërimat që kur ishim 6 vjeç do na ndajë gjimnazi? Po duke ditur se do ikësh aq larg për studime, nuk i dihet kur do të jetë hera e ardhshme që do të të shoh, por prapë ti do jesh tek të parët në listën e miqve të mi të parë në jetë. Vallaj për të vazhduar studimet për inxhinieri në Gjermani duhen nerva prej çeliku ,po unë e di që ai s'është fare problemi yt se korrektësia jote për mësimet është e pakrahasueshme me ndonjë tjetër. Kur iknim te Asefi gjasme për të fituar ndonjë medalje kalonim kohët më të bukura të gjimnazit. Unë do të uroj më të mirat në karrierën tënde se e di që do të duhen. Take care amigo!

Alden Malaj-Ai është senatori i klasës këtë vit dhe e meriton vërtet. Kemi kaluar shumë kohë të bukur bashkë dhe shpresoj të kalojmë sa më shumë në të ardhmen. Matematika është lënda e tij, megjithatë ai dëshiron të bëjë diçka në lidhje me kompjutrat. Ai mëson gjithçka nëse do dhe ndonjëherë flet më shumë se zysha për mësimin. Mbi të gjitha është një djalë shumë i sjellshëm dhe fjalët "Ju lutem" dhe "Faleminderit" nuk mungojnë asnjëherë.

Amarda Heta- Ke qenë gjithmonë prapa meje në bankë dhe është e çuditshme si nuk më je ndarë asnjëherë gjatë këtyre tre viteve, por përtej shakave jam shumë e lumtur që ke qenë pjesë e kësaj eksperience të gjimnazit.Faleminderit që më ke ndihmuar kur kam pasur nevojë.Shpresoj mos t'i humbasësh më kuletat aq shumë më saktë mos të t'i vjedhin siç t'i kam vjedhur unë dhe të uroj sa më shumë suksese!

Arbi Braçi-Ti je djalë i mirë dhe shumë inteligjent, bashkë këmbëjmë shumë shaka. Të uroj suksese!

Brandi Beshku-Ti je djalë i mirë, bashkë këmbëjmë shumë shaka. Të uroj suksese!

Ekaltra Sulçe-Nuk e mbaj mend në cilën klasë kemi qënë kur patëm "konflikt" gjatë javës së panairit të ushqimit. Shoqeritë që nisin me zënka gjithmonë përfundojnë më të afërta. Je djalë i urtë, qesharak dhe dëgjues shumë i mirë I mësimet. Suksese në të ardhmen!

Endi Hysi-Ti je djalë i mirë dhe më i zgjuar seç duhet të jesh.Me vjen inat se je shumë më i mirë se unë në fifa.Me praninë tënde ndryshove tërësisht atmosferën e furgonit të komunës. Të uroj suksese!

Joel Merkaj-Një nga shokët e mi më të mirë që nga klasa e pestë. Kujtimet e bukura që kemi kaluar bashkë janë të panumërta dhe të paharrueshme.Suksese!

Keisi ÇuÇaj- Senatori i klasës këtë vit dhe nuk e meriton ,pasi të gjithë e dimë se duhet të isha unë ,por I more votat me mik. Nejse kemi kaluar shumë kohë të bukur bashkë dhe shpresoj të kalojmë sa më shumë në të ardhmen ,gjë që s'do jetë e mundur ,pasi do ikësh në Gjermani. Matematika është lënda e tij thonë disa njerëz (gënjejnë) ,pasi është lënda ime. Disa njerëz mendojnë se unë jam në garë me Kevin ,po siÇ mund ta shihni I'M NOT. Se po e mbyll tani se më duhet të mësoj t'ja kaloj keq-keq-it. Se harrova SUKSESE KEV!

Ledio Zaimi-Një mik i ri ,por ndihet si një nga më të vjetrit. Shumë i sjellshëm,shakaxhi dhe shquhet për inteligjencën e tij. Të uroj shumë suksese në jetë!

Luis Zenelaj-Një djalë si ty i nevojitet shumë shoqerisë sonë .Të vlerësoj shumë për zgjuarsinë që ke dhe për sinqeritetin tënd!

Rei Skura-Je nga njerëzit më të afërt brenda klasës. Shumë i zgjuar, gazmor, ambicioz, tërë këto të mira, po dil ndonjëherë nga shtëpia se zure myshk. Suksese në jetë Kev!

Shefrin Shtylla-I erdhi fundi edhe gjimnazit e, një rrugëtim kaq i bukur të cilin e nisëm bashkë dhe jam shumë e lumtur që po e mbyllim njësoj. Ti je sheqeri më i kripur që njoh. Aq i mirë dhe i dashur, aq dhe kuksian. Mendoj që kam shumë gjëra për të mësuar nga ty. Ke zënë në jetën time një vend të veçantë dhe të rëndësishëm. Je ai shok që është krenari të kem. Të kam xhan!



Ekjaltra Sulçe

Adora Kika - Një vajzë e urtë së cilës nuk i mungon pozitiviteti. Me të cilën, po të jesh e afërt, e kupton që është një person i ndjeshëm me një zemër të madhe, dhe nuk do të kishte dëshirë të bënte keq kurrkujt. I uroj suksese në shkollë dhe në jetë.

Ajsel Mlika – M'u ngjite në klasë që klasën e shtatë ose të tetë, sepse edhe memorja na ka lënë tani. I ke ca informacione të rrezikshme ti, si CIA. Ma ke marrë pak shpirtin tërë gjimnazin për detyrat e shtëpisë, që mos qofshin, po do t'i fal ato dhimbjet e kokës që më ke dhënë, se je gocë flori. Nuk më dalin fjalët kur të përshkruaj ty, dhe ti e di mirë këtë gjë. Je tepër shumë gango. (Grida të do).

Albi Çela - Je një vajzë shumë e zgjuar dhe e sjellshme. Shpresoj t'i realizosh dëshirat e tua në jetë! Suksese!

Alden Malaj - Ke qenë një mikeshë shumë e mirë këto vite. Qëndrova duke të ndihmuar me Ajselin në provime. Shpresoj që në të ardhmen të ulesh dhe të mësosh më shumë, sepse nuk do të jem gjithmonë pranë duke të treguar gjithçka. Faleminderit që qeshje me humorin tim dhe nuk i merrje gjërat për keq!

Amarda Heta - Je një shoqe e rrallë dhe jam me fat që të njoha. Në Brezovic ja kaluam shumë mirë të dyja. I kishim frikë historitë me fantazma. Të uroj suksese!

Jona Belba - Je një person shumë pozitiv dhe i qetë, si dhe ofrohesh gjithmonë për të dhënë ndihmën tënde. Të uroj më të mirat në këtë jetë!

Keisi Çuçaj - Një vajzë shumë e zgjuar. Di kur duhet të flasësh dhe je tepër e maturuar. Bashkë kemi qenë në disa eskursione dhe kam arritur të kuptoj shpirtin tend

të mirë që të dallon nga të tjerët. Di si të komunikojë në të gjitha rastet dhe të jep këshillat më të vlefshme. Suksese!

Kevin Kotarja - Një vajzë shumë e mirë dhe e qetë. Është e zgjuar dhe di të shprehë mirë mendimet e saj. Suksese të mëtëjshme!

Ledio Zaimi - Vajza më e qetë në klasën tonë. Gjithmonë pozitive dhe shumë e sjellshme. Suksese!

Megi Jataj- Ekaltra, shoqja që më ka shoqëruar këto 3 vite të gjimnazit. Personi të cilit i besoj më së shumti (në shkollë) Është e vështirë të ndaj eksperiencën time me të me disa paragrafë dhe ndonjëherë të mos flasësh është më e vlefshme se të mbushësh faqe kot. Ne kemi kaluar shumë eksperiencë së bashku, të mira, të këqija dhe më së shumti do veçoja ato frytdhënëset. Normalisht rrugët tona do ndahen këtu, pasi unë do vazhdoj studimet jashtë, por siç dhe e kemi lënë ti do vish të më vizitosh së paku një herë në muaj (everything's on me hahaha). Me mençuri dhe ndjeshmëri, ti ke qenë gjithmonë një prezencë e ndritur ne jeten time. Me kete dedikim dua te shpreh falenderimin tim dhe dashurine time per ty, shoqe e ngushtë. Po e mbyll me kaq, pasi nuk kam dëshirë të zgjatem ,pasi ti e di mendimin dhe dashurinë që kam për ty kështu që ë uroj më të mirat dhe qofshim kështu gjithnjë!

Rei Skura - Je gjithmonë e qeshur dhe pozitive. Klasa jonë është më e pasur me një njeri kaq të vecantë si ti. Suksese në jetë!

Tania Shoraj - Tani që ta shkruajta emrin m'u dukë pak e çuditshme ,se u mësova duke të thënë Çelik hahahah. Kur të shoh duke hyrë në klasë në mëngjes dukesh aq shumë ëngjëllore sikur kam para meje një fëmijë të vogël ,por pastaj fillon e flet edhe unë përmendem. Nuk do e harroj ditën që do shkonim në eksursion edhe të telendisa njëherë unë me një xhiro në makinë, në mos të mjaftoja unë na telendisi dhe njëherë mami im mirë e mirë hahahah(e kam gjenetike e di ti s'kam faj). Të pafsha sa më shpejt në Angli dhe mos harro foton te syri i Londrës edhe bion me flamurin anglez e di ti ;). Të uroj shumë suksese Çelik dhe të pafsha duke arritur majat!

Uendi Baço - Një nga vajzat më të mira që kam njohur ndonjëherë. Sheh vetëm punët e tua dhe je gati të ndihmosh çdo person që i duhet ndihmë. Paç fat!



Endi Hysi

Adora Kika - Endi është një djalë i qeshur i cili i merr gjërat me sportivitet dhe të uroj shumë suksese në shkollë dhe në jetë!

Albi Çela - Ti je një djalë i zgjuar dhe pozitiv. Të uroj suksese në jetë!

Ekaltra SulÇe - End Hysi edhe ti, si pjesa dërrmuese e klasës, erdhe në vitin e dytë. Që ditën e parë filluam të kishim komunikim. Je djalë serioz, social dhe qejfli. Suksese të mëtëjshme!

Joel Merkaj - Një nga shokët më të mirë që kam. Jemi njohur jashtë shkollës. Më vjen mirë që ndoqe këshillën time dhe erdhe në klasën tonë. Të uroj suksese!

Joel Metaj - O, perandori i klasës dhe pse vetëm 2 vite në klasë bashkë ,jemi miqësuar shumë. Je një djalë inteligjent dhe i sjellshëm. Shpresoj të mbetemi shok! Të uroj gjithë të mirat!

Jona Belba - Miqësia me ty ishte ndër gjërat që nuk e prisja të më ndodhte këtë vit. Je një person në dukje i ftohtë ,por me zemrën më të dashur që kam njohur, ku me shakatë e tua gjithmonë ke arritur të vësh buzëqeshje në fytyrat tona. Të uroj gjithë të mirat në jetë!

Keisi ÇuÇaj- Endi është një mik i vërtetë dhe i zgjuar. Faleminderit që më ke ndihmuar sa herë kam pasur nevojë për një mik të mirë. Kur të njoha për herë të parë ishe shumë serioz fiks si Joeli, por më pas kuptova që serioziteti është pjesë e karakterit tënd ,por ti di të bësh edhe shaka dhe të jesh një mik i mirë për të gjithë.Suksese!

Ledio Zaimi - Një shok i mirë që mund të gjendet pranë kur të kesh nevojë për të. Suksese në jetë!

Rei Skura - Ke një shpirt shumë të pastër dhe je aty në çdo moment kur dikush kërkon ndihmë. Je një djalë fantastik dhe të uroj suksese të mëtëjshme kudo që të shkosh!

Tania Shoraj- Je një djalë shumë i dashur edhe i komunikueshëm. Një nga personat e vetëm që e dallon kur unë mund të jem e mërzitur. Të uroj shumë suksese edhe fat në jetë!

Uendi BaÇo - Në fillim të shkollës më je dukur paksa i çuditshëm dhe sikur nuk shoqëroheshe me askënd, por kur u afruam këtë vit, kuptova se nuk je fare ashtu siç të mendoja unë. Je një person shumë shakaxhi dhe i dashur, më ke qëndruar gjithmonë afër kur kam pasur nevojë, edhe pse nuk e kishe për detyrë ta bëje. Kemi kaluar shumë kohë të bukura, duke dalë çdo ditë pas shkolle dhe duke qeshur me Adrin dhe Eldin. Të uroj gjithë mirat dhe të kesh fat në jetë! Shpresoj këtë shoqëri ta mbajmë edhe më vonë në jetë!



Briselda Kaçi

Adora Kika - Briselda është një nga vajzat më të urta të klasës sonë, e cila nuk ngurron të qeshi. I uroj suksese në shkollë dhe në jetë!

Ajsel Mlika - Rastësisht qëlluar të dy tek e njëjta klasë në vitin e dytë të gjimnazit dhe jam me fat që pata mundësinë të njihja një person kaq modest dhe fjalëpak. Për sa kohë që kemi rastisur të jemi në të njëjtën bankë nëpër provime, unë kam pasur kënaqësinë të të ndihmoja me çfarëdo kisha mundësi. Je mjaft e veçantë si person dhe për këtë duhet të jesh mjaft krenare.

Alden Malaj - Gjithmonë më je dukur si një vajzë e urtë dhe e sjellshme, edhe pse nuk jemi njohur mirë. Kur mundohesh, ti arrin gjithçka dhe ky virtyt më pëlqen te ty. Të uroj mbarësi!

Amarda Heta - Vajzë inteligjente. Gjithmonë dallohesh për shpirtin tënd konkurrues. Sa herë kam pasur nevojë për ndihmë, më ke ndihmuar. Të uroj më të mirat në jetë!

Ekaltra Sulçe - O Bris, vajza. Nuk kemi pak kohë që njihemi për të mos vlerësuar shoqërinë tonë. Je një vajzë tepër e dashur, nuk i do të keqen askujt dhe nuk nguron të ndihmohet aty ku duhet. Të uroj suksese në të ardhmen!

Jona Belba - Miqësia me ty nisi që vitin e parë. Nuk je vajzë problematike dhe me qetësinë që të karakterizon të bën të duash të të njohësh akoma më shumë, për të zbuluar edhe çfarë zemre të mirë ke. Të uroj gjithë të mirat kudo në jetë.

Keisi ÇuÇaj - Je ndër vajzat më të mira që kam njohur,

udhëtimi në Brezovic na lidhi akoma më shumë. Kur të gjithë tregonim histori të frikshme, ti nuk flisje fare, sikur nuk të bënte fare përshtypje madje flete vetëm në dhomë në errësirë. Hahahaha sa e frikshme. Të uroj suksese të mëtejshme!

Rei Skura - Je e qeshur gjatë gjithë kohës dhe duket sikur nuk e vret mendjen për asgjë. Gallatat që bëjmë në orën e mësimit janë fantastike. Të uroj shumë suksese!

Tania Shoraj-Je një vajzë e matur dhe e drejtë. Edhe pse ke patur sfidat e tua gjatë gjimnazit ti i ke kaluar ato gjithë maturi edhe qetësisht edhe mendoj se këto janë pikat e tua të forta. Shpresoj që të pelqeu drejtimi i flokëve nga unë Kaci hahaha. Të uroj shumë suksese dhe fat në jetë!

Uendi Baço - Gjithmonë shumë e qetë dhe e urtë, thuajse nuk të dëgjonim fare zërin. Nuk është se kam pasur rastin të të njoh shumë, por me aq sa të kam njohur je një vajzë shumë e mirë dhe e ëmbël. Të uroj fat në jetë!



Uendi Baço

Ajsel Mlika - O Uendo, po me ty nga do t'ia nis unë. Përveç faktit që të kam ngacmuar çdo ditë me faktin që je pak kineze, je një shoqe tepër e mirë dhe kam shumë respekt për ty. Kur ngelnim pa shokë banke, gjithmonë uleshim bashkë dhe sështë se e kishte ndonjëri mendjen te mësimi, po hajt mo. Je shumë vajzë e mirë dhe do të kem fatin të të ndjek diku aty afër vendeve të para në ndonjë pasarelë kur të ecësh (po më ftove gjithmonë).

Albi Çela - Ti je një vajzë shumë e zgjuar dhe e sjellshme. Shpresoj t'i realizosh dëshirat e tua në jetë! Suksese!

Alden Malaj - Që na u bë modele e mos ngelt njeri pa u bërë. Ajo përpiqet të jetë shoqe me të gjithë dhe të mos shqetësojë askënd. Ajo është e mençur dhe nuk i intereson shumë për njerëzit që i mbajnë inat dhe çfarë thonë ata. Ajo është një vajzë me sjellje të rrallë dhe një shoqe e vërtetë. Nëse keni nevojë për ndihmë nga Uendi, ajo patjetër do t'ju ndihmojë. Edhe pse kopjon gjithçka nga Ajseli... lëre se nuk është vendi i duhur për të folur. Shpresoj shumë që miqësia jonë të vazhdojë edhe për shumë vite!

Ekaltra SulÇe - Ky vit shkollor më ka afruar më shumë me ty. Kujtimet tona lidhen më shumë me projektet që kemi dhe orët e informatikës që herë shkojmë e herë nuk shkojmë. Je një vajzë inteligjente, e dashur dhe shumë e përkëdhelur... Të uroj suksese në të ardhmen dhe boll gjete pretekste për të mos ardhur në informatik!

Endi Hysi - Vajzë e dashur dhe pozitive. Të uroj më të mirat në jetë!

Jona Belba - Kemi shumë pak kohë që jemi njohur, megjithatë kami kaluar dhe kemi ndarë shumë gjëra së bashku. Jam shumë me fat që kam një shoqe si ti dhe jam shumë me fat për kujtimet e paharrueshme që kemi krijuar së bashku. Te kam shumë xhan!

Keisi ÇuÇaj - Fjala e parë që kam dëgjuar për ty ka qenë 'E shikon atë aty ajo është Uendi Baço, modele', si fragment i shkëputur nga një film hahahaaha. Më ke qëndrar pranë sa herë kam pasur nevojë dhe për këtë të jam mirënjohëse. Suksese në jetë Uend!

Rei Skura - Je një vajzë e mirë dhe shoqe e shkëlqyer. Ke një zemër të madhe dhe më ke ndihmuar për shumë gjëra. Faleminderit për gjithçka! Suksese të mëtejshme!



Joel Metaj

Ajsel Mlika - Fjalëpak, i qetë, i urtë... më të tjerët ndoshta ,po jo me mua. Në plan të parë dukesh pak si i ftohtë, por je çunë tamom kur i themi ne. Mjafton të kujtojme çka kemi kaluar bashkë nëpër ekskursione dhe i përmbledh të gjitha mendimet e mia për ty. Edhe pse më shumë ke munguar sesa ke ardhur në shkollë gjatë gjimnazit, ke qënë gjithmonë aty për mua dhe kemi kaluar momente goxha interesante. Je shumë tip dhe do të mbaj mend gjatë bro.

Albi Çela - Ne njihemi që në klasën e gjashtë dhe ti je një shok shumë i mirë. Ti je një djalë pozitiv dhe i zgjuar. Të uroj suksese në jetë!

Alden Malaj - Ku të filloj... Së bashku që nga dita e parë. Nuk më shkon mendja për asnjë moment që të mos kemi kaluar bashkë. Unë nuk e quaj shok, por vëlla.. Që të vegjël garuam se kush ishte më i miri në futboll, pasi është sporti ynë i preferuar dhe ende nuk dihet përgjigja. Edhe pse jemi me ekipe të ndryshme, kemi shumë të përbashkëta. Ne i kemi mësuar njëri-tjetrit shumë gjëra, por gjëja më e rëndësishme është të mbetemi miq përgjithmonë. Ai do t'i shohë të gjithë të lumtur pa përjashtim. Komunikon lirshëm me të gjithë. Ai është një djalë i respektueshëm dhe u hap rrugën të tjerëve kur është e nevojshme. Këtu po them vetëm gjëra të mira, mos ta turpëroj. Do të kemi shumë sfida të tjera në të ardhmen, por do t'i përballojmë së bashku.

Amarda Heta - Mik i mirë dhe serioz. Gjithmonë do të kujtoj kohën kur hanim stika në orën e turqishtes hahahah. Suksese!

Ekaltra SulÇe - Kam gjithë këto vite që të kam në klasë. Je një djalë i sjellshëm, i dashur dhe mbrojtës i të

drejtave të femrave gjithmonë. Në çdo orë shoqërore je i pari për të folur për temat aktuale. Të uroj suksese në të ardhmen!

Endi Hysi - Djalë shumë inteligjent dhe i shkathët. Të uroj gjithë të mirat!

Joel Merkaj - Futbollisti më i mirë i shkolles dhe një djalë shumë inteligjent. Suksese!

Jona Belba - Për ty mund të them se me shakatë dhe zgjuarsinë tënde gjithmonë i jep më shumë energji klasës. Gjithmonë e ndihmojmë njeri-tjetrin në mësim dhe kjo tregon shumë për shpirtin e mirë që ti ke.

Kevin Kotarja - Djalë shumë i mirë dhe i qetë. Shyqyr vjen ndonjëherë në shkollë që ta takojmë. I uroj suksese!

Ledio Zaimi - Mik i mirë dhe me pak fjalë. Gjithmonë në dispozicion kur kemi nevojë për ndihmë. Suksese!

Luis Zenelaj - Jam me fat që kam patur një shok si ty për tre vite në klasë. Shpresoj ta mbajmë shoqërinë tonë edhe pas gjimnazit! Të uroj suksese në rrugëtimin tënd!

Rei Skura - Inteligjent, i urtë, optimist. Karakteristikat e një djali të mbarë e të veçantë sic je ti. Jam i lumtur që të kam njohur. Suksese të mëtëjshme!

Tania Shoraj- Eh,ore Joel sa i komplikuar që je... Edhe pse do aq shumë të bësh sikur nuk të intereson , e di që nëse do të thoja për diçka do ishe i gatshëm pasi ky je ti, një djal që do prishte edhe gjumin nëse do kisha nevojë për diçka edhe këtë gjë e vlerësoj shumë tek ty. Je i zgjuar nga natyra, je shumë i thjeshtë edhe nuk i vendos njerëzit ne pozita të vështira, ama ato ironitë e tua nuk i kursen. Mbetet për të theksuar që sa herë hyn ti në klasë , na sjell një aromë të rëndë parfumi që na kënaq. Kur të mendoj ty në klasë të imagjinoj me ato stikat e tua si ketër. Kemi kaluar shumë momente të bukura bashkë. Edhe pse kapitulli i gjimnazit po mbyllet unë shpresoj që të jesh prezent edhe tek kapitujt e tjerë të jetës sime. Të uroj shumë suksese edhe fatin që meriton në jete!

Uendi BaÇo - Je një djalë i mirë dhe plot humor. Gjithmonë ke qëllime të mira dhe je gati t'i ndihmosh të gjithë. Të uroj fat!



Alden Malaj

Adora Kika- Një djalë i qetë ,i cili mendon për veprimet e tij përpara se ti kryej ato, gjë e pritshme nga një gjygtar i ardhshëm. Një shok i mirë të cilit po ti kërkosh ndihmë do të të gjendet pranë pa hezituat. I uroj suksese!

Ajsel Mlika- Partneri im i krimt në shkollë. Për ty nuk kam shumë fjalë të them se ti e di që ne merremi vesh dhe me të voglin shikim. S'kemi lënë njeri pa ngacmuar dhe dije se këto janë ato momentet që unë do të mbaj mend përgjithësisht. Kemi qarë e kemi qeshur, kemi vuajtur e jemi gëzuar bashkë si dy vëllezër e jo si dy shokë që i bashkon gjimnazi. Sësthtë nevoja për hartim se ti e di që të du e do të du fort.

Ekaltra SulÇe- Je një ndër shokët që nuk nguroj të ulem në tavolinë dhe të bisedoj. Pavarsisht “ngacmimeve” që kemi gjatë ditës ne prapë gjejmë kohë për njëritjetrin “për t’u futur në ndonjë luftë të re debatesh” edhe më shumë, asnjëherë për të reflektuar për sjelljet që bëjmë. Kjo do të thotë që miqësia jonë është e pastër. Lartëso mbiemrin dhe genin nga vjen!

Endi Hysi- Një djalë me karakter dhe zemër të mirë. Gjithmonë gati për t’ju ndihmuar dhe për të qenë pranë jush. Njeri bisedues dhe asnjëherë s’të zhgënjën. Të uroj suksese!!

Joel Metaj- Me Denin shokë që fëmijë, jemi njohur që në klasë të pare dhe që atëherë nuk u ndamë kurrë. Gjithmonë te klasa B deri në vitin e tretë të gjimnazit. Tani nuk quhemi më shokë ,por vëllezër. I vlersoj të gjitha gjërat që ke bërë për mua gjatë gjithë këtyre viteve dhe që nuk më le kurrë në baltë. Kujtimet tona janë të pazëvendësueshme. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdoj. Të uroj gjithë të mirat!

Jona Belba- Për ty mund të them se je një djalë vërtet shumë i zgjuar, i cili i ka të qarta prioritetet e tij. Sheh gjithmonë punët e tua dhe ato të cilat kanë rëndësi për ty. Je shumë i shkathët dhe energjik.

Keisi ÇuÇaj-Me Aldenin zëre sikur jam njohur këtë vit ,se vitet e tjera nuk fliste fare rrinte si serioz.Orët e gjeografisë janë shumë të bukura pasi shkëmbejmë shumë shaka. Aldenit i mbetet shumë qejfi dhe e di që do më mbaj mëri për gjënë më të vogël ,po që për dy ditë do e harroj (se bëj shaka a thu ti e lë egoja atë hahaahah 2 javë pa fol) .Suksese Alden!

Kevin Kotarja - Më ka ngelur në mendje sa herë më thua “Kevo” plot pozitivet në mëngjes. Kënaqesh të flasësh me ty se jo vetëm je shumë i kuptueshëm ,por edhe rrit nivelin e bisedës. Këto 3 vite që të kam pasur në klasë nuk më ke lënë asnjëherë përshtypje të keqe. Uroj të mbetemi shokë dhe pas rrugëtimit tonë te gjimnazit!

Ledio Zaimi- – Nxënës i rregullt dhe i qetë. Një djalë me vlera që duhet në shoqëri. Dikush si ti ja vlen vërtet ta kesh si mik.Suksese në jetë!

Luis Zenelaj-Je një djalë shumë i mirë kam fat që të kam patur shokë .Suksese!

Rei Skura- Je djali me të cilin nuk mund të krijosh një marrëdhënie të keqe. Je gjithmonë pozitiv, s’të kam parë kurrë të mërzitur. Këmbëngulës dhe shumë inteligjent. Suksese gango!

Tania Shoraj-Alden ore Alden, sa e sa vite ke që s’më ndahesh nga klasa sesi do më duket vitin tjetër. Edhe pse ndonjëherë debatojmë ,se të dy mërzitemi çik shpejt(ti më shumë që t’a dish dmth) prap unë nuk i ul konsideratat e mia për ty dhe do më vinte shumë keq nesë një ditë ne ndërpresim kontaktet ,pasi ti zë një vend shumë te rëndesishëm tek unë. Nuk do t’i harroj kurrë gallatat që benim në furgon, mbështetjet që më ke dhënë me aq sa ke pasur mundësi. Shpresoj shumë që të të realizohen ëndrrat edhe të jesh i lumtur në çfarëdolloj vendi që ti vendos të nisësh rrugëtimin tënd te jetës. Suksese Alden!

Uendi BaÇo - Nuk është se kemi folur shumë bashkë, por me aq sa të kam njohur je një person shumë i qetë dhe nuk të pëlqen të përzihesh dhe kjo gjë më pëlqen te ti. Paç fat!



Jona Belba

Adora Kika- Jona edhe pse një vajzë e re këtë vit në klasën tonë, diti të ambjentohet shpejt. Ajo është e qeshur dhe e dashur ,ndaj i uroj suksese të mëtejshme!

Ajsel Mlika- A kam shumë kohë që të njoh? Jo në fakt ,por kjo s'më ndalon aspak të jap mendimin tim për njerëzit që kaloj një pjesë të madhe të ditës brenda të njëjtit ambient. Ke qënë një vajzë tepër e urtë dhe mund të kem kaluar ndonjë ditë dhe pa ta dëgjuar zërin në klasë. Gjithmonë sheh punën tënde pa ndërhyrë shumë tek të tjerët, gjë e cila është për tu vlerësuar tek ti. Urtësia jote ndonjëherë më le dhe pa fjalë dhe ndonjëherë them me vete pse nuk jam dhe unë pak si ti. Të falenderoj për momentet që kemi kaluar bashkë dhe suksese!

Alden Malaj- Edhe pse ke ardhur vetëm vitin e fundit në klasën tonë, duket sikur e ke gjetur veten. Je përshtatur mirë me klasën e re dhe ke krijuar shoqëri ,që do të zgjasin për vite me rradhë. Gjithmonë të shoh me Uendin, shpresoj të keni një miqësi të pastër. Të uroj shumë suksese në jetë!

Ekaltra SulÇe- Këtë vit erdhe në klasën tonë. Je një vajzë e urtë, e sjellshme dhe korrekte në kryerjen e detyrave mësimore. Të uroj suksese ne vazhdim!

Joel Metaj- Dhe pse këtë vit erdhe në klasën tonë arritëm të afrohemi dhe të bënim shoqëri. Je një vajzë e zgjuar dhe e sjellshme. Të uroj gjithë të mirat!

Megi Jataj-O mac nga t'ja nis me ty, erdhe shpejt në klasën tonë dhe po aq shpejt u krijua dhe shoqëria jonë. Në klasë nuk mund të them se kemi ndejtur shumë, por momentet që kemi krijuar jashtë shkolle kanë

bërë që të nguliten thellë në zemrën time. Karakteri yt nuk i përshtatet fare asaj që do përfytyroja unë që do ishe. Sa më shumë kohë kaluam bashkë kuptova se ti në të vërtetë nuk je vajza e qetë, por përkundrazi një vajzë tepër energjike dhe ndaj ke marrë nofkën "mac". Jam shumë e lumtur që kam pasur mundesinë për t'u njohur me një person si ti.. e dashur, e ciltër, e thjeshtë dhe pa komplekse. Shpresoj dhe besoj se kjo miqësi do vazhdoj dhe më tej edhe pse rrugët tona do ndahen së shpejti. Gjithmonë do më kujtohen kohët kur linim orët e turqishtes për të ndejtur në kantinë. Po ashtu dhe shëtitjet tona nga ku ne kemi parë në të vërtetë që jemi një superdyshe fantastike.Ti e di qe do jesh e ftuar kudo qe une te shkoj per studimet e larta.. te uroj fat ne rrugen tende te dijes dhe te pafsha sa me larte!

Rei Skura- Aftësia jote për të ndihmuar këdo e për të zgjidhur secilën situatë të bën një shoqe shumë të mirë dhe të denjë për ne. Të uroj suksese!

Uendi BaÇo - Edhe pse kemi shumë pak kohë që njihemi, jemi afruar shumë dhe kalojmë thuajse çdo moment së bashku. Kemi bërë shumë kujtime në kaq pak kohë dhe jemi kënaqur jashtëzakonisht shumë. Jam tepër me fat që të kam dhe shpresoj ta vazhdojmë këtë shoqëri edhe kur rrugët tona të ndahen duke vazhduar për studimet e larta. Të uroj fat dhe shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat qe mund të kesh! Te kam shumë xhan!



Ergi Tahiri

Ajsel Mlika- Kur unë e njihja Erg Tahirin, këto të tjerët as nuk i dija që ekzistonin. Edhe pse më shumë nuk të kam parë se sa të kam parë këto tre vitet e fundit, kur ke ardhur në klasë vetëm gallata e qyfyre kemi bërë. Ndër Çunat më flori që kam takuar ndonjëherë, me zemër të bardhë dhe një sens humori shumë të mprehtë. Të kam dasht e më ke dasht fort, se e kam pas ditur tipin tënd gazmor e interesant. Kur vinin ato listat për ekskursionet ne të dy kemi qënë të parët përherë te dera e Umitit me lekët te dora e shihnim Umitin duke qesh. Për çdo ekskursion që kemi shkuar bashkë në 9-vjeçare, kemi kaluar ndër çastet e momentet më të bukura sidomos në Kolashin. Do shihemi shpejt edhe kur të mbarojë shkolla. Big kiss!

Albi Çela-Të kujtoj në klasën e gjashtë si një djalë me humor dhe i dashur. Shpresoj t'i realizosh dëshirat e tua dhe të uroj suksese në jetë!

Alden Malaj- Oligarkun nga Kukësi e kam njohur që fëmijë. Na mungon ta shohim dhe na ka mbetur vetëm si kujtim koha kur takoheshim në klasë. Dhe humori nuk i mungon asnjëherë. Nëse kemi një orë të lirë, gjërat me të cilat qeshim janë të paimagjinueshme. Edhe në momentet më të këqija, ai është pranë dhe nuk ka asgjë që mund të ndryshojë karakterin e tij unik. Edhe kur nuk i di gjërat, ai përsëri gjen një mënyrë dhe të ndihmon të jetosh për atë që dëshiron. Sa shpejt kalon koha qëkur kemi ëndërruar se si do të ishte jeta kur të ishim maturantë. Një gjë është e sigurt, ne jemi bashkë njësoj si 12 vjet më parë dhe bashkë për 120 të tjera.

Ekaltra SulÇe- Çuku, djali më gazmor i klasës. Të njoh që ditën e parë kur erdha në turk. Bashkë kemi kaluar një adoleshencë që vështirë të harrohet. Të uroj

vazhdimësinë e jetës me sa më shumë buzëqeshje!

Endi Hysi – Një djalë pozitiv dhe i qeshur. Më shumë e kam takuar jashtë shkollës sesa në shkollë. Të uroj gjithë të mirat!

Joel Metaj- O biznesmeni klasës ti ,që kam nja ca kohë që nuk të shof se s'po na vjen nanjëherë në klasë. Jemi shokë për vite. Momentet tona janë të pafundme si në shkollë, si jashtë saj me kujtime të bukura dhe te paharrueshme. E di që do jemi shokë përherë dhe shoqëria jonë nuk mbaron këtu. Të uroj gjithë të mirat o qofte!

Jona Belba- Nuk vjen shpesh në shkollë, por kur vjen vërtet di si ta bësh klasën të mbushet me të qeshura. Nuk je një djalë i cili meson shumë, megjithatë je shumë i zgjuar në aspekte të ndryshme. Je energjik dhe gjithmonë ke një koment për të bërë në lidhje me gjithçka.


Kevin Kotarja- Djalë shumë i mirë. Ka një sens humori të lezetshëm dhe është i shoqërueshëm me të gjithë. Suksese!

Luis Zenelaj-Ergi edhe pse më shumë s'të kemi parë se sa të kemi parë në shkollë ,prapë ne së bashku me Joelin dhe Brandin ja kemi kaluar shumë bukur këto vite gjimnazi me plot kujtime dhe momente shumë të bukura.Uroj të bëhesh një biznesmen i fuqishëm rrobash ashtu siç do ti !

Rei Skura-Je një djalë me karakter të vecantë dhe zemër shumë të madhe. Je gjithmonë aty për të bërë shakatë e tua e për të kënaqur gjithë klasën. Suksese!

Tania Shoraj- Po si ore djalë s'të pash tre ditë rresht këtë vit në shkollë hahaha. Edhe pse në shkollë çalon, në biznes je njësh edhe këto kohë kjo ka rëndësi. Kur e merr diçka seriozisht e çon deri në fund edhe kjo cilësi më pëlqen tek ti. Gjithmonë përcjell një energji pozitive. Edhe pse ke munguar aq shpesh, nuk di një njeri nga klasa që nuk i je gjetur pranë kur kanë patur nevojë, sado pak të ketë qënë ajo. Të uroj shumë suksese edhe paç rrugëtimin tënd sa më të bukur edhe të lehtë!

Matura 2024









Donika Çekrezi

Të dashur nxënës të klasës së 12 C,

Në këtë moment të veçantë të përfundimit të një kapitulli të rëndësishëm të jetës suaj, dua të shpreh me gjithë zemër mirënjohjen dhe krenarinë time për secilin prej jush. Ka qenë një kënaqësi e veçantë të jem pjesë e rrugëtimit tuaj edukativ dhe të ndajë momente të paharrueshme me ju.

Marrëdhënia jonë ka qenë gjithmonë frymëzuese, e mbështetur në mirëkuptim dhe përkrahje për zhvillimin e personalitetit tuaj. Ju keni treguar një miqësi dhe solidaritet të jashtëzakonshëm ndaj njëri-tjetrit, duke u bërë model për të gjithë. Kreativiteti juaj, uniteti dhe aftësia për të shfaqur personalitete të veçanta kanë bërë që kjo klasë të shkëlqejë.

Gjithashtu, humori juaj ka sjellë gëzim dhe freski në çdo ditë të shkollës. Jeni bërë një komunitet i vërtetë, ku secili prej jush ka kontribuar me dhuntitë dhe aftësitë e veta, duke e bërë klasën e 12 C një vend të veçantë dhe të dashur për të gjithë ne.

Ju uroj nga zemra suksese të mëtejshme në çdo hap që do të ndërmerrni në të ardhmen. Le të mbani gjithmonë me vete kujtimet dhe mësimet që kemi ndarë së bashku. Jini të sigurt se do të vazhdoj të jem krenare për ju dhe do t'ju mbështes gjithmonë në rrugëtimin tuaj të mëtejshëm.

Me shumë dashuri dhe respekt,

Donika Çekrezi



Alba Bylyku

Altea Gjinaj-Alba, për mua je një nga shoqet më të mira që kam. Jam me fat që kam njohur një vajzë të qetë, të zgjuar dhe shumë të dashur. Bashkë kemi kaluar vite shumë të bukura e kemi krijuar pafund kujtime. Bisedat tona i vlerësoj pafund dhe je një nga ato persona që gjithmonë të dëgjon e të këshillon. Ke një natyrë të veçantë dhe më pëlqen që gjithmonë ke një këndvështrim pozitiv në shumë situata. Janë të panumërueshme rastet që më ke bërë të qesh pafund me shprehjet e batutat e tua (rrëzh). Do më mungojnë shakatë që vetëm ne i kuptojmë. Të uroj shumë suksese Albasita dhe shpresoj të mbetemi po kaq shoqe të mira dhe në të ardhmen!

Amir Pazari- Nuk e di si t'ia nis, por fjalët për ty nuk do të më mbarojnë dot. E kemi njohur njëri-tjetrin në klasë të 6-të ku ishim në të njëjtin furgon. Edhe pse nuk flisnim në vit të parë ne u bëmë të pandashëm. Kujtimet që ndaj me ty janë të paharrueshme dhe shumë të bukura. E vlerësoj shumë faktin që je shoqja ime dhe e admiroj moskokçarjen tënde për çdo situatë dhe vazhdon gjithmonë me mendimin tënd. Nuk t'i harroj kurrë kohët kur ne dilnim dhe ti harroje lentet në shtëpi dhe të duhej ndihmë për të ecur, kur filloje të këndoje në telefon kur nuk fliste njeri ose kur mbanim hundën me dorë nga era e keqe që vinte në klasë. Faleminderit që i ke bërë këto vitet e gjimnazit më të bukura. Të uroj suksese në të ardhmen!

Arbër Tafani-Je një vajzë e qetë dhe shumë e zgjuar. Të uroj suksese të mtejshme!

Armin Vargu- Je një vajzë shumë e pjekur dhe fjalëpakë. Shumë pozitive dhe inteligjente. Gjithmonë e gatshme për shokët dhe këtë e vlerësoj shumë. Të uroj shumë suksese!

Ena Çaushaj- Albaaa, nuk më besohet që kemi plot 12-të vite që njihemi bashkë. Gjatë këtyre viteve kemi krijuar kujtime të paharrueshme dhe je bërë një nga shoqet e mia më të mira. Jam shumë e lumtur që shoqëria jonë ka zgjatur kaq gjatë pasi je një vajzë e mrekullueshme, e mbushur me virtyte. Me shakatë e tua, komentet dhe mimikat e shumta, më ke bërë gjithmonë të qesh. Shpresoj të mbetemi kaq të afërta dhe në vitet e ardhshme dhe uroj të të plotësohen të gjitha dëshirat pasi e meriton! Të kam shumë xhan!!

Erkli Boka-Me gëzim dhe admirim për të gjitha cilësitë e mrekullueshme që posedon. Urtësia jote dhe aftësia për të dhënë respekt tregon shkëlqim në karakterin tënd. Je një shoqe që të ndihmon në momente të vështira. Dëshiroj që rrugëtimi yt të jetë i mbushur me gëzim dhe suksese, sepse ti meriton të gjitha të mirat në botë.

Gledis Arapi-Alba je një vajzë e mirë dhe e zgjuar. Kemi kaluar kohë të bukura bashkë. Të uroj gjithë të mirat. Suksese në të ardhmen!

Megi Musta- Alba je një shoqe shumë e mire dhe e zgjuar. Gjatë gjithë këtyre tre viteve ke mbetur gjithnjë ajo vajza pozitive, e çiltër dhe e qeshur. Ndonjëherë më mahnit me mirësinë dhe qetësinë tënde. Do më marrë malli shumë për ty dhe bisedat tona. Momentet që kemi kaluar bashkë nuk do t'i harroj asnjëherë. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj t'ia dalësh mbanë gjithmonë!

Vesa Çeliku- O yllo, do më marri pafund malli për atë kafën e mëngjesit dhe për thashethemet te kaloriferi. Ditëlindjet në një ditë, në një orë dhe prap të kundërta ne! Më ke dhënë shumë këshilla të mira dhe ke një durim të jashtëzakonshëm. Shpresoj shumë që në Holland të arrish aty ku synon, të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe do vijmë të të takojmë!!!

Sindi Rraja- Albaa! Bashkë njihemi që nga klasa e 8-të dhe kemi kaq shumë kujtime që nuk do ti harroj kurrë. Të uroj shumë suksese në vazhdim!!

Klea Muceku-Një vajzë e qeshur dhe pozitive. Të uroj suksese!

Klejvist Demaj-Alba je një vajzë shumë e sjellshme dhe inteligjente, po ashtu shumë serioze. Të uroj shumë suksese!



Alisia Gjata

Amir Pazari- Alisia je një vajzë shumë e sjellshme me këdo. Më pëlqen që ne shoqërohemi bashkë dhe që kam njohur një vajzë kaq të thjeshtë dhe të dashur si ti. Të uroj suksese kudo në jetë!

Steisi Laraku-Alisia ime, kam tre vite që njihem me ty dhe tre vite që jemi rritur së bashku. U njohëm në vit të parë dhe ashtu vazhdoi rrugëtimi ynë. Njoha një shoqe e cila më ka qëndruar afër kur kam qeshur dhe kur kam qarë, nuk je lodhur asnjëherë nga bisedat e mia kemi folur së bashku shumë gjëra edhe ato më privatet, kemi kaluar shumë momente të bukura bashkë dhe do t'i kujtoj gjithmonë me mall. Dua që shoqëria jonë të zgjasi dhe të bëhet akoma më e fortë në të ardhme. Të dua shumëëë lisia imee xoxo

Erkli Boka-Për Alisian, një vajzë e mrekullueshme dhe e dashur, gjithmonë gati për muhabet gjithë orën. Je një vajzë shumë e zgjuar edhe të uroj suksese në të ardhmen. Me respekt dhe mirënjohje për të gjitha kujtimet e bukura që kemi kaluar në gjimnaz.

Klejvist Demaj- Me ty, Alisia, jemi njohur edhe më parë se të ishim në një klasë bashkë. Ty të kam njohur që më parë dhe je një vajzë shumë e mirë dhe e zgjuar. Më ke ndihmuar dhe unë të kam ndihmuar për shumë gjëra. Je një person që më ka qëndruar afër për çdo gjë dhe e di që shoqëria jonë do të vazhdojë.

Megi Musta- Alisia, u njohëm dy vitet e fundit dhe ti arrite të pasqyrosh vlerat e tua më të mira dhe më bëre të kuptoj se çfarë njeriu me zemër të madhe je. Më ke qëndruar gjithmonë pranë, më ke pyetur si jam e nëse jam lodhur, e këto gjeste kaq të vogla vlejné shumë për mua. Faleminderit që më ke mbështetur. Te uroj shume suksese kudo që të shkosh!

Sabjan Haska- O mbretëresha e Fierit ti! Je një shoqe

shumë e mirë dhe gjithmonë më ke qëndruar pranë. Pa ty sdo kishin lezet thashethemet. Të kam shumë xhan dhe e di që do mbetemi miq për shumë gjatë.

Erik Bici-Alisia, je një vajzë goxha e sjellshme dhe e besueshme. Këto dy vitet e fundit kemi qenë unë, ti dhe Erkli të cilët kemi kaluar gjatë gjithë kohës bashkë me njëri-tjetrin. Ndryshe ishim treshja fantastike. Më ke ndenjtur afër kur kam pasur nevojë dhe këtë ta di për nder. Të uroj gjithë të mirat Alisia, ishalla të shoh sa më të lumtur në të ardhmen dhe suksese!

Gledis Arapi- Ishte shumë kënaqësi që të kisha në klasë këto dy vite. Je një vajzë e mirë dhe e dashur. Kemi kaluar momente të bukura dhe shumë gallata bashkë të paharrueshme. Shpresoj të të realizohen të gjitha dëshirat që ti ke!

Parid Cela-Je vajzë shumë e mirë edhe gjithmonë pozitive. Kemi kaluar momente dhe gallata që sdo të harrohen. Të uroj më të mirat e botës kudo që të shkosh se i meriton edhe suksese!

Sofia Stavri- Ti je vajza më e bukur dhe zemra jote është plot mirësi. Faleminderit për kujtimet që kemi kaluar bashkë. Suksese dhe t'u plotesofshin të gjitha dëshirat!

Sofia Burimi-Ketrushi im i vogël, së mendoja kurrë që do të kisha kaq shume shoqe. Që në momentin e parë që ne kemi shkëmbyer bisedën tonë të parë jam ndjerë më rehat e më e lirshme se kurrë. Mund të them që je një nga personat që unë mund t'i shprehem e t'i flas për çdo gjë, dhe e di që do më kuptosh e sdo më gjykosh në asnjë moment. Këshillat e tua i kam marrë gjithmonë për bazë e më kanë ndihmuar në çdo rast. Jam shumë mirënjohëse për çdo moment që kemi kaluar bashkë dhe shpresoj të kemi kujtime të tjera. Të dua shumë dhe të uroj të gjithë të mirat e botës sepse i meriton!

Klea Culaj-Për shoqen time të dashur, e cila është gjithmonë aty për mua në çdo moment. Faleminderit që je një pjesë e rëndësishme e jetës sime! Një mikesh e vërtetë është një thesar i çmuar, i cili ndriçon ditët e mia me gëzim dhe kuptim. Jemi të lidhura përjetësisht nëpërmjet kujtimeve dhe aventurave që ndajmë së bashku. Të uroj shumë suksese!



Altea Gjinaj

Amir Pazari- Altea u bënë shumë vite që njihemi. Gjithmonë ke qenë ajo vajza e urtë por kur fillon të të njohësh , je shumë energjike dhe pozitive. Bashkë kemi kaluar kohë të bukura, kemi qeshur pafund dhe i kemi vërtetuar të gjithëve që bricjapët nuk janë vetem heartless por mund të jenë njerëz të dashur. Gjithmonë i bën njerëzit të shprehen lirisht pranë teje dhe nuk i gjykon ata bazuar në gjërat që nuk i rregullojnë dot. Je një vajzë me objektiva të qarta dhe uroj t'i bësh realitet. Shpresoj që rrugët tona të mos ndahen pasi dua të punoj me ty në të ardhmen. Veç me ëndrra jena vesh my favourite stargirl.

Ema Çaushaj- Të shkruaj për ty nuk e kam të vështirë, përveç faktit që më duhet t'i përmbledh në pak rreshta, por megjithatë virtytet, vlerat dhe cilësitë e tua si vajzë dhe si shoqe ma thjeshtësojnë punën. Më kujtohet që vitin e parë që erdhe në klasën tonë ishe ajo vajza e ndrojtur, e urtë dhe e sjellshme. Me këto cilësi e kuptova menjëherë që do të bëheshim shoqe, por dhe që të ishim kaq të pandashme sa që dhe mësueset të na pyesin sa herë mungon njëra nga ne, nuk ma kishte marr mendja. M'i ke zbuluar këto tre vite të gjimnazit dhe mund të them me plot gojë se nuk e di çdo kisha bërë pa ty. Nuk e di si do i kaloja ditët pa komentuar çdo situatë të mundshme që ndodh në klasë dhe ato shikimet që i hedhim njëra-tjetrës. Do të më mungojnë shakatë tona me të cilat qeshim pa ndalim, që vetëm ne mund t'i kuptojmë dhe njerëzit që na shohin duke menduar 'Ore po kto të dyja ç'patën'. Këtë vit, kemi qëndruar pak të ndara pasi t'i zgjedhe lëndët shkencore dhe mund të them se çdo orë mësimi mendoj: "Sa do të doja të ishte Altea këtu!". Jashtë shkollës jemi duke shkruajtur gjatë gjith kohës bashkë dhe nuk mungojnë telefonatat tona në darkë, të cilat unë i pres me pa durim, duke nisur me

pretekstin e deyrave e duke përfunduar me analizën e çdo situatë dhe personi të mundshëm. Shkurt, ne nuk mund të rrim të ndara nga njëra-tjetra :) dhe besoj që dhe njerëzit e tjerë që e shohin këtë gjë e mendojnë njësoj. Jam e sigurt që shoqëria jonë nuk do të përfundoj këtu. Shpresoj që të të shoh gjithmonë të lumtur, Alteeeee. Të dua shumë shumë fare!

Megi Musta- Ti je si një reflektim ku unë shoh vetveten. Jam shumë e lumtur që kemi krijuar këtë lloj marrëdhënie me njëra-tjetrën. Edhe pse mund të mos e kuptosh, dua që ta dish që të dua shumë Alte. Të vlerësoj për gjithçka je, e zgjuar, e qetë, modeste dhe e respektueshme. Suksese Alte!

Sindi Rraja- Altee, sozia ime hahah! Njerëzit si ty janë të rrallë dhe e them me plot bindje! Sa shumë gjëra kemi diskutuar bashkë, sa shumë halle kemi qarë. E di që në të ardhmen do të bëhesh një grua e arrirë!! Të puç!!!

Vesa Çeliku- Tea ime, njeriu që jep shumë shumë dashuri në mënyrën tënde dhe me qetësinë që të karakterizon e gjenë një zgjidhje për gjithçka. Shoqe që nga klasa e 9-të dhe mendoj që që atëherë e gjetëm njëra-tjetrën dhe pse nuk ishim në të njëjtën klasë. Ke qenë pjesë në gati të gjitha kujtimet e mia në këtë shkollë dhe nuk do ndryshoja asnjë të tillë. Fjalët e shumta dhe thashethemet nuk të pëlqejnë po s'e di ku të ra një shoqe si unë. Shpresoj që kur t'i kthehesh këtij libri mbas shumë vitesh të të jenë plotësuar të gjitha dëshirat e tua dhe të uroj më të mirat!

Luisa Spahiu- Që kur të kam njohur më ka bërë përshtypje karakteri yt dhe çiltërsia jote në të folur e në të sjellur. Ajo fundjavë në Mynih, ku ne u njohëm më mirë, na la të kuptojmë se sa shumë gjëra të përbashkëta kemi dhe se sa njëlloj i kemi shijet. Je një nga ata persona që i sjell një atmosferë të ngrohtë ambientit duke të bërë automatikisht të duash të shpenzosh kohë me ty. Je një shoqe shumë e afërt për mua dhe shpresoj (e di që po) që të mbetesh e tillë. Duke të uruar të të plotësohen të gjitha dëshirat e tua po e mbyll këtë kujtim të vockël nga gjimnazi.

Kiara Olldashi- Altea, kam qenë shumë me fat që gjatë periudhës së gjimnazit jam afruar më shumë me një person me karakter aq të bukur sa ti. Kemi kaluar shumë momente të bukura këto tre vite bashkë që nuk do t'i harroj. Jam e sigurt që do të mbesim shoqe të mira dhe në vazhdim. Të uroj mbi të gjitha vetëm gëzime dhe plot sukses në rrugëtimin tënd.



Amina Haxhialushi

Gledis Arapi- Amina, vajza më e ëmbël, më e lezetshme dhe më e qetë që kam pasur ndonjëherë në shoqëri. Ke qenë një shoqe shumë e mirë dhe e sinqertë. Kemi kaluar shumë momente të bukura dhe të paharrueshme bashkë. Je një person që më fal shumë pozitivitet. Shumë faleminderit që më ke ndihmuar për shumë gjëra dhe nuk je lodhur asnjëherë. E vlerësoj shumë kohën që kam kaluar me ty dhe shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj të të plotësohen dëshirat!

Megi Musta-Jemi njohur që në vitin e parë së bashku, por kurrë nuk u afruam aq sa këtë vit, që kemi kaluar çdo orë mësimore bashkë, sepse ne kemi qëllime të njëjta. Orët e mësimin me ty do të mbeten të preferuarat e mia. Mësova që je një vajzë shumë e zgjuar dhe bujare, kurrë nuk heziton t'i ndihmosh të tjerët kur të kërkojnë ndihmë apo t'i shpjegosh një gjë të re. Brenda pak kohësh nga një shoqe klase ti u ktheve në një person shumë të rëndësishëm për mua. Me ty kuptova se si është të kesh një person që i beson gjithmonë sepse e di që të do të mirën. E vlerësoj shumë shoqërinë tonë dhe dua të të kem pranë gjithmonë. Uroj të kesh sa më shumë suksese në jetë dhe të të plotësohen të gjitha dëshirat! Të pres në universitetin e mjeksisë sepse ky është vetëm fillimi i shoqërisë sonë.

Sindi Rraja- Aminë! Amina ime që ia del të gjejë të mirën në gjithçka dhe që do të bëj këdo rreth saj të ndihet mirë. Çdo moment me ty është i mrekullueshëm dhe i paharrueshëm. Ti akoma nuk i je përgjigjur pyetjes time byrek apo fasule? Por, gjithsesi hahaha. Dua të them që me ty ia kam kaluar kaq mirë dhe jam shumë me fat që kam njohur një njeri si ty! Shpresoj të plotësoh çdo dëshirë tënden dhe të

jesh gjithmonë e lumtur kokëkuqja ime!!!

Klea Muceku-Amina është një vajzë që punon shumë, që gjithmonë do të dalë sa më mirë, dhe në fund ia arrin. Njihemi prej tre vitesh dhe ia kemi kaluar shumë bukur bashkë. Minaa ime është gjithmonë e qeshur, pozitive dhe një vajzë me zemër të madhe. Të uroj shumë suksese Mina!

Sabjan Haska-Oj mizaaaa!!! Të uroj sa më shumë suksese në rrugëtimin tënd. Këtë vit të fundit shkollor kemi kaluar shumë bukur bashkë. Do më mungojnë shumë shakatë dhe të qeshurat gjatë orëve të mësimin. Shpresoj të bëhesh një doktoreshë e mirë ashtu siç dëshiron.

Keisi Çuçaj- Amin e vogël tiii! Kurrë nuk do ta kisha menduar se një shoqëri që lindi në furgonat e shkollës do të na bashkonte kaq shumë. Gjëja ime e preferuar tek ty është se gjithmonë më mbështet dhe më qëndron afër kur kam nevojë për dikë të sinqertë. Kemi kaluar shumë momente të bukura bashkë dhe asnjëherë nuk kemi debatuar. Na është bërë rutinë tani që çdo mëngjes të shkojmë në tualet dhe rregullojmë flokët dhe Make Up-in, dhe së di qysh do ia bëj kur të fillojë universiteti. Të dua shumë Amin dhe shpresoj që ta mbajmë lidhjen tonë shoqërore deri në fund! Suksese!

Klea Çulaj- Amina, dhe pse kemi pak kohë që njihemi kam kuptuar që je një shoqe e mrekullueshme dhe një krah ku gjen gjithmonë mbështetje! Je një vajzë plot ngjyra, e dashur dhe jam shumë e lumtur që të kam njohur këtë vit. Të kam shumë xhan! Të uroj shumë suksese në jetë!!

Altea Gjinaj-Amina, je një vajzë e qetë dhe shumë e sjellshme. Këto vite kemi kaluar momente të bukura bashkë. Uroj të të plotësohet çdo dëshirë e jotja! Shumë suksese mizuke!

Emra Çaushaj-Kemi vite që ndodhemi në të njëjtën klasë dhe dua të të them se je një vajzë e sjellshme, e zgjuar edhe se ke qenë një shoqe shumë e mirë përgjatë këtyre viteve. Të uroj suksese në të ardhmen!

Vesa Çeliku-Mina, je një vajzë e zgjuar dhe pozitive. Bashkë njihemi që në klasë të gjashtë dhe ke mbetur e njëjta, gjithmonë e buzëqeshur dhe e gatshme para sfidave. Të uroj sa më shumë fat dhe suksese doktoresha jonë e ardhshme!



Amir Pazari

Alba Bylyku-Miriii, jemi takuar që në klasë të 8 dhe dua të të them që je berë shoku im më i mirë. Në fillim, kur të njoha nuk mendoja që do të bëheshim kaq të afërt. Të falenderoj shumë që ke qenë aty për mua kur ta kam patur nevojën. Je përherë shumë i qeshur dhe pozitiv. Nuk do t'i harroj kurrë momentet tona që janë të panumërta. Gjithë ato gallata që kemi bërë bashkë gjithmonë do t'i kujtoj. Uroj që të mbetesh përherë kështu Miro. Shyqyr që u bëmë kaq të afërt me njëri-tjetrin. Të uroj më të mirat e kësaj botë!

Altea Gjinaj- Miri, bashkë jemi njohur në klasën e 9 dhe kemi krijuar një shoqëri shumë të mirë. Si dy bricjapë, ne kemi një marrëdhënie të shkëlqyer e të pazëvendësueshme. Je një djalë i sjellshëm, i qetë dhe shumë gallatë edhe pse në pamje të parë nuk ta jep këtë përshtypje. Siç thua dhe ti një "perl magjike" e vërtet! Bashkë kalojmë një pjesë të madhe të kohës dhe diskutimet tona janë vërtet shumë të vlefshme. Më ke qëndruar gjithmonë pranë dhe asnjëherë nuk ke hezituuar të më dëgjosh e të më japësh këshilla. Kemi krijuar kujtime vërtet të bukura që nuk do t'i harroj kurrë. Shpresoj të mbetemi po kaq miq të mirë, dhe në të ardhmen të punojmë bashkë një ditë. Në koncertin e rradhës të The Ëeeknd duhet të ikim bashkë me patjetër! Ps: Je The Starboy to my Stargirl dhe do të ta blej një ditë atë makinën të premtosj.

Armin Vargu- Je një djalë fjalëpakë inteligjent dhe me shumë vullnet. U bë kohë që njihemi dhe je një shokë shumë i mirë. Të uroj shumë suksese!

Ema Çaushaj- Amiriii, shoku më i mirë që unë kam (nuk dua asnjë koment pasi ta lexosh këtë). Bashkë kemi vite që njihemi tashmë dhe mund të them se marrëdhënia jonë sa vjen e përmirësohet. Të gjithë e

dinë se shoqëria jonë ka nisur me zënka ama nuk e dinë sa shumë jemi afruar në këto kohë e fundit. Di të them që nuk do t'i harroj kurrë momentet tona duke filluar nga të dalat në fundjavë, të muhabetet që bënim teksa shkonim në shtëpi e deri tek telefonatat tona. Jam shumë e lumtur që je pjesë e shoqërisë sime pasi je një faktor i rëndësishëm në ngritjen e humorit tim (nuk ta them shpesh pasi të bëhet qejfi e fillon bëhesh acarues). Të kam shumë xhan dhe dua që shoqëria jonë të vazhdojë për një kohë të gjatë. Shpresoj të të shoh gjithmonë të lumtur e të të plotësohen të gjitha dëshirat! (Përveç Anglisë... mos ik se pastaj nuk kam me kë ta bëj rrugën për në shtëpi)

Klejvist Demaj -Ti je një djalë shumë i zgjuar që të kam njohur që në klasën e parë. Je shumë kreativ dhe ke mendime vetëm për mirë. Të uroj shumë suksese!

Megi Musta- Amir, ti je një djalë punëtor, i zgjuar dhe i shoqërueshëm. Ti ke spikatur në shoqërine time për natyrën pozitive dhe sinqeritetin tënd. Je një shok shumë i mirë dhe jam shumë e lumtur që këto vite ne kemi krijuar këtë shoqëri. Dua shumë që edhe në të ardhmen të mbajmë kontaktet. Gjithmonë e kam vlerësuar që ti arrin t'i bësh të gjitha gjërat në mënyrën e duhur dhe të japësh më të mirën kurdoherë të jesh një nxënës i mirë, të jesh një mik i mirë, të jesh i matur e pozitiv. Për të gjitha këto arsye, unë mendoj që ti do të realizosh të gjitha ëndrrat e tua dhe do të jesh një person i suksesshëm në të ardhmen. Puno sa më shumë se dua të të shoh sa më lart.

Vesa Çeliku- Miriii, njeriu që i lexohet çdo emocion në fytyrë. Jam shumë e lumtur që kam një shoqëri kaq të ngushtë me ty dhe pse ti do na harrosh kur të shkosh në Angli. Ke dëgjuar muhabetet nga më të çuditshmet dhe nuk je ankuar asnjëherë. E di që do më mari malli për pozitivitetin tënd, por e di që s'do na harrosh kot bën. Të uroj sa më shumë fat në Angli dhe të bëhesh më i miri!

Sindi Rraja- Amiro! Kam një jetë që të njoh dhe e them me plot bindje që je një djalë i mirë. Më ke qëndruar pranë sa herë që mund të kem qenë keq. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!



Arbër Tafani

Alba Bylyku- Arbër je një djalë i sjellshëm dhe shumë pozitiv me çdo person. Të uroj suksese në të ardhmen!

Altea Gjinaj- Arbër, djalë i sjellshëm, pozitiv dhe gjithashtu shumë inteligjent. Këtë vit jemi njohur dhe ia kemi kaluar shumë mirë. Të uroj shumë suksese!

Amina haxhialushi- Arbër, ky ishte viti i parë që ishim bashkë në klasë. Je djalë i mirë dhe i zgjuar. Të uroj suksese!

Amir Pazari- Arbër, djalë i mirë dhe i qetë. Këtë vit jemi njohur dhe je treguar shumë i sjellshëm gjatë gjithë kohës. Të uroj shumë suksese.

Armin Vargu- Je një nga djemtë më të zgjuar që njoh, me një mentalitet shumë të pjekur. Je shumë pozitiv.

Ema Çaushaj- Edhe pse nuk kemi shumë që jemi njohur mund të them me plot bindje se je një djalë shumë i sjellshëm, inteligjent, i qeshur dhe mbi të gjitha një shok shumë i mirë. Të uroj suksese në të ardhmen!

Endrit Çenga- Je një djalë shumë i sjellshëm dhe fantastik. Suksese!

Erkli Boka- Arbër nuk kemi shumë kohë që njihemi bashkë, por kam vënë re një gjë shumë të rëndësishme që të karakterizon që është pozitiviteti dhe mençuria. Të uroj suksese në të ardhmen dhe e di që me mençurinë tënde ti do të ecësh përpara.

Gledis Arapi- Arbër dhe pse një vit në klasë bashkë, kam kuptuar që je një djalë shumë i sjellshëm dhe inteligjent. Të uroj shumë suksese në jetë.

Klea Muçeku- Je një djalë i zgjuar dhe i edukuar. Të uroj suksese!

Klejvist Demaj- Je një nxënës i ri në klasën tonë, por kjo nuk të ka krijuar probleme dhe u afrove me të gjithë. Ke një inteligjencë shumë të madhe dhe gjithmonë je i qeshur në fytyrë. Të uroj shumë suksese!

Megi Musta- Arbër, këtë vit erdhe në klasën tonë dhe na tregove se sa pozitiv dhe i zgjuar je dhe se si arrin t'ia dalësh gjithmonë mbanë. Ti gjithmonë je i gatshëm të ndihmohesh të tjerët. Je një djalë shumë i mirë. Suksese!

Jonuz Gjini- Jemi njohur që në vit të parë bashkë. Je nga personat me të cilin ja kaloj më mirë. Je shumë pozitiv dhe shumë i zgjuar. Kemi kaluar shumë kohë të bukura bashkë dhe do të vazhdoj po ashtu. Suksese në jetë dhe mos fli më në klasë!

Vesa Çeliku- Arbër ti je një djalë shumë i zgjuar (besoj se këtë e di dhe vet) dhe me këmbë në tokë. Faleminderit që ke qënë gjithmonë i gatshëm të më ndihmoje me ato pak lëndë shkencore që kisha zgjedhur. Të uroj shumë suksese dhe boll flete në klasë kur të shkosh në Uni.



Armin Vargu

Alba Bylyku- Armin je një djalë shumë I sjellshëm dhe humorist. Gjithashtu një shok shumë i mirë. Të uroj shumë suksese!

Altea Gjinaj-Armin, je një djalë i sjellshëm dhe shok shumë i mirë. Gjithmonë i gatshëm të të ndihmoj. Të uroj shumë suksese!

Amina Haxhialushi-Armin, je një djalë i qeshur, pozitiv dhe plot gjallëri. Diskutimet që kemi bërë bashkë kanë qenë gjithmonë interesante. Suksese Armin!

Amir Pazari- Je një person shumë pozitiv dhe i zgjuar. I ndihmon të gjithë kur kanë nevojë dhe ke gjithmonë sjellje shumë të mirë me të gjithë. Ka qenë kënaqësi që të kam patur në klasë. Të uroj suksese në të ardhmen!

Arber Tafani- Je një djalë i zgjuar, i afrueshëm dhe shumë pozitiv. Të uroj gjithë të mirat!

Ema Çaushaj- Bashkë jemi njohur që në klasë të gjashtë dhe shoqëria jonë ka vazhduar edhe pse ndodheshim në klasa të ndryshme. Në gjimnaz u takuam sërish dhe për këtë gjë jam e lumtur pasi je një shok shumë i mirë, i cili është gjithmonë aty kur ke nevojë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Endrit Çenga- Armin je në shokë shumë i mirë. Kemi kaluar një kohë të bukur në gjimnaz më shumë shaka të ndryshme, më ke ndihmuar dhe më ke këshilluar në shumë raste kur kam pasur nevojë dhe të falenderoj shumë.Suksese!

Erkli Boka- Për Arminin, një djalë të zgjuar dhe të

talentuar, me të cilin kemi kaluar shumë aventura të mrekullueshme gjatë këtyre tre viteve. Me urime dhe admirim për suksesin tënd në botën e aktrimit, dhe me shpresë për më shumë suksese të mëdha në të ardhmen.

Gledis Arapi- Për aq kohë sa kemi ndenjur bashkë, do të të mbaj mend si një shok të mirë.Të uroj çdo të mirë dhe suksese në të ardhmen!

Klejvist Demaj- Je një person që gjithmonë sa herë kanë pasur nevojë. I ke ndihmuar shokët. Këto 3 vitë ja kemi kaluar shumë bukur bashkë edhe pse ne njihemi që më përpara. Të uroj suksese në të ardhmen!

Megi Mustaj- Je një djalë shumë pozitiv dhe i zgjuar. Kemi kaluar shumë vite në klasë bashkë dhe ke treguar shumë karakteristika te tuat. Më bëhet shumë qejfi që jemi njohur. Të uroj shumë suksese ne vazhdim dhe uroj që t'i realizosh të gjitha ëndrrat që ke.

Sabjan Haska- Je çun i edukuar dhe i qetë. Shpresoj të arrish çka dëshiron në jetë.

Jonuz Gjini-Je djalë i sjellshëm që nuk mund të krijosh dot një marrëdhënie të keqe. Je inteligjent dhe gjithmonë pozitiv.Suksese në jetë!

Vesa Çeliku- Je një shok shumë i mirë dhe një njeri pozitiv mbi të gjitha. Me sportivitet kalon çdo situatë. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat!



Ema Çaushaj

Alba Bylyku- Emushee, njihemi që në klasë të parë. Je një nga personat që më ke ndenjur gjithmonë afër. Një nga gocat më të mira dhe me sens humori që kam njohur, sado e merzitur të jetë ajo prap e gjen diçka për ta ngritur humorin. Je një nga shoqet më të mira që kam pasur dhe uroj që shoqëria jonë të vazhdoj më tej. Faleminderit për të gjitha kujtimet që kemi patur bashkë. Suksese ylloo!

Altea Gjinaj- Emka, të shkruaj për ne më duket shumë e veshtirë pasi nuk di ku të filloj. Jemi njohur në klasen e 9-të dhe që atëherë mund të them se jemi bërë të pandara. Aty ku jam unë je ti dhe aty ku je ti jam dhe unë. Nuk e di sesi do i kaloja këto vite të gjimnazit pa ty! Je këshilluesja më e mirë, personi më i duruar me luhatjet e mia dhe i vetmi ku mund të mbështetem gjithmonë sepse e di që kurrë nuk do të më lë në baltë. Sa darka kemi ndenjur deri vonë duke diskutuar detyrat dhe pastaj duke përfunduar në diskutime për jetën. E kemi pasur të veshtirë ta etiketonim njëra-tjetrën si shoqe te ngushta sepse si afrohen njerëzit në kaq pak kohë, por pavarësisht këtyre teorive mua më duket sikur kam një jetë që të njoh. Të jesh me ty në bankë do të thotë ose do e kemi mendjen 100% në mësim ose do kapemi me diçka dhe do qeshim gjithë orën. Mjafton një shikim dhe e kuptoj në sekond se çfarë do të më thuash. Lëre pastaj goditjet me këmbë kur ndodh diçka që duhet diskutuar më vonë. Nuk po zgjatem më shumë sepse kushedi sa faqe do të mbusheshin. Uroj që të arrish çdo gjë që ti dëshiron dhe gjithashtu do të jem gjithmonë pranë teje të të përkrah!

Amir Pazari- Ema kemi më shumë se një dekadë që njihemi. Jemi njohur në klasë të parë, por që nga klasa e tetë ne jemi bërë të pandashëm. Edhe pse

ndonjëherë zihemi për gjëra të pakuptimta sërish flasim teksa bëjmë rrugën bashkë për në shtëpi. Fakti që ne kemi kaq shumë të përbashkëta dhe nuk i kemi dalluar të gjitha ende më habit sidomos shijet e njëjta në muzikë. Më ke ndenjur pranë dhe më ke ndihmuar sa herë kam pasur nevojë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen dhe shpresoj që shoqëria jonë të vazhdoj kështu komshia ime e preferuar.

Megi Musta- Të kam njohur për një kohë të gjatë, dhe mund të them se je e karakterizuar nga mirësjellja, zgjuarsia e optimizmi, disa nga virtytet më të rëndësishme që një njeri duhet të ketë. Gjithmonë je e gatshme të ndihmosh e të këshillosh shoqet apo nxënësit e klasës. Edhe pse në fillim ishim pak të ndrojtura për t'u afruar ne ia dolëm që në një kohë shumë të shkurtër të bëheshim shoqe shumë të mira. Më ke qëndruar pranë e më ke bërë të ndihem mirë kur kam patur nevojë. Të vlerësoj shumë e të kam shumë xhan. Suksese Ema dhe uroj që çdo gjë në jetën tënde të shkojë ashtu si ti do!

Sindi Rraja- Emm! Ne njihemi që nga klasa e 8 bashkë dhe di të them që je një shoqe shumë e mirë. Muhabetet që ti bën Ema si bën njeri haha! Të uroj shumë suksese në vazhdim!

Vesa Çeliku- Emushee e di që do më mari shumë malli për grricjet tona se kur nuk je smë ecën dita. Bashkë me Tean ma keni bërë gjimnazin plot me kujtime të bukura dhe jam shumë falenderuese. Faleminderit që më dëgjoje hallet në orët e Psikologjisë dhe gjithmonë mundoheshe të më bëje të qesh. Ndoshta unë nuk e shpreh shumë se sa të kam xhan po të kam shumë dhe jam e lumtur që u rikthyem në një klasë mbas dy viteve të ndara në klasa të ndryshme në 9 vjecare. Uroj vetëm të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe të jesh e lumtur sepse e meriton.

Sara Çollaku- Shoqëria jonë ka nisur që kur kemi qenë të vogla, në klasën e 6. Edhe pse ndoshta nuk jemi shoqja më e ngushtë e njëra-tjetrës si atëherë, jam shumë e lumtur që miqesia jonë ka vazhduar deri sot. U bënë rreth 7 vite që të njoh dhe tani që po e shkruaj po e kuptoj se sa shpejt kanë kaluar vitet. Di të them se je një shoqe shumë e mirë dhe e tillë do të mbetesh gjithmonë. Nuk do t'i harroj kurrë të gjithë momentet e bukura që kemi kaluar bashkë gjatë këtyre viteve, që nga muhabetet në fushën e basketbollit te 9- vjecarja.. Të uroj suksese në të ardhmen dhe shpresoj shumë që të arrish atë cka ti dëshiron!



Endrit Çenga

Alba Bylyku-Endrit, je një nga çunat më të urtë dhe pozitiv të klasës. Të uroj suksese në të ardhmen!

Altea Gjinaj- Je një djalë i qetë dhe i sjellshëm. Shumë suksese!

Amina Haxhialushi- Endrit, je një djalë i mirë dhe i sjellshëm. Të kam njohur këto vite dhe ia kemi kaluar mirë. Të uroj shumë suksese!

Amir Pazari-Endrit, ti je një shumë i mirë dhe i zgjuar. Më ke ndihmuar shumë kur kam pasur nevojë dhe këtë gjë e vlerësoj. Të uroj suksese në të ardhmen.

Arbër Tafani- Je një djalë i sjellshëm dhe i qetë! Të uroj gjithë të mirat!

Armin Vargu-Endrit je një djalë shumë besnik e ke treguar veten në shumë raste. Shpresoj të shikoj sa më lart.

Ema Çaushaj- Je një djalë shumë i qetë dhe i sjellshëm. Të uroj suksese në të ardhmen!

Erkli Boka-Endriti, një djalë i mirë edhe i urtë, ke një zemër të madhe dhe je një djalë i zgjuar. Të uroj suksese në të ardhmen.


Gledis Arapi- Je djalë i sjellshëm dhe i urtë. Ishte shumë kënaqësi që të kisha në klasë këto tre vite. Uroj të të plotsohen dëshirat dhe suksese në jetë.

Klea Muceku-Endrit, të njoh që në klasë të 8, je një djalë i sjellshëm dhe i edukuar. Të uroj suksese.

Klejvist Demaj- Endrit, je një nga personat më të

urtë dhe më të sjellshëm të klasës. Gjithmonë je duke qeshur dhe i gëzuar. Të uroj shumë suksese!

Megi Musta-Endrit, ishte vërtetë kënaqësi që të kisha këto dy vite në klasë. Do të të kujtoj gjithmonë si një djalë të urtë e të qetë që shikon gjithmonë punën e tij. Suksese!



Erik Bici

Alba Bylyku- Je një djalë I mire dhe i sinqertë. Të uroj suksese të mëtejshme !

Altea Gjinaj- Je një djalë inteligjent dhe i sjellshëm. Në këto tre vite gjimnazi i ke dhënë gjallëri klasës me batutat e tua. Të uroj shumë suksese!

Amir Pazari- Eriku është një shok shumë i mirë për mua. Bashkë kemi kaluar momente shumë të bukura dhe kemi qeshur pafund. I uroj shumë suksese në jetë.

Arbër Tafani- Je një djalë shumë i zgjuar dhe tepër i shkathët. Uroj të të plotësohen dëshirat që ke në jetë!

Armin Vargu- Je nje shok i mirë dhe shumë shakator. Na ke bërë për te qeshur shumë herë dhe kjo nuk harrohet. Të uroj shumë suksese!

Ema Çaushaj-Edhe pse ndonjëherë mund të mos biem dakord me mendimet e tua, prap nuk mund ta mohojmë se je një djalë tepër inteligjent dhe ambicioz, me një të ardhme të ndritur.
Të uroj shumë suksese!

Erkli Boka -Bice këto tre vite ja kemi kaluar shumë mire Nga viti parë e deri në vit të tretë kemi bërë lloj lloj aventurash , kur u mekshim ne klase kur perfundoshim ne drejtori e pafund histori të tjera. Nuk ka pasur ditë që ne të dy kemi qenë bashk edhe sjemi mekur me shakatë tona edhe nuk u uleshim dot bashkë në bank se e dinim qe do perfundonim jashtë. Je nje njeri shumë I zgjuar edhe mbi të gjitha je i drejtë . Teë uroj suksese te metejshme bica lalit.

Gledis Arapi- Je një djalë shumë inteligjent dhe i qeshur. Më ke bërë gjithmonë për të qeshur me

humorin tënd në klasë. Ishte shumë kënaqësi që të kisha në klasë këto tre vite dhe shpresoj që të të realizohet çdo dëshirë në jetë.

Klea Muceku- njihemi bashke që ne klasë të gjashtë . Një djalë I cili e mban klasën me shakatë e tij. Të uroj suksese!


Megi Musta- Bicin gjithmonë do ta mbajmë mend si atë djalin me vetëbesimin e tij të lartë e me ëndrra të mëdha. Me inteligjencën që të karakterizon ti bën ndryshimin në klasën tonë. Je një djalë shumë kreativ e miqësor. Uroj që një ditë të gjithë të të shikojmë atje ku ti do të arrish!

Sabjan Haska- Je shumë çun i mirë edhe pse ne pamje të parë nuk ta jep përshtypjen. Më pëlqen vetbesimi dhe humori jot. Uroj të arrish çdo gjë që dëshiron në jetë.

Sindi Rraja- Eriku pashë Bici djali më gallatë i klasës. Dy vitet e fundit jemi afruar goxha bashkë, kemi diskutuar shumë gjëra të rëndësishme si psh-astrologjia,dalja nga matriksi e shumë gjëra që fundja vetem me bicin diskutohen se normal është pesë hapa para nesh hahahaah. Je një djalë shumë i mirë dhe di që kurrë mos ta teprosh me shakanë. Shpresoj shumë që të kesh sukses në atë që do bësh(probabiliteti është tepër i lartë normal).Tungg bicee!!

Jonuz Gjini-Je një djalë me shumë talente, i shkathët,gazmor ,ambicioz dhe plot energji.Të uroj suksese të mëtejshme!

Vesa Celiku- Humoristi klasës tonë, ky humori jot është i ndërlydhur me pak ironi tek-tuk ndonjë kunjë por ke aftësi ti bësh njerëzit të të dëgjojnë. Do thoja 'të uroj fat' por ti e krijon vet fatin tënd se je pesë hapa para!



Erkli Boka

Alba Bylyku-Je një nga djemtë më argëtues të klasës. Je një djalë i mirë dhe i sjellshëm. Të uroj sukses!

Altea Gjinaj -Erkli, një djalë i sjellshëm dhe shumë pozitiv. Gjithmonë e bën klasën për të qeshur edhe në situata ku nuk ndihet. Të uroj shumë sukses në të ardhmen!

Amina Haxhialushi -Erkli, je një djal plot humor, i qeshur dhe i sjellshëm. Gjithmonë e ke bërë klasën për të qeshur dhe ke krijuar një mjedis pozitiv. Të uroj sukses!

Amir Pazari -Erkli jemi njohur për tre vite dhe gjithmonë ke qenë një djalë i zgjuar dhe i sjellshëm. Je një shokë i mirë, i sinqertë dhe shumë argëtues. Të uroj sukses në të ardhmen!

Arbër Tafani -Je një nga personat më gazmor në klasë, i zgjuar dhe i shkathët. Sukses në jetë!

Armin Vargu- Je një shokë shumë i mirë me një humor shumë të bukur. Na ke bërë për të qeshur gjithmonë. Kjo është një dhunti që nuk e kanë të gjithë

Ema Çaushaj-Erkli, humoristi i klasës sonë. Gjithmonë gjen ndonjë batutë që i bënë për të qeshur të gjithë, madje dhe mësueset. Edhe pse ndonjëherë mund ta teprosh, unë përsëri do të mbaj mend si ai djali që na ngrinte humorin dhe në ditë të mërzitshme. Të uroj shumë sukses!

Endrit Çenga -Kemi kaluar një kohë të bukur në gjimnaz duke bërë shumë shaka të ndryshme. Sukses!

Gledis Arapi-Je një djalë i mirë dhe me shumë humor.

Të uroj çdo të mirë dhe shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat në jetë.

Klea Muçeku-Erkli të uroj sukses kudo që te jesh!

Klejvist Demaj -Erkli që kur filluam të njiheshim në vitin e parë, kuptova që ti ishe një person që duhej mbajtur afër. Je një tip shumë i zgjuar, por edhe shumë shakaxhi. Të uroj sukses në të ardhmen!

Megi Musta-Është e vështirë të harrosh dikë si Erkli që me batutat e tij dhe me qetësinë e tij na ka zbukuruar ditët në gjimnaz. Je vërtetë një djalë shumë i mirë e me zemër të madhe që gjithmonë rrezaton pozitivitet. Të uroj shumë sukses në çdo hap tëndin!

Sabjan Haska-Edhe pse shpesh bëhesh acarues, prap klasa nuk do të kishte lezet pa gallatat e tua. Je çun pozitiv dhe uroj të arrish qëllimet e tua në jetë.

Jonuz Gjini -Je një nga njerëzit më të shkathët dhe aktiv brenda klasës. Shumë i zgjuar dhe gazmor. Sukses në jetë!

Vesa Çeliku -Je një shok i mirë dhe nuk të mungon asnjëherë humorin dhe aty ku sduhet! Përtej të gjithave të uroj më të mirat dhe të të plotësohen të gjitha ëndrrat.

Arbi Bulica- Erkli Boka, je almet cuni nga Tirona. Kthimi në shtëpi me furgon dhe byreqet e Bereqetit në mëngjes ska qenë asnjëherë kohë të mërzitshme me praninë tënde. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë edhe me mbarimin e gjimnazit. Të uroj shumë fat dhe sukses në jetë!

Endrit Çenga- Kemi kaluar një kohë të bukur në gjimnaz duke bërë shumë shaka të ndryshme. Të uroj sukses!



Gledis Arapi

Alba Bylyku- Gledis, një vajzë pa komplekse dhe shumë pozitive. Energjike dhe e sjellshme me të tjerët. Kemi shumë vite që njihemi, që në klasë të 8. Të uroj shumë suksese!

Altea Gjinaj- Gledis, mbaj mend orët e pushimit në klasën e 9 që i kalonim së bashku unë, ti dhe Ema ku aty njoha një vajzë humoriste, të zgjuar dhe shumë pozitive. Jemi afruar shumë këto vite gjimnazi dhe kemi krijuar kujtime shumë të bukura bashkë. Je e gatshme gjithmonë të më ndihmosh, gjë të cilën e vlerësoj shumë. Të uroj suksese kudo në jetë dhe shpresoj të jemi kolege në të ardhmen!

Amina Haxhialushi-Gledisa! Je shumë e mirë dhe shumë e dashur. Gjithmonë ke treguar kujdes dhe dashamirësi ndaj çdo njeriu rreth teje, duke i falur dashuri në çdo moment. Me ty kam folur për çdo gjë dhe më je gjendur pranë. Kemi kaq shumë kujtime të bukura, duke qeshur aq shumë sa nuk merrnim dot frymë. Gledis të kam shumë xhan dhe shpresoj që shoqëria jonë të vazhdoj! Uroj që të të plotësohen të gjitha dëshirat! Të uroj shumë, shumë suksese!

Ema Çaushaj-Gledis, u bënë 5 vite që jemi bashkë në të njëjtën klasë. Mund të them me plot bindje se ke qenë një nga shoqet e mia më të mira përgjatë këtyre viteve. Me atë humorin tënd të veçantë ke arritur të më bësh shumë herë për të qeshur. Gjithashtu te ti do të veçoja dhe faktin që je gjithmonë e gatshme të ndihmosh të tjerët sa herë ata kanë nevojë. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe suksese në të ardhmen!

Klea Muçeku-Gledis u bënë 3 vite që të njoh. Je një njeri shumë i mirë dhe gjithmonë do të mirën e të

gjithëve. Nuk mendoj që kam njohur ndonjëherë një person kaq pozitiv dhe energjik sa ti. Më ke ndenjur pranë sa herë kam pasur nevojë. Një vajzë e cila vendos njerëz të tjerë në fillim dhe më pas veten e saj. Je një vajzë shumë e mirë dhe një shoqe që çdo person do të donte të kishte në shoqërinë e saj. Muhabetet me ty nuk kanë mbarim dhe nuk mendoj se do të kenë ndonjëherë fund. Kur të takova për herë të parë nuk e mendoja që do të krijonim një shoqëri kaq të ngushtë por jam shumë e lumtur që të kam. Të uroj shumë suksese kudo që të shkosh dhe faleminderit që mi ke zbukuruar këto 3 vite!

Megi Musta- Kujdestarja ime që gjithmonë më këshillon e kujdesesh e interesohesh sa herë që sëmurem dhe gjithmonë më pyet nëse kam nevojë për diçka. Nuk ka fjalë me të cilat mund të të falenderoj për sa here më ke ndenjur pranë. Të dua shumë Gledis. Shoqëria jonë ka shumë vlerë për mua. Ti si një individ ke shumë rëndësi për mua. Ti rrezaton vetëm pozitivitet. Je njeri shumë i mirë dhe jam me fat që të kam njohur. Nuk dua të humbas kontaktet me ty sepse në zemrën time ti gjithmonë do të kesh një vend special. Unë dua të të shoh vetëm të qeshur dhe të uroj me gjithë zemër që t'i arrish ëndrrat e tua.

Sabjan Haska-O Gledi, o partnere. Si do bësh ti në universitet pa mua në bankë nuk e di. Të kam shumë xhan dhe të vlerësoj pafund. Shpresoj të të realizohet çdo dëshirë e jotja errrrr drej*!

Vesa Çeliku- O Gledi moj, njeriu me zemrën më të pastër, më e ëmbla dhe e sinqerta. Bashkë u bënë shumë kohë që njihemi dhe gjithmonë më ke këshilluar dhe kemi ndarë mendimet tona. Të kam shumë xhan dhe të uroj të të plotësohen të gjitha ëndrrat.

Alvis Qëndro- Gledis, shoqja ime gallat me të cilën kaloj çdo ditë në shkollë, që mezi presim pushimin e gjatë që të takohemi bashkë e të bëjmë gallata. Imagjino të ishim në një klasë bashkë (Nuk na ka lënë kastile se dihej që skishte për t'u bërë mësim hahaha). Je një vajzë me shpirt shumë të mirë dhe jam shumë mirënjohës që të kam pjesë të jetës time! Jam shumë i sigurt që shoqëria jonë do të vazhdojë akoma dhe më tej dhe aventurat tona nuk do kenë të mbaruar! Të uroj më të mirat dhe suksese në rrugëtimin tënd!



Jonuz Gjini

Arber Tafani - Je një nga personat që kaloj më shumë kohë në shkollë. Jemi njohur që në vit të parë dhe je një djalë shumë i zgjuar dhe me këmbë në tokë. Të uroj gjithë të mirat dhe t'u plotësofshin të gjitha dëshirat që ke!

Amir Pazari- Jonuz , nuk të kam parë kurrë të humbasësh qetësinë, dhe kjo gjë me ka shtyrë gjithmonë të bëj të njëjtën gjë. Edhe pse nuk kemi folur shumë bashkë e di që je një djalë i mirë dhe uroj të jesh i lumtur!

Ema Caushaj- Je një djalë shumë i sjellshëm, i zgjuar, me një qetësi që të karakterizon, dhe mbi të gjitha një shok i mirë. Të uroj shumë suksese në vitet e ardhshme!

Brus Tupi-Ti ke qenë një djalë me ambicie të madhe që kur të kam njohur në vit të parë. Një nga djemtë më të pjekur edhe pse që në adoleshencë, bashkë kemi kaluar 3 vjet ku kemi kaluar pafund momente të bukura bashkë. Shpresoj që gjatë jetës time të të kem pranë sepse shok si ti është thujse e pamundur të jenë të dytë. Uroj të të plotësohen të gjitha ëndrrat e tua dhe të arrish në jetë ato që dëshiron !

Gledis Arapi- Jonuz, dhe pse një vit në klasë bashkë, kam kuptuar që je një djalë shumë i sjellshëm dhe inteligjent. Të uroj shumë suksese në jetë dhe të të plotësohen dëshirat.

Klejvist Demaj- Jonuz, ti erdhe i ri në këtë klasë për vitin e tretë, por kjo nuk të ndaloi që ti njihje me të gjithë dhe të tregoje që je një djalë shumë i sjellshëm dhe inteligjent. Nuk ke konflikte me askënd dhe i ke ndihmuar të gjithë. Të uroj suksese në të ardhmen!

Megi Musta- Je një djalë me shumë vlera, i qetë, inteligjent dhe shumë pozitiv. Këtë vit u bashkove në klasën tonë dhe vërtetë bërë një ndryshim. Më bëhet shumë qejfi që të kam njohur. Uroj që t'i bësh ëndrrat e tua realitet dhe dua të të shoh një mjek sa më të mirë.

Klea Muceku- Je një djalë i zgjuar dhe i sjellshëm. Të uroj suksese!

Bjorn Tupi - O lazaratsi më Gango . Njihem me ty që prej vitit të parë dhe vazhdoj të kem një shoqëri shumë të mirë me ty. Kemi kaluar shumë kohë të bukura se bashku dhe shpresoj që ashtu të vazhdoj. Je një person me karakter pozitiv dhe i sinqert . Të uroj më të mirat dhe suksese në dëshirat e tua në të ardhmen!

Vesa Celiku- Nuzi je një djalë shumë i qetë dhe i zgjuar. I je bashkuar klasës tonë këtë vit por në kaq pak kohë na i ke treguar të gjitha cilësitë e tua pozitive. Më shumë kemi folur këto dy javët e fundit sesa gjithë vitit shkollor por ska gjë (shaka shaka). Të uroj shumë suksese dhe fat!

Altea Gjinaj- Je një djalë i qetë dhe shumë i sjellshëm. Të uroj shumë suksese!

Sindi Rraja- Mbaj mend herën e parë që ishim bashkë në bankë. Unë ajo llafazania që si mbyllej goja, dhe ti që vetëm pohoje me kokë (lëri pastaj ato të qeshurat me ironi) Faleminderit që më ndihmoje në matematikë sa herë që kisha nevojë hahahah. Je një djalë shumë i sjellshëm!! Suksese!!

Amina Haxhialushi- Jonuz, ky ishte viti i parë që u njohëm dhe kam kuptuar që je djalë i mirë dhe i zgjuar. Të uroj suksese!

Detjon Xhepi- Gjithmonë doja të kisha një vëllain por nuk e dija që do të njihja në kolegji. Jemi njohur në vitin e parë të gjimnazit dhe që atëherë e deri tani të quaj si vëllain tim që nuk e kam pasur kurrë. Rikujtoj çdo moment që kemi kaluar bashkë dhe qesh me çdo gjë që kemi bërë bashkë. Pa u zgjatur shumë të uroj më të mirat e kësaj bote dhe suksese të mëtejshme kudo që të ndodhesh. P.S: Të dua fort lali!!

Denis Prenga- Për shokun që gjatë shkollës u bë një vëllai ose ndryshe siç i thërras, hermano. Gjithmonë pozitiv dhe i gatshëm të të ndihmoj. Gjithmonë i gatshëm të të ndihmoj dhe përcjell pozitivitetet. Të uroj vetëm suksese dhe arritje në rrugën e re vëllai im!



Klea Muçeku

Altea Gjinaj- Klea, je një shoqe tepër e mirë, një vajzë e zgjuar dhe e dashur. Je e qeshur dhe gjithmonë i merr gjërat me pozitivitet. Ja kemi kaluar shumë mirë këto vite dhe shpresoj ti ruajmë kontaktet! Të uroj suksese kudo!

Amina Haxhialushi- Kleaaaaa moj Kleaaaaa!! Ti je një vajzë shumë e mirë, e qeshur dhe e fortë. Gjithmonë flet për atë që mendon që është e drejtë. Je shumë e dashur dhe pozitive dhe arrin ta reflektosh këtë dhe tek të tjerët. Jam e lumtur që krijova kaq shumë kujtime të bukura me ty dhe shpresoj të krijojmë edhe më shumë. Uroj që të të plotësohet çdo dëshirë! Të kam shumë, shumë xhan! Klea, të uroj vetëm më të mirën dhe shumë suksese!

Ema Çaushaj- Klea, me zgjuarsinë, shkathtësinë dhe humorin tënd që të karakterizojnë, je pa dyshim një nga vajzat më të mira të klasës. Vlerësoj shumë faktin që je gjithmonë aty për shoqet, dhe përpiqesh t'i bësh të lumtura, duke shfaqur vetëm vlera pozitive. Shpresoj të të shoh gjithmonë ashtu të qeshur dhe uroj të të plotësohen të gjitha dëshirat. Suksese në të ardhmen!


Gledis Arapi- Kle u bënë tre vite që ne jemi shoqe bashkë dhe më duket sikur kemi më shumë vite që njihemi me njëra tjetrën. Je një vajzë plot energji, gazmore dhe e dashur. Kemi kaluar aq shumë momente të bukura dhe gazmore bashkë sa që vështirë të numrohen dhe të harrohen. Si mund të harrohen ato orë mësimi që vetëm qeshim, bëjmë muhabete, komentojmë njerëzit ose kur këndojmë greqisht. Shumë faleminderit për çdo këshillë që më ke dhënë, për çdo moment kur unë nuk jam ndjerë mirë dhe ke qenë ajo që je munduar të më qetësosh. Ka ndodhur edhe që jemi mërëzitur me njëra tjetrën por prap kemi gjetur mirëkuptim dhe

kemi vazhduar si gjithmonë. Shpresoj që kjo shoqëria jonë të vazhdojë. Uroj që të arrish majat dhe të të plotësohen të gjitha dëshirat! Të kam shumë xhan!

Megi Musta- Klea ime, u njohëm bashkë që në klasë të parë, kaluam të gjithë fëmijërinë së bashku, u rritëm dhe ja ku jemi sot. Je një person shumë i veçantë dhe i rëndësishëm për mua dhe gjithmonë do të jesh e tillë (aq e veçantë je sa nga të gjitha shoqet e mia vetëm ty ta mban mend emrin babi). Kemi kaluar kohë dhe momente shumë të bukura gjatë këtyre 12 viteve të cilat nuk do t'i harroj kurrë. Më ke ndenjur pranë dhe më ke ndihmuar gjithmonë për çdo gjë që mund të kem pasur nevojë. Me ty me të vërtetë ndihem vetvetja. Dua të të kerkoj falje nëse ndonjëherë pa dashur të kam berë të ndihesh keq ose e zhgënjyer nga unë, sepse si të gjithë ndonjëherë ndodh që dhe unë nuk i mendoj mire gjërat që them. Nuk do të gjej ndonjëherë fjalë për ta shpjeguar se çfarë vlerash ke për mua. Do të bëja gjithcka që shoqëria jonë të mos mbaronte kurrë sepse dua Klean time në çdo hap që do të hedh dhe kudo që të shkoj. Të uroj shumë suksese kudo që të shkosh, ji vetvetja dhe do t'ia dalësh mbanë përherë. Të adhuroj vërtetë për karakterin tend të veçantë. Mos e ul kokën për asgjë se ti je më e mira. Unë do të të mbështes sa herë të kesh nevojë. Të kam shumë xhan dhe faleminderit që ke qenë përkrahja ime që në moshën 6-vjeçare e deri tani dhe që më tregove çfarë është shoqëria e vërtetë!

Sabjan Haska- Je një nga njerëzit më pozitiv që kam njohur, gjë që nuk e prisja aspak nga ty. Do të kem gjithmonë përzemër se je shpirt njeriu. Mos u acar kur kam bërë ndonjë shaka më tepër se kështu e kam unë. Vazhdo kështu siç je se ke për të realizuar çdo gjë që do.

Sindi Rraja- Klia nga Burreli! Në vitin e parë nuk e mendoja kurrë që do kishim një mardhënie kaq të fortë bashkë. Këto tre vite gjimnaz në shoqërinë e njëra-tjetrës nuk kishin si të kalonin më bukur. Nuk do t'i harroj kurrë shakatë tona në orët e mësimi dhe normalisht nuk do harroj kurrë dhe sa bukur i këndon këngët e Malumës, në atë gjuhën tënde që vetëm ti e kupton. Shpresoj shumë të arrish atë që dëshiron në jetë dhe mos ndalo kurrë së pëlqyeri Stich-in- "Ohana means family. Family means no one gets left behind or forgotten."



Klei Shkupi

Alba Bylyku-Një djalë pozitiv, i qetë dhe inteligjent. Suksese!

Altea Gjinaj-Një djalë i sjellshëm dhe i qetë. Të uroj shumë suksese!

Amina Haxhialushi-Klei, je një djalë i mirë dhe i qetë. Ja kemi kaluar mirë këto vite në klasë bashkë! Të uroj suksese!

Amir Pazari-Klei ti je një djalë shumë i sjellshëm dhe i mirë. Nuk kemi pasur shumë kohë që të njihemi po për aq pak kohë ti ke vërtetuar që je një djalë shumë besnik. Të uroj shumë suksese!

Arbër Tafani-Je një djalë i qetë dhe gazmor. Suksese në jetë!

Armin Vargu-Je një djalë me vullnet të madh. Je një nga shokët e mi me të mirë. Të uroj shumë suksese!

Ema Caushaj-Je një djalë shumë i edukuar e i qetë dhe të uroj suksese të mëtejshme!

Endrit Cenga-Kemi kaluar një kohë të bukur në gjimnaz dhe një një ndër shokët e mi më të mirë që më ke ndihmuar në shumë situata të ndryshme dhe të falenderoj. Shumë suksese!

Erkli Boka-Për Klein, një shok i urtë dhe i qetë, me të cilin kam ndarë shumë vite të bukura dhe aventura,emocionuese. Me respekt dhe mirënjohje për miqësinë dhe mbështetjen tënde të pafund. Me mirënjohje për të gjitha momentet e bukura që kemi ndarë bashkë. Të uroje suksese ne te ardhmen !

Gledis Arapi-Je një djalë i mirë. Të uroj shumë suksese kudo në jetë.

Klejvist Demaj-Klei je një djalë shumë i mirë dhe i zgjuar. Po ashtu je shumë i sjellshëm me njerëzit që mban pranë. Ndhmon shokët dhe kjo është një gjë shumë e mirë. Të uroj shumë suksese!

Megi Musta-Je një djalë i qetë e i sjellshëm. Në këto tre vite kam kuptuar se nëse ti vërtetë do të arrish diçka ti ia del mbanë. Të uroj shumë suksese!

Jonuz Gjini-Je një djalë i qetë dhe gazmor në momentet e duhura.Suksese në jetë!



Klejvist Demaj

Alba Bylyku- Një nga çunat më të mire të klasës. Je një djalë I sjellshëm dhe I qeshur. Ka qenë një kënaqësi që kemi qenë në klasë bashkë. Suksese!

Altea Gjinaj- Një djalë i sjellshëm dhe një shok shumë i mirë. Gjithmonë i gjendesh të tjerëve pranë kur kanë nevojë. Të uroj shumë suksese!

Amina Haxhialushi- Klevist, ti je një djalë i mirë, i zgjuar dhe plot humor. Rreth teje gjithmonë argëtohesh shumë. Je shumë punëtor dhe jam e sigurt që do të arrish atë që dëshiron në jetë. Të uroj shumë suksese!!

Amir Pazari- Klejvist je një djalë shumë argëtues. Më kujtohen shumë momente të bukura ku na ke bërë të qeshim. Tregohesh përherë pozitiv dhe ke vetëbesim. Këto tre vite ja kemi kaluar shumë mirë bashkë. Të uroj suksese në jetë.

Arbër Tafani - Je një djalë i shkathët dhe i sjellshëm. Të uroj gjithë të mirat!

Armin Vargu - Je një shokë shumë i mirë. U bë kohë që njihemi dhe kam kuptuar që je një mik i mirë dhe pozitiv. Te uroj shumë suksese!

Ema Çaushaj- Për këto tre vite që kemi qenë në njëjtën klasë, kam kuptuar se je një djalë shembullor, mjaft inteligjent dhe i edukuar dhe ke qenë një shok shumë i mirë për mua. Të uroj suksese në të ardhmen!

Endrit Çenga-Je një shok shumë i mirë dhe shumë i sjellshëm ja kemi kaluar shumë mirë ne këto 3 vitet e gjimnazit dhe të uroj suksese

Erkli Boka -Klejvistin një djalë i mençur dhe i guximshëm, i cili mbart me krenari trashëgiminë e Tropojës. Kto tre vite gjimnaz ja kemi kaluar mirë Klevo dhe të urojë sukses ne te ardhmen! Me respekt dhe admirim për zgjuarsinë dhe forcën tënde të brendshme.

Gledis Arapi - Për aq kohe sa kemi ndenjur bashkë, do të të mbaj mend si një shok të mirë. Të uroj çdo të mirë dhe suksese në të ardhmen.

Megi Musta - Je një djalë shumë i sinqertë, pozitiv dhe inteligjent. Mbi të gjitha je një shok shumë i mire. Në këto tre vite kam kuptuar se je një njeri me zemër të madhe që i ndihmon të tjerët dhe i qëndron pranë kur kanë nevojë. Të uroj shumë suksese!

Sabjan Haska - Më pëlqen që je i qetë dhe di si të veprosh në situata të ndryshme. Vazhdo kështu siç je dhe ke për të arritur shumë në jetë!

Sindi Rraja - Vistii! Mezi po prisja të të shkruaja ty! Vitin e fundit kemi kaluar goxha kohë bashkë dhe realisht je kthyer në një njeri shumë të rëndësishëm për mua. Me ty kam diskutuar shumë gjëra, më ke këshilluar për shumë gjëra dhe më ke qëndruar pranë sa herë që kam pasur nevojë. Të uroj shumë sukses në të ardhmen! P.s unë i jap makinës më mirë se ty.

Jonuz Gjini- Klejvist- Je një djalë i sjellshëm dhe plot me energji gati për gjithçka. Të uroj suksese në jetë!

Vesa Çeliku-Bashkë njihemi qe ne klasë të 8-të dhe mund të them me plot bindje që nuk ke ndryshuar fare. Shpresoj mos ndryshosh sinqeritetin dhe ironinë që të karakterizon dhe të uroj shumë fat, Visi nonës!

Alisia-Klejvist, cfarë të them më para për ty... Edhe pse kur jemi njohur nuk e kemi pasur qejf njëri-tjetrin, ti për mua tani je një nga shokët më të mirë që kam. Me ty kam folur për të gjitha situatat që kam pasur dhe përherë je munduar të gjesh zgjidhje për të gjitha. Momentet që shkonim bashkë në shkollë me taksi dhe shakatë që shkëmbenim me njeri tjetrin do t'i kujtoj përherë me mall. Të vleresoj pamasë dhe shpresoj qe shoqëria jonë të vazhdoj edhe pas gjimnazit. Të uroj shumë suksese dhe të arrish gjithçka që ti do. Të kam shumë xhan!



Matteo Esposito

Alba Bylyku-Je një djalë I urtë, I qetë dhe një shok I mire. Suksese Mateo!

Altea Gjinaj- Një djalë i sjellshëm dhe i qetë. Të uroj shumë suksese!

Amina Haxhialushi-Matteo, je një djalë i mirë, i qeshur dhe i sjellshëm. Je pozitiv dhe plot herë ke sjellur të qeshura në klasën tonë. Të uroj shumë suksese!

Amir Pazari-Mateo ti je një djalë i sinqert dhe humorist. Kemi kaluar shumë mirë bashkë dhe jemi kënaqur duke qeshur. Uroj të jesh shumë i suksesshëm në të ardhmen.

Arbër Tafani-Je një djalë shumë pozitiv dhe gazmor. Suksese të mëtejshme!

Armin Vargu- Je nje shok vërtet besnik është bërë kohë që njihemi dhe e di që miqësia jonë është e pastër. Të uroj suksese!

Ema Çaushaj-Je një djalë shumë i sjellshëm dhe gazmor, duke na bërë të gjithëve për të qeshur me shakat e tua. Të uroj suksese në të ardhmen!

Endrit Çenga- je një ndër shokët më të mirë që kam. Kemi bërë shumë shaka ne klasë me Arminin dhe Klein. Më ke këshilluar në shumë situata të ndryshme dhe të falenderoj shumë Kanë qënë vite shumë të bukura dhe të uroj suksese!

Erkli Boka- Mateo nje djali i mirë dhe i sjellshëm . Ja kemi kaluar mirë keto tri vite te bukura gjimnazi. Je një djal me zemër te madhe dhe i gatshem per te bërë një shaka në çdo moment. Të uroj suksese ne te ardhmen

Gledis Arapi-Matteo je një djalë shumë i mirë dhe i sinqertë. Gjithmonë më ke bërë për të qeshur dhe më vjen mirë që të kisha në klasë. Të uroj çdo të mirë dhe shpresoj të të realizohen të gjitha dëshirat në jetë.

Klejvist Demaj- Jemi njohur që në klasën e gjashtë dhe që atëherë kam pasur një mendim të mirë për ty. Je i zgjuar dhe një shok shumë i mirë. Të uroj shumë suksese!

Sabjan Haska-Je pak impulsiv, por me aq sa të kam njohur më dukesh mjaft pozitiv. Shpresoj të të plotësohet çdo dëshirë e jotja.



Megi Musta

Amina- Megii! Ti je një vajzë shumë e mirë, shumë e zgjuar dhe shumë punëtore. Je shumë e dashur dhe gjithmonë më je gjendur pranë. Kemi folur e kemi qeshur për gjëra nga më të ndryshmet për orë të tëra. Ia kemi kaluar shumë bukura bashkë dhe kemi krijuar plot kujtime të paharrueshme. Jam e lumtur që këtë vit shoqëria jonë u forcua edhe më shumë. Je një shoqe shumë e mirë dhe uroj që shoqëria jonë të vazhdojë. Jam e sigurt që do të bëhesh një doktoreshë e shkëlqyer. Megi, të uroj shumë, shumë suksese! Të kam shumë xhan!!

Amir-Të kam njohur në klasë të gjashtë dhe ke qenë dhe vazhdon të jesh ajo vajza e zgjuar dhe puntore që çdo gjë e merr me forcat e veta. Je një vajzë plot gjallëri dhe nuk të lë asnjëherë në blatë. Do t'i mbaj mend gjithmonë kohët kur të merrja me ten ten dhe filloja të këndoja që të të zgjoja nga gjumi , ose të të vija ne siklet me familjen. Shpresoj të bëhesh një doktoreshë me emër dhe të uroj shumë suksese në jetë!

Ema-Megi, je një vajzë e mrekullueshme me cilësitë më të mira që mund të ketë një njeri. Je një vajzë mjaft inteligjente, e sjellshme dhe i përkushtohesh shumë shkollës, madje mendoj se ndonjëherë lodhesh më tepër se ç'duhet. Pozitiviteti dhe energjia që përcjell më bëjnë dhe mua të jem më e qeshur dhe për këtë falenderoj. Nuk dua të harroj pa përmendur dhe faktin që je gjithmonë e gatshme të më ndihmosh e asnjëherë nuk mërzhitesh edhe pse të çmend ndonjëherë me pyetjet e mia. Një shoqe shumë e mirë, të cilën e vlerësoj shumë dhe e kam xhan! Uroj që të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe suksese në vitet e ardhshme!

Gledis- Megi,vajza më punëtore që kam njohur

ndonjëherë që punon fort për të arritur qëllimet e veta, dhe kjo cilësi e jotja më pëlqen shumë.Kemi kaluar shumë momente të bukura që nuk do të harrohen lehtë.Po si mos të mbahen mend të qeshurat tona,kërcimet tona latine apo gafat tona që janë të pafundme?!Faleminderit që më ke qëndruar pranë në çdo moment dhe që je munduar të më ndihmosh kur unë kam pasur nevojë.Kemi qeshur, kemi qarë, jemi mërzhitur me njëra tjetrën dhe prapë jemi mirëkuptuar bashkë. Shpresoj që kjo shoqëri të vazhdojë edhe përtej gjimnazit.Uroj shumë që të bëhesh një mjeke shumë e suksesshme në të ardhmen dhe të të realizohen të gjitha dëshirat! Të kam shumë xhan!

Klea-E mi Megii nga t'ia nis me ty... Po filloj me ditën e pare të shkollës, në klasë të parë aty ku të njoha. Si një fëmijë që nuk shoqërohesha shumë me fëmijët e tjerë gjeta mbështetje tek ti. Njoha një vajzë e cila më mbështeti për 12 vite rresht. Njoha një vajzë me të cilën jam shprehur dhe jam hapur për veten time. Njoha Megin e cila sa herë kam qënë e mërzhitur më ka ndenjtur pranë duke më këshilluar dhe më pas duke u munduar të më riktheje humorin.Je një vajzë kreative, ambicioze dhe gjithmonë e arrin atë që kërkon. Një vajzë e cila më ka ndihmuar në çdo gjë që kam patur nevojë, dhe po ashtu një vajzë me karakter të fortë. Jemi rritur bashkë, kemi kaluar momente shumë të bukura të cilat i kujtojmë në ditët e sotme dhe qeshim. Edhe pse njihemi prej shumë vitesh, çdo dite mësoj diçka të re nga ti. Je një vajzë e mrekullueshme në të gjitha aspektet dhe veshtirë të gjesh diçka "negative" tek ti. Sa kujtime kemi bashkë dhe mezi pres që të na shtohen akoma më shumë. Kur mendoj që mbaroi shkolla dhe nuk do të jemi më bashkë çdo mengjes duke filluar ditën së bashku duke ngrënë byrek, e duke pirë kafe tek kantina, mërzhitem, por pastaj mendoj që momente akoma më të bukura do t'i shtohen shoqërisë sonë. Je një person shumë i rëndësishëm për mua dhe dua të të kem pranë gjithmonë. Të uroj shumë shumë suksese dhe shpresoj t'ia arrish qëllimit tend në jetë, një mjeke e suksesshme!

Sindi-Goca ime që jeton në botën e saj ngjyrë rozë (bashkë me mua). Sa shpejt kaluan këto tre vite , dhe sa shpejt erdhi momenti që të them këto fjalë. Megu, shoqëria jonë ka pasur gjithmonë ato ulje ngritjet e veta , por gjithmonë i kemi qëndruar pranë njëra-tjetrës. Mezi pres të shoh gruan e arrirë që do bëhesh. Të uroj shumë sukses në atë ç'ka do të bësh!! Të kam shumë xhan!!



Sabjan Haska

Arlind Islami-Sabjan , je një nga shokët e mi më të mirë dhe më të vecantë që kam pasur ndonjëherë. Shoqëria jonë ka nisur në vitin e parë, por ajo ka arritur kulmin e saj tani në vitin e tretë. Je një djalë i kompletuar në të gjitha fushat dhe nje shok perfekt. Nuk e kisha menduar se do të kisha ndonjëherë një shok të tillë. Ti tashmë për mua nuk je thjesht shok ,por je akoma më shumë se kaq. Të jam mirënjohës për çdo këshillë dhe çdo ndihmë që më ke dhënë gjatë këtyre tre viteve. Nuk mjafton një faqe libri dedikimesh për të shkruar të gjitha kujtimet tona kështu që unë po e mbyll me kaq. Të uroj shumë suksese në rrugen tënde drejt universitetit . T'u realizoftë ëndrra që ke për t'u bërë mjek! Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë e të forcohet nga dita në ditë! Me respekt Çepellsy yt i preferuar!

Sofia Stavri- Ti më kupton pa folur asnjë fjalë. Je shumë këmbëngulës dhe do e arrish qëllimin tënd. Zgjuarsia jote i tejkalon kufijtë, me pak fjalë je si ajo shprehja “ctë sheh syri,ta bën dora”. Kapemi ndonjëherë po motra nuk i kushton rëndësi debateve. Lart e më lart Sabjan, motra të mbeshtet në çdo hap!

Debora Qendra- Një ndër shokët më të mirë që kam je dhe ti. Jam me fat që kisha mundësinë të të njoh në vit të parë dhe të kaloja gjithë gjimnazin në shoqërinë tënde. Tashmë që po vjen fundi mundem të të falenderoj për kohërat e bukura që kemi kaluar. Je një person shumë i ëmbël dhe i zgjuar. Nuk do t'i harroj kurrë telefonatat tona kur ankohehe për konviktin. Të uroj suksese kudo!

Keti Bardhoshi-Sambuan, aq shumë jam mësuar me ty saqë harroj se ka pasur kohë kur nuk njiheshim. Edhe pse shoqëria jonë filloi me një konkurrencë në

biologji, nuk mund ta imagjinoj si do të kaloja të gjitha orët e maturës pa ty. Je gjithmonë gati për të ndihmuar në kimi, dhe je një shok të cilin e besoj se më thotë të vërtetën për të mirën time. E di që do të shkelqesh në rrugën tënde si mjek dhe mezi po pres!

Vera Meta-Edhe pse njohja jonë ishte me vonesë po të them që kemi kaluar një kohë të paharrueshme. Nuk do t'i harrojë ato përkëdheljet e tua duke më quajtur Verina. Ndihma jote në orën e kimisë ishte një shpëtim për mua. Kujtoj ato bisedat e pafundme dhe thashethemet e këndshme. Se mos harron klinikën që do hapim. Të përqafoj!!!

Erisa Noga-Je ndërmjet nxënësve më të rregullt dhe të zgjuar. Je djali që çdo prind do dëshironte. Me buzëqeshjen tënde ke bërë gjysmat e vajzave të shkollës për vete. Suksese në universitet, jetë dhe dashuri! (Sidomos tek kjo e fundit).

Megi Musta - Sabi, je një shok shumë i mire, mbështetës dhe i rëndësishëm për mua. Jam e lumtur që të njoha këtë vit sepse me të vërtetë kisha nevojë për një person si ti. Inteligjenca nuk do të lërë kurrë në baltë dhe do të shkëlqesh gjithmonë. Të admiroj për vetëbesimin tend. Do takohemi ne universitet, nuk ke shpëtim nga unë. Faleminderit për gjithçka!

Sofia Burimi - Sabiii, s'do më shkonte në mendje që do ishim kaq afër. Ne ramë bashkë në klasë vjet dhe që nga ai moment s'jemi ndarë. Mund të them që je shoku më i mirë që kam dhe të jam mirënjohës për të gjitha herët që më ke ndjenjur afër kur kam pasur nevojë. Do të doja të ishim edhe këtë vit në klasë bashkë. Të kam xhan<3.

Kreisa Guçe- O kusho këto dy vite që kemi kaluar, sidomos tani që jemi rritur, kanë qenë fantastike. Do thoja se do më mungosh shumë ,por ne do takohemi dhe në Gjirokastër. Që të vegjël nuk na ka ndar gjë kështu që dhe tani bashkë do jemi, nuk ke shpëtim.

Kaila Velmishi- Jam me fat që të kam njohur edhe pse në fillim s'më pëlqeve. Gjithmonë informohesh për të rejat e fundit. Je si sferë magjike. Sa herë kam një problem përherë vij te ti sepse e di që do të ma zgjidhësh. Të përqafoj dhe shpresoj ta mbash gjithmonë ate buzëqeshjen e bukur!



Sindi Rraja

Altea Gjinaj-Bashkë jemi njohur në klasën e 9 ku të gjithë na thonin sesa ngjanim me njëra-tjetrën. Në fillim asnjëra nga ne se dallonte ngjashmerinë, por mund të themi se pas këtyre viteve biem dakort se ngjajmë pak. Je gjithmonë e qeshur, një shoqe që ia del të të bëj të ndihesh mirë sa herë që ke nevojë. Shpresoj që të të realizohen të gjitha ëndrrat e tua! Shumë suksese!

Amina Haxhialushi-Sindiiiiiiii!!! Je një vajzë shumë e mirë, e dashur, e fortë. Ne kemi që në klasë të tetë që njihemi dhe kemi plot kujtime të bukura bashkë. Gjithmonë kam mundur të flas me ty për çdo gjë dhe diskutimet tona kanë qenë shumë të bukura. Të qeshurat mes nesh s'kanë munguar kurrë. Jam shumë e lumtur që kemi një shoqëri kaq të bukur dhe uroj që ajo të vazhdoj edhe më tej. Jam e sigurt që do të arrish t'i plotësosh të gjitha ëndrrat!! Të kam shumë xhan!! Sindi, të uroj shumë, shumë suksese!

Ema Caushaj-Sindi, je një vajzë shumë e dashur, e zgjuar dhe e sjellshme me të gjithë. Nuk mund të lë pa përmendur faktin se je një nga personat më pozitiv që ka kjo klasë. Gjithmonë je aty për të të bërë të ndihesh mirë dhe gjithashtu me shakat e tua na ke bërë për të qeshur. Kemi krijuar shumë kujtime të bukura këto vite dhe të uroj suksese në të ardhmen!

Erkli Boka- Për Sindin, një vajzë e mrekullueshme, e cila përveç që është e sjellshme, është gjithashtu shumë e zgjuar. Ja kemi kaluar shumë mirë këto tre vite gjimnazi dhe te uroj suksese në të ardhmen .Me respekt dhe admirim për të gjitha cilësitë e tua të shkëlqyera.

Klea Muceku-Sindi kemi 3 vite që njihemi dhe kam

kaluar momente shumë të bukura me ty. Më ke ndenjur pranë sa herë kam patur nevojë. Nuk do ti harroj asnjëherë shakatë tona, të qeshurat tona në orët e mësimit. Je një vajzë me zemër të madhe dhe i ndihmon te gjithë. Një vajzë e cila kurrë nuk dorëzohet pa arritur qëllimet e saj. Gjatë këtyre viteve arrita të njoh jo vetëm atë Sindin e bukur, e dashur por edhe Sindin me një karakter të fortë, ambicoze dhe një vajzë zemërgjerë. Je një njeri të cilin dua ta kem pranë gjithmonë. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj ti realizosh ëndërrat e tua të bukura!

Klejvist Demaj-Sindi gjatë këtij viti të fundit të gjimnazit ti je një nga personat që jam afruar më shumë. Je bërë një nga ata persona të cilët mund të bisedojnë për shumë gjëra dhe të kërkoj ndihmë, pasi e di që do të më gjendësh afër. Je një person shumë i afërt për mua dhe e di që shoqëria jonë do të vazhdojë edhe pas këtij viti. Të uroj shumë suksese në të ardhmen! P.S. Jo, ti nuk i jep makinës më mirë se mua.

Megi Musta- Unë dhe ti kemi një gjuhë të përbashket që nuk e kam pasur asnjëherë me askënd tjetër dhe jam e lumtur që askush nuk mund ta kuptojë përveç nesh. Ti më kupton më mire se të gjithë dhe e di që me ty mund të shprehem sa herë që kam .Të kam shumë xhan.Dua të të shoh vetëm të lumtur sepse kur ti buzëqesh mua më bëhet zemra mal. Je vërtetë shumë e rëndësishme për mua. E di që ne nuk do të ndahemi kurrë sepse ne kemi një lidhje shumë të forte mes njëra-tjetrës.Kjo besoj se kuptohet direkt duke filluar nga telepatia jonë. Mos hiq dorë nga ëndrrat e tua sepse unë e di që ti do t'ia dalësh mbanë. Edhe mua këtu më ke gjithmonë sa here që të duhem,mos e harro kurrë.

Sabjan Haska-ZEMËR, e di ti sa xhan të kam unë ty. Përqafimet më të mira në gjithë turkun ti i jep.Shpresoj të mos më lësh rehat edhe pas gjimnazit, e di vet ti. Të uroj suksese në çdo drejtim që dëshiron!

Klejsa Neza-Sindushi ime ti, je një vajzë e bukur dhe tepër e ëmbël . Më ke falur gjithmonë dashuri me fjalët e tua të bukura dhe më ke bërë të ndihem tepër e vecantë . Së bashku kemi krijuar shumë kujtime të bukura të cilat do të mbeten të gdhendura në mendjen time . Shpresoj që mbas disa vitesh të jemi duke shijuar jetën si dy vajza të sukseshme . Do mundohem të jem gjithmonë aty për ty, të dua shumë!



Vesa Çeliku

Altea Gjinaj- Vesita, ne bashkë u njohëm në klasë të 9-të dhe edhe pse nuk ishim në të njejtën klasë u afruam menjëherë. Gjatë këtyre viteve kemi kaluar pothuajse çdo çast bashkë dhe kemi krijuar kujtime vërtet të veçanta. Edhe pse jemi persona të kundërt në karaktere mendoj se e plotësojmë njëra-tjetrën më së miri. Jam me fat që kam njohur një vajzë kaq solare, pasi pozitiviteti yt më ka ndihmuar pafund këto vite gjimnazi. Të falenderoj që më dëgjon dhe që më je gjendur gjithmonë pranë këto vite. Je një vajzë që asnjëherë nuk heziton ta thuash mendimin tënd, dhe për këtë gjë të admiroj shumë edhe pse nuk ta them. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë sepse kemi krijuar një marrëdhënie vërtet unike. Të uroj suksese dhe jam e bindur që do të arrish aty ku ti dëshiron!

Amir Pazari-Vesa ishte kënaqësi që të kisha këto tre vite në klasë. Je një vajzë shumë e ëmbël, e brishtë dhe e shoqërueshme me të gjithë. Nuk e mendoja që ne të dy do të ishim kaq miq të mirë bashkë për kaq pak kohë. Mbjaj mend galletat që kemi bërë bashkë të cilat nuk do të harrohen kollaj. Të gjithëve i duhet një mami VEZ në skuadrën e tyre. Të uroj suksese kudo dhe shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat që ti ke!

Emma Caushaj-Vesusheeee, siç thonin dhe njerëzit "ëmbëlsira për në fund". Edhe pse gricemi shumë. (pa u zënë një herë ne të dyja nuk shtyhet dita), ti përsëri mbetesh një person i veçantë për mua. Kemi kaluar shumë vite bashkë duke krijuar kujtime që do të mbetëm gjithmonë në mendjen time. Energjia jote pozitive e shoqëruar me atë buzëqeshjen e ëmbël, shakat e tua (të cilat më bëjnë të qeshin sepse nuk janë për të qeshur), "dhuntia" jote për ta kthyer një situatë nga të sikletshme në një atmosferë plot me të qeshura,



vetem më një koment, ma zbukurojnë ditën. Sa herë mendoj shqyrr që të kam ty në bankë në lëndët shoqërore se nuk e di si do t'i shtyja. Jam shumë me fat që të kam shoqe dhe faleminderit që ma bënë ardhjen në shkollë më të pranueshme! Shpresoj të të shoh gjithnjë të lumtur e sa më lart dhe të bëhesh avokatja më e aftë! Të kam shumë xhan! PS: Jam e sigurt që do e marrësh italishten kështu që mjaft u stresove.

Keid Mersini-Mund të them me plot bindje se njohja jonë ka qenë një ndër më të bukurat të cilën do ta vecoja për disa arsye. Ke qenë aty për mua gjatë gjithë kësaj kohe dhe ditë pas dite i ke vërtetuar vecantitë e tua. E vetmja gjë që ka ngelur është të rritesh pak se ngele e vogël, më pas të tjerat i rregullojmë. Të përqafoj, Keidi



Megi Musta- Je një njeri që çdokush do të donte të kishte pranë e të të kishte shoqe. Jam shumë e lumtur që kemi kaluar tre nga vitet më të veçanta të jetës sonë së bashku. Kam nisur çdo mëngjes, ditën me pozitivitet bashkë me ty dhe e kam mbyllur atë me buzëqeshjen tënde të ëmbël. Më pëlqen pozitiviteti yt dhe mënyra se si gjithmonë bën gjënë e duhur dhe me qetesinë më të madhe arrin t'ia dalësh mbanë. Do të dëshiroja shumë që shoqëria jonë të vazhdojë edhe në vitet që vijnë dhe të mos humbasim kontaktin së bashku sepse ti je një njeri shumë i veçantë për mua. Të uroj suksese në gjithçka që të pret!

Sindi Rraja- Vesa një ndër vajzat më të edukuara të klasës. Me ty kam një shoqëri goxha të ngushtë, i kemi qëndruar njëra-tjetrës pranë kur kemi pasur nevojë, kemi qarë shumë "halle" bashkë dhe shumë gjëra të tjera që nuk do i harroj kurrë. Je një njeri që çdokush do dëshironte ta kishte në shoqërinë e tij. Të uroj shumë sukses në atë cka do të bësh dhe shpresoj shumë që një ditë të jemi dhe kolege. Të pucc!!

Ergysa Reka-Vesuuuuu nuse bukurrrr! Në këto tre vite gjimnazi ti ishe një shoqe që më ke ndenjur gjithmonë pranë me pozitivitetin tënd që nuk mungonte kurrë. Kemi kaluar shumë momente si të lumtura dhe të trishta të cilat na mësonin shumë për njëra-tjetrën. Krahas momenteve të bukura dhe të zënata nuk kishin fund por dinim ti kalonim si të parëndësishme duke mos i lejuar të ndikonin tek shoqëria jonë. Ves do më mungojnë shumë të gjitha bisdat me ty por ky nuk është fundi do të më kesh në krah për çdo gjë. Nuse të uroj sa më shumë suksese dhe shpresoj të arrish çdo gjë që ti dëshiron.




Matura 2024









Greljon Zaimi

Të dashur nxënës të klasës 12D,

Sot, ndërsa po përshkojmë një nga momentet më të rëndësishme të jetës suaj, dua t'ju shpreh mirënjohjen dhe krenarinë time të thellë për të gjithë ju. Këto vite që kemi kaluar së bashku në gjimnaz, nga momentet e para të vitit të dytë ,deri te mbrëmja e maturës, kanë qenë të mbushura me përvoja të paharrueshme, sfida të kapërcyera dhe suksese të arritura.

Në veçanti, dua të përmend angazhimin tuaj të palodhur në organizimin e aktiviteteve të klasës, si dhe përpjekjet tuaja të vazhdueshme për të ndihmuar njëri-tjetrin. Ju keni treguar një shpirt të jashtëzakonshëm bashkëpunimi dhe solidariteti, duke bërë që klasa jonë të jetë më shumë se thjesht një grup nxënësish, por një familje e vërtetë.

Kujtoj me mall ekskursionet tona, ku keni treguar gjithmonë sjellje të shkëlqyera dhe një frymë grupi të pashoq. Gjithashtu, debatet e zjarrta në klasë kanë qenë një tjetër tregues i pasionit dhe mendjemprehtësisë suaj. Një detaj që nuk mund ta harroj është fakti që, nëse dikush nga grupi: Brian, Arlind, Brajan, Bajram, apo Brendon ,merrte leje, ishte e sigurt që edhe të tjerët do të vinin për të kërkuar leje menjëherë pas tij. Sarës dhe Nicole distanca nga porta e shkollës deri në klasë ,që ju duhej 20 minuta për ta bërë. Brian, betimet e tua se ishte hera e fundit që vije pa uniformë, dhe Arlind, premtimet e tua se berberi nuk ishte aty dhe se do ta hiqje mjekrën ditën e premtë, Joana, vendosmëria jote për të më mbushur mendjen që nuk ishit në dijeni për quize që zyshat jua rikujtonin çdo orë mësimi. Kutia e telefonave që nuk u plotësua asnjëherë. Falë jush, unë mësova artin e negocimit, pasi çdo ditë më është dashur të negocioj me zyshat për të justifikuar një prej jush. Si mund të harroj pa përmendur debatet e vazhdueshme me ju në lidhje me rregulloren e shkollës? Asnjëherë nuk ju binda dot që rregullorja është bërë për t'u zbatuar. Vendet e uljes nëpër banka ishin një sfidë më vete; edhe atëherë kur e bëja planin sipas dëshirave tuaja, ai plan nuk u zbatua kurrë. Por më e rëndësishmja, ishin përpjekjet e mia të vazhdueshme për t'i bindur zyshat që ju ishit nxënës shumë të mirë, por ato nuk ju kishin njohur ende plotësisht.

Ndërsa ju përgatiteni për të hapur kapitullin e ri të jetës suaj, dua t'ju inkurajoj që të ndiqni ëndrrat tuaja me guxim dhe vendosmëri. Mos harroni asnjëherë se jeni të aftë për të bërë gjëra të mëdha dhe se çdo sfidë është një mundësi për t'u rritur dhe për t'u përmirësuar.

Ju falënderoj nga zemra për besimin që keni pasur tek unë si mësuesin tuaj kujdestar. Uroj që për çdo hap që do të hidhni në të ardhmen,t'ju sjellë suksese dhe lumturi të pafund.

Me shumë dashuri dhe respekt,



Kristian Ndreu

Sindi: Kristian, më vjen mirë që ramë në klasë bashkë dhe unë arrita të të njoh më mirë. Je një djalë shumë i mirë dhe të uroj shumë suksese. Shpresoj t'i arrish të gjitha ëndrrat e tua në jetë.

Sakistjo: Horri, kur erdhe në fillim, nuk shoqëroheshim shumë, por me kalimin e kohës e gjetëm komunikimin dhe u afruam shumë. Je një tip i dashur që bën shumë për shoqërinë, dhe kjo është arsyeja që u afruam bashkë, shokë me karaktere të njëjta pra. Je një çun gjigand dhe shumë shakaxhi, dhe gjithmonë nuk më le vetëm për të bërë shaka me shokët e tjerë të klasës. Vazhdo të jesh kështu siç je, shok, dhe më beso që intuita ime që ti do arrish majat nuk gënjen. Fundja, meriton më shumë se arritjen e majave. Të uroj shumë suksese, shok, dhe uroj shumë që shoqëria jonë të zgjasë edhe pas gjimnazit.

Nicole: Kristian, një person modest dhe i qeshur me të gjithë. Të uroj suksese në vitet në vazhdim!

Joana: Je një nga djemtë më të mirë që njoh. Gjithmonë i gatshëm për debate konstruktive me zyshat, por edhe për të na dhuruar të qeshura pafund. Të uroj shumë suksese kudo në jetë!

H: Kristian Ndreu, je një tip shumë pozitiv dhe, edhe pse të kam njohur këtë vit, je treguar shumë miqësor. Të uroj suksese në vazhdim.

Arbi: Kristian Ndreu, nuk kemi folur aq shumë gjatë këtij viti shkollor, por me aq sa të kam njohur kam kuptuar që je një djalë i respektueshëm dhe me shumë vlera. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Denis: Kristian, erdhe këtë vit dhe u përshtate goxha

shpejt me klasën. Je një nga njerëzit më të maturuar që unë kam takuar, dhe je goxha gjakftohtë në situata tensionuese. Shpresoj të kesh sa më shumë sukses dhe lumturi në të ardhmen.

Bajram: Kristian Ndreu, megjithëse nuk kemi shumë që jemi njohur, je person shumë i mirë dhe i respektueshëm. Shpresoj të arrish gjithçka që dëshiron. Suksese, nga Bajrami.

Katrin: Kristian, gjithmonë i qeshur dhe na përcjell pozitivitet. Ishe gjithmonë i gatshëm të na ndihmoje me detyra dhe na shton humorin me shakatë e tua. Të uroj suksese në shkollë dhe kudo në jetë.


Brajan: Kristian Ndreu, jam me fat që kam gjetur një shok si ti. Kristian, miqësia jote e sinqertë është një pasuri e vërtetë. Të uroj gjithë të mirat dhe shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Brendon: Kristian është një mik i besueshëm dhe i sjellshëm. Ai është gjithmonë i gatshëm të ndihmojë të tjerët. Kristian gjithashtu ka një karakter shumë të veçantë dhe të ndihmon në çdo situatë. Dhe ta dish që ne përherë do të jemi më të mirë në FIFA se Brajani dhe Arlindi sepse ata nuk dinë as të luajnë, hahahaha. Shpresoj që të kalojmë edhe shumë kohë të bukura së bashku dhe të mbajmë këtë miqësi që kemi edhe në të ardhmen.

Arlind: Je një djalë sa pozitiv aq edhe serioz. Nuk kemi shumë që njihemi, por kemi krijuar marrëdhënie të mira shoqërore. Shoqëria jonë është krijuar për shkak të një aftësie të përbashkët, prandaj ke fituar dhe pseudonimin LORDI I B. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë edhe pas shkollës.

Sara: Edhe pse nuk njihemi prej shumë kohësh, di të them se je një djalë shumë i mirë dhe i sjellshëm me të gjithë. Do t'i kujtoj gjithmonë momentet e bukura që kemi kaluar bashkë në shkollë dhe bisedat e shumta që kemi pasur. Je gjithmonë pozitiv dhe nuk e vret mendjen për gjëra të kota. Të uroj shumë suksese në të ardhmen! :)

Neki: Viti i parë që ne jemi në klasë bashkë. Megjithëse nuk të njoh shumë mirë, ke qenë i gatshëm në çdo moment për kafe, xhiro, bixhoz, murlan, etj. Je djalë i respektueshëm dhe një dëgjues i mirë. Shpresoj që të ecësh sa më lart në jetë sepse e meriton. Unë të uroj të gjitha të mirat.



Brajan Nesim

Anisa - Një djalë i sjellshëm dhe i qetë. Besoj se karakteri yt pozitiv do të bëjë të arrish gjithçka që do në jetë. Suksese!

Bajrami - Do na mungojë karakteri yt bashkëpunues, por mbi të gjitha aftësitë e tua në futboll. Shpresoj që të të ecë mbarë në çdo rrugëtim që do të ndërmarrësh në jetë. Suksese!

Nicole - Një person i urtë dhe modest. Gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar dhe për të dhënë një dorë ndihmëse. Të uroj suksese në vitet në vazhdim!

Bjorni - Ashtu si vëllai yt, ke të njëjtin karakter dhe aftësi në sporte të ndryshme, por ti je më i hapur dhe miqësor me të tjerët. Të uroj suksese në të ardhmen!

Sara - Je një djalë shumë i mirë dhe i sjellshëm me të gjithë. Jam shumë e lumtur që ramë përsëri në klasë bashkë sepse je një shok shumë i mirë. Kurrë nuk do të harroj të gjitha momentet e bukura që kemi kaluar bashkë me të tjerët në klasë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Katrin - Djalë i mirë dhe i sjellshëm. Është i gatshëm të na ndihmojë dhe të na përcjellë pozitivitetin që e shfaq me të gjithë nxënësit e tjerë në klasë. Suksese!

Briani - Dua të të tregoj se sa i çmuar je për mua si shok. Ti je gjithmonë i gatshëm të ndihmosh dhe gjithmonë sjell një buzëqeshje në fytyrën time. Faleminderit që je gjithmonë aty për mua. Shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë të rritet dhe të zgjasë për shumë vite.

Keiti - Je një shok shumë i mirë dhe i qetë. Më pëlqen pozitiviteti që përcjell gjithmonë. Suksese kudo në

jetë!

Joana - Do të të kujtoj gjithnjë si një nga nxënësit më sportivë të klasës. Veç kësaj, je një djalë i sjellshëm dhe i zgjuar, ndaj të uroj shumë suksese në të ardhmen.

Sindi - Je një djalë shumë i sjellshëm dhe i mirë, ke disa vlera shumë të mira si person që unë do jem përherë mirënjohëse. Të uroj shumë suksese në rrugëtimin tënd!


Arlindi - Je një djalë shumë i mirë dhe një shok i shkëlqyer. Pozitiviteti yt të bën një njeri të veçantë. Bashkë kemi kaluar shumë kohë dhe do të vazhdojmë të kalojmë mirë. Që do të shikohemi as që nuk diskutohet. Të uroj të gjitha të mirat e kësaj bote!

Brendon - Brajan, vëllai im, në këtë rrugëtim të jetës, ku të dy jemi bashkëpunues në një histori të përbashkët, dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjitha momentet e shkëlqyera që kemi kaluar bashkë. Faleminderit që ke qenë një pjesë kaq e rëndësishme në jetën time, për mbështetjen dhe mirëkuptimin. Nga ditët e vështira deri te ato të lumtura, ti je gjithmonë aty, duke më inkurajuar, duke më ndihmuar dhe duke më bërë të ndjehem i rëndësishëm. Këto momente të përbashkëta janë thesari im më i çmuar dhe një kujtim që do të ruhet gjithmonë në zemrën time. Me shpresën që të vazhdojmë të shkruajmë bashkë këtë vëllazëri, me dashuri dhe me respekt. Brajan, nëpërmjet lidhjes sonë të thellë vëllazërore, çdo ditë bëhet një aventurë e bukur dhe një përvojë e çmuar. Faleminderit për qëndrimin tënd të përkushtuar dhe për mbështetjen gjatë kësaj kohe. Vlerësoj thellësisht çdo moment të kaluar bashkë dhe shpresoj që vëllazëria jonë të vazhdojë të rritet dhe të forcohet me kalimin e kohës.

Eskobari - Brajan, ti bashkë me vëllain tënd jeni djem shumë të mirë, përherë të qeshur dhe shumë pozitivë. Ju uroj shumë suksese në të ardhmen!

Arbi - Përveç ngjashmërisë nga ana e jashtme, jeni të ngjashëm edhe nga karakteri. Jeni djem shumë të edukuar dhe të sjellshëm. Përveç këtyre, jeni dhe një nga njerëzit më atletik që kam njohur ndonjëherë. Ju uroj të dyve shumë suksese në jetë!

Denisi - Ti je më i qeti nga binjakët, por kjo s'do të thotë asgjë. Je një nga çunat më sportivë që kam njohur ndonjëherë, duke luajtur çdo orë fiskulture në një nivel të lartë. Sa herë që e jep opinionin tënd, ka qenë gjithmonë i saktë. Shpresoj që ti me vëllain të keni sa më shumë vite lumturi.



Brendon Nesim

Sakistjo - Je një djalë shumë i mirë dhe i shoqërueshëm, ofrohesh gjithmonë në diskutime dhe shpesh qeshim me situatat që ndodhin. Je një djalë i urtë dhe i vendosur. Të uroj suksese në jetë.

Anisa - Një djalë i përkushtuar dhe pozitiv. Je gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar. Përpara ke një të ardhme të ndritur. Suksese!

Nikoli - Një person i sjellshëm dhe modest, si tani ashtu edhe në nëntëvjeçare. Gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar. Të uroj suksese në vitet në vazhdim!

Bjorn Tupi - Je një tip i veçantë dhe ke një lidhje të fortë me sportet si volejboli dhe futboli. Mendoj që duhet ta vazhdosh talentin tënd dhe të uroj suksese në universitet.

Katrin - Një nga binjakët më të sjellshëm dhe pozitivë që kam njohur. Je gjithmonë i gatshëm t'i ndihmosh të gjithë dhe të na përcjellësh mirësinë që të karakterizon. Suksese

Sara - Brendon, je një djalë shumë i sjellshëm dhe i mirë, ashtu siç ke qenë që në nëntëvjeçare. Do më mungojnë të gjitha momentet e bukura që kemi kaluar bashkë dhe shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë edhe në të ardhmen. Të uroj shumë suksese!

Joana - Ndryshe nga vëllai, do të të kujtoj edhe për bisedat e gjata kur bashkë me Arlindin ankoheshim për kiminë. Ti je shumë punëtor dhe besoj se emrin tënd do ta dëgjoj sërish në të ardhmen si një nga arkitektët më të mirë në vend.

Brian - Faleminderit që ke qenë gjithmonë aty për

mua dhe për të ndarë momente të mrekullueshme bashkë. Ti je një shok i vërtetë dhe i çmuar për mua. Gjithmonë mund të mbështetem tek ty në raste të vështira.

Sindi - Jam shumë e lumtur që të kam njohur, ma ke bërë vitin e fundit edhe më të bukur. Je një djalë dhe shok shumë i mirë për mua, Brendon. Të uroj shumë suksese dhe lumturi!

Arlindi - Je një nga djemtë më pozitivë që kam njohur ndonjëherë, një djalë i mirë dhe mbi të gjitha një shok i mrekullueshëm. Me ty kam kaluar momente të paharrueshme dhe jam i sigurt që shoqëria jonë do të vazhdojë. Je djalë i mirë në çdo aspekt, por ke edhe një gjë të keqe që je me Milanin. Ndërro ekip, lale! Të uroj të gjitha të mirat e kësaj bote!

Arbi - Përveç ngjashmërisë nga ana e jashtme, jeni të ngjashëm edhe nga karakteri. Jeni djem shumë të edukuar dhe të sjellshëm. Përveç këtyre, jeni dhe një nga njerëzit më atletikë që kam njohur ndonjëherë. Ju uroj të dyve shumë suksese në jetë.

Eskobari - Ti bashkë me vëllain tënd jeni djem shumë të mirë, përherë të qeshur dhe shumë pozitivë. Ju uroj suksese!

Brajan - Nëpërmjet viteve që kemi kaluar bashkë, marrëdhënia jonë është përhapur si një rrëfim i pasur me ngjarje dhe emocione të pashmangshme. Nga ditët e para të fëmijërisë deri te sfidat dhe gëzimet e rritjes së të dyve, ti je bërë më shumë se vetëm një vëlla - je një mik i ngushtë, një shok i vërtetë dhe një bashkëudhëtar i pandashëm në udhën time të jetës. Faleminderit për qëndrueshmërinë tënde, për dashurinë dhe mbështetjen e pafund që më jep gjithmonë. Me humorin tënd të këndshëm dhe vëmendjen tënde të ngrohtë, ti bën çdo ditë të jetë një aventurë e padukshme. Bashkë do të shkojmë përtej çdo sfide që na vjen përpara, sepse bashkë është më e lehtë të përballohem me jetën dhe të përjetojmë çdo kënaqësi që na sjell. Vlerësoj thellësisht çdo moment të kaluar bashkë dhe shpresoj që vëllazëria jonë të vazhdojë të rritet dhe të forcohet me kalimin e kohës.

Denisi - Edhe ti si Brajan je goxha i qetë, por më i hapur me mendimet e tua. Po si ai, aftësitë e tua sportive janë fantastike në çfarëdolloj sporti të mundshëm. Jam i sigurt që në të ardhmen do të kesh sukses.



Raneem Alsafarti

Melis Albayrak: Raneem, humbas përherë sensin e kohës kur jemi bashkë. Aq shpejt kanë kaluar vitet që kur u njohëm, sa që nuk më besohet se tashmë jemi maturante. Më habit se sa jemi afruar në një periudhë kohe aq të shkurtër. Aq shumë sa të gatujmë në shtëpitë e njëra-tjetrës apo të vizitojmë vende të tjera me familjet e njëra-tjetrës. Çdo aktivitet që kemi bërë bashkë kanë qenë nga më të këndshmet. Nuk doja aspak të mbaronte ky vit shkollor, pasi ai është i fundit që ne do të kalojmë bashkë. Por çdo gjë e kënshme e ka një mbarim. Prandaj, si mbyllje të këtij kapitulli, doja të të shprehja se sa shumë dua të të kem të pranishme në jetën time edhe pasi të mbarojë shkolla e mesme. Jam e lumtur që pata shancin të kisha një shoqe si ti, që më mbështet në çdo gjë dhe më dëgjon kur kam nevojë. Momentet tona, si në shkollë apo jashtë shkolle, nuk do të më fshihen kurrë nga mendja. Mos të të prishet asnjë dëshirë kankam! Gjithmonë qëndro si ajo vajza e çiltër dhe e hareshme që je. Suksese kudo të shkosh në jetë!

Sara Çollaku: Raneem, je një shoqe shumë e mirë dhe e drejtpërdrejtë. Kemi kaluar gati dy vite bashkë në gjimnaz dhe, edhe pse nuk kemi patur gjithmonë relatat më të mira, e di që kurrë nuk kemi hatërmbetje. Do më mungojnë opinionet e tua të sinqerta për çdo gjë që të pyesja. Shpresoj të arrish shkollën që dëshiron dhe të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Anisa Haldeda: Raneem, ky është viti i dytë që jemi në klasë bashkë, dhe je vajzë shumë pozitive dhe e dashur. E vlerësoj sinqeritetin dhe humorin tënd. Të uroj shumë suksese!

Sindi Nikolli: Raneem, je një vajzë shumë pozitive dhe e mirë. Gjithmonë kemi kaluar mirë bashkë dhe

shpresoj që edhe pas gjimnazit të kalojmë ditë të bukura përherë. Të uroj shumë suksese në jetë!

Nicole Kolaveri: Raneem, të njoh prej plot dy vitesh tashmë dhe mund të them se sjellja jote miqësore dhe shakatë tua nuk dështojnë kurrë të më rrisin humorin, veçanërisht në ato ditë të vështira kur një e qeshur e mirë është shumë e nevojshme. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Marina Peshtani: Raneem, jemi njohur së bashku këtë vit dhe të shoh si një vajzë shumë pozitive. Gjithmonë thua diçka që ma rrit humorin dhe më pëlqen shumë muhabeti që bëj me ty. Të uroj sa më shumë suksese në jetë.

Eliora Qëndro: Raneem, je një vajzë e dashur, e çiltër dhe e urtë. Të uroj shumë suksese në jetë kudo që të shkosh!

Bajram Kuqi: Raneem, edhe pse nuk njihemi shumë mirë, ti ke qenë një vajzë ndihmuese dhe e sjellshme. Të uroj suksese të mëtejshme.

Arbi Çiftja: Raneem, je një vajzë e qetë, e sjellshme dhe me shumë vlera. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Sakistjo Meraj: Raneem, nuk të njoh shumë mirë, por në pak raste që kemi biseduar kam kuptuar zemërmirësinë dhe zgjuarsinë tënde. Të uroj shumë suksese në jetë.

Rea Agalliu: Raneem, në fillim të vitit të tretë ne patëm një keqkuptim dhe mendova se nuk do të bëheshim shoqe, por gjatë kohës që kemi kaluar bashkë, ti më ke provuar të kundërtën. Tani jemi shumë shoqe dhe me ty kaloj shumë bukur. Shpresoj të të realizohet çdo ëndërr që ke, Raneem.

Tuana Hoxha: Raneem, nuk më besohet akoma që do ikësh këtë vit. Më duket sikur do jesh përsëri këtu vitin tjetër. Ne kemi katër vite që njihemi dhe kemi kaluar shumë momente të bukura bashkë. Do më marrë malli për çdo ditë të lumtur që kam kaluar me ty. Ndoshta do ikësh shumë larg dhe ne nuk do kemi mundësi të takohemi, kështu që do më premtosh se do më shkruash dhe do më bësh update për gjënë më të vogël. Je një vajzë shumë e dashur dhe e zgjuar. Jam me fat që të kam njohur dhe të kam shoqe të ngushtë. Uroj që miqësia jonë të mos mbarojë asnjëherë dhe të uroj shumë suksese në të ardhmen!



Melis Albayrak

Raneem Alsafarti – Melis, asnjëherë në jetën time nuk kam qenë aq e afërt me dikë aq sa jam me ty. Aq e afërt më je bërë sa që as babai im nuk ta harron emrin. Kur jemi pranë njëra-tjetrës, koha kalon aq shpejt sa që gati nuk e ndjej që po kalon. Nuk më besohet se jemi në klasën e dymbëdhjetë tashmë. Më kujtohet kur uleshim e flisnim për t'u maturuar e na dukej larg, por ja ku jemi. Shkolla, momentet e kaluara jashtë shkolle, ato të kaluara në shtëpitë e njëra-tjetrës e më shumë, përherë do të jenë si momentet më të bukura në mendjen time. Edhe pse ky vit po mbaron dhe ne mbase nuk do të vazhdojmë në të njëjtin universitet, nuk dua të humbasim kontaktin e njëra-tjetrës. Të falenderoj shumë për ndihmën tënde dhe mbështetjen që më ke dhënë kur më nevojitej. Jam e lumtur që kam një shoqe si ti. Gjithashtu doja të të falenderoja kur më ke ndihmuar me problemet e mia, qofshin të vogla apo të rëndësishme. Të dua shumë dhe uroj të të realizohen të gjitha ëndrrat! Të uroj plot sukses në të ardhme!

Tuana Hoxha: Sa vura re, kemi shtatë vite që njihemi! Që nga fillimi ne kemi qenë shoqe shumë të mira dhe miqësia jonë është forcuar vit pas viti. Je një vajzë shumë e lezetshme, e dashur dhe e guximshme. Kohët e fundit të kam parë të stresohesh në disa tema dhe mërzitem kur nuk e shoh më energjinë që ke pasur më parë. E kuptoj që është viti i fundit dhe ndihesh e mërzitur, por gjithashtu duhet të mendohesh dhe të bësh plane për të ardhmen. Jam shumë krenare për ty dhe thjesht dua të dish se je duke bërë më mirë se çfarë mendon. Kemi kaluar momente nga më të ndryshmet, të lumtura dhe të mërzitura, të falenderoj për çdo kohë dhe çdo ditë që ke ndenjur me mua dhe më ke bërë të ndihem e lumtur dhe e sigurt kur nuk kam qenë. Nuk më besohet fare që do të diplomohesh

dhe do ikësh nga shkolla. Jemi mësuar aq shumë të bëjmë xhiro çdo pushim sa që më duket sikur vitin tjetër do të jesh përsëri këtu. Besoj se do të vazhdojmë të flasim ditë për ditë, ashtu siç flasim çdo ditë në shkollë (të paktën do kemi tema të tjera për të folur). Uroj të mos humbasim kontakt asnjëherë, gjithashtu të uroj shumë, shumë suksese në të ardhmen!

Marina Peshtani: Melis, të kam pasur në klasë dhe në vit të parë dhe me sa duket do e mbyll gjimnazin me ty! Je një vajzë e qetë dhe shumë e sjellshme. Ndihem mirë që jemi afruar me njëra-tjetrën këtë vit. Gjithmonë i ke bërë orët e fizikës më të këndshme me historitë dhe shakatë tua. Shpresoj të kesh sa më shumë suksese më tej!

Nicole Kolaveri: Melis, të njoh që në fillore dhe jam e lumtur që kemi qëlluar prapë bashkë në klasë. Është pothuajse qesharake se si ne përfundojmë vazhdimisht në të njëjtat grupe projektesh. Puna në grup dhe bashkëpunimi mund të jenë të lodhshme, por mund të them që ti e bën procesin më të lehtë. Faleminderit për ndihmesën dhe mirësinë tënde. Të uroj suksese në vazhdim!

Anisa Haldeda: Melis, të kam njohur që në klasën e parë dhe ke qenë gjithmonë një vajzë e urtë, e zgjuar dhe një shoqe shumë e mirë. Jam e lumtur që kemi kaluar dy vitet e fundit të gjimnazit së bashku. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Sara Çollaku: Melis, ky është viti i dytë i yni dhe mund të them se je një njeri shumë i qetë dhe i mirë. I përkushtohesh shkollës dhe ke shënimet më të rregullta se të gjithë ne. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Sakistjo Meraj: Pavarësisht se nuk jemi shoqëruar shumë, duke qenë se nuk njiheshim më parë, me aq sa shoh je një vajzë e zgjuar dhe e vendosur në atë që do të bësh dhe të thuash. Të uroj suksese të mëtejshme.

Denis Faqolli: Melis, nuk kemi pasur shumë biseda gjatë të dyja viteve që kemi qenë bashkë në një klasë, por nga larg më je dukur një vajzë e sjellshme e cila shikonte punën e saj. Shpresoj të kesh sukses në vitet në vazhdim.



Nicole Kolaveri


Anisa: Niki, ti je një shoqe e veçantë, gjithmonë e sinqertë dhe besnike. Jam me fat që të kam në jetë. Mbaj mend ditën kur u bëmë shoqe në klasën e parë dhe që prej atëherë jemi rritur e kemi kaluar çdo fazë së bashku duke ndarë plot kujtime të bukura. Pavarësisht ndryshimeve që kemi në personalitet dhe shije, balancojmë njëra-tjetrën. Ke qenë dhe shoqja ime e bankës gati gjithë gjimnazin dhe bisedat tona të pafundme i bëjnë orët të kalojnë më shpejt. Nga rastet kur flisnim me pasion për temat më të parëndësishme, tek ato që realisht kishin thelb e na maturuan. Gjithmonë ndihem e lirë të jem vetvetja e të flas për gjithçka me ty dhe për këtë jam shumë mirënjohëse. Më ke dhuruar një shoqëri pa kushte e pa interes. Teksa po afrohet matura, dua të të falënderoj për çdo shtysë e çdo këshillë që më ke dhënë, pasi jam çik e pavendosur, dhe që gjithmonë je aty për mua me dashuri dhe mbështetje. Mezi pres të ndajmë sa më shumë memorje së bashku. Të kam shumë xhan dhe të uroj një të ardhme plot sukses dhe lumturi!

Sara: Miqësia jonë ka filluar në një mënyrë shumë të papritur, mendoj për të dyja ne. Njiheshim që në fillore, por kurrë nuk kishim folur bashkë. Nicole më dukej një tip gjykues, të cilin nuk e pëlqeja dhe mendimi im për të ishte shumë pasiv. Shoqëria jonë nisi befasisht në klasë të tetë kur, pas disa bisedave në klasë, në një test që kisha, duhej të kisha lexuar librat e “Harry Potter”, gjë të cilën nuk e kisha bërë. Mbaj mend që i kishe parë filmat dhe vendosa të të telefonoja. Aty kuptova kush ishte sepse nuk ngurove të më ndihmosh, gjë të cilën jo të gjithë do e bënin, për më tepër kur sapo ishin zgjuar nga gjumi. Shoqëria jonë vazhdoi gjatë kohës së karantinës, ku edhe pse larg, ditët e mija nisnin duke luajtur lojëra me ty në telefon. Flisnim gati gjithë kohës dhe ti kurrë nuk ngurove të më ndihmoje me

çdo problem që unë kisha, edhe me ato për të cilat të kisha folur plot herë. Ke qenë gjithmonë aty për mua dhe këtë unë e vlerësoj shumë, është diçka për të cilën do të jem gjithmonë mirënjohëse sepse pa ty do isha një njeri shumë i pavendosur. Bashkë kemi ndarë momentet më të bukura, si dhe ato më të çuditshmet, të cilat i kujtoj gjithmonë me mall. Je një shoqe me të vërtetë shumë e mirë, tek e cila e di që gjithmonë më bën të ndihem më mirë, edhe ndoshta pa e kuptuar dhe pa bërë asgjë konkrete. E di që ke shumë plane për të ardhmen dhe jam shumë e sigurt që do mundesh t'i arrish të gjitha (vetëm mos u bëj kokëfortë). Të uroj shumë suksese dhe mezi po pres të shoh rrugëtimet tona në universitet. Të premtoj se do të jem gjithmonë aty për ty në mënyrat e mia pak të pazakonshme ama. Të kam shumë xhan, Nik.

Melis: Nicole, do të të kujtoj përherë si ajo vajza konfidente dhe e vendosur në atë që thotë. Mbase kemi pasur një “inat” fëmijësh në fillore, por fakti që i kemi kaluar ato faza më bën të kënaqur. Kurrë s'do të më shkonte ndërmend që vitin e fundit do ta mbyllja me ty që nisa jetën time shkollore me. Të uroj suksese kudo në jetë!

Marina: Sapo të kam njohur këtë vit dhe më je dukur si një vajzë shumë e sjellshme dhe e zgjuar. Bisedat me ty janë gjithmonë shumë argëtuese dhe interesante. Të uroj sa më shumë suksese në jetë dhe shpresoj të arrish të ardhmen që dëshiron!



Alvis Qëndro

Gledis Arapi: Visi, u bënë dy vite shoqëri edhe më duket sikur kam një jetë me ty. Kemi kaluar aq momente të mrekullueshme plot të qeshura që nuk do t'i harroj ndonjëherë. Faleminderit për çdo këshillë që më ke dhënë dhe që më ke ndenjtur afër në çdo moment. Gjithmonë do të mbahesh mend tek unë si ai shoku që gjithmonë të bën për të qeshur dhe që ke qenë gjithmonë i sinqertë me mua. Nuk po zgjatem shumë se vitin tjetër po bashkë do jemi. Të kam shumë xhan dhe shpresoj që të të realizohen të gjitha dëshirat në jetë!

Brajan Nesim: Alvis, jam me fat që jemi në të njëjtën klasë! Me ty, çdo ditë bëhet më interesante dhe je i gatshëm të ndihmosh të tjerët.

Brendon Nesim: Alvis është një njeri intelektual dhe i përkushtuar në punën e tij. Ai është gjithmonë i gatshëm të ndihmojë të tjerët me sfidat e tyre të punës dhe është një shok i shkëlqyeshëm.

Bajram Kuqi: Ke qenë gjithmonë mirëkuptues, i sjellshëm dhe i respektueshëm. Je ideali i një shoku të mirë. Shpresoj të arrish gjithnjë e më lartë. Suksese, nga Bajrami.

Sara Çollaku: Alvis, je një djalë shumë i mirë dhe pozitiv, gjë të cilën e vlerësoj shumë. Do më mungojnë të gjitha momentet e bukura dhe qesharake që kemi kaluar bashkë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Joana Taraj: Alvis Qëndro, je një nga djemtë më pozitivë që njoh dhe i vetmi që bën të gjithë ata që ke në krah të ndihen më mirë. Të uroj shumë suksese në çdo hap të jetës!

Eliora Qëndro: Alvis, ti jo vetëm je një kushëri i mirë, por edhe një shok fantastik. Je gjithmonë gati për të bërë ndonjë muhabet dhe për të shpërndarë pozitivitet. Këto vite që kemi kaluar së bashku kam kuptuar sesa njeri i dhimbsur që je ndaj të tjerëve dhe mund të them që është një cilësi e mirë e jotja. Të uroj shumë suksese në jetë dhe të jesh gjithmonë i lumtur!

Keit Gjata: Alvis Qëndro, je një shok shumë i mirë që çdo kush do ta donte. Ti të ndihmon në çdo rast kur ke mundësi dhe je shumë i sjellshëm dhe i qeshur. Të uroj suksese të mëtejshme!

Katrin Gjata: Alvis, je një djalë pozitiv dhe një shok shumë i mirë. Jam me fat që të kam njohur dhe shpresoj që t'i realizosh të gjitha dëshirat e tua. Suksese!

Denis Faqolli: Alvis, kemi qenë për shumë vite shokë klase dhe kemi njohur kualitetet tona gjatë viteve së bashku. Je një person i qetë dhe që di kur duhet të flasësh. Shpresoj që të kesh suksese në jetë.

Arbi Çiftja: Alvis, bashkë kemi që në klasë të gjashtë që njihemi dhe u bëmë shumë vite në klasë. Pavarësisht se nuk kemi ndenjtur aq shumë bashkë, me sa të kam njohur je një djalë shumë i mirë dhe i sjellshëm. E them këtë gjë pasi në gjithë këto vite nuk të kam parë asnjëherë të debatosh ose zihesh me dikë në klasë. Të uroj shumë sukses!

Sakistjo Meraj: Alvis, je një djalë i zgjuar dhe i vendosur. Nuk përzihesh në çdo situatë dhe mban vendin tënd aty ku të takon. Je tip i shoqërueshëm dhe i kujdesshëm. Ofron gjithmonë ndihmë. Jam i sigurt që do të arrish shumë në jetë dhe të uroj shumë suksese në këtë udhëtim!

Sindi Rraja: Visi! Jam shumë me fat që të kam njohur! Edhe pse pak vonë, ne kemi kaq shumë memorije bashkë! Je një djalë shumë i sjellshëm, i dashur dhe me ty e kam shumë të lehtë të flas. Zemra ime, të kam shumë xhan! Të uroj shumë sukses në vazhdim, Vis!

Megi Musta: Je djali më pozitiv dhe më i mirë që kam njohur. Nuk e di se si u bëmë kaq miq të mirë, por diçka që di me siguri është se ti je një njeri shumë i rëndësishëm për mua. Të vlerësoj shumë për karakterin që ke dhe dua të të them që qëndro kështu e mos ndrysho për asgjë. O, Visi, sa do më marrë malli për mëngjesin tek kantina së bashku, ku kemi qeshur e na ka dëgjuar gjithë shkolla. Të kam shumë xhan, Viso! Suksese! Edhe një gjë, djalë i fortë ë?



Neki Rrapaj

Sakistjo Meraj: Ky është viti i tretë që ne jemi shokë klase dhe mund të them që tashmë shoqëria jonë ka kaluar në një stad në të cilin është vështirë që të ketë diçka që mund ta prishë këtë shoqëri. Me aq sa kam njohur tek ti mund të them që je një person super karizmatik dhe çdo gjë e merr me sportivitet (ndonjëherë nuk duhet, por ne jse, gjëra që mund t'i anashkalojmë). Vetëbesimi yt është një pikë shumë e fortë e jotja, dhe pse ndonjëherë ai krijon një formë mburrjeje në mentalitetin tënd. Jam shumë i sigurt që do të bëhesh dikush në jetë, pasi je person që nuk dorëzohesh pa arritur atë për të cilën je nisur. Të uroj sukses në çdo hap të jetës, shok! <3

Joana Taraj: Je një djalë shumë i mirë, por besoj këtu ndikon dhe fakti që jemi "patriotë". Jam vërtet e lumtur që pata fatin të takoj një djalë si ti, i cili mbi të gjitha ka vlera njerëzore. Shpresoj që gjërat të të shkojnë mbarë dhe të uroj shumë sukses në jetë! Përzemërsisht, Joana.

Eliora Qendro: Je i veçantë si nga emri, por edhe nga tipi. Kam krijuar një opinion pozitiv për ty pasi je një djalë spontan dhe miqësor. Të uroj sukses në vazhdim!

Bjorn Tupi: Je një person shumë i qesharak dhe i sjellshëm. Ke shumë humor të veçantë dhe bën çdo kënd për të qeshur. Të uroj sukses në jetë.

Keit Gjata: Je një djalë shumë i mirë gjë që nuk diskutohet se je patriot. Gjithmonë më ke ndenjtur shumë afër dhe kemi folur për tema të ndryshme. Do doja që shoqëria jonë të zgjasë edhe më tej gjimnazit. Të uroj sukses kudo në jetë.

Katrin Gjata: Një ndër shokët më të mirë që kam pasur gjatë këtij viti. Të uroj më të mirat kudo që të shkosh. Do më marrë malli për shakatë e bankës së fundit dhe çdo të qeshur që kemi kaluar së bashku.

Bajram Kuqi: Je një djalë shumë pozitiv që je treguar kurdoherë ndihmues. Nuk do të harrohen shakatë e tua dhe atmosfera e lezetshme që na ke dhuruar. Të uroj suksese në jetë dhe kudo.

Brian Durici: Shoku im, Neki, ti je një mik i shkëlqyeshëm dhe një shok i vërtetë. Faleminderit që je gjithmonë aty për mua. Të uroj fat dhe sukses në jetën tënde.

Sindi Nikolli: Gjatë këtij viti ndoshta nuk kemi pasur miqësinë më të mirë si me gjithë të tjerët në klasë, por më vjen mirë që të paktën u kuptuam me njëri-tjetrin dhe tani i kemi lënë konfliktet tona në të shkuarën. Je një djalë i mirë dhe shpresoj që përherë të tregosh anët e tua më të mira që ti i ke. Të uroj shumë fat dhe sukses në rrugëtimin tënd!

Denis Faqolli: Ndryshe nga çunat e tjerë që erdhën vjet, ti gjithmonë ke qenë i qetë dhe ai që i mendonte gjërat përpara se të fliste. E gjithë klasa ka respekt për ty prej kësaj gjëje. Uroj të kesh sa më shumë sukses dhe gëzime në jetë.

Nicole Kolaveri: Je një person shumë komik. Do më mungojnë shakatë e tua që bëje gjithmonë në klasë. Të uroj suksese në vitet në vazhdim!



Marina Peshtani

Bjorn Tupi: Je një vajzë e sjellshme dhe e urtë dhe shumë e edukuar. Kemi vite që njihemi bashkë dhe kemi kaluar kohë dhe kujtime shumë të bukura. Ke pasion dhe talent vizatimin, e cila është gjëja që më ka pëlqyer gjithmonë tek ty. Sidomos pikturat që bëje gjatë verës, ato ishin ato më të bukurat dhe kishin shumë ngjyra. Të uroj shumë suksese në jetë dhe shpresoj të ecësh përpara në karrierën që ti dëshiron!
<3

Anisa Haldeda: Marina, u njohëm këtë vit, por je shumë vajzë e këndshme dhe kreative, si dhe e përkushtuar. Je treguar gjithmonë e gatshme për të më ndihmuar. Shpresoj të vazhdosh kështu dhe të uroj shumë suksese!

Melis Albayrak: Marina, ti do të ngelesh në kujtimet e mia si ajo vajza artiste që nuk i pëlqen të përfshihet në dramën e të tjerëve. Pavarësisht se jemi njohur edhe më parë, jemi miqësuar më tepër kur na vendosën në të njëjtën klasë në klasën e dhjetë, dhe tashmë po maturohemi nga e njëjta klasë. Do t'i kujtoj momentet tona në orën e fizikës apo gjatë provimeve, duke qeshur në të ardhmen. Shpresoj të ndjekësh ëndrrat e tua për t'u bërë një arkitekthe e denjë. Suksese kudo!

Nicole Kolaveri: Marina, edhe pse jemi takuar këtë vit, e kam shijuar mirësinë që sjell në klasë. Je gjithmonë aty për të ndihmuar dhe për të biseduar. Qofshin skicimet që do bësh në të ardhmen po aq të shkëlqyera sa mirësia jote. Suksese!

Sara Çollaku: Marina, edhe pse ky është viti jonë i parë në klasë bashkë, di të them se aftësitë e tua në vizatim janë mbresëlënëse. Shpresoj të arrish atë që dëshiron dhe të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Alvis Qëndro: Marina, kemi shumë vite që njihemi. Je një vajzë e qetë dhe punëtore. Të uroj shumë suksese kudo që të shkosh!

Joana Taraj: Je një vajzë e sjellshme dhe e gatshme për të ndihmuar të tjerët. Aftësitë në pikturë dhe dizajn i ke të mëdha e rrjedhimisht kështu do të jenë dhe sukseset. Uroj të arrish çfarë ti vërtet do! Joana.

Arlind Islami: Je një vajzë shumë e mirë dhe e talentuar në pikturë dhe vizatim. Shpresoj që të arrish atë çka dëshiron në të ardhmen dhe të uroj shumë suksese!

Arbi Çiftja: Këto vite që të kam pasur në klasë, kam arritur të të njoh si një vajzë të sjellshme dhe me shumë vlera. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Neki Rrapaj: Je një vajzë pozitive dhe e hapur gjithmonë për të ofruar ndihmë aty ku mundesh. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe suksese të mëtejshme.

Sakistjo Meraj: Je një vajzë e zgjuar dhe e qetë, flet vetëm në momente të zgjedhura dhe nuk ke frikë të japësh mendimin tënd. Të uroj shumë suksese në jetë.

Alesja Quku: O kaçurrelsja më e bukur e paralelit. Jam me fat që të njoh. Me qetësinë, dashamirësinë dhe humorin tënd ma zbukurove vitin e dytë të shkollës. Të falënderoj që ke qenë pranë meje dhe më ke dëgjuar për çdo gjë. Ke qenë mbështetja ime në atë klasë.

Amina Haxhialushi: Marina, ti je një vajzë shumë e mirë, e sjellshme dhe e talentuar. Jam shumë e lumtur që u njohëm dhe që ia kaluam bukur bashkë. Të uroj suksese!



Anisa Haldeda

Joana: Anisa, je një nga vajzat më të qeta të klasës dhe besoj se kjo do të të ndihmojë të arrish gjërat që do në jetë.

Sindi: Anisa, të falënderoj që përherë je treguar e sjellshme dhe e mirë me mua. Je shumë e ëmbël dhe ke një shpirt të pastër. Të uroj shumë suksese!

Sara: Anisa, je një vajzë e mirë dhe e urtë. Shoqëria ime me ty ka filluar në klasën e tetë dhe duket si diçka e pazakonshme sepse para kësaj ne nuk flisnim kurrë. E gjitha nisi kur zysha na vendosi bashkë në bankë. Ditët e mia në shkollë ishin më të bukura me ty dhe çdo moment që kalonim bashkë më bënte të kuptoja se sa shumë ngjasojmë. Me ty ndihem gjithmonë rehat dhe sikur mund të tregoj veten time pa asnjë mur rrethues. Me ty mund të sillem si fëmijë dhe ti gjithmonë më kupton pa më gjykuar, gjëra të cilat i vlerësoj shumë. Bashkë kemi kaluar çdo aktivitet shkollor sepse ti kurrë nuk ngurroje të vije me mua. Gjithmonë gjenim mënyra për t'i bërë ato më interesante dhe na shihje gjithmonë duke qeshur, edhe kur s'duhej. Në kujtimet e mia të nëntëvjeçares, gjimnazit dhe gjithë adoleshencës time (edhe pse kam bërë 18 vjeç tani) do mund ta gjesh veten gjithmonë tek njerëzit e zemrës sime, edhe pse ndoshta nuk e tregoj shumë. Mendoj që mundohem në mënyrat e mia pak të pazakonta. Të uroj shumë suksese në të ardhmen në të gjithë planet e tua dhe të premtoj se do jem gjithmonë aty për ty. Të kam shumë xhan <33

Melis: Anisa, që kur të kam njohur për herë të parë, kam patur përshtypje të mira për ty. Ke qenë gjithmonë ajo vajza e ëmbël dhe e qetë që nuk përziehet me të tjerët. Më vjen shumë mirë që po e mbyll vitin e maturës me një nga vajzat që nisa klasën e parë. Të uroj suksese

kudo në jetë!

Nicole: Kam një mijë kujtime dhe mendime të këmbyera me ty që nga klasa e parë ku të dyja i kapnim flokët bishtalec deri tani ku vetëm fotot e asaj kohe e dëshmojnë atë realitet. Nuk kam takuar ndonjëherë një person kaq të mirëkuptueshëm sa ti. Të dëgjon të flasësh për të njëjtat probleme monotone dhe asnjëherë nuk ankohet. Do doja të kisha 1% të përmbajtjes që zotëron ti. Jemi rritur së bashku dhe ndihem akoma si fëmijë sentimental duke e shkruar këtë sepse ndaj të njëjtat ndjenja nostalgjive si atëherë dhe si tani. Duke naviguar vitin e fundit që ndajmë në shkollë, nuk e di se çfarë do të bëj në vijim pa një brune të qetë por kokëfortë (e ke të lindur sepse je dem). Egoja jote e butë, humori dhe "argumentet" e tua kanë kthyer ditët monotone të shkollës në momente të çmuara. Në të ardhmen mendoj dhe e di që ke për t'i arritur të gjitha qëllimet në jetë. Të kam xhan dhe të uroj suksese!

Marina: Të kam njohur vetëm brenda një viti shkollor, ama më je dukur si një vajzë e urtë, e sjellshme dhe shumë e këndshme. Të falënderoj për ato kohë që më ke ndihmuar në shkollë. Shpresoj të kesh sa më shumë suksese më tej!

Keit: Anisa, je një vajzë shumë e qetë dhe e mirë. Më pëlqen shumë ëmbëlsia jote. Të uroj suksese kudo!

Eliora: Një vajzë e qetë dhe e ëmbël që sjell shumë mirësi në klasë. Shpresoj të realizohen të gjitha ëndrrat e tua në jetë. Suksese!

Brendon: Anisa është një vajzë e urtë dhe e kujdesshme. Ajo është gjithmonë në dispozicion për të ndihmuar dhe për të qenë një mbështetje e fortë për miqtë e saj. Të uroj suksese.

Raneem: Je një vajzë shumë e ëmbël dhe e urtë. Ke një zemër të pastër dhe nuk heziton kurrë të më ndihmosh me mësimet kur të pyes. Të uroj sa më shumë suksese në të ardhmen!

Arbi: Je një vajzë e urtë dhe shumë e sjellshme. Të vlerësoj për vlerat e shumta që ke. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Denis: U njohëm këtë vit dhe më ke lënë përshtypje të mira. Je e qetë dhe punon shumë fort gjithmonë në mësimet e tua. Të uroj sa më të mira në të ardhmen.



Bajram Kuqi

Arbi Çiftja - Vitin e kaluar nuk kemi folur shumë, por këtë vit që jemi afruar si shok kam kuptuar sa djalë me vlera dhe pozitiv je. Këtë vit shkollor kemi kaluar shumë kohë të bukura dhe të mbushura me gallata. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Kristian Ndreu - O baromooo... atë drekën në Belsh kur do ma japësh? Je një nga njerëzit që vlerësoj më shumë në klasë. Bisedat dhe batutat me ty janë përherë kënaqësi. Të uroj më të mirat!

Joana Taraj - Bashkëvuajtësi im i orës së biologjisë, të uroj më të mirat dhe shumë suksese në të ardhmen!

Katrin Gjata - Një ndër njerëzit më të mirë që njoh që na përcjell vetëm pozitivitet dhe na kënaq me shakatë e tua. Suksese në shkollë dhe kudo tjetër.

Brendon Nesim - Ti je një mik i mirë dhe i besueshëm. Kemi kaluar shumë kohë bashkë dhe kam pasur fatin të të njoh. Faleminderit për gjitha momentet e mrekullueshme!

Brajan Nesim - Ti je një mik i mirë dhe i besueshëm. Kemi kaluar kohë së bashku dhe kam pasur fatin të të njoh. Faleminderit për gjithë momentet e mrekullueshme.

Brian Duriçi - Ti je një shok i vërtetë, i cili më inspiron me guximin dhe vendosmërinë tënde. Faleminderit që je gjithmonë aty për mua dhe që më ndihmon të rritem si person. Të uroj suksese dhe lumturi në të gjitha sfidat e jetës!

Arlind Islami - Kemi qenë shokë gjatë këtyre dy viteve të gjimnazit dhe kemi kaluar shumë mirë bashkë. Je

një djalë shumë i mirë dhe me karakter të fortë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen dhe shpresoj të arrish atë çka dëshiron!

Alvis Qëndro - Këto dy vite që kaluam bashkë, ishin vite të bukura. Për aq kohë sa kemi ndenjur bashkë, do të të mbaj mend si një shok të mirë. Të uroj çdo të mirë në të ardhmen!

Keit Gjata - Bajram, je një shok shumë i mirë dhe i sinqertë. Bashkë jemi njohur në vit të dytë dhe kemi krijuar shumë momente të lezetshme. Të uroj shumë suksese.

Marina Peshtani - Bajram, je një djalë shumë pozitiv dhe i sjellshëm. Të uroj suksese në të ardhmen tënde!
Sindi Nikolli - Gjithmonë je treguar shumë i sjellshëm dhe djalë i mirë. Të uroj shumë suksese në çdo pozitë të jetës tënde!

Sara Çollaku - Bajram, je djalë i mirë dhe i qetë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Nicole Kolaveri - Një person i sjellshëm që gjithmonë ndihmon kur mundet, të bën të qeshësh dhe është gjithmonë në një humor të mirë. Të uroj çdo të mirë për vitet që do vijnë. Shpresoj që të arrish të gjitha qëllimet që ke në jetë. Shihemi!



Sindi Nikolli

Sara Çollaku - Miqësia jonë filloi në vitin e parë të gjimnazit. Edhe pse nuk ka shumë kohë, mund të them se je e preferuara ime. Nga çdo vendim që kam marrë, dita që të kërkova të ulesh në bankë me ty ka qenë më e vlefshmeja. Edhe pse më parë nuk mendoja kurrë se do ishim shoqe për shkak të paragjykimeve, miqësia jonë filloi direkt që në bisedën e parë dhe kuptova se je një njeri vërtet shumë i mirë dhe i veçantë. Çdo ditë pas asaj e kemi kaluar në bankë bashkë, madje as mësuesit nuk na ndanin sepse e dinin që ishte e kotë. Edhe pse shkolla nuk më pëlqente shumë, koha që shpenzonim bashkë e bënte atë shumë të veçantë dhe shumë më të bukur. Bashkë kemi kaluar momentet më të bukura dhe më të vështira, dhe kemi qenë gjithmonë krah njëra-tjetrës, pa kushtëzime, që nga problemet që sot na janë kthyer në shaka e deri tek ato ku të qenit pranë teje ishte e vetmja qetësi për mua. Jam e sigurt dhe shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë gjithmonë kështu sepse je gjysma ime më e mirë. Sa herë që mendoj për kohët e gjimnazit, ku të gjithë thonë se shoqëria nuk zgjat, je gjithmonë ti ajo që më bën të besoj të kundërtën. Edhe pse fjala “soulmates” përdoret shpesh, je i vetmi person të cilit ja them dhe e mendoj me gjithë zemër. Sot, bashkë ndajmë çdo gjë aq sa duket sikur i kemi jetuar të dyja. Edhe pse nuk e shpreh gjithmonë siç duhet, e di që ti e di se je një ndër personat më të rëndësishëm për mua dhe gjithmonë do të mbetesh e tillë. Do më mungojnë shumë përqafimet e tua të ngrohta kur të ikim në universitet, dhe siç të kam premtuar, gjithmonë do të jesh, siç ke qenë, shoqja ime më e mirë. Të falënderoj për çdo gjë që ke bërë për mua dhe të kam shumë xhan. Je the better Blair to my Serena. Të uroj shumë suksese në të ardhmen dhe të premtoj që do jem gjithmonë aty me ty duke të të mbështetur në çdo moment dhe për të të kritikuar në gabim, siç kam bërë gjithmonë. <33

Hilda Marinaj - Sindi, hey love! Më vjen shumë keq që nuk kemi qenë shumë afër dy vitet e para të gjimnazit sepse e di që do të ma bëje më të bukur, gjithsesi e kemi rikuperuar jashtë shkollë. Je një nga shoqet e mia më të mira me të cilat kaloj momentet më të bukura. Faleminderit për çdo kujtim që më ke dhuruar. I'm glad we got closer and got to know each other more. Je një ndër vajzat më të bukura të shkollës and you know that. Të dua shumë dhe të uroj shumë suksese në gjithçka. Uroj të të plotësohet çdo dëshirë sepse ti e meriton. Të puth, FAVORITE.

Greta Berisha - Sindiii, u bënë vite që të njoh dhe jam e lumtur që një vajzë si ti ka qenë e pranishme në momente të bukura të jetës sime. Shpresoj shumë që jeta jote të jetë e mbushur plot me lumturi, dashuri dhe gjëra të bukura sepse një vajzë si ti meriton çdo gjë. Vite të veçanta na presin përpara ndaj të uroj sa më shumë suksese. Të kam shumë xhan and I love you loqka!

Arlind Islami - O sind o yll bote. Je një ndër gocat më të mira dhe më inteligjente që njoh. Jam shumë i lumtur që të kam njohur këtë vit shkollor. Të uroj shumë suksese në çdo rrugë që do ndjekësh në të ardhmen tënde. Të jesh e sigurt që do e vazhdojmë shoqërinë edhe pas gjimnazit dhe do të bëjmë victory's sa të të dojë zemra. Të uroj të gjitha të mirat e kësaj bote dhe KQYR NALT SE TBI KURORA!

Brian Duriçi - Ti je një mikeshë e vërtetë. Faleminderit që je gjithmonë aty për mua dhe për të gjitha momentet e mrekullueshme që kemi kaluar së bashku. Shpresoj që miqësia jonë të mos thyhet asnjëherë dhe të zgjasë përtej gjimnazit. Faleminderit për të gjitha gjërat që kemi kaluar dhe të uroj shumë suksese në hapat e tua të jetës.

Brajan Nesim - Sindi Nikolli, një vit ka kaluar që nga dita e parë që u njohëm në klasë, dhe gjatë kësaj kohe kam pasur fatin të të njohë. Faleminderit për miqësinë dhe për gjithçka që kemi kaluar së bashku.

Brendon Nesim - Faleminderit për momentet e bukura që kemi kaluar së bashku këtë vit. Me ty, çdo ditë bëhet më e këndshme dhe më e mbushur me kujtime të bukura. Shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë të rritet dhe të kultivohet në ditët që vijnë. Të uroj suksese.



Katrin Gjata

Brendon: Katrin është një shoqe e shkëlqyeshme me një zemër të madhe. Ajo është gjithmonë e përkushtuar në marrëdhënien e saj me miqtë dhe gjithmonë është aty për të ndihmuar në çdo moment.

Bjorni: Katrin Gjata, je një vajzë zemërmirë, gjithmonë e gatshme për të dhënë një dorë ndihme. Ajo i trajton të gjithë me respekt dhe mirësi, duke e bërë atë një mike të dashur për të gjithë ata që e njohin. Të uroj suksese në studimet e tua.

Anisa: Katrin, je një vajzë shumë e mirë. Përcjell shumë çiltërsi dhe pozitivitet. Shpresoj që të kesh një të ardhme të ndritur dhe të uroj shumë suksese!

Nicole: Katrin, gjithmonë shumë gazmore dhe e qeshur me të gjithë, krijon një atmosferë energjike për klasën. Të uroj suksese në vitet në vazhdim!

Bajram: Katrin, ke qenë shembulli më i mirë i një personi dhe shoqeje ndihmuese e cila di të kuptojë dhe të bëjë shaka. Të uroj më të mirat në çdo aspekt për të ardhmen tënde.

Brian: Katrin Gjata, ti je një shoqe e shkëlqyeshme me një zemër të madhe. Gjithmonë kemi pasur zënka në klasë por gjithmonë jemi pajtuar përsëri. Faleminderit për miqësinë tënde. Të uroj shumë suksese dhe gëzim në të ardhmen!

Raneem: Katrin, je një vajzë e qetë dhe e ëmbël. Me ty kam qenë në të njëjtën klasë, në klasën e 9-të kur erdha këtu për herë të parë dhe prapë do jemi edhe në vitin e fundit. Të uroj suksese në të ardhmen!

Arlind: Katrin Gjata, je një vajzë e pjekur dhe

inteligjente, por mbi të gjitha edhe me humor fantastik. Besoj se jam me fat që të kam pasur në klasë dhe vazhdoj të të kem. Shpresoj që të biem bashkë në klasën e arkitekturës dhe të shihemi përsëri. Të uroj mbarësi kudo të jesh dhe kujdes lekët!

Denis: Katrina, jemi njohur për herë të parë vitin e kaluar. Në fillim nuk ishe shumë e hapur dhe më dukeshe e turpshme. Por duke kaluar koha së bashku në klasën tonë, kam kuptuar që je goxha e shoqërueshme dhe miqësore. Edhe pse e përdor shumë ironinë, kjo gjë nuk e ka dëmtuar shoqërinë tonë aspak, por e ka forcuar. Shpresoj që të kesh sa më shumë suksese në jetë.

Sindi: Katrin, kurrë nuk mendoja se ka një njeri kaq të ëmbël me një shpirt kaq të pastër sa tëndin. Jam mirënjohëse që kam një shoqe si ti pranë vetes. Të uroj më të mirat në të ardhmen tënde dhe shpresoj që ti arrish ëndrrat e tua!

Joana: Katrin Gjata, vërtet Keitin e ke motër, por e vetmja ngjashmëri që keni është humori që ju karakterizon të dyjave. Mes shumë gjërave që kemi folur, pasioni yt për arkitekturën vazhdon të më mahnisë! Jam e sigurt që do të realizosh çdo gjë që do vendosësh të bësh në jetë, sepse ti punon fort për gjërat që do. Shumë suksese kudo në jetë! Me dashuri, Joana.

Kristian: Katrin Gjata, ish-shoqja ime e bankës, i vetmi komunikim që kishim në fillim ishte “edhe sa do të bjerë zilja,” ama me kalimin e kohës filluam dhe u bëmë miq të mirë. Jam me fat që kam një shoqe si ti dhe shpresoj të ngelemi gjithmonë shokë.



Arlind Islami

Sabjan: Nuk mjafton ky dedikim që të them çdo gjë që vlerësoj te ty. Të falenderoj që je shoku im më i mirë që do të mendoja ndonjëherë. Faleminderit për të gjitha herët që më ke qëndruar pranë dhe për të gjitha gjërat e bukura që kemi bërë bashkë këto tre vite. Për mua shoqëria jonë nuk është thjesht shoqëri, për mua ti je familje. E di që do e mbështesim njëri-tjetrin në çdo hap tonin. Je shumë i zgjuar, i sinqertë, i sjellshëm, i shkathët dhe mbi të gjitha me zemër të pastër. Jam i sigurt që do bëhesh një arkitekt shumë i mirë dhe e di me vullnetin që ke që do arrish gjithçka. Të uroj sukseset më të përzierëta.

Brajan: Një vit mund të të duket si një periudhë e shkurtër, por me ty, ajo ka qenë një kohë e mrekullueshme. Kjo kohë që kemi kaluar bashkë ka sjellë shumë kujtime të bukura dhe momente të gëzuara që nuk do t'i harroj kurrë. Me ty, kam gjetur një shok të vërtetë, dikë që më kupton dhe është gjithmonë aty për të më mbështetur.

Brendon: Arlind, me ty kam pasur momente të mrekullueshme. Ti je i njohur për humorin dhe mbështetjen tënde gjatë gjithë kohës. Kemi një vit bashkë dhe çdo moment ka qenë një kujtim i paharrueshëm. Faleminderit që ke qenë aty gjatë momenteve të bukura. Shoqëria jote është një pasuri e vërtetë, dhe çdo kujtim me ty është një thesar. Shpresoj që të kalojmë edhe shumë kohë të bukura së bashku dhe të mbajmë këtë miqësi të fortë. Faleminderit për çdo moment që kemi ndarë, Arlind! Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Sindi: O zemër, ti sa i mirë që je dhe e meriton që të kesh dedikimet më të bukura! Jam vajza më e lumtur në botë që jemi në një klasë bashkë dhe njohëm njëri-

tjetrin. Je një shok kaq i veçantë për mua. Ti m'i bën ditët më të bukura me pozitivitetin tënd që e shoqëron përherë me buzëqeshje. Normalisht që ne do të jemi shokë edhe përtej gjimnazit, se do kapim victorys në Fortnite. Të kam shumë xhan dhe të uroj suksese në çdo rrugëtim të jetës tënde. Je shtim jete!

Sara: Arlind, je djali më pozitiv që kam njohur ndonjëherë dhe besoj që ta kam thënë shpesh këtë gjë. Gjithmonë gjen mënyra për t'i ngritur humorin klasës dhe për ta aktivizuar atë ndryshe, dhe je çelësi i atmosferës. Jam e sigurt që klasa nuk do të ishte e njëjtë pa ty. Do t'i kujtoj gjithmonë kohët e bukura që kemi kaluar bashkë, të mbushura me të qeshura dhe humoret e pafundme. Je një shok shumë i mirë dhe shpresoj që miqësia jonë të zgjasë dhe pas gjimnazit. Të uroj shumë suksese në të ardhmen dhe shpresoj të mos ndryshosh kurrë!


Brian: Shoku im i dashur Arlind, ti je një person i jashtëzakonshëm dhe i vlefshëm në jetën time. Me të vërtetë e çmoj miqësinë dhe mbështetjen tënde. Faleminderit që je gjithmonë aty për mua. Gjithë të mirat për ty.

Kristian: Jemi njohur këtë vit, ama më duket sikur kemi vite. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë dhe mos e humb kurrë buzëqeshjen dhe humorin që të karakterizon! (Harrova të thoja dhe që mezi po pres ta blesh shtëpinë në Fresk, hahaha!)

Katrin: Një ndër djemtë e preferuar të klasës që e karakterizon humorin i shoqëruar më të qeshurat e gjithë klasës. Të vlerësoj për pozitivitetin, mirësinë dhe ndihmën që ti nuk ia kursen askujt. Shpresoj që të bashkëpunojmë në projektet tona të ardhshme. Suksese në shkollë dhe në jetë!

Arbi: Vetëm dy vite të kam pasur në klasë, por me aq më është dashur të të njoh si person dhe të kuptoj vlerat e tua. Ke një cilësi të cilën pak persona e kanë dhe ajo është aftësia për t'u ngritur humorin njerëzve të tjerë edhe pse mund të jenë në kohët më të vështira. Je me të vërtetë një djalë dhe një shok shumë i mirë dhe ke respektin më të madh nga unë.

Denis: Edhe pse nuk kemi shumë që njihemi, prezenca jote në klasë ndihet dhe sa herë që ti s'gjendesh aty, klasa nuk është njësoj. Shakatë e tua dhe personaliteti yt e ndriçon çdo orë mësimi. S'ke dështuar asnjëherë të jesh pozitiv edhe në momente të vështira. Më pëlqen që nofka ime prej teje është VËLLAI MYSLIMAN, edhe pse nuk kemi vajtur asnjëherë në xhami bashkë. Ndoshta këtë vit kjo gjë ndryshon.



Keit Gjata

Bajram: Edhe pse shkolla po mbaron, kujtimet tona do të mbeten përjetësisht. Faleminderit që ke qenë një shoqe e shkëlqyeshme dhe për të gjitha momentet e bukura që kemi ndarë së bashku.

Bjorn Tupi: Je një vajzë vërtet e jashtëzakonshme. Mirësia dhe zemra jote e ngrohtë të bëjnë një shoqe të jashtëzakonshme. Ti gjithmonë bën gjithçka për të ndihmuar të tjerët dhe sjell pozitivitet kudo që shkon. Të uroj që të plotësohen të gjitha dëshirat.

Sara Çollaku: Edhe pse ky është viti i parë që jemi në klasë bashkë, miqësia jonë ka nisur që në fillim të gjimnazit. Je një vajzë shumë e mirë, e sinqertë dhe me karakter të fortë. Gjithmonë e buzëqeshur. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Brendon Nesimi: Keit është një shoqe e sinqertë dhe e përkushtuar. Ajo gjithmonë sjell një dozë humor dhe pozitivitet në çdo situatë. Keit gjithashtu është një aventuriere dhe pëlqen të provojë gjëra të reja.

Joana: Je një nga vajzat më të mira që kam patur fatin të njoh. Shpresoj që të të buzëqeshë fati në jetë siç ti ke të stampuar një buzëqeshje dashamirëse në fytyrë. Të uroj shumë suksese! Me dashuri, Joana.

Sindi Nikolli: Je një nga vajzat me karakterin më të fortë që kam njohur. Shpresoj që këtë gjë mos ta humbësh kurrë. Sa më shumë të njoh, aq më shumë për zemër të kam. Je shumë e mirë dhe gjithmonë do jem e lumtur që bashkë kemi krijuar shumë momente të bukura me njëra-tjetrën. Të uroj shumë suksese Keit!

Alvis Qendro: Je një njeri që çdokush do donte ta njihje

dhe ta kishte për shoqe. Je nga ata njerëz që mund të gjesh mbështetjen gjithmonë sepse të ndihmon me aq sa mundesh. Je nxënëse shumë e mirë dhe një gocë e përkryer. Uroj që të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe qëllimet që ke në jetë!

Arbi Çiftja: Ndhem shumë me fat që erdhet në klasën tonë vitin e kaluar bashkë me Katrinën, pasi i dhatë një gjallëri tjetër klasës e cila mungonte në vitin e parë. Je një vajzë e sjellshme dhe shumë e shoqërueshme, sepse ke aftësinë për t'u miqësuar dhe për të bërë shokë shumë shpejt. Të uroj shumë suksese në të ardhmen.
Denis: Si me motrën tënde, jemi njohur vjet për herë të parë. Por ti ndryshe nga ajo, që nga fillimi ke qenë më e çiltër dhe e shoqërueshme me të gjithë nxënësit e klasës. Të dyja jeni përshtatur më së miri me ne. Shpresoj që edhe ti të kesh sa më shumë lumturi në të ardhmen.

Sakistjo: Keit, për ty mund të them që je ndër vajzat më të mira që kam njohur deri në këtë moment të jetës. Pozitiviteti yt dhe buzëqeshja që shfaq dhe pse çdo gjë mund të jetë komplet kundër rrymës, tregon karakterin tënd të fortë. Je një person shumë i dashur dhe i afrueshëm dhe për këtë gjë të vlerësoj shumë. Të këshilloj që të mendosh më shumë rreth të ardhmes tënde, pasi jeta nuk është vetëm për momentin që jetojmë, ajo vazhdon dhe vendimet që ne marrim, kanë një rol shumë të rëndësishëm për ne. Përveç kësaj të përgëzoj për çdo gjë tjetër dhe të them të vazhdosh të jesh kështu, pasi mendoj që je në versionin më të mirë tëndin. Të uroj suksese dhe të arrish në majat më të larta.

Arlindi: Je një nga vajzat më të mira dhe më të çilverta që unë njoh por përveç kësaj je dhe një shoqe shumë e mirë. Te humori dhe gallata them se ta kalon Katrina por gjithsesi kjo nuk do të thotë që ti nuk ke humor. Të uroj të gjitha të mirat e kësaj bote dhe shpresoj të kemi kontakt edhe pas gjimnazit. Tung Batman!

Steisi Laraku: Ah mi Keit, si kaluan kaq shpejt tre vite. Jam shumë e lumtur që njoha një shoqe si ti dhe arrite të bëheshe shoqja ime më e mirë edhe pse nuk kemi shumë vite që njihemi, kemi shumë konfidenca me njëra-tjetrën dhe flasim për çdo gjë bashkë pa pasur druajtje nga njëra-tjetra. Kemi kaluar momente shumë të bukura me njëra-tjetrën që do më mbesin gjatë në kujtime disa dhe përgjithmonë. Shpresoj që të arrish qëllimet e tua në jetë dhe të plotësohet çdo dëshirë që ti ke, sepse e di që ti këmbëngul gjithmonë për të arritur atë që do. Të dua shumë fierakja zembrës xoxo!



Arbi Çiftja

Denis Faqolli: Edhe pse kemi qenë në klasë për vetëm 3 vite, duket sikur miqësia jonë ka vite që kur ka filluar. Në të gjitha situatat që kemi kaluar së bashku, e ke provuar veten që je një nga shokët më të mirë që kam pasur në gjimnaz. Fjalët së shprehin dot mirënjohjen që kam ndaj teje për çdo problem që më ke ndihmuar, dhe se si pas çdo vështirësie ke qëndruar gjithmonë pozitiv duke parë anën e mirë të gjërave. Shpresoj të kesh vite plot sukses dhe të gësh lumturinë që meriton.

Arlind Islami: Je një djalë me karakter të fortë dhe inteligjent. Kur të kam parë për herë të parë kam menduar se nuk afron njeri lehtësisht, por me kalimin e kohës krijuam një miqësi shumë të mirë dhe shpresoj të vazhdojë edhe pas gjimnazit. Të uroj sukses dhe mbarësi kudo që të shkosh!

Eskobar Elezi: Je një shok shumë i mirë dhe kemi shumë kohë që njihemi bashkë, por këtë vit që na bashkuan në klasë bashkë, jemi njohur më mirë dhe më ke qëndruar pranë çdoherë. Të uroj shumë suksese.

Brian Duriçi: Ti je një shok i vërtetë dhe i besueshëm. Me të vërtetë e çmoj miqësinë tonë. Gjithmonë ke qeshur me batutat e mia që bëj në klasë. Të uroj shumë suksese dhe lumturi në të gjitha qëllimet e tua.

Sara Çollaku: Arbi, edhe pse nuk kemi shumë që njihemi, mund të them se kemi kaluar shumë mirë bashkë këtë vit të fundit të gjimnazit. Je një djalë shumë i mirë dhe i respektueshëm i cili të ndihmon sa herë që ke nevojë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Sindi Nikolli: Je një djalë shumë i sjellshëm dhe i mirë, ke disa vlera shumë të mira si person që unë do

jem përherë mirënjohëse. Të uroj shumë suksese në rrugëtimin tënd.

Katrin Gjata: Një ndër djemtë më të mirë që njoh. Shakatë e tua dhe batutat që shkëmbejmë me njëri-tjetrin do më mungojnë. Të karakterizon mirësia dhe pozitiviteti që e shfaq çdo ditë. Suksese kudo në jetë!

Keit Gjata: Arbi, je një shok shumë i mirë. Që në fillim kur kam ardhur në klasë, më ke folur gjithmonë. Edhe pse dukesh shumë serioz, për mendimin tim je shumë ndryshe dhe shumë i sjellshëm. Të uroj suksese kudo në jetë!

Eliora Qendro: Për këto tre vitet e gjimnazit që kemi kaluar bashkë në klasë, mund të them se të njoh si një person të matur dhe të qeshur. Sado serioz që shfaqesh, prapë batutat e tua ngacmuese nuk të lënë deri në fund të jesh i tillë. Ke sedër dhe besoj se do bësh përpara në jetë. Të uroj shumë suksese!

Ajsel Mlika: Diçka që unë mund të mburrem në jetën time është lidhja jonë e hekurt, jo mes dy miqve, por mes dy vëllezërve. Me kalimin e viteve, jo vetëm që ke qenë një mbështetës dhe dëgjues mjaft i mirë, por dhe një person i cili më ka ndihmuar të rritem dhe të mësoj shumë gjëra për veten time gjithashtu për ty. Vitin e vetëm që ishim bashkë në të njëjtën klasë, u desh të na ndanin vitin tjetër se nuk kishte bir nëne t'na duronte njëri neve. Dhe pse vetëm një vit bashkë, bëmë shokë të rinj që dhe sot ne ato i kemi mes nesh. Fluturuan vitet e gjimnazit si të ishin tre muaj, por asnjëherë s'do ta ktheja kohën, pasi kemi kaluar vitet më të bukura e më kuptimplotë deri sot. Kur një ditë të shohësh këtë dedikim, dua që të kujtosh në moment çdo çast që kemi kaluar bashkë brenda shkollës. Se çka ndodhur jashtë shkollës nuk ke shans t'i harrosh. Të uroj më të mirat dhe suksese në rrugëtimin tënd të gjatë e të largët e do të shihemi shumë shpesh. Ciao Fratello!

Noel Sulejmani : Kemi qenë shokë që në klasë të tetë, ku na lidhte vetëm basketbolli, ndërsa tani nuk na shkon më mendja aty. Në gjimnaz jemi miqësuar shumë sepse ndajmë shumë përvoja të përbashkëta dhe kemi pikëpamje të njëjta. Je një djalë shumë i matur dhe i muhabetit. Mund të këshillojmë mirë njëri-tjetrin pasi i dimë kërkesat tona. Nuk e prisja që në universitet të shkoje aq larg, por sidoqoftë shpresoj ta mbajmë shoqërinë tonë dhe të uroj shumë suksese, lalex!



Denis Faqolli

Arbi: Bashkë për herë të parë jemi njohur që në klasë të pestë pasi të dy atë vit erdhëm në shkollën Turgut Ozal. Gjatë asaj periudhe e deri në klasë të nëntë kemi qenë thjesht shokë shkolle pasi e bënim fiskulturën bashkë. Më pas, për këto tre vite të gjimnazit që pata mundësinë të të kisha në klasë, të njoha akoma më shumë si person dhe për mua nuk ishte më thjesht një shok shkolle, por një shok i mirë dhe i ngushtë i cili qëndrova dhe vazhdon të qëndrosh me mua si në kohë të mira ashtu dhe në të vështira. Për mua kjo shoqëri e krijuar mes nesh është fat dhe shpresoj që ta mbajmë për vite e vite me radhë. Të uroj më të mirat e kësaj jete dhe sa më shumë sukses në rrugën që do të zgjedhësh të vazhdosh.

Brendon: Denis, je një person me një shpirt të madh dhe gjithmonë i gatshëm të ndihmosh. Me ty kam kaluar shumë kohë të bukura dhe kam shumë respekt për ty.

Brian: Ti je një shok i veçantë, i cili më kupton dhe më përkrah në çdo moment. Gjithmonë e di se mund të mbështetem tek ti. Faleminderit për miqësinë tënde. Të uroj shumë suksese në jetën tënde.

Brajan: Denisi është një njeri i përkushtuar në punën e tij. Ai është gjithmonë i gatshëm të ndihmojë të tjerët me sfidat e tyre të punës dhe është një shok i shkëlqyer. Të uroj suksese.

Arlindi: Në përshtypje të parë më je dukur një djalë indiferent, por kur filluam të flisnim dhe të krijonim shoqëri, kam ndryshuar totalisht mendim. Unë të kam vendosur dhe një pseudonim si VËLLAI MYSLIMAN dhe pse nuk kemi shkuar asnjëherë bashkë në xhami. Të jam mirënjohës për të gjitha masazhet që më ke

bërë dhe do të vazhdosh t'i bësh me përkushtim. Përtej shakave, je një djalë i shkëlqyer dhe që më ke mbajtur afër. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë më tej.

Keit: Denis, që në fillim kur kam ardhur në klasë vitin e dytë, je treguar gjithmonë shumë i sjellshëm dhe një shok shumë i mirë me mua. Më pëlqen shumë mënyra se si flet dhe i mendon gjërat. Të uroj suksese kudo!

Sara: Denis, kemi qenë shok që në klasë të 7-të dhe mund të them se je një njeri shumë pozitiv në çdo gjë. Çdo gjë e merr me sportivitet pa e vrarë shumë mendjen. Do më mungojnë shënimet e tua kur të iki në universitet, do nis t'i shkruaj vetë se s'kam ç'të bëj. Je një djalë shumë i mirë dhe të uroj shumë suksese.


Sindi: Denis, në fillim nuk mendoja se së bashku do të krijonim një shoqëri si kjo që kemi krijuar. Je një nga individët në klasë që më pëlqen të kaloj kohë me të. Përherë je sjellë shumë mirë me mua dhe më ke ndihmuar sa herë të kam kërkuar ndihmë. Je një djalë shumë i mirë dhe të uroj shumë suksese!

Joana: Je një djalë serioz dhe i vendosur, ndaj besoj se do arrish gjërat që ti do në jetë! Të uroj shumë suksese kudo!

Katrin: Denis - Djalë pozitiv dhe i mirë. Nuk përzihesh asnjëherë në punët e të tjerëve dhe punon për gjërat që ti do, duke mos e humbur fokusin tënd. Shakatë që bëjmë me njëri-tjetrin janë pjesa e preferuar e ditës sime. Të uroj më të mirat dhe suksese kudo në jetë!

Noel: Edhe pse jemi njohur që në klasë të gjashtë, gjimnazi na ka afruar shumë. Interesat e përbashkëta që kemi na kanë afruar shumë. Ndoshta përvojat tona nuk na përputhen plotësisht, por ato na kanë bërë të mësojmë nga njëri-tjetri. Je djalë shumë stoik (natyrisht) dhe i matur. Gjithmonë e mendon atë që thua dhe këshillat e tua janë ndër më të vlefshmet. Të vlerësoj shumë dhe të uroj suksese, Denis!

Shefrina: O FAQOLLI. Vetëm qesh ky Faqolli se marr vesh si ia bën. Gjithmonë e kam ditur Librazhdin si vend mistik. Deno, si të të takoja në klasë të 8-të, si tani, po njësoj do të ishte. Je i njëjti tip i buzëqeshur, pozitiv dhe pa komplekse. Gjatë këtyre viteve unë kam njohur një djalë plot hare e kurajo e që do të jetë në harmoni me të gjithë njerëzit që e rrethojnë (përveç meje), e këtë e vlerësoj shumë. Nuk kam çfarë të them dhe të mendoj për ty përveç se më të mirat. Për ty shok kam vetëm respekt, kështu që suksese kudo njish!



Joana Taraj

Nikol Kolaveri: Joana, je një vajzë tepër e zgjuar dhe një njeri i cili ka durim të ndihmojë të gjithë klasën, tipar unik. Të uroj suksese në vitet në vazhdim!

Alvis Qëndro: Joana, je një shoqe shumë e mirë dhe e dashur. Jam shumë me fat që të kam njohur! Faleminderit për çdo herë që më ke ndihmuar dhe më ke shpjeguar çfarë kisha nevojë kur nuk kuptoja asgjë në mësim! Shpresoj që çdo dëshirë të të plotësohet! Të uroj suksese të mëtjshme!

Sara Çollaku: Joana, një vajzë shumë e përkushtuar në atë që do. Jam e sigurt që mund të arrish çdo gjë që e vendos si qëllim, sepse je një njeri punëtor. Gjithmonë na ndihmon për çdo problem, si për mësim, por dhe ato në klasë. Përveç këtyre, je dhe një senatore ideale, na shpëton nga quizet për të cilat s'kemi mësuar pa hezituar. Je një vajzë e sinqertë dhe shumë e buzëqeshur. Shpresoj të jesh kështu gjithmonë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Katrin Gjata: Joana, një ndër vajzat më të mira që njoh. Jam krenare që kam një shoqe kaq të përkushtuar dhe zemërmirë si ty, që në çdo moment tregohet e gatshme të më ndihmojë. Jam shumë e bindur që do arrish çdo gjë për të cilën ti po lufton dhe përpiqesh në çdo mënyrë që t'ia dalësh. Suksese në jetë dhe në shkollë! Përqafime!

Rea Agalliu: Edhe pse kemi shumë pak kohë që njihemi, do të ndahem nga ty me përshtypjet më të mira. Je një vajzë shumë punëtore dhe e sjellshme. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj të të realizohen të gjitha ëndrrat.

Denis Faqolli: Joana, nuk kemi shumë që njihemi, por

je një nga gocat më të mira që unë njoh. Gjithmonë je e gatshme që t'i ndihmosh të tjerët me mësimet në qoftë se ata kanë pyetje. Ke qenë miqësore dhe pozitive me çdo nxënës të klasës. Nuk mund të mendoj një person që mund të ishte senator më i mirë se ty.


Arbi Çiftja: Joana Taraj, për këto dy vite që të kam pasur në klasë, ke qenë një nga vajzat më të mira dhe të sjellshme të klasës. Ke qenë dhe je gjithnjë e papërtueshme për të ndihmuar çdokënd, qoftë në detyra ose në mësim. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj që do t'ia dalësh më së miri në rrugën që ke zgjedhur.

Bjorn Tupi: Joana Taraj, je një vajzë vërtet e shkëlqyer, me një inteligjencë të rrallë dhe një sjellje të mrekullueshme. Ke një aftësi të jashtëzakonshme për të kuptuar dhe për t'u marrë vesh me njerëzit në një nivel të thellë emocional. Të uroj suksese në shkollën që do vazhdosh.

Arlind Islami: Joana Taraj, je një nga vajzat më shpirtmirë dhe më e sinqertë që kam njohur, por mbi të gjitha edhe senatorja më e mirë në shkollë. Të jam mirënjohës për të gjithë ndihmën që më ke dhënë me detyrat dhe shpjegimet e mësimëve që nuk i kuptoja. Të uroj të gjitha të mirat dhe shpresoj të shihemi përsëri pas gjimnazi. Forca sa më shumë ekskursione sivjet!

Kristian Ndreu: Joana Taraj, shoqja ime e parë e bankës, jam me fat që kam njohur një vajzë fantastike si ti. Je shumë bujare dhe asnjëherë nuk përton të më ndihmosh. Të uroj gjithë të mirat dhe shpresoj të arrish majat siç të takon!

Sakistjo Meraj: Joana Taraj, ky është viti i dytë që ne njihemi dhe kemi krijuar një afrimitet shoqëror. Kemi shkëmbyer informacion rreth gjërave që ne duam të bëjmë dhe gjithmonë më je shprehur si mbështetje në pikat ku unë mendoja që nuk isha mjaftueshëm i fortë. Ke qenë gjithmonë ndihmuese në çdo gjë, si në aspekt mësimor, po ashtu edhe në probleme që nuk kanë të bëjnë fare me shkollën. Dashamirësia jote është ajo që të karakterizon dhe deri diku është inspirim për mua, duke më bërë të kuptoj se si një person mund të jetë kaq i mirë në këmbim të asgjëje (siç pritet nga shumica e brezit tonë). Je person shumë i përkushtuar, por nuk mungon të përfshihesh edhe në shakatë që bëjmë ne në klasë. Të uroj shumë fat dhe suksese në jetë, dhe shpresoj që një ditë të dëgjoj për ty që të kesh arritur majat.



Sakistjo Meraj

Adela: Kisto, që kur jemi takuar për herë të parë në vit të dytë, e kam kuptuar që je një çun me karakter të fortë, por shumë i dashur dhe nëse dikush “të hyn në zemër” nuk ka gjë që nuk bën për të. Shoqëria me ty ka ndryshuar shumë gjëra këtë vit. Më shumë biseda, më shumë të qeshura, gallata, por mbi të gjitha, kam gjetur dikë që mund t’i besoj çdo gjë “me sy mbyllur”. Më pëlqejnë shumë bisedat tona, mendimet që shkëmbejmë me njëri-tjetrin (se vetë nuk po nxjerrim gjë në dritë) dhe telefonatat që bëjmë sa për të thënë diçka e që përfundojnë në orë të tëra filozofie. Jam mirënjohëse për shoqërinë tonë dhe për çdo kujtim që kemi krijuar bashkë. Mezi pres të shohim çfarë na sjell e ardhmja sepse, siç ta kam thënë dhe e them gjithmonë, këtu do ngelesh, nuk ke ku shkon :) Të kam xhan, bestie. <3

Shefrin: Nëse je duke e lexuar këtë dedikim, ose je ti, Saki, ose një i interesuar për dedikimet kushtuar atij. Për këtë të fundit, do të të vij unë në ndihmë duke të thënë se Sakistjo është një djalë pozitiv, një shok i mrekullueshëm (dhe i bezdisshëm), një tip kurajoz dhe mbi të gjitha është human. Sa herë e takoj, e di që do të më sjellë një buzëqeshje në fytyrë me ato mimikat e veta. Çdo pushim i kaluar mes ne të dyve e gjysëm nuk ka qenë kurrë i mjaftueshëm. Shpresoj të qëndrojë gjithmonë kështu, kaq i qeshur, kaq i matur, kaq i gjatë... Të uroj shumë suksese dhe gjithë të mirat e botës! <3

Arlind Islami: Je personi më gazmor në klasë, pas meje sigurisht. Kemi kaluar një kohë të mrekullueshme bashkë dhe kemi krijuar një shoqëri shumë të mirë. Në komisionin e etikës për herë të parë kemi shkuar bashkë dhe mendoj se në qoftë se ne të dy do të uleshim në të njëjtën bankë, do të shkonim orë për orë

dhe do na kishte inat çdo mësues. Ishte një kënaqësi që kemi kaluar 3 vitet e gjimnazit bashkë dhe shpresoj që të kemi përsëri kontakt pas gjimnazit.

Bjorn Tupi: Je një shok shumë i veçantë për mua. Për 3 vjet që kemi kaluar së bashku, kam vlerësuar shumë inteligjencën dhe sinqeritetin tënd. Gjithmonë je i gatshëm për të ndihmuar dhe për të qeshur bashkë. Të uroj suksese në vazhdim.

Katrin Gjata: Sakistjo – Një ndër djemtë më me vlera që njoh. Të karakterizon mirësia dhe shpirti luftarak që ke. Një djalë punëtor dhe këmbëngulës në ato që do të arrijë. Kemi krijuar një miqësi shumë të mirë bashkë, për të cilën jam krenare që e kam dhe do e vazhdojmë dhe në të ardhmen. Jam shumë e lumtur që po lufton të ndjekësh ëndrrën tënde dhe krenare për vështirësitë që ke marrë përsipër, të cilat do t’i realizosh. Njerëzit ambiciozë, punëtorë dhe të virtytshëm si ty janë të rrallë. Suksese në çdo hap të jetës tënde! <3

Keit Gjata: Sako, je ndër shokët më të mirë që kam. Bashkë jemi afruar shumë shpejt dhe më pëlqen mënyra se si më kupton vetëm me një shikim. Ke qenë gjithmonë mbështetje në klasë. Më pëlqen shumë shkathësia jote dhe mënyra se si i mendon gjërat. Jam e sigurt që shoqëria jonë do të vazhdojë përtej gjimnazit. Të uroj më të mirat dhe suksese kudo! <3

Kristian Ndreu: O horri, faleminderit për komfortin dhe pozitivitetin që më ke përcjellë çdo ditë. Kështu siç ma ke përcjellë mua, jam i sigurt se e përcjell tek të gjithë pa përjashtim. Të uroj gjithë të mirat, ashtu siç ke dhe shpirtin dhe mos u ndal kurrë duke qenë ky që je. <3

Neki Rrapaj: Kisto, një shok perfekt. Kam tre vite që të njoh dhe e them sinqerisht që je një djalë shumë i mirë dhe i respektueshëm, gjithmonë i gatshëm për të dhënë ndihmën tënde në të gjitha problematikat dhe për më tepër shumë gazmor. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe të uroj shumë fat në jetë.

Sara Çollaku: Sakistjo, je një djalë shumë i mirë dhe pozitiv, si dhe një shok shumë dashamirës. Kurrë nuk ngurron të më ndihmosh sa herë që të pyes, edhe pse e nis gjithmonë me ndonjë tallje. Edhe pse nuk njihemi prej shumë kohësh, miqësia jonë u krijua shumë shpejt këto muajt e fundit. Nuk do t’i harroj kurrë momentet e bukura që kemi kaluar së bashku në këtë vit të fundit të gjimnazit, bisedat e pafundme për temat më të ndryshme dhe shpresoj të mbetemi shokë edhe në të ardhmen. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj të arrish atë ç’ka dëshiron! <3



Brian Duriçi

Brendon Nesim: Kemi kaluar 8 vite bashkë, çdo kujtim është një kapitull i çmuar në historinë tonë të miqësisë. Faleminderit për çdo kohë të bukur dhe mbështetje në kohëra të vështira. Shoqëria jote është një dhuratë e çmuar, dhe jam mirënjohës për çdo moment të paharrueshëm që kemi ndarë. Shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë të rritet dhe të kalojmë edhe shumë kohë së bashku. Faleminderit, Brian, që ke qenë gjithmonë aty për mua!

Sindi Nikolli: Këtë vit klasa ka qenë një nga arsyet që jam kënaqur më shumë dhe ti je një person që e bëje klasën edhe më të bukur për mua. Të kam shumë për zemër dhe shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë edhe pas gjimnazit! Suksese!

Brajan Nesim: Ti je më shumë se një shok për mua, je një mik i vërtetë. Ti ke qenë gjithmonë aty kur kam pasur nevojë për mbështetje, për të ndarë gëzimet dhe trishtimet e mia. Me ty kam njohur thellësisht vlerën e një mikut të vërtetë dhe jam mirënjohës për çdo moment që kemi ndarë së bashku. Nuk di se çfarë na sjell e ardhmja, por jam i bindur se do të jemi së bashku, ashtu siç jemi deri më tani.

Keit Gjata: Brian, një shok shumë i mirë dhe i drejtë. Më pëlqen shumë për karakterin tënd të fortë dhe shpresoj të jesh kështu gjithmonë. Të uroj shumë suksese në jetën tënde.

Sara Çollaku: Brian, jemi njohur që në klasë të tetë dhe mund të them se nuk ke ndryshuar aspak. Gjithmonë gjen mënyra për të ngritur humorin e klasës si dhe atë të zyshave. Ja del me sukses çdo herë që punon për diçka. Je një shok shumë i mirë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Bjorn Tupi: Je një tip pozitiv dhe humorist gjatë gjithë kohës. Pasioni yt rreth makinave nuk ka kufi. Të uroj suksese në shkollën e lartë.

Sakistjo Meraj: Brian – Je një shok i veçantë. Tip i shoqërueshëm dhe karizmatik, kjo është gjëja që na bëri bashkë. Je një djalë i mençur, prandaj jam i sigurt se do të bëhesh dikush në jetë. Të uroj suksese në jetë.

Arlind Islami: Je një nga personat më pozitivë në klasë dhe një nga të parët nxënës që më ke afruar kur jam transferuar në këtë shkollë. Me ty kam krijuar një marrëdhënie shoqërore të veçantë dhe e kam shumë të vështirë që ta besoj se një ditë nuk do të jemi më në një klasë. Si shenjë e shoqërisë sonë ka ngelur veshi im, të cilin sa e shikoj, më kujtohesh ti. Situatat që kemi kaluar bashkë nuk mund të shkruhen vetëm në një paragraf, por të premtoj se shoqëria jonë do të vazhdojë dhe jashtë mureve të kësaj shkolle.

Arbi Ciftja: Edhe pse kemi qenë në të njëjtën shkollë, këto vite të gjimnazit të kam njohur dhe mund të them se ke qenë një person plot energji dhe humor e i rëndësishëm për klasën tonë. Me aftësinë tënde për të gjetur gjithmonë momentin e duhur për të bërë ndonjë shaka, arrin të na ngreshë humorin dhe atmosferën e klasës. Të uroj shumë suksese në rrugën që ke zgjedhur.

Katrin Gjata: Një ndër djemtë më të mirë që njoh. Gjithmonë kemi pasur një marrëdhënie të mirë bashkë, duke bërë shaka dhe duke shkëmbyer biseda me njëri-tjetrin. Të uroj më të mirat dhe shpresoj që t'i realizosh dëshirat e tua!

Denis Faqolli: Nuk të njihja para klasës së 9-të, por mund të them se ke qenë një shok i mrekullueshëm për mua këto 3 vite. Bashkë me Arlindin, ju të dy e keni bërë të gjithë klasën për të qeshur dhe na keni hequr mërzinë në ditë të lodhshme. Edhe pse nuk kemi kaluar shumë kohë bashkë jashtë shkolle, ato kohë që kemi dalë jemi kënaqur gjithmonë. Shpresoj të jesh kështu për vite me radhë.

Neki Rrapaj: Djalë shumë i mirë dhe pozitiv, gjithmonë i gatshëm për të ardhur në bankën e fundit dhe për të bërë ndonjë dorë muhabet. Përherë kur të sheh të mërzhitur, të afrohet dhe mundohet me sa ka mundësi të të gëzojë sadopak. Të uroj gjithë të mirat.



Rea Agalliu

Sindi: - Gjithmonë do kesh një vend shumë special brenda meje. Kam njohur disa anë të tuat dhe kam kaluar disa nga momentet më të bukura të jetës time me ty, je një shoqe shumë e mirë dhe jam shumë mirënjohese që të kam pasur përkrah shumë herë gjatë kohës që kemi kaluar bashkë. Me zemër të uroj shumë suksese në jetë!

Sabjan: - Ti e di shumë mirë sa shumë e kam ndryshuar mendimin fillestar që kam pasur për ty dhe e di shumë mirë që s'kam bërë aspak gabim. Ndoshta për ty duhet të thuash atë shprehjen 'Mos e gjyko një libër nga kopertina'. Mund të dukesh njeriu më i ftohtë, por je një vajzë plot sinqeritet dhe dashuri për njerëzit që të rrethojnë, dhe mbi të gjitha një shoqe shumë e mirë. Shpresoj t'i arrish qëllimet e tua në jetë. Të përqafoj (jetaaa*).

Joana: - Edhe pse u njohëm këtë vitin e fundit, jam shumë me fat që njoha dikë si ti, Rea! Një vajzë e mirë, por një shoqe akoma më e mirë. Në kujtimet e mia do ngelesh personi i parë që më shkonte në mendje t'i kërkoja ndihmë për çdo gjë, sepse je gjithmonë pozitive dhe i merr gjërat me sportivitet. Të uroj me gjithë zemër shumë suksese dhe shpresoj të arrish gjithçka dëshiron! Me shumë dashuri, Joana.

Marina: - Për këtë kohë që të kam pasur në klasë, më je dukur një vajzë shumë pozitive. Gjithmonë të kam parë duke qeshur. Të uroj suksese mëtej.

Alvis: - Je një vajzë shumë e mirë dhe e dashur. Edhe pse vetëm një vit në klasë bashkë, e kam kuptuar që je një person me shumë vlera. Të uroj suksese në shkollë e kudo.

Arlind: - Je një vajzë me karakter të fortë, po ashtu edhe gazmore në të njëjtën kohë. Jam shumë i lumtur që kam pasur mundësinë të kem një shoqe si ty dhe uroj që të të shkojë mbarë kudo që të jesh. Shpresoj që të shihemi edhe pas gjimnazi.


Rannem: - Rea, je një vajzë shumë e mirë dhe e sjellshme. Do të kujtoj gjithmonë argumentet e tua të forta në orën e psikologjisë dhe sociologjisë. Shpresoj të arrish kudo në jetë dhe të uroj suksese në të ardhmen!

Arbi: - Ky vit i fundit më është dashur për të të njohur si një vajzë e mirë dhe energjike që je. Ke dhe shumë vlera të tjera të cilat i vlerësoj pa masë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Denis: - Jemi njohur që në vit të parë, por s'kemi qenë shumë të afërt me njëri-tjetrin. Të uroj më të mirat në karrierë, dhe shpresoj që të kesh fat në zgjedhjet e së ardhmes.

Anisa: - Je një vajzë shumë e çiltër dhe e sjellshme. Shpresoj të arrish gjithçka që do dhe të uroj shumë suksese!

Nicole: - Një vajzë shumë e dashur dhe argëtuese me të gjithë. Të uroj suksese në vitet në vazhdim!



Sara Çollaku

Sindi Nikolli: - Miqësia jonë filloi në vitin e parë të gjimnazit pasi ramë në klasë bashkë dhe gjithmonë do ta mbaj mend se si u afruam, edhe pse shumë rastësisht duke u ulur në bankë bashkë. Bashkë kemi krijuar disa nga momentet më të bukura gjatë gjimnazit, të cilat do t'i kujtoj si më të veçantat për mua. Bashkë kemi ndarë momentet më të bukura si dhe ato më pak të tilla dhe jam e bindur që do të vazhdojmë po kështu në të ardhmen dhe kur rrugët tona të ndahen prej distances. Nuk do të arrij kurrë ta gjej ngrohtësinë që ti më ke dhuruar tek dikush tjetër. Të falenderoj për çdo gjë që ke bërë për mua dhe për çdo herë që ke qenë aty për mua. Ne jemi dhe do të jemi gjithmonë shoqet më të mira të njëra-tjetrës. We are Serena and Blair but the better version of them. Të dua shumë dhe të uroj shumë suksese në çdo rrugëtim të jetës tënde, do jem gjithmonë aty për ty. <3

Nicole Kolaveri:- Sarën e njihja që në fillore, jo me emër por si ajo goca që vinte me vonesë, në të njëjtin orar me mua. Ecte shumë e vendosur, diçka që nuk e kisha parë asnjëherë në pikë të mëngjesit. Më vonë, në klasë të shtatë, klasat na ishin bashkuar në orën e fiskulturës dhe Sara më hipte në nerva. Më dukej shumë llasticë (s'isha gabim për këtë) dhe gjithmonë të shikonte me një shikim skeptik kur flisje. Kur ramë në klasë të tetë bashkë filloi dhe miqësia jonë aty ku kuptova që Sara s'ishte AQ acaruese sa unë, paragjykesja numër NJË e mendoja. Të ndihmonte kur mundej, madje shkonte në masa të palimituara që shumë njerëz as nuk mund t'i perceptonin për të ndihmuar dikë. Të bënte për të qeshur në momentet dëshpëruese dramatike që kishim si adoleshentë. Të fliste pa rezervim social. Dhe ngadalë e ngadalë u bë pjesë e përditshmërisë sime, privilegj i madh. Të kesh Sarën shoqe është të jesh pjesë e njerëzve me fat,

dhe duke e shkruar këtë ndihem e tillë. Akoma është acaruese, por në një mënyrë që të plotëson ditën. E di që ëndërron shumë, të uroj udhëtimin më të ëmbël drejt plotësimin të tyre dhe do të jem aty duke të të suportuar. Të kam xhan dhe të uroj suksese!

Anisa:- Miqësia jonë filloi që në klasën e tetë, kur ramë në bankë bashkë, dhe jam shumë e lumtur që e kemi mbajtur atë gjatë viteve. Voicet e tua dhjetë minutëshe që ndihen si podcasts dhe idetë e pafundme kreative nuk do më mërziten kurrë. Karakteri që ke do të të bëjë të veçantë kudo që të shkosh. Ti je një shoqe e vërtetë, zemërgjerë dhe kush të njeh është me fat. Një nga cilësitë tua më të veçanta është toleranca dhe në raste kur nuk duhet. Je një nga personat e paktë që ma heq gjithë turpin dhe ndihem gjithmonë e lirë rreth teje. Nga paniku i vitit të parë kur merrnim pjesë në çdo aktivitet dhe konkurs për të mbledhur certifikata, ne kemi krijuar disa nga kujtimet më të mira së bashku. Historitë dhe humori që sjell në çdo moment i bëjnë ditët e mia më të këndshme dhe aftësia jote për t'i kthyer momentet më të zakonshme në memorije të paharrueshme është diçka që do ta vlerësoj gjithmonë. Tani që po i afrohem maturës, dua të të falenderoj me zemër për kohët e mrekullueshme që kemi kaluar gjatë këtyre viteve dhe mbështetjen tënde kur kam pasur nevojë. Mezi pres të krijojmë sa më shumë momente të bukura së bashku dhe pas gjimnazit. Të kam shumë xhan dhe të uroj vetëm lumturi e sukses në të ardhmen tënde!

Greta Berisha: - Sara, së bashku kemi kaluar të gjithë vitet e gjimnazit. Je një vajzë shumë e bukur, e cila fal mbështetje, kujdesje, dashuri, buzëqeshje dhe përqafime të pafundme. Je një person i qetë me shpirt të madh ku çdo gjë dhe çdo njeri ka vendin e tij. Gjithmonë ke qenë aty për mua dhe për këtë gjë jam shumë falenderuese. Uroj që çdo sukses i yti të jetë i madh, pasi buron nga një shpirt i pastër dhe i sinqertë. Të kam shumë xhan, kiss!

Hilda Marinaj: - Sara, vajza me flokët më të bukura në shkollë. S'do t'i harroj kurrë momentet e bukura që kemi kaluar bashkë. Faleminderit që ke qenë pjesë e këtyre viteve, sepse i ke shtuar mjaft të qeshura. Je shumë pozitive dhe gjithashtu je gjithmonë e gatshme për të dhënë këshilla mjaft të vlefshme. Mendoj që çdo person duhet të ketë një shoqe si Sara. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj t'ja dalësh mbanë kudo që të shkosh, bbyy!



Bjorn Tupi

Brusen Tupi: Bashkë jemi rritur dhe kemi kaluar shumë momente të bukura së bashku. Në pjesën më të madhe të iniciativave të jetës i kemi ndarë bashkë dhe gjithmonë kemi qenë ndihmë për njëri-tjetrin. Gjithmonë një kushëri është vëllai që nuk e ke kurrë. Të uroj suksese dhe mbarësi në jetë!

Jonuz Gjini: O Fieri! Jemi njohur bashkë që në vit të parë dhe ke ngelur po i njëjti djalë i sjellshëm dhe pozitiv në të gjitha situatat. Kemi kaluar shumë kohë të bukura së bashku dhe plot me të qeshura. Të uroj shumë suksese dhe të plotësoshin të gjitha dëshirat që ke!

Sakistjo Meraj: E vlerësoj shumë durimin tënd, pasi je një person që gjithmonë duron edhe pse të tjerët mund të sillen keq me ty, ti zgjedh që t'i largohesh konfliktit. Të këshilloj të mendosh më shumë rreth gjërave që has në jetë, pasi jo çdo gjë mund të kalohet me një mendje të lehtë siç vepron ti në shumicën e rasteve. Mbi të gjitha, je një person që me të vërtetë vlerësoj dhe konsideroj si një shok të vërtetë. Të uroj sukses në çdo hap të jetës dhe jam i sigurt se do të arrish në pikën që ti ke qejf më shumë, të bëhesh një inxhinier për brandin tënd të preferuar të makinave BMW. Me respekt, Sakistjo.

Joana Taraj: Të jesh nga Fieri, rrjedhmisht do të jesh i mirë, ndaj dhe ti, Bjorn, nuk mund të ishe ndryshe! Gjithmonë i qeshur, ti i ke dhënë klasës shumë pozitivitet! Orët e fizikës do të ishin shumë të mërzitshme pa ty. Të uroj sa më shumë suksese në çdo rrugë që do ndërmarrësh në jetë! Përzemërsisht, Joana.

Bajram Kuqi: Pavarësisht shakave me njëri-tjetrin, do

mbetesh një shok i mirë i cili di të pranojë dhe të bëjë shaka. Të uroj më të mirat për të ardhmen. Suksese, nga Bajrami.

Arlind Islami: Je një nga djemtë më të mirë dhe më pozitiv që kam njohur, mos të them më pozitiv. Je një djalë që bën shaka po edhe mban shaka. Jam shumë i lumtur që të kam pasur në klasë sepse disa orë mësimi i bën të kalojnë më shpejt. Shpresoj të shihemi edhe pas gjimnazi dhe të uroj mbarësi kudo të jesh!

Keit Gjata: Je një shok vërtet i mirë dhe i sinqertë. Më pëlqen pozitiviteti yt dhe batutat e tua. Të uroj suksese kudo!

Arbi Ciftja: Për aq sa të kam njohur, je një djalë shumë pozitiv dhe tepër gazmor. E gjen gjithnjë mënyrën për të krijuar një situatë për të qeshur në klasë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Neki Rrapaj: Kemi kaluar tre vjet tashmë në të njëjtën klasë dhe besoj se mund të them se të njoh shumë mirë. Aq sa për të thënë që je një djalë flori. Shpresoj të të realizohen të gjitha dëshirat. Suksese në jetë, Patriot.

Detjon Xhepi: Të kam njohur që në vitin e parë, vëlla, dhe nuk jam penduar për çdo moment që kemi kaluar së bashku. Gjithashtu dua të shtoj që ke qenë një shok dhome shumë i mirë për këto tre vite të gjimnazit. Dua të të them që shpresoj të mos ndryshosh nga Bjorni që njoh unë dhe gjithashtu të uroj suksese të mëtejshme kudo që të ndodhesh, vëlla!



Eliora Qëndro

Alvis: Eliora, koha që kemi kaluar së bashku gjatë gjimnazit ka qenë e jashtëzakonshme. Ndërsa përgatitemi për një kapitull të ri, rikujtoj të gjitha momentet që kemi ndarë gjatë këtyre tre viteve. Kjo eksperiencë nuk do të kishte qenë kaq e veçantë pa ty, dhe për këtë të jam shumë mirënjohës. Të uroj sa më shumë lumturi dhe të përmbushësh të gjitha ëndrrat e tua. Le të jetë kjo fazë e re e mbushur me emocione dhe përvoja të çmuara. Suksese!

Marina: Je një vajzë që kam shumë kohë që e njoh, më vjen mirë që kemi kaluar tërë këto vite bashkë. Je një njeri konfident që kurrë nuk ka frikë të thotë atë që mendon. Kam shumë kujtime të bukura me ty dhe në kohët më të vështira të kam pasur aty. Gjimnazi për ne të dyja ka qenë i gjatë dhe kanë ndodhur shumë gjëra, por besoj se miqësia jonë do të vazhdojë! Të uroj suksese në jetë!

Keit: Je një vajzë shumë e mirë dhe e komunikueshme. Më pëlqen qetësia jote. Të uroj suksese në jetë!

Ranim: Eliora, jemi njohur këtë vit dhe mund të them se je një vajzë e sjellshme dhe e qetë. Të uroj suksese më tej.

Anisa: Eliora, ti je një vajzë e shkathët dhe shumë miqësore. Shpresoj që karakteri yt pozitiv dhe i këndshëm të të shoqërojë në të ardhmen. Të uroj shumë suksese!

Nicole: Eliora, shpresoj që gjithmonë të kesh të njëjtën aftësi biseduese, nuk ke asnjë tregim të mërzitshëm. Të uroj suksese në vazhdim!

Brajan: Një vajzë e qetë dhe e sjellshme. Gjithmonë e

gatshme për të ndihmuar. Suksese në të ardhmen!

Bajram: Faleminderit për miqësinë tënde të vërtetë dhe për çdo moment të bukur që kemi ndarë së bashku. Të uroj më të mirat. Suksese, nga Bajrami.

Arlind: Bashkë kemi qenë në klasë që në vit të dytë dhe di të them se je një vajzë me karakter të fortë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen dhe shpresoj të arrish atë që dëshiron!

Arbi: Për këto vite të gjimnazit mund të them se kam arritur të të njoh si një vajzë të qetë dhe të sjellshme. Në përshtypje të parë dukesh tepër serioze, por me kalimin e kohës ke arritur të vërtetosh se nuk je e tillë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen!

Joana: Je një vajzë e rezervuar dhe shumë realiste. Punon për gjërat që do dhe shpresoj që kjo të të ndihmojë në arritjen e synimeve të tua. Shumë suksese! Joana

Denis: Kemi qenë së bashku që në klasë të 8-të dhe jemi afuar më shumë vit për vit. Respekti që kam për ty nuk ka ndryshuar asnjëherë dhe do vazhdojë të qëndrojë ashtu gjithmonë edhe pas shumë viteve. Opinioni yt ka qenë gjithmonë i mirëmenduar dhe i saktë sa herë që e ke dhënë. Të uroj suksese në të ardhmen!

Megi Jata: Eliora, shoqja më fisnike që kam njohur... mund të them që të kam njohur që në 9-vjeçare. Ti e di shumë mirë që unë jam selektive me personat që zgjedh të rri dhe këtë gjë besoj se e ke parë. Nuk do i harroj asnjëherë ato daljet tona spontane sa herë mbaronte shkolla, as shoqërinë e pastër dhe fisnike që ke treguar ndaj meje. Edhe pse nuk kemi qenë shumë afër këtë vitin e fundit, kjo nuk do të thotë që i gjithë admirimi që kam për ty si person është shuar. Pak njerëzve mund t'u them vërtet të afërt dhe shpirtbardhë dhe ti je një ndër to. Nuk dua të zgjatem shumë pasi ti e di ç'mendim kam unë për ty dhe një tekst nuk do ta përshkruante dot, kështu që po e mbyll duke ditur që shoqëria jonë nuk do të rresht asnjëherë së qeni... të kam shumë xhan dhe suksese pac gjithmonë!

Alesja Quku: Po si moj goce je kaq e mirë!? Je numri një për muhabet. Nuk të mungojnë batutat asnjëherë. Në fillim më je dukur tip i ftohtë, por pasi të njoha ishe me të vërtetë e çiltër. Më vjen mirë që të kam njohur. Të uroj shumë suksese në të ardhmen! Je e veçantë.



Eskobar Elezi


Eliora– Je një person shumë i lëvizur dhe i gëzuar, që bën shumë shaka, por ndonjëherë edhe e tepron. Prapëseprapë, je i këndshëm në stilin tënd. Të uroj shumë suksese në jetë!

Brajan: Do të na mungojë pozitiviteti që përcjell, por mbi të gjitha, humori yt. Shpresoj që të ecësh mbarë kudo në jetë. Të uroj suksese!

Joana: Eskobari, djali më gallat i klasës! Do të të kujtoj gjithmonë si një djalë shumë pozitiv dhe të uroj shumë suksese në jetë!

Brendon: Një djalë i sjellshëm dhe i shoqërueshëm. Të gjendet pranë atëherë kur ke nevojë dhe bën shaka me të gjithë. Të uroj suksese!

Arlind: Kam dëgjuar shumë legjenda për ty gjatë viteve në shkollë, dhe këtë vit ato legjenda u provuan të vërteta. Je një djalë shumë i mirë, i cili edhe pse nuk mëson shumë, respekton goxha. Të uroj sa më shumë gëzim në vitet e ardhshme.



Matura 2024









Rajmonda Haxhiaj

Të dashur nxënës të klasës 12-E!

Në një mëngjes të ngrohtë shtatori të datës 13, të vitit 2021, nisi rrugëtimi juaj në gjimnaz, në klasën 10-E. Mbaj mend që kisha kureshtje për t'ju njohur. Ju më pritët me buzëqeshje, por edhe pak me ndrojtje dhe në fytyrat tuaja lexohej emocioni i një fillimi të ri.

Tani, pas tre viteve, ju shoh të rritur, të maturuar dhe sërish me të njëjtat emocione të ditës së parë, emocionet e hedhjes së hapave drejt universitetit. Është bukur dhe shumë emocionuese të shikosh sa shumë jeni rritur, sa shumë keni ndryshuar dhe sa shumë janë zhvilluar aftësitë tuaja. Ai grupi i adoleshentëve të datës 13 shtator 2021, sot, në qershor të 2024-ës është një grup miqsh, që me ëndrra të mëdha hidhet në të ardhmen. Në këtë rrugëtim, kujtime të shumta janë ndërtuar dhe, duke hedhur shikimin pas, unë ndiej më shumë se sa nostalgji; ndiej krenari për rritjen dhe përparimin tuaj.

Për mua, si mësuese kujdestare, ka qenë një kënaqësi të shihja angazhimin tuaj dhe perkushtimin për të arritur rezultate të mira, por mbi të gjitha ka qenë kënaqësi të shoh të rriten para meje individë me parime e vlera që rrallë i gjejmë sot mes nesh. Ju keni qenë frymëzim për mua.

Arnisi, përherë i qetë, asnjëherë nuk u ankua apo kërkoi diçka pa e merituar.

Bjorni, djalë i urtë, që na tregoi se nuk është e vërtetë që brezat e rinjë nuk sakrifikojnë për t'u shkolluar sa më mirë.

Danieli, babaxhani i klasës, që tregoi modelin më të mirë të njeriut që shpërndan pozitivitet.

Dea, energjike, luftarake, modeli i vajzës që merr atë çka do dhe nuk pret gjë prej rastësisë.

Eldi, ``vullkani`` i klasës, që gjithmonë kishte diçka për të thënë. Edhe kur nuk fliste, besoj se krijonte ndonjë skenar në kokë.

Emili, kombinimi perfekt i ëmbëlsisë me seriozitetit, i shkëlqimit modest e pa bujë.

Endi, që pati fatin e keq që pëshpërimat i dëgjoheshin si ulërime. Megjithatë, gjithmonë djalë me vlera dhe me qëllime të mëdha.

Ensar, djali modest që kurrë nuk iu dëgjua një fjalë e keqe t'i dalë nga goja.

Ermiri, shembulli i djalit të fortë, që sfidat e jetës nuk arrijnë t'ia zbehin buzëqeshjen.

Fabio, rehatlliku. Një vit te 12-E, por nga 12-E nuk iku asnjëherë. Gjithmonë të qeshur e pozitiv e pashë në klasë.

Flavio, djali që iu desh të ndërronte 2 shkolla e 3 klasa në 3 vjet, por që tregoi që kur je i dashur dhe pozitiv, kudo do të gjesh vendin tënd.

Gleni, sa shumë ka qeshur! Një motor energjie! Një kameleon që përshtatej kudo dhe po kudo linte gjurmën e vet unike.

Greisi, vajzë dinjitoze, e rritur me parimin e së drejtës dhe me dëshirën për të merituar atë që merr.

Iliri, djali me zemër të mirë, plot humor dhe energji.

Kapllani, misteriozi i klasës. Sado mister që mbeti, arritëm të dallojmë te ai perkushtimin, logjikën dhe zemrën e mirë që ka.

Kesli, e ëmbël, e ndjeshme. Një vajzë me shpirt të butë, që kishte gjithmonë dashuri për të dhënë për të tjerët.

Matura 2024

Klea Çulaj, shkodranja që të gjithë kishin fjalë të mira për të thënë për të.

Klea Metaj, shembull i përkushtimit dhe i arritjeve me punë të madhe.

Rei, djali që arriti të rritet shumë në 3 vite dhe të tregojë që punon fort për ëndrrat e veta

Sara, vajza e dashur që, edhe në kulmin e nervave të ishe, do të ta zbuste zemrën.

Sindi, përherë me një buzëqeshje. Shembull i njeriut që e merr jetën lehtë...

Xhejmon, djali serioz, që asgjë nuk e ndaloi për të shkuar drejt rrugës që ka zgjedhur.

Dikush nga ju më pyeti nëse do më marrë malli për ju dhe përgjigjen e kësaj pyetje po ua jap sot. Do të më mungoni shumë, por dijeni se do vazhdoj t`ju mbështes, duke qenë e sigurt që ju do i jepni vlerë çdo ditë të jetës suaj, sepse jeni njerëz me shumë vlera.

Uroj që të gjitha ëndrrat dhe synimet tuaja të përmbushen, të jeni gjithmonë të lumtur, të suksesshëm dhe të arritur, sidomos në nivelin shpirtëror!

Përzemërsisht, zysh Rajmonda!



Arnis Llazari

Daniel Lavdari - Kur kujtohem që kam gjeografi, te Arnisi shkoj për ndihmë. Momente shumë të bukura kemi kaluar bashkë, të cilat më kujtohen shpesh. Je person që të karakterizon urtësia dhe mençuria. Të uroj suksese në jetë dhe t`u realizofshin të gjithë dëshirat! Ty të kam dedikuar dhe këtë:

Një mendim po pres të më vij,
S`më vjen gjë tjetër përveç
Fjalëve mirësi, respekt dhe shoqëri,
Që të pakufijshme janë tek ti.

Eldi Pashaj - Arnis, je një nga shokët e mi më të mirë dhe një nga çunat më të saktë që kam takuar në këtë shkollë. Kemi kaluar bashkë shumë gjëra, duke filluar nga lojërat që luanim në klasë të 8-të dhe deri te galletat që bëjmë në bankën e parë, gjatë orës së fizikës. Kam mësuar shumë gjëra nga ty, sidomos kur vjen puna për gjeografi dhe histori. Je një djalë me shumë disiplinë dhe karakter. Kam fatin që kam takuar një `kokëmadh` si puna jote <3, Visca Barca! Visca Catalunya!

Emili Leka – Sa më shumë kalojnë vitet në shoqërinë tonë, aq më shumë të vlerësoj për karakteristikat e tua. Je një djalë shumë i sjellshëm, i matur, i zgjuar, por mbi të gjitha je një person shpirtmirë. Ke qenë i gatshëm të na ndihmosh të gjithëve si klasë, ndaj jo më kot je senator. Jam e sigurt se do të arrish gjithçka që do në të ardhmen.

Endi Rexhepi - Aptullah, njeriu Zotit! Gjithë këto vite u bënë që njihemi dhe kurrë nuk u ndamë. U bënë 6-7 vite besoj. Si kanë kaluar o Tulle!!! Me ty në bankë kam qenë në klasë të 6-të dhe me ty në bankë

do e mbyll edhe vitin e fundit të gjimnazit. Gati të gjitha kujtimet e këtyre viteve i kam pasur me ty dhe shpresoj të krijojmë kujtime të reja në universitet, po të jemi bashkë. Je djali më atdhetar dhe i disiplinuar që njoh dhe kjo gjë të bën ky që je. Do më kujtohesh gjithmonë si një nga shokët më të mirë dhe me më shumë ndikim te unë. Të uroj më të mirat Tulle, kolegu im programues!

Glen Qesku - Uooo Arnisooo! Ke kokën më të madhe në botë... domethënë... më të bukur, se u ngatërrova! Kemi gjithë këtë kohë që jemi shokë bashkë dhe një nga kujtimet më të bukura që mbaj mend është kur jemi ulur bashkë tek divani në ditëlindjen tënde dhe ti po kërkoje telefonin. Atë ditë kanë ndodhur shumë gjëra, që nuk ka nevojë t`i përmend ahahaha. Më mungojnë ditët kur bënim palester bashkë dhe i dërgonim Endit video duke stërvitur pulpat. Uroj që të jesh ky djalë i matur dhe me principe të forta që je tani dhe një ditë të kesh makinën dhe shtëpinë tënde të ëndrrave, siç e ke vizatuar njëherë tek Konkursi i Vizatimit. Po e mbyll duke të uruar sa më shumë fat dhe sukses në jetën tënde!

Kesli Sejdarasi – Arnis, ti je djali që rri gjithmonë në qetësi, edhe pse nuk je natyrë e urtë. Koha gjatë së cilës të kam njohur më mire, ka qenë në vit të dytë, kur të kisha edhe shok banke. Më përpara mendoja se je njeri i ftohtë dhe shumë i mbyllur, por kur arrita të të njihja nga afër kuptova që je shumë më ndryshe. Je njeri shumë ambicioz dhe mendoj se do ecësh shumë përpara në jetë. Uroj të kesh sa më shumë suksese dhe t`i arrish të gjitha gjërat që do!

Rei Xhoga - Senatori ynë i dashur, me plot siguri mund të them se je një nga personat më të dashur që njoh. Je njeriu më i qetë, por edhe më i zgjuari në klasë. Kujtimet tona duke luajtur "Warzone" për orë të tëra, së bashku me Glenin dhe Eldin, do të jenë të paharrueshme për mua. Të uroj më të mirat dhe suksese të mëtejshme në shkollë të lartë! Me respekt dhe miqësi, Xhoga.



Bjorni Prrini

Dea Merkaj - Je një djalë i urtë, por edhe shakator. Sa herë përmendet emri yt në klasë, mendimi i parë që më vjen në mend është mënyra se si artikulon në orën e historisë, në një menyrë shumë të natyrshme e të këndshme. E vlerësoj shumë thjeshtësinë tënde, pasi ditët e sotme është e vështirë ta shikosh këtë tipar te njerëzit. Të uroj sa më shumë suksese dhe mbarësi!

Ensar Zhuka - Jemi takuar për herë të parë në klasë të tetë dhe që atëherë kemi kaluar shumë aventura të bukura bashkë. Je një person shumë i qeshur dhe uroj që mos të ta heqë njeri atë lumturi! Je një djalë shumë i zgjuar dhe ke shumë ide të veçanta. Edhe pse mbaroi gjimnazi, nuk besoj se do të rrimë pa folur bashkë. Të uroj shumë suksese dhe të bëhesh një programues shumë i mire!

Fabio Dani - Bjorn more Bjorn, nga ku t'ia nis? Kemi kaluar shumë kohë të bukura bashkë. Batutat tona s'kanë të mbaruara. Je një djalë shumë i mire, po ashtu edhe një shok shumë i mirë. Të uroj më të mirat, sepse e meriton!

Greis Koka – Bjorn, je një djalë i urtë. Më bën shumë për të qeshur kur i referohesh koncepteve të historisë me fjalinë “e po ça e kanë ato...”. Je zgjatur goxha këto vite. Nuk mendoja se ishte e mundur që dikush të zgjatej aq shumë. Të uroj shumë suksese dhe fat në të ardhmen!

Kapllan Sheno - Edhe pse jemi njohur jo prej shumë kohësh, më kujtohen plot momente kur kemi qeshur bashkë (seminaret). Bjorn, je një djalë i qetë dhe i dashur, gjithmonë gati për të sjellë një grimcë humor dhe dritë në çdo moment. Do ta di gjithmonë për nder që, edhe kur kishe vetëm një çamçakëz, nuk e mbaje

për vete, por ma jepje mua. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në jetë! Me respekt nga shoku yt, Kapo.

Kesli Sejdarasi – Bjorn, je një djalë shumë i urtë, i respektueshëm dhe zemërgjerë, që kujtohesh të marrësh orbitë gjithmonë për ne. Nuk do t'i harroj kurrë orët e anglishtes, kur zysha na vuri në një bankë dhe ti mekeshe përherë me shakatë e mia. Të uroj shumë suksese në vazhdim!

Rei Xhoga - Me kënaqësi po ndaj pak fjalë për ty, për këtë udhëtim të përbashkët, shoku im i shkëlqyer! Me dashamirësinë dhe shpirtin tënd bujar, i ke bërë ditët në shkollë të jenë jo vetëm produktive, por edhe të këndshme. Falemnderit që ke qënë gjithmonë aty për një këshillë të mençur, për ndonjë shaka që na bënte të qeshnim dhe ndihmën pa kursim në çdo detyrë! Bashkëpunimi ynë ka sjellë jo vetëm sukses, por edhe një atmosferë të këndshme dhe motivuese. Dua të të falenderoj për shoqërinë tënde të shkëlqyer. Me respekt dhe miqësi, Xhoga.



Daniel Lavdari

Arnis Llazari - Jemi njohur bashkë në vit të parë, e mund të them se, që atëherë, jemi afruar shumë dhe një nga arsyet e këtij afrimi kanë qenë ditëlindjet e Glenit. Je një djalë shumë i sjellshëm dhe besnik. Së bashku, në orën e gjeografisë, jemi të paparë. Të uroj shumë suksese në rrugën që do të vazhdosh në jetë!

Dea Merkaj - Danieli nuk është një individ që mund të rastisë çdo ditë. Ai ka një inteligjencë të lartë dhe një korrektësi maksimale në aspekte të ndryshme të jetës. Në qoftë se do të përshkruaja një karakteristikë të Danielit që do të doja ta kisha edhe unë, ajo do të ishte mënyra e të menduarit dhe të parapriturit e gjërave. Edhe pse Danieli është tip i qetë dhe pak i mbyllur, më bëhet qejfi kur e shikoj të ambientuar, duke dalë nga zona e komfortit. Shpresoj që gjithçka të shkojë sa më mirë dhe më bëhet qejfi që të kam njohur dhe që të njoh vazhdimisht dita ditës. Suksese të mëtejshme!

Eldi Pashaj - Daniel, je një djalë fjalëpakë dhe i matur. Kemi kaluar edhe ne të dy disa aventura, si me atë cheesecake-un e shpifur të D'Angelos dhe gallatat që kemi bërë në Qerret. Shpresoj që të shkosh në Amerikë, se, me sa na ke thenë, ai është vendi i cili ti po synon dhe shpresoj që t'ia dalësh dhe të të vijë të gjitha të mirat! Bëji te fala Estit!

Endi Rexhepi - O Dane, gjithë gjimnazi kaloi me ty në një bankë para meje. Ishim ajo 4-shja aty në fund, që gjithmonë bashkë e shtynim mësimin dhe kështu, mësim pas mësim, kaluan 2 vite. Çdo vështirësi të këtyre dy viteve e kemi kaluar bashkë dhe janë krijuar disa kujtime të paharrueshme. Je djali më moskokçarës që njoh dhe kjo gjë të karakterizon. Shpresoj të plotësohen të gjitha ëndrrat që ke dhe të ecësh para në jetë. Suksese Dane!

Glen Qesku - Dane, kemi që në klasë të parë që njihemi bashkë. Je shoku im më i vjetër. Në bankë dhe në kurs kemi që në vit të parë bashkë. Dalim bashkë, madje edhe kemi fjetur në një krevat. Me ty e kam ndarë tavolinën e bukës që i vogël dhe nuk e harroj dot këtë gjë. Mbas gjithë këtyre viteve miqësi, akoma nuk e kuptoj se si ti ha më shumë se unë dhe nuk shëndoshesh, kurse unë po. Një nga dilemat e tjera që kam pasur gjatë gjithë këtyre viteve shoqëri është se si ka mundësi që përton kaq shumë, megjithëse vitet e fundit jam mësuar. Shpresoj që dhe universitetin ta bëjmë bashkë, sepse ndryshe s'kemi gjë në vijë ahahaha. Meqë je një poet i shkëlqyer, po të shkruar një poezi titulluar "Kohë të vështira" Pse duhet të jetë jeta kaq e vështirë

O Dane a ke pak ujë për të pirë?
Na iku jeta shokë bashkë, po çë do
Se vetëm një herë në bilardo t'kam rraf.

Greis Koka - Danieli është fjalëpakë, por ama gjithmonë aty për të dëgjuar. Është jashtëzakonisht i zgjuar, edhe pse përtacia e tij e pengon të arrijë potencialin që të gjithë shohim te ai. Jam e lumtur që kemi qenë të afërt, pasi shoqëria jonë, bashkë me Glenin dhe Dean, e kanë bërë gjimazin të paharrueshëm. Më bëhet shumë qejfi që të kam pasur në klasë gjithë këto vite. Të uroj sukses kudo që të të çojë jeta!

Kapllan Sheno - Daniel, ti je personi që shprehja "zgjidhe shokun më të mirë se vetja" merr vërtet kuptim. Inteligjenca jote dhe qetësia që ti ke në çdo situatë, mua shpeshherë më bëjnë përshtypje. Duke njohur karakterin tënd, jam i bindur se të gjitha qëllimet që i ke vendosur vetes do t'i arrish shumë shpejt, kështu që shto edhe disa të tjera. Të uroj suksese kudo në jetë dhe shpresoj që të vazhdosh studimet për shkencë kompjuterike në New York (ose në një vend tjetër, po që se ke ndryshuar mendjen)!

Rei Xhoga - Në qoftë se do të më pyesnin se cili është personi më i sjellshëm që njoh, do të zgjidhja Danielin. Ai është një person të cilin nuk e kap dot kurrë duke ofenduar, fyer ose tallur dikë. Me Danielin jam njohur që në klasë të 9-të dhe miqësia jonë është zhvilluar vit për vit. Danieli është një person, i cili me një fjalë mund të rrëfejë një histori të tërë. Ai është një djalë besnik dhe i sjellshëm, dhe e di që s'jam i vetmi që mendon kështu për të. Shpresoj që e ardhmja të jetë vetëm me të mira dhe me plot sukses. Miku yt, Xhoga.



Dea Merkaj

Daniel Lavdari - Si çdo klasë, edhe ne kishim ditët tona kur vinim pa mësuar, por ne kishim Dean që na shpëtonte në të tilla raste, sidomos në lëndët sociale. Dea karakterizohet nga një bagazh i madh fjalësh dhe dijesh, për t'u patur zili. Me vullnetin e madh dhe me aftësitë që zotëron, jam i sigurt që do ia dalësh të realizosh ëndrrat e tua. Të uroj veçse suksese në jetë!

Glen Qesku - O Dea, si në klasën e nëntë, ashtu edhe gjatë viteve të tjera, e stresuar mbete! Qetësohu pak, moj vajzë! Ato që na kanë inat, as tek gishti i vogël i këmbës nuk na vijnë (e di vet ti çfarë themi në këto raste). Të përshëndes me këngën ``Gips`` të Mato Lalës. Të uroj suksese në karrierën tënde si avokate ose kryeministre e ardhshme! Shpresoj të luftosh në sallën e gjyqit, sikur lufton me zyshat kur të ulin pikë në teste.

Greis Koka - Nuk e di se si përfunduam këtu, por s'më intereson, pasi kam gjetur një person që e dua në çdo hap të jetës. Je një vajzë unike dhe shumë e fortë, dhe këtë gjë e tregon çdo ditë e më shumë. Me ty kam kaluar tre vitet e gjimnazit dhe, edhe po të mundesha, s'do ndryshoja asgjë. Në fillim të klasës së tetë, opinionin për ty ishte neutral, pasi s'të njihja edhe aq mirë dhe ke pasur goxha reputacion, por ti je shumë më shumë se nga çfarë njohin njerëzit. Je e dashur (po, po, e vërtetë) dhe jep shumë nga vetja. E vlerësoj mënyrën se si ti mundohesh të kujdesesh për njerëzit, pa e vënë re ata. Nuk para i shpreh ndjenjat dhe e di se ke pasur dyshime për shoqërinë, por e vërteta është se nuk mendoj se do të gjej një person, me të cilin kam një lidhje shpirtërore, më shumë seç kam me ty. Më duket e pamundur që të ndihem kaq mirë me dikë tjetër sepse tashmë ti je bere pjesë e imja. Do ta kem të vështirë të hapem me tjetër person, apo

të bëj të njëjtin humor idiot siç kemi ne të dyja dhe ta kuptoj një person në sekondin që e shoh, siç ndodh me ty. Një pjesë e zemrës sime do të shkojë kudo që do të shkosh ti dhe për këtë mos dysho asnjëherë. Të dua shumë!

Kapllan Sheno - Që në fillim të gjimnazit, më kishe dhënë përshtypjen që kishe një karakter krejt ndryshe nga të tjerët, dhe akoma jam i atij mendimi. Por ndryshimi është se në fillim kisha një përshtypje negative, ndërsa tani mendoj krejt të kundërtën. Je një vajzë inteligjente, me plot ambicie dhe pozitivitet. Madje, disa nga cilësitë e tua pozitive ke arritur të na i ngjitesh edhe neve. Pasioni yt për librat më ka influencuar edhe mua. Një nxënës, i cili kishte vite pa lexuar një libër jashtëshkollor, filloi ta ketë leximin një hobi të tijin. Kam besim të plotë që ti do t'i arrish qëllimet e tua, për shkak të vullnetit dhe vendosmërisë që ke. Të uroj që të pranohesh në universitetin ku ti vërtet dëshiron të shkosh dhe të arrish majat e suksesit. Shpresoj që të takohemi sërish, po kësaj here në Holandë!

Kesli Sejdarasi - Dea është një nga njerëzit më të afërt, me të cilin kam kaluar 12 vite të jetës sime. Shoqëria jonë u bë më e fortë gjatë klasës së nëntë dhe vazhdon deri sot. Ajo është shumë e sinqertë dhe mendjehapur. Dea më mbështet në vendimet e mia, por gjithashtu më kritikon. Tipari im i preferuar i karakterit të Deas është se nuk ka frikë të shprehë atë që ndien dhe natyra aventuriere e saj. Do të doja që njerëzit ta vlerësonin më shumë Dean për atë që është dhe ta shihnin atë në të njëjtën mënyrë siç e shoh unë. Kujtimet tona së bashku nuk do t'i ndërroja me asgjë. Dea të dua shumë dhe shpresoj të kalojmë akoma më shumë vite së bashku!

Rei Xhoga - Një nga gjërat që më pëlqen më shumë tek ti është fakti që je gjithmonë e drejtë, atë që ke ta thua përballë (sado e keqe të jetë). Më pëlqen fakti që je një feministe dhe parimi yt i drejtësisë gjithmonë triumfon. Diskutimet tona si klasë nuk kanë kuptim pa ty, si një orkestër pa dirigjent. Me thënë të drejtën, krijimi i një shoqërie me ty ishte diçka që s'do e mendoja se do e arrija kurrë, por jam i lumtur që ka ndodhur. Dea është një person me zemrën më të bardhë se bora dhe që gjithmonë kërkon më shumë nga vetja. Të uroj suksese në të ardhmen! Miku yt, Rei.



Eldi Pashaj

Arnis Llazari - Ore Eldi, je një nga shokët e mi më të mirë dhe njeriu më unik që njoh. Shkathtë e tua më bëjnë gjithmonë të qesh. Sa shumë lojëra që kemi luajtur bashkë, që nga PUBG, Warzone, FIFA, etj. Jam shumë i lumtur që të kam shok dhe nuk e imagjinoj dot të mos të të kisha njohur. Uroj të të plotësohet çdo dëshirë që të ka zemra sepse ti ke një zemër të madhe!

Daniel Lavdari - Eldi, je një shok i mrekullueshëm që të gjithë do të donin ta kishin pranë. Je i sjellshëm, i qeshur, humorist dhe i gatshëm për të ndihmuar. Momentet me ty janë të paharrueshme, pasi je personi më gallatë që njoh. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në jetë! Gjithashtu, s'mund ta mbyll pa këtë:

Gur gur bëhet kalaja,
Kur flet ti e qeshura arin maja,
Dy dele treqind pare,
Pa ty në klasë nuk rrihet fare.

Endi Rexhepi - Eld Pashaj, s'di nga t'ia nis me ty vëlla. Aq shumë kohë kemi kaluar bashkë këto vite, saqë s'di ç'është më përpara. E vetmja kohë në të cilën nuk kemi qenë bashkë ishte koha kur flinim. Më kujtohen rrugët e gjata për në kurs, kur ndalonim nja dy minuta për te gropa. Ai fugoni i vitit të parë, që ka qenë një nga kujtimet më të bukura të gjimnazit, nuk do harrohet kurrë, por dhe ky i vitit të tretë nuk ngelet mbrapa. Aq shumë gjëra kemi bërë, aq shumë situata kemi kaluar, por vetëm disa prej tyre mbajmë mend. Shtëpia jote u bë si shtëpia jonë e dytë. Ajo ishte baza për grupin tonë. Kujtoj atë ballkonin, që sikur ishte menduar kastile për ne, dhe që të shijonte aq shumë kur rrinim të gjithë bashkë aty. Ty nuk mund të të thërras më thjeshtë shok, por pjesëtar të familjes sime.

Jam i sigurt që kjo shoqëri nuk do të vdesë kurrë, ngado që të ikim. Po të jemi larg do më mungojnë ato muhabetet e çuditshme që bëjmë përditë dhe ato zënkat e vogla (``zezaku`` e ka fajin). Eldo, të uroj më të mirat vëllai im dhe shpresoj që pas disa vitesh të jesh koka e asaj kompanie që po të pret!

Glen Qesku - Sa shumë kemi qeshur bashkë! Nuk numërohen rastet kur zyshat më kanë tërhequr vëmendjen, sepse më bëje për të qeshur ti. Kjo shoqëri që kemi ne është e rrallë dhe e pazëvendësueshme. O bjondi im i preferuar, që ma ke bërë këtë pjesë të jetës të paharrueshme! Më vjen shumë keq që këto ditë të bukura po ikin shumë shpejt, por nëse do të ishte e mundur do ta ktheja kohën pas, që t'i përjetonim dhe njëherë orët e pafundme që kemi ndenjur bashkë, duke luajtur çdo të shtunë në kompjuter tek Blinku, sepse këto janë kujtimet e mia më të bukura. Mos të flasim pastaj për momentet e kaluara tek shtëpia jote (s'po përmend ç'është pak turp ahahha). Je i vetmi tifoz i Arsenalit që unë njoh. Shpresoj që vërtetë të të shoh lart e më lart dhe të arrish të udhëtosh nëpër botë, pas universitetit. Paç fat dhe të shkëlqesh në çdo gjë që do të bësh në jetë, sepse e meriton!

Kapllan Sheno - Nxënësi i dytë më i mirë në orën e matematikës (pas meje) dhe nxënësi më shembullor në orën e fizikës. Eldi, kohët që kam kaluar me ty në bankë kanë qenë nga më të bukurat. E si mund të harroj poezitë që ti bën për Nushin dhe "precipita"? Vërtet jam mirënjohës që kam njohur një person si ty. Të uroj suksese me studimet në Barcelonë! Nga shoku i bankës, Kapo.



Emili Leka

Albana Bami- Emily, çdo vit që kalon shoqëria jonë vazhdon dhe shtohet, por gjatësia jo, gjithsesi s'ka problem se kemi njëra-tjetrën. Bashkë kemi kaluar shumë momente të bukura dhe funny, që nuk kanë të mbaruar. Jam e sigurt që kështu do të vazhdojë edhe për shumë vite të tjera... nëse ti i mban premtimet. Je shoqja më e zgjuar e grupit dhe nuk e di se çfarë do kishim bërë ne pa ty. Jam shumë e lumtur që je pjesë e jetës sime! Të uroj shumë suksese në vazhdim dhe më të mirat e botës, sepse i meriton! Love you!

Dea Merkaj - Emilia është një vajzë pozitive, që sa herë e shikon të qeshur, të vjen dhe ty instiktivisht të qeshësh. Karakteri i fortë i saj i mundëson vetëm sukses në të ardhmen, pasi ajo punon fort për gjërat që do dhe nuk dorëzohet asnjëherë. Emilia është një vajzë që kur e takon, ti dëshiron të kesh afrimitet. Sa më shumë të njoh, aq më shumë kuptoj pse ti ke për të vazhduar goxha përpara dhe se si ke për t'ia dalë mbanë në realizimin e ëndrrave të tua, pasi personaliteti yt është mbresëlënës. Shpresoj të të shikoj sa më lart!

Eldi Pashaj - Një motorriste e vërtetë! Gjithmonë e buzëqeshur dhe nuk ka asgjë që nuk i bën dot ballë. Suksese!

Flavio Gjoka - Të gjitha veçoritë e mira që një person mund të ketë, mund t'i gjesh tek ti, duke përjashtuar faktin se nga vjen. Ajo nuk mund të lihet pa përmendur. Të uroj sa më shumë suksese!

Glen Qesku - O Milo, je një nga njerëzit më pozitiv të klasës. Një vajzë si ty nuk e kanë të gjitha klasat, dhe për këtë na kanë zili. Të uroj të gjithë të mirat, por mos harro, ki kujdes topuzin!

Greis Koka - Je vajzë e mrekullueshme, me vullnet të çmendur dhe jashtëzakonisht inteligjente. Mendoj se je bërë për gjëra të mëdha. Shpresoj të jesh e vetëdijshme për këtë, e të mos e humbasësh asnjëherë vetëbesimin. Suksese! Banda e Komunes.

Kapllan Sheno - Je vajza më e mire që ka kjo shkollë. Çuditë se si një person i ka gjithë këto të mira. Thonë që çdo person e ka një huq, por unë akoma nuk kam arritur ta gjej atë tek ti. Ndajmë plot momente të bukura që nga klasa e parë e ja ku jemi tani në fund të gjimnazit. Jam mirënjohës që kam takuar një vajzë si ti, sepse e di që persona të këtillë janë shumë të rrallë. Ta dish që pres goxha nga ty, sepse e di potencialin që mbart. Shpresoj të kapësh majat e suksesit dhe të takohemi edhe pas gjimnazit.

Kesli Sejdarasi - Shoqja ime e klasës dhe e furgonit. Më pëlqen që kemi që në vit të parë që ulemi tek i njejtë vend të dyja bashkë dhe diskutojmë për gjithçka. Je shumë e mirë dhe të kam shumë xhan!

Sara Pajtoni - Em, shumë e çuditshme më duket të shkruaj këtu për ty! Sa shumë vite u bënë që jemi kaq afër njëra-tjetrës në çdo moment dhe sa shumë vite të tjera do të vazhdojmë kështu. Nuk është e nevojshme të të them sa e rëndësishme je në jetën time, se ti e di këtë. Faleminderit për çdo moment të bukur që kemi kaluar bashkë dhe që më ke qendruar pranë në momente të vështira. Nuk e mendoja kurrë më parë që do të kisha një shoqëri me dike, si kjo që kam me ty. Tani do ikësh jashtë dhe akoma nuk kam filluar ta mendoj pjesën që nuk do të kem më këtu gjatë gjithës kohës. Kudo që të shkosh mua sërish aty do më kesh, sa herë të kesh nevojë. Të njoh dhe jam e bindur që do ia dalësh dhe do të kesh sukses në çdo fushë të jetës. Jam me fat që të kam! Suksese!

Xhoi Beja - Mily, my cutie pie, dhe pse ky dedikim nuk mjafton të shpjegojë çdo gjë që unë mendoj për ty, do përpiqem ta permbledh me pak fjalë. Nuk e kam pritur kurrë që ne mund të ishim shoqe, sepse më je dukur një person i ftohtë, por duke të njohur me shumë kuptova që isha gabuar. Je një person me zemër shumë të madhe dhe je një nga njerëzit më të afërt që kam. You're the smartest in our group dhe kështu do të mbetesh gjithmonë. Të uroj shumë suksese, edhe pse e di që nuk ka nevojë të t'i them këto fjalë, sepse gjithësesi do t'i arrish të gjithë ëndrrat e tua! Love you!



Endi Rexhepi

Adrin Cacaj - Rexhinald, ne jemi takuar goxha më përpara, por këtë vit jemi njohur tamam. Në kaq pak kohë je bërë një nga shokët e mi më të mirë. Ne kemi histori nga më të ndryshmet së bashku, që nuk do t'i harroj kurrë. Nga Prishtina e deri në jug, kudo kemi gjetur mënyra si të argëtohem dhe të qeshim. Shpresoj që këto aventura të vazhdojnë dhe në të ardhmen. Je shumë i zgjuar, gallatë dhe kam vetëm fjalë të mira për ty, Puki.

Arnis Llazari - Shpendi i dashur! Të njoh që në klasë të 6-të dhe që atëherë jemi bërë jo vetëm shokë, por vëllezër. Je një nga miqtë e mi më të mirë dhe shpresoj që do të jesh i tillë përjetë. Bashkë jemi njohur që kur ishim fëmijë, e po prapë bashkë jemi tani që jemi rritur. Me ty dhe me çunat kam kaluar disa nga momentet më të bukura të jetës sime, dhe shpresoj që në të ardhmen do të krijojmë momente edhe më të bukura akoma. Të uroj gjithë të mirat, o pëllumb!

Daniel Lavdari - Kemi shumë vite që njihemi, ndaj kemi bërë akoma edhe më shumë gallata. Kemi bërë shaka pafund. Ke qenë ndihmës dhe shok shumë i mire, gjatë gjithë këtyre viteve. Shpresoj të vazhdosh kështu dhe të uroj sa më shumë suksese në jetë! Por s' mund ta mbyllja me kaq, prandaj shtova këtë:

Kam një shok që është ca qejfli,
Me origjinë nga Fieri,
Ca i thonë shpendi,
Por për mua është Endi.

Eldi Pashaj – Endi, je një nga shokët e mi më të mire. Përveç kësaj, ti je dhe djali me të cilin njihem më shumë. Vështirë se mund të gjesh një të dytë si

ty. Ti ke qenë një sup ku mund të mbështetesh, një djalë mendjehapur dhe gjithmonë me ide të reja. Je ambicioz dhe syapatrembur, ndaj, në qoftë se me të vërtetë dëshiron diçka, ti mund të arrish çdo gjë. Gjithashtu ti je shumë i saktë në gjërat që bën dhe, për moshën që ke, je shumë i informuar për gjithçka që të rrethon. Po ashtu, je një djalë që e vlerëson familjen e tij, po ashtu edhe shoqërinë. Kemi qeshur shumë bashkë dhe kemi bërë jashtëzakonisht shumë gjëra. Nuk do të të ndërroja për asnjë gjë në këtë botë dhe jam shumë i lumtur që kam një shok si puna jote, nje vëlla i cili është aty për mua në çdo moment. Faleminderit për gjithçka dhe shpresoj që të të plotësohen te gjitha dëshirat!

Glen Qesku - O pëllumb paqe! I bukuri i dheut! Lum si unë që kam një shok si ty! Gjithë këto vite dhe kujtime që kemi krijuar, s' do i ndërroja me asgjë. Kanë qenë vitet më të bukura të jetës sime. Nuk besoj se ka njeri në botë që bën biseda aq të çuditshme sa kemi bërë ne. Më shumë kohë kemi harxhuar bashkë, sesa me familjet tona. Të kam si vëlla të vogël dhe do të të kem gjithë jetën. Nuk është e mundur të ulem në bankë më ty, sepse nuk do të pushonin të qeshurat. Shpresoj që mos të ndryshosh kurrë e të jesh gjithmonë ky që je. Të uroj që të bëhesh një programues i shkëlqyer dhe të përshëndes me një poezi:

O Endo, o vëlla
Gjithë jetën vaj e paç
S' do i harroj asnjëherë fjalët e tua,
O xhaxhi o xhaxhi a ke

Kapllan Sheno - Shpendii, je vërtet një djalë i veçantë. Arrin të balancosh në mënyrë perfekte humorin me mësimet dhe për këtë pjesë vërtet të kam zili. Gjithmonë më mek me improvizimet që ti bën (hint: HBr). Vazhdo kështu dhe jam i sigurt që një ditë do arrish majat. Të uroj suksese kudo në jetë! Nga miku yt, Kapo.

Rei Xhoga - Fieraku më i madh në botë! Kur u njohëm, në fillim të vitit të parë, shoqëria jonë nisi të çelë dhe u zhvillua shumë. Asnjëherë nuk do t'i harroj batutat dhe shakatë që kemi bërë në orë të mësimet. Edhe pse ndonjëherë e ke kaluar cakun me shakatë, shoqëria jonë vazhdon akoma. Je një djalë shumë i zgjuar, edhe pa u përpjekur fare. Arrin t'i konceptosh qartë gjërat dhe je gazmor me veprimet që bën. Ke aftësinë për t'i bërë 40 minuta mësim të duken si 5 minuta. Suksese të mëtejshme. Miku yt, Xhoga.



Ensar Zhuka

Arnis Llazari - Je një shok i mirë, një djalë që punon fort dhe që sillet mirë me të gjithë. Po ashtu luan mjaft mirë futboll. Të uroj shumë suksese në jetë!

Bjorni Prri - Ke qenë një nga miqtë e mi më të mirë gjatë këtyre viteve në gjimnaz. Je një djalë dhe një shok i mirë, gjithashtu dhe shumë i zgjuar, të paktën në lëndët shkencore. Të uroj sukses gjatë rrugës tende për t' u bërë një dentist sa më i mirë.

Daniel Lavdari - Kemi kohë që njihemi dhe je një shok shumë i mirë. Je një djalë i shkathët dhe i sjellshëm. Gëzohem që jemi njohur dhe shpresoj të të realizohen dëshirat dhe synimet që ke. Suksese në të ardhmen!

Dea Merkaj - Je një djalë i sjellshëm dhe i komunikueshëm. Gjithmonë mund të flasësh lirshëm me ty dhe je i gatshëm të ndihmosh, në rastet që të kërkohet ndihmë. Të uroj sa me shumë suksese dhe shpresoj të arrish qëllimet e tua!

Eldi Pashaj - Ensar, një djalë me të cilin mund të komunikosh shumë kollaj. Je një mesfushor me goditje vdekjeprurëse. Gjithmonë je i qeshur dhe shpresoj që të vazhdosh të jesh kështu! Të uroj të gjitha të mirat në rrugëtimin tënd që sapo ka nisur!

Emili Leka - Je një djalë i sjellshëm dhe shumë gazmor. Shoqëria jonë ka patur shumë vlera. Dua të të falenderoj që ke qenë pjesë e klasës sime. Te uroj suksese të mëtjshme!

Endi Rexhepi - Kaluan 3 vite që jemi në të njëjtën klasë dhe më duket sikur nuk ke ndryshuar fare. Je një djalë shumë i qetë dhe fjalëpakë, por shumë i zgjuar dhe i matur. Të uroj shumë suksese dhe u bëfsh dentist sa

më i mirë!

Fabio Dani – Ensar, shoku im i dashur! Jam shumë i lumtur që të kam shokun tim të ngushtë dhe të jam shumë mirënjohës që gjatë gjithë kësaj kohe më ke ndihmuar dhe suportuar. Paç fat në të ardhmen dhe uroj që të marrësh atë M3-sh, se na çmënde!

Glen Qesku - Gjithë këto vite që njihemi bashkë, vetëm kujtime të bukura kam me ty, sidomos duke qeshur për ndonjë ndodhi të pazakontë të Fabios, aty tek banka e parë. Këtë vit ke bërë ca mungesa, por nuk quhen, sepse i ke kompensuar në orën e kimisë. Shpresoj të bëhesh një nga dentistët më të zotë dhe me M8-ën më të shpejtë në botë!

Greis Koka - Je shumë djalë i mirë dhe i qeshur. Mund të flasësh shumë lirshëm me ty, sepse je shumë i këndshëm. Shoqëria jonë vazhdon edhe përtej shkollës, ndaj të uroj vetëm gjërat më të mira! Shumë suksese!

Kapllan Sheno - Per ish-shokun tim të bankës, Ensarin! Jo vetëm një shok klase, por edhe një shok stërvitjeje. Nëse nga të tjerët jam inkurajuar që të arrij më shumë akademikisht, nga ti jam motivuar që të zhvillohem fizikisht. Mund të them që kemi shtyrë njëri-tjetrin në maksimum, aq sa ndiheshim të mpirë për ditë me radhë. Por përveç këtyre, ke qenë një shok banke që rrallë mund ta gjesh në ditët e sotme. Nuk do i harroj kurrë orët e gjeografisë, kur të çonte zysha gati çdo orë, edhe pse ti vije 5 minutshin e fundit të orës. Te uroj sukses në studimet e ardhshme dhe në jetë! Me respekt, Kapllan Sheno.

Kesli Sejdarasi – Ensar, ti ke qenë shoku im që në klasë të 8-të dhe gjatë këtyre viteve që të kam njohur mund të them se je një njeri pozitiv dhe i qetë (deri sa të ngacmojnë). Nuk harron kurrë t' i takosh të gjithë sa herë që vjen në mëngjes dhe je gjithmonë i sjellshëm. Të uroj shumë suksese të mëtjshme dhe të arrish ato që do!

Rei Xhoga - Një nga miqtë e mi më të ngushtë në klasë, por edhe në palester. Më kujtohen batutat qesharake që i kemi treguar njëri-tjetrit gjatë verës dhe gjatë vitit shkollor. Ndihem i privilegjuar që kam një shok të tillë pranë meje. Falemnderit për çdo moment të bukur, për çdo këshillë dhe për çdo gëzim që kemi ndarë së bashku! Në të ardhmen, shpresoj që t' i realizosh ëndrrat e tua dhe të bëhesh një stomatolog i suksesshem. Je një shembull i vërtetë i miqësisë dhe vlerave njerëzore. Me respekt dhe miqësi, Xhoga!



Ermir Gjikota

Arnis Llazari - Bashkë kaluam pak kohë në bankë vjet, kur ti sapo kishe ardhur në shkollë. Je një shok i mirë, besnik dhe shakaxhi. Të uroj shumë suksese në jetë!

Bjorni Prri - Ermir, shakatë e tua na kanë bërë shumë herë për të qeshur si klasë. Mirënjohja ime për karakterin tënd të fortë dhe vendosmërinë tënde është e pafund. Faleminderit për mbështetjen dhe ndihmën tënde, edhe në momentet më të vështira! Të uroj sukses dhe lumturi në të gjitha hapat e jetës tënde!

Dea Merkaj - Asnjëherë nuk të kam parë te trishtuar dhe mundësisht gjithmonë ke qënë optimist. Ky është tipari yt më i mirë, që shpresoj ta ruash me kohën. Të vlerësoj shumë si shok, pasi gjithmonë je i respektueshëm, mirëkuptues dhe i komunikueshëm. Shakatë tua gjithmonë më bëjnë dhe mua të buzëqesh. Fakti që ti e ndan unin tënd pozitiv me të tjerët tregon se çfarë zemre të bardhë ke. Shpresoj të arrish çdo qëllim që ke dhe jam shumë e lumtur që të kam patur në klasë!

Eldi Pashaj - Një djalë gazmor, që gjithmonë ka diçka për të thënë. Ke qënë gjithmonë i qeshur dhe një djalë shumë i respektuar. Shpresoj që të jesh sa më i lumtur në vitet në vijim dhe mos të kesh asnjë problem! T`u plotësofshin të gjitha dëshirat!

Emili Leka - Je një djalë shumë i zgjuar dhe shakaxhi. Çdo klasë ka nevojë për dikë që t`i ndyshojë dinamikën, dhe ky ishe ti për ne. Shpresoj të kesh kaluar një kohë sa më të bukur në klasën tone dhe suksese në jetë!

Ensar Zhuka - Jemi takuar vitin e dytë kur na erdhe në klasë dhe ke qënë gjithmonë një person shumë pozitiv dhe i qeshur. Je një djalë shumë i zgjuar dhe të uroj

shumë suksese në jetë!

Fabio Dani - Ermir, edhe pse nuk pata mundësin të të njoh më mirë, mund të them se je një çun shumë i mirë dhe me humor. Të uroj suksese të mëtejshme!

Flavio Gjoka - Bashkë kemi qënë në të njëjtën klasë, që nga klasa e 10-të, prandaj mendoj se të njoh më mirë, sesa pjesën tjetër të klasës. Di të them që, po të përkushtohesh, mund të arrish çdo synim tëndin. Suksese në jetë!

Greis Koka - Je shumë humorist dhe super djalë i mirë e pozitiv. Uroj që ky karakter mos të të ndryshojë, sepse sinqerisht ke sjellë një energji të bukur në klasë. Të uroj shumë suksese dhe fat për çdo gjë që do kesh dëshirë të realizosh!

Kapllan Sheno - Kamzaliu im, pa ty klasa duket bosh. E si mund të kalojë ora pa shakatë e tua? Je vërtet një person që sjell pozitivitet në çdo kohë. Por, përveç shakave, je vërtet një djalë që më çudit me zgjuarsinë që ke. Fakti që ti nuk mundohesh fare dhe arrin të marrësh nota të shkëlqyera, vërtet më habit. Ta dish që akoma po e pres kafën. Të uroj suksese kudo në jetë! Nga shoku yt, Kapo.

Kesli Sejdarasi - Eri, ti je një nga shokët e mi më të afërt dhe një njeri shumë i mirë. Kujtohesh përherë për mua dhe më ke qendruar gjithmonë afër. Je shumë inteligjent dhe gjithmonë ke qënë një njeri shumë me "këmbë në tokë". Akoma më çudit se si mund të dish gjithçka, edhe pa mësuar. Jam shumë e lumtur që të kam njohur, që kur erdhe tek ne në vit të dytë dhe akoma më e lumtur që të kam shok. Të kam shumë xhan dhe të uroj shumë suksese në jetë!

Rei Xhoga - Fillimi i miqësisë sonë ishte i mrekullueshëm. Në fillim m`u duke person i heshtur dhe i urtë, por kur të njoha më mirë e kuptova që je krejt e kundërta. Më kujtohen gallatat dhe muhabetet që kemi bërë gjatë këtyre viteve në klasë, por edhe në ambientet jashtë. Je një shok i mrekullueshëm dhe shoqërinë tonë nuk do ta ndërroja me asgjë. Të uroj suksese të mëtejshme në të ardhmen dhe sa më shumë lumturi! Me dashuri, Xhoga.

Xhejmon Korça - Ermiri, shoku që ka qendruar me mua në çdo kthesë, për 3 vite! Me ty ka kaluar koha shpejt dhe me plot kujtime të bukura. Falemnderit për miqësinë dhe ndershmërinë tënde të pakursyer! Shpresoj që rrugëtimi ynë të vazhdojë së bashku, me sukses dhe gëzim!



Fabio Dani

Arnis Llazari - Je djalë që të karakterizon urtësia. Së bashku s'kemi kaluar shumë kohë në klasë, por mund të them se je një djalë i mirë dhe i sjellshëm. Të uroj shumë suksese!

Bjorni Prhini - Ne e kemi njohur njëri-tjetrin që në klasën e 8-të dhe kemi kaluar shumë kujtime të bukura dhe gazmore. Gjithmonë përpiqesh t' i nxjerrësh gjërat siç dëshiron, kjo ndoshta sepse kështu është karakteri yt. Shpresoj që t'ia dalësh mbanë në rrugën tënde për menaxhimin e bizneseve të babait tënd dhe përpiqu mos t'i falimentosh që ditën e pare!

Daniel Lavdari - Me Fabion jemi njohur këtë vit dhe tema e patentës, apo e makinave në përgjithësi, përsëritet gjithmonë nëpër bisedat tona. Të uroj suksese në jetë dhe me mend në kokë, si shofer i ri që je!

Dea Merkaj - Je një djalë i urtë në pamje të pare, por kur të njeh, del një Fabio krejtësisht ndryshe. Je një njeri goxha shakator, që nuk përfshihesh në punët e të tjerëve dhe të intereson më së shumti qetësia jote individuale dhe mirëqënia e njerëzve të afërt për ty. Të uroj suksese dhe shpresoj t' i arrish të tëra qëllimet e tua!

Eldi Pashaj - Fabio, një djalë gazmor. Gjithmonë di sesi të të bëjë të qeshësh. Një njeri pa komplekse, i thjeshtë, që nuk kërkon shumë. Një shok i mire, dhe po ashtu, një djalë fantastik. Shpresoj ta blesh atë Range Roverin që sheh tërë kohës në orën e kompjuterit. Paç një të ardhme plot gaz dhe hare!

Emili Leka – Fabio, je një karakter shumë i veçantë që iu shtua klasës sonë këtë vit. Qetësia jote dhe shakatë

e tua nën zë, i japin klasës një atmosferë pozitive. Shpresoj të kesh një të ardhme sa më të suksesshme!

Endi Rexhepi - Këtë vit na u bashkove prapë në klasë, që nga klasa e tetë. Shumë shaka kemi bërë me njëri-tjetrin dhe kemi kaluar shumë bukur. Të uroj shumë suksese!

Ensar Zhuka - Jemi takuar për herë të parë në klasën e tetë. Edhe pse gjatë këtyre pesë viteve të fundit, vetëm dy vite kemi qënë në një klasë, gjithmonë kemi kaluar pushimet midis orëve bashkë. Je një person shumë i mirë dhe shumë i qeshur. Ky vit do të mbarojë, por shoqëria jonë jo. Të uroj shumë suksese në juridik dhe të bësh sa më shumë lekë, edhe pse s' të duhen më shumë!

Flavio Gjoka - Fabio, një mik i cili flet pak, por me vend dhe batutat i kanë lezet. Më pëlqen fakti që asnjëherë nuk mërzhitesh dhe çdo gjë e merr me sportivitet. Mos ndrysho kurrë, sepse je kampion!

Greis Koka - Nuk të kam kuptuar kurrë, por dukesh djalë i mirë dhe i qetë. Do të doja dhe unë të kisha qetësinë shpirtërore që të karakterizon ty. Uroj që të të realizohen dëshirat që ke dhe shumë suksese në jetë!

Kapllan Sheno - Fabio, je një djalë shumë i urtë dhe i sjellshëm. Një gjë që më bën vërtetë përshtypje është qetësia që ti shfaq në çdo kohë, pavarësisht nga situata. Si është e mundur që s' të kam parë asnjëherë të stresuar për shkollën? Për këtë gjë të kam vërtetë zili. Kam parë edhe më parë njerëz të tillë, por në nivelin tend, jo. Uroj që të shkëlqesh dhe të realizosh qëllimet e tua të mrekullueshme!

Kesli Sejdarasi – Fabi, shoku im i ngushtë prej 5 vitesh, që gjithashtu hyn tek njerëzit më të veçantë që kam njohur në jetën time. Gjithmonë më bën të qesh me shakatë e tua, edhe kur jam e mërzhitur, dhe gjithashtu më duron, edhe kur të bezdis. Ke një karakter të veçantë, shumë ndryshe nga unë, por sërish ndajmë shumë mendime dhe sjellje të përbashkëta. Shpresoj të gjesh akoma më shumë njerëz që të vlerësojnë. Të kam shumë xhan!

Xhejmon Korça – Fabio, je një shok i çmuar, gjithmonë i qetë dhe i drejtë! Me karakterin tënd të qetë dhe integritetin tend, je gjithmonë aty me një këshillë të mençur. Shpresoj që rrugëtimi yt të vazhdojë me sukses dhe qetësi!



Flavio Gjoka

Bjorni Pririni - Flavio, ti je një person i shkëlqyer, me një humor të veçantë dhe një energji të jashtëzakonshme. Edhe në momentet e pakta që kemi kaluar bashkë, kam ndjerë gjithmonë një atmosferë të këndshme dhe të qetë në praninë tënde. Faleminderit për të gjitha buzëqeshjet dhe momentet që ke ndarë me ne! Të uroj që rruga jote përpara të jetë e mbushur me gëzim dhe sukses!

Daniel Lavdari - Je ndër personat më të qetë që njoh, por në të njëjtën kohë edhe ndër personat që të bën më shumë për të qeshur. Shpresoj të kesh sa më shumë sukses në të ardhmen!

Dea Merkaj - Ty të thonë e bukura e nënës! O mashkull inteligjent si Ajshtanji, të uroj më të mirat dhe sa më shumë suksese në çdo aspekt të jetës! Kam shijuar çdo moment që kemi kaluar së bashku, sidomos orët e gjermanishtes. Ti me të vërtetë sjell në klasën tonë një energji ndryshe. Shpresoj që të të rastisë rruga këtej nga Baldushku dhe të takohemi! Kujdes mos ngatërron kthesën!

Eldi Pashaj - Flavio, nuk kemi më shumë se një vit që njihemi dhe sërish mendoj se je një nga djemtë më të respektuar që kam njohur. Je një djalë me të cilin, po të kapi e qeshura, nuk pushon. Je ambicioz dhe shumë i saktë në gjërat që bën. Shpresoj që të të plotësohen të gjitha dëshirat!

Rei Xhoga – Flavio, je një shok i veçantë dhe me një zemër të madhe. Dua të shpreh mirënjohjen time dhe të them se çdo moment me ty është një aventurë e këndshme. Shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë të rritet dhe të ndajmë bashkë kujtime të paharrueshme. Me respekt, Xhoga.

Endi Rexhepi - Këtë vit erdhe në klasën tonë dhe u përshtate shumë shpejt. Kemi kaluar shumë orë kimie duke qeshur me çunat. Të uroj mbarësi e suksese ngado që të ikësh!

Fabio Dani – Flavio, je një djalë danoç. Në kaq kohë që kemi kaluar bashkë, di të them që je një djalë shumë i zgjuar dhe më bën për të qeshur me shakatë e tua. Të uroj shumë fat në të ardhme!

Greis Koka - O i bukri nënës, je super djalë dhe ke një humor fantastik. E pranoj se në fillim isha skeptike për ty, por ma ke ndryshuar komplet opinionin. Jam e lumtur që munda të shoh përtej asaj që duket në shikim të parë. I kam shijuar shumë orët e gjermanishtes me ty dhe mund të them se asaj klase do t'i mungojë gjithmonë esenca jote. Të uroj shumë suksese dhe mos humb më rrugës për Baldushk! (Ki kujdes nga live-t që futesh!).

Kapllan Sheno - Edhe pse njihemi prej pak kohësh, në kujtimet më të këndshme do të të kem përherë. I qetë, fisnik dhe inteligjent ke qenë gjithmonë. Shakatë nuk të mungojnë asnjëherë. Të respektoj dhe uroj rrugën e jetës të ndritur ta kesh!

Kesli Sejdarasi – Flavio, je një njeri shumë i mirë, i kujdesshëm, por edhe me shumë humor. Komentet tua pas çdo shakaje dhe ajo e qeshura jote, i bëjnë situatat akoma më tepër për të qeshur. Falemnderit që je gjithmonë aty sa herë kam nevojë dhe që më ndihmon përherë me ushtrimet e matematikës! Çdo orë mësimi ka kaluar më shpejt me shakatë që kemi bërë gjithë vitin. Të uroj shumë suksese dhe të arrish ato që do !

Klea Metaj - Edhe pse kemi një vit që njihemi, kohë kjo shumë e shkurtër, kam arritur të kuptoj se çfarë njeriu pozitiv dhe i sjellshëm je. Suksese kudo!

Emili Leka – Flavio, je një person shumë zemërmirë. Nuk kam për t'i harruar orët e gjermanishtes dhe shakatë e tua. Je një djalë shumë i veçantë dhe je përshtatur më së miri me klasën tonë. Të uroj sa më shumë suksese!

Xhejmon Korça - O lali, je një nga shokët më të mirë që kam, edhe pse bashkë kemi kaluar vetëm 3 vite. Në çdo moment më ke ndihmuar me aq sa ti mundesh. Besoj se të njoh mire, sepse je një djalë që nuk hapesh me persona të cilët nuk i njeh sa duhet. Je një djalë i zgjuar. Uroj që t'i të arrish majat e suksesit!



Glen Qesku

Adrin Cacaj- Glen, gjatë këtij viti ne kemi ndenjur goxha bashkë. Mahnitem se si, në asnjë moment, nuk ke bërë nje veprim negativ ose ke thënë dicka të gabuar. Kam vetëm fjalë të mira për ty dhe je një nga çunat më pozitiv dhe të sjellshëm që njoh. Ti di si të kënaqesh dhe të festosh. Je shumë i zgjuar dhe një shok fantastik. Jam shumë mirënjohës për të gjitha momentet që më ke ndihmuar. Uroj t'i plotësosh të gjitha dëshirat që ke për të ardhmen!

Arnis Llazari - UO GLENOU! Je një nga shokët e mi më të mirë e gjithmonë do të jesh. Je personi i vetëm që njoh që, sapo t'i thuash diçka, fillon e qesh. Që në klasë të 8-të, e deri më sot, jemi bërë shumë të afërt dhe kemi kaluar shumë gjëra bashkë. Kemi bërë dhe një video shumë për të qeshur tek ditëlindja ime. Të uroj shumë suksese në të ardhmen Gleno!

Daniel Lavdari - Po mbaron gjimnazi e ne përsëri në bankë bashkë jemi. Shpresoj që kjo gjë të vazhdojë edhe në universitet. Për ty mund të them me plot gojë që je një nga shokët më të mirë që kam. Je i qeshur, i çiltër, i matur, gazmor e shumë gjëra të tjera të mira. Për ty mund rri e të shkruaj pafund, por po e mbyll me ca vargje:

Jemi e do mbetemi shokë,
Me gjithë çunat bëhemi shumë kokë,
Shumë mësim kam për t'i harruar,
Por kujtimet me ty s'kanë për t'u larguar.

Dea Merkaç - Gleni është gjithçka që dikush mund të kërkojë te një shok. Ai është njeriu që të dëgjon, të mbështet, të kundërshton, por gjithashtu të suporton në mënyrën e tij të çuditshme. Kur Gleni mungon,

klasa ndihet pak e zymtë, pasi të qeshurat e tij mbushin klasën me një energji pozitive. Momenti kur të gjithë kuptuam se Gleni me të vërtetë mund të shkonte përpara në jetë, ishte kur ai merrte notat më të larta në lëndën e gjuhës. Ai gjithmonë të bën të ndihesh rehat për të shprehur mendimet dhe ngjarjet nga jeta jote, dhe këtë gjë e vlerësoj shumë. Mendoj se me karakterin që Gleni zotëron, ai ka mundësi të shkojë larg në jetë, pasi është ambicioz, plot synime dhe më e rëndësishmja, optimist. Çdo ditë ndihem e lumtur që të kam njohur në një nivel kaq të lartë dhe shpresoj që të arrish të gjitha qëllimet e tua! Por dëshira ime më e madhe për ty është që të qëndrosh ai që je, me këtë frymë pozitive dhe me humorin tënd tipik! Të uroj vetëm suksese në jetë dhe shpresoj të mos dëgjosh askënd që do synojë të të ndryshojë.

Eldi Pashaj - Vëllai im, disa nga kujtimet më të bukura unë i kam kaluar me ty. Disa nga të qeshurat më të forta, të cilat më kanë shtuar jetën, i kam kaluar me ty. Kemi kaluar në pafund aventura dhe ti e di vetë shumë mirë. Je një shok i vërtetë. Ajo e qeshura jote ngjitet, nuk do të harrohet kurrë. Je një shok me të cilin mund të bësh muhabet pa asnjëlloj problem. Gjithmonë i drejtë. U bëfsh një cyber security fantastik në të ardhmen! Shpresoj që të të vijë gjërat në mënyrën më të lehtë të mundshme dhe të gësh sa më shumë të qeshura në vitet në vazhdim <3! Të puth, Eldi.

Endi Rexhepi - Gleno, hahahahaha ça djali je! Djali me zemrën më të mirë që kam njohur! Kështu është kur të konsiderojnë si djali me moral më të lartë nga grupi jonë. Të gjitha gjërat i kemi kaluar. Aq shumë kujtime kemi, sa pjesen më të madhe e kemi harruar. Po s'ka gjë, prapë do bëjmë gjëra të reja dhe kur t'i kujtojmë pas disa vitesh, do qeshim me lot. Shpresoj mos ta humbasim kurrë këtë shoqëri që kemi krijuar gjatë gjithë këtyre viteve, me plot gallata nga më të ndryshmet. Koha iku shumë shpejt këto 4 vite, por këta pak muajt të mbetur do i shijojmë në maksimum. Me atë shprehjen që i kanë thënë disa xhuxha një kriminel, do e mbyll (ti e kupton vetë, s'kam pse e them).



Greis Koka

Daniel Lavdari - Për Greisin mund të them që është një person që shpërndan pozitivitet dhe mirësi. Je gjithmonë e lumtur dhe e qeshur. Sa më shumë kohë kalon ti tregon mprehtësinë, inteligjencën dhe miqësin tënde.

Dea Merkaj - Shoqëria ime me Greisin ka qenë ajo çfarë më ka bërë mua të shijoj në maksimum vitet e gjimnazit. Edhe ditët e mërzitshme, edhe ditët e lodhshme bëheshin më të bukura me prezencën e Greisit. Për mua, ajo është e pagabueshme. Cilësia kryesore që unë adhuroj te Greisi është pozitiviteti. Fakti që ajo më bën të qesh, edhe kur jam e mërzitur apo me nerva, dhe fakti që mundohet të shikojë gjithmonë aspektet pozitive të situatave negative, më ka ndihmuar mua që Greisin ta shikoj si një inspirim për veten time. Ajo më inspiron dita ditës me ambicien e saj, me forcën që ka për t'iu bërë ballë problemeve dhe me faktin se si i di vlerat e saj dhe rëndësinë që ka. Nuk kam për ta harruar kurrë se sa afër më ka qëndruar gjatë momenteve të mia më të trishta dhe se si edhe atëherë është munduar të më ndihmojë aq sa mundej. Dua të dish që unë gjithmonë do të jem suportuesja jote më e madhe, në çdo hap që do të hedhësh. Të dua shumë! Krrahhh! Kaq zysha.

Eldi Pashaj - Grejs, je një vajzë shumë gazmore, e dashur dhe gjithmonë e saktë në ato që thua. Ti je shumë e zgjuar dhe adhuruese e madhe e adrenalines. Përherë mund të bësh një shaka me ty, se ti je gjithmonë e qeshur.

Emili Leka – Greisyy, edhe pse shoqëritë kur je e vogël harrohen, këtë me ty nuk do ta harroj kurrë. Je një vajzë vetëm me virtyte. Je shumë e çiltër dhe ngjall një pozitivitet tek të gjithë ata që ke pranë.

Endi Rexhepi – Greis, u bënë disa vite që njihemi, por kaluan aq shpejt sa që m'u dukën si muaj. Je njeriu më pozitiv në klasën tonë, madje njeriu më pozitiv që njoh. Shpërndafsh sa më shumë pozitivitet!

Glen Qesku - Ke qenë një shoqe shumë e mirë. Këto 5 vite kanë qenë më të bukurat me ty. Bisedat tona të çuditshme, krahasimet e shakatë do mbeten të paharrueshme gjithashtu.

Kapllan Sheno - Greis, jam vërtet mirënjohës që kam njohur një vajzë si ty. Pozitiviteti yt ka qenë një burim frymëzimi për mua, në çdo moment. Je një vajzë shumë e zgjuar, me plot vullnet e ambicie. Greis, nuk duhet të harrosh që KAPO T'I PLOTSON!

Kesli Sejdarasi – Greis, je një nga njerëzit më pozitiv në jetën time, që më shtyn gjithmonë që të shoh anën pozitive të gjërave. Ti më dëgjon përherë kur kam nevojë të flas dhe më këshillon. Jam shumë mirënjohës që të kam njohur këto 5 vite. Faleminderit që je për mua aty, sa herë që kam nevojë. Të dua shumë! Shpresoj që të vazhdosh të jesh pjesë e jetës sime edhe më vonë.

Klea Metaj - Tregohet e drejtpërdrejtë në mendime, gjë që kërkon mjaft guxim, që shumë prej nesh nuk e kanë. Di të "godasë" bukur me ironi.

Megan Mara – Greis, të them të drejtën as vet nuk e di se sa kohë ka shoqëria jonë, por di të them që e vlerësoj shumë. Edhe pse nuk ta them shumë shpesh, të dua shumë! Me ty kam ndarë disa nga kujtimet më të bukura. Shumicën e tyre nuk i flasim dot as me zë të lartë. Ti je një shoqe, një motër, që ka qëndruar pranë meje në momentet e bukura dhe në momentet e vështira. E di që mund të të besoj plotësisht dhe absolutisht për çdo gjë dhe gjithmonë do të marr këshillat më të mira nga ti. Tani që perfundoj gjimnazi, mezi pres të përjetojmë gjëra të reja bashkë. Uroj që të të realizohen të gjitha dëshirat, sepse me të vërtetë e meriton. Je një vajzë shumë e shkathët, e dashur, e zgjuar dhe bukuroshe. Faleminderit që je shoqja ime më e mirë dhe faleminderit që qëndron pranë meje në çdo moment!

Rei Xhoga - Gjatë kësaj kohe, kam vlerësuar thellësisht cilësitë e tua unike dhe gjithmonë jam ndjerë i privilegjin që të kam shoqe. Me humorin tënd shpërthyes, mendimet e zgjuara dhe mbështetjen tënde të pakursyer, i ke bërë këto vite shkollore më tërheqëse.



Ilir Duçkollari

Arnis Llazari - Kemi qenë shokë që në klasë të parë dhe vazhdojmë të jemi edhe sot. Kur u njohëm ishim veçse fëmijë të vegjël, të ulur për herë të parë në bankat e shkollës, duke pritur zysh Nasipen në këtë udhëtim të gjatë. Edhe pse shokët e klasës, zyshat e godinat e shkollës u ndryshuan, ne mbetëm po prapë bashkë. Shpresoj të mbetemi shokë gjithmonë. Të uroj suksese!

Dea Merkaj - Je një djalë me karakter të veçantë, ku te ti mbizotëron një pozitivitet tepër i rrallë. Gjithmonë më ka bërë përshtypje ky tipar te ti, por gjithashtu më ka bërë të të kem zili. Dëshira ime më e madhe në lidhje me ty është që ti të realizosh ëndrrën tënde për t' u bërë një prokuror. Do të ishte një kënaqësi të "luftonim" krimin së bashku. Të uroj sa më shumë suksese e mbarësi, dhe të këshilloj të shtrosh pak kurrizin në shkollën e juridikut!

Emili Leka - Ilir, je shoku më besnik dhe më zemërmirë që kam. Të vlerësoj shumë për respektin që ke treguar ndaj meje dhe uroj ta kem shfaqur këtë. E di se gjithmonë do të kem mbështetjen tënde. E qeshura jote sjell pozitivitet kudo që shkon. Kemi kaluar shumë mirë bashkë, ndaj shpresoj që kjo shoqëri do të vazhdojë, por sidoqoftë do të të mbaj mend gjithmonë.

Glen Qesku - Likja i stërmadh, ke shumë emra, por bespreme nuk është njëri prej tyre. Ti i jep esencën gjithë klasës. Ndonjëherë pa ty nuk shtyhet fare. Aq shumë mungesa ke bërë, na i thave sytë. Po në fund të fundit kush ia ka parë hajrin shkollës? Shakatë që kemi bërë për katalin e klasës janë të përrjetshme. Ishte një periudhë që kishe filluar boksën, edhe na bëje si boksier. Të uroj suksese!

Kapllan Sheno - Përveç se një shok lagjeje, por edhe një mik klase/banke. Mendoj se emri yt përshkruan fiks atë që ti je vërtet: një njeri të lirë, që rregullat nuk vlejnë për ty. Personaliteti yt i gëzueshëm dhe aftësia jote për të bërë humor në çdo situatë, i kanë bërë të gjitha momentet tona të jenë të paharrueshme. Me ty nuk ka pasur asnjë ditë që ka kaluar pa shaka dhe të qeshura. Ti je një frymëzim për të gjithë ne, me pozitivitetin që arrin të përcjellësh në çdo situatë. Ilir, je një shok i vërtetë dhe jam krenar që kam njohur një person si ti. Të uroj shumë suksese!

Kesli Sejdarasi – Liri, kam disa vite që të njoh dhe ke qenë gjithmonë nga njerëzit e mi më të afërt. Kemi ndarë shumë të përbashkëta dhe kujtime të bukura së bashku. Je më i zgjuar se sa të tjerët mendojnë dhe më i ndjeshëm se sa shfaqesh. Jam e lumtur që pata rastin të njoh edhe këtë anë tënden. Edhe pse shpeshherë m' i ngre nervat, sërish të kam shumë xhan! Uroj të ecësh përpara në jetë dhe t' i realizosh gjërat që ti do!

Klea Metaj - Ke një zemër të madhe e të bardhë, që i bën të gjithë të buzëqeshin. Pikërisht ti, Ilir, je dhe më i miri i klasës së 12-E. Këmbëngulës për t' i bërë të tjerët të qeshin, edhe kur nuk duan. Klasa ndihet shumë bosh pa ty e shakatë e tua, kur ti mungon. Ti je një shok shumë i mirë dhe mendoj se të gjithë duhet ta kenë një "Ilir" për shok, por të rrallë janë ata që e kanë këtë privilegj. Je shembull për mirësinë, pozitivitetin, guximin për t' i thënë gjërat ashtu siç janë, sarkazmën, intelektin dhe dhembshurinë që ke për shokët e tu. Suksese, Ilir!

Rei Xhoga - E ku ka fjalë që të përshkruajnë ty more Ilir? Fillimet tona ishin shumë të bukura. Akoma më kujtohen nofkat me të cilat ti më thërrisje, dhe nuk do t' i harroj kurrë. Ti për mua je një person shumë special. Kemi bërë qindra biseda bashkë dhe jemi mbytur duke qeshur. Mbaj mend në vit të dytë kur luajtëm "Paintball" dhe isha në skuadër me ty kur fituam. Jam shumë i lumtur që të kam pasur në klasë gjatë gjimnazit. Të uroj suksese të mëtëjshme!

Sara Pajtoni - Djali më pozitiv i klasës dhe shoku im më i mirë. Klasa jonë nuk do të kishte kuptim pa batutat e të qeshurat që ti shkakton në çdo orë. Je një nga djemtë më zemërmirë dhe të dashur që kam njohur dhe nuk do ta harroj kurrë kohën që kemi kaluar së bashku. Shpresoj të mbetemi po kaq miq të mirë edhe në vazhdim. Të uroj suksese!



Kapllan Sheno

Arnīs Llazarī - O greku im i dashur! Bëj shaka, se jemi patriotë Korçë. Me ty ia kam kaluar shumë mirë këto vite dhe je një shok shumë i mirë. Mbjaj mend kur ikëm në palestër me Ilirin dhe unë provova të bëja shtangën e nuk e ngrita dot se po qeshnim dhe ngelëm si tre budallenj që mezi po çonim një shtangë. Ose në klasë të tetë që fituam medalje në kimi duke kopjuar në Google (unë kopjova, se ti bën kot sikur s' i di). Je djalë shumë i zgjuar, por prapë s' ma kalon dot (pusho se JT).

Dea Merkaj - Nuk mendoj se ndonjë fjalë që mund të shkruaj në këtë dedikim mund të shpjegojë kompleksitetin tënd ose edhe dinamikën tonë. Je një njeri me të cilin nuk e shikoja veten të afërt, pasi ftohtësia jote nuk përputhet me karakterin tim, por ja ku jemi. Je një djalë ambicioz, me aspirata, i palodhur, me një karakter të zjarrtë, që nuk lejon padrejtësitë dhe mbi të gjitha me intelekt. Nuk mund ta mohoj që të kam zili në shumë aspekte pasi është realiteti, por shpresoj që ti vetë ta vlerësosh mjaftueshëm veten tënde dhe mos ta nënvlerësosh asnjëherë. Edhe pse kjo miqësia jonë nisi prej ngacmimeve të tua tendencioze, unë jam shumë e lumtur që mund të të quaj shokun tim. Nuk dua të bëhem bajat me ato urimet e përsëritura, pasi i ke dëgjuar me mijëra herë, sidomos nga unë, por thjeshtë dua të të kujtoj që ti me të vërtetë do të arrish çdo gjë për të cilën je duke punuar. Do të të takoj në Holandë, pasi miqësia jonë nuk mbyllet me kaq, me shpresa që do të më vizitosh edhe ti mua ndonjëherë.

Greis Koka - Sheno ekselenti, na e ka marrë në kthesë të gjithëve. Je djalë plot vullnet, edukatë dhe inteligjencë. Nuk mund të kisha gjetur një person më të mirë për të prezantuar Asef-in për racizmin. Dukesh i urtë ne

pamje të parë, por je shumë konfliktual dhe të pëlqejnë dramën. Je tepër pozitiv dhe i ndihmon goxha të tjerët kur kanë nevojë. Jam e lumtur që kam arritur të të njoh më shumë këto vite. Ambicia jote do të të çojë shumë larg në jetë dhe besoj se do jem aty për të të uruar. Do të shihemi në Holandë (do hamë patate) dhe ti do mbash premtimet. Të uroj shumë suksese, por s'ta kam frikën xio. P.s: Bluzja do vijë me ne në Holandë.

Rei Xhoga - Për shokun tim të dashur, Kapllanin. Kemi kaluar shumë momente bashkë, nga klasa e parë deri tani, dhe çdo ditë është një rast për të kujtuar se sa e rëndësishme dhe e çmuar është miqësia jonë, të cilën nuk do ta ndërroja me asgjë. Akoma e mbaj mend ditën e parë që kemi folur dhe është një nga kujtimet më të bukura që kam. Por, të them të drejtën, kujtimi më e bukur ka qenë ekskursioni në Bosnje në klasë të 4-t. Bënim gallata në furgon, luanim me topa bore, por më kryesorja ishte kur blemë "nerf guns" dhe luanim në dhomën e hotelit, derisa na spiunuan personat e dhomes ngjitur tek recepsioni. Ti je një shok i vërtetë, gjithmonë aty kur kam nevojë për motivim, një këshillë ose thjesht një moment argëtimi. Kujtoj ditët e klases së katërt kur na largohej furgoni sepse luanim mbrapa shkollës tek lodrat dhe na bërtiste drejtori kur na thërrisnin në zyrë, por unë nuk të lija kurrë të merrje ndëshkim, sepse e pranoja vetë fajin. Dëshiroj që të vazhdosh rrugën tënde me pasion dhe angazhim. Ti ke potencialin për të arritur majat me atë inteligjencën tënde prej gjeniu. Kam shumë besim në aftësitë e tua. Kujto këto momente dhe periudha të veçanta, të cilat do të lënë kujtime dhe buzëqeshje të paharrueshme. Shtoji sukseset tua dhe kultivoji lidhjet e reja që do të të shoqërojnë në të ardhmen. Shfrytëzo çdo mundësi për të zhvilluar veten dhe për të eksploruar pasionet e tua. Ti je një shembull i vërtetë i përkushtimit, talentit dhe vullnetit. REFUZON të dorëzohesh dhe gjithmonë e gjen një zgjidhje, sado e vështirë që mund të jetë situata. Me respekt dhe urime, nga miku yt, Xhoga.



Kesli Sejdarasi

Arnis Llazari – Hey, Kesli! Je një shoqe shumë e mirë dhe bashkë kemi kaluar një kohë shumë të bukur në vit të dytë, kur ishim në të njejtën bankë. Ke një vlerë të madhe që s'i harron gjërat që njerëzit të thonë për veten e tyre. Mbaj mend kur donim të iknim në palestër, por ja futëm për te Mulliri. Jemi patriotë e kjo na ka afruar akoma edhe më shumë. Jam shumë i lumtur që të kam shoqe.

Dea Merkaj - Keslin e njoh prej 12 vitesh dhe di të them që kur nisa ta njihja personalisht kuptova shprehjen “mos e gjyko librin prej kopertines”, pasi Kesli ishte çdo gjë, përveçse një vajze të urtë. Gjatë 3 viteve të fundit u afrova shumë me të dhe kjo gjë më ka bërë të kuptoj personalitetin e vërtetë të Keslit. Ajo është pozitive dhe ka dashuri për të tërë. Kesli shikon vetëm të mirën te njerëzit dhe ndonjëherë toleron më shumë se ç'duhet. Ajo është një prej vajzave më të afrueshme. Në qoftë se ajo dallon një ndryshim në gjëndjen tënde, do të bëjë çdo gjë që të rregullojë humorin. Shpresoj që të realizohen të gjitha dëshirat për të udhëtuar bashkë! Të dua shumë dhe mezi pres të shoh se çfarë do na sjellë e ardhmja.

Eldi Pashaj – Çiçe, je fantastike! Je një vajzë e qeshur dhe nuk lejon askënd që të kalojë kufijt që ti vendos. Ti je një detajiste dhe një adhuruese lulesh. Gjithmonë e qeshur dhe me një shikim vrastar. Shpresoj që të jesh sa më e lumtur në rrugëtimin që të pret!

Emili Leka – Kisloo, je një vajzë shumë e mirë. Thonë se shoqëritë më të mira fillojnë me “zënka”, dhe me sa duket, kjo gjë për ne është e vërtetë. Megjithatë mendoj se zënkën lindën ngaqë ti je gjithmonë e gatshme për të mbrojtur të gjithë, edhe kur nuk e meritojnë. Një cilësi tjetër tënden, që nuk e lë dot pa

përmendur, është çiltërsia dhe që i bën të gjithë të ndihen të mirëkuptuar. Jam e sigurt se çfarëdo që të bësh në jetë do ta bësh më së miri, por unë do të shoh gjithmonë si psikologjia e klasës sonë.

Fabio Dani – Kesli, shoqja ime më e mirë. Jam me fat që kam pasur mundësi të të njoh dhe të kuptoj se sa vajzë e mrekullueshme je. Je një vajzë shumë e zgjuar dhe shumë e sjellshme. Kemi kaluar një kohë shumë të bukur bashkë. Të kam shumë xhan dhe do të kesh gjithmonë një vend të veçantë në zemrën time!

Glen Qesku – Kelso, ty të kam pas shoqe që në kohët e zymta (ke pasur shoqëri të çuditshme atëherë). Aftësia jote për të treguar histori të bukura është e paparë. Më mek gjithmonë me historitë me mbesën tënde. Ajo, megjithëse është e vogël, është gango. Si halla, normal. Momentet kur kërcenim që në pikën e mëngjesit në klasë, sikur ishim në ndonjë dasmë, do jenë të paharrueshme. Je vërtetë një vajzë ekstremisht e mirë. Shpresoj ta marrësh atë G-class që të ka premtuar babi dhe të mos harrosh të na bësh ndonjë xhiro.

Greis Koka - Kesli mi Kesli, nga t'ia filloj për ty? Je super vajzë! Plot gjallëri, si një fëmijë. Je si një rreze drite (përveç rasteve kur duket sikur do na mbyësesh nga nervat). Jam shumë shumë e lumtur që këto vite kisha mundësinë të njihja Keslin e vërtetë. Shoqëria jonë, do s'do ti, do vazhdojë, kështu që nuk po bëj urime kot. Ti, me fytyrën tënde si një beb, na ke hapur probleme dhe s'kam dyshim që do vazhdosh të na hapësh. Të dua shumë dhe uroj më të mirën gjithmonë për ty! (Më pëlqen jashtëzakonisht shumë e qeshura jote si maniake.)

Kapllan Sheno - Kesli, patriotja ime korçare! Je një vajzë shumë e sjellshme. E vlerësoj vërtet kohën që kemi kaluar bashkë, në shkollë edhe jashtë shkolle. E admiroj vërtet qetësinë tënde. Duke marrë parasysh shokun tënd të bankës, vetëkontrolli yt është shumë mbresëlënës.

Rei Xhoga - Për shoqen time më të mirë, Keslin. Akoma i mbaj mend ditët kur më kishe inat në vit të parë. Je person që gjithmonë do më të mirën për njerëzit dhe këte e adhuroj tek ti. Me sjelljen tënde të ëmbël, bujarinë tënde të madhe, bisadat gazmore që kemi bërë, koncertet në të cilat kemi marrë pjesë, tashmë je bërë një pjesë e çmuar e jetës sime shoqërore. Jam shumë i lumtur që kam një mikeshë kaq të mirë sa ti. Shpresoj që të shkëlqesh si yll kudo!



Klea Çulaj

Alisia Gjata-Klea, je një nga shoqet e mia të parat që kam pasur kur erdha në shkollë në klasën e 9-të. Me ty kam kaluar një kohë fantastike dhe kurre nuk kemi pasur probleme me njëra-tjetrën. Natyra jote e qetë dhe tolerante më ka bërë që të përshtatem më mirë me ty. Të kam shumë për zemër dhe deshiroj që miqësia jonë mos të mbarojë asnjëherë. Të uroj sukses dhe që të plotesohen të gjitha dëshirat që tike. Të kam shumë xhan!

Arnis Llazari - Je një vajzë e dashur me të gjithë, e zgjuar dhe shumë e shoqërueshme. S'besoj se të kam parë ndonjëherë në mësim orën e parë të ditës. as ne shkollë. Të uroj shume suksese!

Daniel Lavdari - Klea je nga njerëzit më pozitiv dhe me këmbë në tokë. Gjithmonë je e gatshme të ndihmosh klasën dhe i bashkohesh çdo grupi të saj. Të uroj suksese në jetë!

Dea Merkaj - Në qoftë se do të më duhej të të përshkruaja me një fjalë do të ishte "e zjarrtë". Ti je një femër me karakter të fortë e cila i bën ball çdo problemi dhe gjithmonë mundohesh të mbash frymën optimiste. Të admiroj në lidhje me çdo gjë që ti simbolizon. Sa herë më duhet të diskutoj me dikë pa patur rëndësi tema ti je gjithmonë aty duke dëgjuar dhe shpeshherë duke pohuar mendimet e mia. Më pëlqen shumë fakti që je aq mirëkuptuese dhe e çiltër. Jam shumë e lumtur që kam patur mundësinë të njoh një vajzë si ti. Të uroj sa më shumë suksese!

Eldi Pashaj - Një vajzë shumë e shkathët shumë e dashur dhe shumë e qeshur, një shoqe e cila të ndihmon gjithmonë në çfarëdolloj momenti. Një njeri shumë i dashur dhe suportues. Të uroj suksese!

Emili Leka - Klea, je një vajzë e urte dhe serioze por

shume e zgjuar. Je një shoqe shpirtmirë që përshtatesh me të gjithë. Edhe pse ukrijua pak vonë shoqëria jonë, e kam shijuar shumë. Të uroj sa më shumë suksese në jetë!

Gledis Arapi-Nuk e di si t'ia nis, por fjalët për ty nuk do të më mbaronin kurrë. Klea, ky ishte viti i parë që ne u afruam kaq shumë dhe më duket sikur kam shumë vite që të njoh. Kemi kaluar aq momente të bukura bashkë, aq shumë gallata e aventura që nuk do të harrohen kollaj. Në fillim, kur të njoha se mendoja që do të beheshim kaq të afërta. Shumë faleminderit për çdo këshillë, për çdo moment kur unë nuk jam ndjerë mirë dhe je munduar të më qetësosh. Sa herë të shoh më kujtohen të gjitha budalliqet apo ndodhitë fliqëse që ne na ndodhin shpesh e sa shumë e shumë.

Greis Koka - Je një femër e zjarrtë dhe shumë playful. Je një vajzë e cila ka shumë aspekte e talente. Më bën shumë përshtypje pozitiviteti jotë dhe më pëlqen shumë energjia që ti sjell. Je konfidente, por gjithashtu me këmbë në tokë dhe rrallë gjenë vajza si ti. Të uroj shumë suksese dhe uroj të marrësh çdo gjë që do nga kjo botë.

Kapllan Sheno - Klea, edhe pse kemi tre vite që jemi bashkë në gjimnaz, ende nuk kam arritur të të njoh plotësisht. Por me aq sa kam arritur të të njoh, më ke dhënë një përshtypje vërtet pozitive. Të falenderoj për të gjitha ndihmat që më ke dhënë gjatë testeve. Çdo mbështetje dhe këshillë e jotja ka qenë e çmuar për mua. Të uroj suksese në të ardhmen dhe të them se jam i bindur se do të arrish të bëhesh një vajzë e zonja. Me vendosmërinë dhe inteligjencën tënde, nuk kam dyshim se do të bësh ndryshime të mëdha në botën e ligjit.

Katrin Gjata-Klea, një nga shoqet e mia më të mira gjatë gjimnazit. Nuk do i harroj kurrë momentet e bukura që kemi kaluar bashkë dhe si jemi rritur së bashku. Shpresoj që jeta të sjellë vetëm të mira dhe të kesh suksese në çdo hap që do hedhësh. Të uroj të mirat. Të uth!

Kesli Sejdarasi - Klea je një njeri shumë i shoqërueshëm dhe një shoqe e mirë. Për këto vite që të kam njohur shoqëria jonë sa vjen dhe është forcuar. Ke një balancë të madhe mes qetësisë tënde dhe anës tënde sociale. Kemi kaluar vetëm momente pozitive dhe argëtuese së bashku. Të perqafoj! Sara Pajtoni - Klea një vajzë e qetë dhe e buzëqeshur, që gjithmonë është aty për të të ndihmuar. Të vlersoj për miqësinë në këto vite dhe të uroj suksese të mëtejshme!



Klea Metaj

Anda Kola - Klea, një nga vajzat më punëtore dhe ambicioze, që pata fatin ta njoh në vitin e tretë. Edhe pse nuk njihemi prej shumë kohësh, më duket sikur të kam patur gjithnjë shoqe. Shoqëria jote këtë vit ka qenë mjaft e këndshme për mua, dhe jam mirënjohëse që ndaj kujtime me dikë kaq të veçantë si ti. E paç jetën plot arritje dhe pozitivitet! Jam e sigurt që do shkëlqesh, siç shkëlqen gjithnjë! Të kam shumë xhan dhe të uroj më të mirat e botës! <3

Arnis Llazari - Je një vajzë e zgjuar dhe e dashur me të gjithë. Më pëlqen dedikimi yt për rrugën që po vazhdon dhe të uroj shumë suksese kudo në jetë!

Bjorni Prri - Klea, një vajzë shumë e sjellshme dhe e devotshme në mësimet. Ke një karakter shumë të qetë, por kur vjen puna për mësimet, je aktive dhe e gatshme për të folur. Nëse vazhdon kështu jam i sigurt se do ia dalësh për t'u bërë një doktoreshë sa më e mirë.

Daniel Lavdari - Klea, je një nxënëse model. Në fillim, kur erdhe në klasën tonë, më ke habitur me zgjuarsinë që të karakterizon, por tani kjo gjë është bërë e përditshme. Jam i sigurt që, kudo që të shkosh, do t'ia dalësh t'i realizosh qëllimet e tua. Të uroj shumë suksese!

Dea Merkaj - Ambicia, puna e palodhur dhe vullneti, janë tiparet që të karakterizojnë ty dhe e bëjnë të sigurt faktin që ke për t'ia dalë kur të ballafaqohesh me sfidat e jetës. Edhe pse erdhe në klasën tonë vitin e kaluar, unë personalisht të jam mirënjohëse për ndihmën që ke dhënë. Je një vajzë shumë e mirë, me aspirata të larta për sukses, prandaj të uroj gjithë të mirat dhe që të realizosh çdo gjë që dëshiron! Gjithashtu, mendoj se

asnjë degë tjetër nuk mund të të përshtatej më shumë se sa zgjedhja jote aktuale, prandaj uroj që gjithçka të shkojë sa më mirë!

Emili Leka - Klea, je një vajzë shumë e zgjuar, që je përshtatur më së miri në klasën tonë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen dhe jam e bindur se do të bëhesh një mjeke e shkëlqyer!

Endi Rexhepi - U bënë dy vite që ke ardhur në klasën tonë dhe gjatë këtyre dy viteve ke qenë nxënësjë më ekselentja. Je një vajzë shumë e zgjuar dhe e përkushtuar në mësimet. Të uroj suksese!

Flavio Gjoka - Klea, doktoresha e klasës! Ti nuk ke fjalë, por vepra. Jam i bindur që nuk do të jetë aspak problem për ty të përballësh me sfidat e jetës. Jam shumë i sigurt, por gjithësesi të uroj më të mirat!

Glen Qesku - Nuk e di se si ja del që të mësosh kaq shumë! Je një vajzë që të gjitha zyshat e lavdërojnë dhe që i ndihmon të gjithë nxënësit e klasës me mësimet. As zysh Flora nuk të kap dot mat. Ke qenë një shoqe klase dhe vajzë shumë e shkëlqyer këto 2 vite. Paç fat në të ardhmen tënde shumë premtuese si mjeke! Shpresoj mos të kemi nevojë të vijmë tek ti për t'u shëruar, por për të pirë një kafe të gjithë si klasë. Të uroj suksese!

Kapllan Sheno - Je një vajzë jashtëzakonisht e sjellshme dhe e zgjuar. Me inteligjencën tënde të habitshme ke arritur të ndriçosh klasën dhe të jesh një frymëzim për të gjithë ne. Dua të shpreh mirënjohjen time për ty. Edhe pse jemi njohur prej pak kohësh, vlerësoj shumë prezencën tënde në rrethin tonë shoqëror. E di që do të arrish gjëra të mëdha në jetë dhe jam i bindur se një ditë do të bëhesh një kirurge shumë e suksesshme dhe me emër. Të uroj shumë suksese dhe fat në jetë! Me respekt dhe miqësi, Kapo.

Rei Xhoga - Edhe pse jemi njohur prej pak kohësh, kjo kohë ka mjaftuar që të vlerësoj inteligjencën dhe sjelljen tënde të mrekullueshme. Ti je një vajzë JASHTËZAKONISHT e zgjuar dhe e sjellshme. Faleminderit që je pjesë e rrjetit tim të miqve dhe që sjell një dritë të veçantë në çdo situatë. Me shpresën për kujtime të shumta të përbashkëta dhe aventura të reja, po të shpreh mirënjohjen time për shoqërinë tënde të mrekullueshme. Me dashuri dhe respekt, Rei!
Sara Pajtoni - Një vajzë shumë inteligjente dhe e palodhur. Ambicia për punë do të të çojë shumë përpara në realizimin e qëllimeve të tua. Të uroj suksese në jetë!



Rei Xhoga

Arnis Llazari - O mbreti i klasës! O Xhog palestra! Mbaj mend kur më pyesje në vit të parë për palestrën, se sapo e kishe filluar, e ja ku je tani, 18 vjeçari më i madh i vërtetë! Je një shok shumë i mirë dhe jam shumë i lumtur që të kam pasur në klasë këto 3 vite, sepse na e ke bërë çdo ditë interesante me ndonjë gjë të re. Kemi kaluar kohë të bukura dhe duke luajtur Warzone bashkë. S'do të harroj kurrë dhe shpresoj të mbetemi miq përgjithmonë!

Dea Merkaj - Rei nuk ka qenë një individ me të cilin mund ta shikoja veten time të afruar në fillim. Rei është një djalë ambicioz, me aspirata të larta dhe qëllime të qarta për të ardhmen e tij. Ai lufton fort për të arritur çdo gjë që ai dëshiron, prandaj dhe unë nuk kam dyshimë që atij kanë për t'iu realizuar të gjitha dëshirat. Gjithmonë është kënaqësi të krijosh një shoqëri me një njeri si Rei, pasi, edhe pse ndonjëherë mund të duket e kundërta, qartazi ai ka një zemër të bardhë. Nuk kam fjalë ta përshkruaj se sa e lumtur jam që në miqësinë tone nuk ekzistojnë barrierat dhe mbizotëron lirshmëria. Sukseset e mëtejshme Rei dhe më bëhet qejfi që të kam njohur! Pres të m'i bësh vizitat falas!

Ermir Gjikota - Me zemër dhe ngrohtësi për mikun tim të shkëlqyeshëm, Rein! Faleminderit që ke qenë gjithmonë aty për mua në çdo kohë, të vështirë dhe të lumtur! Jeta është më e bukur me ty pranë. Uroj që rrugëtimi ynë i përbashkët të vazhdojë me kujtime më të bukura!

Glen Qesku - 18 vjeçari më i madh dhe më hiperaktiv në botë! Tështimat tona, që dëgjoheshin deri tek zyra e ekonomistes, nuk kanë për t'u harruar asnjëherë. Mezi pres të shoh që të bëhesh një doktor i shkëlqyer

dhe të shpëtosh sa më shumë jetë. Jam i sigurtë që do ia dalësh, edhe pse do ta vazhdosh universitetin tek ``Zoja...``. Një këshillë po ta jap: Duhet të tregohesh më i mprehtë dhe mos e vrit shumë mendjen! Pyetja ime për ty është: A shtyn dot 200 kg me triceps?

Greis Koka - Xhonga, tentativa jote për t'më vrrarë, nuk funksionoi :D. Pavarësisht shakave, je një djalë shumë i mirë, i edukuar dhe plot humor (ndonjëherë s'e kuptoj a janë shaka apo të vërteta). Jam e lumtur që të kam patur në klasë dhe kemi pasur shoqëri. Je një djalë shumë i zgjuar, kështu që s'ta kam frikën. Uroj që planet, të cilat ke menduar për veten, të realizohen me sukses dhe shpresoj që komunikimi ynë të vazhdojë. Mos i ``manipulo`` më zyshat! :D

Kapllan Sheno - Kohët që kemi kaluar së bashku, që nga fillimi i klasës së parë e deri në fund të gjimnazit, kanë qenë të mrekullueshme dhe kujtimet që kemi ndërtuar janë thelbësore dhe të paharrueshme për mua. Ti ke qenë një shok i besueshëm dhe plot energji. Përtej miqësië sonë, kemi mësuar bashkë dhe kemi rritur njëri-tjetrin. Kemi kaluar shumë momente, të cilat, kur më kujtohen, më vjen të qesh me to, por gjithashtu ndiej nostalgji për ato kohëra të bukura që tani nuk kthehen më. Më kujtohet veçanërisht një moment kur kemi qenë bashkë në bankë, në orën e gjuhës, dhe kemi qeshur aq shumë saqë u mbytëm (e di ti se për ç'a). Një pjesë e jetës sime është pasuruar për shkak se ti ishe në jetën time dhe për këtë të jam mirënjohës. Dua të theksoj se jam krenar që kam një mik të tillë si ty dhe shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë të forcohet përgjatë viteve. Unë besoj se të gjitha ëndrrat dhe synimet që ke do të realizohen me sukses, sepse ke një vullnet të fortë. E di që një ditë e gjithë puna jote do të shpërblehet, kur ti të bëhesh një kirurg i suksesshëm. Të uroj të gjitha të mirat në rrugën tënde të ardhshme! Kujdesu mirë për veten dhe mos harro që gjithmonë do të kesh një mik të besueshëm!

Kesli Sejdarasi - Rei, një nga shokët e mi më të afërt dhe gjithashtu shoku im i bankës i vitit të tretë. Kemi shumë kujtime të bukura dhe të qeshura së bashku. Je zemërgjerë dhe qëndron vetvetja, pa i dëgjuar opinionet e të tjerëve. Disa cilësi të tjera të tua shumë të mira janë disiplina që ke dhe që më dëgjon me vëmendje përherë kur flas. Uroj t'i realizosh të gjitha ëndrrat e tua!



Sara Pajtoni

Albana Bami - Sara, një nga shoqet e mia më të afërta. Shkolla po mbaron, por duhet të dish se shoqëria jonë nuk do të ndaloje kurrë, edhe nëse jemi larg. Që në ditët e para që jemi njohur, ti u bërë një pjesë e rëndësishme e jetës sime, dhe që atëherë shoqëria jonë po vazhdon e po forcohet. Momentet tona të paharrueshme dhe aventurat nga më të çuditshmet, do të mbeten gjithmonë kujtimet më të bukura për mua. Qëndro kështu siç je, vajza më e mirë, që di të më sjellë buzëqeshjen në fytyrë, sado keq të jetë duke më kaluar dita! Kur jemi bashkë nuk ka momente të qeta, sepse gjithmonë ka diçka që na bën të qeshim me lot dhe këto gjëra unë nuk do t'i harroj kurrë. Nuk po zgjatem shumë, sepse të gjithë e njohin personalitetin tënd unik, por thjesht do të uroj shumë suksese në vazhdim dhe gjithë të mirat e botes! Love you!

Arnis Llazari - O Sarë! Je një shoqe shumë e mirë. Je tepër e matur dhe mendoj se bashkë ia kemi kaluar shumë bukur. Shpresoj që gjithmonë të jesh kjo që je dhe të uroj shumë suksese në çdo gjë që do të bësh!

Daniel Lavdari – Sara, je një person i qetë dhe paqësor, gjithmonë me një vetëbesim të madh dhe e vendosur. Me aftësitë dhe cilësitë që ke besoj se do ecësh përpara dhe do kesh arritje të mëdha. Të uroj të të plotësohen të gjitha synimet në jetë!

Emili Leka – Soraa, ti i di fjalët që do them unë te ky dedikim akoma pa ti shkruar, sepse t'i shpreh çdo ditë ;), por dëgjoji përsëri! Më duket e çuditshme të shkruaj një dedikim për shoqërinë tonë, pasi po mbyllet gjimnazi, e jo miqësia. Kemi arritur në një pike, ku fjala shoqe më duket shumë pak për t'u drejtuar ty. Kemi kaluar aq shumë kohë bashkë dhe e kemi parë njëra-tjetrën në gati çdo situatë. Je një person shumë

i rëndësishëm për mua, pasi shumë situata nuk i kaloj dot pa ty. Sa herë ndodh diçka që më bën të qesh, je i pari njeri të cilit i shkruaj dhe, nga ana tjetër, mund të jesh i vetmi person që e di kur mërzhitem. Edhe pse unë mund të shkoj jashtë tani, mos mendo se do shpëtohet dhe bëj gati biletat se të dua atje çdo fundjavë (vjen për takime pune, po pyeti njeri). Love you!

Endi Rexhepi - Njihemi që në klasë të parë, kur ishim te A-ja. Sa shpejt kaluan vitet! Mbjaj mend si sot, kur munde të gjithë çunat në mundje dore dhe ne na dukej e pabesueshme. Kaloj nje dekadë që atëherë dhe ke ndryshuar shumë. Edhe pse nuk të njoh aq mire, më dukesh një vajze shumë e matur dhe e zgjuar. Te uroj shumë suksese!

Gledis Arapi- Sara, je një vajzë shumë e mirë, e dashur dhe gazmore. Ishte shumë kënaqësi që të njoha këto 3 vite. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat!

Glen Qesku - O mi Sare! Je një vajzë inteligjente dhe e mprehtë. Mendoj se këto dy vite kemi pasur një shoqëri shumë të bukur. Uroj që këto virtyte të të ndjekin gjithë jetën dhe të jesh gjithmonë e tillë! Paç fat dhe suksese të mëtejshme!

Kapllan Sheno - Sara, këtë vit arrita të njoh më mirë karakterin tënd të veçantë. Je një vajzë e jashtëzakonshme, e sjellshme dhe plot pozitivitet. Edhe në momentet kur nuk kam qenë në humor, gjithmonë ke arritur të më bësh të qesh dhe të më japësh energji pozitive. Ke qenë gjithmonë aty për të kthyer një ditë të zymtë në një ditë me diell, ndaj të falenderoj për çdo moment! Të uroj suksese kudo në jetë! Me respekt, Kapllan Sheno.

Xhoi Beja - Sara Paxhoni, my yl! Gjatë këtyre viteve tek ty kam gjetur këshillat më të mira dhe kujdesi që t'i ke trreguar për grupin tonë shoqëror, të ben ty super speciale. Sa herë që kam diçka, ti gjendesh gjithmonë aty për mua. Mund të them se ti je një nga personat më të afërt që kam dhe nuk i imagjinoj dot këto vite pa ty. E di që në të ardhmen do vazhdojmë të jemi besties, se edhe po mos të duash, s'ke nga shkon. Je the best shofer që mund të kisha patur dhe vetëm prej teje kam mësuar rrugët e Tiranës. Të uroj suksese our businesswoman dhe shpresoj të të shoh sa më të lumtur së shpejti... Love you!



Sindi Miftari

Bjorni Prhini - Sindi, ndonëse nuk kemi kaluar shumë kohë bashkë, përshtypja ime për ty është e jashtëzakonshme. Zemërgjerësia dhe mirësia jote kanë ndikuar në të gjithë klasën. Të uroj që të gjitha synimet të të realizohen!

Dea Merkaj - Më shkrin mënyra se si ti thjesht rrefuzon dhe del nga klasa në orën e gjermanishtes. Të admiroj për moskokëçarjen tënde. Faleminderit që na bën të qeshim pak, edhe në ato ditët tona të zymta. Shyqyr që të kemi ty pak të gjatë në klasë se këta të tjerët lënë për të dëshiruar. Të uroj suksese!

Eldi Pashaj – Sindi, një dibran i vërtetë! Gjithmonë i merr gjërat shtruar dhe nuk e streson veten me lloj e soj broçkullash. I çon gjërat deri në fund. EPPPE TOPIN. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat.

Ensar Zhuka - Edhe pse të kam njohur ktë vit, dhe shumicën e vitit ke qënë në gjumë, sërish mund të them që ti je një person shumë pozitiv dhe gazmor. Je një djalë shumë i sinqertë dhe të uroj shumë suksese në jete!

Ermir Gjikota - Dashuri dhe miqësi të pafund, për një shok të mrekullueshëm! Gëzuar për çdo moment të mirë dhe për aventurat që na presin së bashku. Suksese!

Fabio Dani – Sindi, këtë vit që qëlluar në një klasë, ti ke qënë shumë i afrueshëm me mua, edhe pse gjysmën e kohës ose ke munguar ose ke qënë në gjumë. Të uroj suksese!

Flavio Gjoka - Besoj se unë dhe Ermiri të njohim më mirë se të gjithë dhe nuk mund të harroj gallatat tona,

të cilat, kur i fillojmë nuk dimë se kur do na mbarojnë. Jam i sigurt se do të të kem mik për gjithë jetën dhe të uroj më të mirat!

Greis Koka - Djalë plot humor, që e mbush klasën me të qeshura. Klasa e gjermanishtes s'do ishte e njejta pa ty dhe shakatë që bën. Më mek shumë se si thjesht vendos që të dalësh nga klasa dhe nuk kthehesh. Je goxha djalë pozitiv dhe e vlerësoj këtë si fakt. (Shyqyr që je ti i gjatë se këta lënë për të dëshiruar.) Uroj të kesh shumë fat dhe t'u plotësofshin të gjitha dëshirat, slay!

Kapllan Sheno - Një djalë që sjell vetëm pozitivitet. Ndonjëherë më dukesh shumë i urtë në orën e mësimit, por kur ktheja kokën pas për të të parë, e kuptoja pse ishe aq i urtë. Nuk do t'i harroj kurrë historitë që tregojë në orën e fiskulturës, bashkë me Ermirin. Historia me spaghetti do të mbetet gjithmonë në mendjen time. Sind, të uroj suksese kudo në jetë!

Kesli Sejdarasi – Sindi, ti ke qënë një shok shumë i afërt i imi dhe të gjitha kohët që kemi ndejtur bashkë ia kemi kaluar shumë mirë. Je gjithmonë i afrueshëm me njerëzit, sidomos kur erdhe tek klasa e re këtë vit. Të uroj shumë suksese në jetë dhe shpresoj të të realizohen ato që ti do!

Klea Çulaj - Sindi, edhe pse jemi njohur më vonë, kemi arritur të krijojmë shoqëri. Je një djalë i zgjuar, por që kënaqësi të veçantë të jep vetëm gjumi në klasë. Edhe pse kemi qënë bashkë në bankë, sërish nuk kemi arritur të bisedojmë aq shumë, pasi pasioni yt për gjumin është më i madh sesa biseda me të tjerët. :D Megjithatë, në momente të tjera ke treguar që je një djalë i zgjuar, i dashur dhe plot humor. Të uroj suksese në jetë!

Rei Xhoga – Je një nga miqtë e mi më të mirë në klasë. Shoqëria jonë s'ka të ndalur: plot muhabete e batuta. Akoma më kujtohet ekskursioni që bëmë në Vlorë, ndaj gallatat që bëmë atë ditë nuk do t'i harroj kurrë. Të uroj suksese të mëtejshme! Me dashuri, Xhoga.

Xhejmon Korça - Kemi 3 vite që njihemi bashkë dhe them se të njoh mirë si person. Përpiqesh të arrish maksimumin tënd dhe me shakatë e tua na ke bërë për të qeshur gjithmonë. Të uroj më të mirën dhe shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë!



Xhejmon Korça

Bjorni Prrini - Xhejmon, në të vërtetë ka qenë një privilegj të të njoh dhe të ndaj momente me ty në klasë. Edhe pse nuk kemi kaluar shumë kohë bashkë, çdo moment që kemi ndarë ka qenë i çmuar për mua. Admirimi im për karakterin dhe zemërgjerësinë tënde është i madh. Faleminderit për të gjitha buzëqeshjet dhe çdo moment të këndshëm që ke sjellë në klasë! Uroj që të gjitha ëndrrat dhe synimet të të realizohen!

Dea Merkaj - Je një djalë i qetë, artikulon bukur dhe ke shaka të lezetshme. Gjithmonë kam patur përshtypje pozitive për ty, pasi më je dukur njeri realist dhe i komunikueshëm. Dukesh që je ambicioz dhe me synime të qarta. Të uroj sa më shumë suksese dhe shpresoj të arrish çdo gjë që ti do! Më bëhet qejfi që i je bashkuar këtë vit klasës sonë.

Eldi Pashaj - Je një këngëtar serenatash i vërtetë, një djalë shumë i matur dhe gjithmonë i qeshur! Ti je një fizikant i vërtetë, prandaj me dashurinë dhe pasionin që ke për fizikën, do të mposhtësh gjithë botën. Shpresoj të jesh gjithmonë i qeshur dhe të të plotësohen të gjitha dëshirat tua! U bëfsh një mjek i pakapshëm! Respekte! Eldi.

Emili Leka - Xhejmon, je një djalë shumë i zgjuar dhe i sjellshëm. Ato pak herë që ti flet, nuk harrohen kurrë. Uroj të arrish sa më shumë në jetë dhe na ndero atdheun!

Ensar Zhuka - E kemi kaluar vitin e fundit bashkë, në të njëjtën klasë. Edhe pse nuk kemi qëndruar shumë kohë bashkë mund të them që je një person shumë i sinqertë. Je një djalë shumë i zgjuar dhe i qetë. Të uroj shumë suksese në jetë!

Ermir Gjikota - Bashkë kemi shijuar momente

të paharrueshme, nga ditët e thjeshta në kafe, deri te udhëtimet e papritura. Kujtoj çdo shaka, çdo bisedë dhe çdo mbështetje që kemi ndarë.

Flavio Gjoka - Lali im, si mund të të harroj?! Me të vërtetë kemi 3 vite që njihemi, po këtë vit që kemi qëndruar në bankë, e kemi njohur më mirë njëri-tjetrin. Nuk besoj se mund të harrohen momentet kur e gjithë klasa ishte në qetësi dhe papritmas dëgjohej e qeshura ime, herë nga batutat e tua e herë nga serioziteti yt. Jam i sigurt që ka pasur momente që ta kam nxirë jetën duke të folur, po edhe kur shkolla të mbarojë, përsëri do të t'i kujtoj këto kohë të bukura që kemi kaluar së bashku. Dhe, se për pak do harroja, mos u kthe më andej nga ke ardhur (USL), por më mirë eja në qytetin tim të bukur të lindjes. Uroj që çdo dëshirë e jotja të bëhet realitet!

Greis Koka - Je një djalë i urtë, por ke goxha shaka të bukura. Je i sjellshëm dhe mund të bësh lehtësisht muhabet me ty. Jam e lumtur që iu bashkove klasës sonë sivjet. Të uroj shumë suksese!

Kapllan Sheno - Xhejmon, me këtë dedikim dua të shpreh mirënjohjen time për të gjitha momentet e këndshme që kemi kaluar së bashku, gjatë këtij viti. Ti je një djalë i sjellshëm e me karakter të fortë, dhe kjo është diçka që admiroj shumë tek ti. Edhe pse nuk arrita të të njoh prej një kohe të gjatë, ka qenë një privilegj të takoj një person si ti. Uroj që të vazhdosh të shkëlqesh në të gjitha fushat e jetës dhe të arrish suksesin në çdo hap që hedh! Me respekt, Kapllan Sheno.

Kesli Sejdarasi - Xhejmoni, që nuk na zhgënjën kurrë me shakatë e veta dhe na bën përherë për të qeshur. Në fillim të lë përshtypjen se je njeri shumë i qetë dhe serioz, por është komplet e kundërta. Edhe pse me shaka ne bëjmë sikur zihemi tërë kohën, sërish shkojmë shumë mirë. Jam shumë mirënjohëse që ju pata ngjitur bankës, ty dhe Flavion.

Klea Metaj - Je një djalë shumë i sjellshëm dhe që gjithmonë përpiqet për të dhënë performancën më të mirë në shkollë. Suksese!

Rei Xhoga - Xhejmon, miku im i mire! Dua të të falenderoj që ke qenë pjesë e klasës sime, me sjelljen tënde të mrekullueshme. Je një ish-senator ambicioz dhe kjo është diçka që admiroj shumë tek ti. Uroj që të vazhdosh të shkëlqesh në të gjitha fushat e jetës dhe të arrish suksesin në çdo hap që bën. Miku yt, Xhoga.













Brikela Salihaj

Të dashur nxënës të klasës 12F,

Në këto dy vite të kaluara së bashku, kemi ndarë momente të paharrueshme dhe kemi krijuar kujtime të çmuara. Jeta është plot me mundësi emocionuese – kapini ato me të dyja duart dhe mos i lini të shkojnë derisa të keni gjithçka që dëshironi. Unë e njoh secilin prej jush kam marrë dhe kam dhënë për të ndërtuar diçka që ndoshta asnjëherë askush nuk mund ta shembë. Kjo gjë ju bën juve të veçantë dhe unik.

Do të mbaheni mend gjithmonë si klasa që ka fituar më shumë konkurse se çdo klasë tjetër. Përkushtimi, bashkëpunimi dhe pasioni juaj kanë qenë shembull për të gjithë ju.

Ju falenderoj për çdo moment të bukur dhe ju uroj një të ardhme plot me suksese dhe lumturi.

Mbajeni gjithmonë këtë dritë brenda jush dhe vazhdoni të ndriçoni botën!

Me dashuri dhe krenari,

Zyshe kujdestare e klasës 12F Brikela Salihaj



Albion Qojle

Je një djalë i urtë dhe shumë i zgjuar, me plot virtyte që t'i njohin të gjithë. Je i sjellshëm, i matur, shumë kokëfortë dhe mjaft i sinqertë. Nëse nuk do të të kisha folur asnjëherë, nuk do e dija që të karakterizon një sens humori i veçantë që ma ndryshon gjithë ditën, që qëndron i fshehur mes shumë cilësive të tjera të rralla. Bisedat e mrekullueshme që kemi bërë së bashku do të mbeten gjatë në memorien time si nga më të veçantat që do të kem. Mendoj se je shoku më i mirë që mund të kisha pasur ndonjëherë. Je i papërsëritshëm dhe është gjë e rrallë të gjej një njeri plot mirësi si ty. Jam shumë mirënjohëse që të kam takuar e që shoqëria jonë ka zënë një pjesë të madhe të kujtimeve të mia të gjimnazit. Jam e bindur që do të arrish shumë larg, e mezi pres të të shoh të suksesshëm. Të kam shumë xhan! - Anda Kola

Je një person që e çon gjithmonë deri në fund atë që fillon. Ti gjithmonë përpiqesh të japësh më të mirën edhe për gjëra në dukje të parëndësishme. Nuk të mungon disiplina, mos e vë kurrë në dyshim, sa herë që ke nevojë për pak pushim. Jam e bindur se çdo përpjekje do të shpërblehet dhe e ardhmja do të jetë ashtu siç e ke imagjinuar. - Emilja Zeneli

Albion, je një nga çunat më zemërmirë që njoh, si dhe nga njerëzit më të zgjuar që kam njohur deri tani, si në shkollë dhe në shah. Kujtoj kampionatin e shahut dhe sa herë takoheshim për të luajtur e për të bërë muhabet, si dhe ndeshjen e fundit, ku kemi qëndruar tri orë mësimi jashtë. Këtë vit erdha në klasë me ty, gjë që na afroi më shumë. Të uroj shumë fat, por me shumë mundësi nuk do të kesh nevojë për shumë, pasi të njoh dhe di që do të jesh i shkëlqyer sido që të të shkojnë punët. - Rei Escobar Durmishaj

Albioni, një djalë i qeshur, i dashur, mirëkuptues, me karakter të jashtëzakonshëm dhe unik, këto janë fjalët që të përshkruajnë më së miri. Jam mirënjohëse që munda të ndaj vitet më të bukura duke pasur një mik si ty. Je një diamant i rrallë që vështirë se gjendet më, prandaj vazhdo të ecësh në rrugën tënde drejt suksesit. Shpresoj që në vitet në vazhdim të takohemi jo vetëm si miq, por edhe si kolegë. Atëherë... shihemi në majë borëbardhë! - Merisa Dumani

Boni, rrugëtimi yt nga shkolla e mesme në profesionin e mjekësisë ka qenë frymëzues. Etja jote për njohuri dhe aftësia për të kapërcyer sfidat akademike na ka treguar përkushtimin e kërkuar për t'u bërë një mjek i ardhshëm. Ke qenë një burim motivimi për të gjithë ne. Udhëtimi yt i mrekullueshëm sapo ka filluar dhe pres me padurim ditët kur përkushtimi yt do të kthehet në një të ardhme premtuese në fushën e mjekësisë. P.s.: Shpresoj që të shkëmbehemi sërish ndonjë ditë në Berat. - Vivien Kushi

Albion, je një entuziast i njohurive, i magjepsur nga faktet dhe i etur për të shkëlqyer akademikisht. Je gjithmonë i hapur për t'u përfshirë në diskutime për tema të ndryshme. Këto janë vetëm disa nga cilësitë e tua të shumta. Të uroj suksese në rrugëtimin tënd drejt mjekësisë! - Alisa Imeraj

Albion, je ndër njerëzit me zemrën më të mirë që kam takuar ndonjëherë, gjithmonë je aty për çdokënd që ka nevojë për ty. E di që të kam lodhur me 100 pyetje për mësim çdo ditë, por ke qenë më efikas se ChatGPT. Shpresoj që të rrethohesh gjithë jetën me njerëz si vetja. - Barjena Sulollari

Për Albionin, nxënësin me arritje të mëdha dhe përkushtim të palëkundur, intelektin dhe puna sistematike e të cilit ka spikatur në klasën tonë. Përpjekja jote për përsosmëri është një shembull që kërkohet ta ndjekin shumë prej nesh. Unë ndihem e privilegjuar që kam ndarë këtë rrugëtim me ty dhe mezi pres të shoh arritjet e tua në të ardhmen. Urime për punën e mirë, Albion, të uroj suksese kudo! - Daria Sinani

Je i vetmi person që njoh i cili kur zysha të pyet se çfarë librash lexoje kur ke qenë fëmijë, thojë libra shkencorë. Seriozisht, dashuria jote për shkencën është për t'u admiruar dhe pa frikë them që është një veçori që të diferencon nga të tjerët. Ta uroj me gjithë shpirt të arrish majat në jetë, jam shumë e sigurt që do të arrish çdo gjë që dëshiron. - Klesta Ademaj



Aldo Kulemani

Haveri jem, do të të mbaj mend gjithmonë si djalin më gallat dhe energjik që njoh. Shakatë e tua gjithmonë ma kanë zbukuruar ditën. Edhe pse mbarimi i shkollës mund të duket si një mirupafshim, të siguroj që shoqëria jonë do të mbetet po njësoj. Të uroj shumë suksese, syjeshili më i bukur! - Klejsa Neza

Ça me thën për ty... Njihemi që 5 vjeç dhe mund të them që je shok shumë i mirë. Humori gjithmonë është pjesë e pandashme e jotja. Personi më gallat që nuk rri dot një minutë pa bërë një shaka. Aldo, çuni që mbush klasën me plot humor. S'do të harroj kurrë, kur në orët e mësimit shkruanim me letra duke u marrë me thashetheme. Sukses dhe vetëm fat për ty, "Skënderbe"! - Fiona Shehu

Aldo Kulemani, ose ndryshe siç e thërrasim ne "Skëndërbeu". Gjithmonë tip i qeshur dhe pozitiv, edhe pse kam pak kohë që e njoh, është një nga shokët e mi më të mirë. Të uroj suksese kudo! - Gledidja Këmbaci

Je një nga çunat më të sinqertë e më të mirë që kam njohur. E mban mend në fillim se sa inat e kishim njëri-tjetrin dhe ta mendosh që tani kemi një shoqëri mjaft të mirë. Faleminderit për çdo gjë dhe jam me fat që të kisha pjesë të shoqërisë sime. Do të kesh një vend të veçantë në memorien time. Suksese, arritsh sa më lart! - Gledis Ruçi

Je një djalë shumë i respektueshëm dhe një nga shokët më të mirë. Gallatat që kemi bërë bashkë këtë vit nuk harrohen. Shpresoj të vazhdojmë të krijojmë akoma kujtime më vonë. Të uroj më të mirat e botës dhe suksese vlla! - Parid Çela

Aldo, je një djalë shumë i veçantë, ke parimet e tua dhe një këndvështrim tëndin për botën. Ke qenë gjithmonë energjik duke i përcjellë kështu dhe klasës këtë rrezatim energjie. - Barjena Sulollari

Je një shok shumë i mirë, me shumë humor dhe që i bën orët e mësimit sa më pak të mërzitshme. Të uroj suksese në të ardhmen! - Alfred Gabili

Një nga personat më të dashur dhe të shoqërueshëm që kam takuar dhe jam me fat që të konsideroj shok. Të uroj gjithë të mirat në jetë dhe shpresoj të arrish gjithçka që dëshiron në të ardhmen. - Klesta Ademaj

Për Aldon, djalin që edhe pse na u bashkua në vitin e fundit të rrugëtimit 3-vjeçar të gjimnazit, arriti fare mirë të përshtatej me shoqërinë tonë dhe na dhuroi shumë e shumë të qeshura me shakatë e tij. Do t'i kujtojmë gjithmonë orët e fiskulturës dhe shërbimet e tua të forta në volejball që përshkonin fushën me shpejtësi e prej të cilave na duhej të mbroheshim dhe të struknim kokën. - Daria Sinani



Alisa Dyrmo

Në çdo moment, ti arrin të kapërcesh barrierat dhe të krijosh lidhje të thella me të tjerët, duke i bërë bisedat tërheqëse dhe frymëzuese për të gjithë. Vazhdo më tej me të njëjtën energji dhe zell! - Alisa Imeraj

Pak veta mund të arrijnë të futen brenda Alisë dhe të kuptojnë vajzën e veçantë, plot me attribute të mira që ti je! Ndodhitë me ty nuk kanë fund dhe padyshim që në memorien time do ngelen gjatë. - Albion Qojle

Alisa, je një shoqe shumë e mirë, me të cilën ndaj kujtime. Ne të dyjave kurrë nuk na mbarojnë bisedat për të bërë, sepse gjithmonë ke diçka të re për të më treguar. Kjo gjë më pëlqen shumë. Je plot surpriza, prandaj do të më mungosh shumë. Të uroj suksese <3 - Anda Kola

Je një shoqe e besueshme dhe që nuk nguron të ndihmohet me mjetet. Të uroj sa më shumë suksese në të ardhmen! - Alfred Gabili

Për Alisën, vajzën me kaçurrela të arta e të pabindura. Zëri yt kumbues mi bën të vibroj në muret, klasën dhe korridorët e shkollës. Goca e një mbi një dritareve, që me natyrën e saj të hapur dhe të guximshme i dha emocion dhe entuziazëm klasës sonë. Nga Daria Sinani

Vajza më aktive që ka pasur klasa jonë. Me ty orët e historisë kanë kaluar shumë shpejt dhe bisedat në pushim të gjatë kanë qenë gjithmonë interesante. Të uroj suksese në rrugëtimin tënd! - Deivid Koçi

Vajzë e mirë dhe gjithmonë ka energji për të bezdisur të tjerët, por prapë klasa nuk do të kishte lezet pa të. Suksese! - Gledisja Këmbaci

Ti je një person me karakter të fortë dhe s'të dridhet qerpiku. Të uroj sa më shumë suksese në jetë. - Kejsi Kotica

Gjatë dy viteve të para, kemi folur pak, por kur erdha në klasë, më dhe përshtypjen e një personi të mirë, gallatë, me të cilin mund të flisje për gjëra të bukura. Mendoj se je një shoqe e mirë dhe pozitive, gjë që më bën të kënaqur që u afruam më shumë pasi erdha. Uroj që të të plotësohet çdo dëshirë që ke dhe të uroj shumë suksese. - Rei Escobar Durmishaj

Do të të quaja pa frikë një vorbull energjie dhe emocionesh, pasi kështu ke qenë gjithmonë. Je një personazh shumë i veçantë dhe për këtë të vlerësoj. Të uroj sa më shumë suksese në jetë dhe asnjëherë mos e humb këtë energji që ke. - Klesta Ademaj

Ndonëse kemi pasur përplasje të shumta në karaktere, gjithnjë do të të kujtoj si një vajzë energjike e karizmatike. Përgjigjet e tua të mprehta dhe të qeshurat infektive i kanë kthyer edhe momentet më të zakonshme në momente të paharrueshme. Ke qenë një mikeshë me të gjithë dhe humori yt na ka afruar më shumë. Teksa afron fundi i gjimnazit, do ta mbaj gjithmonë me vete të qeshurën dhe shoqërinë që solle në klasën tonë. - Vivien Kushi

Je ndër personat më hupthi-pupthi që kam njohur! Goxha e shkathët, me humor por dhe tepër e dashur. Krahas gjithë bëmave të tua, në thelb je shpirtmirë dhe i gjendesh pranë personave në kohë të zymta! Të uroj udhë sa më të ndritur dhe me sa më shumë suksese! - Merisa Dumani

Faleminderit që ke qenë një shoqe e mrekullueshme dhe që ke qenë gjithmonë aty për mua. Të uroj fat dhe suksese në të gjitha sfidat e tua të ardhshme. - Gledis Ruçi

Një vajzë shumë e çiltër dhe pozitive, të uroj fat dhe suksese në jetën tënde!! - Fiona Shehu

Dyrmo, ke qenë gjithmonë një vajzë shumë energjike. Di si të tërheqësh vëmendje dhe arrin gjithmonë të bësh biseda interesante me këdo që takon, pavarësisht nëse i njeh apo jo. Nuk heziton kurrë të shprehësh mendimin tënd dhe ta mbrosh atë deri në fund. Pavarësisht karakterit tënd në dukje të fortë, vlerësoj edhe anën tënde të ndjeshme dhe ndoshta pak feminare, e cila na ndihmon të të kuptojmë më mirë. Vazhdo të luftosh për gjërat që të bëjnë të lumtur! - Emilja Zeneli



Alisa Imeraj

Çupka më zemërgjerë e shkollës tonë. Ke qenë një ndër shoqet më të mira përgjatë këtij rrugëtimi shkollor. Miqësia jonë lindi rastësisht gjatë vitit të dytë dhe u forcua çdo ditë nga pak e nga pak. Ecjet tona plot diskutime e debate përgjatë shtigjeve të liqenit i kanë bërë të këndshme dhe të ngrohta fundjavët e shkurtra të këtyre muajve të gjatë. Një psikologe e vërtetë që e zhvillove këtë profesion pa përfunduar ende gjimnazin. Psikoanalizat e tua kanë qenë po aq interesante sa edhe të frikshme. Gati-gati përmes aftësive të tua duket sikur na bëje magji! Edhe pse shkollës po i vjen fundi, kujtimet tona do t'i mbaj gjithmonë pranë zemrës. Se vë në dyshim që do arrish të kesh sukses në profesionin tënd prej horizontit të gjerë që ke në psikologji dhe filozofi. Çfarëdolloj gjëje të ndodhë, pres që në të tridhjetat tona të flasim përsëri si në ditët e sotme. <3 - Esiana Këllici

Alisa, gjithnjë do të të njoh si një vajzë të qetë, të ëmbël dhe të apasionuar pas psikologjisë. Gjithnjë më kanë shijuar bisedat tona kur flisnim për tipet e ndryshme të personaliteteve, apo dhe të ndonjë teme filozofike tek të cilat thelloheshim dhe përhumbeshim aq shumë sa që na humbiste i tërë filli i diskutimit. Më kujtohet kur Arbi të ngacmonte në fillim të vitit të parë për kristalet, duke të të quajtur magjistare. Por ti ruaje qetësinë, duke e pranuar shakanë përzemërsisht. Shpresoj që të jesh gjithnjë me atë buzëqeshjen tënde të ëmbël e të ngrohtë dhe që të tëra dëshirat për të ardhmen të të plotësohen. - Vivien Kushi

Për Alisën, ose ndryshe siç e thërras unë, xhanëmin. Je një nga shoqet e mia më të mira që me praninë tënde, ma ka bërë udhëtimin tim në gjimnaz pafundësisht më të bukur. Miqësia, mbështetja dhe kujtimet tona kanë qenë qershia mbi tortë e këtyre viteve.

Faleminderit që ke qenë gjithmonë aty për mua me analizat e tua psikologjike. Do t'i kujtoj gjithmonë të qeshurat, bisedat dhe momentet e panumërta që kemi ndarë. Për mua, nuk je thjesht një shoqe klase, por një mikeshë e përvetshme. Shpresoj që lidhja e bukur që kemi krijuar do të na shoqërojë drejt shumë aventurave të ardhshme. Të dua fort! - Daria Sinani
Kam shumë për të thënë. Si mund të përmbledh me disa fjali 12 vjet dhe kaq shumë kujtime? Ti ke qenë gjithmonë në çdo moment, në çdo ndryshim, personi tek i cili mund të mbështetem. Ti je e kundërta ime në çdo aspekt të mundshëm, por kjo thjesht i ka bërë pikëpamjet tona gjithnjë e më të plota. E ardhmja do të ndryshojë shumë gjëra, por e shkuara nuk do të shuhet kurrë. Epo, në fund, gjithçka kishte kuptim... apo jo? - Emilja Zeneli

Rrëlsja klasës, ndër personat më të çiltër, më të dashur dhe më të drejtë që kam njohur. Binjakja ime profesionale, të uroj vetëm suksese dhe vetëm të mira!
- Merisa Dumani

Për Alisën, një vajzë empatike e të dashur. Alisa, je një nga vajzat më të këndshme e më interesante që njoh. Me tonin tënd të lezetshëm të zërit, duket sikur dhe ndodhitë më negative janë pozitive; kur janë të treguara nga ti. Prezenca jote i jep një atmosferë ndryshe klasës sonë, dhe jam mirënjohëse që kam kaluar kohë me dikë si ty. Të uroj më të mirat dhe shumë suksese! - Anda Kola

Alisa, je një nga vajzat me botën më të madhe që unë njoh. Kur të sheh për herë të parë nuk e kupton këtë gjë. Unë kam pasur fatin të të njoh më nga afër dhe dua të të falenderoj për të gjitha gjërat që më ke mësuar. Nuk do i harroj kurrë debatet tona të forta për ndjenjë-llogjikë. Të uroj suksese në rrugën tënde pasi e meriton. - Albion Qojle

Të kam njohur që në vit të parë dhe më ke krijuar përshtypjen e një vajze të sjellshme dhe me zemër të mirë. Këto mendime m'u përforcuan në këtë vit të tretë që kemi qenë shokë klase dhe ke qenë nga njerëzit dhe surprizat më të mira të këtij viti, duke qenë gjithmonë e gatshme për të ndihmuar dhe një person shumë i mirë për të biseduar. Qetësia me të cilën flet dhe dëshira për të kaluar bukur e për të diskutuar janë gjëra që i vlerësoj te ti. Uroj që të jesh sa më e lumtur dhe të të plotësohen dëshirat. - Rei Escobar Durmishaj



Arbi Bulica

Një djalë i veçantë, karizmatik, që s'ka të dytë si ty. Ke tërësisht prerjen e një deputeti. Je një person i aftë për të qenë lider fantastik, që i jep një frymë bashkuese grupit me aftësinë e papërsëritshme për të motivuar. Je djalë i sjellshëm dhe shumë i këndshëm, me të cilin mund të flasësh për çdo gjë. Jam mirënjohëse që njoh dikë si ty, dhe të uroj shumë suksese. - Anda

Arbi kemi kaluar shumë ulje-ngritje në shoqërinë tonë, por duhet pranuar gjithnjë na kanë pasur zili. Debatonim për gjërat më kot vetëm se s'kishim si të shtynim pasditen. Kam qenë dhe do të jem aty për ty sa herë të kesh nevojë. Te kam shumëëë xhan- Barjena Për Arbin, burimi i gazit dhe haresë në klasën tonë. Me batutat e tua argëtuese na ngre gjithmonë moralin. Humori yt ka ndriçuar edhe ditët më të mërzitshme dhe e qeshura jote infektuese është një shtysë për të mos e marrë kurrë jetën shumë seriozisht. Faleminderit që na ke mbajtur të gjithëve të buzëqeshur dhe na ke shtuar gëzim gjatë viteve të shkollës. Stili yt i humorit është unik dhe ne do t'i kujtojmë gjithmonë të qeshurat që kemi ndarë së bashku. Komandant, mbaj lart gjithmonë flamurin e gëzimit! - Daria

Ishim 3 vite në klasë bashkë. Je një shok shumë i mirë, një djalë shumë pozitiv dhe me humor. Nuk do të harrohen gallatat që kemi bërë bashkë dhe kur zyshat na ulnin larg njëri-tjetrit. Të uroj më të mirat edhe suksese Arbo! - Paridi

Kemi kaluar momente shumë të bukura bashkë. Jemi njohur që në vitin e parë bashkë në të njëjtin furgon. S'do i harroj kurrë mëngjeset me Arbin edhe lezetin që ka pasur "koha e byreku". S'do ta harroj kurrë një njeri si Arbi ku sillte gjithmonë pozitivitet dhe humor në çdo rast. Të uroj shumë suksese në çdo hap tëndin!

- Erkli

Në një botë plot ndjekës, ti shquhesh si një lider i vërtetë. Karizma dhe cilësitë e lindura të lidërshipt janë një dëshmi e aftësisë tënde për të ndikuar në jetën e atyre që të rrethojnë. E vetmja gjë që të uroj është shumë sukses në çfarëdo lloj karriere që zgjedh dhe nëse vjen dita kur do të kandidosh për kryeministër, e ke votën time. - Klesta

Arbi Bulica... [Mendoj që klasa jonë nuk do të ishte njësoj pa ty. Ti je një person i sinqertë dhe pa filtër. Ndonjëherë flet në momente të gabuara, por atë e bëjmë të gjithë. Orët e mësimin nuk janë të mërzitshme dhe aq monotone prej teje. Ti je një çun i mirë dhe shpresoj të arrish aty ku do në jetë. - Kejsi

Shoku im i bankës, një nxënës shumë i mirë dhe studiues aq sa arrin objektivat e tij. Më vjen mirë që je nxënës kërkues ndaj vetes. Je humorist dhe më pëlqen shoqëria me ty. Më pëlqen gjithashtu aftësia për të gënjyer në situata të caktuara. Do të doja që shoqëria jonë të vazhdonte dhe në vitet në vazhdim. - Aldo Hejji Arbi (përkthimi- çkemii arbii)

Kemi pasur gjithmonë një marrëdhënie urrejtje-shoqëri, ndoshta kjo për shkak të bipolaritetit tënd. Ndihem shumë me fat që kam arritur të njoh dikë të reputacionit tënd. Më ke iluminuar gjithmonë me dijen tënde të jashtëzakonshme. Gjithashtu, të falenderoj që më ke bërë kjo që jam sot dhe do të jem gjithmonë mirënjohëse ndaj teje. Përtej shakave je me të vërtetë një shok shumë i mirë që s'do ta harroj asnjëherë, ty dhe as humorin tënd. Të kam shumë xhan dhe të uroj shumë suksese! - Bukrijela

Edhe pse nuk kemi shumë që njihemi, humorin tënd do ta mbaj mend. Je një djalë i respektuar dhe me plot të mira. Suksese në të ardhmen! - Gledi

Personi më gallat që çdo orë mesimi bëhet më interesante. Plot energji dhe i sinqertë, që nuk i interesonte asgjë. Do më mungojë humori yt. Suksese dhe shpresoj të arrish atë që do në jetë! - Fiona

Pa Arbin në klasë 10I, 11I dhe 12F nuk do të kishin kuptim. Humori dhe shakatë e tua na kanë shoqëruar për 3 vite me radhë dhe gjithmonë kur ti mungojë, diçka nuk shkonte me klasën. Karakteri yt ekspresiv ka një humor të pakonkurrueshëm. Patrioti Arb Bulica do të mbetet gjatë në memorien time. - Albioni



Anda Kola

Ti merr rolin e shoqes sonë “psikologe”, duke i ofruar një vesh dëgjues dhe buzëqeshje të ngrohtë kujtdo që takon. Empatia dhe aftësia jote për të ndihmuar të tjerët të zgjidhin problemet e tyre krijon një mjedis harmonik. E qeshur dhe pozitive, ofron gjithmonë një fjalë të mirë dhe mbështetëse për kë ka nevojë. Të uroj shumë suksese në udhëtimin tënd! - Alisa Imeraj

Për Andën, vajzën me të cilën kam krijuar marrëdhënie të afërta në gjimnaz. Në vit të dytë do të ishte një projekt ASEF-i që do të na bashkonte dhe do më bënte të kuptoja se Anda është më shumë se thjesht një vajzë e qeshur dhe miqësore. Është një vajzë punëtore me qëllime, me një botë artistike dhe me një humor me të cilin qesh çdo ditë. Jam falenderues për momentet që kemi kaluar së bashku. E kam dashur dhe do ta dua gjithmonë energjinë që ti më dhuron. Janë të pakët personat me të cilët unë jam rehat dhe padyshim ti je një prej tyre. Përpiqu ta ruash botën tënde të bukur dhe mos ndrysho për askënd; je perfekte siç je. Pavarësisht se me sa pak orë gjumë mund të kem qenë, nuk kam mundur të shpëtoj pa qeshur nga ti. Jam mirënjohës që më ke shoqëruar në rrugëtimin tim. - Albion Qojle

Anda vockëlll, je një ndër vajzat me më shumë ambicie që kam takuar ndonjëherë, gjithmonë e gatshme për të dëgjuar 500 “hallet e problemet” e mia. Pozitiviteti dhe qetësia jote më kanë bërë që shpeshherë t’i shoh edhe unë gjërat në një këndvështrim tjetër. Uroj t’i plotësosh të gjitha ëndrrat e tua bukuroshe <3 - Barjena Sulollari

Për Andën, vajzën e cila me prezencën dhe të folurën e saj na fal një ndjenjë qetësie dhe paqeje në klasë. Edhe pse nuk e ngre kurrë zërin, je një vajzë që imponon gëzim me buzëqeshjen tënde dhe jep gjithmonë mendime të vlefshme. Na ke

treguar shumë herë që mesazhet më të fuqishme burojnë nga zemra dhe nuk ulërasin. - Daria Sinani


Anda moj Anda. Ti je një nga personat e mi të preferuar gjatë këtij rrugëtimi. Më vjen mirë që u bëmë shoqe. Kemi kaluar shumë situata të çuditshme dhe të bukura së bashku. Shpresoj që të vazhdojmë t’i kalojmë kështu edhe në të ardhmen. Të dua shumë dhe ti e di këtë. Të uroj sukses në jetë, sigurisht me mua aty. - Kejsi Kotica

Gjithmonë ke qenë për mua një nga njerëzit më interesantë që kam takuar ndonjëherë. Je një njeri me zemër të mirë dhe të sinqertë, me karakter të fortë, të drejtë dhe shumë aktive, duke qenë njëkohësisht një njeri moskokëçarës, me të cilin mund të kalosh momente të qeta e të flasësh për çdo gjë. Jam i lumtur që jemi shokë prej kohësh e që të kam pasur në furgon, pasi më ke zbukuruar shumë çdo rrugë për në shtëpi. Je nga njerëzit më pozitivë dhe mendoj se çdokush do të ishte me shumë fat të njihnte një njeri kaq të qeshur e të dashur në jetë. Jam i sigurt se do ta gesh veten shumë mirë kudo dhe të uroj shumë suksese e që mos ta humbasësh kurrë buzëqeshjen. - Rei Escobar Durmishaj

Aspiratat e tua të larta dhe zemra altruiste janë një kombinim i fuqishëm i destinuar për madhësi—udhëtimi yt qoftë i mbushur me arritje dhe ndikim pozitiv. Të kam shumë xhan dhe shpresoj të arrish çdo gjë që ti dëshiron. Me shumë dashuri, Klesta Ademaj
Je një mike që të vlerëson dhe që të gjendet gjithnjë pranë në situata të vështira. Je nga femrat që me vullnet e dëshirë mund të arrish gjëra të mëdha. Të uroj shumë sukses në rrugëtimin tënd! - Merisa Dumani

Anda, tek ti kam parë gjithmonë harmoninë dhe sharmin e natyrës, ndoshta edhe për shkak të fotove të peizazheve të gjelbëruara që poston në rrjetet sociale. Je aty për të ndihmuar njerëzit në nevojë dhe për të ndërgjegjësuar të tjerët për çështje që kërkojnë më shumë vëmendje. Veprimet paqësore, sado të vogla, janë një kontribut i çmuar për të gjithë ne. - Emilja Zeneli

Andushh, për ty nuk mund të them asgjë më pak se më të mirat. Je një vajzë e buzëqeshur dhe e ëmbël, aq sa e gjej veten duke kërkuar për ty sa herë fillon ora e kimit. Ke qenë një vajzë që vetëm ma ke zbukuruar këtë vit. Pres që të dyja të vazhdojmë kështu sepse nuk pranoj dot ndryshe. Të uroj shumë suksese Andush, love you! - Shefrin Shtylla



Alfred Gabili

Fred Gabili, erdhe në vitin e fundit në klasën tonë por na solle shumë pozitivitet. Je një djalë shumë inteligjent dhe një njeri me të cilin të lezeton muhabeti që bën. Ke premisa për gjëra të mëdha në jetë dhe shpresoj të arrish majat. Uroj që të vish më shpesh në Tiranë pas mbarimit të gjimnazit! - Arbi

Ke qenë një nga shokët më të mirë që kam pasur këto tre vite. E kemi kaluar shumë bukur këtë kohë dhe shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë akoma. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në shkollë dhe jetë. - Gledi

Alfred, edhe pse s'kemi shumë që njihemi, ti je një çun humoristik ahahaha. Gjithmonë e ke diçka për të thënë dhe asnjëherë nuk është ora e mërzitshme kur jemi bashkë në bankë. Ti je një djalë i zgjuar dhe i sinqertë, të cilat janë veçori shumë të rëndësishme në jetë. Shumë suksese në jetë. - Kejsi

Këto 3 vite, më je dukur një çun i mirë, i rregullt dhe i respektueshëm. Në dy prej tyre ke qenë senator, kështu që je gjithashtu një shok shumë i mirë, i saktë, i cili ka marrëdhënie të mira me shumë nxënës. Je, si nga njerëzit më të zgjuar që njoh në matematikë, ashtu dhe nga më të zotët që njoh në futboll. Të uroj shumë suksese, Fred. - Rei

Vendosmëria dhe qëndrimi yt kanë qenë gjërat e para që lanë përshtypje. Je një person shumë i zgjuar dhe të uroj gjithë të mirat në jetë dhe në karrierë. Shpresoj të trajtosh çdo problem që të sjell jeta me aq lehtësi sa trajton problemet e matematikës. - Klesta

Shoku matematicien që s'më la kurrë në baltë me ushtrimet e matematikës. Ky vit na njohu dhe, pse për një kohë të shkurtër, arritëm të krijonim momente

humoristike shumë të bukura. Nuk kishte ditë që nuk ziheshim, por gjithsesi do mbetesh një shok shumë i mirë. Shumë suksese, Thumansi, në jetë! - Fiona

Alfredi është djalë i zgjuar dhe i dashur, që i mban marrëdhëniet mirë me të gjithë në klasën tonë. Ka aftësi lideri, dhe kjo vërtetohet nga posti i senatorit që ka mbajtur në klasë këtë vit të fundit. Faleminderit Alfred që je pjesë e klasës sonë, jam mirënjohëse që njoh dikë si ty. Të uroj shumë suksese! - Anda

Të flasësh për Fredin dhe mos të përmendësh gjenialitetin e tij në matematikë është e pamundur. Të vlerësoj shumë për karakterin e fortë që ke shfaqur kudo dhe kurdo. E di që me pakëz punë dhe karakterin që ti ke, do të arrish majat. Të uroj shumë suksese në rrugëtimin tënd! - Merisa

Do të të kujtoj si matematicientin e klasës. Edhe pse kemi kaluar vetëm 1 vit së bashku, kemi patur shumë momente të bukura. S'do të harroj kurrë kur në orën e mësimit shkruanim me letra duke u marrë me thashetheme. - Gledis

Alfred, aftësitë e tua të jashtëzakonshme në matematikë kanë qenë objekt admirimi për klasën tonë. Ndonëse ti erdhe në klasën tonë në vitin e fundit, talenti yt mbresëlënës nuk ka kaluar pa u vënë re. Udhëtimi yt matematikor është gjëgjëza e pazgjidhur e klasës sonë dhe ne mezi presim të shohim zgjidhjet që do të sjellësh në botë. - Vivien

Për Alfredin, magjistarin e matematikës. Talenti yt për shifrat na ka bërë përshtypje të gjithëve. Ti ke qenë një burim frymëzimi për të gjithë ata që s'i kanë punët mirë me ekuacionet dhe formulat. Dashuria jote për matematikën është vërtet e admirueshme. Vazhdo të llogaritësh rrugën tënde drejt suksesit! -Daria

Alfred, ja një ekuacion i thjeshtë: Suksesi = Pasion + (Punë e palodhur \times aftësi të shkëlqyera matematikore)². Uroj që variablat e ndryshme në jetën tënde të çojnë gjithmonë në konstanten e suksesit! - Emilja Zeneli
Aftësia jote në matematikë është vetëm një nga dhuntitë e tua. Të pret një e ardhme e ndritur, e ndriçuar nga intelektin dhe vendosmëria jote. Uroj që aftësia dhe përkushtimi yt të të çojnë drejt suksesit. - Alisa Imeraj



Barjena Sulollari

Barjena, Eni, apo Borjena? S'ka shumë rëndësi, sepse kuptohet për kë po flas ahahah. Barjena, je një vajzë shumë sociale dhe shakatë e tua të shoqëruara me sarkazëm na zbukurojnë ditën. Këshillat e tua dhe inteligjenca emocionale që ke të bëjnë një shoqe shumë të mirë. Do të të mbaj mend prej bisedave që kemi bërë orën e fiskulturës, nëpër cepat e kalçetos, ku gjithnjë ke pasur një histori për të thënë. Karakteri yt është unik dhe është e vështirë të gjesh dikë tjetër si ty; me të njëjtin vetëbesim e të njëjtin bukuri <3. Do më marrë malli për ty. - Anda Kola


Barjena... s'di nga t'i filloj. Ti ke qenë shoqja më e mirë që kam takuar në gjimnaz. Gjithçka filloi me mua duke kërkuar një nder dhe tani ne mund të diskutojmë dhe mbështesim njëra-tjetrën për çdo gjë. Shkolla nuk do të më shtyhej pa ty, që nga muhabetet serioze deri tek shakatë tona të vdekura. Ti je personi më i besueshëm, i lezetshëm dhe le të themi më e bukura në klasën tonë. Ja se e teprava pak me komplimentet. Por që të të them unë gjithmonë jam kënaqur kur kam dalë me ty që gjithmonë përfundonim duke ngrënë bukë me qofte hahahahah. Por që të të them shpresoj që të jemi shoqe për një kohë të gjatë. Të kam shumë xhan, balena vogel <33 - Kejsi

Barjen, dua ta nis duke të të thënë se je një person shumë i rëndësishëm për mua. Nuk mund ta kujtoj se si u bëmë shoqe, por për mua rëndësi ka fakti se tashmë jemi të pandara. Çdo ditë që kaloj me ty, inspirohem për të qenë një vajzë më e pavarur dhe e fortë. Je qaq e ëmbël dhe e dashur, po aq sa racionale dhe inteligjente. Më pëlqen mënyra se si i mendon gjërat me qetësi dhe mundohesh të gjesh zgjidhjen më të mirë. Kreativiteti yt do më lërë gjithmonë pa fjalë. Do jem gjithmonë falënderuese ndaj teje për faktin se

më ke qëndruar gjithmonë afër, më ke ndihmuar me çdo gjë. Bisedat tona të gjata më bindin se do të ishim psikologe shumë të suksesshme. Je një ndër personat më të bukur që njoh si jashtë dhe brenda. Të këshilloj të mos ndryshosh kurrë sepse je perfekte dhe uroj të arrish majat ashtu si e meriton. Të kam shumë xhan, tuç! - Ema

Është e vështirë të përmbledhësh tri vite shoqëri në vetëm disa fjalë, pasi kujtimet kanë kaluar milionat. Në bisedën tonë të parë kuptova se sa e veçantë dhe inteligjente je. Aftësia jote për të përdorur ironinë me aq finesë është diçka që më ka bërë gjithmonë për vete. Edhe pse nuk ishim kurrë në një klasë, i kemi shfrytëzuar pushimet 5-minutëshe në maksimum duke ndarë të qeshura pafund. Akoma më habit aftësia që kemi për të kuptuar njëra-tjetrën vetëm me një shikim. Tani që po ndjekim rrugë të ndryshme për studimet tona, nuk do të thotë që do të ndahemi. Kam dëgjuar fjalë të mira për Mynihun, por e di që do të bëhet edhe më i bukur me praninë tënde atje. Gjithsesi, që ta dish unë i kam gati valixhet për një vizitë. E kam vlerësuar gjithnjë vërtetësinë tënde dhe dua të të them se sa shumë besoj tek ti. E di që çfarëdo që të ndodhë, ti do të shkëlqesh në atë që bën. Për ta mbyllur, besoj që më kuptove. - Klenisa

Më kujtohet shumë mirë dita e parë që të pashë tek përsëritja, por nuk e mendoja që ti do ishe një nga kujtimet më të bukura të miat gjatë periudhës së gjimnazit. Ke qenë arsyeja pse unë u paraqisja në ambientet shkollore, gjithmonë arrite të më rregulloje ditën me një shaka tënden. Fjalët nuk arrijnë dot të përshkruajnë se sa e zgjuar, e bukur dhe e talentuar je për sytë e mi. Ndihehem shumë me fat që të kam njohur që në fillim të gjimnazit dhe kemi arritur të krijojmë kujtime të paharrueshme. Çdo herë që do i rikthehem gjimnazit në kujtimet e mia, ti do të jesh e para në çdo kujtim. Diçka që nuk do harroj kurrë nga ti është humori yt... dhe fakti që nuk e bëje kurrë një javë të plotë në shkollë. Faleminderit që ke qëndruar pranë meje gjatë këtyre tre viteve, prezenca jote ka bërë çdo moment ose emocion më të mirë. Të falenderoj nga zemra për çdo gjë dhe teksa të tjerëve rrugët e tyre po u vjen fundi, ne do kalojmë një eksperiencë të re sërisht së bashku. <33 - Bukrijela



Daria Sinani

Daria, ti je sinonimi i fjalës rregullsi. Je një vajzë sistematike, me një shkrim kaligrafik kaq të bukur, që mirësjellja dhe dashuria nuk të mungojnë. Për herë të parë mbaj mend që jemi ulur afër në orën e historisë teksa mësuese Haxhirja shpjegonte. Ishe shumë e zellshme dhe e artikuluar. Që në momentin e parë, kam menduar se je shumë e zgjuar, por sukcesi yt sot është fryt i durimit dhe punës tënde të palodhur. Nuk besoj se do kem mundësinë të njoh vajzë më të pastër, të rregullt, të komunikueshme dhe të kuruar se ty. Jam tepër i lumtur që shumë eksperienca i kemi ndarë së bashku. Të uroj shumë sukses dhe jam i sigurt që puna jote do shpërblehet. -Nga Albion Qojle

Ti je shpirti i shoqërisë. Gjithmonë diskuton me të gjithë shokët dhe shoqet e klasës. Je e dashur dhe prezenca jote i bën njerëzit të ndjehen të kuptuar. Sjellja jote e ngrohtë dhe miqësore krijon një atmosferë ku konfliktet janë të rralla. Je gjithmonë e gatshme të ndihmosh ata që kanë nevojë, duke shfaqur një zemër plot dhembshuri dhe një gatishmëri për të qenë një shoqe e mirë. Jam shumë e lumtur që në këto tre vite kam pasur një mikeshë si ty, e cila më ka bërë të qesh, më ka këshilluar dhe qëndruar afër në momente të mira, por edhe të vështira. -Nga Alisa Imeraj

Daria, nuk mund të flasësh me ty dhe të mos vësh re personalitetin tënd të ngrohtë dhe optimist. Ti ke një zemër të madhe që shkëlqen në çdo anë. Buzëqeshja jote dhe aftësia për të ndriçuar dhomën, të bëjnë një person shumë të dëshiruar për të të pasur pranë. Ti je tipi i personit që lë një ndikim pozitiv te të gjithë ata që takon, edhe nëse kryqëzon rrugët vetëm një herë. -Nga Barjena Sulollari

Kush tjetër mund të organizojë më mirë, jo vetëm

jetën e saj, por edhe veprimtaritë e ndryshme shkollore dhe shoqërore!? Rregullsia duket kaq e thjeshtë dhe e natyrshme tek ti dhe për këtë na duhet vetëm të shohim shënimet e tua që duken më mirë se librat e botuar. Përsosmëria do të ishte fjala që të përshtatet më mirë nga fjalori i gjuhës shqipe, pasi është rezultati i gjithçkaje që bën, të cilës i ke kushtuar vëmendjen dhe mundin e duhur. - Emilja Zeneli

Si një doktoreshë e ardhshme, përmbush çdo lloj kriteri. Ke një konfidencë që gjithmonë të ka ndriçuar rrugën dhe besoj do vazhdojë dhe më tej. Zgjuarsia dhe inteligjenca jote gjithmonë ka qenë impresionuese. Nga ti, mund të them me plot gojë, që mësova sesi të përballoj sfidat me një kombinim të logjikës dhe kreativitetit, duke e bërë të pamundurën të duket e arritshme. Shumë faleminderit që ke qenë gjithmonë e pranishme dhe e gatshme për të ndihmuar! Kudo të ikësh, të uroj sa më shumë suksese dhe jam e sigurt që do vazhdosh të shkëlqesh. -Klesta Ademaj

Daria, do të më mungojë rrezatimi yt i mbushur me energji pozitive, i cili niste që në mëngjes dhe nuk shteronte deri në fund të ditës. Faleminderit që ke qenë gjithmonë gati për të më ndihmuar. Të uroj suksese nga thellësia e zemrës sime! - Deivid Koçi

Dariaaaa, rruga jote drejt mjekësisë është një simfoni dhembshurie dhe kurioziteti, ku çdo notë çon drejt një të ardhmeje më të ndritshme. Përkushtimi yt i palodhur për të kuptuar trupin e njeriut, pasioni për shërimin dhe kërkimi yt për njohuri, të kanë kthyer në një forcë të jashtëzakonshme në klasën tonë. Ti je vizionare e klasës, e gatshme të kompozosh një kryevepër në botën e mjekësisë. Daria, udhëtimi yt në mjekësi është një vepër arti me potencial dhe ne mezi presim të shohim ngjyrat e gjalla që do të sjellësh në botë... - Vivien Kushi

E kam njohur Darian që ditën e parë të shkollës dhe më është dukur si vajza më e mirë dhe e sjellshme në klasën tonë. Është një vajzë shembullore, gjithmonë me nota të mira, gjithmonë pozitive dhe gati për të ndihmuar klasën, shkon mirë me të gjithë anëtarët e klasës. Jam krenare që kam një shoqe si ajo... Të uroj të gjitha të mirat dhe suksese në jetë! - Gledisja Këmbaci

Je vajzë shumë e zgjuar dhe pozitive. Shpresoj që t'i arrish të gjitha gjërat që dëshiron, sepse i meriton! Suksese Daria! - Parid Çela



Deivid Koçi

Je një nga djemtë që padyshim nuk do e harroj kurrë për humorin esencial që i ka dhuruar klasës. Momentet gazmore me ty janë të pafundme. Mendoj se të gjithëve u duhet një Deivid në klasë për ta bërë orën e mësimit më pak të lodhshme e monotone. Të gjithëve na ke lënë gojëhapur me aftësitë e tua kompjuterike. Suksese në rrugën e programimit! - Albioni

Për Deividin, një djalë të komunikueshëm dhe unik, i cili gjithnjë ka pasur ndonjë gjë për të komentuar. Deivid, je mjaft punëtor dhe i përkushtuar pas gjërave që të kapin vëmendjen, gjë që të bën mjaft interesant. Ke logjikë të ftohtë e të saktë, të cilën e vlerësoj shumë. Mendoj që do të arrish shumë në jetë, prandaj të uroj suksese. - Anda

Për Deivin, djalin me humor pikant e sarkazëm të spikatur. Gjithmonë je ai që na kthen me këmbë në tokë me komentet e tua që s'mungojnë në çdo situatë. Shpeshherë na dhuron shumë të qeshura me batutat e tua që godasin aty ku duhet. Nën petkun e një djali harrakat, të egër e aspak serioz, fshihet një djalë punëtor, duartartë, i sjellshëm, inteligjent e mjaft i pjekur, që ka njohuri për çdo fushë. Të uroj suksese kudo, hakeri më i zoti në gjithë Librazhdin! - Daria Sinani

Je një djalë i zgjuar dhe shumë i respektueshëm. Ke qenë gjithmonë plot energji edhe pse vije ditë për ditë nga Librazhdi. Shpresoj të arrish gjërat që do dhe suksese Deivo! - Paridi

Si çdo person që kishte kontributin e vet në klasë edhe ti kishe humorin e pazëvendësueshëm. Sado e vështirë për t'u pranuar, klasa s'do ishte njësoj pa ty. Në fillim të vitit, kur ishe në klasë tjetër mungesa jote la një boshllëk të dukshëm që ishte e pamundur të injorohej.

Por nuk zgjati shumë, pasi u ktheve sa hap e mbyll sytë. Ke një karakter të veçantë dhe një inteligjencë që nuk vlerësohet mjaftueshëm, gjë që të bënë të veçantë për atë që je. Të uroj shumë suksese dhe gjithë të mirat koleg i ardhshëm. - Klesta

Deivid Koçi, a ka rëndësi mungesa e mbylljes së një kllape në një hap të ekuacionit matematikor edhe nëse kjo nuk e ka ndikuar rezultatin? "Sigurisht që po, është një gabim, por 'gabim i vogël' dhe duhet vënë gjithsesi në dukje." Je një person që ka gjithmonë një koment për gjithçka, por kjo tregon gjithashtu aftësinë tënde të mprehtë për të kuptuar mirë rrethanat dhe kontekstin, për të vërejtur shpejt detajet dhe për të nxjerrë nga e gjitha përfundime. Përfundimet e tua gjithashtu nuk fshehin asgjë, ato janë aq transparente sa vetë e vërteta objektive. Fjalët janë arma jote më e fortë dhe duket se nuk të mbarojnë kurrë municionet. Nga jeta reale e praktike e di që mund të rendisë shumë më tepër shembuj se unë dhe t'i shpjegosh me imtësi. Vazhdo të përqëndrohesh në atë që bën më mirë: të jesh praktik dhe detajist. - Emilja

Qasja jote unike ndaj gjërave shpesh solli të qeshura dhe spontanitet në ditët tona dhe ne kemi arritur të vlerësojmë argëtimin dhe gëzimin që na ke dhënë përgjatë gjimnazit. Vendosmëria dhe humori yt i spikatur gjithnjë shoqërohej me të qeshura të papritura. Prezenca jote në klasë është një element kryesor, sepse në dy javët e para të vitit të tretë, kur të kishin ndryshuar klasën ndihej një boshllëk i pamohueshëm. - Vivieni

Gjeniu me ide inovative, librazhdioti më me humor dhe në të njëjtën kohë më i qetë që kam njohur. Të vlerësoj shumë për urtësinë tënde dhe për mënyrën si e tregon pjekurinë tënde. E di se me pakëz punë mund të arrish gjithçka do. Të uroj sukses në çdo hap të jetës tënde! - Merisa

Çun shumë i mirë dhe me fat që ndanim shoqërinë bashkë. Vazhdo ec përpara! Me humorin tënd të këndshëm dhe dashurinë për të ndihmuar të tjerët, ti je një prezencë e denjë në jetën tonë shkollore. Do të të mbaj mend si njeriun që fliste më shumë dhe si nxënësin që gjithmonë kishte një arsye për t'u kapur me të tjerët. Suksese! - Gledis

Bashkë jemi kuptuar gjithmonë duke filluar që nga ironitë e shumta dhe për këtë nuk çuditem. Kemi kaluar momente mes gallatave dhe temave serioze. Je një shok i shkëlqyer, të uroj shumë fat dhe sukses! - Fiona



Emilja Zeneli

Mendoj se nuk do të ishte e drejtë të të quaja thjesht një shoqe. Ti je shumë më shumë se kaq. Je një person shumë i dashur për mua. Miqësia jonë 12-vjeçare është një dëshmi e saj. Megjithëse në shumë aspekte, ide apo pikëpamje kemi mendime të kundërta, ne i vlerësojmë dallimet tona, të cilat vetëm na afrojnë. Disa cilësi si racionaliteti dhe besueshmëria jote, i admiroj thellësisht. Je një mikeshë që më ka dhënë një mbështetje të palëkundur në çdo hap. Udhëtimi ynë së bashku është i paharrueshëm. Nëse do të më pyesnin se çfarë dua të ndryshoj tek ti, përgjigja ime do të ishte: asgjë. Nëse do të ndryshoja diçka, ti nuk do të ishe kjo që je. Originaliteti dhe cilësitë e tua janë ato që të bëjnë shoqen e mrekullueshme që unë njoh dhe dua. - Alisa Imeraj

Rrugëtimi im trevjeçar nuk do të kishte kuptim pa ty. Gjithçka ka nisur në vit të parë, kur ti ishe një nga personat e parë me të ciltët kam folur. Në fillim më dukesh shumë misterioze, të rrethonte një energji të cilën doja me patjetër ta zbuloja. Shpeshherë të shikoja tek uleshe vetëm dhe lexoje libra. Kjo gjë më habiste, nuk të interesonte për të tjerët dhe zhyteshe në botën e fantazisë. Do të ishte vendosja ime një bankë para teje ajo që do të niste një shoqëri shumë të vyer për mua. Mund ta them me plot gojë që je një nga personat më inteligjentë që unë njoh. Ke njohuri në çdo fushë e kjo gjë gjithmonë më ka mahnitur. Je një person i veçantë e ndryshe nga të tjerët edhe për faktin e bisedave cilësore që bën. Nuk do t'i harroj kurrë debatet filozofike (si liria frymëzuar nga AOT) nga të cilat kam mësuar shumë. Sa herë kam pasur ndonjë pyetje gjithmonë jam drejtuar tek ti, pasi e dija që do të gjeja përgjigje. Nuk mund ta imagjinoj ekzistencën e gjimnazit pa emrin Emilja. Mund të them se nga shoqëria jonë kam fituar shumë. Je një

nga njerëzit që duhen marrë shembull. Në shumë aspekte të admiroj dhe jam tej mase falënderues që shumë eksperiencë i kemi ndarë bashkë, duke filluar nga konkurset, olimpiadat, daljet etj. E di që nuk i ke qejf fjalët e tepërta, por të uroj pafund sukses në rrugën e mjekësisë. Lum ata që do të bien në dorën tënde për t'u shëruar. - Albion Qojle

Emilja, më vjen mirë që njoh dikë kaq të veçantë sa ti. Bisedat tona gjithnjë kanë pasur nota humorit, diçka që nuk e prisja prej teje kur të njoha në fillim. Mes cilësive të tjera, të karakterizon urtësia, një nga cilësitë më të rralla e të veçanta që zotëron. Jam e bindur që do të arrish majat, prandaj të uroj shumë sukses. - Anda Kola

Nihilistja më e zgjuar që njoh! Nuk do të kishte kuptim gjimnazi pa humorin tënd të zi dhe kritikave mbi veprat e ndryshme letrare. Do më duket e çuditshme të mos të të shoh në bankën tënde të zakonshme duke mësuar gjermanisht ose duke u shpjeguar të tjerëve biologjinë. Të paharrueshme do të mbeten edhe ironitë e sarkazmat që bënim gjatë orëve të fiskulturës ose darkave të sushit. Zgjuarsia, shpirtmirësia dhe humorit yt i kanë bërë këto vite akoma më të bukura dhe të veçanta. Jam e sigurtë që çdo dëshirë që ke do ta arrish përmes punës dhe përkushtimit tënd. Uroj të të realizohet çdo gjë që dëshiron! P.s.: Uroj që në universitet të rregullojmë orarin e gjumit! - Esiana Këlliçi

Për Emiljan, një nga vajzat më të zgjuara që kam njohur dhe një nga shoqet e mia më të mira. Udhëtimi ynë përgjatë gjimnazit ka qenë koha ku së bashku jemi mbushur me dije dhe kemi shtyrë njëra-tjetrën drejt arritjeve. Edhe pse nuk je fanse e zjarrtë e përqafimeve dhe puthjeve, gjithmonë ma ke treguar ngrohtësinë tënde, ashtu siç di ti vetë duke e bërë miqësinë tonë një thesar të çmuar. Faleminderit që gjithmonë ke qenë këtu për mua! Do të vazhdoj të të admiroj për zgjuarsinë, inteligjencën dhe urtësinë tënde. Je e mrekullueshme! Me respekt dhe dashuri, Daria Sinani Ende më kujtohet kur të takova për herë të parë, ishte viti i parë, në orën e fizikulturës teksa po lexoje një libër. Më bëri shumë përshtypje se sa e qetë, sa e urtë dukesh. Rrezatoje një ndjesi paqeje, sikur e tërë bota ndalonte në një pikë dhe ngeleshe vetëm ti, libri, dhe çdo gjë heshtte. Dhe këtë aurë bardhësie të pruarur ke rrezatuar përgjatë të tria viteve të gjimnazit. Diskutimet tona të lirshme gjithnjë do t'i kujtoj me përzemërsi. - Vivien Kushi



Fiona Shehu

Personaliteti i fortë të bënë një shoqe të sigurt dhe komunikuese. Ti e di se çfarë dëshiron dhe nuk ke frikë të ndjekësh ëndrrat e tua. Besueshmëria dhe përkushtimi yt janë cilësi që ne të gjithë i admirojmë, pasi ato të bëjnë ty dikë tek i cili mund të mbështetemi gjithmonë. - Alisa Imeraj

Je një vajzë e ftohtë me një karakter misterioz në pamje të parë, por në fakt je shumë miqësore dhe e dashur. Më pëlqejnë shumë rastet kur thua që të kap 5-minutëshi, janë raste që mezi i pres pasi shkrihem së qeshuri. Të uroj shumë sukses, pasi e meriton. - Albion Qojle

Fiona jep përshtypjen e një personi të ftohtë e të paafreshëm, por kur flet më tërësisht është komplet kundërta. Prezenca jote i jep atmosferë të hareshme klasës sonë. Je person shumë i këndshëm dhe jam e gëzuar që të njoh e që të kam shoqe. Të vlerësoj shumë e të uroj shumë sukses në çdo hap të jetës tënde <3 - Anda Kola

Fiona, pavarësisht se nuk kemi shumë momente së bashku, mendoj se je një tip shumë pozitiv, optimist dhe ambicioz. Dukesh e ftohtë në pamje të parë, por je shumë më e çiltër kur të njeh nga afër. - Barjena

Për Fionën, shoqen time të guximshme. Nuk ke frikë të thuash atë që mendon, dhe kjo është një cilësi e rrallë sot. Gjithmonë ke qenë ballëllartë dhe syapatrembur. Faleminderit për të gjitha shakatë dhe të qeshurat që më ke falur gjatë orëve të mësimi, shoqja ime e bankës! Me dashuri, Daria Sinani

Një vajzë e qetë, por shumë serioze, do të jesh gjithmonë pjesë e kujtimeve që do të më mbeten nga klasa jonë. Të uroj shumë sukses! - Deivid Koçi

Vajzë pozitive dhe energjike, është një shoqe që më përshtatet në karakter. Nuk ka frikë të thotë atë që ka në mendje dhe kjo është një nga gjërat kryesore që më pëlqen tek ajo. Edhe pse shpeshherë i bërtas pak për ca gjëra se s'ha shqip, përsëri ngelet një nga shoqet e mia më të mira. Të uroj vetëm suksese në jetë <3 - Gledisjaaa Këmbaci

Fiona, edhe pse kur hyre për herë të parë në klasën tonë, dukesh shumë intimiduese. Në të vërtetë je një vajzë e bukur, ambicioze dhe shpresoj që të gjitha ëndrrat e tua të realizohen. - Kejsi Kotica

Për Fionën, autenticiteti dhe natyra e vërtetë e të cilës e kanë bërë përvojën tonë të shkollës së mesme vërtetë të paharrueshme. Ndërsa hyn në fazën tjetër të jetës tënde, shpresoj që të arrish të plotësosh dëshirat dhe ëndrrat e tua. - Vivien Kushi

Shoqeeee, s'di nga t'ja filloj me ty sepse më duket sikur do të flas për veten time. Edhe pse kemi pak kohë që njihemi, më duket sikur të njoh prej vitesh. Je shumë pozitive dhe më bën gjatë gjithë kohës të qesh. Momentet që kemi kaluar bashkë janë më të çmuarat, ashtu siç je dhe ti për mua. Uroj që të gjitha ëndrrat e tua të bëhen realitet, shoqja ime e zemrës! Je e pazëvendësueshme. - Gledis

Fiona, fillimisht m'u duke si një vajzë shumë e ftohtë dhe jo miqësore, por ishte përshtypje e gabuar. Kam kuptuar që je një shoqe shumë e vlefshme për mua dhe jam shumë me fat që të njoha. Të uroj shumë sukses në jetë dhe asnjëherë mos ndrysho personalitetin e veçantë që ke. Me dashuri, Klesta Ademaj

Ona ime vogël, në fillim kur të njoha më je dukur si një vajzë serioze të cilës nuk do t'i pëlqenin shakatë e mia, por që kur filluam të rrinim bashkë gjatë orëve të kimisë kuptuam që kishim shumë kimi me njëra-tjetrën ;). Gjëja që adhuroj më shumë tek ti është ëmbëlsia dhe dashuria që mundohesh ta fshehësh gjithmonë. Të dua shumë dhe të uroj sa më shumë sukses! - Klejsa Neza

Fiona bukuroshja, shoqëria me ty ka qenë qershia mbi tortë këtë vit. Ndonëse në klasa të ndryshme, kemi kaluar mjaft momente sa për të krijuar kujtime që do i mbaj mend gjithmonë. Je shumë e dashur dhe tek ti gjej kombinimin perfekt të një vajze sa të fortë aq dhe të ndjeshme. Dua të të shoh gjithmonë të qeshur... - Juara



Franc Kalemaj

Natyrja jote e qetë dhe bashkëpunuese është një vlerë e shtuar në komunitetin e shkollës tonë. E qeshura jote është ngjithëse dhe krijon një frymë pozitive në klasë. E vlerësoj tek ti dëshirën për të punuar së bashku dhe për të nxitur unitetin në klasë. Uroj t'i ruash gjithmonë këto vlera të cilat padyshim do të të hapin shumë dyer në jetë, dhe do të jenë faktor i rëndësishëm për suksesin tënd në të ardhmen. - Alisa Imeraj

Franc, je një nga miqtë e parë të gjimnazit. Për mua ke qenë një shok shumë besnik dhe i gatshëm për të më ndihmuar në çdo problem që kam pasur. Të vlerësoj shumë dhe do të doja që të mos ndryshosh karakterin tënd unik. Kemi kaluar shumë momente gazmore që do t'i kujtojmë për vite me radhë. Të uroj suksese në çfarëdo gjëje që do të bësh pas gjimnazit! - Arbi Bulica

Franc, je një djalë i urtë dhe i sjellshëm, me morale dhe virtyte të shumta. E qeshura jote karakteristike krijon një atmosferë shumë pozitive në klasë. Jam mirënjohëse që të kam njohur këto tri vite dhe të uroj shumë suksese kudo që të shkosh. - Anda Kola

Është një mik i vërtetë, gjithmonë i përkushtuar dhe i gatshëm për të ndihmuar në çdo situatë. Gjithmonë do t'i kujtoj muhabetet që ke sjellë në pushim të gjatë! Suksese në jetë! - Alfred Gabili

Për Francin, djalin që kurrë s'ndaloi së qeshuri. Do t'i kujtoj gjithmonë shakatë e tua që i bëje aq natyrshëm dhe të qeshurat e mëdha që elektrizonin gjithë klasën. Shprehja jote: "Daria, moj, Daria" më ka shoqëruar vazhdimisht gjatë këtyre viteve. Je një shok shumë i mirë që i jep energji pozitive kujt do dhe me një buzëqeshje në fytyrë e kalon çdo situatë stresante me lehtësinë më të madhe. - Daria Sinani

Franc, ti ke qenë një shok vërtet i mirë për këto tri vite e fundit dhe jam shumë mirënjohëse që të takova dhe u bëra shoqja jote. Je një djalë vërtet i mirë dhe e vlerësoj shumë që ke bërë shoqëri gjatë orëve të mërzitshme të fizikës. Më pëlqejnë bisedat tona, me të vërtet janë qesharake dhe kjo e bën shkollën shumë më interesante dhe më pak të mërzitshme. Të uroj suksese në jetë dhe të realizohen të gjitha ëndrrat e tua. - Kejsi Kotica

Humori karakteristik dhe niveli i inteligjencës janë tepër të veçanta tek ti. Person i veçantë pasi shkon gjithmonë kundër rrymës. Të uroj vetëm të mira dhe suksese! - Merisa Dumani

Qetësia jote më ka bërë gjithnjë përshtypje. Nuk mbaj mend ndonjë situatë në të cilën të kam parë vërtet të shqetësuar për diçka, përkundrazi, në shumicën e rasteve të kam parë gjithmonë duke buzëqeshur dhe ndoshta edhe duke u përpjekur ta frenosh të qeshurën, e cila pasqyrohej qartë nga fytyra e bërë flakë e kuqe. Në fillim mendova se ishe thjesht një person pasiv, por më pas mësova se sa shpejt dhe sa lehtë mund të rimarrësh kontrollin e situatave dhe të arrish rezultatet që dëshiron me fare pak mundim. Gjithmonë ia del mbanë, në një mënyrë apo një tjetër. Shpresoj që epiteti "i stresuar" të mos jetë kurrë i përshtatshëm për ty. - Emilja Zeneli

Djalë i urtë edhe i respektueshëm. Kemi kaluar bukur këto tri vite. Të uroj suksese dhe kalofsh sa më mirë Franco! - Parid Çela

Franc, je një shok shumë i mirë, më bën shpeshherë të qesh pasi ke një karakter shumë pozitiv, megjithëse shumicën e kohës je në gjumë. Përseri kam shumë kujtime të bukura me ty. - Barjena Sulollari



Gledi Zaimi

Për Gledin, djalin e qetë dhe gazmor të klasës sonë. Të uroj vetëm suksese dhe gëzime në rrugëtimin tënd. Shpresoj t'i arrish të gjitha qëllimet që ke në jetë. - Daria Sinani

Çun i qetë që gjithmonë sheh punën e vet. Faleminderit që ke qenë gjithmonë aty për ne dhe për të ndarë kujtime të paharrueshme. Të uroj vetëm të mira dhe sukses në të gjitha sfidat e tua të ardhshme. Je një shok i vërtetë dhe do të mbetesh gjithmonë në zemrën time. - Gledis Ruçi

Djalë i qetë dhe i sjellshëm. Shumë pozitiv. Të uroj fat dhe shumë suksese! - Fiona Shehu

Je një djalë shumë pozitiv, i zgjuar dhe ke humor të veçantë. Do të doja të ishim njohur më parë me njëri-tjetrin pasi ia kaloj shumë mirë me ty. Kemi shumë momente së bashku dhe do të doja që shoqëria jonë të vazhdojë. Të uroj sukses në çdo gjë që të pret në jetë!
- Arbi Bulica

Gledi, ke qenë dhe je një shok shumë i mirë dhe ndihmues. Janë bërë disa vite që njihemi bashkë dhe asnjëherë nuk ka pasur një moment ku nuk kemi qeshur. Të uroj suksese në të ardhmen! - Alfred Gabili

Gledi, edhe pse të kam njohur këtë vit, për mua je një mik i mirë. Gjithmonë ke qenë aty për mua kur kam pasur nevojë për ty dhe të kujtoj gjithmonë me një buzëqeshje në fytyrë. Ke batuta interesante dhe i ke shtuar harmoni klasës. Shpresoj të ngelemi shokë edhe pas gjimnazit! - Barjena Sulollari

Djali më i mirë që kam njohur me zemër të bardhë e që nuk di të bëjë keq. Ia ke dalë mbanë gjithmonë t'i dhurosh një buzëqeshje të gjithëve që ke përreth. Të uroj suksese! - Deivid Koçi

Gledi, edhe pse je i ri në klasën tonë, dhe u mërzita vetëm me ty për disa muaj, ke qenë mik i mirë dhe e vlerësoj shumë ndihmën tënde gjatë orëve të matematikës. Ke një humor interesant dhe më pëlqen shumë atmosfera që i jep klasës sonë. Të uroj gjithë të mirat për ty dhe të realizohen të gjitha ëndrrat e tua.
- Kejsi Kotica

Djalë flori dhe gjithmonë të gjendesh pranë. Kemi kaluar shumë bukur bashkë dhe humoret kanë qenë pa fund. Të uroj më të mirat, Gledi, dhe suksese në jetë! - Parid Çela



Gledis Ruçi

Shoqe që nuk besoja se do e gjeja ndonjëherë në Turgut. Më shton jetën me çdo shaka që ne të dya bëjmë. Kemi aq shumë të përbashkëta sa mund të themi që e marrim jetën shumë piano-piano dhe kemi ëndrra të njëjta. Jam shumë e lumtur që të njoha dhe po kaloj këto momente të gjimnazit me ty, por udhëtimi ynë tani ka nisur. Qëndro kështu siç je, pasi je më e mira. Jam me fat që të kam mike zemre dhe që ma bën çdo ditë edhe më të bukur. Je si shpirt shoqeeeee. Suksese në çdo hap dhe vetëm të mira paç në jetë! - Fiona Shehu

Je një person që dallohet për humorin, qetësinë dhe në shumë momente për pjekurinë tënde. Të vlerësoj shumë për karakterin që ke dhe besoj se edhe të tjerët të njohin për Gledisin e vërtetë, atë vajzën shpirtmirë dhe të dashur. Të uroj vetëm të mira dhe suksese! - Merisa Dumani

Ka qenë kënaqësi të të kem ty si shoqe klase, dhe jam veçanërisht mirënjohëse për çokollatat e tua të përditshme - padyshim që ndihmuan në ëmbëlsimin e vitit shkollor së bashku me energjinë tënde pozitive. Të uroj shumë suksese në jetë dhe shpresoj të të shoh sa më lart! - Klesta Ademaj

Vajzë shumë e mirë, edhe pse shpesh herë na ngatërrojnë emrat dhe na duhet t'i shpjegojmë ndryshimet midis emrave tanë. Përsëri mbetet një gocë shumë e mirë dhe e respektueshme. Të uroj të gjitha të mirat dhe suksese! - Gledisja Këmbaci

Ti je një nga vajzat më të mira që kam njohur në gjimnaz. Faleminderit që ke qenë pjesë e shoqërisë sime dhe do t'i mbaj mend gjithmonë kujtimet e bukura që kemi bashkë. Të uroj suksese! - Deivid Koçi

Për Gledisin, një shoqe të shkëlqyer. Të falenderoj që e ke bërë rrugëtimin tim më argëtues dhe të pasur me momente të këndshme. I vlerësoj shumë bisedat tona dhe shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë edhe përtej bankave të kësaj shkolle. Me dashuri, Daria Sinani

Gledis, ti do mbahesh mend gjatë për "Jë"-në tënde të famshme dhe për mënyrën e të shprehurit të dashurisë. Parimi yt është dashuri me dhunë dhe pickime, dhe fjalët "Ah ti ti...". Faleminderit që ke qenë pjesë e rrugëtimin tim dhe të jam mirënjohës për kujtimet e krijuara. - Albion Qojle

Je një vajzë e dashur, e gjallë me dëshirë për jetën. Uroj që ky entuziazëm të jetë me ty përgjithmonë! - Alisa Imeraj

Gledis, më ke lënë gjithnjë përshtypjen se je një vajzë e qetë dhe disi serioze, por bisedat me ty më kanë bërë të shoh anët më argëtuese të tuat. Ja kemi kaluar bukur dhe më ke lënë një impakt mjaft pozitiv. - Barjena Sulollari

Je një shoqe shumë e mirë. Të uroj më të mirat dhe suksese kudo! - Parid Çela

Tamam jemi njohur këtë vit dhe mund të them se më ke dhënë përshtypjen e një vajze interesante, që dëshiron të flasë me këdo dhe për çdo gjë. Me këtë sjellje, ke krijuar situata, të qeshura dhe ke qenë një pjesë e rëndësishme e klasës. Të uroj fat dhe sukses. - Rei Escobar Durmishaj

Gledis, je gjithmonë një ndër personat e parë që urojnë në raste festash, që interesohen për ekskursione dhe aktivitete të tjera argëtuese që forcojnë ndjenjën e komunitetit. Asnjëherë nuk heziton të kërkosh ndihmë kur të nevojitet dhe me pak mbështetje mund të arrish shumë! - Emilja Zeneli



Gledisja Këmbaci

Je një vajzë e kujdesshme me një natyrë shumë të ngrohtë. Humori yt nuk dështon asnjëherë për të më bërë të buzëqesh. Ti rrezaton mirësi dhe ngrohtësi, duke të bërë një shoqe të dashur që gjithmonë lë një ndikim pozitiv tek personat rreth teje. E dashur Zeno, jam shumë e lumtur për gjithë të qeshurat që kemi ndarë së bashku këto vite. Jam e bindur që me personalitetin, vullnetin dhe gjithë cilësitë e tua do t'ia dalësh mbanë më së miri në çfarëdo rruge që të zgjedhësh. - Alisa Imeraj

Për Gledisjan, një nga shoqet më të mira që kam patur gjatë këtij rrugëtimi. Nga fillimi i gjimnazit e deri tani, shakatë tona ia kanë shtuar koloritin ditëve të shkollës. Pseudonimet që i kemi vënë njëra-tjetrës do t'i mbaj mend gjatë. Me çdo shaka të bukur që bëjmë, kuptoj se miqësia jonë shtohet çdo ditë e më shumë duke u ngritur mbi momente të këndshme e të paharrueshme. Faleminderit që ditët e shkollës m'i ke bërë më të lehta dhe shpresoj se do të vazhdojmë të kemi shaka më të shumta në të ardhmen. Me dashuri, Daria Sinani


Je një vajzë e mirë dhe e qetë. Do mbahemi mend si treshja e pandashme unë, ti dhe Fiona. Ndihem me fat që isha me ju! Të uroj shumë suksese. -Gledis Ruçi

Goca që sa herë e takoj më mbush plot me pozitivitet. Një shoqe shumë e mire, të mirëkupton dhe të jep këshilla, edhe pse ndonjëherë më qorton, por nejse. Mund të them që duhet një Gledisja në rrethin shoqëror. Të uroj vetëm suksese kudo në jetë! -Fiona Shehu

Ke qenë gjithmonë pranë meje, madje më shoqëroje edhe sa për të blerë një ujë, që të mos më dukej e mërzitshme. Je imituesja më e mirë e mimikave

të tredeve të Tik Tok-ut që kam parë ndonjëherë dhe gjithmonë di të bësh shakatë e duhura. Përveç menteve që na jepje çdo ditë, nuk do të harrojë kurrë edhe të gjitha momentet që kemi kaluar së bashku, pra të gjithë periudhën 3-vjeçare të gjimnazit (përveç mungesave shumëjavore për shkak të imunitetit tënd delikat). Shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë edhe pas gjimnazit, por mbi të gjitha: Vazhdo të jesh e njëjta Zeno! - Emilja Zeneli

Një nga gjërat që do të mbaj mend nga gjimnazi është se si nuk kemi kaluar asnjë ditë pa qeshur bashkë. Ke një zemër të madhe sa malet dhe këtë e tregon me çdokënd. Faleminderit për çdo moment dhe uroj të mos ndryshosh kurrë se je shumë e mirë kështu. - Juara



Ilir Ndoja

Ndojaaaa!! Edhe pse u bëre pjesë e klasës sonë në vitin e fundit, ti i dhe një frymë të re të qeshurash. Më kujtohet kur në vit të parë më dukesh një person intimidues, një këndvështrim, i cili u rrëzua poshtë shumë shpejt me shakatë e tua të përzemërta. Më duket shumë për të qeshur dhe fakti se si ne, dy persona tërësisht të ndryshëm, ndajmë po të njëjtën ditëlindje. Shpresoj që të jesh gjithnjë i lumtur dhe një shpirt i lirë, njësoj si të kam njohur në gjimnaz! – Vivien Kushi

Djalë pozitiv dhe shumë i thjeshtë. Edhe pse na u bashkove këtë vit, e ke gjetur veten shumë lehtë krahas nesh. T'u dhurosh njerëzve një të buzëqeshur çdo ditë është dhuntia jote, ndaj ruaje fort! Të uroj vetëm suksese në jetë. - Albion Qojle

Ilir Ndoja, je njeri pozitiv dhe ke qenë një shok shumë i mirë për mua. I solle klasës sonë shumë hare dhe momente gazmore. Të uroj suksese në çdo gjë që ke menduar të bësh! – Arbi Bulica

Ilir, edhe pse jemi bërë shokë këtë vit, mund të them që je një karakter i veçantë, plot ngjyra dhe shumë interesant. Ke një tip karizmatik dhe ke mbushur gjithnjë klasën me pozitivitet. – Barjena Sulollari

Për Ilirin, shokun që na kënaq me humorin e tij. Me çdo gallatë që ti bën, na dhuron të qeshura dhe na bën të kuptojmë se sa e rëndësishme është të kemi një dozë të mirë pozitiviteti çdo ditë. Faleminderit që me thjeshtësinë dhe humorin tënd mbush ditët tona me gëzim dhe kujtime të bukura. Me dashuri, Daria Sinani

Je një nga shokët më të mirë që kam. Ja kemi kaluar

shumë mirë këto vite dhe kemi krijuar shumë kujtime. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë dhe të krijojme akoma kujtime të bukura. Të uroj gjithë të mirat e kësaj bote dhe suksese kudo që të vesh! – Gledi Zaimi

Gjithmonë i qeshur dhe energjik, po e pe të mërzitur dije se nuk ka ngrënë çokollatë për sot. Ky na ngatërron emrat mua dhe Gledisit, pak rëndësi ka kjo. Është tip i sinqertë. Suksese! – Gledisja Këmbaci

Ilir, je vërtet djalë i mirë dhe në fakt je shumë miqësor. Në fillim kur të pashë për herë të parë, mendova se nuk do të bëheshim kurrë miq, por mendoj se gabova dhe përshtypja ime e parë ishte vërtet e gabuar. Je një djalë shumë miqësor dhe mund të përshtatesh kudo që je. Faleminderit që u bëre pjesë e këtij rrugëtimi. – Kejsi Kotica

Je shok shumë i mirë i imi edhe do të mbetesh. Je një djalë shumë energjik dhe me prezencë. Nuk do t'i harroj kurrë momentet që kemi kaluar dhe gallatat që kemi bërë bashkë. Të uroj më të mirat dhe suksese, vlla! - Paridi

Që në vitin e parë, më dhe përshtypjen e një çuni të veçantë dhe të mirë, dhe jam i kënaqur që të kam pasur gjatë gjithë gjimnazit në klasë, pasi gjithmonë ke qenë një pjesë e rëndësishme e klasës, duke krijuar situata të bukura e për të qeshur dhe duke qenë pozitiv. Shumë suksese dhe uroj që të jesh gjithmonë i lumtur. - Rei Escobar Durmishaj

Ky ka qenë viti i parë që të kisha në klasë. Na ke krijuar shumë atmosfera të bukura në klasë që do ngelen kujtim nga ky vit i fundit. Të uroj shumë suksese në jetë dhe bëfsh sa më shumë lekë. Me respekt, Klesta Ademaj

Njeri pozitiv dhe me një zemër shumë të madhe. Shok i sinqertë që çdokush do të dëshironte ta kishte në klasë. E lumtur që një pjesë të kujtimeve i ndamë bashkë. Suksese! – Gledis Ruçi

Gëzon shumë respekt nga unë. Një djalë shumë i sjellshëm, jo më kot e duan të gjithë. Ka lindur vetëm për qejf dhe me një tip unik. Personi që e mbush klasën plot hare. Duhej një tip si ty në klasë. Me fat që këtë vit ndamë të njëjtën klasë. Shumë pozitiv dhe që fal dashuri pa kushte tek të gjithë! Shumë suksese në jetë! - Fiona



Kejsi Kotica

Kejss, kemi 3 vite shoqëri dhe të falenderoj shumë për çdo moment që kemi kaluar së bashku, që nga orët më të gjata e të mërzitshme të mësimit, në të cilat gjithmonë gjeje ndonjë muhabet potent, deri te momentet që qeshnim me të madhe dhe pa ndonjë arsye specifike, dhe pastaj thonim: “S’ishte dhe aq për të qeshur.” Ti gjithnjë e ke kuptuar ironinë time dhe komunikimi ka qenë i nivelit që merreshim vesh edhe me shikime nga cepi në cep të klasës. Shpresoj të ngelemi shoqe edhe pas gjimnazit dhe të premtoj që s’të qeras më me bukë me qofte kur të dalim (kismet). Të kam shumë xhan <3 - Barjena Sulollari

Kejsi, megjithëse kam 8 vite që të njoh, këto 3 vite të gjimnazit jemi afruar më shumë se kurrë. Jam shumë mirënjohëse që të kam shoqe kaq të afërt, e që kemi kaluar kaq shumë gjëra së bashku. Je vajzë shumë e ëmbël, e dashur dhe e këndshme. Nga ana tjetër, je vajza më guximtare që do të njoh ndonjëherë. Faleminderit që më ke qëndruar pranë. Të kam shumë xhan dhe të uroj më të mirat e botës <3 - Anda Kola

Kejsin do ta përshkruaja si një nga njerëzit më energjik që njoh. Është njeri shumë empatik dhe nuk ta prish kurrë qejfin. Me të ndihem aq rehat sa ndonjëherë më duket sikur e njoh prej kohësh dhe jo vetëm prej 2 vitesh. Me këtë dedikim gjej rastin të falenderoj dhe shofer Fatmirin dhe këdo që është përgjegjës për fugonat që na la bashkë në të njëjtin fugon. Kejsi është nga ata njerëzit që do doja t’i kisha gjithmonë në shoqëri. Do më mungojnë ato makeup sessions në furgon, muzika, muhabeti etj. Të uroj shumë suksese dhe të përqafoj fort <3333333333 - Luisa Spahiu

Kejsi, ti ke përcjellë pozitivitetet gjatë gjithë gjimnazit, i cili pa ty do ishte shumë ndryshe. Je një vajzë e dashur,

e kujdesshme dhe e drejtpërdrejtë. Ke kërkesa ndaj vetes dhe këtë e vlerësoj. Jam mirënjohës për kohën që kalojmë bashkë dhe sigurinë që gjejmë te njëri-tjetri. Të uroj shumë suksese. - Noel Sulejmani

Për Kejsin, vajzën e guximshme të klasës sonë. Kurrë s’ke frikë ta thuash atë që mendon dhe me zgjuarsi, i jep përgjigjen e duhur çdo pyetjeje që të drejtohet. Të uroj suksese dhe shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat që ke. - Daria Sinani

Do të kujtoj gjithmonë lojërat tona të volejbollit në orën e fiskulturës, ku kemi luajtur gjithmonë me zell dhe pasion. Të uroj më të mirat! - Deivid Koçi

Je një gocë e zgjuar dhe e sjellshme. Faleminderit që më ke ndihmuar kur kam pasur nevojë. Të uroj suksese në shkollë dhe në jetë! - Gledi Zaimi

Kemi kaluar shumë bukur këto vite në klasë. Je një vajzë shumë e mirë dhe pozitive. Të uroj më të mirat dhe të arrish ato që dëshiron! Suksese! - Parid Çela

Më pëlqen shumë përkushtimi që tregon në lojën e volejbollit. Gjithmonë bën gjithçka që është e mundur për të fituar dhe luan me të njëjtën energji dhe përqendrim deri në momentin e fundit. Shpresoj që të mbash gjithmonë të njëjtin qëndrim edhe në çështjet e tjera të jetës! - Emilja Zeneli

Je një vajzë me karakter shumë të veçantë, e qetë dhe e heshtur, por në të njëjtën kohë shumë miqësore. Je një vajzë e fortë që nuk i dridhet qerpiku dhe që gjithmonë kërkon të drejtën e saj. Këtë vit kam pasur mundësinë të të njoh akoma edhe më shumë dhe kam kuptuar që je një vajzë me shumë humor. Dije se të vlerësoj shumë. Faleminderit që je pjesë e rrugëtimit tim. - Albion Qojle

Gjithmonë më je dukur një karakter interesant, me të cilin mund t’ia kalosh bukur, pasi ndikon atmosferën e bisedës në mënyrë pozitive. Je gjithashtu lojtarja më e mirë e basketbollit, me të cilën kam luajtur në shkollë dhe bashkë kemi pasur shumë biseda dhe shaka të bukura. Kujtoj grupin e verës së kaluar, që më duket duhet të jetë akoma diku te grupet dhe ku flitej çdo minutë. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj që të jesh gjithmonë e lumtur. - Rei Escobar Durmishaj



Klesta Ademaj

Klest ne nuk kemi shumë kohë që njihemi, por ka qenë e mjaftueshme për të të përshkruar ty si një goçë me karakter të fortë, e vendosur, por mbi të gjitha me një zemër të madhe, duke e bërë të lehtë për të të pasur xhan. Orët e gjeografisë nuk do të ishin të njëjta pa ty aty. S'kemi bërë gjë tjetër veçse muhabet, muhabet, muhabet (ok dhe pak mësim). Të uroj gjithë të mirat dhe shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë edhe pas gjimnazit. Suksese! - Adela Shahini

Klestaaa, një nga vajzat më stoike dhe të zgjuara që njoh. Punon fort për çdo gjë që dëshiron të realizosh dhe ke një dhunti të krijosh shoqëri me çdo njeri. Ne u njohëm rastësisht dhe në fillim nuk ishim shumë të afërta me njëra-tjetrën, por dy tipa energjikë si ne nuk mund të rrinin larg për shumë kohë. Shpresoj të të shoh gjithmonë të lumtur pranë njerëzve që ti dëshiron. Të përqafoj fort! - Klejsa Neza

Ti je një shoqe që na prezanton vazhdimisht me ide të reja dhe na nxit të përmirësohemi. Dashuria jote për librat i kapërcen faqet e librit, sepse pasioni për dijen është infektues për të gjithë rreth teje. Shkathtësia jote në fushën e IT-së është një dëshmi e përkushtimit tënd për botën teknologjike. Shpresoj të arrish çfarëdo që dëshiron. - Alisa Imeraj

Për vajzën kuksiane të grupit tonë. Kontakti ynë i parë ka qenë në një detyrë qytetarie ku më ke spikatur me pozitivitetin dhe ekspresivitetin tënd. Je një vajzë që gjithmonë e kam marrë shembull për angazhimin e lartë në aktivitete të ndryshme. Je shumë karizmatike dhe inteligjente, padyshim e lindur për të qenë një lidere. Faleminderit që i jep grupit tonë një prezencë të domosdoshme. Të uroj sukses kudo! - Albion Qojle

Klesta, je një shoqe shumë e mirë, totalisht e sjellshme me çdokënd. Ndiem shumë komode në praninë tënde, sikur mund të flas për çdo gjë. Shpresoj të plotësosh çdo dëshirë që ke në jetë. - Barjena

Për Klestan, shoqen e buzëqeshur dhe të mbushur me pozitivitet. Me buzëqeshjen dhe ngrohtësinë tënde bëhesh një burim drite dhe shkëlqimi në çdo moment. Së bashku kemi punuar në shumë projekte dhe kompeticione, prandaj e di që je një lidere e shkëlqyer, por edhe shumë bashkëpunuese. Faleminderit që sjell dritë në çdo moment. - Daria Sinani

Klesta - Një vajzë e qetë që gjithmonë sheh punën e saj. Të uroj gjithë të mirat dhe shpresoj të të realizohen të gjitha dëshirat! - Deivid Koçi

Që në fillim, kur u njohëm në vit të parë, ke qenë shoqja ime më e mirë dhe jam shumë mirënjohës për marrëdhënien tonë në këtë gjimnaz. Gjatë gjithë kohës, në çdo pushim, kemi qëndruar bashkë dhe kemi diskutuar, qeshur e luajtur. Je nga njerëzit më të mirë, të fortë dhe të dashur që kam njohur ndonjëherë dhe gjithmonë do të jesh një person shumë i afërt për mua, për të cilin do bëja çdo gjë. Gjithmonë do ta vlerësoj faktin që pata një lidhje kaq të ngushtë me një person kaq të vërtetë, të veçantë dhe me një të qeshur që mund të më bënte të harroja çdo gjë që më bënte të ndihesha keq. Nuk i imagjinoj dot gjimnazin dhe jetën jashtë shkollës këto vite pa ty. Uroj që kjo shoqëri të zgjasë përgjithmonë dhe të uroj gjithashtu shumë suksese dhe që të realizohet çdo dëshirë e ëndërr që do të kesh. - Rei Escobar Durmishaj

O Lewis Hamiltoni i Charles Leclercut tim! S'e mendoja që do të vinte kaq herët koha kur duhet të të shkruaja këtë dedikim. Ti je ajo e cila më ka dhuruar siguri dhe komfort përgjatë viteve të gjimnazit, përmes të qeshurave dhe lotëve të derdhura nëpër provime. Fjalët për ty, Klesta, më vërshojnë me aq shpejtësi në mendje sa që është tejet e vështirë që unë të kap ndonjëherë prej tyre; si ndonjë lumë yjesh, ku njëri shndrit më shumë se tjetri. Sa më shumë thellohet miqësia jonë, aq më shumë ndjej mirësinë, ngrohtësinë dhe paqen që ti rrezaton. - Vivien Kushi

Klesta, një nga gocat më të mira të shkollës. Vajza me të cilën mund të bësh muhabet pa pikën e problemit pasi të jep shumë rehati. Një shoqe shumë e mirë që gjithmonë do mbetet në mendjen time. Shumë shumë suksese, loqk! - Fiona Shehu



Merisa Dumani

Meri top sheqeri, një vajzë e ëmbël dhe fjalëpakë, e cila gjithmonë të gëzon me ngrohtësinë e saj, këtë mendoja në fillim. Je një vajzë shumë më komplekse se çdukesh, një mike e vërtetë me një inteligjencë emocionale të pabesueshme që të dallon nga çdo person në dhomë. Një qetësi dhe kujdes që shpesh kalohet si diçka normale, ndikoi shumë në shoqërinë tonë, e cila me kalimin e ditëve sa vjen e forcohet. Njoha Merin e vërtetë, e cila acarohet, mërzhitet dhe qesh pafund. Një vajzë e cila mban afër njerëzit e saj por gjithmonë sheh të mirën tek një person, sado e vogël të duket nga sytë e të tjerëve. Një nga surprizat më të bukura të këtij viti qe gjetja, do të thoja nga hiçi e një nga mikeshave dhe njerëzve më të mirë që njoh. Të të thoja suksese pas kësaj sikur nuk shkon, kështu që po të uroj një jetë me sa më pak vështirësi dhe sa më shumë lumturi, pasi je ndër të paktët që me të vërtetë e meritoni! - Enio Kazazi

Je një mike me shumë cilësi pozitive dhe virtyte. Natyra jote e kujdesshme dhe e dhembshur shtrihet te të gjithë ata që të rrethojnë. Ti je e shpejtë për të ofruar një dorë ndihmuese dhe je vazhdimisht mbështetëse, duke krijuar një atmosferë besimi dhe miqësie. Të uroj shumë sukses në rrugëtimin tënd! - Alisa Imeraj

Merisa, je një person i mbushur me emocione dhe me një botë të madhe. Je unike dhe shumë pozitive. Me ty ndihem sikur mund të them çdo gjë pa u gjykuar. Je fiks një psikologe që zgjidh të gjitha problemet. Këtë vit jemi afruar edhe më shumë dhe gjithmonë ke qenë si “mamaja” e grupit duke na organizuar e duke u kujdesur për ne. Edhe pse ke kaluar shumë, kjo nuk të ka bërë që të heqësh buzëqeshjen tënde. Tek ty shoh një vajzë jashtëzakonisht të fortë, të aftë për të përballuar gjithçka, por në të njëjtën kohë të brishtë

që ka nevojë të marrë shumë dashuri ashtu siç edhe jep. Faleminderit që je pjesë e rrugëtimit tim. - Albion Qojle


Merisa, je një bukuroshe që vetëm rrezaton mirësi dhe dashuri, prandaj të dua fort. Ke një buzëqeshje pozitive që do e mbaj në memorien time shumë gjatë. Je një shoqe shumë e mirë, e mbi të gjitha je një njeri i mirë. Të vlerësoj shumë dhe jam mirënjohëse që të njoh e që të kam shoqe. - Anda Kola

Natyra kureshtare dhe nevoja për të kuptuar më mirë njerëzit rreth teje jo vetëm që të bëjnë një dëgjuese shumë të mirë, por së bashku me aftësitë e tua analitike të krijojnë mundësinë për të dhënë këshilla nga më të vlefshmet. Merisa, do të jesh një psikologe e shkëlqyer! - Emilja Zeneli

Merisa, ti je një perlë e vërtetë. Mirësia jote nuk njeh kufij dhe aftësia për t'i ndriçuar ditën dikujt me një buzëqeshje të thjeshtë është një dhuratë që të gjithë e vlerësojnë. Ke një kapacitet të jashtëzakonshëm për empati, gjithmonë e gatshme për të dhënë një dorë ndihmë dhe për të ofruar mbështetje kur është më e nevojshme. Shumë suksese dhe vazhdo kështu siç je! - Klesta Ademaj

E qeshura, e ëmbla Merisa! Ndonëse ti erdhe në klasën tonë në vit të dytë, arrite të bëheshe një prej vajzave më të dashura të klasës. Aftësia jote për të ofruar mbështetje dhe një vesh për të dëgjuar për ata që të rrethojnë të ka bërë një mikeshë të dashur dhe të besuar për të gjithë ne. Të dhuroj plot përqafime dhe puthje të përzemërta! - Vivien Kushi

Që në fillim të vitit, nuk kishe nevojë për shumë kohë për t'u bërë surpriza më e bukur e gjimnazit. Në vetëm pak javë, jemi ulur bashkë, kemi folur për tema nga më të ndryshmet dhe jemi afruar shumë. Mendoj se je personi më zemërmirë dhe më i dashur, duke u sjellë aq mirë me çdo person në klasë, pavarësisht se si mund të ndihesh për vete. Je njeriu më i vërtetë që njoh, më pozitiv, që mund të më bëjë në çdo moment të buzëqesh dhe vajza më e fortë që kam takuar ndonjëherë. Uroj që ky raport që kemi bashkë, të zgjasë përgjithmonë dhe të premtoj se do të më kesh gjithmonë pranë vetes. Ti e di se sa përzemër të kam e se sa shumë dua të jesh e lumtur. Të uroj lumturi, paqe, sukses dhe që çdo ditë të jetë e gëzuar për ty. - Rei Escobar Durmishaj



Parid Çela

Prej shumë vitesh ke qenë shoku im më i mirë. Jam mirënjohës për kohët e bukura që kemi kaluar. Shpresoj që shoqëria jonë e mirë të mos thyhet kurrë! Të uroj suksese në jetë dhe unë do të të gjendem pranë gjithmonë! - Luis Zenelaj

Parid Çela, je një skraparli shumë ambicioz dhe karizmatik. Gjatë këtyre 3 viteve të gjimnazit, ti për mua ke qenë një nga miqtë e mi më të vyer. E vlerësoj shumë shoqërinë tonë dhe shpresoj që të ngelet e tillë, sot e gjithmonë. Momentet dhe humoret që kemi kaluar do të ngelen të paharrueshme. E di që do ia dalësh kudo që jeta do të të çojë, por unë do të jem gjithmonë i gatshëm për ty në çdo hall e nevojë. Të uroj suksese të pafundme! - Arbi

Parid, je një djalë karizmatik dhe prezenca jote është ndjerë po aq sa edhe mungesa jote. Kemi kaluar momente mjaft të këndshme së bashku dhe ndoshta të paharrueshme. Mendoj se shoqëria jonë do të zgjasë pavarësisht pengesave të vogla që na janë hasur. - Barjena

Për Paridin, shokun tim që m'i ndriçon ditët me pozitivitetin e tij. Me dashurinë tënde, kujdesin për detajet dhe aftësinë tënde të mrekullueshme për të rritur humorin, i ke bërë ditët e mia më të bukura. Faleminderit për kujdesin, komplimentet dhe shakatë që më kanë dhuruar përherë buzëqeshje. Me dashuri, Daria Sinani

Shoku im i bankës që m'i bëri më të lehta orët e mësimin me batutat që bënim së bashku të cilat do të mbeten të paharrueshme. Të uroj suksese! - Deivid

Edhe pse nuk kemi shumë kohë që njihemi, u ktheve

shumë shpejt në një nga shokët më të mirë për mua. Kemi kaluar shumë bukur këtë vit që kemi qenë në klasë bashkë. Të uroj shumë suksese kudo që të shkosh! Nga patrioti yt, Gledi

Parid Çela, je një çun shumë i mirë dhe orët kalonin shpejt prej teje. Humori yt i çuditshëm gjithmonë na bën për të qeshur. Orët e muzikës ishin gjithmonë të bukura me ato karaoket e tua. Përtej shakave, ti je një çun i zgjuar dhe shpresoj që të jesh i suksesshëm në jetë. Je një shok shumë i mirë dhe faleminderit për kohët e bukura. - Kejsi

Paridi... edhe pse këtë vit kemi arritur një miqësi shumë të mirë mund të them që është lezeti i klasës. Çun gallatë që orët e mësimin i bën shumë të bukura, sidomos të kimisë. Shumë pozitiv dhe s'ka këngë në botë që nuk e di. Të falenderoj për çdo moment të bukur që nuk do të harrohet kurrë. Shumë suksese, Parid Çela! - Fiona

Parid, je një shok me vlera dhe ke një karakter shumë të veçantë. Më bëhet shumë qejfi që kam pasur mundësinë të ndaja momente të bukura me ty gjatë këtyre viteve. Je një nga njerëzit që mezi pres të shoh ku do të arrijnë në të ardhmen pasi pres shumë prej teje. Të uroj shumë suksese dhe asnjëherë mos ndrysho, vazhdo kështu siç je. Me respekt, Klesta Ademaj

Kemi kaluar shumë momente të bukura për një periudhë shumë të shkurtër. Ishe ndër personat më të dashur që njoha dhe një shok shumë i mirë brenda dhe jashtë shkollës. Të uroj suksese në çdo hap të jetës, vlla. - Aldo

Parid, asnjëherë se mendoja se do të njihja dikë me tip si ty. Je një person i cili di të ndërthur shumë bukur humorin me seriozitetin. Gjithmonë do të më bëjë përshtypje zgjuarsia dhe qetësia që tregon ndaj çdo situatë. Shpresoj të qëndrosh gjithmonë ky djali pozitiv. Sa më lart, inxhinier, suksese! - Klejsa Neza

Një nga shokët e mi më të mirë. Me batutat dhe humorin e tij nuk të lë asnjëherë të jesh i mërëzitur. Djalë energjik dhe kërkues që do të bëjë më të mirën në gjithçka që bën. Nuk do t'i harroj kujtimet dhe momentet e bukura që kemi kaluar. Të uroj suksese! - Joel Merkaç



Rei Escobar Durmishaj

Ky vit shkollor nuk do të kishte qenë asnjëherë i njëjtë pa ty. Je personi më i drejtë dhe me shpirtin më të pastër. Mund të them me vendosmëri të plotë se që në fillim të shoqërisë, e dija që do të ishe një mik që ia vlen të mbahet pranë përjetë. Të vlerësoj shumë për durimin, qetësinë, urtësinë, dashamirësinë dhe humorin që të karakterizon. Je me të vërtetë shumë i veçantë dhe jam e sigurt që nuk jam e vetmja që mendoj kështu. Uroj shumë që suksezi, shëndeti dhe të mirat të jenë në çdo hap të jetës tënde dhe të jesh i sigurt që për çdo arritje tënden, do të jem pranë teje duke të thënë “e dija që do ia dilje!” - Merisa Dumani

Me këtë dedikim nuk mund të shpreh dot minimumin e fjalëve që dua të them për Rein. Mund të them troç që është shoku më i mirë që kam bërë ndonjëherë. Kujtimet që kam në këto tri vite janë të pamundura t'i numëroj dhe herët që kam qeshur me të, akoma më të pamundura. Me të kam një miqësi që ka qenë gjithnjë duke u forcuar që nga dita e parë që jemi njohur. Nuk kam patur asnjëherë një hatërmbetje ose zënkë me të. Ai ka qenë një nga shtysat e mia më të mëdha përpara sa herë jam gjendur në një situatë të vështirë. Me atë kam një rekord në futboll që vazhdon ende: nuk kam humbur një lojë të vetme me të në ekip. Fiksim e kisha të hapja një bandë muzikore me të. E vlerësoj tej mase si person dhe për shoqërinë që më ofroi gjithë këto vite. Të uroj vetëm të mirat dhe të të gjej në çdo moment ashtu siç të lë, gjithmonë të lumtur dhe të hareshëm. – Jon Memushi

Rei!!! Braziliiani i klasës sonë! Më kujtohet kur të takova për herë të parë në vitin e parë, kur kishe ato syzet (dukeshe fiks si nerd, po, madje më shumë se unë). Miqësia që kemi pasur përgjatë këtyre tri viteve ka qenë e një vlere të çmuar për mua, ndonëse kemi

pasur edhe mosmarrëveshje, të cilat i kemi zgjidhur me sukses. Më kujtohet kur sa vinim në shkollë nisnim dhe flisnim për tenis dhe Formula Uno dhe përfundonim duke u bërë si komentatorë sporti. Shpresoj që gjithnjë të jesh i lumtur dhe i suksesshëm në të ardhmen tënde! P.S.: Shpresoj që Lando të kapë P1 në këtë sezon të Formula Uno!!! LANDO WE CAN BE WORLD CHAMPIONS I SAIDDD- Charles Leclerc - Vivien Kushi

Pas dy viteve përpjekjesh për të të sjellë në klasën time, nuk prisja të ndodhte as tani. Me shumë mundësi je personi i vetëm që është në gjendje të më bëjë të qesh edhe në situatat më serioze, edhe kur nuk je aty. Pozitiviteti dhe energjia jote është diçka që ka pasur ndikim tek unë jo vetëm gjatë këtyre viteve, por do ketë për një kohë të gjatë. Jam shumë e sigurt që gjatë këtyre viteve kemi krijuar një shoqëri që vështirë do të prishet për një kohë të gjatë. Duke të njohur shumë mirë, dua të them që ti do të arrish çdo gjë që dëshiron në jetë, pasi e njoh kapacitetin dhe zgjuarsinë që ke. Lando, we can be world champions. Shumë faleminderit për “lezetin” që i shtove këtyre viteve.– Klesta Ademaj

Për Rein, një nga djemtë që vlerësoj më së shumti. Ne kemi folur që nga viti i parë e gjithmonë kam pasur një respekt tej mase të madh për ty. Kur mora vesh lajmin që më në fund do vije në klasën tonë, jam gëzuar shumë. E kam ditur që ke qenë një djalë i edukuar dhe karizmatik, por në vitin e tretë kam kuptuar që je shumë më shumë se aq. Përveçse punëtor dhe i zgjuar, je edhe shumë i ndjeshëm, edhe pse këtë gjë shpesh përpiqesh ta fshehësh. Kujdesesh shumë për të tjerët dhe gjithmonë përpiqesh t'i bësh njerëzit që ti do të lumtur. Je një djalë të cilit humori nuk i mungon, edhe pse shumë herë kur të kap pesë minutëshi nuk di çfarë thua. Jam shumë i lumtur që kam një shok si ty, që ndryshe nga adoleshentët e tjerë, je shumë i maturuar. Padyshim që ti, Rei, do të mbahesh mend gjatë, e kjo jo për mbiemrin tënd të famshëm brazilian, por për djalin e mrekullueshëm që ma ka bërë gjimnazin shumë më të bukur. - Albion Qojle



Vivien Kushi

Vivi, ëndërrimtarja ime e dashur! Shoqëria jonë është një ndër më të bukurat dhe të ëmblat që kam patur. Karakteret tona të kundërta nuk na ndaluan që të kishim interesa të përbashkëta. Madje, ato ishin çelësi që ne të afroheshim me njëra-tjetrën. Miqësia jonë lindi gjatë ASEFIT të letërsisë, por u forcua përmes Bobbës dhe kafes së mëngjesit. Kohës së gjimnazit po i vjen fundi, por diskutimet dhe të qeshurat tona do të mbeten kujtime të ngrohta që do të më mbushin gjithmonë plot me nostalgji. E ardhmja nuk i dihet çfarë sjellë, por jam e sigurt që ti do ia dalësh të pranohesh në LMU dhe të shkëlqesh në mjekësi. Edhe pse do të jemi në dy kontinente të ndryshme, nuk do na ndaloj që të flasim me njëra-tjetrën për librat e rinj që po lexojmë ose për këngët që na pëlqejnë. Viv, të uroj sa më shumë fat për të ardhmen e ndritur që të pret në Gjermani!<3 - Esiana Këlliçi

Është e vështirë të gjej një pikë ku të nis të përshkruaj shoqërinë tonë, por mund të nis shumë mirë me një thënie nga Aristoteli: "Miqësia është një shpirt i vetëm që banon në dy trupa." Kujtimet që do mbaj me vete në etapat e tjera të jetës janë të panumërta. Jam shumë e sigurt që ne do të vazhdojmë të qeshim me çdo kujtim nga shkolla për vite me radhë teksa përballemi me sfida të tjera të. Një gjë që dua ta mbash mend është që gjithmonë do të më kesh pranë siç më ke pasur këto tre vite për çdo vështirësi me të cilën mund të përballësh. Faleminderit që je ajo që je, dhe shpresoj të vazhdosh kështu. - Klesta Ademaj

Vivi, goca nga i njëjti qytet që jam dhe unë, Berati. Të dy jemi shumë krenarë për këtë gjë dhe nuk ngurojmë ta shprehim. Bisedat tona kanë filluar që në vit të parë, ku të mbaj mend për mirësinë dhe pozitivitetin që përcjell. Je shumë punëtore dhe përpiqesh shumë

për të shkëlqyer në çdo lëndë. Është shumë e lehtë të flasësh me ty pasi ti të bën të ndihesh rehat. Shpresoj shumë që në rrugën tënde si mjeke të kesh vetëm sukses! - Albion Qojle

Je nga shoqet e para që njoha kur erdha në shkollë dhe padyshim, nga njerëzit e mi të preferuar. Bashkë kemi folur çdo pushim dhe ka qenë një pjesë e eksperiencës time në shkollë, që e vlerësoj shumë, si për faktin e të paturit dikë për të folur, edhe për pjesën e të paturit dikë për të kaluar momente të bukura. Çdo gjë, si bisedat mbi muzikën, si ato për Formula 1 dhe shakatë e shumta që kemi ndarë, kanë qenë nga pjesët më të bukura e të preferuara të ditës sime. Je shumë e zgjuar dhe je e vërtetë me veten, gjë që më ka pëlqyer gjithmonë te ti. Gjithmonë do të kesh një vend të veçantë në zemrën time dhe kujtimet që ndajmë janë nga kujtimet më të vlefshme që kam. Të uroj suksese dhe fat në çdo gjë, me dëshirën që të jesh sa më e lumtur. - Rei Escobar Durmishaj

Për Vivin, mikeshën me shpirt të ëmbël. Ke qenë gjithmonë një shpatull mbi të cilën mund të mbështetem, pasi nuk m'i ke kursyer kurrë dashurinë, këshillat dhe përkujdesjen. Do t'i kujtoj momentet kur së bashku diskutonim për mësimet apo kur para ndonjë provimi, përpiqeshim të qetësonim njëra-tjetrën nga stresi. Faleminderit për çdo moment që kemi kaluar bashkë dhe shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë edhe më tej. Me dashuri, Daria Sinani

Edhe pse me Vivienin më duhet t'ia nis që nga klasa e parë, ka qenë në vitet e gjimnazit ku ne u bëmë me të vërtetë të afërt me njëri-tjetrin. Kuptova së pari se sa shoqe e mirë mund të jetë, se sa njeri i arsyeshëm dhe i drejtë është, se si vepron me zemër dhe se sa e përkushtuar është për shoqërinë e saj. Gjithashtu zbulova që është një nga njerëzit me durimin më të kalitur që kam njohur ndonjëherë, prej faktit që më ka patur dy vite të tëra në bankë dhe ka dëgjuar fjalët e mia që ndonjëherë nuk reshtnin. Është një nga vajzat më të zgjuara dhe të vullnetshme që njoh: ia kam patur gjithmonë zili vullnetin për të mësuar. Të uroj vetëm më të mirat dhe të arrish të gjitha synimet dhe dëshirat që ke për veten tënde: jam shumë i sigurt që s'do ketë vend për momente të dobëta për ty. - Jon Memushi











Erisa Muhja

Të dashur nxënës!

Sot, ndërsa mbyllni një cikël të rëndësishëm të jetës suaj, më kujtohet me emocion dita e parë kur erdhët në mjediset e shkollës. Së bashku kaluam 3 vite të mbushura me kujtime të bukura, sfida dhe arritje. Këto vite nxorën në pah cilësitë tuaja më të mira: përkushtimin, solidaritetin, mbështetjen, edukimin dhe integritetin.

Gjatë këtyre viteve, ju u rritët fizikisht dhe mendërisht. Ju na kuptuat dhe na mirëkuptuat për vështirësitë që hasëm në rrugën e dijes, dhe në këtë mënyrë, ne lidhëm dhe forcuam urat e bashkëpunimit në të mirë të dijes. Të gjithë kuptuam se sa të rëndësishëm jemi për njëri-tjetrin.

Prandaj, nuk mund të jem më e lumtur se sot, kur ju po lini bankat e gjimnazit për të hedhur hapa të sigurt drejt formimit të mëtejshëm; si qytetarë të denjë dhe profesionistë të suksesshëm.

Në çdo hap të rrugëtimit tuaj të mëtejshëm, jini të bindur se unë personalisht dhe shkolla “Turgut Ozal” do t’ju mbështesim dhe do të duartrokasim për sukseset që do të arrini.

Jam besimplotë se do të rishihemi përsëri në të ardhmen. Pavarësisht se rruga e dijes është e gjatë dhe e mbushur me sfida, kjo është e vetmja rrugë e sigurt që unë uroj për secilin nga ju.

Suksese në çdo hap që do të hidhni dhe mirë u takofshim!

Me dashuri, Mësuesja juaj, Erisa.



Aureli Miftari

Nga Denisi:

Një djal tek i cili gjithmonë do ta kem zili qetësinë dhe pozitivitetin e tij, në shumë raste te ndryshme. Ai që sjell buzëqeshjen në klasës në momentet më kritike. Do ta konsideroj si një mik të vyer për këto tre vite të bukura, që kemi kaluar këtu në Kolegj. Të falenderoj për çdo moment. Shpresoj që rruga juaj të jetë po ashtu siç ke dhe zemrën “o llomsh”.

Nga Detjoni:

Aureli është një shok i mrekullueshëm, që kam njohur prej tri vitesh në shkollë. Ai është i zgjuar, i sjellshëm dhe shumë i këndshëm për të biseduar. Ne kemi kaluar shumë kohë së bashku dhe ai ka qenë gjithmonë aty për mua. Ka një humor të shkëlqyeshëm dhe është gjithmonë gati për të ndihmuar. Është një mik i vërtetë dhe jam shumë i lumtur që e kam në jetën time. BRAVOOO Reli!

Nga Elvi:

Edhe pse i ri në klasën tonë, ti u ambientove shumë shpejt me nxënësit e klasës me anë të humorit dhe të shpirtit të mirë. Jam me fat që të njoha edhe pse më vonë se të tjerët, por një shprehje thote: “më mirë vonë se kurrë.” Kështu që dua ta dish, që do të mbahesh mend si djali që nak e bërë gjithmonë të qeshim. Të uroj suksese në rrugën tëndetë dijës dhe të jetës!

Nga Ema:

Ne kemi qeshur, kemi bërë shaka dhe kemi ndihmuar njëri-tjetrin gjatë kohës sonë në shkollë. Do ti kujtoj përherë momentet e bukura që kemi kaluar. Shkathtë e tua do të mbeten me mua përherë. Unë jam mirënjohëse që të kam patur shok klase dhe jam e emocionuar të shoh të ardhmen e ndritur që të pret!

Nga Ergysa:

Djali më gallatë dhe patrioti më i mirë. Bisedat për biznese me ty, do mbeten gjithmonë nivel tjetër. Je pozitiv dhe nuk e prish terezinë për asgjë, një cilesi tepër e mirë tek ti. Mos je pakëz vonë për të zgjedhur degën..? Të uroj më të mirat dhe shpresoj të arrish atë që ti dëshiron!

Nga Anxhela:

Edhe pse i je bashkuar klasës sonë këtë vit shkollor, arrite të përshtatesh shumë mirë me të gjithë ne. Padyshim, i favorizuar nga sjellja e humorit i mrekullueshëm. Do ti kujtoj gjithmonë batutat e shprehjen tuaj të famshme karshi meje, “O Senatore”. Ju uroj suksese të mëtejshme!



Kaila Velmishi

Nga Denisi: Një vajzë mjaft e sjellshme dhe humoriste në të njëjtin kohë. Një vajzë që kur bëmë muhabet ditën e parë më dukej sikur kisha kohë që e njihja për shkak se ajo kupton shumë mirë humorin tim të zi. Kaila është një vajzë që qëllimet e saj i ka të qarta (mesatarja që afrohet te 11 po nejtse.) Prandaj i uroj vetëm suksese dhe miqësia jonë të vazhdoj përgjithmonë.

Nga Elvi: Shoqja ime e furgonit, e cila gjithmonë ka mbajtur klasën në humor me çiltërsinë e të shkon përshtat. Të falenderoj për çdo ndihmë që më ke dhënë dhe për çdo moment të bukur që kemi kaluar. Shpresoj të arrish aty ku dëshiron dhe të mos dorëzohesh për ëndrrat e tua.

Nga Enio: Kajla, një nga vajzat më pozitive të klasës, me shprehjet e saj të veçanta që janë shumë humoristike. Kemi që në klasë të 10-të që njihemi dhe ti gjithmonë ke qenë e gatshme për të më ndihmuar për çdo gjë që unë të kam kërkuar, për këtë shumë faleminderit Kajla. Të uroj suksese kudo që të shkosh në jetë!

Nga Ergi: Kaila, dua të të falenderoj dhe të tregoj mirënjohje për çdo moment që më ke ndihmuar. Je një person pozitiv, karakterizohesh nga zgjuarsia e gatishmëria jote për të ndihmuar çdo person tregon shumë për ty. Jam i sigurt që do të arrish çdo qëllim që i ke vënë vetes. Të uroj më të mirat në të ardhmen tënde!

Nga Kreisa: Kajo je një nga personat që unë dua më së shumti dhe që vrapoj menjëherë për t'i treguar nëse më ka ndodhur diçka. Ke qenë shoqja e parë që kam bërë këtu dhe mbetesh kryesorja. Të falenderoj për çdo moment që kemi kaluar së bashku dhe më pëlqen shumë fakti që je një person kaq karizmatik dhe

zemërmirë. Të të shoh ty të buzëqeshur më bën dhe mua që ta nis ditën me po aq mirësi sa rrezaton dhe ti. Të lutem mos mungo më aq shumë. Faleminderit për mirëkuptimin!

Nga Kejsi: Vajze lozonjare me një karakter tepër të lezetshëm, si një gangstere e vogël. Është tepër inteligjente dhe e mprehtë. Rrezaton plot pozitivitet dhe është tamam si një kanace me pije energjike që të rigjeneron me energji sa herë që bisedon me të. Shpresoj të të plotesohen të gjitha dëshirat dhe suksese në jetë Kajo <3!


Nga Ergysa: Një vajzë pakëz mistrece, por e dashur. Je tepër e zgjuar, edhe nëse nuk e ke mendjen në mësim përsëri përgjigjesh saktë. "Lexoje pak çfarë shkruan se është shumë larg". Shpresoj shumë të arrish aty ku do dhe të uroj shumë suksese.

Nga Sibora: Edhe pse nuk kemi shumë kohë që njihemi, momentet që kam kaluar me ty janë disa nga më të bukurat në klasë e në shkollë. Çdo bisedë e shaka e jona do të ngelet në kujtimet e mia përjetë. Nuk mund ta shpreh dot me fjalë se sa të veçanta janë për mua të gjitha ditët që kemi qenë bashkë në shkollë apo jashtë saj, këshillat e tua, momentet kur ziheshim sepse nuk na përputheshin mendimet e gjithçka tjetër. Për mua nuk je thjesht një shoqe klase, je një mike që më ka qëndruar pranë në çdo moment e ka menduar për të mirën time gjithmonë. Një vajzë me karakterin tënd është e vështirë ta gjesh prandaj jam me fat që kam arritur të të njoh. Të uroj me pse e di që do punosh fort për t'i arritur. Me shumë dashuri, Sibora!

Nga Fiona: Kaila bukuroshe ,kemi kaluar shumë momente të bukura si në shkollë po ashtu dhe në furgon, ku budalliqet nuk kishin fund.Do më mungosh shumë dhe të uroj suksese në jetë!! <3 u FionaShehu

Nga Sabjani: Kajo ti je e paparë. Ai shikimi jot i frikshëm do më përndjekë gjithë jetën. Je shoqe shumë e mirë edhe pse ke qejf të debatosh kot. Do më marrë malli për "Gangstan e vogël të turkut". Shpresoj të arrish majat dhe të jesh e suksesshme siç ëndërron!

Nga Kiara: "Kajo!" Vajza lozonjare, pak çapkëne dhe e shoqërueshme me këdo. Më pëlqen shumë energjia që përcjell dhe çdokush që të njeh nga afër, e di sa person i mirë je. Pavarësisht se nuk kalojmë shumë kohë bashkë, duket sikur asgjë nuk ka ndryshuar sepse mbetesh e njëjta me ato shakatë e tua. Të uroj suksese në të ardhmen! – Kiara Mersini



Ergysa Reka

Nga Bora: Jam e lumtur që kam njohur një person si Ergysa. Nga ju do të mbaj mend te qeshurat pafund, diskutimet e shumta që kemi zhvilluar dhe çdo moment që kemi kaluar së bashku. Shpresoj që miqësia jonë të zgjasë. Ju uroj suksese në rrugëtimin tuaj të mëtejshëm!

Nga Bela: Kemi kaluar bashkë 9-vjecaren dhe gjimnazin. Gjithmonë ke qenë një vajzë pozitive dhe e buzëqeshur. Nuk do të harroj asnjëherë mëngjeset e bukura e plot energji që kemi kaluar në furgon. Ke qenë gjithmonë një mbështetje për mua dhe më je gjendur pranë në çdo moment. Të falenderoj për gjithçka dhe të uroj suksese të mëtejshme në rrugëtimin tënd!

Nga Detjoni: Shoqe e klasës pak më shumë se të tjerat, sepse jemi njohur dhe me herët. Je një vajzë shumë shumë e mirë dhe më pëlqen shumë fakti që arrin të marrësh çdo gjë me pozitivitet siç duhet gjithmonë. Shpresoj të jesh mirë kudo që të shkosh dhe të uroj më të mirat!!

Nga Elvi: Një ndër personat që mund t'ia kem kaluar më bukur gjatë kohës që kemi qëndruar në bankë bashkë, me shakatë dhe lojrat që kemi bërë përherë edhe gjatë orës së mësimin për të thyer atë monotoninë e lodhshme të përditshmërisë. Ja kemi kaluar shumë bukur gjatë gjithë gjimnazit dhe uroj t'ia kalosh edhe më bukur në vazhdim.

Nga Ergi: Ergysa, shoqja e bankës së biologjisë. Dua të të falenderoj për momentet gazmore që kemi kaluar dhe për gjithçka që ke bërë për mua. Ti je një vajzë që të karakterizon mirësia dhe ke qenë gjithmonë e gatshme për të ndihmuar të tjerët. Të jam shumë mirenjohës që ke qenë pjesë e këtyre tri viteve dhe

shpresoj që miqësia jonë të zgjasë sa më shumë. Unë të uroj të gjithë të mirat dhe suksese në rrugëtimin tënd. Nga Jasmina: Ergysaaa kemi kaluar pothuajse gjysmën e vitit të ulura së bashku. Duket si një kohë e shkurtër e cila vërtet ka kaluar shpejt, por ka mjaftuar për të krijuar një opinion pozitiv për ty. Je një vajzë e qeshur, optimiste e plot pozitivitet. Kam kaluar momente shumë të bukura me ty. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe ëndërrat e tua!

Nga Kejsi: Një vajzë e ëmbël si mjalti. Një nga gjërat e mija të preferuara që bëjmë së bashku janë muhabetet që kemi në lidhje me tema të ndryshme. Akoma kujtoj shakatë fantastike që bën gjatë bisedave me të cilat vdisja së qeshuri. Rrezaton plot pozitivitet dhe është tamam si një kanaçe me pije energjike që të rigjeneron sa herë që bisedon me të. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe sukseset në jetë zemër!

Nga Elena: Jam shumë e lumtur që kisha mundësinë të të njihja më shumë këto vite të gjimnazit. Faleminderit që ke qenë gjithmonë shumë e dashur dhe e gatshme për mua. Të kam shumë xhan! Borxhin që të kam nuk e harroj, të premtoj!

Nga Anxhela: Gysaaa, një mike që ka ditur të jetë e veçantë këto tri vite. Kemi kaluar momente të paharrueshme së bashku, kemi ndarë histori e kemi "qarë hallet" :) Tek ju kam vlerësuar gjithmonë edukaten, durimin e maturinë që shfaq. Të uroj nga zemra një rrugëtim të ndritshëm!

Vesa Çeliku: Gysa ime sa shpejt ikin vitet ëëë!! Ke qenë me mua që nga viti i parë, atëherë kur vetë ideja e gjimnazit na e shtonte ankthin. Çfarëdo lloj gjëje të të ndodhi, nuk ta heq buzëqeshjen e bukur nga fytyra dhe me sportivitetin që ke, i kalon të gjitha vështirësitë. Historitë tona të gjimnazit nuk kam për ti harruar kurrë. Të uroj vetëm më të mirat dhe shpresoj që jeta për ty të ketë ruajtur momente akoma më të bukura!

Kiara Mersini: Nuk e kisha menduar ndonjëherë që do uleshja të shkruaja për Gysin. Nuk jam tip që bëj shumë dedikime dhe ti me mirë se kushdo tjetër e di, po për ty e bëj një sakrificë. Përtej shakave ky vit nuk do të kishte kuptim pa xhirot tona në pushim që jam unë ajo që insistoja gjithmonë se gocado të rrijë te mensa poshtë... Peng më ka ngelur që na ike nga klasa në fillim të vitit, se nuk do lodhesha duke ngjitur kate, se mos kujton për ndonjë gjë tjetër... Të uroj të arrish çdo gjë që dëshiron e ta dish që do më kesh përherë krahu.



Bora Bica

Nga Anxhela: “Mirësi”, pikërisht kjo është fjala me të cilën do të personifikoj një mike si ty. Jemi njohur që nga klasa e 10-të dhe përgjatë këtij rrugëtimi, them me siguri se keni sjell gjithmonë një dozë të veçantë të çiltërsisë dhe optimizmit. Është i adhureshëm fakti, se për këdo që ka nevoj për diçka sado të vogël, ju jeni aty për të. Ju uroj shumë suksese në rrugëtimin tuaj të mëtejshëm!

Nga Elena: Jam shumë me fat që në jetën time njoha një njeri si ti. Një vajzë kaq zemërmirë dhe kaq e gatshme për të ndihmuar këdo. Të dua shumë Borina. Uroj me gjithë zemër të arrish skajet e suksesit.

Nga Ergysa: Sinqerisht një vajzë shumë e mirë. Më pëlqen shumë si i vlerëson mendimet e të tjerëve edhe nëse nuk mendon në të njëjtën mënyrë dhe se si nuk e ke problem të dëgjosh e të japësh këshilla. Nuk do e harroj udhëtimin që bëmë në Korçë dhe të gjithë ngjarjet që ndodhën aty... Jam e lumtur që të kam njohur! Të uroj më të mirat!!

Nga Bela: Vajza më e mirë dhe më punëtore e klasës tonë. Që nga viti i parë kemi patur një marrëdhënie shumë të mirë bashkë, që akoma vazhdon dhe shpresoj të vazhdojë dhe pas përfundimit të gjimnazit. Do të kujtoj gjithmonë kohët e bukura që kemi kaluar. Do të më mungosh shumë dhe të uroj shumë suksese në rrugëtimin tënd dhe pse e di që ju do ja dilni mbanë pavarësisht gjithëkaje.

Nga Elvi: Padyshim vajza më e dashur dhe më e “pastër” e klasës, e cila përherë më ka dëgjuar dhe ndihmuar për problematika të caktuara. Ashtu siç ke qetësinë dhe çiltërsinë, ashtu ke dhe humorin, të cilin nuk e shfaq në pamje të parë, por në fakt e ke

një element shumë të rëndësishëm dhe të favorshëm tëndit. Të falenderoj shumë për këto tri vite në gjimnaz dhe shpresoj të arrish më të mirën e mundshme.

Nga Jasmina: Bora. Me të qeshura e me pozitivitet, kështu ka nisur dhe vazhdon të jetë shoqëria jonë që nga viti i parë dhe kjo gjë e bën të veçantë. Një arsye e vazhdimësisë së shoqërisë sonë janë mendimet e tua me të cilat gjithmonë bie dakort. Je një vajzë shumë e zgjuar, e vendosur dhe pozitive. Shpresoj që miqësia jonë të vazhdojë! Të uroj suksese në çdo hap tëndin!

Nga Ema: Ndërsa kalojme këtë ngjarje të rëndësishme së bashku, nuk mund të mos reflektoj në rrugëtimin e gjatë që kemi ndarë. Mbështetja jote, gëzimi dhe miqësia kanë qenë shumë të rëndësishme gjatë kohës sonë në shkollë. Ky është një urim për një të ardhme të ndritshme dhe shumë vite të tjera të lumtura që do të vijë.

Nga Ergi: Bora, një nga vajzat më të sjellshme në klasë, që e karakterizon mirësia dhe gjithmonë i ndihmon të tjerët. Jam shumë mirënjohës që të kam njohur dhe të falenderoj për çdo moment të bukur që kemi kaluar bashkë. Uroj që kjo miqësi të zgjasë sa më shumë dhe të uroj gjithë të mirat në rrugëtimin tënd!

Nga Klenisa: Për vajzen më të sjellshme dhe mendjen më të ndritur - Bora, je një ndër shoqet më të mira që më ka sjell ky rrugëtim. Jam mirënjohës për çdo moment të bukur që kemi kaluar bashkë. Gatishmëria juaj për të ndihmuar të tjerët, natyra e kujdesshme dhe përkushtimi ndaj studimeve janë cilësi që të dallojnë. Të falenderoj për ndihmën që më ke dhënë çdo herë që jam gjendur në vështirësi.

Denisi: Vajza që ka vërtetuar në klasë se me punë sistematike dhe pak vullnet çdokush mund t’ia dalë në sistemin e Kolegjit. Me Borën kam më shumë se miqësi, për vetë faktin se jemi kushërinj, por ama për mua ajo është një vajzë model që gjithmonë do mundohem të jem afër saj. Suksesi është diçka më se normale për Borën.

Detjoni: Shoqja e bankës më e mirë. Po ti shikosh të gjithë janë xhelozë që nuk e kanë një shoqe banke po aq të mirë sa të kam unë ty BORAAA. Faleminderit për shënimet, mësimet që më ke ndihmuar dhe të kërkoj falje për çdo moment që të kam bezdisur, edhe pse ti e di mirë që nuk kam dashur asnjëherë. Bora të uroj më të mirat!! (kthehu para pusho!!)



Jasmina Durmishi

Nga Klenisa: Nuk e di nga t'ja nis, pasi kujtimet tona janë të panumërta. Na ka bashkuar gjithmonë mënyra e të menduarit dhe humori i përbashkët. Siç ka thënë dhe Elvana: "Ne jemi njësoj". Edhe pse të bezdisshme, do më mungojnë mesazhet e tua duke më pyetur për detyrat. Si t'ja bëjmë që nuk mu ndave (shihemi rreth e qark Epokës). Më ka pëlqyer gjithnjë gatishmëria jote për të munguar në shkollë, si dhe aftësia për të ma mbushur mendjen edhe mua të mungoj. Kështu vazhdoftim se po e ndrisim! Përtej shakave, ke një karakter shumë të veçantë dhe mos ndrysho kurrë pasi kjo të bën edhe më të bukur. Sa herë që jemi së bashku, nuk ka një moment të vetëm pa qeshur. Jam tepër falenderuese për çdo moment që kemi kaluar dhe e di që shoqëria jonë do të zgjasë. Uroj më të mirat për ty, pasi ti i meriton!

Nga Bora: Gjatë tri viteve të gjimnazit kam krijuar një shoqëri shumë të vyer dhe ajo është me Jasminën. Është një vajzë shumë e zgjuar, e sjellshme dhe me shumë humor. Të falenderoj për të qeshurat që më ke dhuruar në çdo moment. Me Jasminën kam krijuar një marrëdhënie shumë të veçantë dhe besoj që kjo miqësi do të zgjasë. Shpresoj të të shoh sa më lart dhe të suksesshme në atë ç'ka vendos të ndjekësh!


Nga Ema: Kjo është një kohë për fillime të reja, por gjithashtu është një kohë për të çmuar miqësinë që na ka sjellë deri këtu. Shakatë e tua, më bëjnë të qesh në çdo lloj situatë. Më pëlqen shumë mënyra se si i dëgjon njerëzit pa i gjykuar dhe jep këshilla të sinqerta. Miqësia jote ka pasur një rëndësi të madhe për mua, dhe ky shënim të dedikohet ty si një simbol i kujtimeve, gëzimit dhe tri viteve që kemi ndarë. Pres të shoh ku na çon jeta, por jam me shumë e sigurt që do të kem pranë.

Nga Kejsi: Shoqes time më të ngushtë e cila më mësoi kuptimin e vërtetë të shoqërisë, Jazzit. Jam shumë mirënjohëse që të kam në jetën time. Faleminderit për zë gjithë sakrificimin e qelizave nervore dhe durimin ekstrem që ke në shpjegimin e koncepteve të ndryshme gjatë kohës që mua me zor më rezistojnë dy qeliza në tru. Faleminderit për të gjithë energjinë historike dhe pozitive që ma ngjit si virus vdekjeprurës (në fakt është më shumë si 'qeshprurës') e cila bën që orët e gjata dhe të mërzitshme të shkollës të shkojnë vaj. Gjendjet tona gjatë pesëminutsheve janë momentet më të preferuara të mijat, në të cilat të dyja nuk dimë si të përmbahemi dhe humbasim totalisht kontroll (aq sa na kërcënojnë dhe zyshat për te na ndarë nga banka). Shpresoj që kapitulli ynë i shoqërisë mos të mbyllet këtu dhe të kem shansin që të të prezantoj dhe tek fëmijët e mij. Shpresoj që të marrësh gjithçka që dëshiron sepse me të vërtetë e meriton. (Pa ty pz këtë vit shkollor se kisha mbijetu hahahaha TE DUA MOJ QËNE!<3)

Nga Debora: Me Jasminën jam afruar në fillim të këtij viti sepse ndajmë të njëjtin sens të çuditshëm humorit. Edhe pse koha jonë bashkë ka qenë e shkurtër, mund të them se jemi bërë shoqe shumë të mira. Ju keni qënë një person që shumë situata serioze keni mundur t'i ktheni në qesharake dhe kjo është një aftësi që jo të gjithë e zotërojnë. Ju uroj suksese në rrugëtimin pas gjimnazit!

Nga Ergysa: Jasminaaa, kam kaluar me ty më shumë se një vit të ulura në një vend dhe mund të them që i kemi bërë të gjitha, duke nisur nga muhabeti, batutat e duke mbaruar tek të fokusuarit në mësim. Je një vajzë tek e cila gjen shumë cilësi të mira. Je e zgjuar, e urtë, di të bësh shaka e të na argëtohesh duke na bërë të qeshim. Do jem gjithmonë krah teje kundër "snowitt" dhe për pagesën rregullohemi më vonë... Faleminderit që s'je lodhur duke më dëgjuar mua se si këndoj... Të uroj shumë suksese në jetë dhe shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshiratt<3

Nga Vera: Mund të them se ti gëzon një fat, pasi ne jemi njohur bashkë që në klasë të parë në shkollën e mëparshme. Më duket disi e çuditshme, pasi për këtë kohë kaq të gjatë nuk jemi zënë apo të kemi patur qoftë edhe një konflikt të vogël. Ndoshta për shkak të tipit sportiv dhe praktik që ke, ama realisht gjithmonë më ke lënë të surprizuar me atë mënyrën racionale qëi koncepton gjërat. Të mbaj akoma mend me ato bishtalecat që rrije gjithmonë e heshtur në bankën e fundit.



Kleidi Babasi

Me humorin tënd ti bën që cdo orë mësimi të kalojë shumë shpejt. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë edhe pas gjimnazit. Të falenderoj për çdo moment të bukur që kemi kaluar në klasë dhe të uroj suksese në rrugëtimin tënd!

Nga Aureli: Ti je një mik i vërtetë, gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar dhe për të qeshur së bashku. Faleminderit për të gjitha kohët e mira. Të uroj gjithë të mirat në të ardhmen!

Nga Bora: Ju uroj vetëm sukses në rrugëtimin tuaj të ri! Gjatë këtyre viteve ke treguar djalin e sjellshëm dhe me humor. Jam e lumtur që të njoha.

Nga Denisi: Një nga personazhet me gjallërinë më të madhe në shkollë, ku nuk sjell humor vetëm për klasë, por kujtohet edhe për stafin pedagogjik të iu rikthejë buzëqeshjen. Kleidi përcjell vetëm pozitivitet dhe gjallëri kudo që shkon. I uroj suksese të mëtejshme dhe të panumërta!

Nga Elvi: Erdhe si nxënës i ri në klasën tonë në mesin e vitit të parë dhe të gjithë mendonin se do ta kishin të vështirë që të ambjentoheshin me ty dhe anasjelltas, por ti ke vërtetuar të kundërtën. Ke qenë dhe do të jesh gjithmonë personi që edhe situatën më të lodhshme e më të mërzitshme, do ta ktheje në një situatë komike e të këndshme për këdo. Mua do më mbesin në kujtesë përherë shakatë e tua dhe “aventurat” që kemi kaluar.

Nga Enio: Kleidi, një djalë punëtor, i respektueshëm, e mbi të gjitha i sjellshëm dhe i edukuar me të tjerët. Këto dy vite në klasën tonë ke shpërndarë vetëm pozitivitet dhe gjallëri. Të uroj suksese kudo që të shkosh në jetë!

Nga Ergi: Kleidi të uroj më të mirat në rrugëtimin tënd. Gjatë këtyre viteve edhe pse nuk ke qenë gjithmonë prezent në klasë, ke treguar që je një djal plot humor. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në çdo hap tëndin!

Nga Klesjani:



Bukrijela Brahimi

Nga Bora: Jam shumë e lumtur dhe me fat që në jetën time kam njohur një person si Bela. Me Belën që nga fillimi kemi krijuar një marrëdhënie të veçantë dhe shpresoj ta kemi edhe në vazhdim. Do më mungosh shumë. Uroj që kjo miqësi të zgjasë dhe shpresoj të të shoh sa më lart !

Nga Detjoni: Bela bestiii tjetër. Dhe me ty jo shumë kohë bashkë, por çdo moment që kemi kaluar, e kam shijuar deri në maksimum. Je një vajzë shumë e sjellshme, shumë e ëmbël dhe shpresoj që të mbash gjithmonë atë buzëqeshje që ke. Suksese ne çdo hap Bela<3!!

Nga Elvi: “Bello” që asnjëherë nuk u acarua me mua sado i bezdisshëm të kem qenë unë karshi saj, sigurisht në formën e shakasë dhe lojës, në mënyrë që ta bënim sa më të bukur shoqërinë tonë gjatë këtyre viteve të paharrueshme shkollore. Të falenderoj për çdo “Orbit” që më ke dhënë dhe t’i kam borxh. Uroj të arrish suksesin që dëshiron e të jesh përherë e qeshur siç të ka hije!

Nga Ema: Kur dua të shkruaj për ty nuk rri dot serioze, kujtoj gjithnjë shakatë tona dhe faktin se nuk mund të mbajmë të qeshurën kur jemi së bashku. Ky është një moment për të çmuar çdo kohë të bukur. Sa herë kthej kokën pas dhe mendoj për kujtimet tona, kujtoj vetëm te qeshura, shaka dhe një shoqe te vërtetë (si themi ne gjithnjë, flaka i dalt). Jam shumë me fat që gjeta persona te cilët ndajnë interesa të njëjta si unë. Nejse, me ta thënë drejt o Bel, ja kemi kaluar shumë bukur. Pres me padurim të shoh se ku do të na cojë e ardhmja, por dicka është e sigurt se as distanca nuk do të na ndajë dot!! -Ema

Nga Klenisa: Më kujtohet dita e parë e shkollës, ku ti mu afrove dhe u ulëm bashkë në bankë. Pasi biseduam për pak kohë shkruajtë numrin tënd tek libri im i matematikës (lënda jote e preferuar). Energjia jote pozitive që në ditët e para tregonte shumë për ty. Edhe në ditët më të vështira, ti ke një aftësi unike për të më bërë të buzëqesh, duke më kujtuar që të mos e marr jetën shumë seriozisht. Do më mungojë pasqyra jote gjigande dhe çdo lipgloss që të kam përdorur pa dijeninë tënde ;). Por më shumë do më mungojnë kohët me ty në bankë duke ngrënë byrek gjatë orës së turqishtës. Kemi parë njëra-tjetrën duke u maturuar dhe nuk mund të isha më krenare për këtë. Miqësia jonë është një thesar që do ta ruaj përgjithmonë. Teksa nisim aventura të reja dhe rrugë të ndara pas këtij kapitulli, kam besim se miqësia jonë do t’i rezistojë kohës. Si shoqja jote, jam tepër mirënjohëse që kemi ndarë momente të panumërta gëzimi. Qoftë e ardhmja jote po aq e ndritshme sa buzëqeshja jote!

Nga Barjena: Më kujtohet ditën e parë të shkollës ne vit të parë teksa the një fjalë në suedisht që unë sot e kësaj dite nuk ja di kuptimin, më kujtohet edhe biseda jonë e parë atë orë të mërzitshme fiskulture, u bëmë shoqe shumë rastësisht dhe prej atij momenti s’mund të kisha imagjinuar 3 vite më të bukura gjimnazi. S’mbaj mend të kem qeshur ndonjëherë me lezet apo fallco me ty, gjithmonë kemi qenë të palosura në tokë, ose duke përplasur duart mbi tavolinë, ose duke u shtyrë e u përplasur ne muret e paralelit, pse jo edhe ndonjë nga shpullat e tua drejt meje. Do t’i mbaj mend gjithmonë momentet se sa herë dilja me dorën në kokë nga ndonjë provim ti ke qenë duke më pritur me të dyja duart në kokë, kur humbisje skenat më të bukura që ndodhnin vërdallë se skishe vënë syzet, kur hiperbolizonim shakat me gocat aq sa na binte rimeli nga lotët e shumë e shumë momente të tjera të panumërueshme. Jam çdo ditë mirënjohëse që të kam ty, dhe po të me jepej mundësia të kthehesha pas në kohë, në atë moment ku frym lulet e dëshirave në vit të parë, dëshira ime do të ishte gjithnjë po e njëjta, -“të jemi gjithmonë pranë njëra tjetrës”. -tuçi jot<3

Nga Arbi: Bela Brahimi, je një vajzë shumë speciale, me njohuri të thelluar në gjuhën suedeze dhe shumë e mirë në mësim. Je njeri tepër pozitiv dhe shakat e tua që kam qeshur gjithmonë do mbahen mend gjatë. Ke qenë një mikesh shumë e mirë për mua dhe e vlersoj shumë shoqërinë tonë. Të uroj shumë sukses në rrugtimin tënd me mbarimin e gjimnazit!



Vera Meta

Nga Aureli: Faleminderit për të gjitha momentet e këndshme! Lumturi dhe suksese përpara!

Nga Bora: Ju uroj vetëm suksese në rrugëtimin tuaj të ri! Tek ju kam parë vajzën e sjellshme, të zgjuar, të edukuar dhe me humor. Shpresoj dhe besoj që do t'i arrish të gjitha synimet që i ke vendosur vetes!

Nga Bela: Vera, ti je një vajzë e qeshur e pozitive. Të falenderoj për komplimentat që ke bërë ndaj meje. Uroj të të plotësohen të gjitha dëshirat në jetë. Suksese !

Nga Debora: Kam qënë tepër me fat që kam njohur një person kaq energjik sa Vera. Nuk kanë munguar asnjëherë bisedat interesante dhe të qeshurat në praninë tuaj. Ju keni qënë një shoqe shumë e dashur për të gjithë individët rreth jush. Ju uroj suksese në rrugëtimin që ju pret në universitet!

Nga Elvi: Një person shumë pozitiv gjithmonë e qeshur dhe me humor të bukur. Sinqeriteti është një ndër armët e tua më të forta, që mendoj se duhet t'a përdorësh dhe në të ardhmen. Të uroj që të arrish më të mirat që shpreson dhe suksese të mëtejshme!

Nga Ema: Të falenderoj për çdo kompliment që më ke bërë këtë vit :)! Je një vajzë shumë e dashur dhe i bën të tjerët të ndihen shumë mirë. Do të kujtoj gjithmonë të qeshurat e mia me shaktë e tua. Shpresoj të arrish çdo dëshirë që ti ke dhe jam e bindur se do te bëhesh një doktoreshë e mrekullueshme!

Nga Enio: Vera, edhe pse s'kemi shumë që njihemi, për aq sa të kam njohur je një vajzë e kulturuar, e zgjuar dhe sistematike, që shfaq kudo dhe në çdo çast

pozitivitet. Të uroj suksese kudo që të shkosh në jetë!
Nga Ergi: Vera, ti je një vajzë shumë e sjellshme dhe pozitive. Menyra se si ti sillesh me të tjeret tregon mirësinë dhe pozitivitetin që ti percjell tek të tjerët. Te uroj të gjithë te mirat dhe suksese në çdo hap tëndin.

Nga Sofia: E përkushtuar si gjithmonë. Kokëfortë, por një kokëfortë e guximshme për të bërë ëndrrën tënde realitet. Do bëhesh një dermatologe shumë e suksesshme duke ecur me këto hapa.



Debora Qendra

Snow, më në fund erdhi fundi i një udhëtimi kaq të bukur, por edhe të lodhshëm i cili do të ngelet gjatë në mendjet tona. Të jam mirënjohëse që gjatë gjithë kësaj kohe ke qenë një mbështetje e madhe për mua. Gjimnazi mund të perfundoj, por kujtimet dhe miqësia jonë kurrë sdo të shuhen. Mezi pres të shijojmë së bashku të gjitha aventurat e universitetit. Të uroj një të ardhme të mbushur me sa më shumë suksese dhe lumturi mikja ime më e mirë! -Erisa Noga

Jam shumë e lumtur që pata mundësinë të të njihja më mirë pasi erdhëm në Turgut. Jam shumë mirënjohëse për çdo orë fiskulture dhe pushimi, që kemi patur mundësi të flasim për çdo gjë ka ndodhur gjatë ditës. Ke një sens humori të mrekullueshëm dhe një shije vërtet të mirë në muzikë. Je një ndër me personat më të afërt që kam patur në shkollë dhe shpresoj mos të humbasim kontaktin edhe në të ardhmen. Të uroj me gjithë shpirt një të ardhme të lumtur dhe të suksesshme, kudo që të jesh, çfarëdo që të bësh! -Moana Gorezi

Pa diskutim vajza më e mrekullueshme që njoha në vit të fundit. Një pikëpyetje që do të kem gjithmonë, është se si do ishte sikur të të kisha takuar që kur erdhe në vit të dytë. Gjithsesi, kohën që kaluam bashkë për aq sa mundëm nuk do ta harroj kurrë. E konsideroj veten shumë me fat që u njohëm, siç ta kam thënë shumë e shumë herë. Do jesh përgjithmonë një nga kujtimet më të bukura të mia të gjimnazit. Të dua vetëm më të mirën dhe të uroj të jesh gjithnjë e lumtur, ashtu siç e meriton. -Jon Memushi

Një vajzë sharmante dhe një nga personat më inteligjentë që njoh. Më mahnit mënyra e të menduarit dhe të shprehurit tënd. Në qoftë se do nisje një

podcast, do isha fansja jote më e zjarrtë. Nuk harroj pa përmendur maturinë që të karakterizon. Faleminderit për momentet që kemi kaluar së bashku. Të uroj shumë suksese kudo! -Sara Halilaj

Debora është një vajzë dhe një shoqe shumë e mirë. Është e përkushtuar ndaj synimeve të saj dhe ndaj shoqërisë. Ajo nuk të lë kurrë vetëm dhe të vlerëson për atë që je. Debora është një ndër të vetmet shoqe nga më të mirat që unë kam që prej vitit të parë. Qëndrimi me të është gjithmonë shumë i këndshëm dhe kurrë nuk mund ta refuzoj. Ajo është një shoqe që unë e dua shumë dhe i uroj çdo të mirë dhe sukses. -Adelajda Shahini

Ndryshe nga të tjerët në klasë, ty të kam njohur më parë dhe je njeriu me zemrën më të pastër që kam njohur ndonjëherë. Vlerësoj çdo sekond që kemi kaluar dhe do të kalojmë së bashku. Je një vajzë shumë e bukur si nga jashtë, por më së tepërmi nga brenda. Do më mungojë humori yt i vecantë dhe bisedat e gjata që kryenim së bashku për orë të tëra. Dua të të shikoj të arrish majat sepse e di që e meriton. -Sabjan Haska

Në fakt mund të duket shumë e ftohtë dhe e ndrojtur në vetvete, por nëse flet qoftë edhe një herë me të, do të ndryshosh mendim. Kjo më ndodhi mua kur e pashë për herë të parë, pastaj normal si mund të mos ndryshoja mendim kur dëgjova atë të fliste me një lirshmëri dhe pompozitet, që në fakt i shkante shumë me imazhin që ajo kishte krijuar në shoqërinë tonë. Që ta dish jam fansja jote përsa i përket personalitetit tënd aq spontan dhe unik. -Vera Meta

Debora, e kam adhuruar gjithmonë qëndrimin tënd, mënyrën si e menaxhon situatën duke i bërë ballë deri në fund. Mos ndrysho për asnjë. Suksese në jetë! -Sofia Stavri

Një vajzë pakëz e ndrojtur, por jashtëmëse e ëmbël, aq sa më dukej sikur po dhembnin dhëmballat nga gjithë kjo ëmbëlsi. Gjithmonë është në dispozicion për të ndihmuar të tjerët në situata të vështira dhe kjo është një gjë që e vlerësoj masivisht tek ti. Ke një shpirt kreativ dhe plot ngjyra. Gjithkush do ishte me fat të kishte një shoqe si ty. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe suksese në jetë zemër! -Kejsi Hidaj



Denis Prenga

Nga Aureli: Ti je një djalë që pak persona të njohin. Je gazmor dhe I lezetshëm. Për mua je një shok i paharrueshëm. Të uroj suksese të mëdha në të ardhmen!

Nga Bora: Denisi është kushëriri im dhe e njoh që të vogël. Është një djalë shumë i mirë, i sjellshëm dhe që të dhuron të qeshura pafund. Ishte kënaqësi për mua që në vit të tretë të ishim bashkë në një klasë. Ju uroj shumë suksese në rrugëtimin e mëtejshëm!

Nga Bela: Do të mbaj mend për shakat e bëra në orën e mësimit, si me nxënësit por edhe me mësueset. Je një djalë shumë i mirë e pozitiv. Të uroj shumë suksese në rrugëtimin tënd.

Nga Detjoni: Xio shife se po të kërkon... Viti i fundit që qeshim dhe kënaqemi në shkollë zemra. Çdo gjë që kemi bërë bashkë, më ka pëlqyer sidomos humori yt: qoftë për mirë, qoftë për keq. Do t'i mbajmë kontaktet kudo që të shkojmë dhe do t'i rikujtojmë sërish gjithçka që kemi bërë dhe do themi me vete "Sa budallenj paskemi qenë". Sukseseee në çdo hap të jetes!

Nga Elvi: Një nga njerëzit më të drejtpërdrejtë që njoh. Shakatë e tua do më mbesin në mendje dhe të falenderoj shumë për momentet e bukura që kemi kaluar. Të uroj më të mirat dhe suksese në vazhdimësi.

Nga Ema: Aftësia jote për të bërë një shaka në çdo situatë ka qenë një ndihmë e vërtetë për stresin. Do ta kujtoj gjithnjë sensin tënd të humorit. Shpresoj që e ardhmja jote të jetë e mbushur me sukses!

Nga Enio: Denisi, një djalë me karakter unik, i sjellshëm, që gjithmonë kërkon të krijojë situata

pozitive dhe gazmore. Përvëç këtyre, je dhe një djalë i respektueshëm. Të urojsuksesekudoqëtëshkoshnëjetë!

Nga Ergi: Denis, natyra jote zemërmirë dhe pozitiviteti yt kanë qenë pjesë shumë e rëndësishme e jona. Ti çdo ditë përcillje mirësi dhe humor, me të cilën ne kalonim ditën. Jam shumë mirënjohës që të kam njohur dhe shpresoj që të plotesosh ëndërrat e tua kudo që të shkosh. Mezi pres të shoh gjërat e mrekullueshme që do të arrish.

Nga Kejsi: Epiqendra e kaosit të klasës, por pa të klasa nuk do të ishte e njejtë. Është një djalë i sjellshëm, pozitiv dhe shumë i sinqertë, që e vlerësoj shumë te nje mik. Shakatë e tij janë fantastike dhe gjithmonë gjen një menyrë se si ta nxjerr klasën nga ajo monotonia e ditës. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe suksese në jetë.

Nga Klenisa: Denis, entuziazmi yt dhe natyra zemërmirë e spontane, kanë lënë mbresa te secili prej nesh. Ndërsa nisim këtë kapitull tjetër të jetës sonë, nuk kam asnjë dyshim se do t'i plotësosh të gjitha synime e tua dhe mezi pres të shoh gjërat e mrekullueshme që do të arrish.

Nga Klesjani: Denisi është një shtesë e shkëlqyeshme në klasën tonë këtë vit. Me një qëndrim të hapur dhe miqësor, ai ka bërë shpejt miq të rinj. Ai ka një energji tërheqëse dhe një dëshirë të madhe për të mësuar dhe për të bashkëvepruar me të tjerët. Suksese në rrugëtimin tënd pas shkollës!

Nga Ergysa: Veriori klasës. "Mos u zgjat më se e ke tepër pakëz fare". Je një djalë shumë gazmor dhe i zgjuar kur do. Të uroj shumë suksese në rrugëtimin tënd Denis!

Nga Sibora: Një djalë serioz në pamje të parë e i dashur me personat që do. Humori e vendosmëria të karakterizojnë e të bëjnë të veçantë. Uroj të të plotësohen të gjitha ëndërrat dhe dëshirat! Suksese kudo që shkosh në çdo hap të jetës!

Nga Vera: Gjatë vitit të dytë që ndamë klasën bashkë, mësova shumë gjëra nga ti. Mësova si të jem më e zgjuar në menaxhimin e situatave dhe si të jem më e duruar pavarësisht rrethanave të shumta plot sfida. Shoqërinë tonë e kam konsideruar gjithmonë si të shenjtë pasi me të vërtetë e kam vlerësuar përkushtimin dhe vëmendjen tënde ndaj personave që doje. Të vlerësoj për gjithçka dhe të uroj suksese!



Klenisa Keshi

Nga Ema: Këto vite kanë qenë vitet më të bukura për mua, vite të cilat e di se do të mbeten në memorien time përherë. Pjesë shumë e rëndësishme e tyre ishte dhe ti. Shoqe te ngushta që në vit të parë, kemi kaluar cdo gjë bashkë dhe mendoj se do të jetë kështu edhe për një kohë të gjatë. Që në fillim e dija që ishte bjondja më e bukur që do shihja. Nuk mund të rri dot pa buzëqeshur kur kujtoj shakatë tona dhe momentet e bukura që kemi kaluar. Nuk e mendoja se këtu do të takoja shoqen time më të mirë, por jam mirënjohëse që ndodhi kështu. Diçka të fundit, mos më pyet më, se floket i ke gjithmonë shumë mirë. Faleminderit që i bërë vitet e mia të gjimnazit dhe më të bukura!! Ky nuk është fundi, pres të bëjmë sa me shumë kujtime së bashku.

Nga Bela: Një ndër arsytet se pse unë vija në shkollë, një vajzë kaq e zgjuar, talentuar, e bukur dhe pozitive. Pata fatin të të njihja që në fillim të vitit të parë dhe që atëherë kemi qenë të pandashme. Më ke zbuluar tre vite të gjimnazit duke më dhuruar kujtime të paharrueshme. Të falenderoj për cdo herë që me je gjendur pranë, për cdo paqartësi ose problem që unë kam patur. Kujtimet tona për mua do të mbeten gjithmonë në mendjen dhe zemrën time pavarësisht se rrugëtimit tonë të gjimnazit po i vjen fundi. Faleminderit që më ke mësuar për cdo personazh dhe më ke thënë çdo thashethem të qytetit tënd. Dhe pse këtij rrugëtimit po i vjen fundi, ne do të vazhdojmë të jemi përsëri shoqe shumë të mira. Të vlerësoj pafundësisht shumë dhe të uroj suksese të mëtejshme dhe pse unë e di që ti do ja dalësh mbanë gjithmonë.

Nga Barjena: O klenis, o vajzë misterioze. Më ka bërë gjithnjë përshtypje finesa jote, dukesh e qetë dhe sikur kursen treçerekun e fjalëve, por në të njëjtën

kohë duartrokisje idetë apo planet e mija më mizore. Kemi qeshur pafund, aq sa na kanë dalë versionet më të shëmtuara të të qeshurave (s'mund të rrimë gjithë kohën misterioze dhe me klas). Faleminderit që ke qenë pjesë e gjimnazit tim, s'do të ishte njësoj pa ty. Shpresoj që një ditë të arrijmë majat. (p.s. normal që do të të pres ne Mynih, do përdorësh të njetin navigator me të cilin desh humbëm në Tiranë?)

Nga Bora: Jam shumë e lumtur dhe me fat që në jetën time kam njohur një person si Klenisa. Ajo që e karakterizon Klenisën është pozitiviteti dhe qetësia që të jep që në herën e parë që e takon. Me Klenisën kam krijuar një marrëdhënie shumë të veçantë dhe shpresoj që të zgjasë. Shpresoj që t'i arrish të gjitha synimet që i ke vendosur vetes!

Nga Ergi: Klenisa, shoqja ime e bankës. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë për mua, për durimin që ke kundrejt meje dhe për detyrat që mi jep gjithmonë. Ti je një vajzë shumë e sjellshme dhe plot mirësi. Të karakterizon një buzëqeshje që percjell pozitivitet tek të tjerët. Jam shumë mirënjohës që të kam njohur dhe shpresoj që miqësia jonë të zgjas shumë. Të uroj gjithë të mirat dhe shpresoj që ti plotësosh ëndrrat e tua.

Nga Jasmina: Si fillim të kërkoj falje për cdo herë që të kam bezdisur në lidhje me detyrat. Tani ç'mund të them për ty: e bukur, e qeshur, pozitive, e zgjuar, e sjellshme, besnike etj. Gjithmonë më bën të qesh me batutat e tua, që i thua në vendin e duhur dhe në kohën e duhur. Mendimet që gjithmonë na janë përputhur, tregojnë raportin tonë të bukur. Jam mirënjohëse për vitet që kemi kaluar së bashku dhe shpresoj të vazhdojmë njësoj. Uroj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe suksese në të ardhmen!

Nga Detjoni: Besti i fundit. Dhe me ty besti, jo shumë kohë bashkë, por të kam shoqe shumë të mirë. Faleminderit për detyrat e ekonomisë edhe pse i kishe gabim një ditë:) Të uroj të qeshësh gjithmonë!



Sofia Stavri

Nga Debora: Me Sofian jam njohur në fillim të vitit të dytë, të rrugëtimit në gjimnaz dhe mund të them se që atëherë, jemi bërë shoqe mjaft të afërta. Ju keni qenë dhe ende jeni një suport shumë i madh për mua dhe nuk mjaftojnë fjalët për të përshkruar vlerësimin dhe respektin që kam për ju. Do t'iu mbaj mend gjithmonë si një vajzë shumë energjike dhe mendjehapur. Ju uroj suksese në rrugëtimin që do të ndërmerrni pas gjimnazit dhe jam e lumtur që do të jem aty për të parë çdo hap që do të hidhni!

Nga Elvi: Vajzë shumë e zgjuar dhe e sjellshme. Pavarësisht se e re në klasën tonë, arrite të përshtateshe shumë thjeshtë me ne duke u bërë pjesë e klasës pa problem. Të uroj suksese dhe shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat që ke.

Nga Kejsi: Është një vajzë bukuroshe dhe shumë pozitive. Shpreh gjithmonë mendimin e saj në lidhje me çështje të ndryshme dhe është natyrë ngulmuese dhe e vendosur. Është një person ku mund të shprehesh lirisht për probleme të ndryshme, ajo gjithmonë të dëgjon dhe përpiket që të të ndihmojë në zgjidhjen e tyre. Edhe pse nuk kemi shumë kohë që jemi njohur bashkë, kam kuptuar që je një shoqe shumë e mirë për ta pasur në rrethin shoqëror. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe suksese në jetë zemër!

Nga Sibora: Njihemi tani prej dy vitesh e jam mirënjohëse për çdo moment që kemi kaluar me njëra-tjetrën. Aftësitë e tua në "design" i ke po aq të mëdha, sa do të kesh edhe suksesin në ëndrrat që po bën realitet. Të uroj me gjithë zemër që çdo hap që ti hedh të të bëjë akoma e më të lumtur dhe krenare për ato që po arrin! Me dashuri, Sibora!

Nga Vera: Që në momentin e parë që u takuam më përcolle një ndjesi shumë sublimë dhe autentike në llojin tënd. Mund të them se me fjalët e tua të ëmbla më bërë për vete. Me pozitivitetin dhe çiltërsinë tënde, bisedimet që bënim kalonin shumë shpejt dhe shumë këndshëm. Për mua në këtë eksperiencë 3-vjeçare je personi më i sinqertë dhe më i drejtpërdrejtë në vendimet dhe fokuset e tua. Kam shumë besim që ke një forcë të pathyeshme dhe një potencial shumë të suksesshëm e dashur.

Nga Elena: Sofia, me këtë dedikim dua të shpreh mirënjohjen time për angazhimin dhe durimin tënd në rrugën e arsimit. Suksese në të ardhmen!

Nga Anxhela: Sofia, ju kam parë gjithmonë si një vajzë moskokëçarëse dhe te guximshme. Këto janë cilësi që ju veçojnë padyshim. Nuk dua të lë pa përmendur edhe faktin se jeni shumë e talentuar dhe pozitive. Të uroj suksese në rrugëtimin që do të zgjedhësh!

Nga Kaila: Edhe pse s'kemi shumë kohë që njihemi, të kam shumë përzemër, sepse je shumë e dashur dhe një vajzë me shumë sedër. Je e matur kur duhet dhe më pëlqen shumë kjo cilësi e jotja. Të uroj suksese të mëtejshme.

Nga Sabjani: Ti je motra ime që prindërit nuk ma dhanë. Më shan shumë, po e di që më do të mirën gjithmonë. Ta dish shumë mirë që ke mundësi të bëhesh më shumë se dikushi në jetë. Kam shumë besim te ty dhe aftësitë e tua. Thashethemet më pikante gjithmonë do i bëjmë bashkë. Mos u mërzit kur të flas se ndonjëherë më bie damari e di ti. Të puth fort Haska!

Nga Alisia: Për Sofian, një mikeshë e shkëlqyer që njeh stilin dhe modën si askush tjetër. Faleminderit që me je gjendur gjithmonë pranë. Të uroj shumë suksese!

Nga Adelajda: Sofia një vajzë e fortë, e dashur, miqësore dhe e mirë. Një njeri që të mbështet dhe të qëndron pranë gjithmonë. I uroj suksese dhe shpresoj që dëshirat e saj të bëhen realitet.



Ema Mara

Nga Klenisa: Që nga momenti kur u njohëm, ishte sikur universi kishte planifikuar për të na bashkuar. Ky afrim i menjëhershëm dhe të qeshurat që ndamë, përcaktuan lidhjen tonë të jashtëzakonshme. Ti je vajza më e zgjuar që kam takuar ndonjëherë dhe unë frymëzohem vazhdimisht nga përkushtimi yt për të mësuar, etja jote për dije dhe kërkimi për përsosmëri. Ti nuk ke qenë vetëm një model për mua, por një shoqe e vërtetë që ka qenë gjithmonë aty për të më ndihmuar kur kisha nevojë, një partnere studimi ose thjesht një vesh që më dëgjonte. Faleminderit që je shoqja ime më e mirë! Unë e vlerësoj miqësinë tonë më shumë sesa mund ta shprehin fjalët dhe jam e emocionuar të shoh se ku na çon jeta. Pavarësisht se ku shkojmë apo çfarë bëjmë, një gjë është e sigurt, miqësia jonë do të vazhdojë të jetë edhe më e ngushtë. Do të jem pranë teje në çdo hap teksa ti arrin majat dhe synimet që i ke vënë vetes!

Nga Bora: Ema është personi i parë me të cilën jam prezantuar dhe kam biseduar kur u bëra pjesë e kolegjit. Është një vajzë që karakterizohet nga durimi, qetësia dhe mirësjellja. Jam e lumtur dhe me fat që të kam njohur dhe tashmë je pjesë e jetës sime. Shpresoj që kjo miqësi të zgjasë me vite të tëra dhe të uroj suksese në rrugëtimin tënd të ardhshëm!

Nga Bela: Një nga shoqet e mia të ngushta që nga viti parë, për të gjitha të qeshurat, kohët e bukura, momentet e vështira të cilat më ke qëndruar pranë dua të të falenderoj. Pavarësisht ditëve jo të mira që kemi kaluar, ti gjithmonë bëje ndonjë batutë dhe më qëndroje afër. Do të mbaj mend gjithmonë të gjitha momentet e bukura që kemi kaluar tek shkallët e shkollës dhe orët e fiskulturës. Ndihej shumë me fat që kam patur mundësinë të njoh dikë si ju, kaq të sjellshme,

pozitive, të buzëqeshur, ndihmuese, e zgjuar e të bukur si nga brenda ashtu dhe nga jashtë. Të falenderoj që më ke zbuluar e lehtësuar kaq shumë këto tri vite të paharrueshme të cilat do jenë pjesë e kujtimeve të mia përgjithmonë. Edhe pse rrugëtimi jonë i gjimnazit po vjen afër përfundimit, skam asnjë dyshim që shoqëria jonë do vazhdojë dhe më tej. Të uroj shumë suksese në rrugëtimin tënd dhe pse e di që ju ja dilni mbanë pavarësisht gjithçkaje.

Nga Denisi: Vajza më e qetë dhe e urtë që na dhuroi shoqëri për tu ambjentuar me klasën e re. E falenderoj që nuk nevikoset asnjëherë me mua edhe pse mund ta pyes mbi 5 herë/orë mësimore: "Edhe sa minuta bie zilja". Ema është një vajzë e sjellshme që përcjell edukatë dhe kulturë kudo. I uroj një rrugëtim sa më të mbarë në këtë kapitull të ri që po vjen përpara.

Nga Detjoni: Një nga bestit. Edhe pse kemi pak muaj që jemi njohur, përsëri të kam shoqë shumë të mirë dhe më duket sikur kam tërë jetën që të njoh. Faleminderit për çdo moment që më ke bërë të qesh dhe për çdo detyrë gjithashtu. Të kam shumë xhan dhe të uroj më të mirat!

Nga Ergi: Ema, ju jeni një nga pesonat më të zgjuar dhe më të sjellshëm që më ka sjell ky rrugëtim. Një vajzë e mrekullueshme, që perpiqesh gjithmonë të përcjellësh pozitivitetin tënd dhe të ndihmosh të tjerët. Jam shumë mirënjohës që të kam njohur dhe shpresoj që lumturia dhe suksesi të jenë pjesë e rrugëtimin tënd!

Nga Barjena: Emushee, më lind instiktivisht nevoja të të përqafoj sa herë që të shoh. Sdo t'i harroj kurrë bisedat tona që nisnin si një bashkëbisedim normal e përfunonin në analiza të thella psikologjike dhe me 5 pako biskota të mbaruara mbi tavolin. Kemi qeshur shumë dhe se imagjinoj sa më shumë do të kishim qeshur nëse do të ishim në të njëjtën klasë. Mezi pres të vij të shtrihem te divani klinikës tënde kur te behesh doktoresh, ama kjo qëndron në të ardhmen, pasi tani për tani sja kemi nxjerrë akoma bojën sendiljes së pasagjerit të makina jote e re. Të kam pafund xhan dhe do të jesh gjithnjë mikesh e imja <3

Nga Anxhela: Vajza së cilës i 'shkon më për shtat' shprehja: 'Buzëqeshja, pasqyra e shpirtit'. Zgjodha ta nisja kështu, sepse e shoh si mënyrën më të mirë për të përshkruar atë çka ju përfaqësoni. Gjithmonë pozitive dhe e dashur, ia keni arritur të jeni një ndër karakteret më të spikatura të klasës. Do t'iu kujtoj gjithmonë për mirësinë që rrezatoni. Ju uroj shume suksese dhe jam e sigurt që rrugëtimi juaj do të vazhdojë të jetë i ndritur!



Kreisa Guçe

Nga Elvi: Do të më kujtohen përherë bisedat që kemi bërë së bashku, duke këshilluar njëri – tjetrin dhe duke i shoqëruar ato me shaka dhe humore që ndoshta vetëm për ne bënëin kuptim. Të falenderoj për këto tri vite që kemi kaluar së bashku duke më ndihmuar gjithnjë. Pa dyshim një ndër vajzat më positive dhe të qeshura të klasës. Të uroj shumë suksese!

Nga Ergi: Teksa këtij rrugëtimi po i afron fundi, doja të të falenderoja për gjithëçka që ke bërë për mua. Ti je një person shumë i sjellshëm dhe gjëja e vetme që mendon është si të ndihmohet të tjerët dhe për këtë të adhuroj. Je treguar e zgjuar dhe një vajzë që është gjithmonë e gatshme për të dhënë dhe për të mbrojtur mendimin e saj. Të uroj suksese në çdo hap të jetes tënde.

Nga Kejsi: Është një vajzë bukuroshe dhe shumë positive. Kreativiteti është një nga pikat e saj më të forta dhe kjo gjë pasqyrohet gjithashtu dhe në projektet e ndryshme shkollore që dorëzonte. Ka ide “crazy” ashtu siç ka dhe vetë emrin, por shumë të lezetshme. Gjithmonë është në dispozicion për të ndihmuar të tjerët duke i dëgjuar dhe duke i ofruar këshilla të cilat janë shumë të vlefshme. Çdo ditë është furnizuar me energji të mirë të cilën ia transmeton dhe të tjerëve në një mënyrë ose tjetrën. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe suksese në jetë krejkej<3!

Nga Kaila: Shoqja ime më e mirë e gjimnazit të cilën unë e dua shumë. Vajza me të cilën jam njohur që në ditën e parë të shkollës dhe më ka hyrë në zemër që atëherë. Të falenderoj që gjithmonë më ke qëndruar pranë. Asnjë ditë nuk shtyhet pa ty. (shyqyr që nuk mungon shpesh)

Nga Anxhela: Pozitive, e çiltër, lozonjare, e edukuar dhe shumë e sjellshme. Këto janë disa nga cilësitë me të cilat do t’iu përshkruaja. Jeni me të vertetë një mike e veçantë, që ma ka zbukuruar rrugëtimin e këtyre tri viteve. Të uroj nga zemra një të ardhme sa më të bukur dhe plot suksese në vijim!

Nga Ergysa: Kreis, herët që bëjm debate bashkë nuk numërohen por prap e gjejmë zgjidhjen. Ke gjithmonë energji pozitive dhe je e gatshme për të ndihmuar në çdo moment. Je tepër e ëmbël në fytyrë, po dhe shumë e zgjuar. “Si mi mban ato shënime aq të organizuara aq me rregull”. Nuk e di nga të buron e gjithë ajo energji që ke, por shpresoj të jesh e tillë gjithmonë. Uroj t’i plotësohen dëshirat që ke Kreiss<3

Nga Sibora: Të gjitha ato biseda të shkurtra gjatë pushimit dhe ato të tjerat që zgjasnin me orë të tëra nuk do t’i harroj kurrë. E kam nisur çdo ditë me pozitivitet prej përfaqimeve e puthjeve të tua të ngrohta, që më prisnin në mëngjes sa hyja në klasë dhe me beso se për ato do të më marrë malli jashtë mase shumë. Je një shoqe që çdokush do të donte ta kishte pranë, sepse ti je aty në ditë të vështira ashtu siç je në momente lumturie. Kur jam me ty më duket sikur jemi rritur bashkë sepse çdo gjë na përputhet e prandaj ndihem aq mirë në çdo kohë. Shpresoj shumë që edhe jo vetëm tani, por të diplomohemi bashkë dhe në universitet. Të uroj sinqerisht të arrish çdo gjë që ke ëndërruar ne jetë! Me shumë dashuri, Sibora!

Nga Fiona: Goca më e ëmbël që ma ka zbukuruar këtë vit shkollor. Kemi kaluar shumë kohë të bukura së bashku duke bërë thashetheme e duke krijuar momente nga më gazmoret;) Të uroj suksese zemraaaa kudo në jetë!<3

Nga Sabjani: O KUSHO, ne jemi picariatët më të mirë në univers. Të kam shumë xhan dhe ti e di. Më acaron me ato sjelljet e tua, e di vetë ti. Mos u bëj naive dhe impulsive, vetëm pozitivitet. Të uron kusho sa më shumë suksese në jetë dhe të bëhesh ajo çka dëshiron!

Nga Kiara: “Hë mi, ke humbur fare!” Kreisa një vajzë e dashur dhe pozitive që gjithmonë e gjen mënyrën për t’i marrë situatat me shumë sportivitet, gjë të cilën kam filluar ta bëj pjesë timen. Sinqerisht ma bën ditën më të lumtur me ato komplimentet e tua që nuk mungojnë asnjëherë. Shumë suksese zemër! Kiara<3



Sibora Hysenaj

Nga Elvi: Përherë e qeshur dhe e qetë, gjithmonë do të kujtoj si një person zemërgjerë, që dukej sikur nuk mërzitej asnjëherë për asgjë. Të uroj suksese në të ardhmen dhe të jesh sa më e lumtur!

Nga Ema: Kujtimet tona do të mbeten gjithmonë si një pjesë e bukur e kujtesës sime. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për miqësinë tonë gjatë këtij viti shkollor. Suksese në çdo rrugë që do të ndjekësh përpara!

Nga Enio: Sibor, edhe pse skemi shumë që njihemi, për aq sa të kam njohur je një vajzë e kulturuar, e zgjuar dhe sistematike, që shfaq kudo dhe në çdo çast pozitivitet. Të uroj suksese kudo që të shkosh në jetë!

Nga Ergi: Sibora, gjatë këtij rrugëtimi ke treguar që je një vajzë e zgjuar, inteligjente dhe e qetë. Ndërsa nisim këtë kapitull tjetër të jetës sonë, nuk kam asnjë dyshim se do t'i plotësosh të gjitha synimet e tua dhe mezi pres të shoh gjërat e mrekullueshme që do të arrish.

Nga Kreisa: Sibora jam shumë mirënjohëse që të kam njohur. Je një vajzë me zemër të pastër dhe nuk tregohesh asnjëherë negative, duke u munduar që çdo gjë ta kalosh me pozitivitet. Gjithashtu jep perqafime shumë të mira dhe që ma bëjnë ditën më të bukur.

Nga Klesjani: Je një ndër vajzat që sa herë kam pasur nevojë për ndihmë, ti më ke ndihmuar. Me zgjuarsinë tënde ti bën që çdo ushtrim i vështirë të jetë i thjeshtë dhe për këtë gjë unë të falenderoj pasi më ke ndihmuar në momentet e mia më të vështira. Të uroj sukses në çdo vendim të jetës tënde!

Nga Ergysa: Sibora, edhe pse na u bashkove në vit të

fundit të gjimnazit më ke lënë një përshtypje shumë të mirë. Je shumë e sjellshme dhe inteligjente. Në pamje të parë dukesh e urtë, por nuk ke ndrojtje të flasësh aty ku duhet. Uroj të vazhdosh ta ruash qetësinë tënde dhe mos ta prishësh terezinë për asgjë. Të uroj shumë suksese në jetë!

Nga Vera: Me thënë të drejtën më ke lënë shumë përshtypje që në fillim me karakterin tënd shumë social dhe fleksibël me këdo. Më ke pëlqyer shumë me atë aurën tënde të qetë që rrezatoje gjatë orës së mësimi dhe gjatë bisedave që bënim bashkë. Po ashtu tipar dallues ke patur atë buzëqeshjen, me ato sytë e vegjël që shfaqin vetëm mirësi. Të uroj fat dhe suksese në rrugëtimin dhe karrierën tënde!

Nga Kaila: Edhe pse kemi vetëm një vit që njihemi, prapë je një nga shoqet e mia më të mira. Ke një karakter shumë tërheqës dhe pozitiv dhe gjithmonë më dëgjon. Asnjëherë nuk mërzitesh nga shakatë e mia edhe pse unë i ekzagjeroj pak. Uroj që të të plotësohet çdo dëshirë!

Nga Anxhela: Ajo çka më ka bërë përshtypje tek ju, është puna e palodhur e sistematike. Ju kam vlerësuar gjithmonë për këtë fakt e jo vetëm. Sdua të lë pa përmendur edhe edukatën që shfaqni në çdo rrethanë. Ju uroj suksese në rrugëtimin tuaj!

Nga Fjona Duka: Sa herë që duhet të shkruaj dicka për ty, gjithmonë e kam të vështirë, sepse mendoj që asnjë fjalë nuk mund të shprehë mjaftueshëm se sa e rendësishme je për mua! Bora, nëse do më duhej ndonjëherë të flisja për të mirën në jetën tonë, do të të përmendja më shumë se një herë si gjë e mirë në jetën time, sepse tek ti kam gjetur një shoqe, të cilën nuk e kam vec shpatull ku të mbështetem, por edhe një njeri që më frymëzon. Nuk e di nëse ndodhitë në jetën tonë janë të shkruara apo jo, por sa herë mendoj për miqësinë tonë, mendoj që kemi qenë të destinuara të bëhemi shoqe të ngushta që prej fillimit. Faleminderit Bori që më gjithmonë je aty për mua, që më dëgjon, që më ndihmon dhe që je kjo që je: mikja më e mirë që mund të kërkoja. Jam pafund fatlume që të kam takuar! Melek, gjithmonë do të shpresojë më të mirën dhe më të bukurën për ty! Nuk e di se çfarë kam bërë për të merituar miqësi kaq të bukura dhe të mrekullueshme në jetën time! Vazhdo shkëlqej dhe dije që gjëra shumë të bukura të presin! Të dua pafund!



Elvi Shehi

Nga Bora: Elvi i ka dhuruar pozitivitet dhe të qeshura klasës që në fillim. Më ke dhuruar te qeshura në çdo moment me imitimet e batuata e tua edhe atëherë kur kam qenë e mërzitur. Uroj që jeta juaj të vazhdojë të jetë e mbushur me gëzim në çdo hap!

Nga Denisi: Djali që na bën të gjithëve për të qeshur kur nis të imitojë memet më të reja nga rrjetet sociale. Ai është shumë gazmor dhe social deri në momentin që ti i cënon ekipin e futbollit të Tiranës, ku mund të ketë ndryshim karakteri. Një shok mjaft pozitiv dhe i sjellshëm që do t'i uroja më të mirat e këtij rrugëtimi të ri që do nisim.

Nga Ema: Ti ke qenë burim të qeshurash, madje edhe në ditët më të vështira në shkollë dhe jam mirënjohese për të qeshurat e pafundme. Do të qesh gjithnjë kur të kujtoj imitimet e tua. Do t'i vlerësoj gjithnjë momentet që kemi kaluar bashkë. Shpresoj që e ardhmja jote të jetë e mbushur me shaka të pafundme!

Nga Enio: Tironsi më i fortë, regjizor, aktor, piktor, gjeograf, historian, matematicien, edhe shumë fjalë të tjera që marrin kuptim prej teje. Që në ditën e parë që jemi njohur e në vazhdim humori yt të linte për të dëshiruar, e bëje të gjithë klasën të qeshte. Të veçojnë gjithashtu dhe mendimet e tua, që janë aq brilante dhe të sofistikuara, sa na lënë të gjithëve të habitur dhe duke menduar sesa pa lidhje janë fjalët që ti thua. Le ti lëmë shakatë mënjanë, je një nga njerëzit më të mire që kam njohur, një shok i vërtetë që më ke qëndruar afër në çdo moment. Shumë faleminderit për këto vite që kaluam së bashku, vite që nuk do ti harroj kurrë. Paç sukses kudo që do të shkosh!

Nga Ergi: Që në ditën e parë te shkollës kur u njohëm

isha i sigurt që ti do te ishe pjesë e grupit tim shoqëror. Ti më mesove që librat, mësimi, notat nuk ishin pjesa më e rëndësishme e shkollës por miqësia, humori, momentet e gazmore. Prania jote ishte gjithmonë e nevojshme që grupi jonë të ishte i gjallëruar dhe plot pozitivitet. Unë do të jem gjithmonë mirënjohës për çdo gjë që ke bër për mua. Uroj që të gësh rrugen e duhur në jetë dhe ëndërrat e tua të plotësohen.

Nga Klesjani: Elvi është shoku që të gjithë do të donin ta kishin. Ai është gjithmonë aty për të sjellë buzëqeshje dhe gëzim në çdo moment. Me një humor tërheqës, ai bën që koha të jetë gjithmonë argëtuese. Nëpërmjet pranisë së tij, bën që momentet më të thjeshta të kthehen në kujtime të paharrueshme. Të uroj suksese në çdo zgjedhje të jetës.

Nga Ergysa: Shoku i bankës më i mirë. Një djalë shumë pozitiv dhe gallatë, por edhe serioz kur duhet. "Vdes fare" kur acarohesh me gjëra të kota, thua jo nuk bëj më ushtrime dhe pas pesë minutash je sikur nuk ndodhi gjë fare. "Mu po mpyt?" Po kë tjetër o Elviii, hajde se i di këto ti. Je sinqerisht shok shumë i mirë dhe uroj të të plotësohen dëshirat që ke!!

Nga Elena: "Kusho" Çfarë mund të them unë për ty e nga t'ia nis? Mos harro anjëherë sesa falenderuese jam për gadishmërinë tënde për të më bërë mua të lumtur. Vidjot, skeçet, filmat që ti ke idejuar u bënë një arsye e ardhjes time në shkollë me dëshirën më të madhe. Faleminderit që më mbrojtë nga "keqdashësit e mi" edhe pse ndonjëherë me dhunë. Humoret dhe batutat e tua do të qëndrojnë përjetë në mendjen time. Elv, përtej shakave ke qenë një nga personat më të rëndësishëm për mua përgjatë këtij rrugëtimi dhe jam shumë me fat që njoha një shok si ti. E sigurt mund të them se shkathtësia, intelijenca dhe pak manipulimi, do të bëjnë të arrish në skajet e suksesit.

Nga Anxhela: Elvi, një ndër miqtë më të mirë që më solli rrugëtimi i bukur i gjimnazit. Gjithmonë iu kam vlerësuar pa masë, për çiltërsinë dhe pozitivitetin që rrezatoni. Uroj që e tillë të jetë edhe jeta juaj, të pasqyrohet në çdo copëz të saj, ajo çka ju jeni. Nuk mund të lë pa përmendur edhe sensin tuaj të humorit, shakatë e momentet e bukura që kemi kaluar së bashku. "Xio" të uroj shumë suksese në rrugëtimin e mëtejshëm!



Elena Xhixho

Nga Bora: Në sytë e personave që nuk e njohin është një vajzë moskokëçarëse, por kur e njeh më mirë, e kupton se sa e brishtë është. Është një person që e kam vlerësuar shumë që në vit të parë. Një cilësi që e karakterizon Elenën është pozitiviteti që e shfaq në çdo kohë, në çdo moment. E pëlqej edhe natyrën e saj provokative që shfaq ndonjëherë. Do më mungosh shumë. Shpresoj që jeta të jetë e mbushur me gëzim dhe sukses!

Nga Elvi: Shoqja më e mirë që mund të kem patur ndonjëherë. E mbaj mend “kusho” se si ne u afruam që në fillim të shkollës dhe se si e mbajtëm shoqërinë tonë të pandarë deri në fund më të fortë akoma. Të falenderoj për çdo moment që kemi kaluar sidomos për çastet gazmore dhe për këshillat. Dua të dish që për mua je një person shumë i rëndësishëm dhe kujtimet që kemi lënë do të mbeten në mendjen time gjithmonë. Jam me fat që je pjesë e shoqërisë sime “Pufeta e vogël”.

Nga Enio: “Fratja prej korçe bre lalk”, për këto tri vite ke qënë një ndër shoqet e mia më të mira. Me një zemërgjërësi dhe çiltërsi që të karakterizon kudo që ndodhesh. Je një nga vajzat më të kulturuara dhe të sjellshme, por ndonjëherë kujton ose imagjionon se ke humor edhe di ti bësh te tjerët të qeshin me marrëzitë e tua, bravo për këtë gjë të respektoj. Krahas këtyre të jam shumë mirënjohës për momentet që më ke qëndruar afër. Shpresoj që të kesh sa më shumë suksese në jetën tënde dhe të arrish atë që ti do! Faleminderit për këto kujtime dhe vite të paharrueshme!

Nga Ergi: Që nga momenti kur u njohëm e dija që miqësia jonë do të ishte e pafundme. Elena, ti ke qënë dhe do të jesh një nga personat më të rëndësishëm në rrugëtimin tim. Prania jote plot pozitivitet dhe

buzëqeshja jote rrezatuese ishte një shtysë për mua dhe një pjesë shumë e rëndësishme e ditës time. Unë të vlerësoj ty dhe miqësinë tonë më shumë sesa fjalët mund ta përshkruajnë. Pavarësisht se çfarë bëjmë apo sesi rrugët tona ndahen miqësia jonë do të jetë e pafundme. Faleminderit që më ke ndihmuar në çdo hap të rrugëtimin tim dhe do të jem gjithmonë mirënjohës që je pjesë e jetës time. Do të jem pranë teje në çdo hap të rëndësishëm të jetës tënde. Te dua shumë, Nuci.

Nga Klesjani: Je shoqja më energjike, më e dashur, më e ndjeshme. Këto janë disa nga cilësitë e karakterit tënd unik. Në ditët e mia më të vështira ke ditur të më kthesh buzëqeshjen. Shpresoj që shoqëria jonë të zgjasë gjithmonë dhe të kem përkrah një shoqe me vlera të larta si ti. Të falenderoj për të gjitha momentet e bukura që kemi kaluar bashkë dhe shpresoj që shumë të tjera të na presin. Të uroj suksese në çdo hap të jetës tënde dhe shpresoj që të arrish suksesin që dëshiron dhe meriton!

Nga Ergysa: “Lena sa e qeshur je mbaroj fare kur të shohh”. Singërisht të kam shumë xhann. Faleminderit për të gjitha këshillat që më ke dhënë dhe moralet e pafundme që ndonjëherë dhe nuk janë dëgjuar (kërkoj ndjesë)... por të siguroj që nuk do t’i harroj. Në këto tri vite ke qënë një mikeshë që duhet pasur afër, me një pozitivitet që të bën për vete. Uroj t’i plotësosh të gjitha dëshirat që ke dhe të arrish sa më shumë suksese.

Nga Anxhela: Elena, një mike zemre që do të gëzojë gjithmonë një vend të veçantë tek unë. E tillë është edhe historia jonë që në gjenezë: “e veçantë”. Nuk e kisha menduar kurrë që gjimnazin tim do ta kaloja kaq bukur, e prezenca jote në të, i ka dhuruar këtij rrugëtimin një tjetër magji. E në fakt nuk habitem, s’kishte si të ndodhte ndryshe. Shoqëria me një Princëshë është e shkruar të jetë unike, siç edhe ti je. Mos harro kurrë që brënda vetes ke një forcë të jashtëzakonshme, tek e cila duhet të besosh dhe të mos kesh drojë për asnjë moment që ta shfaqësh atë. Faleminderit që nuk u lodhe për të përcjellë tek unë energjinë tënde shpërthyesë, e që ke qënë gjithmonë aty për mua. Të uroj nga zemra një rrugëtim sa më të ndritur, të cilin patjetër do ta dëshmoj, e s’do ndalem duke të thënë: “Shkëlqë”.



Kejsi Hidaj

Nga Debora: Para vitit të tretë bisedat e mia me Kejsin ishin të pakta, por fati e donte që të zgjidheshim në një klasë në vitin final të gjimnazit. Mund të them se kam fituar një shoqe të re me të cilën jam argëtuar jashtë mase gjatë gjithë këtij viti. Kam pasur mundësinë t'ju njoh më mirë, duke kuptuar kështu se jeni shumë e dashur me njerëzit rreth jush dhe se jeni një dëgjuese shumë e mirë. Ju uroj suksese në hapat tuaj të ardhshëm!

Nga Elvi: Si përherë me sinqeritetin dhe çiltërsinë që të karakterizon, je një ndër personat më të veçantë të klasës. Të falenderoj për ndihmat që më ke dhënë gjatë gjimnazit, si dhe për çastet e pharrueshme në klasë. Uroj të arrish dëshirat e tua në jetë dhe të jesh e lumtur përherë.

Nga Jasmina: Kejsi! Një mikeshë që më ke shoqëruar në çdo periudhë, si të keqe ashtu edhe të mirë. Shoqëria jonë ka filluar krejt rastësisht në bankën e fundit aty ku me këmbënguljen tonë vazhdojmë të jemi ulur. E adhuroj zemërgjerësinë tënde dhe tendencën që gjithmonë e ke për të ndihmuar njerëzit. Je një vajzë shumë e zgjuar dhe gjithmonë do e them për sa kohë ti këmbëngul për të kundërtën. Kurrë nuk do ti harroj momentet e 5-minutëshit, stresin që kalojmë së bashku në momentet kur pyetemi në mësim, të cilën pozitiviteti yt e ka bërë me të lehtë për tu kaluar. Uroj që kjo shoqëri e jona të vazhdojë për vite rradhazi. Shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe ëndërrat e tua!

Nga Klenisa: Në fund të një kapitulli të rëndësishëm, dua të të falenderoj për mirësinë dhe respektin që ke treguar këto tri vite. Ti je një vajzë tepër e zgjuar dhe e sjellshme me të gjithë. Çdo ditë në shkollë, në çdo

projekt grupi, dhe në çdo bisedë, ti ke treguar se si sjellja dhe mirëkuptimi shkojnë dorë për dorë. Duke të njohur, jam e sigurt se cilësitë e tua do të të çojnë në suksese të mëdha. E di që rrugëtimet tona mund të marrin drejtime të ndryshme, por une besoj që vlerat dhe sjellja jote do të vazhdojnë të ndriçojnë rrugën për ty dhe ata që do të kenë fatin të jenë pjesë e jetës tënde.

Nga Ergysa: Kejs ti je një vajzë e ëmbël, e urtë dhe shumë zemërmirë. Je gjithmonë e gatshme të ndihmosh të tjerët dhe tu qëndrosh pranë. Më pëlqen që në momente jo të mira flet aq qetë, ama di dhe ta ngresh zërin kur ndodh ndonjë padrejtësi. Një vajzë e zgjuar dhe e dashur si ti, ia vlen ta kesh shoqe. Të uroj gjithë të mirat në jetë Kejs!

Nga Vera: Tek ty e gjej me të vërtetë rëndësinë e atyre njerëzve që janë gjithmonë aty për ty në çfarëdolloj momenti të vështirë apo të lumtur. Me zemërgjerësinë tënde, më ke bërë të kuptoj që ne si qenie kemi realisht shumë nevojë për ndonjë fjalë apo mbështetje emocionale në periudha të caktuara. Ndaj të përgëzoj për këtë virtyt që ke dhe shpresoj fort të realizohet çdo objektiv që ke në sirtar.

Nga Elena: Vajzë shumë serioze, por pas atij serioziteti fsheh një shpirt të pastër e të dashur. Faleminderit që je treguar me mua gjithnjë e ëmbël dhe aq zemërgjerë. Ju uroj shumë suksese në rrugëtimin tuaj dhe shpresoj të plotësoni çdo dëshirë!

Nga Anxhela: Kejsi, jeni vërtetë një vajzë me karakter shumë të fortë. Kam arritur të zbuloj, se përtej ftohtesisë që shfaqni, fshihet një shpirt i bukur e i dhembshur. Janë pikërisht këto, cilësitë që kam vlerësuar gjithmonë tek ju. Suksese të mëtjeshme në rrugëtimin tuaj!

Nga Bora: Kejsi, vajza pozitive që ka qenë pjesë e shoqërisë sime. Mirësia dhe mirësjellja janë ato cilësi që të karakterizojnë. Do mbaj mend të qeshurat, diskutimet, por edhe nervat e tua ndonjëherë. Uroj që jeta jote të vazhdojë të jetë e mbushur me të qeshura dhe gëzim në çdo hap!

Nga Ema: Të falenderoj për mbështetjen tënde gjatë këtyre viteve! Do të të kujtoj gjithnjë si një person të dashur dhe një person që kujdesej gjithmonë për mua. Dua të rikujtoj kujtimet, gëzimin, sfidat që kemi kapërcyer së bashku. Le ta mbajmë këtë miqësi dhe në të ardhmen!



Ervi Bicaku

Nga Aureli: Në pamje të parë më je dukur si një djalë jo shumë i afruedhëm, por pasi të njoha kuptova që ke një zemër të madhe dhe bën shumë për shoqërinë. Mendoj që çdokujt i nevojitet një shok si ty!

Nga Bela: Je një ndër djemtë më të sjellshëm e pozitiv që kam njohur. Do të mbaj mend nga ju gjithmonë batutat që bëje, orët e fiskulturës që kemi kaluar duke bërë thashetheme dhe humorin tënd të zi herë pas here.. Të falenderoj për këto kujtime dhe të uroj shumë suksese në rrugëtimin tënd.

Nga Denisi: Ervi që ndryshe çunat I thërrasin “Boli”. Ervi është djali më pozitiv që mund të kem takuar këto tri vite rrugëtim, ku për çudi nuk kam arritur ta shoh ndonjëherë të mërzitur ose të nevrkosur. Gjendet aty gjithmonë për të bërë shaka, pasi sensi i tij i humorit është shumë i lartë. Në rrugëtimin e ri që ne do të nisim, unë për Ervin uroj vetëm suksese dhe të mira pafund. (Love you Boli)

Nga Detjoni: U bënë 14 vite me ty buçko dhe përsëri në klasë bashkë jemi. Si s’mu ndave një moment. Kemi kaluar çdo gjë bashkë, kemi qeshur kemi qarë, kemi bërë budalliqe nga më të ndryshmet dhe i kam shijuar secilën prej tyre. Dua të them që nuk dua të të humbas kurrë dhe të uroj më të mirat e kësaj jete, si dhe suksese të mëtëjshme në çdo hap të jetës. Të kam shumë xhan!

Nga Elvi: Një nga djemtë më pozitiv dhe argëtues të klasës. Megjithëse erdhe i ri këtë vit në klasën tonë, ti arrite të bëheshe pjesë e saj shumë shpejt duke u shoqëruar me të gjithë. Të falenderoj për këtë vit të bukur dhe shpresoj të takohemi përsëri. Të uroj suksese në jetë.

Nga Kreisa: Erv, je një person shumë i mirë. Ajo qetësia që ti ke është një nga gjërat që vlerësoj tek ti dhe fakti se bashkë me të vjen dhe një sens humori i fshehur. Të jam shumë mirënjohëse për shoqërinë që kemi krijuar në një kohë kaq të shkurtër.

Nga Klenisa: Ervi, gjithmonë ke spikatur me njohuritë e tua rreth fushave të ndryshme. Nuk ka fushë që nuk e njeh, nuk ka pyetje që nuk gjen përgjigje. Përveç zgjuarsisë, të karakterizon humori. Madje, edhe kur flije gjumë në klasë, ke pasur aftësinë të na bëjë për të qeshur. Ti je një djalë i ndritshëm dhe i sjellshëm. Të uroj suksese në të ardhmen dhe shpresoj që rrugëtimi yt të jetë i mbushur me lumturi.

Nga Ergysa: Erviii, jam e lumtur që kam njohur një shok aq të mirë sa ti. Je një djalë shumë pozitiv dhe sjell energji të mirë kudo. Faleminderit që gjithmonë më bën të buzëqesh kur jam e mërzitur. Uroj që rrugëtimi yt të jetë i mbushur me suksese dhe të realizosh të gjitha ëndrrat e tua.

Nga Ergi: Ervi, personi më pozitiv dhe më i sjellshëm që kam njohur këto tri vite. Jam shumë mirënjohës që të njoha në këtë rrugëtim edhe pse në vitin e fundit të gjimnazit. Ti je një djal i mrekullueshëm, ku përveç zgjuarsisë të karakterizon dhe humori. Te uroj suksese në të ardhmen dhe shpresoj që rrugëtimi yt të jet plot lumturi.



Enio Dervishi

Nga Aureli: Ti je shoku i bankës më i mirë që mund të kisha njohur. Ti më ke ndihmuar në çdo lëndë mësimore. Të jam shumë mirënjohës. Të uroj shumë fat në jetë!

Nga Bora: Këto tri vite më dhuruan shumë miqësi dhe një ndër to je dhe ti. Enio në memorien time do të mbahet mend si një djalë i sjellshëm, i kulturuar, i edukuar me të gjithë. Jam e lumtur që të njoha. Shpresoj të të shoh sa më lart dhe të suksesshëm në atë ç'ka ti vendos të ndjekësh!

Nga Elvi: Shoku i parë që fola sapo hyra në derën e shkollës sonë. Më duket sikur kanë kaluar shumë pak kohë, por që kemi parë dhe kaluar shumë gjëra të ndryshme sëbashku. Shakatë dhe aftësitë e tua prej një miku të vërtetë, do të të karakterizojnë përherë siç ke bërë çdo ditë në grupin tonë shoqëror. Të uroj më të mirat e kësaj bote dhe suksese në çdo gjë!

Nga Ema: Duke hyrë në këtë kapitull të ri, dua të shpreh mirënjohjen time për përvojat e përbashkëta dhe për këtë rrugëtim që kemi ndarë bashkë. Ke qenë një shok shumë i mirë gjatë këtyre viteve. Ky është një rikujtim i momenteve të lumtura që kemi kaluar në shkollë. Uroj që e ardhmja jote të jetë aq e ndritshme sa potenciali yt.

Nga Ergi: Që në momentin kur të takova e kuptova që ishe një person i sjellshëm, i zgjuar dhe i respektueshëm. Menjëherë mendova se miqësia jonë do të zgjasë shumë. Së bashku kemi kaluar momente të paharrueshme, plot të qeshura dhe gëzim, që nuk mund ti kaloja me asnjë person tjetër. Do të jem gjithëmonë mirënjohës për gjithçka që ke bërë për mua. Shpresoj dhe besoj që do t'i arrish të gjitha

synimet që i ke vendosur vetes.

Nga Klenisa: Enio, nuk mund të lë pa përmendur se je një djalë tepër i respektueshëm dhe i sjellshëm me të gjithë (përveç Klesjanit). Teksa nisim një rrugëtim të ri, shpresoj të të shoh sa më lart dhe të suksesshëm në atë ç'ka ti vendos të ndjekësh!

Nga Klesjani: Je një nga shokët e mi më të mirë. Me humorin tënd ti bën që çdo orë mësimi të kalojë pa e kuptuar. Më pëlqen fakti se je një djalë i shoqërueshëm me të gjithë. Do të doja që çdo moment që kemi kaluar dhe do të kalojmë, të jenë momente të paharrueshme. Të uroj suksese në çdo hap të jetës tënde!

Nga Ergysa: Enio ti je një shok dhe një djalë shumë i mirë. Bashkë kemi kaluar shumë momente të bukura gjatë këtyre tri viteve duke krijuar kujtime që do të ruhen gjithmonë në mendjen time. Jam e lumtur që të kam njohur. Uroj që rruga jote të jetë e mbushur me suksese dhe që t'i realizosh të gjitha ëndrrat dhe synimet e tua.

Nga Vera: Në fakt dedikimin mund ta nisja dhe ta përfundoja me vetëm dy fjalë: një djalë shumë i sjellshëm dhe serioz në momentet e duhura. Me atë egon tënde të justifikueshme, ke ditur të më bësh përshtypje. Dalloje nga të tjerët, përse i përket mënyrës se si i merrje me sportivitet situatat e papritura e me një vetëpërmbajtje tërëhëqëse.

Nga Elena: Frate jam shumë e lumtur që ky gjimnaz më njohu me një njeri si ti. Je thjesht model i një shoku të mrekullueshëm. Faleminderit Enio që me qëndrove pranë ato ditë që nuk isha vetvetja dhe faleminderit që më bërë te qesh dhe atëherë kur nuk e ndjeja. Qëndro kështu siç je për gjatë gjithë jetës tënde. Ta uroj me gjithë shpirt të arrish majat e suksesit se je munduar për atë ditë..

Nga Anxhela: Enio, padyshim një ndër djemt me karakterin më të veçantë, e një ndër miqtë e mi më të mirë. Nuk është aspak e vështirë të lexosh tek ty durimin, respektin e maturinë që ke. Me këto cilësi jam shumë e bindur që do të thurësh një rrugëtim të ndritshëm. Dua të të them, që je me të vërtetë një shembull i miqësisë dhe i asaj ç'ka një djalë duhet të jetë. Të falenderoj për mbështetjen dhe kohët e bukura që kemi kaluar! Të uroj shumë suksese në vijim "Fratee"!



Ergi Sejdi

Nga Denisi: Një nga cunat më të sjellshëm dhe social që mund të kisha njohur ndonjëherë. Tipi i tij është shumë elastik, gjë që e bën të përshtatet me çdo njeri dhe të shpërndajë respekt. Kjo është padyshim pika e tij më e fortë. Shpresoj që rrugëtimi që do të vazhdojme, të jetë sa më i suksesshëm për Ergin në çdo aspekt.

Nga Detjoni: Byro, dhe me ty jo shumë kohë bashkë, por më duket sikur të kam njohur gjatë gjithë jetës. Më pëlqen shumë sensi yt i humorit, si dhe energjia që kemi me njëri-tjetrin. Të uroj më të mirat si dhe të sfidoj shumë shpejt në bilardo.

Nga Elvi: Djali më i zgjuar dhe më i admirueshëm i klasës. Sa herë mund të kaloja një moment të keq, mjaftonte të më thojë një shaka nga ato që vetëm ti mund t' i dish dhe humori im do të ndryshonte komplet. Gjithmonë do jesh personi që nuk mund të të bëjmë dysh fjalën, për shkak të çiltërsisë, pastërtisë dhe sinqeritetit që të karakterizon. Gjithashtu, dua të shtoj që ke qenë një ndër shokët më të veçantë dhe më të dobishëm që kam patur ndonjëherë. Të falenderoj për këto tri vite fantastike dhe të uroj suksese në jetë!

Nga Enio: "Gjigandi prej Bulqize". Që prej ditës së parë që jemi takuar e deri më sot ke qenë gjithmonë i njëjti, një djalë me një sens të bukur humorit dhe ndonjëherë pa lidhje, i sjellshëm me të gjithë madje ndonjëherë më shumë seç duhet, mëndjemprehtë dhe në të shumtën e rasteve mëndjelehtë. Më erdhi keq që në vit të dytë ndryshove model flokësh dhe i bërë "buzz" cut, se me thënë të drejtën atëherë flokët të paktën ta bënin kokën të dukej e plotësuar dhe plot, tani mirë që ske as flokë, por ske as tru. I lëmë shakatë mënjanë, edhe pse janë gjysma e së vërtetës, përsëri je

nje djalë me vizion dhe nje shok i mrekullueshëm. Të uroj suksese kudo që të shkosh në jetë, te arrish atë që kerkon dhe te behesh personi që ti do.


Nga Ergysa: Ora e biologjisë nuk do të ishte e njëjtë pa ty. E tepruam pakëz fare me muhabetin, por ska gjë se ishte shumë i rëndësishëm... Je një djalë shumë i zgjuar dhe pozitiv. Habitem gjithmonë me përgjigjet e tua dhe për gjëra që zysha nuk i ka përmendur fare dhe menyra si kënaqesh sa here e thua saktë. Saktësia jote do mbahet mend dhe ato lapsuset e vogla them ti harrojmë. Të uroj shumë suksese dhe të mira në jetë Ergii!!

Nga Elena: Sa e vështirë të shpreh me fjalë se çfarë njeriu je ti. Nuk arrij as ta perceptoj se sa te zymta mund të ishin këto tri vite për mua, pa prezencën tënde. Ishte mrekulli të isha shoqja jote. Në ditët e mia më të këqija arrije t'i mbushje me pafund buzqeshje. Gjithmonë ke arritur të më falësh lumturi dhe di që kjo do jetë dhe në vazhdimsi. Ky gjimnaz më tregoi se njerëz si ti ekzistokan. Faleminderit për të gjitha "nuçi" im. Nga zemra shpresoj të arrish gjithçka që do!

Nga Anxhela: Nëse do të më duhej të përmblihdja me një fjalë, atë që ti na ke dhuruar të gjithëve gjatë këtyre tri viteve, do të ishte padyshim "pozitivitet". Ke treguar që di të jesh një djaë i matur, i qetë dhe mjaft mendjemprehtë në shumë situata. Të gjitha këto cilësi fshihen pas asaj buzëqeshjeje që nuk dite ta heqësh kurrë nga fytyra. Jam mirënjohëse për kujtimet e bukura që kemi krijuar dhe uroj të arrish sukseset më të larta në jetë!

Nga Ervi: Ergi je një shok i shkëlqyeshëm Me këtë dedikim, dua të shpreh mirënjohjen time për miqësinë dhe për faktin se ke qenë gjithmonë aty për mua. Faleminderit për çdo moment të këndshëm. Uroj që rrugëtimi yt të jetë plot me sukses dhe që miqësia jonë të vazhdojë të forcohet me kalimin e kohës.

Nga Keidi: Erdhi edhe rasti që të shkruaj një dedikim për ty byrazer. Nuk e mendoja kurrë se një shoqëri e ndërnuar në aq pak kohë, do të mund të zgjaste dhe të bëheshe një ndër shokët e mi më të mirë. U ulëm në një bankë sepse na detyruan duke e thirrur njeri-tjetrin "byrazer" me shaka, por sot krenohem me një shok si ty. Mos harro të përshëndesësh edhe shokët tanë nga Amerika, se unë për vete i kam bërë shumë të fala. Te priftë byro, Keidi.



Detjon Xhepi

Nga Bela: Per shokun më pozitiv që pavarësisht çdo gjëje ishe gjithmonë i buzëqeshur. Per ju nuk kishte rëndësi nëse kishe marrë një notë jo të mirë, ose nëse kishe kaluar një ditë të keqe. E kaloje atë me pozitivitet e të qeshura. Do kujtoj nga ju thashethemet që kemi bërë gjatë orës së fiskulturës e të gjitha batutat e bëra. Je një djalë shumë i sjellshëm e të uroj suksese të mëtejshme.

Nga Denisi: Deri më sot nuk kam njohur ndonjë person që shakanë ta kombinojë aq bukur me sarkazmën. Kemi krijuar një miqësi të fortë këto tri vite së bashku, aq sa mund të kuptohemi me shenja. "E o Detjon po të thërrasin". Shpresoj me gjithë zemër që ti vetëm të shkëlqesh në rrugën e zgjedhur. (Lali)

Nga Elvi: Një nga djemtë më argëtues e shakatorë që kam njohur ndonjëherë. Je një person shumë i sinqertë dhe i drejtë. Këto i vlerësoj shumë te ti. Edhe pse i ri në këtë klasë, arrite të përshtatesh shumë shpejt e të krijosh shoqëri me ne shumë thjeshtë. Të uroj suksese dhe t'ia kalosh sa më bukur!

Nga Ema: Edhe pse u bëmë shokë, besties dmth, vitin e fundit (gjë që nuk e prisja), ke qenë një ndër shokët më të mirë! Je personi më pozitiv që njoh. Do më mungojnë shakatë e tua dhe sensi yt i humorit. Gjithmonë e dija se mund të të tregoja gjithçka. Rrugëtimi ynë në shkollë është i mbushur me të qeshura, biseda (tea dmth) dhe momente te panumërta të paharrueshme. Do t'i kujtoj përherë këto kujtime, me premtimin se do të krijojmë dhe shumë të tjera! Te kam shumë xhan dhe të uroj vetëm lumturi në të ardhmen!

Nga Enio: Deto, edhe pse s'kemi shumë kohë që njihemi gjithmonë percjell një energji pozitive dhe gazmore kudo që merr pjesë, me humorin

tënd shumë "broken" që është në fakt dicka që të karakterizon. Do të mbaj mend përherë si një djalë që gjithmonë ta do të mirën dhe te respekton. Të uroj të gjitha të mirat e botës dhe të arrish atë që ti do.

Nga Ergi: Ky vit solli shumë momente dhe kujtime të bukura, por mbi të gjitha një shok të ri, të cilin e karakterizon humori dhe mirësia. Këto momente kanë qenë disa nga më të bukurat në këtë udhëtim dhe të jam mirënjohës. Ti je një person plot me pozitivitet, me një buzëqeshje të madhe të cilën e percjell edhe tek të tjerët. Jam shumë i lumtur që të njoha dhe shpresoj që gëzimi dhe suksesi të jenë gjithmonë pjesë e rrugëtimit tend.

Nga Kejsi: Një nga mistreca e klasës, por një djalë shumë i ëmbël dhe shakaxhi. Bën batuta superiore të cilat të gjithë i kanë shumë qejf. Është një djalë shumë i rrespektueshëm dhe gjithmonë transmeton energji pozitive te të tjerët. Gjithashtu faleminderit dhe për rosakun lejla lodër që më jepje gjatë ores së mësimit kur mërzhitesha. Shpresoj të të plotesohen të gjitha dëshirat dhe suksese në jetë!

Nga Klenisa: Ky vit solli kujtime të bukura, por dhe miqësi të reja. Më solli një shok të ri me të cilin kam ndarë mirësi, momente humori dhe të qeshura pafund. Këto momente do t'i vlerësoj dhe ruaj gjithmonë në kujtesën time. Detjon, teksa nisim këtë aventurë të re, shpresoj që jeta jote të jetë e mbushur me gëzim dhe sukses. Të sugjeroj të mos ndryshosh kurrë dhe të jesh pozitiv si gjithmonë!

Nga Ergysa: Je një djalë që të bën gjithmonë për të qeshur dhe nuk e prish terezinë tënde asnjëherë. Batutat e tua gjatë orëve të mësimit do të mbahen mend. Vazhdo të jesh po aq pozitiv sa je tani Detjon dhe shumë suksese në drejtimin që do të zgjedhësh.

Nga Ervi: Detjon, bashkë kemi qenë që në kopesht dhe këtë gjë nuk do ta ndryshoja kurrë. Ti asnjëherë nuk zhgenjen të bësh njerezit për të qeshur dhe kjo është një nga aftësitë e tua më të mira. Të uroj suksese në jetë!

Nga Jonuzi: Librazhdioti më i mirë nga të gjithë! Vllai im, kemi kaluar shumë kohë të bukura bashkë dhe ngjarje nga më të ndryshmet, që veshtirë se mund të harrohen. U bënë tri vite që të njoh dhe nuk ke ndryshuar aspak dhe shpresoj që të ngelesh gjithmonë Detjoni që asnjëherë nuk mërzhitet për asnjë gjë. Vllackoja im, pa e zgjatur shumë të uroj gjithë të mirat e kësaj bote dhe shumë suksese !!



Anxhela Demiri

Nga Bora: Senatorja më e mirë e cila na ka shoqëruar për dy vite radhazi. Personi që na ka mbështetur dhe na ka qëndruar pranë për të dëgjuar çdo shqetësim. Një ndër vajzat më të drejtpërdrejta që kam njohur. Një cilësi që karakterizon Anxhelën është forca e fjalës. Zotëron në perfeksion forcën e argumentit dhe të arsytimit. Uroj më të mirat për ty dhe shpresoj të të shoh sa më lart!

Nga Elvi: “Xio”, siç ne e kemi thirrur njëri - tjetrin që nga viti i parë. Jam shumë falenderues për të gjitha këshillat e ndihmat që më ke dhënë gjatë këtyre tri viteve shkollore, por më kryesorja janë momentet e bukura dhe argëtimet e pafundëta që kemi kaluar së bashku. Jam me fat që të njoha. Shpresoj të arrish aty ku ti do dhe të të realizohen të gjitha dëshirat që ke.

Nga Enio: Shkurt “Anxhi”. Që prej ditës së parë që jemi takuar në përsëritjet në fillim të shkollës, e deri në ditët e sotme ke qënë një shembull që besoj çdo vajzë duhet ta ndjekë. E sjellshme, e kulturuar dhe me një karakter të hekurt. Sëshhtë çudi që ke qënë senatore e klasës këto tri vite, përkundrazi ke aftësi për të qënë më shumë. Admiroj shumë seriozitetin, vetëbesimin dhe përkushtimin që ke, për gjëra të ndryshme, edhe të vogla të jenë por me shumë rëndësi, për mirësinë dhe shpirtin e bukur që dallohet në gjithçka që ti bën. Përbri këtyre, të jam mirënjohës për çdo moment që më ke bërë të ndihem më mirë dhe jam i bindur që e ardhjma jote do të jetë plotë ngjyra dhe arritje të larta. Faleminderit për këtë rrugë që nuk do të harrohet dhe të uroj suksese kudo.

Nga Ergi: Vajza më e sjellshme, më e drejtë dhe më e maturuar. Anxhela një nga shoqet më te mira që më ka sjell kjo aventurë. Pozitiviteti, përkushtimi dhe

gatishmëria jote për të qënë gjithmonë në krye dhe për të qënë zëri i klasës, janë cilësi që të dallojnë. Jam mirënjohës për çdo moment të bukur që kemi kaluar bashkë, uroj që kjo miqësi të zgjasë sa më shumë dhe mezi pres të shoh suksesin që do të arrish në të ardhmen.

Nga Kreisa: Anxhi ti je një person shumë unik. Je nga ata persona që i shohim si shembuj, sepse gjithmonë e ke një zgjidhje në mendje dhe mënyra sesi artikulon të bën të mbetesh pa fjalë. Bën pjesë në rrethin tim më të afërt dhe të jam mirënjohës për kohën që kemi kaluar së bashku.

Nga Klesiani: Ajo goca që na keshillon në çdo moment dhe na qorton në çdo gabim të mundshëm. Shoqëria me ty ka qënë shumë e veçantë. Të falenderoj për ndihmën që më ke dhënë në çdo veshtirësi që hasja. Të uroj suksese kudo dhe uroj që të arrish të gjitha ëndrrat e tua!

Nga Ergysa: Senatorja më e mirë! Je një vajzë shumë e zgjuar dhe inteligjente. Shumë faleminderit për çdo gjë që ke bërë për ne dhe se si mendon gjithmonë për klasën. Je shumë e duruar me ne, po atë udhëtimin tjetër kur e kemi..? Të uroj më të mirat dhe shumë suksese në rrugën që do të zgjedhësh Anxhi!!

Nga Elena: Ishe pikërisht ti që më tregove se shoqëria në gjimnaz nuk ishte aq e frikshme sa e kisha menduar. Të njoha në javën e prezantimeve dhe isha aq e lumtur që perceptimet dhe mendimet tona përputheshin. Totalisht nga “rastesia” u caktuam në një klasë. Senatorja ime e zemrës. Ndihma, përkushtimi, dashuria jote ndaj meje gjatë këtyre tri viteve do të jenë patjetër pjesë e paharruar e kujtesës sime. Faleminderit që asnjëherë nuk u lodhe për të më çuar shënimet dhe për të më treguar se gjimnazi duhej marrë më seriozisht. Jam shumë me fat që të njoha, Anxhela. Them me shumë bindje se do shkëlqesh në çdo cep që jeta do të perballë.

Nga Ema: Ndërsa hyjmë në një kapitull të ri të jetës sonë, dua të vlerësoj rolin që ke luajtur për ta bërë këtë rrugëtim të veçantë me mirësinë tënde. Ke qënë senatorja më e mirë të dyja vitet dhe ke qënë me ne në çdo hap. Do të kujtoj gjithnjë ndihmën që me ke dhënë pa hezitim. Të uroj gjithë suksesin e botës dhe pse e di se padyshim do të arrish majat!



Klesjan Hajdaraj

Nga Bora: Humori yt në këto tre vite gjimnaz nuk ka munguar në asnjë moment. Batutat e tua në çdo orë mësimore janë të paharruara. Klesjani është një djalë i sjellshëm, i edukuar dhe pozitiv. Shpresoj të të shoh sa më lart dhe të suksesshëm në atë ç'ka ti vendos të ndjekësh!

Nga Elvi: Më kujtohet që ditën e parë të shkollës se sa gazmor dhe social ishe me të gjithë. Do mbahesh mend gjithmonë si personi me humorin dhe harmoninë më të mirë. Për mua do të jesh gjithmonë ai shoku që sëbashku mund të kalojmë çdo minutë vetëm duke qeshur. Kles, je djali më i veçantë dhe më karizmatik që ka klasa. Dua të dish që unë do të jem aty për ty sa herë të kesh nevojë, ashtu siç ke bërë dhe ti për mua. Të uroj suksese në shkollë dhe më tej.


Nga Enio: Zoti Klesjan, me thënë të drejtën në fillim të vitit të dytë e mora vesh që ishe në klasën tonë kur më erdhe në bankë të parë, sepse kishe ngelur vetëm në bankën e fundit. Kur të pashë mu duke sikur bëra kontaktin e parë me një alien, por jo. Që nga ai moment dhe në vazhdim jemi bërë shokë. Vetëm se ti nuk u rrite kurrë mendërisht, por vetëm fizikisht. Përgjithësisht je një djalë i mirë, i kulturuar, pa sens humorit dhe pa llogjik. Vitet që kaluam sëbashku kanë qenë vite shumë të bukura dhe pavarësisht çdo gjëje do mbetesh një nga shokët e mi më të afërt. Faleminderit që më ke qendruar afër në çaste të ndryshme dhe më ke ndihmuar "keco". Suksese kudo që të shkosh në jetën tënde.

Nga Ergi: Në ditën që të njoha për herë të parë, menjëherë dallova pozitivitetin, humorin dhe mirësinë që përcillje tek të tjerët. Kemi kaluar shumë momente të bukura dhe plot humor së bashku. Që

nga dita e parë që të njoha e deri tani, të qeshurat dhe momentet gazmore nuk kanë fund. Edhe pse nuk je shumë i zgjuar, më ke dhënë një mësim shumë të rëndësishëm, që ndonjëherë kur nuk marim një rezultat që dëshirojmë nuk ja vlen të mërzitemi, por ta marim me pozitivitet. Shpresoj dhe besoj që do t'i arrish të gjitha synimet që i ke vendosur vetes.

Nga Elena: O kles qëndro gjithmonë kaq transparent dhe i sinqertë saç je. E adhuroj. Faleminderit për të gjithë të qeshurat që më fale kto vite. Jam shumë e lumtur që pata mundësinë të të njoh e për më tepër të të kisha pjesë të shoqërisë sime të ngushtë. Po e pranoj që Berati është më i bukur se Korça, por vetëm këtë herë. Të uroj me zemër më të mirat në jetën tënde.

Nga Anxhela: Klesjanii ose ndyshe ortaku im më i mirë "Don Keci". Gjithmonë ke qënë një mik i veçantë për mua, ekspresiv nga njëra anë, por edhe shumë i matur nga ana tjetër. Mbi të gjitha, kam vlerësuar gjithmonë zemrën e mirë që ke dhe pozitivitetin që fal. Uroj që të vazhosh një udhëtim të ndritur me këto ritme dhe të arrish aty ku ti do!









Jonida Stafa

Përshëndetje Klasa e 12 H!

Mbaroi dhe një vit tjetër shkollor, por këtë herë viti i fundit për ju. Pavarësisht se për disa nga ju ishte viti i parë dhe i fundit në kujdestari, për të tjerë ishte viti i tretë radhazi; ju ishit pjesë e një rrugëtimit të përbashkët. Është kënaqësi dhe emocion të shkruaj për klasën tonë.

Ju ishit një klasë me nxënës me personalitete të ndryshme, me shije të ndryshme, por me zemër dhe bashkëpunim të shkëlqyer. Gjatë këtij udhëtimit së bashku kam qenë dëshmitare e përkushtimit tuaj ndaj mësimëve, sjelljes suaj të shkëlqyer dhe respektit që keni treguar si ndaj mësuesve ashtu dhe ndaj njëri-tjetrit. Ju keni qenë një shembull i vërtetë për të tjerët dhe keni kontribuar në krijimin e një atmosfere pozitive dhe mbështetëse në klasë.

Arritjet tuaja akademike dhe përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar veten janë dëshmi e potencialit tuaj të madh për të ardhmen. Jam krenare për ju dhe jam e bindur se secili prej jush do të vazhdojë të shkëlqejë në rrugën që ka zgjedhur.

Ju uroj gjithë të mirat në sfidat e ardhshme dhe jam e sigurt që do të arrini suksese të mëdha!

Me respekt dhe mirënjohje,

Jonida Stafaj



Alesja Quku

O alesia hë mi,

Teksa ulem për të shkruar këtë letër, një sërë kujtimesh më vijnë në mendje duke filluar nga të qeshurat tona, sekretet e përbashkëta, momentet kur je detyruar të mbash edhe stresin tim mbi supe, të gjitha momentet që e bëjnë miqësinë tonë të veçantë. Është një ndjenjë e trishtë të mendosh se kohës sonë së bashku në shkollë po i vjen fundi. Që nga dita e parë e këtij viti çdo gjë ka shkuar shumë mirë. Ndoshta ishin karakteret tona që përputheshin, mendimet e njëjta ose mënyra se si ne mund të komunikojmë edhe vetëm me një shikim. Ti ke qenë më shumë se një shoqe, por një burim mbështetjeje për mua. Nuk më mbetet gjë tjetër vetëm të të uroj më të mirat! Shpresoj të bëhesh fizikantja që do ndryshosh edhe ligjet e vet Njutonit apo ndonjë shkencëtar tjetër!

Me shumë dashuri, shoqja jote Ami.

Etien Dhima: Alesjan do ta mbaj mend si “kolegen” e orës së biologjisë. Hyj në klasë, i jap dorën, i them: “Përsëndetje, kolege,” dhe pastaj vazhdon ora e mësimet, pikërisht si të ishte klasa një zyrë. Është një vajzë shumë inteligjente dhe e shkathët kur vjen puna te mësimet, shumë e dedikuar drejt qëllimeve të saj. Nuk mund të them që ndajmë të njëjtat botkuptime dhe ideologji (përkundrazi, jashtë shkolle do ishim armiq), dhe ajo ka një shije muzike objektivist të gabuar (dështova në imponim shijesh), por e toleroj gjithsesi. I uroj fat koleges në planet e saj të ardhshme.

Keti Bardhoshi: Ky vit ka qenë i mbushur me njerëz të rinj dhe jam shumë e lumtur që një prej tyre ishte ti Alesia. Ti je një frymëzim i përkushtimit në punë dhe rezultateve që arrijmë kur përpiqemi. Gjithashtu je nga ata personat që mund të flasim mbi gjithçka pa u ndjerë të gjykuar. Jam e sigurtë që e ardhmja

jote do të jetë e ndritur sepse ti arrin çdo objektivi që i vendos vetes. Shpresoj të jesh përherë e lumtur sepse e meriton!

Denis Feto: Alesja, matematicientja e klasës sonë. Ndhima që i ke dhënë klasës me detyrat e shtëpisë mund të krahasohet me ndihmat humanitare botërore. Synimin që i ke vënë vetes për të arritur gjëra të mëdha mund ta shikoj që nga larg. Vullneti dhe disiplina jote janë të dukshme, pasi rezultatet flasin vetë. Rreshti i mesit i klasës së 12-H si dhe e gjithë klasa nuk do të ishte i plotë pa ty. Të uroj të të zgjaten qerpikët pasi nuk mund të të uroj një sukses që ti tashmë e zotëron.

Amisa Lesha: Ishte shumë kënaqësi që mes shumë njerëzve të rinj që kam njohur këtë vit të ishe edhe ti Alesja. Je një vajzë e cila simbolizon vetëm qetësi, vendosmëri për të arritur objektivat e tua, inteligjencë, thjeshtësi dhe shumë dashuri. Jam shumë e lumtur që edhe pse në shumë pak kohë të kam njohur dhe të vlerësoj shumë për të gjithë vlerat e bukura që përfaqëson. Jam e sigurtë që e ardhmja jote do të jetë shumë e ndritur dhe e mbushur me suksese! Uroj që gjithë dëshirat e tua të bëhen realitet!

Arbri Peka: Është viti i parë që jemi në klasë bashkë dhe them që 1 vit nuk është mjaftueshëm kohë për të njohur dikë. Megjithatë me cka kam kuptuar deri tani mund të them që je një person shumë inteligjent dhe je shumë e pjekur. Je gjithmonë e qeshur dhe pozitive. Të falenderoj për ndihmën që më ke dhënë në klasë duke më dhënë shënimet e ekonomisë dhe duke më ndihmuar ti kuptoj. Je gjithmonë e ciltër dhe ske frikë të shprehësh idete e tua. Edhe pse je person i qetë atëherë që flet je shumë e mirë artikulluar dhe sic thotë populli flet pak e saktë. Jam falenderues për shoqërinë tonë dhe të uroj më të mirat në jetë. Shpresoj ti arrish ëndrat e tua.

Moana Gorezi: Alesja, jam shumë e lumtur që të kam pasur në klasë këtë vit dhe që kemi patur mundësinë të punojmë bashkë në të dyja fazat përgatitore të olimpiadës kombëtare të fizikës. Je një ndër personat më inteligjente dhe të talentuara në çdo aspekt. Sa herë ulemi bashkë në bankë kënaqem dhe shkrihem së qeshuri. Të uroj një të ardhme të suksesshme dhe të lumtur!



Alvi Elezi

Simboli i paqes, harmonisë dhe qetësisë... Një njeri i mbushur gjithmonë me energji positive që e transmeton te të gjithë njerëzit rreth vetes. Edhe pse i detyruar të kaloj disa sprova gjatë ditës prej fenomenit “Ani”, ai di shumë mirë ti përballoj ato me dinjitet. Për ne ai është shpëtimi i orëve të mërzitshme përmes orës së tij të famshme. Nëse ke nevojë për një njeri të buzëqeshur, ku mund të gjesh mbështetje e gjen te banka e dytë nga dera. Ka qenë një kënaqësi shumë e madhe që të kam njohur. Edhe pse në shumë pak kohë, kam arritur të të njoh mjaftueshëm sa për të të vlerësuar shumë. Jam e sigurtë që hapat e tua drejt të ardhmes do jenë të ndritura dhe të suksesshme! Uroj që gjithë dëshirat e tua të bëhen realitet! -Amisa

Në fillim Alvi mu duk sikur mbiu nga asgjekundi në klasë. Doli një nxënës i ri, por s’po kuptoja si dhe kur erdhi. U desh ca kohë derisa gjeta interesa të përbashkëta, por pas këtij momenti u bë një shok me të cilin mund të nisja shumë lehtë diskutime të gjata dhe relativisht interesante. Është një person që e kap sensin tim të humorit, gjë që çon në disa diskutime ku mbizotëron e qeshura. Është i zgjuar, dhe mjaft i duruar. Të isha në vendin e tij nuk e di sa do duroja të më ngatërrohej emri nga mësues çdo dy-tre orë. I uroj Elv- ndjesë, Alvit, sa më shumë suksese në rrugën që ka përpara. -Etien

Alvi unë pata mundësinë të të njihja vitin e fundit të shkollës dhe për ty kam mësuar disa fakte: 1. Je shumë po shumë i duruar. 2. Kalon gjithçka me një të qeshur. 3. Je gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar këdo që sheh në vështirësi. Me karakteristika të tilla mund të them se është fat për mua të kem një mik si ti. Të uroj lumturi dhe suksese në çdo hap të jetës!- Keti

Alvi apo mos duhet të themi Elvis... Nga një takim i rastësishëm në orën e fiskulturës vitin e dytë, deri tani që je kthyer në një nga shokët e mi më të mirë. Gjëja që do më mbetet kujtim gjithmonë janë shakatë dhe ngacmimet tona të pafundme, që i kishim si një rutinë ditore. E vlerësoj shumë shoqërinë tonë dhe shpresoj që të vazhdojmë të jemi shokë edhe për vite të tjera me rradhë. Të uroj shumë lumturi dhe suksese në jetë!- Amar

Eshte viti i dyte qe te njoh Alvi dhe mund te them qe qe ne momentin e pare qe te kam njohur me ke lene nje pershtypje shume pozitive. Ke qene gjithmone i sjellshem dhe me ke ndihmuar sa here ke pasur mundesine dhe per kete jam shume falenderues. Je nje person shpirtmire dhe qe te pelqen te rrish ne qetesine tende. Je shume inteligjent, i pjekur dhe ke nje shije shume te mire ne makina. Alvi te falenderoj per shoqerine qe kemi pasur keto dy vite dhe te uroj me te mirat ne te ardhmen. Shpresoj ti arrishe endrrat e tua dhe te te plotesohen te gjitha dëshirat qe ke.- Arber

Alvi, edhe pse kam 3 vjet që të njoh, ti nuk ke ndryshuar, ai djali i gjatë që spikat kur ecën në korridor. Më kujtohet hera e parë kur u takuam, në mencën e gjimnazit tonë që u mbyll, në mëngjesin e parë të javës përgatitore, kur të dy ishim në klasë të 9. U ule me tabakanë e mbushur me patate të skuqura *bëreçeti* dhe nuk i flisje askujt. Prandaj unë për inat t’u afrova. Pa e vrarë mendjen, the një “mirëmëngjes” dhe e zhyte kokën në pjatë përsëri. M’u duke një tip i fjetur, pa të njohur sigurisht. Po ja që dole një nga shokët më të mirë që kam takuar ndonjëherë, që më ke ndihmuar në nuk e di sa teste, detyra e mësimi që as nuk ia kisha idenë. Ama ta kam kthyer borxhin, sepse gjuha shqipe e klasës së 11-të ishte lënda e preferuar jotja. Gjithmonë prisje detyrat e mia me padurim, dhe unë si Ani, të ngacmoja gjithmonë për këto. Ja që t’i kuptoj vuajtjet. Shakatë e tua në mes të orës së mësimi të shkruara në bankë me laps nuk harrohen, se ishin gjithmonë legjendarë, pa harruar video-t e tiktokut që përbëheshin nga një humor i prishur si i joti. Vitin e fundit zinin bankën “tonë” me vrap dhe nuk lejonim asnjë të na e zinte, sepse dukej sikur na ndanin. Këto vite të gjimnazit sinqerisht nuk do të ishin kaq të lumtura pa ty, sepse në qoftë se nuk do të kisha dikë që të ngacmoja, jeta do ishte shumë boshe për mua. Të uroj një të ardhme sa më të suksesshme dhe u pranofsh në universitetet që dëshiron! -Ani



Amar Kruja

Amar, ke qenë një nga shokët e mi më të mirë këto vite që jemi njohur dhe jam shumë mirënjohës për këtë. Shakatë që bënim bashkë më kanë bërë gjithmonë të qesh sidomos kur kemi ngacmuar njëri-tjetrin. Jam shumë i lumtur që të njoha dhe shpresoj që shoqëria jonë të zgjasë për një kohë të gjatë. Shpresoj që e ardhmja jote të jetë e mbushur plot lumturi dhe suksese.- Alvi Elezi

Çkemi Amar,

Si fund i këtij viti shkollor do të doja të të uroja një të ardhme të mbushur me sukses e shumë lumturi! Shpresoj që çdo ëndërr e jotja të bëhet realitet! Paç fat dhe shpresoj që ky udhëtim i ri të jetë i mbushur me shumë mundësi, eksperiencë të reja dhe synime të realizuara.- Nga Amarda

Mari, Amarisi, e nuk e di ca emri tjetër të kemi thirrur ne dhe zyshat, po që ta garantoj që do i kujtojmë gjithmonë kur të rritemi. Së bashku u takuam që në klasë të 8-të, kur Engini priste të vije ti ditën e parë të shkollës, dhe më në fund, doli koka jote nga dera, mbas prindërve të tu. Nuk e prisja që do të ishim përsëri së bashku në klasë pas 5 vitesh, po ja që erdhi dhe kjo ditë. Jo të gjithë e dinë, por që nga klasa e tetë, ke ndryshuar thellësisht, je zgjatur dhe na e ke kaluar të gjithëve, e nuk të dallon dot po të krahasojmë foton e tanishme me ato të vjetërat. Edhe pse ndonjëherë nuk kishe dëshirë t'i bëje detyrat në shkollë, të ndihmonte inteligjenca, që jo të gjithë e kanë. Sa për momentet e bukura, mund të hap mendjen time dhe me mijëra memorie dalin nga aty, kur të shihnim që mezi vrapoje, shakatë me Fatihun, kampionati i futbollit në klasën e 9-të, fotot e pafundme qesharake që i urreje, garat me makinat e vogla që gjithmonë ngelje i fundit, krahasimet me ne duke na thënë ne

se ishe "Busquets-i" i klasës e sa e sa të tjera. Mungesa jote gjithmonë ndihej dhe ndjehet në klasë, e përherë kthehem mbrapa për të parë a je në bankë a jo, edhe pse është përmendur që Amari mungon orën e parë se ka Ekonomi hahahahaha. Zëniet e tua në bankën e fundit me atë tjetrin ke lezet t'i dëgjosh, e kur e mendoj, jam i lumtur që ndodhin, se e mbani klasën tonë të gjallë dhe jo të vdekur. Do të më mungojë ajo figura jote sa një lis kur shfaqesh në derën e klasës. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në të ardhmen, që padyshim do të jetë e sukseshme! - Ani Velo

E kush më mirë se ti mund të më kuptonte mua këtë vit, moj naçe...??? Edhe pse kemi shumë pak kohë që njihemi, më duket sikur shoqëria jonë ka vite që ekziston, sepse e kemi gjetur shumë shumë shpejt gjuhën e përbashkët. Thjesht me të qenurit Shkodran nënkuptohen automatikisht të gjitha vlerat e tua, por thjeshtësia, zemërgjerësia, të qenurit gjithmonë i gatshëm për ndihmë dhe humori janë ato çfarë të bëjnë ty edhe më të veçantë. Një tjetër anë e jotja e cila duhet përmendur dhe vlerësuar është të zotëruarit aftësi menaxhimi dhe durimi "Të bëmave të Enginit" (edhe pse ka akoma vend për përmirësim...). Jam shumë e lumtur që këtë vit të fundit e kemi kaluar në mënyrë kaq të bukur sëbashku dhe jam shumë e sigurtë që bisedat dhe të qeshurat aty në bankën tonë gjatë mësimit dhe pushimeve do të më mungojnë pafund. Shpresoj që koha të ruaj brenda teje të gjitha vlerat e bukura të cilat janë shumë të veshtira për tu gjetur në ditët e sotme. Jam e sigurtë që e ardhmja jote do jetë shumë e ndritur dhe e mbushur me suksese! Uroj që gjithë dëshirat e tua të bëhen realitet!- Amisa Llesha

Në fakt nuk kemi shumë që njihemi por e qeshura jote nga fundi i klasës më oshëtin shpesh në vesh. Me thënë të drejtën bën shumë mirë se nuk shtyhen fare ca orë mësimi. Të uroj shumë fat dhe shpresoj të gdhendet përherë në fytyrën tënde çiltërsia dhe buzëqeshja që të karakterizon dhe tani! Suksese në jetë!- Erisa Noga

Nje djale shumë i mire dhe i singert me te tjerët ,e njoh që prej klases së pare dhe nuk e kam prishur shoqërinë me të. Nuk i diferencon të tjerët bazuar në gjera që ata nuk i kontrollojnë dot dhe ka nje personalitet shumë të ngrohtë që i bën të gjithë të ndihen të mirëpritur. Dhe pse ziheshim në shumë raste ja kemi gjetur anën e komunikimit. I uroj sa më shumë suksese në jetë dhe shpresoj që çdo gjë ti shkojë ashtu siç do dhe gjithashtu të kemi kontakt pas këtij viti ashtu siç i kemi pasur në vitet e 9-vjeçares dhe gjimnazit. - Deivi Gani



Amarda Islami

Ani Velo

Amarda, ajo vajza e urtë dhe e respektueshme, sikur e ka edukuar vetë Sokrati. E panjohur nga unë deri në fazat e vjetshme në gjeografi, kur rrinim deri në orën 3 pas mësimit e na ikte truri, po që pa ato ku do të ishim tani, e ku do të ishte miqësia jonë. Më ke mësuar dhe ndihmuar gjithmonë dhe shpresoj që të mos ndryshosh, të ngelesh kështu, një njeri i mirë dhe punëtor. Të uroj gjithë të mirat dhe shpresoj të arrish majat me atë “mjekësinë e dashur” tënden!

Sabjan Haska

Amarda je me të vërtetë një vajzë model. Një nxënëse e shkëlqyer, vajzë inteligjente, e qetë, punëtore, e qeshur dhe shumë e përkushtuar. Nuk do t'i harroj orët e gjata të kimisë, të cilat së bashku i bënim më pak të lodhshme. Jam i sigurt që ke për të ecur shumë në jetë dhe do të bëhesh një doktoreshë e denjë. Një këshillë kam për ty, merri gjërat më me sportivitet dhe ki besim në vete. Do të kujtoj përherë!

Arbri Peka

Është viti i parë që jemi në klasë bashkë dhe jam falënderues për shoqërinë tonë. Je vajzë e zgjuar dhe e pjekur. Ke nje zemër të madhe dhe mundohesh të ndihmosh të gjithë dhe për këtë jam falënderues unë dhe e gjithë klasa. Je shumë e edukuar dhe e sjellshme. Nuk flet shumë, ama atëherë kur flet je shumë e zonja të shprehësh mendimet e tua në mënyrë shumë të artikuluar dhe flet gjëra me vlerë. Je gjithmonë e qeshur dhe pozitive. Një vit nuk është kohë e mjaftueshme për të njohur dikë ama mund të them me siguri që ti je një person shumë inteligjent dhe një nga njerëzit më shpirtmirë që kam njohur. Të uroj më të mirat në të ardhmen dhe jam i sigurt që do mundesh ti arrish ëndrrat e tua. Uroj të të plotësohen të gjitha dëshirat

që ti ke. Shpresoj që e ardhmja jote të jetë plot të mira e surpriza.

Alesia Quku

O Amarda hë mi, si na iku ky vit kështu, plot me të qeshura dhe harmoni? E pra, merita është e jotja. Mirësia, durimi, intelekti yt e kanë mbushur klasën plot pozitivitet. A, mos harroj edhe faqet e tua të kuqe si shega. Je një shoqe e denjë për mua. Je për t'u marrë shembull.

Sibora Nezha

Kujtesa ime nuk është aq e mirë sa të mbaj mend shumë rreth ditëve të para kur jemi njohur, por është i paharrueshëm stresi që ke pasur, ke dhe që siç duket do vazhdosh të kesh për mësimet, kuicet, provimet, detyrat dhe shumë gjëra të tjera që lidhen me shkollën. Dua të dal në faktin që më pëlqen shumë që i merr gjërat seriozisht dhe u jep rëndësinë e duhur, gjë që ditët e sotme shumë pak njerëz e bëjnë. Për të mos thënë veçoritë që janë të padiskutueshme tek ti, siç janë sjellja shumë e mirë, respekti, dëshira për të punuar, zemërgjerësia, doja më shumë të ndalesha tek ato veçori që të bëjnë ty Ami, pra ajo që je. Më kryesore dua të shpreh pëlqimin që kam për faktin që je një vajzë e drejtë, pa hile, dhe që nuk do ti bësh kurrë keq tjetrit, sado e keqe të jetë sjellja e tyre kundrejt teje. Ti nuk je vetëm një vajzë ekselente, por edhe sociale, të pëlqen argëtimi. Mund të them që je mes i artë që çdo njeri mundohet të gjejë në jetën e tij.

Keti Bardhoshi

Amarda je nga njerëzit e rrallë që ende u skuqen faqet kur flasim për arritjet. Kjo tregon se ti je nga ata njerëzit e rrallë që janë plotësisht të vërtetë. Jam e sigurtë që mund të të besoj me përgjegjësi të mëdha pasi je një nga njerëzit më të gatshëm që kam takuar. Sigurohesh gjithmonë që detajet e mësimëve t'i marrim dhe pse kemi munguar dhe e shoh që përpiqesh të ndihmosh të gjithë klasën. E di se e ardhmja jote do të jetë e mbushur me lumturi dhe suksese të panumërta në rrugëtimin tënd si një mjeke. Mendoj se ti do të bëhesh një mjeke e shkëlqyer për shkak se je shumë e kujdeshme me këdo që ke pranë. Të uroj vetëm gëzime në hapat e jetës tënde!

Alvi Elezi

Amarda, je një person shumë pozitiv dhe i zgjuar. Të falënderoj për gjithçka dhe jam shumë i gëzuar që të njoha. Edhe pse e ardhmja mund të jetë plot pengesa, të uroj sukses dhe lumturi në jetë.



Amisa Lesha

Amisa, njeriu që e dashuronte gjumin më shumë se gjithçka tjetër. E urtë dhe inteligjente, e korrigjoje Ketin gjithmonë për ushtrimet e matematikës, dhe ne me Alvin ktheheshim gjithmonë mbrapa nga kurioziteti. Ti rrallë mungoje në shkollë, me justifikimin se nuk e lije dot shoqen vetëm, por kur nuk vije, rrinte banka bosh, dhe nuk e di pse nuk dukej normale. Tek ty më pëlqejnë ato mendimet me shumë llogjikë që thojë, sepse i vendos qershinë mbi tortë. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në jetë! - Ani

Amisa, nuk kam shumë kohë që të kam njohur por jam shumë i lumtur që u njohëm. Gjithmonë më je dukur si një person shumë i qetë dhe pozitiv. Më ke ndihmuar shumë herë dhe të falenderoj shumë për këtë. Bashkë me Ketin dhe Anin kemi qeshur shumë dhe jemi kënaqur. Të uroj sukses në jetë dhe lumturi! - Alvi

E dashur Misi, Ishte një kënaqësi për mua që këtë vit, pjesë e rrethit tim shoqëror të bëheshe edhe ti. Edhe pse koha që kemi kaluar së bashku nuk ka qenë shumë e gjatë, kam arritur të shoh tek ti seriozitetin, vendosmërinë dhe maturitetin që ti tregon gjithë kohës me mendimet dhe sjelljet e tua. Shpresoj që ky vit të jetë i mbushur me plot lumturi, me qëllime dhe dëshira të realizueshme për ty! Uroj që suksesi të të ndjekë në çdo hap të rrugëtimit tënd! - Amarda

Amisa, që kur të kam takuar për herë të parë kam dalluar tek ty një vajzë simpatike, zemërmirë, të matur dhe inteligjente. Nuk kam asnjë dyshim që do të shkëlqesh në jetë. Të uroj nga zemra që të të plotësohen të gjitha dëshirat dhe ëndrrat! Suksese! - Erisa

Amisa, faleminderit për çdo moment të këndshëm që kemi kaluar këtë vit. Je një vajzë shumë e sjellshme dhe e qetë. Gjithmonë koha dhe bisadat me ty kanë qenë të këndshme. Jam e lumtur që të kam patur në klasë këto dy vite. Të uroj një të ardhme plot me lumturi dhe suksese! - Moana

Amisa, që në momentin që të takova për herë të parë më je dukur shumë vajzë e dashur dhe e dhembshur. Qetësia jote gjithashtu është një atribut i cili të karakterizon më së miri. Uroj që të arrish çdo gjë që dëshiron në jetë! - Ester

Komunikimet tona nuk kanë qenë të shumta, por ndonjëherë fjalët nuk janë të nevojshme për të njohur dikë. Ëmbëlsia dhe qetësia jote janë veçori të cilat i japin klasës një frymë më të bukur. Falë një "bashkëpunimi" të vogël që kam pasur me ty, kam arritur të njoh Amisën detajiste, që i bën detyrat që i jepen me qetësi, dëshirë dhe pa u lodhur. Doja të vlerësoja mirësinë tënde dhe respektin që ke për të tjerët, mbi të gjitha. Mendoj se je një vajzë e çiltër, e vendosur si dhe shumë e këndshme. - Sibora

Amisa është shoqe që gjithmonë të ndihmon. Gjithmonë bujare dhe e sjellshme me të gjithë. Amisa është ai lloj personi prej të cilit nuk do të kesh asnjëherë probleme! Shpresoj të mbajmë kontakte edhe pas viteve shkollore. - Deivi

Amisa, je pa dyshim një ndër personat më të veçantë që njoh. Si rrallë herë je nga të paktat të cilat më kanë lënë një pershtypje pozitive që me herën e parë që jemi takuar. Çiltërsia e optimizmi yt janë ato çka vlerësoj më së tepërmi tek ti. Je vajzë me ambicie e e cila punon fort për të arritur më të mirën. Gjithashtu ia del të bësh gjithkënd të ndihet mirë me pozitivitetin që të karakterizon e sheh gjithmonë anën e mirë të medaljes. Jam mirënjohëse për kohën që kemi kaluar së bashku e mund të them me bindje se ndihem me fat që të kam njohur. Të uroj shumë suksese! - Klara

Gjëja që më pëlqen më shumë tek Amisa është fakti që është në botën e vet dhe nuk i lejon njeriu t'ja prishi qetësinë e saj. Ajo qetësia dhe ai individualiteti që e karakterizon e bëjnë Amisën të duket shumë e vendosur para veshtirësive. Amisa gjithmonë është e qeshur dhe rrezaton mirësi. Është e çiltër dhe shumë zemërmirë. Shpresoj të realizohet çdo gjë që dëshiron dhe të uroj suksese kudo! - Luisa



Ani Velo

ALVI ELEZI - Ani, më kujtohet akoma dita e parë që jemi takuar në Mehmet në klasë të 9-të. Unë nuk njihja asnjë person atje dhe ti ishe një nga personat e parë që kam takuar. Në vit të dytë u bëmë shokë edhe më të ngushtë dhe jam shumë mirënjohës për këtë. Ti më ke ndihmuar shumë gjatë këtyre viteve por në të njëjten kohë dhe unë ta kam kthyer borxhin. Kemi bërë shumë shaka, sidomos kur kemi ngacmuar njëri-tjetrin, që nuk do t'i harroj kurrë dhe ti gjithmonë më ke ngritur moralin me pozitivitetin tënd. Ti ke qenë gjithmonë një person plot energji ndryshe nga unë por që çuditërisht nuk e kam pasur kurrë problem. Nuk e di si do te kishin kaluar këto vitet e fundit nëse nuk do të të kisha ty si shokë. Jam shumë i lumtur që të kam takuar dhe shpresoj që shoqëria jonë te zgjasë për një kohë të gjatë. Shpresoj që të kesh sa më shumë sukses në të ardhmen dhe të jetosh një jetë sa më të lumtur.

AMARDA ISLAMI - Hë mo Ani, e se do kishim kaluar dhe fazën e tretë të Olimpiadës së Gjeografisë nuk e kisha imagjinuar. Ishte një eksperiencë shumë e bukur në të cilën filluam edhe miqësinë tonë si dy "ish-Mehmet Akifsa". Kemi kaluar shumë kohë së bashku duke filluar nga orët e gjata të olimpiadës, rruga që bënim bashkë për në shtëpi e së fundmi na bashkoi klasa 12-H. Kohët e fundit ke qenë duke u përgatitur për aplikimet në universitete. Sukseset Ani dhe uroj që të pranohesh në degën që dëshiron!

AMISA LESHIA - Njeriu më i hareshëm, gjithmonë i mbushur plot me energji për të diskutuar, për të ndihmuar, për të organizuar, për të qeshur. Motivi i çdo dite të tij është "ngacmimi i Alvit" dhe energjia e tyre përcillet gjithashtu mbrapa te unë dhe Keti. Ai është përherë i pari kur bëhet fjalë për aktivitete.

Nuk e gjen kurrë të lodhur ose të mërzhitur, por nëse një simptomë e tillë shfaqet do të thotë se një shumë serioze ka ndodhur. Mënyra se si ti i merr situatat plot sportivitet dhe humor është një veçori e jotja që më pëlqen shumë. Jam e sigurtë që e ardhmja jote do jetë shumë e ndritur dhe e mbushur me suksese! Uroj që gjithë dëshirat e tua të bëhen realitet!

ARBRI PEKA - Është e vështirë të gesh fjalët për të shpjeguar vlerat e Anit dhe mirënjohjen që unë kam ndaj tij. Ani është një në një milion. Një person i veçantë me shpirtin më të pastër dhe më të sinqertë që kam hasur ndonjëherë në jetën time dhe që do hasë ndonjëherë. Per mua Ani është më shumë se sa një shok klase dhe me gjithë zemër i them vëlla. Aventurat dhe koha që kemi kaluar bashkë janë disa nga kohët më të bukura të jetës sime dhe janë kohe te cilat do t'i mbaj përzemer gjithë jetën. Ani sjell pozitivitet kudo dhe shkëlqen në çdo gjë. Në fillim kur erdhe në klasë të 8 ishim pak distantë dhe kur mësova që ishe femija i dy mësuesve, si një djalë 14 vjeçar naiv dhe pak budalla të gjykova pa e menduar thellë, por shpejt e mësova sa gabim e kisha. Është një ndër personat e vetëm që gjithmonë më është gjendur pranë dhe që me ka ndihmuar në çdo situatë pavarësisht nëse e ka pasur mundësinë apo jo. Nuk mund të gjej fjalët për të shprehur se sa falenderues jam për ty vëlla dhe se sa borxhli të jam. Nuk ka fjalë për të përshkruar vlerat që ti ke si njeri, si shok dhe si vëllai im. Kujtoj kohët që kemi kaluar dhe nuk di nga t'ia nis. Vetëm qesh me vete ndërkohë që më vijnë ndërmend tërë budallallëqet që ne bënim me shishet dhe gjerat e tjera në klasë, që mendoj se po i thashë do te fus ne telashe veten dhe ty. Nuk do i harroj kurrë gjërat që më kë mësuat. Sa herë që flet thua gjëra me vlerë dhe e konsideroj veten njeri me fat që kam pasur mundësinë të të njoh e sidomos që kam fatin të të therras shokun dhe vëllain tim. Ani je njëri i veçantë, mos i humb kurrë vlerat e tua dhe ji gjithmonë i vertete ndaj vetes. Je njeri unik dhe mos lejo askënd të ta shuajë dritën tënde. Të jem i sinqertë nuk jam fort i zoti me këto gjëra ama edhe sikur të kisha vite për të shkruar për ty nuk do ishte mjaftueshëm. Ani, të uroj nga thellësia e zemrës më të mirat në jetë. Je djalë punëtor, një person shumë i zgjuar dhe i pjekur, ndaj nuk e ve në dyshim që do shkëlqesh kudo ku të shkosh dhe që do t'i arrish ëndrrat e tua. Mos lejo askënd të të ul poshtë edhe pse sinqerisht askush nuk mund ta bëjë dhe uroj të të plotësohet çdo dëshirë që ti ke.



Arbri Peka

Amarda: Çkemi Arbër, Shpresoj që kjo letër të të gjejë mirë! Teksa fundi i vitit po afron, do të doja të kisha shprehur mirënjohjen time për miqësinë e krijuar gjatë këtij viti. Edhe pse për një kohë të shkurtër, kam arritur të vlerësoj nga karakteri yt inteligjencën, pjekurinë tënde, mënyrën se si argumenton mendimet e tua, sjelljen tënde pozitive dhe batutat e tua që shpesh herë më bëjnë për të qeshur. A, mos harroj dhe ato këngët që vendos në 5-minutshë i qan. Je një nga personat që i jep gjallëri klasës 12-H me prezencën tënde. Uroj që e ardhmja jote të jetë e ndritur dhe me plot gjëra të bukura! Shumë suksese Arbër! Të uroj më të mirat dhe shpresoj të arrish çdo gjë që dëshiron në jetë. Nga Amarda

Amisa: Të bëheshe pjesë e shoqërisë sime këtë vit ka qenë një kënaqësi shumë e madhe. Je një djalë me një karakter fantastik, shumë i vendosur, miqësor, inteligjent dhe gjithmonë i gatshëm për ndihmë. Zotërimi i dijeve nga fusha të ndryshme është një element që të bën ty shumë të veçantë. Edhe pse në një kohë shumë të shkurtër kohore, kemi arritur të krijojmë momente shumë të bukura, që do të na ngelen në memorie për shumë gjatë dhe me siguri do të na mungojnë pafund. Shpresoj që koha të ruajë brenda teje të gjitha vlerat e bukura të cilat janë shumë të vështira për t'u gjetur në ditët e sotme. Jam e sigurt që e ardhmja jote do jetë shumë e ndritur dhe e mbushur me suksese! Uroj që gjithë dëshirat e tua të bëhen realitet!

Ani : Nga t'ia nis? Të dy na bashkoi ajo klasa e famshme e tetë. Me mendjen time si një nxënës i ri në turk, mendoja për klasën, shokët e rinj, pa më rënë në sy një djalë që vinte nëpër klasë dhe bënte shakara, duke menduar me veten se si mund të rrija unë me

ty. Po ja që Ani 14-vjeçar ishte akoma i vogël dhe i gjykonte njerëzit pa i njohur. Ti munde të më provoje që e kisha gabim, të tregoj anën e mirë që unë nuk e kisha parë në fillim, e kjo zgjati vetëm dy javë, sepse u bëmë shokë të ngushtë shumë shpejt, pa e kuptuar as vetë. Afrimitetin tënd me të tjerët shumë rrallë gjendet në këtë botë. Bashkë kemi kaluar pafundësisht kohë, uleshim bashkë në bankë dhe na ndante zyshë Anisa, me argumentin që bënim zhurmë, por ne nuk kishte njeri që na e prishte miqësinë, as koha dhe njerëzit, e jo më zysha. Në klasë të nëntë, harroje librin e gjuhës qëllimisht që të bënim biseda për makinat edhe sidomos për atë P1-shin, sepse bankat teke të shkaktuara nga Covid-i na largonin. Mësimet e tua asnjëherë nuk i harroj, i mbaj "vath në vesh", si e thotë shumë bukur edhe populli. Mos të kujtojmë shakatë tona, fluturimin e shisheve dhe të hekurit nga dritarja në të 9-tën, filmat në të 11-tën, ai goli nga porta jote e ku të gjithë u mblodhëm për të festuar, lojërat, festat, historitë midis nesh, garat në 'go-karting' ku i lije të gjithë mbrapa e qeshje me të madhe e jashtëzakonisht shumë të tjera. Më kujtohet kur ndërtoam projektin e fizikës në pushimin 30 minutësh, duke nxituar e duke i fryrë vinovilit, që të ngrinte. Më pas zysha na dëgjoi kur po flisnim në korridor për të, dhe na ngacmonte në klasë, pa e vënë re që ne qeshnim poshtë bankës. Përherë ai djali i qetë, që ndonjëherë i këpusje gjumin në mes të mësimit pa e vrarë mendjen për asgjë, e çoheshe kur vija unë ose të thërriste zysha, sidomos zysha e matematikës. Duke e mbyllur, të uroj gjithë të mirat në këtë rrugëtim të gjatë të jetës!

Etien: Nëse vlerësoj diçka mbi të gjitha te një njeri, është kultura. Në sytë e mi nuk ka rëndësi ç'pëlqen dhe çfarë jo nëse tregon që je një njeri me kulturë dhe di të respektosh të tjerët. Aty e ke fituar respektin tim. Shembull konkret i kësaj është Arbri. E njoha për herë të parë në klasë të pestë, e më pas vetëm tek-tuk rastisëm në të njëjtin vend, deri këtë vit. Të pakta janë të përbashkëtat që kemi në interesa, por duhet respektuar personi i cili shpreh pasion të thellë mbi interesat e tij, sidomos kur ka njohurinë dhe botëkuptimin në mbështetje. Arbri është një djalë goxha i shkathët, i zgjuar, i talentuar dhe plot kulturë. Është e garantuar që nëse flet me të do të zbulosh shumë gjëra interesante.



Brendis Kasharaj

Marson Aga - Brendis, më pëlqen të mendoj se gjatë viteve të shoqërisë sonë kemi parë shumë indetite të njëri-tjetrit, pavarësisht kësaj mendoj se çdo person mund të shoh qartasi inteligjencën por dhe dëshirën tënde për të bërë mirë. Ama dua të theksoj se ti nuk je vetem kaq, në vetvete je një individ mjaft i veçantë dhe kurioz. Cilësi të cilat më kanë tërhequr të të flas dhe pas tërë këtyre viteve. Gjithashtu dua të të falenderoj për durimin tënd drejt meje por për më tepër dhe miqësinë e cila gdhendi fëmijërinë time. Është e vështirë të përfytyroj një të ardhme që mos të të mbaj mënd, pikërisht për arsyet që thashë më parë. Si përfundim të uroj fat në të ardhmen dhe pse e pretendoj në mënyrë të padiskutueshme se do të ndriçosh çdo vend ku do shkelësh.

Luisa Spahiu - Brendis ty do të të përshkruaja si një person të zgjuar që punon dhe studion fort. Më pëlqen përkushtimi që ke ndaj gjërave që të pëlqejnë dhe është për tu komplimentuar qetësia më të cilën na shpjegon ndonjë ushtrim matematikor. Përvec kësaj, ke një sens humori që di ta përdorësh mirë. Më vjen mirë që të njoha këtë vit dhe të uroj suksese!

Amarda Islami - Brendi, Brendo, Brendoni, aq shumë emra të ka vendosur zysh Vera sa kam harruar dhe emrin tënd të vërtetë. U mundua shumë me neve që të kalonim Olimpiadën e Kimisë po me sa duket e zhgënjem. Gjithsesi ishte një eksperiencë e bukur që na bëri të zhvillojmë edhe më shumë miqësinë bashkë. Je në prag aplikimesh dhe shpresoj që në të ardhmen të na përfaqësosh denjësisht si programuesi i robotëve që do të sundojnë botën! Të uroj shumë suksese Brendis!

Ester Rembeci - Brendis, që kur të kam njohur ti më je

dukur si një person i vendosur dhe shumë inteligjent. Qetësia jote karakterizuese shpalos personalitetin tënd në mënyrën më të mirë. Uroj që ti të arrish të gjitha ëndrrat e tua në jetë!

Jon Memushi - Për të folur pak përtej zgjuarsisë dhe inteligjencës tënde, Brendisi është një nga shokët më të mirë që mund të bësh. Që kur e njoha për herë të parë në vit të dytë, e kuptova se sa njeri pozitiv dhe i maturuar ishte, vërtetë një person me të cilin ta ka ënda të shoqërohesh. Është një nga djemtë më të thjeshtë që kam njohur, i cili të bën të ndihesh shumë rehat në shoqërinë e tij. Për tu përmendur janë dhe lojërat e panumërta të basketbollit që kemi bërë në pushim të madh, që gjithnjë do t'i kem ndër kujtimet më të bukura të gjimnazit. Të uroj suksese në çfarëdo rrugë që do marrësh në të ardhmen vëlla, e di që do shkëlqesh.

Ani Velo - Brendisi, ose Brendoni, si të thërrisnin zyshat ndonjëherë. Një djalë i qetë, i duruar, që i ndihej zëri shumë rrallë, vetëm kur kishte konflikte me Etienin, ose në orën e biologjisë, duke iu përgjigjur pyetjes së zyshës, kur asnjëri nuk kishte çfarë të thoshte. Ty nuk të morën universitetet shqiptare, por të rrëmbeu Kanadaja. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në jetë!

Etien Dhima - Brendisin e njoha në klasë të gjashtë. Ende vazhdon të jetë një djalë goxha inteligjent dhe i dedikuar ndaj qëllimeve që i vë vetes. Nuk ka gjë që t'i dali para që t'i rezistojë shprehjes së famshme "mund të isha duke bërë fizikë". Por edhe përtej këtyre është gjithashtu shumë pasionant për një sërë aktivitete të tjera, si robotika. I uroj suksese të mëtëjshme në të ardhmen.

Moana Gorezi - Brendis, faleminderit për çdo moment të këndshëm që kemi kaluar këtë vit. Je ndër personat më të zgjuar dhe të talentuar që njoh. Jam shumë e lumtur që kam punuar me ty në Earth Prize, Space Apps dhe Olimpiadën Kombëtare të Fizikës. Je një mik i shkëlqyeshëm, një ndër më të afërmit, dhe një person shumë i këndshëm për të folur. Të uroj një të ardhme plot me lumturi dhe suksese!

Arbri Peka - Brendis, me aq sa të kam njohur kam arritur të kuptoj që ti je një gjeni. Gjithmonë ke treguar që je një person i mirë sidomos në rastet kur të kërkonim ndihmë edhe për ato gjëra që për ty ishin elementare. Shpresoj që të arrish synimet që ti i ke vënë vetes dhe të uroj me të mirat në jetë.



Deivi Gani

Ani Velo-Një djalë pa të cilin klasa nuk do të kishte lezet. Gjëja e parë që më shkon në mendje tani është ajo thirrja e Amarit pas orës së parë, për të marrë kafe. Miqësia jonë filloi para 5 vitesh, tek kompleksi i famshëm, tek ajo klasa në fund të korridorit. Nuk më kujtohet momenti fiks kur të pashë, por thjesht di që u krijua grupi jonë i famshëm, dhe ti ishe pjesëtar i tij, edhe pse unë në ato kohë nuk njihja asnjërin, por që tani që e mendoj, një djalë me llogjikë, që i interesonte shumë gjeografia, ushtrimet matematikore së bashku me detyrat e matematikës që i bëje aq shpejt, sa i shkruaje në libër dhe kaloje tek tema tjetër, duke na lënë ne të habitur. Ndonjëherë harroj se çfarë kemi bërë bashkë, sepse vitet kalojnë së bashku me disa fragmente kujtese, por fatmirësisht “jevroo” më shpëton gjithmonë, duke më rikthyer sekonda të vogla të një ngjarje të caktuar, si fotot e minimaturës ose kënga e famshme e yllit në Sudan, e cila ishte aq fiksuese, sidomos kur e këndoje me zë të lartë në klasë, sa që e gjeja vetem duke e kënduar nën zë edhe qeshja. Kemi kaluar një kohë shumë të bukur bashkë, që shpresoj të vazhdojë e më tej. Të uroj suksese në Hollandë ose kudo që ti shkon dhe një jetë sa më të lumtur!

Alesja Quku-Kafexhiu I klasës sonë. Çdo pesë-minutësh të shoh me kafe në dorë. Kuptohet nga e merr gjithë atë energji për të qeshur me gjithë shpirt. Mos le pa përmendur edhe energjinë që ke për të debatuar me zyshat. Ti gjithmonë je i gatshëm të ndihmosh të tjerët. Kjo tregon sa zemërmirë je.

Denis Feto-Deivi, djali me kafën gjithmonë në dorë. Një shok i cili të mbështet dhe të ndihmon në situata të vështira. I sjellshëm gjithmonë, herë i qeshur e herë shumë i qeshur, karakteri yt është një pjesë e veçantë

e kësaj klase. Shpresoj të mësosh sa më shpejt si ta shkelësh syrin edhe pse që në shtator që e praktikon. Të uroj suksese kudo!

Erisa Noga-Edhe pse kam vetem pak muaj që te njoh mendoj se e kam krijuar një opinion të përgjithshëm për ty. Je një cun i zgjuar, pak impulsiv dhe zemërgjere. Jam e bindur që do të behesh një ekonomist vertet i zoti ne te ardhmen. Te uroj sa me shume fat dhe një te ardhme te ndritur aty ku do te shkosh sepse e meriton.

Klara Muca-

Deivi, edhe pse kemi shumë vite shoqëri me njëri tjetrin, më duket sikur dita ditës mësoj diçka të re tek ti. Pa dyshim ndihem shumë e lumtur të të kem njohur e mendoj se çdokush do të dëshironte të kishte një person si ty në shoqëri. Je një djalë shumë punëtor i cili nuk dorëzohet kurrë. Gjithashtu ke një ambicie mjaft të fortë e cila jam e sigurt që do të ndihmojë të ecësh përpara në jetë. Edhe pse zënkat mes nesh nuk kanë munguar, prap se prap kurrë nuk kemi lënë te ndikojë shoqërine tonë. Më pëlqen shumë drejtësia jote dhe mënyra se si shih të dyja anët e medaljes. Çfarëdo të ndodhë, e them me bindje se je ndër të paktët persona që do të kenë besimin tim të plotë. Të uroj shumë suksese e shpresoj të arrish çdo qëllim tëndin.

Klea Kaloshi-Deivi

Ka shumë kohë që njihemi dhe me kalimin e viteve kemi krijuar një shoqëri të brishtë. Me debate dhe te qeshura kështu shkon një ditë normale me ty në bankë. Gjithmonë them që gjëja ime e preferuar është të zihem me ty dhe gjithmonë qeshim sa herë që ndodh. Je një djalë i vendosur dhe shumë ambicioz. Në të ardhmen të shoh të suksesshëm dhe aty ku ke ëndërruar gjithmonë të jesh. Jam e sigurt që ti do dalësh fitues në cdo sfidë që përballon.

Me dashuri, Klea

Sibora Nezha-Dukesh një person që nuk bie në qetësi, por i afërt dhe lehtësisht i komunikueshëm dhe i kuptueshëm. Kam mendimin se je si një elektron i lirë për sa i përket pjesës që çfarë të pëlqen sot, mund të ndryshosh mendim nesër, por kjo të bën njeri aktiv dhe t'i kuptosh më lehtë gjërat apo njerzit. Je një nxënës që e di çfarë do dhe sigurohesh ta arrish. Nuk mund të lë pa përmendur zgjuarsinë dhe mendimet e mprehta që ke.



Denis Feto

Ani Velo:

Doktorri praa. Nuk e dini ju, po Deni “o’ doktorr me vërte.” Një djalë plot energji, pozitivitet, humor dhe vullnet, që jo të gjithë e shohin. Të dy na bashkoi shkolla jonë e famshme e Mehmetit, si dy “ditorë”, dhe duke u ulur ngjitur njëri-tjetrit që në fillim, pa më shkuar mendja që do ishte një mik imi për kaq kohë. Diçka që shumë persona e vënë re, është që ti i ke shumë qejf informacionet e huaja, që nuk hasen në librat tanë “të thatë”, tekste që gjehen të futura nëpër ngushticat e gjata të internetit, të fshehura në ndonjë dokumentar që jo çdokush e sheh, ose në ndonjë enciklopedi të trashë të mbuluar nga pluhuri, pra fjalë që jo të gjithë i dëgjojnë në jetën e përditshme. Kjo është një pikë e fortë jotja, që edhe mua më pëlqen, sepse të jep mundësinë të dalësh nga situatë të ndryshme, kur nuk ke diçka më për të thënë, por mund të të shërbejnë në jetën e përditshme. Ama fakti që nuk e ke bazuar të gjithë personalitetin mbi këto tregon se je një djalë i pjekur dhe i matur në veprimet që bën, duke shfaqur që je i rrahur me problemet e jetës dhe di t’i bësh ballë çdo gjëje. Përveç se nuk ma kalon dot në shah, por nga ana e futbollit ose basketbollit mund të krahasohemi hahahahaha. Shakatë e tua do të më mungojnë gjithmonë, sepse thuhet në çastin e duhur, dhe thyejne qetësinë e thellë të 12H. Në fund, të uroj gjithë të mirat dhe shpresoj që të ndjekë fati nga pas!

Alesia Quku:

Simpatiku i klasës, Denisi. Si do t’ia benim ne po të mos kishim ty në klasë? Kush do na bënte për të qeshur? A kupto*, kush? Hareja dhe pozitiviteti që ti i jep klasës janë me të vërtetë për t’u vlerësuar. Lëre pastaj zgjuarsia. Nga ti ka ardhur fjala ekselencë. *fjala që përdor Denisi për të mbyllur një fjali.

Alvi Elezi:

Denis, ne jemi njohur bashkë që në Mehmet edhe pse nuk kemi qenë shumë të afërt ne atëkohë. Me kalimin e kohës jemi bërë shokë më të mirë dhe jam shumë mirënjohës për këtë. Je një person plot pozitivitet dhe shakatë e tua më kanë ngritur gjithmonë humorin. Jam i lumtur që të kam njohur. Të uroj shumë sukses dhe lumturi në të ardhmen.

Moana Gorezi:

Denis, faleminderit për gjithë kënaqësinë dhe humorin që ke sjellë në klasë. Je një njeri i shkëlqyeshëm dhe gjithmonë ke diçka interesante për të thënë, sidomos në orën e anglishtes. Jam e lumtur që të kam patur në klasë këto dy vite. Të uroj shumë sukses dhe fat në të ardhmen!

Keti Bardhoshi:


Si e ke krahun Denis? Nuk ka gjë ma thuaj përsëri nesër. Qëkur u takuam në klasë të njëmbëdhjetë vendosa që ti je një njeri me pikëpamje të veçanta dhe për temat më të thjeshta. Më pëlqejnë ata njerëz: që kanë mendime të thella për atë që ka rëndësi. Je një person me të cilin mund të flasësh për gjithçka, nga çfarë i bën insulina sistemit tonë deri te menytrat si ne njohim veten. E di që në të ardhmen tënde ka nja mori me zbulime për mendjen njerezore dhe shpresoj të kem mundësinë të degjoj sa më shumë për to. Uroj të jetosh një jetë sa më të lumtur e plot suksese!

Erisa Noga:

Padyshim që ke buzëqeshjen dhe sytë më të bukur nga e gjithë klasa. Para se të të takoja ty nuk kisha njohur kurrë një djalë që i skuqen faqet kur flet. Ajo cka më pëlqen më shumë është disiplina që ke krijuar tek vetja. Të uroj që të jesh përherë kaq i qeshur sa tani! Suksese dhe pac fat ne jetë!

Amarda Islami:

O “Edi Rama” i klasës 12-H, Kjo klasë nuk do të ishte aq e veçantë pa humorin tënd unik, duke i mbushur ditët me plot argëtim e të qeshura. Mund të them që je një person shumëfunktional në klasën tonë. Humorist po, rolin e psikologut të klasës e luan më së miri, mos të të them edhe gjeograf (na ke përfaqësuar denjësisht edhe në Olimpiadën e Gjeografisë duke zënë vendin e dytë në Shqipëri). Je në dilemë se çfarë dege do zgjedhësh mes Biologjisë e Psikologjisë, por për mendimin tim je i lindur për psikolog dhe jam e sigurt që i ke aftësitë e duhura për t’ia dalë mbanë. Nuk kam ç’të them më shumë veçse të uroj shumë suksese dhe të të shoh në të ardhmen lart e më lart!



Elajda Nesim

Elajdaa imee, shoqja ime më e mirë, pa ty gjimnazi sdo kishte kuptim, sdo shtyhej fare madje. E di që mund ti kemi besdisur të tjerët me të qeshurat tona dhe diskutimet e gjata që bënim, por u mesuan me ne mendoj dhe si bente me pershtypje, madje kur njera nga ne mungonte jam e sigurt i mungonte dhe klases pozitiviteti që ne percillnim dhe ishte me e qete sec duhej... Te mirat e tua smendoj se permenden dot te gjitha ketu, sepse jane goxha. Megjithate me pak fjale mund te them se thuajse te gjitha kujtimet e bukura qe une do mbaj mend nga gjimnazi do te te kene dhe ty te perfshire. Kemi qeshur aq shume me njera tjetren per gjera nga me te ndryshmet. Peverc momenteve te kaluara ne shkollë, kemi shume kujtime te bukura dhe jashte saj dhe e sigurt qe do te kemi shume me shume ne vazhdim. Kam qene jashtezakonisht me fat qe kam njohur nje njeri si ti, qe kishte te njejtin sens humori dhe shume ngjashmeri te tjera me mua. Jane te rralle per mua njerezit qe me percjellin te njejtin pozitivitet si ti dhe jane po ashtu ta rralle njerezit qe me bejne te kem besim te plote per ti thene cdo gje me detaje. Nga ty pranoj dhe komente negative apo keshilla, gje qe veshtire ta marr njesoj nga te tjeret sepse e di qe kur eshte nevoja, ti ti thua gjerat pa korniza dhe ta do te miren. Po e mbyll ketu kete dedikim duke uruar me gjithë zemer te kesh një të ardhme ashtu siç e ke dëshiruar, sepse e meriton me se shumti Kiara Olldashi

Nuk mund ta nis këtë shkrim më mirë se duke të të thënë që je vajzë shumë e lezetshme dhe e jashtëzakonshme. Duke pasur prasysh dhe rrethin tënd shoqëror të jep mendimin e asaj vajze që të pëlqen të të kuptojnë qoftë dhe për gjëra të vogla. Je e drejtpërdrejtë, e qetë, me vetbesim, e qeshur dhe që i mbështet miqtë e tu. Ashtu si dielli, i ndriçon ditën

personave te afërt.
Sibora Nezha

Elajda Nesimi, si fillim kërkoj falje për të gjitha rastet që të kam bezdis me pyetjen : “Dhe sa minuta do që të mbaroj ora?” dhe njëkohësisht të të falenderoj që je përgjigjur përherë me buzëqeshje dhe durim. Je një vajzë shumë pozitive dhe lozonjare. Të uroj shumë suksese dhe fat në jetë!- Erisa Noga

Pasi u ndanë klasat në nëntë-vjeçare nuk prisja të ishim përsëri në të njëjtën klasë, por viti i fundit e bëri këtë të mundur. Je një njeri shumë i qetë (dhe kur klasa është gati të pëllcasë) dhe një person me të cilin mund të flasësh pa u gjykuar. Të uroj vetëm suksese dhe lumturi!- Keti Bardhoshi

Eli do më marri malli të të kem në klasë. Humori yt më pëlqen shume dhe ti si person me jep shumë energji positive. Që në klasë të tetë kur jemi njohur më ke lënë një pershtypje të mirë që vazhdoj ta kem edhe sot. Ke një humor mjaft unik që I pershtatet shumë karakterit tënd. Këto pesë vite ku të kam njohur kanë qenë shumë të bukura dhe shpresoj të ketë të tjera. Te uroj shumë suksese në të gjitha drejtimet!- Luisa Spahiu

Elajda je një shoqe shumë e mirë dhe ke një personalitet shumë të lezetshëm. Gjatë kohës që qëndrojmë bashkë ja kalojmë shumë bukur dhe bëjmë shaka dhe gjithmonë na thonë zyshat :” Uleni zërin mos flisni”. Shpresoj të të plotësohen pikësynimet e tua dhe Suksese!- Deivi Gani

E dashur Elajda, dibranja tjetër e klasës sonë, Këto ndryshimet e klasave, koha e shkurtër nuk na kanë dhënë mundësinë të krijojmë një miqësi shumë të afërt por për kaq kohë kam arritur të shoh tek ti figurën e vajzës lozonjare, shumë femërore, me të qeshurën që të karakterizon ty si person. Të uroj një rrugë të mbushur me shëndet, sukses e lumturi Elajda! Shumë suksese dhe shpresoj që të kesh një të ardhme sa më të ndritur! -Amarda Islami

Elajda , një vajzë e qetë , e duruar dhe punëtore. Dyshja jote me Kiarën i jep një ngjyrë ndryshe klasës. Gjithmonë e edukuar dhe e sjellshme. Që kur të kam njohur asnjëherë nuk ke ndryshuar, e njëjta Elajdë. Të uroj suksese në vazhdimësi!- Ani Velo



Engin Kilic

Ani Velo

ENGIN ERGIN ETIEN FATI H KILICI. Je personi i parë që njoha që kur erdha një këtë “xhade” të gjatë të edukimit tim në mjedisin e përsosur të turkut. Personi i parë që u njoha, për shkak të njohjes së prindërvë tanë. Ti më njohe me Amarin, dhe më pas me disa të tjerë, prandaj të jam mirënjohës. Nuk ke ndryshuar fare, po ai Engini që qesh tërë kohës, bën shakara, i dëgjohet zëri deri tek klasa tjetër. Ta kam thënë shumë herë që sa herë të shoh ty, më del një buzëqeshje automatike, pa e kuptuar as vetë. Çfarëdo që ti thua, si me magji, mua më mek në maksimum. Humorit tënd të paparë i shtohet lumturia, gëzimi, dëshira për ta ngacmuar Amarin në çdo kohë, dhe ato lëvizjet e veçanta tuat. Në klasë të 9-të, kopjuam dhe e bënim gjithmonë atë lëvizjen e “Dy Lacave” nga Portokallia, e sa herë që ndodhte, qeshnim me të madhe. Eh, kohërat e vjetëra. Këto nuk janë faqet e vetme të kujtimeve tona. Në vitin e parë të njohjes sonë, ndërnuam projektin e fizikës së bashku me Arbrin në mes së orës së gjuhës dhe ia prezantuam zyshës me vrap, sepse nuk donim të dukeshim, edhe pse ajo e kuptoi menjëhere, ngaqë një nga pasqyrat lëvizte tërë kohën. Në vitin e dytë, kujtoj dyshemenë e mbuluar të klasës me sapun dhe ty që rrëshqisje si i çmendur, së bashku me kampionatin e futbollit, kur ndeshjen e parë humbët 6-0 sepse Amari shënoi 2 autogola hahahahahahaha, ndërsa ndeshjen e dytë ku unë isha pjesë fituam 3-0, ku 3 lojtarë ishin nga klasa G dhe Amarin e lamë në stol. Në vitin e tretë Mehmeti na ndau, por Ani u transferua për 0\$ me një kontratë 2 vjeçare në turk. Në klasa të ndryshme, por miqësia ekzistonte akoma, kur të gjeja duke i shpërndarë të tjerëve çumçakiza (edhe tani e bën), duke bërë detyrat, ose duke ardhur anës klasës, e përherë kur vija, thërrisje me të madhe “ANIIIIII”. Memoriet që kemi krijuar vështirë se fshihen nga truri

im, sepse janë legjendare. Uroj që të mos ndryshosh asnjëherë, për asnjëri në botë. Shpresoj që Zoti të të japë gjithçka që ti dëshiron dhe arritsh majat!

Deivi Gani

Engin Fatih Kiliç- .Të njoha para shumë vitesh dhe shiko ku jemi tani në një shoqëri shumë të forte.Kemi kaluar gjithë ato ngjarje në këto vite por nuk I lamë të na prishnin shoqërinë.Je një djal që më ngre humorin dhe më acaron në të njejtën kohë.Të qeshurat që kam kaluar me ty nuk kanë fund dhe jam shumë mirënjohës.Këto vite ne e kemi njohur njëri-tjetrin dhe tashmë jemi sikur jemi njohur gjithë jetën tone. Shpresoj shumë që një ditë të arrish ëndrrat e tua dhe gjithmonë ta kesh jetën e plotë buzëqeshje dhe dashuri dhe mos ta humbasim shoqërine tone pas gjimnazit!

Keti Bardhoshi

Kur erdha në klasë këtë vit as nuk e dija emrin e personit që kisha në bankën mbrapa, por tani një nga shokët e mi më të mirë vjen gjithmonë me vonesë te po ajo bankë. Engin, ndihem shumë me fat që u njohëm këtë vit. Ti gjen gjithmonë një mënyrë për të na bërë për të qeshur. Gjithashtu ke gjithmonë një kartë në xhep për të na nxjerrë nga orët e vështira. Ka qenë një kënaqësi të shpjegojmë vendimet e çuditshme që kemi marrë këtë vit, por kemi mësuar nga gabimet. E di se e ardhmja jote do të jetë shumë e bukur dhe të uroj suksese gjithmonë!

Sibora Nezha

Sido që ka kaluar e po shkon ky vit shkollor, mendimi im për ty ka qenë gjithmonë pozitiv dhe me të vërtetë që ditët e sotme janë të pakët djemtë si ti. Më tepër se enigmatik je një person emocional por edhe i mençur, intuitiv, i butë, i sjellshëm, simpatik dhe shumë impulsiv. E vlerësoj shumë faktin që di të menaxhosh dhe të sillesh më së miri në situata të ndryshme. Përveç se një shok i mirë, jam e sigurt që je vëlla dhe djalë shumë i mirë gjithashtu. Je një mik kreativiteti dhe inteligjence, gjë që nuk është pak impresionuese, dhe mendoj se të bën tepër të veçantë. Lum prindërit që kanë një djalë si ti se je person që mendon shumë për të afërmit e tu, dhe mundohesh të kujdesesh për ta. Shpresoj që të arrish gjërat që do në jetë dhe të kesh të ardhme sa më të bukur dhe të lumtur!

Erisa Noga

Je padyshim djali më i çiltër dhe më i buzëqeshur që më ka rënë rasti të njoh. Të falenderoj pa masë për cdo bisedë dhe shaka që kemi shkëmbyer gjatë kësaj kohe. Të uroj shumë suksese, fat dhe lumturi në jetë!



Erisa Noga

Erisa, faleminderit për çdo çast që kemi kaluar bashkë këtë vit. Jam shumë e lumtur që u ribashkuam sërish në të njëjtën klasë pas një viti pak të vështirë dhe të pakëndshëm. Je një ndër personat më të sinqertë dhe më të bukur (si brenda, si jashtë) që njoh, si dhe ndër shoqet më të afërta që kam patur në shkollë. Ke gjithmonë dicka interesante për të thënë dhe je një person me një zemër të artë. Të uroj me gjithë shpirt një të ardhme të lumtur dhe të suksesshme kudo që të jesh! (Moana Gorezi)

E dashur Erisa! Sa e sa gjëra kemi kaluar së bashku, mbyllja e kolegjit “Mehtmet Akif”, ndryshimi i shkollës e shumë sfida të tjera dhe nuk ia kemi lëshuar dorën asnjëherë njëra-tjetrës. Ke qenë një udhërrëfyese për mua, një këshilluese e denjë, duke më bërë leksione për jetën si një 19-vjeçare që je, me pjekurinë, logjikën dhe inteligjencën që ti zotëron. Sa shpejt kaluan këto vite edhe nuk e di nëse do të të kem prapë afër kur të kem nevojë për atë përqafimin tënd të ngrohtë. Po të paktën largësia nuk mund të zvogëlojë kujtimet dhe lidhjen e fortë mes njëra-tjetrës. Faleminderit që i ke bërë këto vite të veçanta duke u bërë pjesë e jetës sime! Të uroj gjithë suksesin dhe lumturinë e botës zemër! Të dua shumë, nga Ami yt (Amarda Islami)

Të pakta kanë qenë diskutimet që kam pasur me Erisën, e madje një prej tyre ka qenë një debat e bukur mbi kuzhinën italiane dhe greke. Duket e maturuar në mënyrën si vepron. Nuk duket sikur përflet ndokënd dhe duket e matur në atë që thotë.” Duhet ta them që ky përshkrim duket sikur përputhet një me një me personin që kam përditë në klasë, dhe janë cilësi disi të rralla për një bashkëmoshatar tonin. I uroj sa më shumë suksese në jetë dhe studimet e mëtejshme! (Etien Dhima)

Je një rast që vërtetë nuk duhet marr parasysh mendimi i të tjerëve. Dua të them, tek ti kam njohur një person ndryshe nga ç’dija. Je një vajzë e ëmbël, e bukur, shumë e zgjuar dhe e edukuar. Më pëlqen fakti që di si të sillësh me të tjerët, je e afrueshme dhe vajzë e rritur, me këmbë në tokë. Nuk mund të harroj pa përmendur tështimën tënde. Është shumë e lezetshme. Shpresoj të arrish gjërat që do në jetë dhe të kesh veç sukses! (Sibora Nezha)

Ky dedikim shkon për atë vajzën kacurrelse që bashkë krijuam momente të paharrueshme. Tani që e mendoj ne kemi qenë përherë në klasë bashkë nga Mehmeti deri në Turgut. Filluam duke i marrë librat njëra tjetrës për të lexuar se kishim një pasion të përbashkët, leximi. Falë Mehmetit, ne u njohëm ama falë Turgutit, ne krijuam një miqësi jete. Shumë shpesh mendoj ti për mua nuk je thjesht një shoqe e ngushtë, por si një motër e madhe që e di për cdo situatë do ketë një mendim. Mbase Turguti kishte të metat e veta por të paktën na dha njëra tjetrën. Kujtimet që kemi lënë në atë shkollë janë të pafundme nga t’ia fillojmë nga lënia e orëve mësimore saqë dhe çunat u bënë xhelozë që i linim më shumë se ata, marrja e telefonave, vizatimet në bankë, mesazhet e fshehura nëpër libra, bisedat për të ardhmen, vizionet tona, takimet te psikologjia, të shkuarit në bibliotekë për të mësuar, ngritja në orën 4 të mëngjesit për të mësuar, shpjegimi i mësimin nga njëra tjetra, blerja e byreqeve apo bisedat në telefon një ditë para për të planifikuar ditën e nesërme sipas mënyrës sonë e shumë të tjera. Të gjitha këto momente janë kthyer në kujtime nostalgjike për ne sepse pa e ditur këto na afruan aq shumë me njëra tjetrën që ne e dimë. Kur shkova në Amerikë mund të kisha dyshime për shumë marrëdhënie por asnjëherë për këtë tonën sepse ne e dinim we have each others back for everything. Ne nuk flisnim përditë por nëse diçka ndodhte ishim të parat që telefonim njëra tjetrën për të treguar të rejtat e fundit. Ajo distancë tregoi më së miri sa e fortë është miqësia jonë dhe më shumë se ne janë të lidhura mendjet tona. Faleminderit për këto kujtime nga shpirti! Faleminderit që je shoqja ime dhe më shumë se aq! Faleminderit që je pjesë e jetës sime! To be continued..... (Megan Koçi)

Erisa je një shoqe që çdokush do të donte ta kishte, e qeshur, e zgjuar, përkrahëse dhe shumë e dashur. Pjekuria jote është për tu admiruar. Do më mungojë shumë prezenca jote pasi të mbarojë gjimnazi. Në fund të ditës je braziliana më e bukur nga Saranda. Të përqafoj fort, Sabi! (Sabjan Haska)



Ester Rembeci

E dashur Ester, që në momentin e parë kur të pashë e pata zili atë qetësinë, maturinë dhe pozitivitetin tënd. Je një vajzë me karakter të fort dhe mendoj se kështu do ecësh përpara. Të uroj shumë suksese dhe fat në rrugëtimin e gjatë të jetës. - Erisa Noga

E dashur Ester, Që në ditën e parë që të takova, gjëja që më la përshtypje ishte ëmbëlsia dhe qetësia jote. Për kaq pak kohë që kemi kaluar bashkë, ia kemi dalë të krijojmë një miqësi të bukur me plot momente qesharake që do mbeten gjatë në mendjen time. Meqënëse fundi i vitit po afron dhe na pret një rrugëtim edhe më i vështirë e plot sfida, të uroj një vit sa më të mbarë dhe suksese në çdo hap të jetës tënde! - Amarda Islami

Të karakterizon sinqeriteti dhe dashamirësia. Je gjithmonë aty për t'i ndihmuar të tjerët. Je e drejtpërdrejtë, gjë që bën të kesh një shoqëri të përzgjedhur. Dhe ndihem e lumtur që jam pjesë e shoqërisë tënde, sepse e di që nuk kam miq të pabesë dhe fallso. Je unike. - Alesja Quku

Ester, faleminderit për çdo moment të këndshëm që kemi ndarë këtë vit. Je një vajzë tepër e sjellshme dhe interesante për të folur. Ke një shije të mrekullueshme për muzikë. Jam e lumtur që pata mundësinë të të kisha në klasë këtë vit. Të uroj një të ardhme plot me lumturi dhe suksese! - Moana Gorezi

Një nga miqtë e rinj të gjimnazit, Esterin, e takova në një mënyrë disi të pazakontë: prej shijeve muzikore. Është një shoqe me të cilën ndihem i lirë të diskutoj çfarëdolloj teme që ka të bëjë me pasionet e mia dhe me këngët e reja që zbuloj. I uroj suksese në të ardhmen që e pret. - Etien Dhima

Kur të njoha e kuptova direkt që je vajzë shumë e mirë dhe me ftohtësine e duhur që duhet të ketë një person. Isha e sigurt që do arrija të të njihja më shumë atë personin e fshehur brenda teje dhe mendoj se e njoh çdo ditë e më shumë. E vlerësoj shumë sjelljen, mençurinë, shijet e tua në muzikë, butësinë, sinqeritetin dhe faktin që sheh futboll. Jam e sigurt që ke për të arritur shumë suksese dhe ta uroj me gjithë zemër! - Sibora Nezha

Ester të jam falenderues për kënaqësinë që ke sjellë në jetën tonë shkollore. Të shoh duke përparuar me guxim dhe ndriçuar me inteligjencën tënde. Suksese në udhën tënde të shkëlqyeshme! - Deivi Gani

Dhe pse jemi njohur së fundi mund të them se ti je një vajzë me të cilën bisedat ndihen të pasforcuara dhe pa paragjykim. Mund të qeshim dhe mund të diskutojmë mbi tema të rëndësishme me lehtësi dhe për këtë arsye jam shumë e lumtur që jemi në një klasë. Je një njeri që sheh pjesën e bukur të ngjarjeve dhe kjo është shumë frymëzuese. Jam e sigurtë që e ardhmja ruan arritje të mëdha për ty, por më e rëndësishmja është që të të plotësohet çdo dëshirë që mban pranë! - Keti Bardhoshi

Ester ne kete vit u njohem dhe pavaresisht se pak kemi folur te njoh aq sa per te thene qe je dikush me ambicie te forta dhe qellime te larta ne jete. Ke nje karakter te qete dhe te kontrolluar dhe kjo karakteristike e jotja do te te ndihmoje qe te ecesh me hapa shume te suksesshem ne rrugetimin tend. Te uroj me te miren per te ardhmen! - Klea Kaloshi

Esteri, vajza më e qetë e klasës. Që kur erdhe tek 12H, u ule në bankën e parë, që tregon dëshirën tënde për të mësuar. Ti je një vajzë e zgjuar dhe punëtore. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në jetë! - Ani Velo

Shumë kënaqësi të të kisha në klasë këtë vit. Je një vajzë shumë pozitive, e qetë dhe e thjeshtë. Shpresoj që të kesh një të ardhme sa më të suksesshme dhe të të plotësohen të gjitha dëshirat! - Amisa Lasha

Ester, fillimisht dua të të falenderoj për kujtimet e fituara këto muajt e fundit. E çmoi me të vërtet shoqërinë tonë pasi ndjej se bashkë arrijmë gjithmonë të gjejmë një gjuhë të përbashkët. Kështu te uroj shumë fat dhe suksese ne të ardhmen. - Marson Aga



Etien Dhima

Esteri Rrembeci 12H

Etien, ti je një nga personat më unikë që njoh. Sensi yt i humorit gjithnjë të ngreh energjitë pozitive. Tipari që ty të karakterizon më së miri është dashamirësia jote si dhe dëshira jote për të ndihmuar të tjerët. Ti gjithashtu ke një shije të shkëlqyeshme në muzikë, gjë që persëri reflekton personalitetin tënd. Të uroj gjithë të mirat në jetë!

Amarda Islami 12H

Grupi më i famshëm “Vive la revolution”, nuk mund të formohej pa ty si pjesëtar. Ia kemi kaluar bukur së bashku duke filluar nga bisedat, momentet qesharake, prandaj kam shumë kujtime që do mbeten gjatë në mendjen time. Jam e lumtur që pjesë e listës sime shoqërore tashmë i je shtuar edhe ti. Di që ke aplikuar në një universitet në Milano dhe ke shumë dëshirë të të pranohesh atje. Jam e sigurt që do ia dalësh mbanë. Nuk më ngelet gjë tjetër veçse të të them paç fat dhe të uroj shumë suksese!

Marson Aga 12H

Etien, nëse ka një gjë që kam kuptuar vitet e fundit është se, unë sdo të isha kush jam sot pa ty. Ti më ke mësuar kaq shumë prespektiva të reja, histori të veçanta dhe morale të forta, por dhe kjo është e pakët në krahasim me zemërgjerësinë tënde. Më ke pranuar për ç’jam dhe më ke hapur dyert drejt një jete plot lumturi dhe histori. Sigurisht e mundur prej shoqërisë tende, gjë që e çmoj tej mase. Për më tepër më rrite standartet për të qenit vetja dhe për të ndjekur çdo gjë që dua në jetë. Shpesh kuptoj se sa me fat jam të kem një mik të tillë, gjithmonë aty për ty dhe më e rëndësishmja, gjithmonë zemërhapur. E di me gjithë zemër se në të ardhmen do vazhdoj të jesh vetja, dhe për më tepër të arrish shumë si një person. Te uroj

fat në të ardhmen dhe përzëzohet çdo mik tëndin të ardhshëm për fatin që do të njohin.

Enio Kazazi 12-J

Shoku im më i ngushtë, kemi më shumë se një dekadë që jemi shokë. Unë jam një besimtar i fortë në idenë që mendjet brilante kanë një mënyrë për të gjetur njëra-tjetrën, prandaj nuk ka qënë koinçidencë që ne klikuam si shokë pa vështirësi. Kur shoh mbrapa në kohë arrij të shikoj 12 vite të shkelqyera, gjithashtu mund të shoh evolucionin që kemi patur, ku ishim dhe ku jemi, vërtetë e kemi kthyer veten në art. Dhe më beso, nuk e kemi arritur akoma pikun tonë në artin e krijimit. Mezi pres të shoh performancën tënde. Suksese, do bësh gjëra të mëdha, më beso: Vërtetë je një kampion drite.

Ani Velo 12H

Të kam parë në fillim në korridoret e kompleksit, e më pas jemi njohur në testet provë në klasën e 9. Ai flokverdhi, dhe çuditërisht ta mbaja mend fytyrën, prandaj bëra edhe lidhjen me emrin ndonëse kishim kohë pa u parë. Si atëherë dhe tani, jeni në të njëjtën bankë, ti dhe Brendisi. Gjithmonë me atë lëvizjen tipike tënden. Je një djalë i zgjuar dhe punëtor, ku duket në kreavitetin tënd për ndërtimin e robotëve, që ti e ke me aq pasion. Gjithsesi je po ashtu i pari që ke vendosur muzikë “të çuditshme me kitarë të shekullit 15”, e që më ke kritikuar shumë për këtë term, por gjithsesi e kemi pranuar. Të uroj gjithë të mirat dhe shpresoj që mos të të iki pasioni për ata robotët!

Arbri Peka 12H

Etieni është një person që do të ishit me fat ta njihnit. Edhe pse nuk duket në shikim të parë ai ka një personalitet që disa do ta quanin paksa, eksploziv. Ai është plot surpriza. Shija e tij në muzikë është një ndër me interesantet dhe me të vecantat që kam parë ndër shumë e shumë persona. Ai është gjithmonë vetvetja dhe nuk i intereson fare se cmendojnë të tjerët. Është person i sinqertë dhe i qeshur. Historitë e tij të cilat ngjajnë si skenare filmash komike nuk zhgënjëjnë asnjëherë dhe është e habitshme të mendosh që të gjitha janë histori të vërteta, gjë që i bën ato edhe me qesharake. Një gjë tjetër që adhuroj tek Etieni është talenti i tij në vizatim, që sinqerisht është shumë mbresëlënëse. Etien jam i lumtur që u ritakuam sërish pas shumë vitesh dhe që nuk e kemi humbur shoqërinë tonë që nga klasa e 5. Jam falenderues për këtë shoqëri dhe të uroj më të mirat në jetë. Shpresoj të te plotesohen të gjitha endrrat që ti ke.



Keti Bardhoshi

E dashur Keti,

Nuk kishte mundësi që në listën e letrave të mia të mos ishte një letër për vajzën që i jep gjithë energjinë klasës 12-H dhe më beso që ndihet mungesa jote nëse nuk vjen ndonjë ditë në klasë. Çiltërsia jote, buzëqeshja, mirësia, janë të gjitha këto cilësi që të bëjnë të veçantë për mua. Jam shumë e lumtur që pata mundësinë të të njihja sepse je një ndër personat që më bën të ndihem mirë dhe më mbush me pozitivitet. Sukseset që ti ke arritur deri tani nuk janë çudi, sepse ti i posedon të gjitha aftësitë për t'i arritur ato. Uroj që rrugëtimi yt në të ardhmen të jetë plot me suksese dhe kënaqësi! Nga shoqja jote Amarda Islami

Keti, nuk kemi shumë kohë që njihemi por gjithmonë më je dukur si një person shumë pozitiv dhe i qeshur saqë më bën edhe mua të qesh. Jam shumë i lumtur që të njoha. Të uroj sa më shumë sukses në të ardhmen dhe lumturi në jetë

-Alvi Elezi

Je ndër me personat më të përgjegjshëm, të sjellshëm dhe të qeshur që kam takuar kohët e fundit. Gjithmonë je tepër pozitive dhe shikon më të mirën te njerëzit. Jam me fat dhe tepër e lumtur që të kam pasur në klasë këto dy vitet e fundit. Të uroj një të ardhme sa më të suksesshme dhe të lumtur!

-Moana Gorezi

Ky vit do të ngelet shumë gjatë në mendjen time sepse kam njohur shoqëri të vërtetë. Ndër ta futesh dhe ti Keti. Je një vajzë e zgjuar dhe e mbushur plot me pasion, vullnet dhe pozitivitet. Shpresoj që jeta të tregohet bujare me ty! Të uroj shumë fat dhe lumturi!

-Erisa Noga

Keti, ti je një vajzë shumë e çiltër dhe shumë e dashur. Ëmbëlsia dhe dashamirësia jote reflektohen që në sytë e tu, si dhe buzëqeshja jote e cila mund të ndriçojë çdo dhomë. Ti je një vajzë unike. Unë të uroj shumë suksese e fat për të ardhmen!

-Ester Rëmbeci

E di se një ditë, kur të shihemi përsëri, përpara meje do të kem një avokate dhe një vajzë të sukseshme në çdo aspekt. Argumentet që jep në diskutimet në klasë më lënë pa fjalë. Pa diskutim që do të më duhen njerëz me nivel si ti rreth meje, prandaj mundohem të shijoj energjinë që ti i sjell kësaj klase. Pozitiviteti yt bën që këto vite të mbahen mend. Të uroj shumë suksese dhe po pres të vijë ajo dite!

-Denis Feto

Miqësia jonë ka nisur që në klasë të 8-të, pa e menduar se një ditë do të ishim në të njëjtën klasë. Je një vajzë e zgjuar, studioze dhe shumë sociale. Por gjëja që më ka bërë përshtypje tek ti ka qenë interesi i thellë ndaj librave, botime të rinj e të vjetër, autorë të dëgjuar apo jo. Ti i njeh të gjithë. Kjo duket kur për çdo njërin prej tyre që përmendet nga zysha e letërsisë, Keti e vetmja ka një informacion për të, kur të tjerët as nuk e dinë se kush është. Një "Hillary Clinton" e vërtetë, po që adhuron shkrimet e Fishtës dhe Migjenit. Të uroj suksese në jetë dhe shpresoj që të bëhesh një gjykatëse e zonja!

-Ani Velo

Më vjen mirë që jemi afruar bashkë këtë vit! Kam zbuluar që ndajmë shumë interesa të përbashkëta dhe më pëlqen që bëjmë diskutime "filozofike" bashkë. Më pëlqen këndvështrimi yt në përgjithësi dhe më pëlqen buzëqeshja që është gjithë kohën prezente në fytyren tënde. Përkushtimi dhe mënyra jote e të organizuarit gjithmonë më mahnit dhe në të njëjtën kohë më Inspiron të bëhem pak më shumë si ti. Ti të fal qetësi por në të njëjtën kohë të jep dhe entuziazëm në momentet e duhura. E vërtetë që kemi pak pëlqime gjyshesh, por nuk e shoh problemin ;). Shpresoj dhe jam e sigurt që do të arrish qëllimet e tua në jetë dhe shpresoj të mos i humbasim kontaktet! Të përqafoj!

-Luisa Spahiu



Kiara Oлдashi

Kiara, faleminderit për çdo moment të këndshëm që kemi kaluar këtë vit. Je një person i mrekullueshëm për të folur dhe shumë inteligjente. Jam e lumtur që pata mundësinë të të kisha në klasë këtë vit. Të uroj një të ardhme plot me lumturi dhe sukses kudo që të jesh!

Moana Gorezi

Do të më kujtohet gjithmonë Kiara që sa herë ktheja kokën pas në orën e anglishtes e shihja me Elajden ose duke ngrënë ose duke krehur flokët. Përpos kësaj je vertetë një vajzë shumë e qetë, e bukur dhe inteligjente. Të uroj sa me shumë suksese dhe lumturi.

Erisa Noga

E dashur Kiara,

Teksa po përgatisja letrat për këtë vit të fundit shkollor, nuk mund të mungonte as një letër për ty. Në këtë letër dua të shpreh mirënjohjen time për momentet e bukura që kemi kaluar bashkë. Gjatë kësaj kohe kam vlerësuar tek ti feminitetin, buzëqeshjen dhe pozitivitetin që ti përhap. Të uroj shumë suksese! Qofsh e lumtur dhe uroj që të arrish çdo gjë që dëshiron!

Amarda Islami

Hemm kiaraa cfare mund te them per tyy. Jam afruar me ty më shumë gjatë gjimnazit edhe pse njiheshim dhe me përpara dhe kam kuptuar sesa person i vecante je. Për mendimin tim je një nga njerezit më të organizuar dhe më të logjikshëm që njoh. Ndonjëherë me habit se sa sistematike je dhe kjo eshte dicka shumë e mirë. Në të njëjtën kohë di të jesh e dashur por edhe moskokëçarëse gjë që të jep një lloj sharmi në karakterin tend. Më pëlqen ngushëllimi që gjejmë te ai grupi "Kryqi i kuq" bashkë me Altean dhe fakti që në atë grup vetëm për kryqin e kuq nuk është folur

(injorojmë edhe faktin që nuk shkuam kurrë te asnjë aktivitet). Përpos kesaj, ms pslqen sensi yt i humorit që të shton një hijeshi edhe me te vecante. Nuk dua ta zgjas me shume prandaj po e mbyll duke te uruar sa me shume suksese dhe duke uruar qe te mbetemi shoqe te mira edhe mbas gjimnazit!

Luisa Spahiu

Kiara, je nje vajze pozitive, shume inteligjente dhe gjithashtu shume gallate pasi te njeh. Bashke jemi njohur ne klase te 9 dhe gradualisht kemi krijuar nje shoqeri shume te mire. Mund te them se je bërë një nga shoqet e mia më të mira dhe cdo gjë që ndodh verdallë mezi pres ta diskutojme bashke. Me pelqen stili yt dhe energjia qe ti percjell. Kemi krijuar kujtime mjaft te bukura këto vite që do ti mbaj gjithmonë mend. Jam shume e lumtur që kam njohur një person si ty dhe shpresoj ta ruajme shoqerine dhe me tej. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj të plotësohen të gjitha dëshirat!

Altea Gjinaj.

Kiaraa, pervecse je nje vajze shume e embel dhe e dashur u bere nje shoqe e pandashme per mua gjate ketyre viteve te gjimnazit. Me ke mbeshtetur ne cdo moment edhe ne momentet e tua jo me te mira me ke qendruar gjithmone prane dhe jam shume falenderuese per kete. Kjo kohe nuk do te kishte kaluar keshtu nese nuk do te te njihja ty dhe per kete jam shume e sigurt. Te qeshurat tona qe degjoheshin kudo neper shkollë e humoret qe mbase te tjeret nuk i kuptonin do te mbeten te paharrueshme. Do me mungojne shume bisedat qe benim gjate oreve duke bezdisur pak dhe pjesen tjeter te klases. Miqesia jone do te ngelet gjithmone nje dhurate shume e bukur per mua pavarisht se sa larg mund te jemi ne te ardhmen. Vertete ndihem me fat qe kam njohur nje njeri si ti qe me kupton aq mire cdo gje qe un them e mendoj. Uroj shume te te plotesohen te gjitha dëshirat, duke e ditur qe mua do me kesh prane duke te mbeshtetur ne cdo moment.

Elajda Nesimi

Kiara, një vajzë studioze dhe sociale në të njëjtën kohë. Jemi njohur në klasë të 9, por viti i fundit i gjimnazit na vendosi në një klasë. Ke treguar që asnjëherë nuk të kap dot të papregatitur, që rrallë ndodh midis nxënësve. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në jetë!

Ani Velo



Klara Muça

Je nje nga vajzat me karakter me te forte qe njoh. Je e vendosur ne ate qe mendon dhe punon fort per ate qe ti do. Te njejtën gjë e aplikon dhe ne marrëdhëniet me njerëzit rreth teje. Dashuron fort dhe sa here dikush është ne nevojë të ndihmës tënde ti je e gatshme për ta ofruar atë pa e menduar dy here. Sa here që vije nga udhëtimet e tua rreth botes ishe duar plote me dhurata dhe gjithmone na merrje dicka të re për të provuar, sillje një pjesë të aventurës tënde tek ne. Shpesh here admiroj rrugetimin tënd deri sot. Je një vajzë e cila nuk heziton të vendosi shenjen e saj aty tek shkel dhe jam e sigurt që ne të njëjtën mënyrë nuk do të ja lejosh botes të harrojë atë kush ti je. Shpresoj që endrat të cilat ke shijestruar të behen realitet dhe me shume se aq.- Me dashuri, Klea

Klara, edhe pse kemi vite që njihemi, viti i fundit më ka bërë të njoh më nga afër dhe të kuptoj pozitivitetin që ti përcjell dhe sa zemër të mirë ti ke. I admiroj shumë përkushtimin që ti ke ndaj shoqëve, shijet e tua dhe opinionet e sinqerta që ti gjithmonë jep, të cilat gjithmonë do të marrë në konsideratë. Momentet e këtyre tre viteve me ty do të më sjellin gjithnjë kujtimet më të mira. Të uroj më të mirat e shpresoj që të arrish atë që ti dëshiron! ~ Kiara Olldash

E dashur Klara,
Çfarë më ka bërë përshtypje tek ti gjatë gjithë kësaj kohe është se në çdo moment ruan qetësinë dhe asnjëherë nuk ndërhyr në punët e të tjerëve. Është për t'u vlerësuar tek ti mënyra se si ti i shikon gjërat me objektivitet dhe me një prespektivë të qartë. Do të doja të të kisha njohur për një kohë më të gjatë sepse çdokush do të donte që të kishe pranë vetes një vajzë si ti. Të uroj më të mirat Klara! Shpresoj që çdo ëndërr e jotja të bëhet realitet!- Nga Amarda

- Klara je një nga vajzat më ambicioze që njoh, je shumë e sjellshme dhe ndonjëherë nuk ta përton. Ke një sens shumë të bukur të veshuri dhe shpresoj ta kesh të tillë vitet e tjera. Gjithmonë kur kemi pas bërë muhabet na ka shkuar shumë mbare dhe kemi pasur të njëjtat mendime mbi gjërat. Çdo herë që të kam treguar mbi problemet e mia gjithmone më ke këshilluar se çfarë duhet të bëj dhe në qoftë se jam gabim apo jo. Të më falesh që këto vite që kaluan që të kam acaruar sidomos kur të merrja bidonin e ujit. Shpresoj mos ta humbasim shoqërinë dhe të mbajmë kontakte. Sukses! ~ Deivi Gani

Dhe kur ne jemi të shfazuara nga sezoni i provimeve, ti je gjithmonë e qetë dhe me flokët në gjendje të përkryer. Mund të shkojmë nga diskutime serioze në shaka brenda pesë minutash dhe prej kësaj jam shumë e lumtur që u njohëm këtë vit. Uroj që të jesh gjithnjë e lumtur dhe të arrish çdo qëllim që ke në jetë! ~ Ketii Bardhoshi

Si personi më i qetë në klase, nuk di nëse kam arritur të njoh tamam Klaren, por jam e sigurt që kam kuptuar saktë që përpos bukurisë që të karakterizon, je person shumë pozitiv, që krijon momente të bukura dhe argëtuese për kedo. Do gjithmone të arrish diçka që do, duke qenë dhe e dretë me të gjithë, e arrin atë. Je gjithashtu e shkathët, e zshuar, e sjellshme dhe që i respekton të tjerët. Uroj të kesh një të ardhme sa më të bukur! ~ Sibora Nezha

Klara, padyshim je njeriu më i paqetë dhe më i buzëqeshur që njoh. Edhe pse nuk kemi shkëmbyer shumë biseda me njëra-tjetrën përsëri ja vlen të thuhet se ishte një eksperiencë e bukur të të kisha në klasë. Të uroj shumë suksese dhe pac një të ardhme të ndritur! ~ Erisa Noga

Nuk e besoj dot që kanë kaluar pesë vjet që kur jemi takuar, që në atë klasën e 8 të famshme. Je një vajzë e qetë, moderne dhe me kaçurrela të gjatë e lezetshëm, edhe pse ty të pëlqen ti shtrish ato gjithmonë. Së bashku kemi momente të bukura, të qeshura, shaka të vogla dhe një mori histori të rastësishme. Shijet e tua janë të veçanta, që nuk krahasohen me asnjë tjetër, sidomos kur vjen fjala të k librat e parapëlqyer. Të uroj gjithçka që dëshiron në këtë jetë të gjatë! ~ Ani Velo



Klea Kaloshi

Ani Velo

Aldo Bosi gati ktu. Rrugët na i bashkoi klasa e 8. Memoria e parë që më vjen ndër mend është banka e fundit e klasës së 8F, të ulur dy kushurinjtë bashkë. E pastaj hapet libri i madh i fotove të shkrepura nga truri im, shakatë me Amarin, xhirot në “go-karting”, koncertet dhe vallet ku ti bëje pjesë, pa harruar atë këngën me Eneda Tarifën, lojërat e vollejbolit, bisedat pas shkolle tek kantina dhe shumë të tjera. Tek ti më pëlqen fakti që je e drejtpërdrejtë dhe e sinqertë. Kjo bën që ti ta përzgjedhësh shoqërinë tënde, duke i larguar njerëzit jo të duhur. Shkolla nuk të shqetëson, pasi je e lindur me dhuntinë e të krijuarit art, qoftë duke vizatuar ose duke kënduar. Por edhe dega që ti mendon të vazhdosh, arkitektura, ka një kombinim të shkencave sociale dhe natyrore, ku tregon aftësinë tënde në çdo fushë. Mos të kalojmë tek “zëri më i mirë në të gjithë shkollën”, e këtë e vërtetojnë çmimet vit pas viti, duke iu kaluar të gjithëve. Kam parë njerëz që qajnë duke të dëgjuar ty kur këndon, dhe kjo nuk është pak. Uroj që ti ta arrish potencialin tënd gjigand dhe suksese në ciladoqoftë karriera jote!

Engin Kilic

Klea, nje vajze e cila ka nje talent te jashtezakonshem ne muzike me nje ze te mahnitshem. Gjithmone perfaqesuesja me e mire per shkollen tone ne cdo vend. Jemi njohur ne klase te tete dhe qe ditën e pare kemi pasur nje afrimitet i cili me von u kthye ne nje marredhenie shume me te mire u bem shok te ngushte. Gjate gjithë kohes ke qene nje njeri qe dallohej per energjin e vecante qe i jep klases ate mundimin qe jo shume njerez do kishin per te tjeret ne klase dhe ne shkolle. Ke menduar te miren per te gjithë ne cdo rast ne cdo suate te mundshme. Uroj qe te kesh nje karriere ne muzike edhe me te madhe e ta vazhdosh

kete rrugetim ne jete e te kemi kontakte te perherta kudo qe te jemi ne bote. Uroj me te miren per ty e familjen tende dhe jam i sigurte qe familja jote eshte krenar per ty.

Klea eshte nje person me kembe ne toke qe te fal siguri ne veprimet qe ben me nje lloj qetesie e cila te ben dhe ty te ndihesh e qete. Imazhi qe me vjen ne koke kur mendoj Klean, eshte nje vajze e bukur me sy bajame qe reflektojne ate cka Klea eshte ne shpirt: pozitive, e mbushur plot jete por me nje lloj qendrueshmerie dhe serioziteti qe e karakterizon. Me duket e pabesueshme kur mendoj qe kane kaluar rreth 10 vite qe kur jemi njohur dhe me pezmaton fakti qe nuk do jemi me bashke ne nje klase sic kemi qene keto 10 vjet. Me kujtohet ne klase te trete kur kendove kengen Globi perpara klases dhe nuk e di pse ai eshte core memory i imi nga ty. Ke nje ze magjik qe shpresoj ta degjoj ne skena te medha. Me te vertete nuk do jemi me ne klase duke qeshur me njera tjetren por dije qe gjithmone do ti kujtoj momentet qe kemi kaluar bashke me nostalgji. Shpresoj me gjithë zemer te arrish te gjitha endrrat e tua dhe do te jem aty per te festuar!

Me dashuri, Luisa<3

Amarda Islami

E dashur Klea,

Vajza me zërin më të bukur në shkollë, duke bërë kështu krenare edhe klasën 12-H me prezencën tënde. E admiroj seriozitetin, vendosmërinë, qetësinë tënde dhe mënyrën se si shpreh mendimet e tua me maturi dhe përgjegjshmëri. Të uroj shumë suksese Klea! Shpresoj që një ditë të të shoh duke projektuar ndërtesat më të mëdha duke u bërë një arkitekthe e zonja sepse ke potencialin e duhur për t'ia dalë!

Keti Bardhoshi

Para se të të njihja të shihja si Arilena Arën e kohës sonë, por tani që kam pasur fatin të të njoh nga afër kam kuptuar se ti je shumë më shumë se një këngëtare. Je një person që i qëndron mbrapa të vërtetës dhe asaj që beson pa u ndikuar nga të tjerët. Në momente kaotike arrin të qetësoh situatën duke na treguar se jo çdo gjë është aq dramatike. Uroj që të arrish çdo qëllim në jetë dhe të jesh përherë origjinale si tani!



Luisa Spahiu

Amarda Islami- E dashur Luisa, Jam shumë e lumtur që në këtë udhëtim timin kisha dikë si ty pranë. Je një person i jashtëzakonshëm me zemrën e ngrohtë dhe pozitivitetin që ti shpërndan. Për mua koha që kemi kaluar bashkë ka qenë një dhuratë e çmuar që do të mbetet gjatë në mendjen time. Të falënderoj shumë që më je gjendur pranë në momentet e vështira që kam kaluar, duke bërë edhe rolin e psikologes për mua! Uroj që kjo miqësi të vazhdojë edhe në bankat e auditorëve dhe shpresoj që një ditë të mbajmë të dyja veshur ato përparëset e bardha! Na pret një rrugëtim i vështirë e plot sfida po besoj se do ia dalim. Të uroj shumë suksese Luisa!

Ani Velo-Lui, Luisa apo Luiza, tre emrat e tu të lezetshëm, edhe pse ty nuk të pëlqen ajo “Z”-ja e theksuar. E vijnë kujtimet me rradhë, në ditën e parë të shkollës, ti me Klarën në një bankë, kurioze se cili ishte ky nxënësi i ri i panjohur. Ja që ky djalë as që nuk mendonte që do të kalonim 5 vite bashkë, e që këto 5 vite do të mbusheshin me lloj-lloj historish. Ke qenë gjithmonë pranë në momente të mira dhe të këqija, më ke mësuar dhe kritikuar, kemi qeshur dhe jemi “grindur”, e kur këto ndodhnin, thjesht forcohej shoqëria jonë. Një vajzë e sjellshme, me vullnet dhe e sigurt në hapat që bën. Pa harruar pasionin për librat, kur të shihje në pushimin e madh duke lexuar libra të trashë në mes të zhurmës së shkaktuar nga shokët e klasës, dhe unë me vete çuditesha nga përqendrimi jot. Jam i sigurt që tek ti do të gjej gjithmonë një person që të ndihmon pa të gjykuar, gjë që tregon jashtë mase për kulturën tënde. Duke e mbyllur këtu, të uroj çdo gjë që të ëndërron zemra dhe suksese në këtë udhëtim të gjatë të jetës!

Deivi Gani- Kemi qenë që nga klasa e 8 bashkë dhe

koha duket sikur ka kaluar shpejt sepse këtë vit jemi maturantë. Të kam suportuar në çdo vendim që ke marrë dhe të kam ndihmuar kur ke pasur nevojë dhe gjithashtu dhe ti mua. Nuk do t'i harroj kurrë momentet e bukura që kemi kaluar në bankat e gjimnazit ndonjeherë kur uleshim bashkë. Me ty ndihem shumë mirë dhe t'i tregoj gjërat e mia pa pasur ndonjë ndrojtje, gjithmonë më ke ndenjur afër dhe në momentet e vështira të gjimnazit dhe do ta di gjithmonë për nder. Nuk besoj se kemi për ti prerë kontaktet pas këtij viti sepse unë nuk e dëshiroj diçka të tillë dhe shpresoj që të gjitha planet dhe pikësynimet që ke për veten të të plotësohen liebee!

Etien Dhima-Luisën rastisa ta kisha në klasë në vitin e fundit, rreth 7-8 vite pas fillores kur e takova për herë të parë. Gjithmonë ka qenë një vajzë e zgjuar dhe goxha punëtore. Ende më bën përshtypje një episod nga një orë anglishtje në të cilin ajo bëri një ndërhyrje në komentin e një shoku të klasës, me një argument relativisht të fortë, që e la edhe tjetrin pa fjalë. Për disa opinione muzikore mund të them që jemi në luftë, dhe e dyshoj të biem dakord ndonjëherë mbi këtë temë, por e vlerësoj këmbënguljen e të dyja palëve. I uroj sa më shumë suksese në jetë dhe arsim të mëtjetshëm.

Keti Bardhoshi-Luisa ti je një nga njerëzit të cilët unë i konsideroj pasqyrë. Te ti kam arritur të gjej copëza të vetes sime nga librat te filmat te vendimet e gabuara që mund të kemi ndërmarrë gjatë gjimnazit. Jam jashtëzakonisht e lumtur që fati na sollti në një klasë këtë vit pasi arrita të të njoh më mirë edhe fitova një shoqe të cilës mund t'i besoj. Ti je një person që di çfarë të thuash për të çdramatizuar një situatë, por në të njëjtën kohë mund të ndajmë mendime intelektuale mbi tema që e di se kanë vlerë. Ndoshta mund të kemi disa pelqime gjyshesh, por e di se ti pret çdo gjë me mendje të hapur. Je shumë e vendosur dhe e sigurtë dhe kjo më frymëzon çdo ditë. Të premtoj që do ta kthej Circen shumë shpejt. E di se e ardhmja jote do të jetë e mbushur me arritje dhe shpresoj të jem aty për t'i festuar me ty!

Marson Aga- Luisa, gjithmonë të kam spikatur si një person mjaft i lexuar dhe inteligjent. Sot, mund ta shoh lehtë se pse shumë prej nesh arrinë të komunikojnë mirë me ty. Besoj se pikërisht formimi yt individual arrinë të formoj një mjedis të hapur për çdo person para teje. Kështu të uroj fat dhe suksese në të ardhmen.



Marson Aga

Marson, ju jeni një nga të paktët njerëz që kam njohur me një sens humor fantastik. Ju gjithmonë përpiqeni të jeni pozitiv dhe të buzëqeshur pavarësisht situatës. Ju jeni një person i sinqertë dhe një gjë që unë adhuroj tek ju është fakti që jeni gjithmonë vetvetja dhe nuk ju intereson çfarë thonë të tjerët. Një tjetër gjë që adhuroj tek ju është fakti që jeni një person shumë i arsimuar në shumë fusha, jeni një person shumë i formuar dhe i pjekur. Unë jam mirënjohës për miqësinë që kam krijuar me ju këtë vit dhe ju uroj sinqerisht më të mirat. Shpresoj që t'i arrini qëllimet tuaja në jetë dhe që dëshirat tuaja të realizohen. - Arbri

Marsoni, një djalë i apasionuar pas teknologjisë dhe sigurisht, shkencave natyrore. Një tip i qetë, që mund të komunikosh pa probleme, e që deri tani jemi mirëkuptuar në maksimum. I duhej 12H edhe një Marson, që gjithmonë sheh punën e tij, dhe ndihmon kur ka mundësinë. Shoqëritë e vjetra i mban akoma, me Etienin dhe Brendisin, por edhe me nxënës të tjerë, që tregon se je një njeri social. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në degën që ke dëshirë të vazhdosh! - Ani

Në rradhë të parë po e nis këtë letër duke të të falënderuar pa masë që më je gjendur pranë në një moment të vështirë të jetës sime duke më ngushëlluar e duke më ngritur sadopak humorin. Gjëja që vlerësoj më shumë tek ti është sinqeriteti yt, duke shprehur hapur çdo mendim tëndin. Gjithashtu nuk mund të mbetet pas as inteligjenca jote. Të uroj shumë suksese Marson! Jam e sigurt që me aftësitë e tua do të arrish çdo gjë që dëshiron.

Mund të të quaj një nga miqtë më të çmuar që kam pasur gjatë këtyre 5-6 viteve. Ti je njeri i zgjuar, i shkathët, i dashur dhe mirekuptues, e me një sens të

veçantë për humor, që jo të gjithë dinë ta vlerësojnë. Më ke impresionuar me shpejtësinë me të cilën arrite të fitosh aftësi dhe dije mbi muzikën dhe kitaren. Ke një vesh të mprehtë për të dëgjuar dhe për të kuptuar njerëzit, dhe më ke ofruar këshilla të çmuara kur kam pasur nevojë. Ti je një mik i vërtetë dhe i sinqertë, dhe sado trazira e fjalë të kota të hidhen nga njerëz të paditur, nuk ka gjë që të ma prishë mendimin tim për ty. Shpresoj të mbetemi miq gjithmonë e me tej. Të uroj suksese! -Etien

Marson, një njeri i shkëlqyer, një mik shumë i mirë dhe i veçantë. Jeni ndër njerëzit më kreativë me zemër dhe inteligjencë jashtëzakonisht të lartë deri në atë pikë sa mund ta quaj "të frikshme". Sa herë kam pasur nevojë për ndihmë, ju keni qenë pranë meje dhe keni gjithmonë një zgjidhje të veçantë për çdo situatë të vështirë që mund të ndodhem, për këtë ju falënderoj shumë. Ju keni një vlerë të madhe për mua. Do të doja të të kisha njohur më parë, por e rëndësishme është që tani të njoh dhe je një nga miqtë më të mirë që kam dhe mund të të besoj lehtësisht për çdo gjë. Do më mungojnë shumë bisedat dhe humorin e veçantë me ju. të bindur se do të keni sukses. Unë dua të vazhdoj miqësinë tonë si tani dhe pas shumë vitesh. Asnjëherë mos ndryshoni për të tjerët, pavarësisht se çfarë mund të ndodhë, vazhdoni të jeni vetvetja! - Engini

Mars - Pas 12 vitesh, më në fund ka ardhur momenti kur do të më duhet të të jap këtë përsëritje të fundit (jo se do të më ikësh ndonjëherë). Një shoqëri e formuar që në klasën e parë me shumë histori dhe kërkime anësore që do t'i listoj këtu. ndaj po e them një pjese për t'ju treguar se kush është Marsoni. Marsoni është një person i dashur, i gëzuar dhe i matur që përmirësohet dhe përmirësohet nga viti në vit dhe gjithmonë përpiket të ndjekë çdo pasion që sheh. Një individ që në pamje të parë duket i ftohtë fsheh brenda tij një zemër të ngrohtë plot humor e cila gjithmonë sjell gëzim në çdo dhomë ku hyn. Sa herë keni dashur të bëni diçka të re - të mësoni kitarë, basketboll, etj. Më shtyve të provoj diçka të re, si të them dil nga elementi im, diçka që më ndihmoi të zbuloja shumë pasione të fshehura të vetes, një nga këto dhe parfimet që më shtynë dashuria jote për modën. Tani jemi në fund të rrugëtimit tonë, ose të paktën atij akademik, dhe mund të them këtë - jam shumë i lumtur që miqësia jonë zgjati përtej viteve të fëmijërisë, pasi kam takuar një nga njerëzit më të mrekullueshëm që njihni. Miku juaj Enio Kazazi.



Moana Gorezi

E dashur Moana, Shkrimtarja, fizikania, shkencëtarja që e bën klasën 12-H krenare me sukseset e tua. Ëmbëlsia jote, qetësia, gatishmëria për të më ndihmuar kur kam nevojë, të bëjnë ty një person me shumë vlera në sytë e mi. Jam mirënjohëse për çdo moment të bukur që kemi ndarë bashkë, duke u bërë pjesë e rëndësishme e jetës sime. Uroj me plot zemër që jeta jote të jetë e mbushur me lumturi! Suksesi yt është dëshmi e aftësive të tua. Të uroj më të mirat e botës dhe shpresoj të arrish majat! Të dua shumë, Amarda.

Moana është gjithmonë në krye të detyrës kur dikujt i duhet ndihmë për një mësim ose një detyrë, dhe nuk di ku gjen durimin dhe entuziazmin që ka. Përdor lehtësisht notat e ironisë, duke lënë përshtypje të pashlyeshme. Është një gjeni e vërtetë në mesime dhe është shoqja e vetme për të cilën mund të them se ka shkruar një libër për Fizikën Kuantike... për fëmijët (lutem për mirëqenien e tyre). I uroj shumë suksese në rrugën që e pret! (Etien)

Më shumë se orë mësimore, bashkë kemi kaluar dhe orë në të cilat kemi pas mundësi të njohim më mirë njëra-tjetrën. Je një vajzë shumë e zgjuar, me synime të larta në jetë, por edhe shoqe e mirë, e dashur. Që nga mënyra se si i mendon gjërat kuptohet që je e rritur, dhe jo adoleshente e rrëmuishme. Më bëhet qejfi që kam mundësinë të të kem shoqe klase. Shpresoj të të realizohet çdo dëshirë dhe të arrish sa më lart në jetë! Sibora Nezha

Moana, nuk kemi shumë kohë që jemi njohur por kam kuptuar që ti je një person i qetë dhe shumë inteligjent. Jam shumë i lumtur që të kam takuar dhe faleminderit për gjithcka. Uroj që rrugëtimi yt në të

ardhmen të jetë plot sukses. (Alvi)

Moana, edhe pse kemi pak që njihemi mund të them që je një vajzë e dashur, e komunikueshme dhe me karakter mjaft interesant. Më pëlqejnë shijet e tua në muzikë dhe mënyra se si ti i mendon gjërat. Gjithashtu me pëlqen energjia që ti më përcjell me atë qetësinë tënde. Të uroj suksese në çdo fushë të jetës! (Luisa)

Moana je një vajzë e thjeshtë, e ditur dhe një shoqe shumë e mirë. Gjithmonë do t'i kujtoj historitë që më ke treguar për idhullin tënd, Kirbin. Aftësitë e tua në fizikë janë mahnitëse. Të uroj suksese dhe lumturi! (Denis)

Moana, ndihem mjaft mirë që kam patur një vajzë kaq të zgjuar e pozitive në klasë. Për aq kohë sa të kam njohur, kam kuptuar se je dikush i cili vërtet ia vlen të bisedosh pasi shfaq gjithmonë vlerat e cilësitë e tua të mira. Të uroj të permbushësh të gjitha ëndërrat e tua! (Marson)

Moana ti je me pak fjalë fëmija ideal i çdo familje shqiptare. Gjithmonë do e mbaj mend kur më tregonte mami arritjet e tua që postonte shkolla. Je shumë e zgjuar dhe e përkushtuar. Qetësia jote më bën dhe mua të flas më pak. Shpresoj t'ia dalësh mbanë në jetë dhe të realizosh dëshirat e tua! (Sabjan Haska)

Fati ka qenë në anën time në momentin që ramë në të njëjtën klasë në vitin e dytë. Moana, ti ke qenë dhe ende je një shoqe shumë e mirë për mua. Në kemi shumë kujtime të bukura së bashku të cilat nuk do ti harroj ndonjëherë. Je një nga personat më të zgjuar dhe të dashur që njoh dhe këto janë pak nga cilësitë që admiroj tek ti. Shpresoj që të mbetemi shoqe dhe në të ardhmen dhe të uroj suksese në rrugëtimin që të pret! (Debora Qendra)

Moana, në gjithë këto vite në shkollë s'ka patur njeri më të talentuar dhe inteligjent se ti. Gjithmonë të shkon mendja në zgjidhje kreative për problema. Jemi takuar në fillim të shkollës tek konkursi i NASA-s. Më kujtohet sa i tërhequr isha për të të pyetur që të vije me ne. Për një arsye të çuditshme, një vajzë 1.2 metra po më friksonte. Ajo zgjedhje ishte një nga zgjedhjet më të mira që kam bërë gjithë vitin. Faleminderit shumë për ndihmën që më dhe tek olimpiada e fizikës. Të uroj shumë suksese! (Brendis Kasharaj)



Sibora Nezha

Sibora këtë vit u njohëm por nuk ishte pak për të dalluar karakterin tënd të fortë dhe aftësinë tënde për të përballuar çdo problem në mënyrën e duhur. Mënyra si formulon mendimet e tua dhe i transmeton ato tregon inteligjencën që ti ke dhe ambiciet e tua për të marrë atë që do. Shpresoj që në të ardhmen të arrish çdo qëllim që i vendos vetes dhe të ndihesh e plotë. Të uroj shumë suksese në jetë dhe arkitekturë!

Klea Kaloshi

E dashur Sibi,

Nuk e kisha imagjinuar që do të ishim përsëri në një klasë pas mbylljes së kolegjit “Mehmet Akif” dhe isha njeriu më i lumtur kur në fillim të vitit më lajmërove që ishe transferuar në shkollën tonë. Teksa po rikthehesha në faqet e këtij kapitulli, po më vinin në mendje momentet të cilat i kanë zbuluar vitet tona shkollore. Që nga kujtimet më të bukura në klasën më të famshme të kolegjit “Mehmet Akif”, të qeshurat pafund, sfidat që kemi kaluar e deri te fitoret që kemi festuar, kanë thurur një sërë përvojash që e kanë forcuar gjithmonë e më shumë shoqërinë tonë. Të falënderoj për çdo moment që më je gjendur pranë! Të uroj gjithë të mirat! Uroj që të bëhesh arkitektja më e mirë që do të projektojë strukturat e reja të botës! Nga shoqja jote Ami

Sibora, nje vajzë që të kam vlerësuar gjithmonë, qoftë nga sjelljet, qoftë nga veprimet e tua pavarësisht çdo gjëje. Një shoqe që më ke ndihmuar sa herë kam patur nevojë në çfarëdolloj situatë që kemi qenë. Je nje vajzë shumë e zgjuar, me një zemërgjerësi të madhe për të tjerët. Në lëndën tënde të preferuar, matematikën, të cilën vetë e urrej shumë si lëndë. Je nga nxënëset më të mira në klasë. Një gjë që më pëlqen tek ti është se ti je një shoqe e mirë me të gjithë dhe e buzëqeshur në

shumicën e kohës. Je nje gocë që vërtet i do shumë të afërmit e vet dhe bën çdo gjë për ata. Uroj që të arrish të gjitha objektivat e tua në jetë dhe jam i bindur që do bëhesh një arkitekte e zonja. Shpresoj të kesh një jetë sa më të lumtur me të dashurit e tu!

Engin Kiliç

Është viti i parë dhe i fundit që jemi në të njëjtën klasë. Më parë të dija vetëm emrin, nuk të njihja plotësisht, as tani nuk mund të them se të njoh plotësisht. Në kaq pak kohë, ama kam arrit të kuptoj se je me të vërtet një vajzë e qetë por tepër e zonja dhe e zgjuar. Ajo çka më pëlqen me tepër tek ty është talenti që ke për te pikturuar. Jam e bindur që do të bëhesh një arkitekte vërtet e suksesshme. Të uroj të kesh një jetë të mbushur me lumturi dhe suksese!


Erisa Noga

Sibora, është viti i parë që të njoh, ama mund të them që je një vajzë shumë inteligjente dhe e pjekur. Je njeri i qetë dhe nuk ndihesh shumë në klasë, ama kjo nuk do të thotë që nuk bëhesh pjesë e klasës. Nuk të shpëton gjë dhe je njeri goxha i formuar. Je e sjellshme dhe mundohesh të qëndrosh pozitive gjithmonë. Nuk mund të them që të njoh mirë, pasi një vit nuk është shumë, ama brenda kësaj kohe kam fituar sigurinë të them që je një person i mirë dhe që punon fort për të arritur atë që ti do. Të uroj më të mirat në të ardhmen dhe shpresoj ti arrish ëndrrat e tua!


Arbri Peka

Sibora, që kur të të kam takuar gjëja e parë që më ka shkuar në mendje është se sa njeri i ftohtë dukesh. Jo, se tani nuk e mendoj. Je e ftohtë, solide, ke dhe nje ironi pak therëse dhe je realiste në ato që thua. Megjithatë, gjatë këtyre tre viteve kam zbuluar gjëra të reja për ty. Gjithë kjo ftohtësi është vetëm në sipërfaqe, sepse në të vërtetë ti je e çiltër, shumë e ndjeshme, bujare dhe një mike e vërtetë. Ti gjithmonë më ke dëgjuar për problemet që kam pasur dhe me ke dhenë atë pikëpamjen tënde realiste, por me plot këshilla të vlefshme. Siborë, ti je besnike, punëtore dhe e sinqertë. Ti mund të dukesh e fortë dhe e ftohtë si akulli, por sa më shumë të të njohësh kupton që je e zemërbutë dhe e zemërbardhë si bora. Të kam shumë xhan Siborë dhe uroj që këtë miqësi të bukur ta ruajmë gjithmonë, ashtu sic do ti ruajë une momentet tona te bukura në kujtesën time.

Fjona Duka












Daniela Cuka

I/E dashur Adrin, Albion, Desara, Erik, Erisjona, Ernesto, Joel, Juara, Kaltrina, Keid, Kiara, Kriston, Laert, Leon, Reid, Sara, Sindi!

Dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për çdonjërin prej jush për angazhimin, përkushtimin dhe aftësitë tuaja. Ky vit ka qenë i mbushur me sfida, suksese, gëzime dhe kujtime që do t'i mbajmë gjithmonë në zemër. Secili prej jush ka lënë një gjurmë të veçantë në këtë shkollë dhe në jetët e njerëzve. Keni punuar së bashku dhe keni sfiduar veten në mënyrë të vazhdueshme, duke treguar potencialet tuaja. E kuptoj që fillimi mund të ketë qenë plot kureshtje dhe ndroje për të njohur klasën tuaj të re, por dëshira juaj për t'u integruar në këtë klasë është për t'u admirim. Përvojat me të cilat jeni përballur dhe arritjet që keni realizuar tregojnë se ju jeni të aftë të bëni gjëra të mëdha. Kjo është një dëshmi e vërtetë e guximit dhe e përkushtimit ndaj mësimit dhe zhvillimit tuaj, si në aspektin personal, edhe në atë akademik.

Çdo fillim ka një fund dhe çdo fund është një fillim i ri. Rrugëtimi ynë zgjati vetëm një vit, por më lëjoi të njoh dhe të kuptoj potencialin tuaj. Ju jeni shumë të mirë, secili në formën tuaj, prandaj, nisur nga ajo çka thotë dhe Nelson Mandela: "Arsimi është arma më e fuqishme që mund ta përdorësh për të ndryshuar botën", unë ju them secilit prej jush që të bëheni ndryshimi që bota kërkon, duke përdorur forcën, dëshirën dhe duke ndjekur ëndrrat tuaja!

Ju falenderoj që ishit pjesë e këtij rrugëtimi dhe mos harroni të jepni më të mirën nga vetja juaj, të shkëlqeni kudo që të shkoni, të bëni krenar veten, prindërit dhe ne, mësuesit tuaj! Përzemërsisht, zysha juaj kujdestare.



Leon Nika

Laert Dollani - Në këtë rrugëtim të jetës, shpesh takojmë njerëz që bëjnë udhëtimin më të bukur dhe të pasur. Ti, Leon, je një prej tyre. Faleminderit që je gjithmonë pranë, duke ndarë kujtime të paharrueshme dhe duke shtuar ngjyrë dhe gëzim në çdo ditë. Me humorin tënd shkatërrues dhe me zemrën tënde të madhe, ke bërë rrugën time më të këndshme. Shoqëria jote është një dhuratë e çmuar, dhe kujtimet bashkë janë thesari më i vlefshëm.

Leon

E ke kryer me sukses detyrën e një shoku banke këto dy vitet e fundit, ku nuk kanë munguar shakatë dhe të qeshurat në momentet e duhura. Më kujtohet kur luanim shah ose pingpong, ku herë fitoje ti herë fitoja unë. Nuk më besohet se si kaluan kaq shpejt këto tri vite gjimnazi. Ky vit për ne është një vit shumë i rëndësishëm pasi të dy ne po luftojmë të kemi një të ardhme sa më të mirë. Shpresoj që të dyve ne të na plotësohen dëshirat. Shoku yt
Albion Xhepa

Sindi Demirxhiu

Bossi me dy s, kujt ia merrte mendja se do beja letër dedikimi për ty. Je shoku më i sjellshëm që kam njohur. Je një djalë me këmbë tokë, serioz aty ku duhet dhe i maturuar. Përveç seriozitetit, ty të karakterizon dhe fakti që je shumë "funny". Asnjëherë nuk jam mërzitur kur më ke thënë "o dru" ose "hu gardhi". Përtej shakasë të falenderoj që ke qënë miku im më i mirë gjatë këtij viti dhe të falenderoj për mbështetjen dhe motivimin që më ke dhuruar! Uroj dhe shpresoj që e ardhmja jote të jetë ashtu siç ti dëshiron!

Leon

Ne vitin e fundit jemi njohur, por në kaq pak kohë më ke treguar që je një djalë tërë pozitivitet dhe shumë i sjellshëm. Shakat e tua janë të papara dhe cdokush do të ishte me fat të të kishte shok. Të uroj më të mirat në të ardhmen dhe t'i plotësosh të gjitha dëshirat e jetës!
Adri

Leon Nika

Leon, vëlla, je një djalë i zgjuar dhe karizmatik dhe jam i sigurt që do ia dalësh të shkosh larg në jetë. Të uroj shumë suksese dhe fat në rrugën që ke zgjedhur dhe vazhdo të jesh ai që je
Joeli



Albion Xhepa

Faleminderit që je gjithmonë aty për të ndihmuar dhe për të sjellë pozitivitet. Ti je një mik i veçantë dhe një frymëzim për të gjithë ne.
Kristoni.

Albion Xhepa

Nuk kishte si të mungonte një dedikim për “fadromën”. Je një shok shumë i mirë dhe një djalë me vlera, edhe pse duhet të të njohësh që t’i zbulosh. Nuk do t’i harroj shakatë që kemi bërë, dhe mezi pres të kemi sa më shumë kujtime gjatë këtij viti. Të uroj suksese dhe besoj se do ti arrish sepse je një djalë që i vendos qëllime vetes.

Me respekt, Keidi

Nga ta nis për ty o Albion. Je një djalë inteligjent dhe shumë i shkathët, që nuk do e kuptoj asnjëherë se ku e gjen gjithë atë energji. Të uroj shumë fat dhe suksese, sidomos pasi ke zgjedhur dhe mjekësinë.
Joeli

Albioni

Doktori im i ardhshëm ,3 vitet e gjimnazit ikën shumë shpejt, por ti gjithmonë ishe krahu meje në çdo situatë duke me ndihmuar dhe qeshur me mua. Bashkë kemi kaluar shumë momente të bukura ,të cilat do ti mbaj mend gjithmonë. Ti je një shok i vërtetë ,i cili është fat që të gjendet. Miku im të uroj fat në rrugëtimin ,që do të vazhdosh dhe jam i bindur që do t’ia dalësh ti realizosh ëndrrat e tua.

Miku yt

Leo

Albionnn, dhe pse nuk kemi shumë kohë që njihemi, mund të them se je një nga njerëzit më real dhe vetvetja në klasën tonë. Nuk ke frik të shprehësh çdo mendim që ke dhe këto cilësi të bëjnë të ndihesh e sigurt kur je në praninë tënde. Ke një personalitet të veçantë dhe shpresoj të qëndroj i tillë. Gjithsesi,shakatë tona do të mbeten aty. Të uroj suksese ne rrugëtimin tënd te mjekësisë!

Desara.

P.S: e di që jam më e mirë se ty ne voley:)

I dashur Albion,

Zemra jote e madhe dhe përkushtimi yt ndaj të tjerëve janë për t’u admiruar. Edhe pse kemi kaluar vetëm një vit së bashku, ti ke treguar se sa e rëndësishme është të jesh i dashur dhe i kujdesshëm.



Kaltrina Hoxhalli

SINDI DEMRIXHIU

O mamii. Për ty kam shumë për të shprehur. Je një nga vajzat më të zgjuara dhe më ambicioze që kam njohur ndonjëherë. Ne njihemi që para se të fillonim rrugëtimin e gjimnazit. Vajza nga Devolli që edhe pse nuk të pëlqejnë shumë për qafimet, më ke falur mjaft dashuri. Më kujtohen shakatë që kemi bërë bashkë, bisedat për “Fresk Fare” apo “Kripëmjaltëzat”, apo kur flisnim ndonjëherë me dialekt korçar! Jam tej mase mirënjohëse për momentet që kemi kaluar së bashku dhe të falenderoj që u bërë pjesë e imja! Të pafsha sa më lart në jetë sepse ti vërtet e meriton! Të dua shumë shumë!

DESARA KAPAJ

Kaltrina, një vajzë e zgjuar dhe intelektuale, do të doja të kisha qetësinë dhe vullnetin tënd. Në mes të streseve dhe provimeve je pikërisht ti ajo që je më e qeta dhe e sigurt. Jam e sigurt se do të kesh një të ardhme të ndritur. Suksese në rrugën tendë! - Desara.

ALESJA QUKU

Dshuria që ti ke për librat dhe për letërsinë më kanë influencuar dhe mua. Je një njeri menjë botë të brëndshme të madhe. Mirësia jote rrezatohet në fytyrën tënde. Më vjen mirë që kam njohur një person si ti me kaq shumë vlera. Të uroj më të mirat!

JOEL BIBA

Je një nga vajzat më inteligjente dhe të talentuara që kam takuar ndonjëherë, dhe kam për t'i mbajtur mend gjithmonë bisedat tona me tema nga më të rastësishmet deri te ato më seriozet. Të uroj sa më shumë suksese!
Derisa të më dalësh sërish para, si gjithmonë, Joeli.

BORA BICA

Jam shumë me fat që në jetën time kam njohur një person si ti. Edhe pse ky vit na ka gjetur në klasa të ndryshme, shoqëria jonë vazhdon ende. Një cilësi që të karakterizon është të shprehurit të mendimit siç e mendon, pa filtra. Je një vajzë shumë e zgjuar, pozitive, me humor e ironi dhe mbi të gjitha e drejtpërdrejtë. Nuk më mbetet gjë tjetër veçse të të uroj suksese në rrugëtimin tënd të mëtejshëm!

JASMINA DURMISHI

Kaltraaa! Kalojmë pothuajse çdo mëngjes së bashku me bisedat tona të cilat e them me plot gojë, duket sikur po i bëj me Einstein-in. Nuk ka moment që nuk habitem me njohuritë e tua të pafundme, me opinionet e gjykimet e tua. Ndihej shumë me fat që kam mundësinë të kaloj kohë me ty dhe të mësoj gjëra të reja çdo ditë nga ti. Të uroj shumë suksese dhe jam e bindur që do t'i bësh ëndrrat e tua realitet!

KEJSI HIDAJ

“O KEJSO DO DRU?” Sa herë ma ke thënë këtë kur të ka kapluar një shkëndi nervash “supersajani”? Kur të kam takuar për herë të parë në klasë të pestë, më je dukur ekstremisht serioze dhe e ftohtë, deri në atë pikë që më tmerronte. Por sa gabim isha... Ke një karakter fantastik, plot humor me vullnet çeliku, kreativitetin si një nga armët e tua më të forta dhe je përkufizimi i përkryer i sinqeritetit. Faleminderit për të gjithë ndihmën që më ke ofruar, për të gjitha këshillat e vlefshme, për të gjitha të qeshurat, hallet dhe lotët që kemi ndarë me njëra-tjetrën! -KEJSI



Kiara Mersini

Kiara, je një vajzë e dashur dhe e sjellshme. Edhe pse të njoh për pak muaj, mund të them se kam kaluar momente shumë të bukura pranë teje. Ke një shpirt të pastër e të bukur. Të falenderoj për çdo moment që kemi kaluar bashkë dhe uroj që të kesh suksesin që ti dëshiron! Sindi <3

Kiara, ti je një vajzë inteligjente dhe pozitive dhe këto të bëjnë një person për t'u vlerësuar. Më pëlqen që je indiferente dhe e qetë në punën tënde. Rreshtit nga dritarja i duhej me patjetër një vajzë si ti. :) Suksese në të ardhmen tënde dhe në rrugën që do të zgjedhësh! Desara

Kiara, ne u bëmë shoqe për shkak të një zënke që në fillim të vitit dhe që pas asaj kohe u afruam shumë me njëra tjetrën. Prapëseprapë, nuk është se ato do të mbarojnë ndonjëherë, por gjëja e mirë është se ne e lëmë pas krenarinë dhe kërkojmë falje kur e kemi gabim. Shumë njerëz thonë se të jesh njeri zemërmirë dhe pak më e butë se të tjerët është e gabuar, por unë nuk mendoj kështu, madje besoj se kjo të bën dhe unike, se pavarësisht situatave, ti tregohesh e mirë dhe me ata që nuk janë sjellë mirë me ty. Për sa i përket shkollës, nuk e di se si ia del mbanë gjithmonë të mësosh edhe detajin më të vogël, që me zor shihet me sy dhe të jesh e para për t'u përgjigjur në mësim. Ke një etikë pune tmerrësisht të fortë dhe për këtë të admiroj. Meqë ra fjala, se di a e kam përmendur ndonjëherë, por sistemin e mesazheve në telefonin tim e kam ndërtuar në mënyrë të atillë që secili person ka një melodi karakteristike, që të di se kush shkruan paraprakisht, por ti Kiara nuk ke nevojë për të. Pse? Sepse mesazhet e tua më vijnë gjithmonë si breshëri automatiku AK47, sa ndonjëherë më trembin. Të mos përmendim pjesën e "meme"-ve tona që janë kalvar i

këtyre tre viteve dhe akoma na bëjnë të qeshim duke mbajtur barkun me dorë sa herë që i rikujtojmë. Për mua do të mbetesh gjithmonë një vajzë e dashur dhe me këmbë në tokë. Xoxo "birdy", a.k.a Erisjona

Kiara, vajza më energjike e klasës. Në këto pak muaj që njihemi, nuk mund të lë pa përmendur personalitetin tënd unik. Një vajzë e matur dhe e zgjuar në çdo situatë që përballet. Adhuroj shpirtin tënd bashkëpunues dhe aftësitë e tua për koordinimin e punëve në grup. Të uroj shumë suksese kudo! Sara Halilaj

Kiara, ke një dedikim të ngurtë dhe etikë pune spartane të admirueshme. E qeshura jote është aq ngjitesë sa ç'mundet të jetë një e qeshur. Rrugët tona janë kryqëzuar në klasë të 5-të dhe më vonë në klasën e 10-të. Shpresoj që ky trend të vazhdojë dhe të mbetemi në kontakt. Të uroj gjithë të mirat! Kaltra

Kiara, e preferuara ime nga binjakët. Gjithmonë e gatshme për të folur dhe për të më ndihmuar, një vajzë pa të meta. Faleminderit për shakatë dhe ngacmimet tona të vogla dhe të uroj suksese në rrugën që ke zgjedhur të ndjekësh. Joeli

Kiarita ime, më ke ndenjur afër dhe ke dëgjuar ankesat e pafundme e nuk je lodhur kurrë nga zënkat tona. Ndonëse nuk jemi bërë shoqe që nga viti i parë, mendoj që e gjetëm njëra tjetrën në momentin e duhur kur na duhej një person pranë. Për shumë njerëz mund të jesh fjalëpak e për disa të tjerë pak e ftohtë, por di të them që për mua që në fillim nuk ke qenë asnjëra nga këto. Je njeriu më zemërmirë dhe i komunikueshëm që kam njohur. Mos mendo se me mbylljen e këtij dedikimi do të mbyllet dhe shoqëria jonë se nuk shpëton dot kaq kollaj nga unë. Dua të të kujtohen gjithmonë përqafimet tona në mes të paralelit dhe telefonatat 7 orëshe. Do të ngelesh gjithmonë për mua njeriu që më shihte duke gatuar e duke qarë. Uroj dhe shpresoj që jeta të të shkojë vaj e të të plotësohen të gjitha dëshirat sepse e meriton. Se mos harron, me mua në krah. Vesa <3



Laert Dollani

O Laerttt, shoku im i mirë. Ty të kam parë gjithmonë si djali gazmor, indiferent dhe i zgjuar. Shakatë tona janë ato që ma bëjnë ditën më të lehtë për ta kaluar. Edhe pse nuk kemi shumë që njihemi, prap je bërë një pjesë e madhe e ditë sime. Të uroj suksese në rrugë që do të zgjedhësh!
Të përqafoj, Desara.

Per Laertin

Laerti eshte shoku me gojeëmbel qe un kam njohur ndonjehere.Laerti ka karakter humoristik.Ti je personi qe di te beje cdo suate me te lehte dhe me te gezueshme me shaka te mencura dhe aftesi per te bere te tjeret te qeshin me lot.

Faleminderit per cdo qeshje dhe moment te gezuar qe na dhuron gjithmone.

Dedikuar me miqësi dhe admirim!

ERNESTO

Laert ti je një djalë shumë i mirë dhe i zgjuar! Tani që të kam njohur më mirë mund të them se je një djalë shumë i qeshur dhe përcjell vetëm energji pozitive. Ke një sens humori të paparë, gjë që të karakterizon. Të uroj sa më shumë suksese dhe të falenderoj për miqësinë që më ke dhuruar!

SINDI

Kjo flete eshte per ty Laert.

Shoku im i sinqertë, me një zemër të plotë dhe një frymë të guximshme, dedikohet me respekt dhe dashuri të pafund!

Jeta është më e bukur kur je pranë, duke ndarë kujtime dhe shtrirë dorën e miqësisë në çdo kthesë.

Faleminderit për çdo moment të mirë dhe për mbështetjen e pakursyer. Shpresoj që kjo miqësi të rritet dhe të mbetet e pandarë përjetë! - KRISTONI



Sindi Demirxhiu

Për Sindin, shoqen time më të mire, Në këtë udhëtim të jetës, ka momente dhe njerëz që e bëjnë këtë rrugë më të bukur dhe më të pasur. Ti, Sindi, je një person i veçantë në rrugëtimin tim. Faleminderit që je gjithmonë aty, duke ndarë me mua kujtime të bukura dhe duke qënë një pjesë e kësaj historie të përbashkët. M e humorin tënd të këndshëm dhe mbështetjen tënde të pakursyer, bëhet më e lehtë për mua të përballoj sfidat dhe të gëzoj momentet e lumtura. Shoqëria jote është një pasuri e vërtetë dhe jam i privilegjuar që kam një mik si ti në jetën time.

Laert Dollani

Cindyyyy <3, nuk më besohet që janë bërë dy vjet që të njoh. E mbaj mend akoma se si u takuam për herë të parë vjet, aty në portën e shkollës pa e ditur se çfarë na priste. Nuk do e mendoja kurrë që do ishe ti vajza me të cilën do kaloja dy vite në bankë, në mes të gjithë kësaj shkolle të madhe, por tani jam shumë mirënjohëse. Këto dy vite pa ty sdo të ishin aspak njëllor të bukura siç kanë qënë. Jam e lumtur që kisha mundësinë të njihja një vajzë si ty. Të uroj suksese në të ardhmen tënde kudo që të shkosh!

Të puth fort, Desara.

Sindi, vajza më e ëmbël e klasës. Më pëlqen shumë qetësia dhe maturia që tregon në çdo situatë të mundshme. Përtej këtyre, është për t'u vlerësuar fakti që je gjithmonë e gatshme t'i ndihmosh të tjerët. Uroj t'i realizosh të gjitha dëshirat dhe synimet që i ke vendosur vetes! Kiara <3

Kiara Mersini

Për Sindin, një ndër vajzat më të sjellshme dhe lozonjare që njoh e këtë e tregon cdo mëngjes, që

nuk heziton kurrë të më përfaqosh e të më pyesësh rreth ditës. Më përcjell ndjesi shumë të mira, që i transmeton me veprimet e tua dhe empatia që tregon për njerëzit në çdo moment. Përherë e qeshur dhe e aftë për t'i bërë të tjerët të ndihen mirë. Gjithmonë të pafsha të gëzuar dhe shpresoj të arrish gjithcka që të dëshiron zemra!

Erisjona

Sindi, gjithmonë e urtë dhe më ke ndihmuar sa herë ta kam dashur ndihmën. Je një vajzë inteligjente dhe shpresoj të vazhdosh të jesh ajo që je. Të uroj suksese në rrugën që do të zgjedhësh të vazhdosh. Joeli
Joel Biba

Sindii, vajza më pozitive dhe e dashur që kam njohur ndonjëherë! Dhe zor të gjendet një e dytë si ty. Admiroj faktin që shpërndan dashuri në çdo lloj rrethane, qofsh e lumtur apo e mërzitur. Më ka pëlqyer energjia jote që në ditën e parë të gjimnazit ku dhe u takuam për herë të parë. Dhe që nga ajo ditë, fjalët e mira për ty nuk kanë të sosur. Je rrezja e diellit që i nevojitet çdo personi në jetën e tij! E ndiej veten me fat që të kam shoqe. Të uroj shumë suksese në çdo ëndërr tënden!

Me dashuri, Sara Halilaj

“Baa me tinë, mu rrit çupa mu bë për dë shkollë të lartë!” Dhe pse më thërrisje mua “mami” ke qënë ti ajo që kujdesej për të tjerët duke i bërë të ndihen të sigurt dhe duke ditur gjithnjë ç’të thuash. Kujtoj si ke korrigjuar kodin tonë me modestinë më të madhe. Eleganca jote në situata sociale është për tu aspiruar, madje dhe insektet i shfarros me finesën e një dukeshë të shekullit XIX.


Shpresoj të kemi më shumë karaoke, valle zbathur dhe netë të vona me patatina e thashetheme.

Mos ndrysho kurrë,

Kaltra

Sindi ose siç të thërras unë trangu im i dashur. Të qënurit në klasë me ty ishte me të vërtetë një fat për mua. Mund t’ja them me plot gojë, që je personi më pozitiv, që kam njohur. Je një vajzë e matur, por mbi të gjitha një vajzë zemërgjerë dhe me humor, që nuk rresht kurrë duke më bërë të qeshur. Të gjithë do të ishin krenar që të kishin një shoqe si ti.

Leo



Sara Halilaj

Sara është një vajzë e qetë dhe dëgjuese shumë e mirë. Është e gatshme dhe e disponueshme sa herë që kam nevojë. Është një shoqe shumë e mirë dhe mirkuptuese. Punon fortë dhe e arrinë atë që do pa marrë parasysh lodhjen. Sara është një nga shoqet e mia më të mira që prej vitit të parë e cila më la dhuruar momente dhe kujtime shume të bukura. Ajo është vajza shoqërinë e së cilës do ta ruaj me kujdes dhe e dua shumë. I uroj shumë suksese dhe të arrijë çdo gjë që ajo do.

-Adelajda Shahini

Sara, je ndër personat më të dashur dhe qesharak që njoh. Je gjithashtu e vetmja vajzë që njoh e cila ka 1000 talente! E admiroj sinqeritetin tënd dhe më pëlqen shumë shija jote muzikore. Jam shumë mirënjohëse për momentet që kam kaluar në shoqërinë tënde dhe të uroj suksese kudo në jetë!

-Debora Qendra

Saraa o artiste! Je një nga vajzat më të qeta që kam njohur ndonjëherë. E vlerësoj shumë çiltërsinë dhe optimizmin tënd. Kemi qënë shoqe prej tre vitesh, edhe pse viti i dytë na ndau, përsëri me ty kam kaluar momentet më të bukura! Më ke dhuruar mbështetje, dashuri dhe jam mirënjohëse për çdo minutë që ke qënë pranë meje. Ke njëshpirt artisteje dhe uroj të kesh suksesin që ti meriton e dëshiron! Të dua shumë, Sindi!

-Sindi Demirxhiu

Sara ky është viti i parë që të njoh, por do të doja të ishim njohur më parë. Je një vajzë shumë e sjellshme, e qetë dhe e dashur. Çdo herë që flas me ty më jep aq shumë afrimet sa më duket sikur kemi vite që jemi njohur. Sara, nga zemra të uroj më të mirat në jetë,

sepse i meriton të gjitha.

-Juara Malaj

Sara, një vajzë e qetë dhe indiferente. Nuk kemi patur mjaftueshëm kohë për tu njohur shumë mirë, por gjithsesi më mjafton të them se qetësia jote ndonjëherë është ajo çfarë duhet në klasën tonë.

Vazhdo të jesh e tillë.

Të uroj suksese në rrugën tënde dhe të përqafoj!

-Desara Kapaj

Sara, vajza të cilën do e karakterizoja me urtesinë dhe qetësinë e saj, mjaft e sjellshme, e zgjuar dhe pse fjalëpake. Një artiste dhe detajiste, e ke treguar veten që në fillim të vitit kur more përsipër të ndihmoje me projektin e muajit të letërsisë, nga ku mua më pëlqeu shumë puna jote. U njohëm këtë vit, ku u ndodhëm në klasën që jemi tani dhe nuk njihemi mirë, por që në momentin që mësova se ishim patriote, nuk nevojiteshin më muhabete të mëtejshme. Të uroj sukseset më të përzemërta!

-Erisjona Bunaj

Sara


Vajza më e urtë e klasës, kështu do të të përshkruaja me një fjalë. Më pëlqen fakti që je e qetë, e talentuar dhe e matur në çdo gjë që bën. Pavarësisht se kam pak kohë që të njoh, mund të them që je një shoqe shumë e mirë dhe bashkëpunuese. Të uroj suksese kudo!

-Kiara Mersini

Falenderoj ditët me shi dhe orët boshe që na kanë nxitur të bisedojmë; për veriun dhe jugun, motrat e vllazërit dhe më kritika të :VATHËT. Admiroj si mund të lexosh në mes të zhurmës dhe katraurës e vendosur dhe e qetë në botën tënde. Do të doja të ishim njohur më parë, por shpresoj të kompensojmë kohën e humbur në të ardhmen!

Të uroj shumë suksese -Kaltra

-Kaltrina Hoxhalli



Erisjona Bunaj

Në këto tre vite të gjimnazit, kam patur fatin të kem afër vetes një shoqe me tërë kuptimin e fjalës. Nuk e di në ka person më ambicioz dhe këmbëngulës se ti. Mbaj mend që në vit të parë që të kam takuar që erdhe me synime të qarta për t'u bërë një mjekë dhe i ke qëndruar kësaj ideje deri në fund duke na bërë të gjithëve të luftojmë për atë që duam. Shpresoj të të shikoj lart e më lart sepse e meriton!

“Birdy” a.k.a Kiara

Erisjona, që nuk ndalove njëherë së u shqetësuar dhe të shijoje jetën. Je një vajzë shumë inteligjente dhe e shkathët, por përsëri fituesi i betejave tona me goma mbetem unë. Të uroj suksese dhe të arrish atë që do “muishe”!

Joeli

Erisjona, një nga njerëzit që rrallë herë i ndesh në jetë. Ti je e veçantë sepse sido që njerëzit rreth teje të ndryshojnë, ti qëndron e njëjtë dhe besnike ndaj vetes tënde. Je një vajzë e dashur, punëtore dhe një nga gjërat që më pëlqejnë më shumë tek ty janë qëndrimet e tua të forta. Uroj që të të shoh gjithnjë e më mirë!

~Juara

Erisjona o yll! Ti je një nga vajzat që më mbush shpirtin vetëm me pozitivitet. Je një vajzë me këmbë në tokë, mjaft e zgjuar dhe e sjellshme. Edhe pse nuk kemi shumë që jemi njohur kam marr nga ti vetëm dashuri dhe kam kuptuar që shoqëria jote ka qënë shumë e vlefshme për mua! Të uroj të kesh suksesin që ti meriton dhe dëshiron! Të dua shumë!!!

-SINDI

Erisjona, edhe pse kemi shumë pak që njihemi,

mendimi im për ty qëndron njëlloj. Ti je një vajzë pozitive, e zgjuar dhe e qetë. Mos ndrysho kurrë pasi këto të bëjnë të veçantë. Jam e sigurt se ke një të ardhme të ndritur përpara.

Suksese dhe të përqafoj fort, Desara!

Erisjona, një burim zgjuarsie mundem ta përshkruaj. Një vajzë tepër inteligjente dhe e matur për moshën që ka. Nuk do gjeja senatore tjetër më të mirë dhe të përshtatshme për këtë rol drejtues. Aftësitë e tua drejtuese dhe menaxhuese të lënë pa fjalë. E vërtetë që nuk kemi shumë që njihemi, por mund të them me plot gojë që je një shoqe e mrekullueshme për këdo. Të uroj sa më shumë suksese në rrugëtimin tënd patriote!

Sara Halilaj



Juara Malaj

Vetëm një vajzë si Juara fal kaq shumë dashuri! Je një vajzë shumë e sjellshme dhe e ëmbël. Përqaqimet më të ngrohta janë ato që dhuron ti. Edhe pse nuk kemi shumë kohë që njihemi, prej teje kam marrë vetëm energji pozitive dhe dashuri! Shpresoj që e ardhmja jote për ty të jetë po aq e ëmbël sa ti vet je! -SINDI

“Po ç’të dalim në fiskulturë se është ftohtë”, dhe unë kam mbajtur një polemikë 15-minutëshe për kushedi çfarë, prite të mbaroja dhe gjithë qetësi m’u përgjigje: “po, ma ke thënë këtë”. Po unë kot nuk të thërras “Mbretëreshë Teuta”. Unë lavdëroja veten për durimin, por përmbajtja jote, mungese jote e mimikave i bën të gjithë lojtarët e pokerit xhelozë. Nuk e reklamon veten e modestia jote më ka bërë shpesh të dyshoj se je espionazh i ndonjë grupi kriminal. Me misterin tënd do na surprizosh të gjithëve. Mezi pres të të shoh më lart dhe të uroj shumë suksese.-KALTRA

Juara, ty të kam takuar këtë vit, por më duket sikur kam vite që të njoh. Je një vajzë e zgjuar, e dashur dhe më ke ndihmuar sa herë ta kam dashur ndihmën. E di që ndonjëherë të bezdis me bisedat e mia, por unë jam kënaqur gjithmonë duke folur me ty. Të uroj shumë suksese.-JOELI

Juaraaa! Edhe pse nuk kemi qenë asnjëherë në të njëjtën klasë, në ato pak minuta që takohemi me jep vetëm energji pozitive. Jemi dy karaktere të kundërta, por kjo gjë nuk e ka bërë të vështirë përshtatjen me ty. Ta kam thënë dhe do vazhdoj të ta them se qetësia jote më frikëson, por e adhuroj në të njëjtën kohë. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj të të plotësohen të gjitha dëshirat!- JASMINA


Juara, vajza më e ëmbël e klasës. Pavarësisht kohës së shkurtër që njihemi, jam e bindur që je një shoqe e mrekullueshme. E admiroj natyrën tënde të qetë dhe mikpritëse. Gjithashtu zgjuarsinë, një tjetër tipar dal-lues i yti. Të uroj sa më shumë suksese kudo!- SARA

Juara, shoqja ime e preferuar e bankës. E kemi njohur njëra tjetrën që në vit të parë dhe mund të them që shoqëria që kemi krijuar vazhdon të bëhet më e bukur dita-ditës. Je një vajzë tejmase e qetë dhe e vendosur në gjithçka që bën, gjë e cila më pëlqen shumë. Pavarësisht situatës, ke qenë gjithmonë aty për të më ndihmuar. Të uroj sa më shumë suksese!
<3-KIARA

Juara, një vajzë zemërbardhë dhe tepër e durueshme pavarësisht situatave të vështira e sikletosëse. Sa herë të jepet mundësia të flasësh vetëm "mjaltë" nxjerr nga goja. Me këshillat apo kritikata e tua ke aftësinë të depërtosh në shpirtin e njerëzve dhe t'u komunikosh fjalë mjaft të çmuara. Besnike dhe e sinqertë, nuk di më se me çfarë të të përshkruaj, përveç se të të them që çdo njeriu në jetë i duhet pakëz nga pozitiviteti që përcjell ti. Të pafsha gjithmonë të qeshur dhe paç suksese kudo në jetë!-ERISJONA

E vetmja shoqe që arrin mos të ngatërrohet me GPS. Ishe një ndër personat e parë me të cilët krijova një miqësi që do të zgjaste përgjatë këtyre tre viteve të gjatë. Kemi me qindra kujtime së bashku, por një ndër më të veçantat është udhëtimi jonë në Angli. Nga ai udhëtim nuk do të harroj të qeshurat e shumta që kishim kur ecnim përgjatë muzeve të Londrës dhe aventurat tona për të gjetur restorante turke ose italiane për të ngrënë drekë. Tani, që po i vjen fundi këtij rrugëtimi, po e kuptoj se sa do më mungojnë muhabetet tona të mbushura plot ironi dhe sarkazma. Të uroj sa më shumë fat për universitet! P.s.: Të lutem vë më shumë se një zile për tu çuar nga gjumi kur të kesh leksionet.<3-ESIANA

Juaraaaa loqka ime e vogël që këtë vit ma ka zbukuruar shkollën. Edhe pse të kundërta me njëra-tjetrën në tip ia kemi dal që ti gjejmë pikat më të forta. Jam shumë e lumtur që të kam njohur shoqeee ... Do më mungosh shummmm! <3
FIONA




Keid Mersini

Keido, "EB"-ja po të shkruan. Po s'të erdhi keq ma kthe stilokalemin që më ke marrë që në vit të parë. Mendon se unë harroj ë? Lëre pastaj pjesën e librave që janë "vulosur" të tërë nga firmat e tua. Të kam thënë që do të bej lek me to pas ca vitesh,por problemi është se s'do të të jap asnjë përqindje të fitimit.Gjëja më për të qeshur që do të mbaj mend nga ty dhe binjakja do të jetë koha që kemi kaluar kur ishim të tre në një bankë te klasa e laboratorit të kimisë e do thonë këta të tjerët po c'ka kaq për të qeshur? Vetëm ne i dimë shakatë që bënim dhe faktin që ishim vendosur të tre anemikët në një vend, sikur ta kishte bërë zysha me plan.Pas gjithckaje i'a kemi kaluar shumë mirë bashkë dhe të vlerësoj si një djalë shumë të edukuar e të zgjuar.
ps: Akoma s'më ka dalë inati që në volejball nuk ma pason topin,se unë mund të jem e shkurtër, por ta kam provuar që luaj më mirë se ty.
Visto nga miushi.

Deri më sot nuk kam patur ndonjëherë rastin të të dedikoj disa fjalë, por ja që erdhi dita. Nuk e di se nga t'ia nis, por dua të të them që ke qenë dhe do të mbetesh mbështetja ime më e madhe, gjë për të cilën jam shumë mirënjohëse. Pavarësisht se zihemi pothuajse çdo ditë, përsëri mua do më pyesësh ç'a detyrash kemi për nesër se nuk ke nga shkon. Përtej shakave, je vëllaço më i mirë dhe të kam shumë xhan edhe pse nuk ta them shpesh. Sigurisht që do më kesh përherë pranë dhe jam e bindur që do jem gjithmonë krenare për arritjet dhe sukseset e tua.P.S: Fatin e bën vetë njeriu ke thënë kështu që nuk ke nevojë Binjakja

E mbaj mend si sot ditën e parë që të takova, gjatë konsultimeve të vitit të parë. Atë ditë, nuk do e mendoja asnjëherë se sa shoqeri të ngushtë do të krijonim në 3

vitet e ardhshme. Nuk do t'i harroj kurrë bisedat dhe shakatë tona gjatë orëve të mësimit si dhe jashtë. Të uroj suksese, megjithse e di që do t'i arrish qëllimet e tua. Derisa te shifemi sërish, KM. Joeli



Joel Biba

Klasa e shtatë, ndër ditët e fundit para pushimeve dimërore, letërsi: unë nisa të flisja për Harry Potter-in dhe DIKUSH kishte lexuar "Asgjë të Re nga Fronti i Perëndimit".

Bashkë me Dostoevsky-n do të ishin ndër shakatë tona të vazhdueshme. Bisedat tona nuk kanë qenë kurrë të mërzitshme. Me pasionin dhe idetë e tua origjinale jam e sigurt që do shkosh larg në jetë, dhe pres të m'i rrëfesh bëmat e tua herën tjetër që do të takohemi.

Deri atëherë,
Kaltrinnnnnn

Joel jam shumë me fat që më ra mundësia të kem një shok si ti! As nuk e mbaj mend sesi jemi bërë shok po di të them se kemi kaluar momentet më të bukura. Do t'i kujtoj gjithmonë bisedat dhe të qeshurat tona të shumta. Në vit të tretë u tremba kur pashë se nuk ishim në të njëjtën klasë, fatmirësisht kjo gjë nuk u bë problem për shoqërinë tonë. Çdokush që të ka në shoqërinë e tij është me fat. E di që je një person kujt mund t'i tregoj gjithçka pa u gjykuar, edhe pse zihemi pak, pak si shumë, po ska gjë. Edhe mjaft na hëngre krrriksat tonaa. Të uroj më të mirat e mundshme dhe uroj të arrish cdo gjë që do për të ardhmen sepse e meriton plotësisht! Të kam shumë xhann!!- Ema

Ndihem me fat që kam arritur të kem një shok si ti gjatë periudhës së gjimnazit. Shumë falemderit për çdo herë që ke ngrenë ushqimet tona. Je një shok shumë i mirë që çdo kush do donte ta kishte. Të uroj suksese në rrugëtimin tënd! -Bela

Këto tri vite më dhuruan shumë miqësi dhe një ndër to je dhe ti. Joeli ne memorien time do të mbahet mend si një djalë i sjellshëm, i kulturuar, i eduku-

ar dhe shumë i zgjuar . Jam e lumtur që të njoha.
Shpresoj të të shoh sa më lart dhe të suksesshëm në
atë ç'ka ti vendos të ndjekësh!- Bora

Kam pasur fatin të kem një shok kaq të dashur dhe
me humor të jashtëzakonshëm si ti. Momente tona të
mbushura me të qeshura do ti mbaj mend gjithmonë.
Joel dua të të them sa shumë do të më mungosh. Do
më marri malli për pushimet e gjata që kalonim duke
ngrënë haribot e Emës dhe për çdo shaka tonën. Uroj
që të kesh shumë suksese dhe lumturi në të ardhmen
- Klenisa



Adrin Cacaj

Je një person shumë pozitiv dhe shpresoj të mbetesh
i tillë. Do t'i kujtoj përherë momentet e bukura që
kemi kaluar. Shokatë e tua do të mbeten me mua
përherë. Të uroj një të ardhme të ndritur!- Ema

Je një djalë shumë i mirë. Të uroj suksese në
rrugëtimin tënd- Bela

Shoqëria ime me Adrin ka nisur në vit të dytë kur ai
u bë pjesë e klasës sonë. Adri do të mbahet mend si
një djalë i edukuar, i sjellshëm dhe me shumë hu-
mor e batuta. Jam e lumtur që të njoha. Shpresoj të
të shoh sa më lart dhe të suksesshëm në atë ç'ka ti
vendos të ndjekësh!- Bora

Adri të uroj më të mirat në të ardhmen. Gjatë këtyre
viteve ke treguar që je një djalë i sjellshëm me të
tjerët dhe me humor në klasë. Ndërsa nisim këtë ka-
pitull të ri nuk kam asnjë dyshim se do t'i plotësosh
të gjitha synime e tua dhe mezi pres të shoh gjërat e
mrekullueshme që do të arrish.- Klenisa



Erik Noka


Erik Noka je një shok shumë i mirë, inteligjent, i shkathët dhe zemermirë! Një mik i vërtetë, i gatshëm për çdo gjë. Të uroj shumë suksese!

Armini Vargu

Ti je një mik i jashtëzakonshëm, gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar dhe për të sjellë gëzim në çdo situatë. Faleminderit që je gjithmonë aty për mua. Vlerësoj shumë shoqërinë dhe besnikërinë tënde.

Me respekt dhe mirënjohje

Klei Shkupi



Ernesto Revani

Ernesto je një nga shokët e mi më të mirë që kam pasur në këto tre vite në gjimnaz. Je një djalë me zemër të madhe dhe do ta vlerësojë gjithmonë shoqërinë tonë. Të uroj suksese në rrugëtimin tënd dhe shpresoj dëshirat e tua të realizohen. Të uth Bianco fort!

Për Erneston, shokun tim me një gojë të mrekullueshme,

Me këtë dedikim dua të shpreh mirënjohjen time për personin e shkëlqyeshëm që je dhe për humorin tënd të pakrahasueshëm. Bisedat tona janë si një vallë e këndshme e humorit, ku çdo fjali që del nga goja jote shkakton gëzim dhe kënaqësi.

Faleminderit që e mbush jetën time me shaka dhe histori të paharrueshme. Me çdo fjalë, ti bën botën të jetë një vend më argëtues dhe të lumtur. Shoqëria jote është një dhuratë, dhe koha që kalohet me ty është gjithmonë një aventurë e paharrueshme.

Laerti



Kriston Sulaj


Kriston!

Gjatë kohës që kemi kaluar bashkë në klasë ke sjell gëzim dhe të qeshura të shumta. Ke qenë gjithashtu një shokë skuadre futbollit shumë i mirë në fiskulturë, ku kemi mundur së bashku çdo ekip kundërshtar. Por edhe kur ke qenë kundër meje, ti e ke bërë ndeshjen akoma më interesante. Shpresoj që të të plotësohet çdo ëndërr që ti ke.

Shoku yt,
Albion Xhepa

Per Kristonin.-Në këtë fletë të përzemërt, dua të shkruaj për një person të jashtëzakonshëm, për ty, Kriston. Me të vërtetë ke sjellë një ndriçim të veçantë në rrugën time të jetës.Faleminderit për çdo kohë dhe çdo moment që kemi kaluar së bashku. Me karakterin tënd të fortë, inteligjencën tënde dhe zemrën tënde të ngrohtë, bën që shoqëria jote të jetë një pasuri e çmuar në jetën time.Në këtë dedikim, dua të shpreh mirënjohjen time më të thellë për të gjitha vlerat dhe cilësitë e tua. Një shoqëri e tillë është një privilegj dhe kujtimet që krijojmë bashkë janë thesari më i çmuar.

Nga Laerti



Reid Karamuçaj

Në këto tre vite që kemi kaluar së bashku, ti ke qenë një shok i pashoq dhe një frymëzim për mua. Energjia jote pozitive dhe shpirti i gjallë kanë ndriçuar çdo ditë tonën. Kemi kaluar momente të paharrueshme që do t'i mbaj në zemër përgjithmonë. Faleminderit që je gjithmonë aty për mua, për çdo qeshje, këshillë dhe mbështetje. Ti je një mik i vërtetë dhe një thesar i çmuar në jetën time.

Je shumë shok i mirë, gjithashtu dhe një djalë i zgjuar. Një e vecantë e jotja është që ke talent për muzikë. Të uroj shumë suksese në jetë, gjithashtu dhe në karrieren tënde!-Eriku



Desara Kapaj

DESHARAAA!Uau, nuk ma priste mendja që do të vinte momenti të të bëja një dedikim. Nuk kam fjalë të të përshkruaj. Je vajza më pozitive, më e lezetshme dhe më e bukur që kam njohur ndonjëherë. Nuk mu desh shumë kohë të kuptoja se sa mirë ndihesha pranë teje. Më kujtohet dita e parë që jemi takuar bashkë, ishte situatë e sikletshme e asnjëra nga ne nuk fliste. Sot shoh se sa afër jemi me njëra-tjetrën. Të qeshurat dhe shakatë tona nuk kam për t'i harruar kurrë. Je ndodhia më emrekullueshme gjatë këtyre viteve. Të falenderoj që duke u bërë pjesë e imja, ti i dhe kuptim viteve të mia të gjimnazit! Të uroj të kesh suksesin që meriton në çfarëdo zgjedhje që të bësh në jetë! Të dua pafundësisht shumë, Sindi.

Desara, Edhe pse jemi njohur këtë vit më ka tërhequr shoqëria me ty. Më ka pëlqyer personaliteti yt dhe shakatë që ti bën. Gjatë periudhës së provimeve edhe pse kemi qenë të stresuar e kemi qetësuar sadopak gjendjen tonë emocionale me shakatë tona që vetëm ne të dy i kuptojmë. Të uroj ta mbyllësh këtë vit me sukses. Shoku yt, Albion Xhepa P.S: Ke qenë një rivale e denjë në volejboll.

Në çdo moment të jetës sime, ti je si një shkëlqim i ndritshëm, duke sjellë gëzim, kënaqësi dhe energji pozitive në çdo hapsirë. Me buzëqeshjen tënde të shkëlqyeshme dhe humorin tënde të pazëvendësueshme, bëhet e pamundur përreth teje mos të ndihesh i lumtur.-Laert

Desara, një vajzë bukuroshe, e sjellshme dhe me një humor të veçantë. Më pëlqen shumë stili yt dhe fakti që i përballon situatat me sportivitetin më të madh. Pavarësisht se kemi pak kohë që njihemi, mund të them që ia kemi kaluar shumë mirë bashkë. Të uroj

fat dhe suksese kudo! Kiara <3

Desara, vajza më e ëmbël dhe e kuruar deri në detaje, e fiksuar pas bukurisë dhe modës, sa ,po të konkuroje për "miss", me siguri do e fitoje me atë sharmin tënd karakteristik.Shumë e shkathët dhe gjithmonë e gatshme për t'u bërë pjesë e bisedave të ndryshme me opinionet e tua mjaft ironizuese.Padyshim dhe humoriste e madhe,sidomos kur bëheni bashkë me grupi-shurupin, ska njeri që ua del mbanë.Ka pak kohë që jemi bërë shoqe, por mjafton për të thënë se e zbukuron klasën si me prezencën tënde apo komplimentet e panumërta.Paç suksese gjithmonë! Erisxhona

Sedara nga Vlora, që megjithëse nuk pata mjaftueshëm kohë të të njihja shumë mirë, e kuptova që je një vajzë e cilter dhe e zgjuar. Kurrë nuk do e kuptoj si ke aq shumë gjëra me Hello Kitty-n. Të uroj suksese dhe vazhdo të jesh ajo që je. Joeli

Desara, një vajzë shumë e ëmbël që me stilin e saj unik të tërheq si magnet. Me aq pak kohë sa njihemi, te ty kam vënë re cilësi pozitive që të karakterizojnë, zgjuarsia dhe besnikëria disa nga ato. Të uroj sa më shumë suksese në shkollë dhe më gjerë! Sara Halilaj

Kur hyra në klasën e re këtë vit, ishe personi i parë që pashë dhe që kur të njoha atë ditë nuk e kam parë kurrë atë buzëqeshjen tënde karakteristike të të largohet nga fytyra. Shpresoj që gjithmonë të jesh po aq e qeshur dhe të uroj suksese!-Kaltrina

Desara, Je nje vajzë e sjellshme dhe pozitive.Per sa kohë jemi njohur ke qenë nje shoqe shume e mirë. Faleminderit per cdo herë që më ke ndihmuar me detyrat. Te uroj suksese kudo qe te shkosh! Ernesto.

Desara, ky vit nuk do të kishte qenë i njëjtë po mos të të kisha njohur ty. Ëmbëlsia jote dhe aftësia për ta bërë çdo situatë më të bukur me shakatë dhe buzëqeshjen tënde është frymëzuese. Të falenderoj për çdo kujtim të bukur që më ke dhuruar këtë vit. Uroj të të shoh të shëndetshme dhe të lumtur gjithmonë. ~Juara

Matura 2024









Flora Çollaku

Përshëndetje nxënës!
Uroj të jeni mirë!

Me anë të këtij shkrimi po ju rikthej “arenën” e shfaqjes trivjeçare:

Ardhja në shkollë, rreshtimi, orët e mësimi, ekskursionet, testet, ceremonia e diplomimit, dëftesat...

Ajo ishte arena në të cilën ju u munduat për të qenë koherent, duke u dhënë rëndësi zgjidhjeve të situatave.

Falë këtyre përballjeve e performancave, padyshim që sot ju keni marrë drejtimin në destinacione të ndryshme, për të finalizuar fitoren në arena të tjera speciale.

Ishte emocion i madh për mua që për herë të parë mora në kujdestari klasën e 12-J,

Ku nisa udhëtimin bashkë me ju, me misionin për të dhënë dije, për të ndarë detyra dhe për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin që t'i jepnim formë aftësive tuaja, për të bërë ëndrrat e gjithsecilit realitet.

Zëri juaj më shoqëronte çdo ditë, madje edhe jashtë ambientit të shkollës, sepse kisha detyrime të cilat duheshin përmbushur, për t'i dhënë zgjidhje situatave të ndryshme, për t'ju dhënë përgjigje. Të tilla si: orarin, provimet, ekskursionet...

Luftuam bashkë, unë krah jush e ju krah meje, që t'i përmbushnim synimet dhe të ralizojmë qëllimet tona.

Ju uroj suksese të mëtjeshme ,gjatë rrugëtimit tuaj profesional!



Deji Karaj

Buen Hoxha: Deji, të respektoj për karakterin tënd të qetë dhe të heshtur. Më kujtohen ditët e para të shkollës kur bënim diskutime në orët e pushimit dhe shprehim mendimet dhe idetë që kishim për çështje të ndryshme. Teksa përgatitemi për universitet, të uroj më të mirën rreth degës që do studiosh, si edhe suksese në jetë!

Jon Memushi: Deji është një nga djemtë më të çiltër që njoha këtë vit. Ishte një nga më të urtit e klasës, ndaj jam i lumtur që munda ta njoh se sa i maturuar është dhe sa shok i mirë mund të jetë. Është gjithashtu një nga portierët më të mirë që kam zbuluar brenda shkollës. Të uroj më të mirat dhe suksese në rrugëtimin që do ndjekësh pas gjimnazit.

Denis Alliaj: Deji je një shok i mirë, bujar dhe serioz. Je gjithmonë gati për të ndihmuar. Të uroj suksese!

Klejsa Neza: Deji edhe pse ne nuk njihemi shumë bashkë gjithmonë më je dukur një djalë i qetë, i cili di të respektojë shokët e klasës dhe t'i degjojë ata. Të uroj sa më shumë sukses në të ardhmen tënde.

Ersi Uruci: Je një djalë shumë i mirë dhe i qetë. Më pëlqen që gjithmonë sheh punën tënde dhe nuk shqetësohesh nga asgjë. Të uroj suksese në jetë!

Noel Sulejmani: Je një djalë fjalëpak, por i saktë në ato që thua. Tregohesh i matur dhe e vlerësoj këtë. Të uroj shumë suksese të mëtejshme!

Fiona Gjoca: Je një djalë shumë i sjellshëm, i qeshur, i cili thotë gjërat e duhura në momentin perfekt. Humori që ke është shumë i vecantë dhe jam e sigurt që shumë të tjerë mendojnë si unë. Të uroj shume

suksese në të ardhmen.

Orkida Jahja: Tepër i qetë dhe gjithmonë duke dëgjuar, uroj shumë që të realizosh të gjitha qëllimet e tua. Shumë suksese!

Adela Shahini: Një çun shumë i qetë dhe i zgjuar dhe gjithmonë mjaft pozitiv. Të uroj shumë suksese!

Kledino Salaj: Djalë i urtë dhe i zgjuar. Jo shumë shkathët por përsëri i gjen anën gjërave.

Bergi Avdulaj: Një nxënës i përkushtuar dhe gjithmonë serioz në procesin mësimor, dhe i gatshëm për t'u aktivizuar. Kënaqsi që shpenzuam vitin e tretë së bashku!

Mesila Hoxha: Deji ke qenë gjithmonë një djalë i urtë dhe paksa gjumash, por nuk përtoje kur bëhej fjalë për mësimet. Të uroj suksese për vitet në vijim!

Shefrim Shtylla: Një djalë i qetë dhe i përkushtuar në mësimet. Nuk flet shpesh, por kur përfshihet e bën çdo bisedë të jetë interesante dhe frymëzuese. Kënaqësi që u takuam dhe të uroj suksese!

Enio Kazazi: Deji edhe pse s'te kam njohur për një kohë të gjatë, më ke treguar që je një djalë me vlera dhe mjaft pozitiv. Asgjë si afrohet muhabetëve tona për me nga ne autobuzin e Kamzës, kur na binte rruga bashkë dhe mund të shihje se si të ndritnin sytë, kur përmendej si temë. Edhe pse je mjaft i qetë nuk është e vështirë të kuptohet që je një djalë mjaft i mirë dhe shumë karizmatik i cili edhe pse i ndrojtur gjithmonë të mekte me ato shakatë, te pakta ne numër, por gjithmonë efektive. Të uroj suksese në jetën tënde.



Shefrin Shtylla

Anda Kola- Shefrin, je një nga vajzat më të mira që unë kam patur fatin të njoh. Menjëherë bie në sy prej energjisë pozitive që ti rrezaton duke e përcjellë te të gjithë rreth teje. Je kaq e këndshme,sa bisedat tona do të kenë një vend të veçantë në kujtimet e mia të gjimnazit. Ndihem me fat qëkam kaluar kohë me dikë si ti. Je vajzë shumë e zgjuar, prandaj mezi pres që të të shoh sa më lart,duke arritur majat. Të uroj më të mirat e botës dhe të përqafoj fort fort <3

Ersi Uruci - Shefrin, ti je një vajzë shumë e zgjuar dhe vendosur. Miqësia jonë ka nisur që nëkopësht ,por këtë vit jemi njohur edhe më mirë me njëri-tjetrin. Gjithmonë e ke dalluar veten ngapjesa tjetër me karakterin tënd miqësor. Nuk do e harroj ndonjëherë atë sensin tënd të humorit qëi bënte të gjithë të qeshnin. Ti i plotëson të gjitha qëllimet që i vendos vetes me një përkushtim edëshirë të madhe. Të uroj të vazhdosh kështu edhe suksese në të ardhmen! Shpresoj që miqësiajonë të vazhdojë edhe më gjatë.

Fiona Gjoça - Udhetimi im në 9-vjecare dhe gjimnaz sdo të ishte kurrë bërë i mundur pa ty dhe Adelën, ndaj të falenderoj shumë për cdo moment të bukur që kemi kaluar bashkë. Afërsia me ty më ka treguar më së miri anë të bukura të personalitetit dhe mendjes tënde, të cilat ushqehen mbi dashamirësi dhe zgjuarsi. Je shumë e lirshme dhe komunikon pa komplekse, cilësi që të tërë do donin t'i kishin. Të uroj shumë suksese kudo që të jesh, Bubbleërap!

Kevin Kotarja-Je vajza më e mirë që kam njohur. Edhe pse një kat më poshtë, çdo pushim kemi qenë te dera e klasës së njëri-tjetrit. Je aq e saktë në çdo gjë që bën sa mund të të lej çfarëdolloj pune në dorë pa frikë. Këto tri vite kam pafund kujtime me ty të cilat do jenë të

paharrueshme. Do më mungojnë mëngjeset bashkë ku më tregojë për librat e shumtë që kishe lexuar. Edhe pse nuk kam patur ndonjëherë pasion për librin, ti më ke bërë t'i pëlqej. Çdo pushim i madh me ty ka qenë plot adrenalinë, bazuar në sa gjumë kishe fjetur atë ditë (o)mund të kaloje 30 minutat më të bukura ndonjëherë, ose do të shikoje ferr me sy, një ferr të bukur ama. Do më kujtohet sa e sa herë mezi prisja të fillonte pushimi që më në fund të të përqafoja ty. Shefrin për mua ke qenë pjesa më e bukur e një pjese të madhe të rrugëtimit tim në gjimnaz. Më ke bërë të vij me qejf në shkollë. Je një vajzë shumë e ëmbel e cila më je gjendur pranë kurdoherë dhe ndihem me fat që të kam njohur. Si nje petull e qeshur që je, ma ke bërë këtë rrugëtim shumë të bukur. Të uroj suksese të pafundme!

Adela Shahini- Nëse shpirti binjak do të kishte një emër pa dyshimin më të vogël që do të ishte ti. Dhe vetë çuditë ndonjëherë se si mund të kemi mendime kaq të njëjta, për mos të thënë fiks njësoj. Të qeshurat tona dhe bisedat pa fund janë ato që e bëjnë gjimnazin kaq të veçantë. Se kuptoj si nuk na mbaruan ndonjëherë muhabetet o goc. Do të më marrë shumë malli për shakatë që i kupton pa filluar unë të flas akoma, për momentet që qeshim sa na dhemb barku, por mbi të gjitha për ty bestie. Se nuk e bëje dot universitetin këtu... Nejsee mos t'i hyj asaj teme. Shkurt muhabetit je si një motër për mua, një person që mund të ndaj çdo gjë nga jeta ime pa u menduar dy herë, prandaj shoqëria jonë është një thesar që do ta ruaj gjithmonë me kujdes. Të uroj shumë suksese në rrugëtimin tënd të ri dhe mos mendo se do shpëtosh ndonjëherë nga un. :) Të kam xhan!

Albion Qojle-

Në vit të parë, Shefrinën e pamë,
Por s'folëm kurrë tamam.
Në vit të tretë, te kimia u miqësuam,
Një shoqëri të fortë aty filluam.
Shefrin, e ëmbël dhe pozitive,
Gjithmonë ndihmon, gjithmonë aktive.
Nje vajzë gango, me vetëbesim ,
Ta adhurojmë ate kurajon, me nderim
Nga Albioni dhe Anda, shokët e tu të rinj,
Që shumë të duan, dhe gjithmonë të mbajnë në mend.



Fiona Gjoca

Orkida Jahja - Ah, Fiona. Të them të drejtën, kur fillova vitin e fundit të gjimnazit, nuk prisja të formoja ndonjë shoqëri aq të afërt sa krijova me ty. Edhe pse nuk kam tepër vend të rendis të gjitha momentet gazmore që kemi kaluar bashkë, dije që çdo shaka, çdo 'eskursion shkollor jashtë shkollës', çdo açma në mëngjes dhe çdo vizitë në 'tempull' apo karriget te korridori mbrapa Valit, kanë qenë disa nga kujtimet më të bukura të këtij viti. Të falenderoj për shoqërinë që kemi dhe të uroj të gjitha të mirat e kësaj bote, pasi i meriton pa diskutim Blo :). (PS. Nëse ka nxënës që po e lexojnë këtë dedikim siç i lexonim ne te zyra e zysh Sonilës ,nuk besoj të kenë kuptuar gjë nga këto.)

Andrea Cela - Nëse këtë vit do të më pyesnin t'i vija gishtin personit më të vendosur për qëllimet e saj, më punëtoren dhe sigurisht me një gjakftohtësi të frikshme kundra sfidave të ndryshme, ajo do të ishte Fiona. Një vullnet i paparë, një vajzë e zgjuar dhe shumë e maturuar. Shumë kënaqësi që vitin e fundit pata mundësinë të ishim në të njëjtën klasë dhe të të shikoja vlerat dhe virtytet e mira që ke. Ti synon shumë lart dhe kjo është gjë shumë e mirë duhet t'i mbash prioritetet në vijë të drejtë. Kam besim me aq sa arrita të të "psikologjis" se për atë që do ,lufton deri në fund. Shpresoj të të realizohen të gjitha dëshirat dhe të uroj një jetë me plot sukses dhe gëzim.

Enio Kazazi - Fio, s'është hera e parë që jemi në klasë bashkë dhe mund të them se pas kaq shumë viteve, je kthyer në një individ që rrezaton ngrohtësi dhe që është gjithnjë e gatshme të zgjasi dorën për të ndihmuar dikë. Punëtore dhe e palodhur, je një nga ata njerëz që edhe në mes të talentit bie në sy. Në fillim s'pata mundësi ta shihja këtë, por teksa ditët po kalonin fillova të njihja një person që rrezaton konfidencë tek

njerëzit që të rrethojnë, këtu duke më përfshirë dhe mua. Bisedat në orët e pushimit, vullneti yt për të qenë gjithmonë korrekte dhe gjithmonë e qeshur me ata që ke patur pranë, më ka ndihmuar të kuptoj sado pak se kush je dhe për më tepër sa e veçantë je. Shpresoj që në udhëtimin tënd të gesh gjithmonë lumturi e sukses.

Ersi Uruci - Fiona, shoqja e bankës para. Klasa nuk do të ishte njësoj për mua, nëse nuk do të ishte ti aty çdo ditë me zgjuarsinë dhe muhabetin tënd. Jemi njohur këtë vit, por përsëri e vlerësoj shumë miqësinë tonë, sepse gjithmonë je munduar të më ndihmosh me çdo gjë të mundshme. Të uroj suksese në të ardhmen!

Jon Memushi - Këtë vit kuptova se sa me fat do kisha qenë sikur të kisha njohur Fionën që në vit të parë. Është një nga vajzat më të maturuara, më inteligjente, më energjike dhe pozitive që kam njohur. U çudita sidomos, kur kuptova që kemi të njëjtin humor. Pa dyshim një nga shoqet më të mira që kam bërë këtë vit. Të uroj vetëm më të mirat në të ardhmen tënde.

Esiana Këllici - Fiona, e zgjuara dhe shkathta e klasës. Ndhima jote në shumë lëndë të shkollës më ka shpëtuar në shumë çaste të vitit. Je liderja më e duruar dhe e mirë që kam patur nëpër projektet e shkollës. Nuk e vë në dyshim që pavarësisht degës së vështirë që ke zgjedhur do të arrish të shkëlqesh si gjithmonë.

Adela Shahini - Ende më kujtohet hera e parë që jemi takuar në klasë të pestë dhe buzeqeshja jote që ishte mikpritja e parë për mua në shkollë. Fion, ti je një vajzë shumë e zgjuar dhe e vendosur. Kemi shumë kujtime bashkë që nuk harrohen kollaj (tetë vite nuk janë pak). Mbase

Adela Shahini - Ende më kujtohet hera e parë që jemi takuar në klasë të pestë dhe buzeqeshja jote që ishte mikpritja e parë për mua në shkollë. Fion, ti je një vajzë shumë e zgjuar dhe e vendosur. Kemi shumë kujtime bashkë që nuk harrohen kollaj (tetë vite nuk janë pak). Mbase fati do ti presë prapë rruget tona në të ardhmen dhe kësaj here shpresoj të vijmë me versionin më të mirë të vetes. Të uroj shumë suksese në karrierën tënde dhe fat kudo!

Kledino Sala - Një shoqe shumë e mirë dhe që nuk të lë në baltë. Ndonëse e urtë, je dhe shumë e zgjuar. Faleminderit për ndihmën dhe për kohën e mirë që kemi kaluar këtë vit. Të uroj shumë suksese në jetë!



Esiana Këllici

Mes të qeshurave, sfidave dhe kujtimeve të pafundme, ke qenë mbështetja ime më e madhe gjatë rrugëtimit të gjimnazit. Shakatë tona të panumërta, bisedat e pushimit të madh, debatet për detyrat dhe mbështetja jote e palëkundur do të më mungojnë pafund. Asnjëherë s'ma ke prishur qejfin dhe ke qenë gjithmonë e gatshme të bësh çdo gjë me mua pa e menduar dy herë. Së bashku kemi ndërtuar një miqësi që kapërcen sfidat e kohës dhe distancën. Do të kesh përgjithmonë një vend të veçantë në zemrën time dhe të uroj suksese kudo! -Daria Sinani

E dashura, e ëmbla dhe e vockla (si karamelat e kam përshkruar) Esiana. Je një ndër shoqet më të mira që kam krijuar përgjatë periudhës së gjimnazit. Gjëja që na bashkoi dhe që na e përforcoi shoqërinë tonë ka qenë pikërisht letërsia. Ai ASEF-i i letërsisë është ndër projektet e mi më të preferuar, sepse arrita të të njihja më shumë si person dhe se sa e ngrohtë është shoqëria me ty. Gjithmonë do t'i vlerësoj me përzemërsi librat që më ke rekomanduar, fundja ti më prezantove me një ndër autoret e mia të preferuara (Mieko Kaëakami <33). Të uroj plot suksese në të ardhmen tënde (që është e ndritshme si një yll, pa dyshim)!! P.S.: Kur po të shkruaja dedikimin po dëgjoja playlist-in tonë. -Vivien Kushi

Esiana, je një nga shoqet e mia më të ngushta. Jam e lumtur që miqësia jonë zuri rrënjë në vit të dytë, edhe pse do të doja që kjo të kishte ndodhur më parë. Për mua prezenca jote i ka dhënë më shumë kripë e lezet këtyre viteve. Këtij viti shkollor po i vjen fundi, por unë gjithmonë do të të kujtoj si shoqja së cilës mund t'i flisja me lehtësi për çdo gjë apo çdo problem pasi ishe aty për të më dëgjuar apo dhënë një këshillë. Je një vajzë e qetë, e aftë e racionale dhe mendoj se kudo

të të çojë jeta, ti do t'ia dalësh. Do të më mungosh dhe shpresoj të takohemi sërish herë pas here. Deri atëherë të uroj shumë fat dhe suksese! -Alisa Imeraj

Disa muaj janë pak për të njohur një person, por nuk më ke dhënë asgjë më pak se mendimet më të mira. Më ke dhënë përshtypjen e një vajze të ëmbël dhe të dashur me të cilën mund të zhvillosh lehtësisht një bisedë. Të kam besuar dhe mikeshën tonë, Darlën. Të kam xhan! -Shefrin Shtylla

Gjithmonë në sytë e mi ke qenë një vajzë pozitive, dhe do të të konsideroja pa pikë dyshimi si vajza më e zgjuar që kam njohur ndonjëherë. Je e papërtuar, tepër e sjellshme dhe një shembull për t'u ndjekur nga kushdo. Të uroj shumë suksese në vitet në vijim. -Fiona Gjoça

Esiana ne kemi shumë pak kohë që jemi njohur së bashku, por kjo nuk na ka penguar për t'u afruar me njëra-tjetrën dhe ndarë kujtime shumë të bukura. Orët e fizikës janë bërë të paharrueshme me shakatë e tua dhe gabimet në makinën llogaritëse. Gjithmonë do të më befasoje se si një person mund të duket kaq i qetë, por të jetë kaq energjik në të njëjtën kohë. Kjo është gjëja që pëlqej më shumë tek ti. Faleminderit që gjithmonë më dëgjon plot vëmendje dhe gjendesh aty për mua. Të përqafoj dhe të uroj shumë suksese! -Klejsa Neza

Esianën e kam patur në klasë që prej vitit të parë dhe e kam njohur si një vajzë inteligjente, të sjellshme dhe e cila është gjithnjë në humor. Të uroj fat në të ardhmen tënde, edhe pse e di që serioziteti yt dhe puna jote që tani do të ta shpërblejnë me patjetër. -Jon Memushi



Greta Xhemo

Fjona Gjoca- Një vajzë shumë e sjellshme, e cila dallon nga vajzat e moshës së saj për maturinë dhe mendimet e qarta që ka. Diskutimet gjatë orës së fiskulturës më kanë treguar sesa e zgjuar dhe mirëkuptuese je. Suksese të mëtejshme

Shefrin Shtylla-Greta ty te karakterizon nje çiltersi dhe delikatesë, ashtu si ke dhe kuptimin e emrit, një perlë. Aq kohë sa duhet per të gjetur e për t'u kujdesur për një perlë ashtu vjen dhe veëantia e bukuria jote. Te gjitha momentet që kemi ndarë bashkë në një mënyrë apo tjetrën i kam ndarë dhe me Gledis. Shpresoj të vazhdosh të përhapësh dashuri dhe mirësi kudo që të shkosh, duke treguar se një person e ka aftësinë për të bërë dallimin. Uroj që jeta jote të jetë e mbushur me lumturi dhe arritje

Denis Alliaj-Greta je një vajzë shumë e zgjuar dhe puntore. Nuk e di se për çfarë do vazhdosh, por e di që do bëhesh biznesëoman më e fort' në Shqipëri. Ti bën 1/2 disset më të forta. Të uroj shumë sukses në jetë.

Esiana Këllici - Vajza e qeshur e klasës. Qetësia dhe pozitiviteti jot kanë sjellë një ndjenjë paqeje dhe gëzimi gjatë ditëve të shkollës. Çdo moment të vitit e ke bërë më të këndshëm dhe më ke kujtuar ta marrë jetën ashtu siç vjen. Prezenca jote e bënte klasën si çaji që merrje çdo ditë, të ngrohtë dhe relaksues.

Kledino Sala- Gerti ke qenë një shoqe shumë e mirë. Je një vajzë e zgjuar dhe e fortë. Nuk e prisja të bëheshim kaq shokë ,por koha më tregoi që isha gabim. Kemi kaluar një vit shumë të bukur me eksperiencia nga më të ndryshmet. Të falenderoj për kujtimet e bukura dhe të uroj suksese në jetë!

Klejsa Neza - Shoqja ime më e mirë në klasë dhe bjondja e preferuar. Ke një bukuri karakterizuese me sytë e tu të bukur jeshil. E adhuroj tipin tënd të fortë dhe mënyrën se si tek çdo person gjen më të mirën. Do të ngelen në kujtimet e mia të qeshurat dhe gallatat tona, por mbi të gjitha ngrohtësia, mirëkuptimi dhe mbështetja jote. Gjithmonë të shoh duke u marrë me një aktivitet të ri plot ambicie. Jam e sigurt që do vazhdojmë të krijojmë sa më shumë kujtime së bashku. Të kam shumë xhan dhe të uroj të të plotësohen të gjitha ëndrrat dhe dëshirat e tua!

Buen Hoxha-Greta, ti je e qeshur dhe e gjallë, gjithmonë e gatshme për një aventurë të re. Nuk do ta harroj kur u njohëm për herë të parë në klasën e gjashtë. Mbas asaj, kemi kaluar tri vite të mbara në gjimnaz, duke bashkëpunuar për të arritur nota të mira si në projektin e fizikes nga viti i kaluar. Shpresoj që të arrish synimet që ke, jo vetëm në universitet, por edhe në vazhdim. Të uroj një jetë me plot sukses dhe gëzim.

Adela Shahini- Akoma me kujtohet dita e pare e shkollës në klasë të pestë, kur ndrojtja ime ne klasën e re kishte ikur pasi ti më the te uleshim bashke ne banke. Greta ti je një shoqe shumë e mirë e zgjuar dhe e sinqertë. Gjithmonë e qeshur dhe përherë i merr gjërat me pozitivitet. Je një vajzë me karakter të fortë por zemër të butë. Kemi kaluar kohë të bukur bashkë dhe shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë edhe në të ardhmen. Të uroj gjithë të mirat! Suksese!

Bergi Avdulaj- hera e parë që jemi në klasë së bashku dhe kemi krijuar një shoqëri shumë të mirë, gjithmonë e gatshme për të bërë shaka dhe ngacmuar Nelin. Kemi lloj- lloj kujtimesh, te cilat janë plot me gallata. Je nje person gjithë surpriza dhe asnjëherë s'të thua jo. Suksese ne jetë!

Noel Sulejmani- Greta ti je një vajzë shumë e çiltër dhe e muhabetit. Brenda një viti jemi miqësuar shumë me njëri-tjetrin. Më pëlqen që na përshtatet mënyra e të menduarit, si dhe shija muzikore. Gjithmonë e meriton auxin. Ke karakter të fortë, e për këtë të vlerësoj. Të uroj shumë suksese kudo dhe pa merak se nuk vyshken!

Geldi Pepa:-Bashkë jemi njohur shumë herët,por me sa pashë këtë vit ke ndryshuar shumë. Nuk do t'i harroj kurrë momentet, kur uleshe ne bankë të parë dhe fluturonin letrat kokës. Suksese në jetë!



Jona Ramaj

Jona, je një ndër vajzat më të sjellshme dhe të dashura që kam njohur ndonjëherë. Bisedat e këndshme, shakatë si dhe muzika që shpesh na lidh bashkë, janë kyçe ,kur dua të të përshkruaj. Mendoresh të japësh këshilla të drejtpërdrejta nëpërmjet natyrës tënde të qetë. Të kam shumë xhan dhe të uroj suksese të mëtejshme!-Fiona Gjoça

Për shpirtin më të çiltër që njoh, Jonën. Dashuria dhe ngrohtësia jote na kanë ndikuar pozitivisht të gjithëve në klasën tonë. Gjimnazi nuk do të ishte i njëjtë pa miqësinë tënde të vërtetë. Të uroj gëzim dhe sukses të pafundëm në të gjitha përpjekjet e ardhshme. Ti meriton botën!”-Orkida Jahja

Edhe pse erdhi vetëm për një vit në shkollën tonë, Jonën e dallova si një nga vajzat më pozitive, të çiltra dhe të përkushtuar. Shoqëria e saj në klasën tonë në vitin e fundit s’do jetë gjë veçse një kujtim i këndshëm. Të uroj më të mirat dhe suksese në rrugëtimin që do ndjekësh pas gjimnazit. – Jon Memushi

Jona shoqëria jonë nisi jonë nisi çuditshëm,por kam kuptuar që je një vajzë e urtë,e sjellshme,një vajzë që gjithmonë përcjell energji pozitive.Të uroj shumë suksese dhe shpresoj të mbetesh po kjo vajza që nuk dorëzohet kurrë!-Mesila Hoxha

Nuk arrita kurrë te njihja karakterin tënd te vërtetë ,sepse nuk kemi shpenzuar shumë kohë së bashku,por më ke lënë mbresa shumë të mira. Je gazmore dhe ndonjëhere pak nevrrike.Je një piktoe e jazakonshme,mos e ler mbas dore këtë talent. Te uroj shume suksese!-Klejsa Neza

Edhe pse erdhe në shkollë këtë vit përsëri munde të

përshtatesh shumë mirë duke treguar vlerat e tua. Kënaqësi që shpenzuam vitin e tretë së bashku!-Bergi Avdulaj

Jona, më e talentuara për të interpretuar zërin e personazheve të ndryshëm. Aftësia jote e veçantë më ka bërë gjithmonë për të qeshur. Pozitiviteti jot gjithmonë I jepte më shumë ndriçim klasës. Të uroj sa më shumë suksese në universitet!-Esiana Këlliçi

Je një vajzë e urtë ,por cool nëse të njeh më mirë. Mund të përshtatesh pa vështirësi dhe mendoj se kjo do të të vlejë ne jetë. Te uroj shumë suksese!-Noel Sulejmani

Vajzë e përfshirë si në mësim, si në shoqëri. Ke një energji që i bën të gjithë për vete. Pas shumë interesave të përbashkëta them se shoqëria jonë do të vazhdojë. Suksese!-Shefrin Shtylla

Jona, pavarësisht se nuk kemi biseduar shumë, e kam vënë re që je e çiltër. Ka qenë kënaqësi që jemi njohur këtë vit. Të uroj më të mirën në universitet dhe shpresoj të kesh suksese në jetë!-Buen Hoxha

Jona është një vajzë e zgjuar dhe e qetë . Shpesh herë ajo fshihet shumë mirë mbas te qeshurave dhe bisedave të klases ama gjatë orës së mësimit rrallë herë e sheh të mos të aktivizohet. Të uroj suksese për më tej.-Enio Kazazi



Klejsa Neza

Gledis Arapi-Klejsa, u bënë aq shumë vite që njihemi bashkë. Kemi aq momente të bukura, dhe gazmore që të voglakur luanim në lagje e deri tani. Je një vajzë e qeshur dhe shumë e dashur. Faleminderit për çdo këshillë që më ke dhënë dhe që më ke ndenjtur afër. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj që të të plotësohen të gjitha dëshirat! Të kam shumë xhan.

Klesta Ademaj-Kur bëhen Kuksi me Hasin bashkë bëhet nami. Më vjen mirë që të kam njoftur, edhe që kemi kaluar momente shumë të bukura bashkë. Asnjëherë nuk ka munguar humori yt, dhe muhabetet e pafunda. Çdo ditë ke përcjellur pozitivitet dhe energji. Të falenderoj për gjithçka dhe të uroj gjithë të mirat, me shumë dashuri Klesta!

Aldo Kulemani-Je një ndër gocat më të veçanta që jeta më ka mundësuar të njoh. Ishte vërtet periudhë e shkurtër koha që në të dy kaluam bashkë, por ishte e mjaftueshme për ta kuptuar se sa mirë mendimet tona përshtateshin bashkë. S'mund të harroj lehtë bisedat deri ne orët e para të mëngjesit. Kam arritur ta kuptoj shumë mirë karakterin tënd plot gjallëri, humor dhe me pozitivitet dhe kjo është arsyeja që me sinqeritet të plotë them, se je ndër personat më me vlerë për mua. Kemi kaluar pafund momente të bukura bashkë dhe jam i sigurt se do jenë kujtime të gjata në mendjen tonë.

Greta Xhemo-Klejsa, je një nga vajzat më të mira që kam njohur. Je një vajzë e zgjuar, e bukur dhe shumë gazmore, me një tip shumë modest dhe të lezetshëm. Bjondja ime. Jemi njohur që të vogla, por këtë vit jemi përshtatur shumë me njëra-tjetrën. Më pëlqen shumë fakti që je një person që i do gjithmonë të mirën tjetrit, të ndihmon kur ke nevojë dhe nuk e krahason kurrë veten me njerëzit e tjerë. Je shumë

entuziaste për jetën dhe punon fort për të arritur atë që do. Me këto cilësi dhe zemrën e mirë që ke, jam e sigurt që do të vijnë vetëm gjëra të mira në jetë, të cilat i meriton. Te kam shumë xhan dhe suksese.

Shefrin Shtylla-- Ti gjithmonë do jesh pjesë e kujtimeve të mia që në fëmijëri. Sa herë të kujtohem për filloren do të them se "Kam pasur një Klejsa në klasë që...". Për mirë gjithmonë do vazhdojë fjalja. Me ty, çdo ditë është e mbushur me kujtime të veçanta dhe momente të këndshme. Më frymëzon shumë mënyra si pasqyron vetëm pozitivitet dhe që më kujton gjithmonë atë Pinkie Pie. Të kam shumë xhan! Parid Çela-Klejsa kemi kaluar momente shumë të bukura dhe gallata që s'do harrohen. Vajzë inteligjente me humor te spikatur dhe nje shoqe e veçantë që gjithmonë të gjendet pranë në hall e nevojë! Te uroj gjithë të mirat e botës kudo që të shkosh dhe jam i bindur që do të kesh sukses!

Fiona Shehu-Klejsaaa goca më energjike që çdo ditë të gjimnazit ma ka mbushur me pozitivitet. Kujtimet ,shakatë dhe budalliqet e shumta do të mbeten gjatë në kujtesë .Nuk mund të them që do njoh dikë tjetër si tipi, jot pasi je shumë e veçantë...Suksese zemraaa dhe sa më lart! Denis Alliaj-Klejsa je nje vajze shume gazmore dhe tepër energjike. Humori jot i goditur në çdo moment është një nga virtytet më të forta e tua. Shpresoj te bëhesh një mjeke e suksesshme dhe shumë e pasur. Të uroj vetëm suksese o shoqëruesja ime angleze e çajit! Sindi Rraja- Klejsa ime,për ty e kam kaq shumë të vështirë të flas. Ti je motra që nuk e pata kurrë. Jam shumë me fat që të kam në jetën time,sa herë kam qenë e mërzhitur, gjithmonë je munduar të më bësh të lumtur. E di që shoqëria jonë do të zgjasë. Kam besim që do bëhesh një grua e arrirë! Të dua shumë!!

Esiana Kellici-Klejsa, personi i vetëm që ishe plot me energji dhe humor çdo mëngjes. Çdo situatë që supozohej të ishte kritike, ti e ktheje në komike përmes shakave dhe sarkazmave.Pres që pas 10 vitesh të të dalë emri për mjeken më të mirë, edhe pse mendoj që të shkon më shumë administrimi i biznesit.

Adela Shahini- Nuk duhet të kalonim shumë kohë bashkë për të kuptuar karakterin tënd të fortë dhe moskokëçarës (por jo gjithmonë). Nëse është diçka që më pëlqen më shumë tek ty, ai është pozitiviteti jot që arrin ta "shpëtoje" ditën sa herë që shkolla na ka ardhur "në majë të hundës". Kohet e bukura që kemi kaluar bashkë do mbeten ne kujtesën time.



Buen Hoxha

Jona Rama -Gjithmonë i sinqertë dhe i drejtë me të gjithë.Te uroj suksese të mëtejshme!

Orkida Jahja - Për Buenin, të cilin kreativiteti i pakufizuar dhe mendimi inovativ na kanë sfiduar të shohim botën në mënyra të reja. Uroj që e ardhmja jote të jetë e mbushur me frymëzim të pafund dhe aktivitete krijuese!

Kledino Sala - Djalë i urtë, i mirë dhe i shkathët. Një shok me vlera që jo shumë i kanë.

Mesila Hoxha - Buen që kur të kam njohur në klasë të 6-të,ke qenë një djalë i edukuar, nxënës me bagazh,por mbi të gjitha një djalë pozitiv.Uroj të arrish aty ku e meriton! Suksese!

Fiona Gjoca- Edhe pse jemi njohur prej një periudhe të shkurtër kohore, do të të konsideroja lehtësisht si një prej nxënësve më të zgjuar e të përgatitur që ka shkolla jonë. Gjithmonë je i sjellshëm, ndihmues dhe punëtor, cilësi që janë për të admiruar. Të uroj shumë suksese! Ted Hajdëri - Jam shumë i lumtur që ishim në klasë bashkë këtë vite dhe ja kemi kaluar shumë bukur. Shpresoj të dalësh sa më mirë dhe të uroj më të mirat në të ardhmen.

Esiana Këlliçi - Buen patëm një rrugëtim të gjatë me zgjidhjen e ushtrimeve të fizikës. Me shumë sforco arritëm ta përfundonim me sukses këtë vit. Të uroj suksese dhe fat për sfidat e ardhshme që të presin në universitet!

Bergi Avdulaj - Gjithmonë kemi pasur të përbashkët dëshirën për të luajtur basketboll dhe kjo na ka afruar më shumë. Gjithashtu ke qenë gjithmonë i gatshëm

për të ndihmuar çdo njeri në klasë pa përtesë dhe kjo të bën një shok të mirë. Kënaqësi që shpenzuam vitin e tretë së bashku!

Noel Sulejmani - Një djalë shumë i qetë dhe orator. Je i gatshëm të ndihmosh të tjerët dhe kjo të bën të pëlqyeshëm nga klasa. Të uroj shumë suksese!

Jon Memushi - E kam pasur të tria vitet në furgon, por këtë vit që e kisha në klasë pata mundësinë ta njoh Buenin si shok klase, si partner projekti dhe si shok ekipi në futboll. Është me të vërtetë një nga djemtë më të pjekur që kam takuar dhe më të matur, si një person vërtetë i arsyeshëm. Të uroj suksese në çfarëdolloj rruge që do ndjekësh.

Etien Dhima - Ke qenë gjithnjë një figurë konstante në jetën tonë që nga klasa e 7-të. Gjithnjë flisnim për "Buenin, shokun që është i gatshëm kur duhet", por kurrë nuk kishim dëgjuar se ç'mendonte për veten, deri më tani. Edhe pse nuk mund të them që jemi njëmend për shumë gjëra, që lind debate të pafund, duhet respektuar vendosmëria që mban mbi ideologjinë tënde. E vlerësoj zgjuarsinë tënde dhe përkushtimin tënd për të bërë atë që t'i sheh si të drejtë dhe të uroj suksese në të ardhmen.

Enio Kazazi - Buen je një nga shokët më besnik dhe një nga njerëzit më të mirë që kam njohur dhe për këto vite që të kam njohur kemi kaluar shumë ndodhi dhe kemi krijuar mjaft memorie të bukura. Do t'i kujtoj gjithmonë netët që kemi qenë të vetmit që na duhej të mësonim bashkë pasi nuk na fiksoheshin gjërat. Të shpresoj më të mirat dhe suksese në rrugëtimin tënd të jetës.



Enio Kazazi

Etien Dhima- S' di ta them nga ka qenë zanafilla e Enios në jetën time. A të nisim nga "Enio që njoha në klasën e gjashtë dhe nuk prisja ta kisha mik kaq të afërt", apo "Enio, miku i harruar i fëmijërisë sime"? Në të vërtetë, pak rendësi ka. Rëndësi ka Enio që është tani, një mik i pandarë, dhe me një dedikim të pakrahasuar. Ai pas çdo gafe katastrofike arrin të gjejë mënyrën si të ngrihet dhe ta kalojë atë pengesë. Dhe pse ndonjëherë fillon e endërron duke parë horizontin, ky gjeni e ka vëmendjen 100% te ty kur të duhet ndihmë, dhe bën çmos që të nxjerri miqtë e tij nga gremina. Unë i jam xheloz çdo njeriu që do e ketë mikun e tij të përditshëm me tej, sepse mund ta them që do më mungojë.

Buen Hoxha-Enio, po bëhët viti i pestë me miqësinë midis nesh dhe mund të them që kanë qenë ndër më të mirat të cilat kam përjetuar. Nuk më duhej shumë kohë që të kuptoja sa i përkushtuar dhe i kujdesshëm je me shoqërinë. Kemi pasur plot diskutime nga llojet më të ndryshme dhe gjithmonë vihej re sinqeriteti dhe zgjuarsia jote në to. E di që do arrish majat me degën që ke zgjedhur. Të uroj gjithë të mirat dhe sukseset në jetë!

Orkida jahja-Unë do të jem më së mirë me ty (sic jam zakonisht), kur u detyrova të punoja me ty në projekte të shumta të 'ASEF' dhe 'First Lego League', nuk isha fort e lumtur për këtë fakt. Por, pas tri vitesh miqësie, mund të them se është ndër herët e para që jam e gëzuar që u vertetova gabim. (Kjo nuk ndodh shpesh, siç ti e di edhe vetë). Një person shumë pozitiv, kam vënë re transformimin tend në individin e veçantë që je sot për gjatë 3 viteve. Të uroj shumë suksese në jetë dhe jam e sigurt që do të të shoh serish në ndonjë projekt tjetër në të ardhmen!

Bergi Avdulaj-Një nga shokët e parë që kam bërë, që në fillimet e udhëtimit tim arsimor. Njihemi që në kopësht dhe jam i lumtur, që e nisëm dhe do ta përfundojmë së bashku. Një person shumë i dashur dhe gjithmonë gati për të ndihmuar të tjerët. Gjithashtu një student shëmbull për nxënësit e klasës. Kënaqësi që kaluam vitin e tretë së bashku!

Fiona Gjoca-Më ka bërë çudi që dhe ti ishe po aq i apasionuar pas parfumeve sa dhe unë. Duke folur për koleksione, e duke kaluar më vonë në tema të tjera, qofshin delikate apo qesharake, kam kuptuar se sa djalë shpirtmirë dhe i ndjeshëm je. Mundohu t'i ruash këto vlera dhe t'i transmetosh te kushdo pranë teje. Falë zgjuarsisë dhe aftësive të shumta që ke, jam e sigurt që do ndrisësh kudo që do jesh. Shumë suksese!!

Rei Escobar-Për ndoshta personin më të vërtetë që kam njohur ndonjëherë dhe që gjatë gjimnazit, kemi krijuar një shoqëri që e di që do të vazhdojë dhe pas kësaj eksperience, pavarësisht se ku do të na gjejë jeta. Je nga të paktët njerëz që mund të them me siguri se i besoj plotësisht dhe nga shokët më të dashur, me argëtues dhe me një energji aq unike, që e përcjell te të gjithë ata që ke afër. Jam shumë mirënjohës që njoha një djalë, me të cilin mund të flas për çdo gjë dhe që e ka bërë gjimnazin kaq më të veçantë. E di se nuk e shpreh aq sa duhet sa të vlerësoj në përditshmëri dhe ky dedikim është shumë i shkurtër, por dije se shumë pak gjëra më ngrenë humorin aq sa kur të shoh të qeshur dhe uroj mos ta humbësh kurrë atë buzëqeshje. Shpresoj që të të shkojë sa më mbarë viti i ardhshëm dhe që të të plotësohet çdo dëshirë dhe ëndërr.

Jon Memushi-Edhe pse të kam njohur që në vit të parë, miqësia që formova me ty në vit të tretë është një nga më domethënëset që kam patur ndonjëherë. Kuptuam që jemi pothuajse të njëjtë si personalitete, ndaj për çdo situatë ose vështirësi ku është gjendur njeri nga ne, ndërkohë që jemi aty për njëri-tjetrin, gjithashtu nxjerrim dhe një mësim për veten. Një nga djemtë më inteligjentë dhe personi që kam më shumë qejf t'i ngacmoj nervat. Mezi pres të vazhdoj rrugëtimin tim në universitet me ty mundësisht shok dhome ose të paktën klase. Suksese vëlla, e di që do çash përpara në jetë në çfarëdolloj rruge që do marrësh.

Geldi Pepa-Foka ime ti. Ke qenë një mik i madh në kuptimin e parë të fjalës. Ja kemi kaluar shumë bukur bashkë, sidomos kur luanim lol edhe t'i kaloje paranoja nga unë. Të uroj suksese në jetë!



Denis Alliaj

Denis shoku im më i mirë , i cili më gjallëron çdo ditë me shakatë e tij.S'do te harroj kurrë mënyrën si këndonim ne klasë apo kur pinim çaj si londinez. Je një orator i goditur i cili mund te kthesh në favorin tënd çdo situatë , gjë e cila do të të ndihmoje shumë në profesionin tënd . Shpresoj që shoqëria jonë të mbetet po e njëjta edhe pse do te jemi larg . Te uroj shumë suksese syblujti! -Klejsa Neza

Në klasë të 9-të nuk rrinim shumë bashkë, po tan nga fundi i gjimnazit jemi bërë shokë tamam. Kemi kaluar shumë kohë bashkë, bëjmë rrugën për në shtëpi çdo ditë, dhe siç e thua ti, kemi ngrënë në një tas tërë ato herë. Je djalë shumë pozitiv dhe gati për të të ndihmuar gjithmonë. Mund të ndajmë çdo shqetësim me njëri-tjetrin ,sepse sa gallata mund të bëjmë, aq serioz sillemi kur duhet. Shumë suksese a m'kupton!- Noel Sulejmani

Denis, djali më i çiltër që njoh. Jemi bërë shokë të ngushtë këtë vit gjimnazi, por ka qenë mjaftueshëm për të kuptuar çfarë njeriu je. Je një djalë me morale të forta, besnik, i zgjuar dhe qesharak. Ti je dikush mbi të cilin mund të varesh sepse je gjithmonë aty për të të ndihmuar dhe e vlerëson shumë miqësinë. Ke të gjitha cilësitë për të qenë një mik i vërtetë. Shpresoj që miqësia jonë të zgjasë edhe më shumë dhe të uroj suksese në jetë!- Ersi Uruci

Uore nëna ca ben!?!? Në klasën e vitit të dytë të njoha dhe më je dukur shumë gallatë, por përsëri nuk te njihja mirë, me sakt nuk e dija mirë nga ishe ,po kur mora vesh qe ishe nga Vlora e dija që do bëheshim shok. Ne jemi aq të ngjashëm,po ashtu dhe të ndryshëm nga njeri-tjetri gjë që ka ndikuar pozitivisht në shoqërinë tonë. Ti je një nga njerëzit më të zgjuar


dhe më të fortë që kam njohur gjithashtu shumë besnik. Më ke ndihmuar në shumë situata të ndryshme gjithashtu je bere një shok te cilin nuk do ta ndërroja për asgjë në botë. Avash -avash do largohemi,por e di që shoqëria jonë nuk përçahet dot nga distanca. Ne jse o vlla po e mbyll me k'to gjërat sentimentale ,se ne se kemi për zakon kështu. Te uroj shumë suksese në jet'vlla!- Kledino Sala

Normal që vlonjati do rri me vlonjatin dhe s'ka si të jetë ndryshe. Gjithmonë je i gatshëm dhe i sinqertë dhe mbi të gjitha, shpreh atë që mendon duke i shtuar vlerat vetes tënde si shok, por mbi të gjitha edhe si individ. Gjithashtu puna jote e palodhur në servisim më të fortë ka qenë gjithmonë një frymëzim për mua. Bashkë kemi disa kujtime shumë të bukura, që unë do ti vlersoj gjithmonë. Faleminderit për gjithçka që ke bërë për mua!-Bergi Avdulaj

Do të të konsideroja pa dyshim si humoristin e klasës. E zbukuron orën e mësimit duke bërë lajka, ose duke thënë shprehje të goditura lidhur me çdo situatë. Jam munduar të të njoh përtej asaj ç'ka shfaq, dhe mund të them me lehtësi se krenohem për arritjet e tua akademike dhe zgjuarsinë që të ndjek kudo. Te kam xhan dhe të uroj suksese të mëtejshme!- Fiona Gjoca

Ti je një djalë shumë i mirë dhe unë jam e bindur se do të vazhdosh të shkëlqesh në të gjitha shkallët e jetës. Ke per te qenë avokati më i mirë që kanë nxjerrë universitetet e Londres. Te uroj 44 suksese të mëdha në të ardhmen!- Greta Xhemo

Një ndër çunat e zgjuar, por edhe moskokëçarës të klasës sonë. I dedikuar pas mësimeve por le ta pranojmë, më shumë pas shakave. Gjithashtu si nuk e pranove njëherë ,që unë them mirëmëngjes çdo ditë.... Nejsee, të uroj shumë suksese kudo!- Adela Shahini



Ersi Uruci

Noel Sulejmani: Që në klasë të 6-të kemi qenë shumë shokë, sepse ishim të dy të rinj në shkollë. Që atëherë kemi ndarë shumë momente së bashku, edhe pse ndonjëherë e kemi pasur të vështirë të gjejmë situata të përbashkta. Je një djalë i qetë dhe racional. Gjithmonë do të jem gati të të jap këshilla e të të ndihmoj kur duhet. Gjithë vitin e tretë e kemi kaluar bashkë në bankë dhe prap se prap nuk na kanë mbaruar muhabetet. Shumë suksese Ers Shkodrani!

Shefrin Shtylla: O Erso (me zërin e Noelit), o çuni më pozitiv dhe më i qeshuri i gjithë klasës. Do mbajë gjithmonë mend që sa herë hyja në klasë mjaftonte të të shikoja ty aty në fund, që në pamje të parë, me atë buzëqeshje, nuk dukesh sikur je në shkollë, por duke parë Vllaznin! Shpresoj të të shikoj gjithmonë kështu! Të uroj suksese!

Bergi Avdulaj: Kemi shumë kohë që njihemi dhe e di, që je një person serioz ndaj qëllimeve të tua me një vendosmëri të madhe e cila frymëzon edhe ata rreth teje. Gjithmonë ke ndonjë gjë të re për të na thënë duke i bërë gjërat interesante. Logjika jote na ka ndihmuar në shumë situata të ndryshme se dihet që je një njeri i përgjegjshëm për veten. Faleminderit për gjithçka që ke bërë për mua!

Fiona Gjoça: Këtë vit kuptova se sa me fat do isha po të ishim njohur që në vit të parë. E vlerësoj shumë mprehtësinë tënde, dhe aftësinë që ke për të qëndruar i qetë pavarësisht eksperiencave negative. Meriton gjithë të mirat, dhe s'po e them këtë vetëm pasi jemi shokë. Të kam shumë xhan dhe të uroj shumë suksese në të ardhmen! ps: do vazhdoj t'i ruaj zambaket e ujit :)

Kledino Sala: Erso që nga viti i dytë ke qenë një djalë shumë i mirë, i qetë dhe shumë i matur. Je një nga shokët e mi më të mirë dhe këtë shoqëri nuk mundet ta thyejë asgjë. Kemi kaluar 2 nga vitet më të bukura të jetës sonë dhe gjithmonë ke qenë një shok i pandashëm. Në vit të dytë nuk të njihja aq mirë, por këtë vit pata shancin të shihja Ersin e vërtetë i cili është një djalë i fortë dhe shumë i zgjuar. Të falenderoj që ke qenë pjesë e jetës sime dhe një shok kaq i vyer. Nuk do të të harroj kurrë dhe gjithmonë do mbetesh një nga shokët e mi më të mirë. Të uroj sa më shumë suksese dhe mbarësi në rrugën e jetës!

Endi Rexhepi: Erso, u bënë shumë vite që njihemi, që në klasë të 6-të. Deri në vit të parë nuk të kam njohur aq mire, por sa filloi gjimnazi u afruam më shumë, sidomos kur kaluam fundin e vitit të parë dhe gjithë vitin e dytë bashkë në bankë. Sa kujtime kemi te ajo bankë, kujtime që s'do harrohen kurrë. Edhe pse në vit të 3-të nuk ishe te klasa jonë, ti përsëri ishe pjesë e kësaj klase dhe vendin e kishe te ne. Erso, shumë faleminderit për çdo gjë, dhe faleminderit që ma bërë vitin e dytë shumë të lehtë. Të uroj më të mirat!

Daniel Lavdari: Në mesin e shumë personave që kam njohur, ti je një nga më të zgjuarit dhe më të arrirët. Me mendjen tënde të mprehtë dhe energjinë e pashtershme, ke arritur t'i plotësosh synimet e tua. Ti je motori që lëviz përpara, me pasionin tënd të pandalshëm për dije dhe përkushtimin e palëkundur. Me ty, çdo sfidë kthehet në mundësi dhe çdo orë mësimi kthehet në kujtim. Të uroj gjithë të mirat dhe një rrugëtim të mbushur me suksese dhe arritje të mëdha.

Arnis Llazari: Ore Ersi. Mbaj mend kur jemi njohur në klasë të gjashtë dhe më the që ishe shume i habitur që unë isha i zgjuar, sepse dukesh si një person komplet ndryshe. Që atëherë ke qenë më i zgjuari i klasës dhe ke vazhduar këtë traditë deri më sot. Edhe në universitet më i zgjuari do jesh, mos ki merak. Kurrë s'do ta harroj karanatinën dhe se si që nga ora 8-të e mëngjesit deri vonë në darkë luanim Ëarzone. Po te helikopteri, "O Erso! M'harrove muuu!!!" O sa kemi qeshur. Atë Ëarzonin do ta mbajmë mend gjithmonë. Një tjetër gjë që na bashkon është "Visca Barca". Dy fansa të fuqishëm edhe pse kemi vuajtur shumë këto vite. Vitet kaluan dhe ti ke mbetur po i njëjti shok i mirë që ke qenë gjithmonë, e shpresoj që kështu do jesh përherë. Të uroj shumë suksese Erso në çfarëdolloj gjëje që do bësh!



Orkida Jahja

Orkidën e kisha dalluar që në fillim të vitit të parë si një vajzë inteligjente dhe të matur, edhe pse nuk u shoqërova shumë me të derisa u bëmë bashkë në klasë në vit të tretë. Është një nga vajzat më korrekte dhe më të sjellshme, me të cilën ke qejf të bësh një bisedë “me nivel”. I uroj fat për çfarëdolloj rruge të ndjekë në universitet, edhe pse e di që nuk do t’I nevojitet shumë, pasi është me të vërtetë një vajzë “e zonja e vetes”. – Jon Memushi

Orkida, je shumë e maturuar dhe punëtore, kur bëhet fjalë për bashkëpunim midis pjesëtarëve të grupit. Je e arsyeshme dhe e hapur për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme. Me përkushtimin që shfaq në çdo moment, nuk e dyshoj që do arrish sukses. Të uroj një jetë me plot të mira dhe gëzime. - Buen Hoxha

Vajza që njoh më së miri në tërë shkollën. Më duket ende si dje, kur u takuam për herë të parë në klasë të gjashtë. Gjatë këtyre viteve të gjata kemi kaluar llojlloj situatash e sfidash së bashku. Jam e sigurtë që do kesh një të ardhme të ndritur dhe të suksesshme. - Esiana Këlliçi

“E zgjuar dhe tepër e matur” janë 2 fjalët që të gjithë zgjedhin të të pershkruajnë. Për mua që të njoh më mirë, do të thoja se këto 2 epitete nuk e tregojnë plotësisht identitetin tënd të veçantë. Je një vajzë shumë besnike, e dashur dhe gjithmonë e gatshme për të ndihmuar. Nëpermjet bisedave dhe shakave në pushimet 30-minutëshe, kam njohur një aspekt tjetër tëndin: Orkidën si një vajzë shakaxheshë, e cila ka një të qeshur shumë të bukur. Shpresoj që shoqëria jonë të vazhdojë më tutje dhe që të takohemi sa më shpesh, kudo që ta na çojë jeta. Suksese te metejshme Kida! - Fiona Gjoca

Një vajzë shumë e zgjuar e cila punon shumë për të arritur objektivat e saj. Nuk të kam parë kurrë të dorëzohesh dhe uroj të jesh kështu gjithmonë- Kledino Sala

Shumë e shkathët në marrdhëniet me zyshat, por edhe një person që përcjell pozitivitet në klasë, shpresoj të jesh gjithmonë e qeshur. Kënaqësi që kaluam vitin e tretë së bashku! - Bergi Avdulaj

Orkid, ty do të të kujtoj si një nga gocat më të artikuluara dhe gjithashtu të zgjuara të shkollës sonë, por para së gjithash për mungesat e pafundme. Jam e lumtur që të kam njohur dhe që ke qenë pjesë e klasës. Të uroj shumë suksese në hapat drejt profesionit tënd. - Adela Shahini

Kreativiteti i pakufishëm dhe shpirti inovativ i saj sjellin një energji unike në klasën tonë. Aftësia e saj për të parë botën nga një perspektivë tejet e veçantë ndez frymëzim tek të gjithë ata që e rrethojnë. Mendoj se në të ardhmen idetë e tua prej një shkencëtari të pa diplomuar akoma do të marrin jetë dhe shumë kompani do të duan t’i suportojnë ato. Të uroj gjithë të mirat teksa ndjek pasionet e tua dhe krijon një emër për veten tënde. Të uroj shumë suksese! - Andrea Cela
Ka gjithmonë dicka për të ‘marrë’ nga ty. Si fakti që të shoh gjithmonë të buzëqeshur, dhe se je një njeri që të përcjell ndjesi pozitive. - Shefrin Shtylla

Orkida, shoqja ime sa e dashur aq edhe e ftohtë . Partnerja ime e shkëlqyeshme në çdo konkurs që e bën shumë të vështirë të mos dukesh mirë, kur je në një skuadër me të pasi ka talent pothuajse në çdo gjë (mos të të rritet mendja). Kujtimet tona janë të bëra nga çdo gjë që nga fitorja e deri te sarkazma e përhershme që kemi me njëri-tjetrin. Shpresoj ta kesh kuptuar më tani se sa shumë të vlerësoj. Uroj që në rrugën tënde të jesh sa me e suksesshëm dhe të vazhdosh të kalosh sa më shumë momente të mrekullueshme. - Enio Kazazi
Kida ish-shoqja e bankës sime. Nuk do ta harroj kurrë pallton tënde legjendare dhe mungesat e pafundme. Je një vajzë tepër e artikuluar dhe e zgjuar e cila di të zgjidhë edhe situatat më të vështira. Të uroj shumë suksese! - Klejsa Neza

Je një vajzë e cila gjithmonë je dalluar nga pjesa tjetër me zgjuarsinë, përgatitjen dhe oratorinë tënde. Përveç këtyre, ti je një vajzë e sjellshme e cila të ndihmon gjithmonë. Këto cilësi të tuat do të të ndihmojnë ty të ecësh para në jetë. Të uroj suksese në jetë! - Ersi Uruçi



Mesila Hoxha

shokëve e shoqeve që kanë nevojë. Je një vajzë e zgjuar dhe të uroj më të mirën ne jetë!

Ersi Uruçi-Kemi kaluar shumë vite së bashku në klasë dhe gjithashtu shumë kujtime e momente për t'u mbajtur mend. Përkushtimi yt ka qenë një cilësi dalluese dhe do të të ndihmojë edhe në të ardhmen. Të uroj suksese në jetë!

Buen Hoxha-Mesila, thjesht dua të them sa shumë vlerësoj sinjeritetin dhe tënd. Është rrallë të gesh dikë kaq të hapur dhe të qartë. Shpresoj që të arrish synimet që ke jo vetëm në universitet, por edhe në vazhdim. Të uroj një jetë me plot sukses dhe gëzim.

Adela Shahini-Një vajzë e vendosur, e guximshme por edhe e qeshur. Ndonëse nuk kemi kaluar shumë kohë bashkë, ka qenë gjithmonë kënaqësi të jem në një klasë me ty. Të uroj shumë suksese Mesil dhe shpresoj të mbetemi në kontakt.

Jon Memushi-Siç është një nga vajzat më të urta të klasës, është gjithashtu një vajzë mjaft e shoqërueshme. Nuk e njihja përpara vitit të tretë, gjithsesi shoqëria e saj në klasën time të maturës s'do jetë gjë veçse një kujtim i këndshëm. Të uroj suksese dhe të jesh gjithnjë e lumtur.

Esiana Këlliçi- Mesila, një ndër shoqet e para që pata në klasë. Kohët që kalonim bashkë në bankë kanë lënë kujtime, që nuk do të harrohen lehtë. I kaluam provimet, ndamë frikërat tona ,kur vinte ora e ekonomisë, dhe kaluam kohën tonë në furgon duke diskutuar për lloj-lloj gjërash. Ndihem me fat që pata këtë miqësi me ty dhe të uroj sa më shumë suksese!

Fiona Gjoca-Mesil, githmonë në sytë e mi ke qenë një vajzë pozitive, e cila vendos syninet e saj mbi çdo gjë. Gjithmonë mundohesh të gjendesh pranë



Jon Memushi

Rei Escobar Durmishaj- Epo jam shumë i sigurt që sado të përpiqem ta zgjas dedikimin, nuk do të jetë mjaftueshëm as për të filluar të jap idenë se sa i lumtur jam që shkuam në të njëjtin kurs basketbolli. Je shoku më i mirë që kam dhe nuk mund ta mendoj fare gjimnazin dhe në përgjithësi, jetën time në këto vitet e fundit, pa qenë ti pjesë e saj. Bashkë, në gjimnaz, jemi njohur, jemi bërë të pandashëm dhe kemi bërë gallata, lojëra, muzikë, muhabete, projekte asefi me biçikletë pa marrë biçikletën, shëtitje dhe lojëra pafund në oborr e nuk kemi humbur kurrë një lojë futbollit. Të faleminderit që çdo ditë ma zbukurove me energjinë, idetë dhe me humorin, që e kemi paketë dhe vetëm ne e kuptojmë 100%. Jam më se i bindur se kjo miqësi do të vazhdojë për shumë kohë pas gjimnazit. Të uroj me gjithë zemër të jesh gjithmonë i lumtur e i qetë, me sa më shumë momente të bukura vro.

Albion Qojle- Jon, jam shumë i lumtur që kam patur mundësinë të takoj dikë si ty. Kam kuptuar se je një nga shokët më të mirë që do gjej ndonjëherë. Je një djalë i mrekullueshëm që padyshim na ke mbushur me kujtime të cilat nuk do i harrojmë kurrë. Falë teje ne tani jemi një grup shoqëror shumë i madh, një grup që pa ty dhe kujtimet e krijuara na besoj gjimnazi nuk do kishte kuptim. Na ke dhuruar pafund të qeshura. E di që do jesh shumë i suksesshëm dhe për të ndërtuar shtëpi do vij te ti, inxhinieri matematicionak ultra shkencor më i miri ndonjëherë. E ke zbukuruar gjimnazin me faktor 1000, ke qenë katalizator për eksperiencën të bukura.

Enio Kazazi- Joni, epo miku im këtu do e kem të vështirë t'i them të gjitha pasi e kam numrin e fjalëve të kufizuara. Kemi qenë shokë që në vit të parë edhe pse jo kaq të afërt të kam vlerësuar gjithmonë. Ke qenë

dhe mbetesh nga ata njerëz që bie në sy nga të tjerët. Kujtimet tona, sado që vetëm për një vit, kanë qenë të panumërta sa që do të lodheshim të dy t'i kujtonim. Duke filluar që nga vrapit për tek stacioni i tramvajit në Vjenë deri tek bisedat poshtë pallatit tënd, të falënderoj që më lejove të isha pjesë e shoqërisë tënde dhe po ashtu të falënderoj për kthimin e një nga viteve më pak të këndshme të jetës sime në një të paharrueshëm. Do të të thoja suksese, por kështu si kanë vajtur punët, s'do të kem nevojë pasi do ta shoh vetë progresin tënd në Gjermani.

Debora Qendra- Në tri vitet e mia në gjimnaz nuk kam njohur një person më të ngrohtë e më të ëmbël se ti. Nuk mund të isha më mirënjohëse ndaj teje për gjithë mbështetjen që më ke dhënë. Ndihem shumë me fat që pata mundësinë të të njoh këtë vit, edhe pse do të preferoja të të njihja akoma më herët. Koha që kemi kaluar së bashku, edhe pse e shkurtër, ka qenë shumë e vyer për mua. Shpresoj shumë që të të plotësohet çdo dëshirë që ke dhe të uroj shumë suksese kudo!

Vivien Kushi- Jon, je personi që më ka parë se sa shumë kam ndryshuar, që nga klasa e parë, si të ishe vëllai imi. Je shoku i bankës më i mirë që kam patur ndonjëherë. Janë të panumërta shakatë që kemi thënë me njëri-tjetrin në bankën e fundit në cep të klasës. Një person i zgjuar, i matur dhe një shok për kokë. E konsideroj veten me fat që kam përjetuar një miqësi kaq të ngushtë me ty. Do t'i ruaj me përzemërsi të tëra përjetimet që kemi kaluar. Më duket sikur jemi akoma po të njëjtët fëmijë lozonjarë që ishim në fillore, e sheh se si fluturoi koha përnjëherë? P.S.: Je kitaristi më i mirë... duhet të gjejmë një baterist për atë bandën tonë.

Fiona Gjoça- Jon, edhe pse të njoh prej pak kohësh, në sytë e mi ke qenë gjithmonë një djalë pozitiv, i gatshëm për të ndihmuar dhe tepër i zgjuar. Më ka pëlqyer fakti që gjithnjë mundohesh ta shohesh çdo gjë nga një perspektivë tjetër, e cila është më praktike sesa rruga tradicionale. Të falënderoj shumë për shakatë që kemi bërë gjatë kësaj kohe, për të cilat po më vjen për të qeshur dhe tani që jam duke i menduar. Shumë suksese në të ardhmen drejtor!

Geldi Pepa:-të kam njohur këtë vit ,por ke qenë një djalë vërtetë "danoc". Suksese në jetë!



Adela Shahini

Shefrin Shtylla - Që ta përfytyroni Adelën nëse nuk e njihni, është një vajzë e vogël në dukje, por jo aq e vogël kur të kthen fjalën. Mund të them që gjithçka ndodh për një arsye. Pavarësisht nëse është vendosur nga Zoti ose ndonjë lloj fati tjetër, nuk e di. Nuk më intereson. Por jam mirënjohëse për këtë, për çfarëdo qoftë ajo. Mirënjohëse që më bëri pjesë të jetës së saj. Mirënjohëse që më dha një shoqe glutenoze, që ma lë mua të gjithë çokollatën. Mirënjohëse për çdo shaka që qeshim vetëm ne. Në të vërtetë shoqëria është të bësh muhabet, muhabet, muhabet... Por sado të flasë me ty do të më duket pak. Sa herë ta them "E lejmi këtë orë" do të më duket pak. Me shpresën që kjo që po shkruaj do të gjejë një vend të veçantë në zemrën tënde, po e mbyll tani se boll. T'kam xhan!

Sakistjo Meraj - Llastic, nuk e kisha menduar ndonjëherë që do të vijë momenti të shkruaj për ty dhe për shoqërinë tonë, por ja që ndonjëherë duhet të bëjmë gjëra që ndoshta nuk jemi të gatshëm për t'i bërë. Në momentin që të takova për herë të parë, intuuta më tha që unë dhe ti nuk do të kishim kurrë as afrimitetin më të vogël dhe për më tepër një shoqëri aq të bukur sa kjo që kemi tani (për të cilël falenderoj zotin çdo ditë). Me kalimin e kohës kuptova që intuuta ime më gënjeu dhe që je goca më e dashur që unë kam takuar dhe do të takoj në gjithë jetën time. Nuk arrij ta kuptoj se si karakteri im i fortë mund të bëhet kaq i butë për të dashur që të të shoh edhe më lart se vetja ime, por të jesh e sigurt që nëse ka një goc që e meriton këtë qëndrim, je ti dhe vetem ti. Shpresoj shumë që largimi im nga Shqipëria (akoma çështje e diskutueshme) mos të ndikojë në afrimitetin tonë, dhe që unë me të vërtetë të mos kem nga të shkoj, sic thua ti... Të uroj me të mirat e botës Liliput!

Fiona Gjoca - Më kujtohet si sot dita kur erdhe në klasën 5F, dhe menjëherë me ranë në sy floket me onde dhe atletet e bukura që kishe veshur. Po mendoja për lloj lloj mënyrash se si mund të të flisja, derisa mendimet e mia u ndërprejnë nga e folura jote. Më bëhet shumë qejfi që fati donte që ne të njiheshim, pasi kjo shoqëri na ka ndihmuar të dyja të rritemi dhe të njohim më mirë vetveten. Kjo shoqëri më së miri ka shpalosur se sa e zgjuar, e ndjeshme dhe sa humor të këndshëm ke (gjëja që na ka lidhur gjithmonë më shumë). Je shoqja e parë që më ka mësuar si të dhuroj ngrohtësi e dashuri pa kusht, ndaj për këtë gjë të falenderoj. Të kam shumë xhan dhe të uroj gjithë të mirat ciu!

Bergi Avdulaj - Këtë vit u njohëm, por ia kemi kaluar shumë mirë. Një nga kujtimet më të bukura, që do të ngelet për mua këtë vit të fundit është muzika, që dëgjonim gjatë orëve të pushimit. Shpresoj që të ngelesh gjithmonë pozitive si je dhe mos të ndryshosh për asgjë. Kënaqësi që kaluam vitin e tretë së bashku!

Greta Xhemo - Adela je një vajzë shumë e qetë dhe me zemër të mirë. Bashkë kemi kaluar momente shumë të bukura si dita që shkuam te Panto bashkë me Shefrinën. Je shumë e çiltër dhe ambicioze e kështu të lumtur dua të të shikoj gjithmonë. Ne jemi njohur që të vogla fare bashkë dhe me vjen mirë që ramë sërish në një klasë bashkë. Të kam shumë xhan. Të uroj gjithë të mirat dhe suksese në karrierën tënde.

Klesta Demaj - Adela, pak kemi që jemi njohur, por duket si shumë vite. Që në momentin e parë e dija që do shkonim shumë mirë, dhe padyshim ashtu ndodhi. Kemi krijuar një shoqëri që do vazhdojë për shumë kohë. Je një goc shumë e veçantë dhe për këtë të vlerësoj. Të uroj vetëm sukses dhe lumturi dhe shpresoj të arrish çdo gjë që ti dëshiron. Të përqafoj shumë, Klesta.

Noel Sulejmani - Jemi njohur në vit të parë bashkë dhe je një vajzë e qetë dhe me karakter. Acarohesh pak shpejt, po nuk ka problem. Diçka që kam vënë re është se uljet dhe ngritjet në mësimet e kemi njëlloj. Të uroj shumë suksese!

Ersi Uruci - Adela, je një shoqe shumë e mirë dhe shoqëria mes nesh vërtet ia ka vlejtur. Kemi kaluar shumë gjëra dhe kemi krijuar shumë kujtime së bashku këtë vit shkollor dhe për këtë të falenderoj. Nuk do të kishte qenë njësoj nëse nuk do të ishte për çiltërsinë tënde dhe pozitivitetin që sjell në çdo situatë. Të uroj suksese në jetë!



Noel Sulejmani

Jona Ramaj: Person i përgjegjshëm i cili ka një ndikim pozitiv në klasë.

Fiona Gjoca: Noel, je një djalë shumë i shoqërueshëm, me të cilin mund të besh biseda shumë të këndshme dhe me vlerë. Si një djalë shumë i zgjuar dhe me ambicie të mëdha, dallohesh për sinqeritetin dhe humorin e lezetshëm. E vlerësoj shumë shoqërinë që kam me ty dhe shpresoj të ruajmë kontakte dhe në të ardhmen! Te uroj shumë suksese.

Bergi Avdulaj: Se di çfarë mund të shkruaj më përpara ,pasi jemi gjithmonë bashkë dhe dimë çdo gjë për njëri- tjetrin. Të jesh shok prej 7 vitesh do të thotë se jemi rritur së bashku duke qenë prezent në çdo moment të këtyre viteve. Nuk do ta bëj dedikimin aq të gjatë sa në klasë të 9-të, për shkak se e di që kujtimet tona flasin më shumë se çdo fjali, që unë mund të shkruaj për ty. Shpresoj ta dish çfarë vlere ka shoqëria jonë për mua, ku në një vend në të cilin u nisa për të mësuar, gjeta vëllezër si ty dhe cunat, me të cilët e di se pata mundësinë të merrja maksimumin nga kjo eksperiencë që vjen njëherë në jetë si gjimnazi. Faleminderit për gjithçka që ke bërë për mua!

Kejsi Kotica: Noel ti je një nga njerëzit më të mirë që kam takuar në gjimnaz. Ti je gjithçka që mund të duash në një person: i sjellshëm, i respektueshëm, i dashur etj. Jam shumë falenderuese për çdo gjë që kemi kaluar bashkë dhe s'do i harroj kurrë. Të uroj shumë suksese në jetë dhe të kam shumë xhan.

Arbi Ciftja: Bashkë u njohëm për herë të parë në klasën e tetë. Atë kohë nuk ma priste mendja se do të arrinim të bëheshim kaq shokë të mirë dhe të afërt me njëri-tjetrin, pasi mund të thëm që jemi dy tipa të

ndryshëm. Gjithësesi këto ndryshime nuk na ndaluan që të krijojmë një miqësi kaq të fortë dhe mjaft besnike. Bashkë me Denisin, e quajmë veten me fat dhe çfarë kemi kaluar në klasë të tre, nuk do i harrojmë. Të uroj më të mirat dhe shpresoj edhe pse kam besim tek ty që t'ia dalësh sa më mirë në jetë dhe në vazhdim.

Ersi Uruci: Kur e mendon, sa larg kemi ardhur së bashku. Mbaj mend shumë gjëra gjatë gjimnazit dhe jo rastësisht, ti ke qenë aty për shumicën e tyre. Këtë vit pata mundësinë edhe të ishim shokë banke dhe gjithë diskutimet, këshillat e shakatë që kemi bërë aty vetëm i shtohen koleksionit të kujtimeve. Sa herë kam pasur nevojë për diçka më ke qëndruar pranë dhe më ke ndihmuar. Dashje pa dashje kam mësuar dhe marrë shumë prej cilësive të tua që më kanë bërë mua një njeri edhe më të mirë. Unë e di që miqësia jonë do të vazhdojë edhe më tej dhe ka akoma shumë histori për të shkruar, prandaj po e mbyll me kaq se edhe nëse kam lënë diçka pa përmendur, ti e di tashmë. Të uroj suksese në jetë!

Denis Alliaj: Noel je fytyra e par' që kam par' mëngjes për mëngjes në fugon. Gallatat dhe muhabetet tona do të jenë të paharrueshme. E di që shoqëria jonë nuk do humbet nga distanca dhe shpresoj që të arrish të gjitha qellimet e tua lalex.



Bergi Avdulaj

Ersi Uruci: Bergi, miqësia jonë vjen e rritet akoma edhe më shumë. Do thoja që besnikëria është cilësia jote më e mirë, por kjo nuk do ishte e drejtë për të gjithë të tjerat. Ka shumë momente që unë kam menduar me vete sa me fat jam që kam patur dikë si ti pranë meje gjatë gjithë kohës që kam qenë në këtë shkollë dhe mendoj se sa me fat jam që do të të kem edhe më pas. Vepron gjithmonë në mënyrën më të mirë dhe merr parasysh mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve para se të bësh. Ndonjëherë je më modest dhe i mirë se duhet. Tëra këto të bëjnë ty atë që je dhe pa dyshim, nëse vazhdon kështu, do arrish gjithçka.

Noel Sulejmani: Të pandashëm që nga klasa e 6-të. Kemi kaluar shumë grupe shoqërore, por gjithmonë kemi qëndruar njësoj me njëri-tjetrin. Janë shumë momente për t'u përmendur në dedikim, ndaj nuk po përmend specifike. Je një djalë që nuk të intereson për mendimin e të tjerëve dhe vlerëson çdo moment. Tregohesh shumë i kujdesshëm dhe kupton që çdo veprim shoqërohet me pasoja. Kemi kaluar shumë bashkë, dhe e di që nuk do bëhemi pishman për asgjë. Gjimnazi mbaroi, por shpresoj që kur ta lexojmë këtë paragraf, të jemi në të njëjtin universitet.

Andrea Cela - Gjys vlonjat, gjys pogradecar, unë do thoja cilësitë e tua nuk kanë fort lidhje me origjinën, sepse ti je unik. Me të vërtetë një djalë që bën shumë për shokun dhe është i gatshëm ta prish rehatinë e tij gjithmonë nëse është nevoja. Kemi kaluar aq shumë momente të bukura së bashku sa që zor se harrohen, prandaj shpresoj se të tjera do të vijnë në të ardhmen. Përveç fizikut ke dhe një temperament që dikush tjetër do e kishte zili. Kemi kaluar 3- vite bashkë që duken vetëm si 3 -ditë. Plot zënka e hatërmbetje, por gjithashtu edhe shumë kujtime të

çmendura të cilave ti u shtove lezetin. Me zor pres të vij përsëri dita, kur do të mblidhena përsëri për Sazan me "naçut", sepse për ato aventura ja vlen të jetosh. Të uroj suksese në Itali, shpresoj të të vizitojnë fansat nga Italia, kur ta zbulojnë që do jesh pjesë e tyre për ca kohë në Bocconi!

Denis Alliaj: Bergi lalit je një nga çunat me te vecantë që kam takuar ndonjëherë. Gjithmonë zemërmirë dhe pozitiv si dhe punëtorë dhe i zellshëm. Gjithmonë me humorin tënd te vecantë dhe mendimet e njëjta kemi kaluar këto kohë gjimnazi. Nuk e di se si do jetë universiteti pa ty dhe pa çunat e tjerë, por shpresoj që mos të harrohem i kurrë. Suksese!

Shefrin Shtylla: Me të vërtetë je një djalë i maturuar (dhe shumë gjumash). Një na çunat më të sjellshëm për të cilin kam shumë respekt. Faleminderit për gjithë kohën dhe mbështetjen tënde. Suksese!

Adela Shahini: Berg në kaq pak kohë që njihemi bashkë mund të them që je një nga çunat më të sjellshëm për të cilin kam shumë respekt. Do të më kujtosh gjithmone atë çunin e zgjuar, por edhe shumë social. Kemi krijuar kujtime shume te bukura këtë vit te cilat nuk do t'i harroj. Suksese!

Klejsa Neza- Nje nga kujtimet me te hershme qe kemi se bashku esht ne klase te 9 kur me mesoje si te lozja volleyball, une kurr nuk mesova sic duhet por te falenderoj per durimin. Je nje djale teper i vecant dhe besnik. Edhe pse dukesh sikur je ne gjume ne klase ti prap arrin te marresh notat me te larta. Gjithmone ke dicka te mire per te thene dhe kalon me pozitivitet edhe situatat me te veshtira.

Ted Hajderi- Bergo një nga shokët më të mirë që njoha në klasë të 6 –të dhe deri tani kemi kaluar momente shumë të bukura dhe jam shumë i lumtur që ishe pjesë në jetën time dhe inshalla je dhe më vonë. Do të të mbaj mend për shumë kohë, pasi që nga klasa 6-të e deri tani kemi kaluar gjysmën e ditës bashkë. Fillojmë që kur u vendosëm në klasë bashkë, shëpitem afër njëri -tjetrit, të dalurat por dhe më e bukurat kur u bërë pjesë e ekipit tim të basketbollit. Të falenderoj shumë që më ke mbrojtur në çdo vend dhe ke ndenjurr pranë meje. Te uroj shumë suksese ne Itali dhe të puc.



Andrea Çela

ERSI - Jemi afruar me njëri-tjetrin më shumë në gjimnaz dhe kam kuptuar se ti i ke të gjitha cilësitë që mund të kesh. Ke një kombinim të zgjuarsisë, humorit dhe karakterit që të ka bërë ty një person të cilit mund t'i afroresh shumë thjeshtë dhe mund të bësh një muhabet për çdo gjë të mundshme. E di se në të ardhmen i ke aftësitë për të ecur përpara dhe një ditë kur te takohemi, do flasim për kujtimet që kemi kaluar. Të uroj suksese në jetë!

BUEN - Andrea, dua të të them sa shumë i kam vlerësuar rastet kur kemi luajtur futboll në orët e fizkultures. Je vërtet i shkathët dhe atletik, dhe ka qenë kënaqësi të luanim hera-herazi në të njëjtën skuadër. Faleminderit që bërë ato momente kaq të këndshme. Shpresoj që të arrish synimet që ke, jo vetëm në universitet, por edhe në vazhdim. Të uroj një jetë me plot sukses dhe gëzim.

NOEL - Në fillim jemi miqësuar te tagani para 5 vitesh dhe kemi mbetur shokë që atëherë. Tani në gjimnaz jemi afruar më shumë nga shpërndarja e klasës. Kemi kaluar kohë bashkë, e madje dhe kemi udhëtuar. Këtë verë prap për Vlorë besoj, se vjet nuk e shfrytëzuam të gjithë bashkë. Shumë suksese Ndrex!

KLEDINO - Andrea Cela- Ndrrex ti ke qene shoku i parë që kisha tek kjo shkollë. Më ke pritur me ngrohtësi dhe gjithmonë më je gjendur pranë. Gjatë këtyre dy viteve që kemi qenë bashkë kam vene re te ty zgjuarsinë dhe besnikerinë. Ke një besnikeri të pathyeshme dhe je një shok që vleresoj shumë. Kemi kaluar shumë bashkë dhe çdo eksperiencë është e paharrueshme. Do mbetesh gjithmonë nje nga shokët e mi më të mirë dhe të uroj suksese në jetë!

BERGI-çdo' nickname' që ke patur gjatë gjimnazit ka ardhur prej meje kështu që gjithmonë do të mbaj mend me emra të ndryshëm. Për tre vite jemi bërë shokë të ngushtë duke bërë gallata pa fund. Ndonjëherë edhe mund të kemi pasur mosmarrëveshje, por në fund përfundojmë sërish në të njëjtën bankë. Vera e 2024 do të jetë gjithmonë e paharrueshme, gjithashtu jam i lumtur, që patëm mundësinë që ta kalonim bashkë. Faleminderit për gjithçka që ke bërë për mua!

MARKO - Shoku im i ngushtë që në klase të 6 -të jemi bërë aq shpejt shokë ,sa nuk e kuptoj si arriem deri këtu. Thjesht jemi çuar një ditë ku ishim shokë. .Momentet që kemi kaluar bashkë ,duke përfshirë dhe zënkat se shoqëria pa zenka nuk ka sipas mendimit tim, por gjithsesi këto momente s'nuk do t'i ndërroja me asgjë në këtë botë. Në një farë mënyre jemi rritur bashkë, kemi marrë dhe kemi dhënë për njëri-tjetrin. Më shumë kam ndenjur me ty se sa me të shtëpisë sime, me pak fjalë je si një vëlla që s'do ta jepja për asgjë (përveç një loje kalçeto). Ti e di që s'jam shumë i mirë për ta shprehur se çfarë ndiej me fjalë, por duke të acaruar dhe duke bezdisur ose thjesht duke të kundërshtuar për gjëra koti. Të uroj shumë suksese dhe shpresoj që të të plotësohen të gjitha ëndrrat!

GELDI - Andrea ti je shoku më i mirë që çdokush do të donte ,por fati më ra mua. Që në klasën e gjashtë kur u njohëm për herë të parë e dija që shoqëria jonë do të zgjaste dhe vertet ashtu ndodhi. çdo moment i kaluar me ty është i rrënjësor thellë në kujtimet e mia dhe kurrë nuk do të shkulet. Më je gjendur gjithmonë pranë,pavarësisht situatës ,kjo të bën një shok të vërtetë. Nuk do të ndryshoja asgjë në momentet me njëri-tjetrin, por do ti ribëja dhe një herë me gjithë qejf.

TEDI-Për ty kam shumë gjëra për të thënë ,po është më mirë t'i flasim bashkë ,kur jemi jashtë se këtu (s'dalin fjalët)ke qenë një shok shumë i dashur dhe gjithmonë je i gatshëm për shoqërinë , nuk e besoja se do bëheshim shokë kaq të ngushtë me njeri -tjetrin. Kam video dhe foto me ty pafund qe të kujtojnë dhe të shkuarën.Edhe pse kemi pasur zënka dhe hatërmbetje me njëri- tjetrin nga fillimi,prapë kemi ndenjur afër bashkë.S'do ta harroj asnjëherë shoqërinë me ty dhe të uroj shumë suksese në të ardhmen miku im ke një vend në zemrën time që jo të gjithë e kanë.Shpresoj të jemi shok dhe më vone në universitet.



Kledino Sala

Bergi Avdulaj- Kur të pashë për herë të parë në vit të dytë ,nuk e mendova se shoqëria jonë do të ishte kaq e ngushtë. Si vlonjati(tepelensi) i tretë i klasës, kemi bërë një grup shumë të fortë. Ku ziheshim çdo ditë bashkë duke bërë rrëmujë gjithë klasën e cila do të jetë padyshim një nga kujtimet më të bukura që do të marrë me vete nga gjimnazi. Unë e di se ti je një person, i cili e mban fjalën e tij dhe gjithmonë i dashur për shokët ,prandaj edhe të vlerësoj shumë si një shok, që i ke bërë këto vite shumë të bukura. Edhe pse nuk do të jemi më bashkë e di, që shoqëria jonë do të mbetet ashtu si dhe është tani. Faleminderit për gjithçka që ke bërë për mua!

Noel Sulejmani- Në fillim kur erdha nuk ma mori mendja që do ishim kaq shokë. Për një vit kemi ndryshuar shumë me njëri-tjetrin. Jemi më të matur dhe të kujdesshëm. Kalojmë shumë kohë bashkë dhe asnjëherë nuk mërzhitemi. Më pëlqen që edhe pse je me një temperament shumë impulsiv, i zgjidhim konfliktet brenda ditës. Je djalë shumë pozitiv dhe tolerant. Shpresoj të kalojmë shumë momente të tjera së bashku. Shume suksese ,Dino!

Denis Alliaj- Dinoo je një nga çunat më danoç që kam njohur. Është shumë e veshtirë ta pranoj tani që po të shkruaj dedikimin që nuk do jemi më bashkë për ditë. Gallatat e pafundme, aventurat kudo,zënkat pa kuptim për të shtyrë kohën dhe çdo gjë që kemi bërë gjatë këtyre dy viteve kanë qenë një nga pjesët më të bukura të gjimnazit. Gjatë këtij viti të fundit kemi qenë të pandashëm dhe nuk e besoj dot se kjo gjë do ndryshojë, por ama jeta këto i ka. Ne nuk para flasim për këto gjëra sentimentale, po që gjithmonë do mbetemi shokë edhe pse do të jemi larg. Të uroj shumë suksese dhe të arrish të gjitha qëllimet e tua


në jetë edhe pse ndonjëherç të themi që nuk i bën dot unë e di që ti e bën.

Marko Ismaili- Kledino kur erdhe në fillim në klasë në vitin e dytë ,mendova që s'do te kisha të bëja me ty, ,por koha më tregoi që e kisha gabim. Kemi kaluar shumë momente të bukura së bashku. Muhabetet që kemi bërë rrugës për shtëpi si ndërroj me asgjë aq shumë më kanë shijuar kemi qarë hallet te njëri -tjetri dhe nuk e di si kuptoheshim aq mirë ,nuk shihemi dot në sy në një moment serioz se ja plasim të qeshurës. Shpresoj që ta mbajmë shoqërinë që kemi dhe të uroj gjithë të mirat!

Andrea Cela- E mbaj mend si sot kur te dera e klasës shfaqet një fytyrë e ngrysur me rrënjë Vlore o nëna. U bëm shokë në kohë rekord. Shkëmb në pamje shkëmb në kokë ,Dino nuk di të çaj kokë për njeri përveç çunave të tij ,që ai i do fort dhe shpesh ua thotë. Ke qenë një shok siç e do nëna. Bashkë kemi qeshur aq shumë sa ndonjëherë duhej pak seriozitet fallco që të mos linim nam. Të njëjtin mendim që pata kur të pashë për herë të parë ,kam edhe sot, vlonjat i egër nga jashtë, por i butë nga brenda për ata që i do fort, anën tjetër ju këshilloj mos ta provoni si shumë. Të uroj gjithë të mirat dhe do zoti të realizohen të gjitha dëshirat!

Tedi Hajderi- Dino jemi njohur vjet në klasë kur isha që në fillim në bankë me ty dhe filluam menjëherë shakat menjëri tjetrin dhe më je dukur një njeri shumë pozitiv dhe të vlerësoj shumë për këtë,më kujtohet kur të ndihmoja atëhere nëpër teste dhe që qeshnim bashkë në orët e mësimet.Kemi kaluar këto dy vite momente shumë të bukura bashkë dhe sdo t'i harroj asnjëherë. Ke qenë një shok me të vërtetë zemërgjerë dhe të falenderoj që më ke ndenjtur pranë gjithë këtë kohë dhe të uroj shumë suksese në të ardhmen miku im!

Ersi Uruci- Dino, gjithmonë do të dallohesh për zjarhtësinë tënde. Më ka përlqyer gjithmonë te ti pasioni që kishe pas gjërave. Miqësia jonë ka filluar vjet, por përsëri është shumë e fortë. Ti je dikushi i cili je shumë i sinqertë (edhe pse shumë hatër), besnik dhe kjo transparencë dhe sa i drejtpërdrejtë, më ka bërë mua që të të kem edhe shok më të afërt. Një aftësi e jotja që unë kam vënë re dhe më pëlqen shumë është se ti di shumë fakte mbi tema rastësore. Kemi krijuar shumë kujtime së bashku dhe pa dyshim do të krijojmë akoma edhe më shumë te tjera. Të uroj suksese në jetë!



Ted Hajdëri

Andrea Cela- Për ty miku im nuk do të lodhem shumë, sepse sidoqoftë fjalët nuk të përshkruajnë ashtu siç je në të vërtetë. Ke qejf të tregosh aq pak për veten dhe kjo më pëlqen ,epse e bën tipin tënd më ekskluziv, jo të gjithë e kanë luksin të të njohin nga afër. Akoma se besoj që kaluan 5 -vite qëkur të kam njohur në klasë të 8-të, por këto 3 -të fundit do mbeten gjithmonë më të bukurat. Sa e sa herë e kena abuzuar shtëpinë tënde dhe nuk ke thënë fjalën më të vogël, përkundrazi ke dashur të na ftosh përsëri sekondin që të jepej shanci. Ishte një eksperiencë sa e bukur aq edhe e shkurtër. Nuk e ndjen kohën kur rri me njerëz si ty. Sa e sa kujtime kemi bashkë ,nuk dalin 3 kompjutera t'i ruajnë vidiot me njëri-tjetrin. I urtë kur do dhe eksploziv në raste të veçanta. Ke qenë gjithmonë më i madhi me moshë dhe me zemër, por jo të gjithë arrijnë ta kuptojnë, vetëm ata që të duan dhe të njohin ndryshe nga të tjerët. Jemi zënë plot here, sepse jugorët kanë ngjashmëri të frikshme dhe kur janë bashkë bëjnë masë zakonisht. Sidoqoftë ato vetëm kanë forcuar shoqërinë tonë dhe kush thotë të kundërtën se ka provuar çfarë do të thotë të ketë një shokë si ty. Një kënaqësi e papërshkrueshme t'i kaloja vitet e gjimnazit në klasë me ty. Shpresoj me gjithë zemër se batutat nuk do të mbarojnë edhe në vitet e ardhshme. Të uroj suksese në Holandë dhe shtrohu , se s'do jenë çunat vërdallë të të hallaksin me shakat e tyre.

Geldi Pepa-Ti ke qenë nje mik i vërtetë, më ke bërë gjithmonë për të qeshur me shakatë e tua dhe me buzëqeshjen tënde të veçantë. Netët në shtëpine tënde kanë qenë të paharrueshme pavarësisht”qenit që lehte” pa pushim e s'na lejonte të flinim ndaj të uroj suksese në jetë.

Noel Sulejmani- Që në klasë të 6 -të kemi qenë shok duke bërë asfin me vitamina që gjithmonë do e përmend te këto dedikimet. Që atëherë jemi miqësuar më shumë dhe jam mirënjohës për këtë. Një nga gjërat që do mbahesh mend te ne është që na ke marrë gjithmonë në shtëpi, kur s'kemi pasur ku me fjetur. Gjithashtu je djali me më shumë emra. Kemi kaluar shumë momente bashkë dhe eksperiencia të përbashkëta. Te uroj shumë suksese Strongu!

Bergi Avdulaj- Gjithmonë kemi qenë bashkë, duke filluar nga shkolla deri tek sporti. Në pjesën më të madhe të kujtimeve të mia deri tani je pjesë e këtyre momenteve të rëndësishme. Të kesh një shok kaq besnik nuk është asgjë e lehtë në ditët e sotme dhe mund të ndërtohet vetëm me kalimin e kohës. Fotoja jonë legjendare pas stërvitjes do të mbetet gjithmonë një prej më të preferuarave. Faleminderit për gjithcka që ke bërë për mua!

Kledino Sala- Tëdo aq shumë nofka të kam vendosur sa nuk numërohen. Shoku i parë i bankës që kisha në këtë shkollë. Kur të shihja konfuzohesha nga sjellja jote dhe të dija shumë të ndrojtur ,por në të vërtetë pasi mësohesh je një njeri totalisht ndryshe. Ke një vetëbesim të paparë dhe për këtë të përgëzoj,pasi është diçka që shumë pak veta e kanë. Dua të të falenderoj që ke qenë një shok aq i mirë dhe nuk do të harroj kurrë. Të uroj sa më shumë suksese në jetë!

Ersi Uruci-Ne dy kemi një miqësi shumë të hershme me njëri-tjetrin ,kur u njohëm te Superiori që kur kemi qenë fëmijë të vegjël. Më habitje gjithmonë me aftësitë e tua në basketboll. Kur u njohëm në klasë të gjashtë kuptova që ishe gjithashtu edhe një djalë shumë i mirë. Kemi shumë kujtime së bashku të cilat nuk do i harroj kurrë dhe jam shumë i lumtur që kemi qenë shokë së bashku. Ke shumë cilësi në karakter të cilat nuk i sheh te të tjerët dhe kjo të ka bërë që të jesh i veçantë nga të tjerët. Të uroj suksese në çdo gjë në jetë dhe shpresoj të takohemi përsëri!

Marko Ismaili-Tedi s'mjaftojnë fjalët për të shpjeguar shoqërinë tonë dhe ti e di sa shumë të dua unë pavarësisht se të mërzis ndonjëherë, por ti më njeh aq mirë sa shumicën e kohës nuk i merr fare për bazë fjalët e mia, ju e dini që unë dashurinë time për ju se shpreh dot me fjalë, por duke ju bezdisur dhe acaruar. Të uroj suksese të përzemërta dhe të dua shumë.



Marko Ismaili

Marko, ti je njeri konfident dhe i organizuar, kur bëhet fjalë për projekte. Futbollin në orët e fizkulturës me ty është një nga momentet më të këndshme të ditës. Shpresoj që të arrish synimet që ke, jo vetëm në universitet, por edhe në vazhdim. Të uroj një jetë me plot sukses dhe gëzim. Buen Hoxha

Bashkë kemi filluar të flisnim në klasë të 8-të kur vije te menca në mëngjes. Tani në gjimnaz jemi miqësuar shumë dhe na shtyhet shumë muhabeti. Kemi qenë të gjendshëm për njëri-tjetrin dhe kemi ndarë shume eksperiencë bashkë. Je një shok i mirë dhe pozitiv. Të uroj shumë suksese! Noel Sulejmani,

Marko është një djalë shumë gazmor të cilin do ta vesh re menjëherë sa hyne në klasë. Atmosfera që krijon së bashku me djemtë e tjerë e bën edhe orën më të lodhshme të bëshme. Të uroj suksese dhe një të ardhme sa më të ndritur! Marko, ti ke diçka të veçantë që më ka bërë mua, që të më shkojë shumë muhabeti me ty. Mund të jetë humori, njohuritë, shoqëria jote ose një kombinim i të gjitha këtyre së bashku. Ne kemi krijuar shumë kujtime së bashku në këtë gjimnaz që nuk kam për t'i harruar ndonjëherë dhe jam shumë mirënjohës që të kam pasur afër gjatë kësaj kohe. Shpresoj që në të ardhmen të takohemi përsëri dhe të uroj suksese në jetë! Ersi Uruci

E njoh që pa vënë telat, aq shumë vite kanë kaluar. Ikën tmerrsisht shpejt sa vetëm fotot e provojnë se me mendje nuk jam duke të bërë dedikim tani, por jam diku më larg duke mbledhur pëllumbat. Dua të them se je një djalë me vlera, i shkathët, i zgjuar, praktik, gazmor dhe mbi të gjitha i respektuar nga të gjithë. 4 ditë më i ,por ai është çami i preferuar ndër gjithë të tjerët. Marko ka vendin e vet të cilin ndër vite

nuk ka mundur njeri ta zëre sado janë përpjekur. I uroj shumë suksese të përzemërta në plotësimin e ëndërrave të tij. Andrea Cela


Marko që në vit të dytë jemi bërë shokë shumë të ngushtë dhe kemi kaluar gjëra të panumërta bashkë, të mira dhe të keqja. Mund të them që je një njeri shumë kokëfortë dhe i zgjuar. Kokëfortësia nga të gjithë, meret si një kualitet i keq, por përkundrazi është ajo që të bën ty ,ai që je gjithmonë duke ia gjetur anën gjërave me kokëfortësinë dhe shkathhtësinë tënde. Je një shok shumë i mirë dhe të falenderoj për kujtimet e bukura që kemi bashkë nga gjimnazi. Nuk do të harroj kurrë dhe shpresoj që ta përdorësh atë kokëfortësinë tënde për të çuar përpara në jetë. Të uroj suksese vëllaçko! Kledino Sala

Marko jemi njohur në vit të parë dhe të them të drejtën nuk e mendoja se do ishim shok dhe do të kalonim gjërat që kaluam bashkë. Gjatë vitit të dytë si brenda dhe jashtë shkolle kemi bërë aventura të pafundme dhe ja kemi kaluar mrekullueshëm. Gjithmonë me mendimet e tua të çuditshme dhe gëlltat e pafunda, e ke zbuluar kohën në gjimnaz. Të uroj suksese. Denis Alliaj

Marko je një shok vërtet tërë këto vite ke qenë aty për mua dhe s'më ke lënë kurrë në baltë, prandaj e vlerësoj shumë shoqërinë tonë. Shakatë e panumërta në bankën e fundit me ty ,do të jenë të paharrueshme për mua. Suksese në jetë! Geld Pepa

Marko mër Marko që ma heq trurin gjithmonë, sa herë dalim do e gjesh ndonjë gjë, por përsëri shoqëria jonë ka qenë shumë e fortë dhe e mirë. Mos harro se gjithmonë unë kam te drejtë, kur flas siç ke thënë dhe vetë. Kemi shumë momente të bukura bashkë dhe s'ia vlen t'i përmend vetëm me një dedikim. E di ti fjalinë time që them unë. Të uroj shumë suksese në të ardhmen miku im, puç, të kam xhan!

Ted Hajderi



Geldi Pepa

Andrea Cela-

Nga t'ia zë e nga t'ia nis unë tani. Do përpiqem të them vetëm pse jam me fat që të kam përkrah në të mira e të këqija se ndryshe nuk mjaftojnë 3- fletë. Kemi qesh pafund dhe kur them pafund hiq orët e gjumit pjesa tjetër me lot. Nganjëherë ndonjë zënkë sa për suspancë aty. Jo seriozisht të kam mërzhitur disa herë (disa kanë qenë sa për provokime dhe i ke kaluar sprovat), përtej kësaj e di që sidoqoftë shoqëria qëndron e fortë dhe duhet një mal ta ndajë atë. Ndër të gjitha cilësitë e tua do të përmendja, zgjuarsinë, shkathtësinë, humorin dhe mbi të gjitha besnikërinë. Për ta mbyllur këtë dedikim të vakët, sepse nuk mund të shkruaj sa të dua unë, për dikë që nuk e njeh, Geldi është ai person që nëse të kap duke bërë gjënë e gabuar ndërhyr pa të marrë leje, jep gjithmonë përgjigjen më të sinqertë. Ai është transparent, nuk i njeh filtrat (vetëm të motorrit). Mekaniku lalit do na nderojë kudo që të shkojë, prandaj i uroj urimet më të përzemërta dhe pres t'i plotësojë të gjitha dëshirat dhe qëllimet që ka!

Tedi Hajderi-

Geldi Pepa ,ke qenë një shok shumë i mirë që kur jemi njohur nga klasa e 8-të dhe kemi kaluar momente mjaft të bukura me njëri- tjetrin,por këtë vit ka qenë më ndryshe ,pasi këtë vit kemi ndenjur më shumë bashkë dhe ka qenë një privilegj të të kishe ty afër dhe këshillat e tua që më jepje kur kemi zënka. Të falenderoj që më ke ndenjur pranë gjatë gjithë gjimnazit dhe të uroj shumë suksese në të ardhmen dhe dihet që do jemi shokë edhe më vonë

Shefrin Shtylla-

Për ju që nuk e njihni, Geldi është nga ata persona që nuk "pushon së foluri". Edhe kur mendon se e ka mbyllur gojën për një çast, Geldi është vetëm duke

marrë frymë për t'u kthyer prap në rrugë të të folurit. Të uroj suksese!

Adela Shahini- Geld ty do të të mbaj mend gjithmonë si një nga çunat më të vendosur dhe të shkathët të klasës. Përherë i qeshur dhe plot humor. Shumë suksese kudo në jetë!

Jon memushi-

Geldi është një ndër djemtë që nuk do i zëvendësoja më asnjë nga klasa ime. Është një ndër djemtë më energjik dhe më optimist që kam njohur, i cili gjithashtu di gjithnjë, kur duhet të ruajë seriozitetin dhe të tregojë intelektin e tij. Të uroj suksese në çfarëdolloj rruge që do të ndjekësh.

Buen Hoxha-

Geldi, ti je një lider në çdo moment. Qeshja jote e përhershme i bën të gjithëve rreth teje të ndihen më mirë. Orët e fizkulturës me ty janë një kënaqësi e vërtetë, plot energji dhe motivim. Shpresoj që të arrish synimet që ke, jo vetëm në universitet, por edhe në vazhdim. Të uroj një jetë me plot sukses dhe gëzim!

Kledino Sala-

Geldo nuk prisja te bëheshim shokë që në fillim ,por ti erdhe aq shpejt dhe e zure vendin si një nga shokët e mi më të mire,saqë nuk e kuptova se kur ndodhi. Je një nga njerëzit më të vendosur që njoh dhe nuk i le asnjëherë dy gurë bashkë. Zgjuarsia jote te jep shumë pikë në karakterin tënd. Kemi kaluar një kohë që shumë njerëz mund ta quajnë të shkurtër, por në këtë kohë të shkurtër ne kemi patur eksperiencat të panumërta. Nuk kam për të harruar kurrë dhe të uroj suksese në rrugën e jetës që ke përpara.

Enio Kazazi-

Geldi, gazi i klasës sa here që flet ,të qeshurat s'kanë mbarim. Të kam njohur që nga klasa e 8-të dhe kujtimet që kam janë të panumërta ,që nga te dalurat, discordi e tjt. Ky vit s'ka qenë shumë ndryshe i mbushur me biseda, grindje e të qeshura pafund. Uroj që rruga jote e jetës të vijojë me gëzim dhe sukses të vazhdueshëm

Noel Sulejmani-

Kemi qenë shok që në klasë të nëntë. Më përpara nuk njiheshim ,por kemi shkuar mirë. Kemi këshilluar njëri-tjetrin, kemi dalë, dhe kemi ndarë mendime të rëndësishme. Je gjithmonë shumë i gatshëm për të ndihmuar dhe këtë e vlerësoj shumë. Të uroj shumë suksese!





Matura 2024

REDAKTORËT

Anxhela Demiri

Emilja Zeneli

Erisjona Bunaj

Emili Leka

Joana Taraj

Vesa Çeliku

Kejsi Çuçaj

Arsia Sefaj

Bergi Avdulaj

Kaltrina Hoxhalli



Matura 2024







